RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI
"AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË"

"BASHKIA DURRËS"

Tiranë 2024

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit 4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 6
3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit 13
II. HYRJA 16
1. Objektivat e auditimit 16
2. Qëllimi i auditimit 17
3. Identifikimi i çështjes 17
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 17
5. Përgjegjësitë e audituesve 17
6. Kriteret e vlerësimit 17
7. Standardet e auditimit 18
8. Metodologjia e auditimit 18
9. Dokumentimi i auditimit 20
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 20
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin 20
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit 20
2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik 20
2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit. 47
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2022 108
2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik 138
2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike. 186
2.5 Mbi organizimin, funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit 203
2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtës së Territorit 232
2.7 Të ndryshme të dala gjatë auditimit 259
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME 271
V. ANEKSET 302

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
TAK	Titullari i Autoritetit Kontraktor
DT	Dokumentet e Tenderit
KVK	Kriteret e veçanta të kualifikimit
UKD	Ujësjellës Kanalizime Durrës

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektiv vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Durrës, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, etj. Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive kryesore nga Bashkia Durrës si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Nuk është hartuar plani i menaxhimit të risqeve të nivelit të lartë e të mesëm për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
- Realizimi i buxhetit për *vitin 2022* është 7,235,165 mijë lekë nga 8,648,771mijë lekë të planifikuara, ose në masën 84%.Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 230-231 "Shpenzime për investime" në masën 62%, që ka ardhur nga mos realizimi dhe finalizimi me kontratë i 56 projekteve të planifikuara, për të cilatnuk janë kryer procedurat e prokurimit, ndërsa për 41 projekte të planifikuara, për të cilat janë celur edhe fondet janë financuar pjesërisht ose nuk janë financuar për arsye të mos mbylljes së punimeve Brenda vitit buxhetor nga lidhja e kontratave me vonesë. Gjithashtu 12 projekte investimi të Rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019 të planifikuara janë financuar nga fondet e rindërtimit në masën 50%, për shkak të mosakordimit të fondeve nga buxheti i shtetit për mbylljen e këtyre investimeve.
- Nuk është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura të rezultuara në fund të vitit 2021 në vlerën 156,887,958 lekë**.**Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 110,374,392 lekë.Detyrimet e papaguara rakordojnë me gjendjet e llog. të klasë 4 të bilancit të vitit 2022, por nuk rakordojnë për shumën 36,370,104 lekëme raportimin në MFE të vitit 2022 në vlerën 74,004,288 lekë , diferencë që i përket e detyrimeve të prapambetura për investime të pa financuara nga Ministritë e linjës dhe FZHSH, të cilat nuk janë përfshirë në raportim. Ndërsa gjatë vitit 2022 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura.
- Financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 89% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike) dhe 11% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat, që siguron njësia vendore nga burimet të tjera.
- Vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 prej 165,047,159 lekë, është e pasaktë, pasi kjo vlerë i përket vlerës debitorëve të krijuar në vitin ushtrimor 2022. Nga të dhënat e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vlera progresive në datë 31.12.2022 e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 799,162,272 lekë, duke sjellë një mosrakordim për vlerën 634,115,113 lekë.
- Nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve nuk është kërkuar bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, për të kërkuar monitorim dhe konsulencë juridike për mosmarrëveshjet që kanë lindur nga zbatimi i kontratave apo marrëveshjeve në rastet e konflikteve civile, nga mosrespektimi korrekt i tyre.

-Nga Sektori i pronave publike dhe menaxhimit të aseteve për periudhën janar-dhjetor 2022 është aplikuar për regjistrim në DV ASHK Durrës vetëm 3 pasuri që janë vendosur në dispozicion të drejtorisë së urbanistikës për dhënien e lejes së zhvillimit për objektet të dëmtuara nga tërmeti, ndërsa për (asetet) pasuritë e tjera vazhdojnë të mos jenë të regjistruara në regjistrin publik në DV ASHK Durrës, që do të thotë se nuk ka kërkesë për aplikim "Regjistrim Akti" pajisje me certifikatë pronësie dhe kopje kartele dhe harte.
-Në 2 raste, nga Sektori i Administrimit të Pyjeve, nuk është Monitoruar zbatimi i kushteve të kontrates së qirasë në lidhje me mos pagesën e qirasë në kohën dhe në mënyrën e caktuar në kontratë**,** *duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumen totale prej 18,922,298 lekë*, në kundërshtim me nenet e përcaktuar në kontratë dhe në kundërshtim me nenin 830 të Kodit Civil.
-- Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me objekt "Shtimi i funksionaliteteve të konrollit dhe kalkulimeve të taksave, vjeljes së detyrimeve dhe menaxhimit më eficient të buxhetit fikal në sistemin ekzistues të Bashkisë Durrës", u konstatua se pas kërkesës së Bashkisë Durrës drejtuar AKSHI-t për miratimin miratimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike për përmirësimin e sistemit ekzistues, AKSHI nuk e ka bërë miratimin e specifikimeve teknike, duke njoftuar Bashkinë Durrës që po kryhet një procedurë prokurimi që përfshin procedurën e filluar nga kjo bashki. Edhe pas këtij njoftimi AK Bashkia Durrës, ka kryer prokurimin e këtij shërbimi me fond limit 32,989,483 lekë. Ky investim, me implementimin e projektit për të cilën ka filluar procedura e prokurimit në AKSHI, nuk do të funksionojë më**, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve të Bashkisë Durrës në vlerën 32,989,483 lekë.**
- Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se në 5 raste, në vlerën totale të fondit limit prej 524,304,287 lekë, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
- Nga auditimi i zbatimit të kontratës së shërbimit, me objekt "Depozitimi i mbetjeve urbane", Bashkia Durrës, me vlerë të kontratës (pa tvsh) 281,508,800 lekë, realizuar nga OE "I " BV SPV (për 12 muaj), rezultoi se në kontratë nuk ekzistojnë specifikime teknike të detajuara, nuk ka një peshore dhe persona përgjegjës për peshimin e mbetjeve para transportit për në Landfill-in e Sharrës, veprime që krijojnë hapësira dhe mbartin riskun për shifra fiktive të ardhura nga Furnizuesi dhe për pagesa të pajustifikuara.
-Për periudhën janar-dhjetor 2022 nga Inspektoret e Inspektoratit të Mbrojtjes të Territorin në Bashkinë Durrës, *janë proceduar gjithsej 154 subjekte* për ndërtime in formalë të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit të pa shoqëruara të gjitha me Vendim për "Prishje të Objektit të Kundërligjshëm" dhe me Vendim për "Dënim me Gjobë" në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
-Në 35 raste edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, *nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm"* në kundërshtim me nenin 5 pika "d" dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
-Në 34 raste, edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, *nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë",* në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
-Në 94 raste, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektit të Kundërligjshëm", që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishje**.** vijojnë të pa ekzekutuara nga

IMT-ja e Bashkisë Durrës, duke u bërë shakatarë i rritjes së numrit të ndërtimeve in formalë që kalojnë në procesin e legalizimit, ku subjektet kanë përfituar parcela ndërtimore në pronësi publike, në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" dhe nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe në kundërshtim me nenin 52 pika 6 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjeve	Rëndësia	Rekomandimi
1	Në 7 raste nga Bashkia Durrës, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve Bashkia Durrës dhe Administrata e Ndërmarrjes BGT, është lejuar të ushtrohet aktivitet nga subjekte private në objekte pasuri shtetërore pa Kontratë-Qiraje në kundërshtim me kreun VI pika 2/b të VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar.	E lartë	Nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve Bashkia Durrës dhe Administrata e Ndërmarrjes BGT, të njoftohen me shkrim Qiramarrësit, për "Zgjidhje Kontrate" pasi është mbyllur afatit i kontratës së qirasë për sipërfaqen e objektit të pasurisë shtetërore si dhe të merret në dorëzim me procesverbal objektet që ka në administrim pa Kontratë-Qiraje.
2	Në 34 raste edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vjiuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm", në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.	E mesme	Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës, të vijoj procedurën për nxjerrjen e Vendimit për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm", për 35 subjekte që janë me procesverbal konstatimi për ndërtime in formalë të ndërtuar pa leje ndërtim të mbajtura nga Inspektoret e terrenit.
3	Në 34 raste edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë", në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar	E mesme	Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës, të vijoj procedurën për nxjerrjen e Vendimit për "Dënim me Gjobë", për 34 subjekte që janë me procesverbal konstatimi për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtim të mbajtura nga Inspektoret e terrenit.
4	Nga 119 vendime për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm", janë të ekzekutuara vetëm 25 vendime për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm" të shoqëruar me Urdhër Ekzekutimi nga Kryeinspektori i IMT-së, ***ndërsa 94 vendime*** për ***"Prishje e Objektit të Kundërligjshëm" nuk është vijuar procedura nga Kryeinspektori i IMT-së***, për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.	E lartë	Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës, të nxjerrë Urdhër Ekzekutimi për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për 94 subjekte që janë me Vendimit për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm".
5	Nga 154 procesverbal konstatimi për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, janë shoqëruar me ***Vendim për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm"*** vetëm ***119 Vendime për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm"***, ***ndërsa për 35 subjekte*** që kanë procesverbal konstatimi, ***nuk është vijuar procedura nga Kryeinspektori IMT-së për nxjerrjen e*** Vendimit për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm", në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe në kundërshtim me nenin 52 pika 6 e ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.	E lartë	Kryeinspektori IMT-së Bashkia Durrës, të nxjerrë Vendim për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm", për 35 subjekte që janë me procesverbal konstatimi për ndërtime in formalë të ndërtuar pa leje ndërtim të mbajtura nga Inspektoret e terrenit.
6	Nga Kryeinspektori i IMT-së i Bashkisë Durrës është nxjerrë "Urdhëri i Ekzekutimit" për prishjen e objektit të kundërligjshëm, por nuk është vijuar prishja e objektit me justifikimin se "…*mjeti*	E lartë	Në të gjitha rastet kur ka një Urdhër Ekzekutimi nga Kryeinspektori i IMT për prishjen e objektit të kundërligjshëm që nuk mund të ekzekutohen me mjetet

	tip ekskavator nuk mund të përshkoj distancën mbi 5 km për shkak se çdo divekt që mund ti ndodhi gjatë rrugëtimit të gjatë mund të nxjerrë mjetin jashtë përdorimit", që do të thotë se të gjitha objektet që janë për prishje mbi 5 km nuk janë të ekzekutueshëm nga IMT-ja e Bashkisë Durrës, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.		e veta, të kërkohet mbështetje me mjete nga Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për prishjen e objektit të kundërligjshëm.
7	Në 71 vendime "Për Dënimin me Gjobë" nuk janë likuiduar gjobat nga subjektet, në një vlerë prej 17,400,000 lekë. Nga zyra përmbarimore në asnjë rastë nuk është vijuar ekzekutimi i detyrueshëm për shlyerjen e detyrimit nga debitori konform nenit 606 të K.Pr.Civile, që do të thotë se IKM-ja nuk ka informacion nga zyrat përmbarimore mbi ecurinë e ekzekutimit për shlyerjen e detyrimit nga debitoret.	E lartë	Në të gjitha rastet kur kalon afati 10 ditor i ekzekutimit vullnetar i ekzekutimit për shlyerjen e detyrimit nga debitori, IMT-ja ti drejtohet me kërkesë zyrës përmbarimore për vijimin e ekzekutimit të detyrueshëm për shlyerjen e detyrimit nga debitori konformë K.Pr.Civile.
8	Nga auditimi u konstatua se Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" për taksa dhe tarifa vendore më datën 01.01.2018, ka qenë në vlerën 733,273,353 lekë. Gjatë vitit 2018 për këtë llogari ka pasur pakësime në vlerën 630,083,524 lekë, ndërsa më datë 31.12.2018, gjendja e e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 103,189,829 lekë. Për pakësimin e kryer në vlerën **630,083,524 lekë** e cila i përket detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore, nga Bashkia Durrës nuk administrohet asnjë vendim, shkresë apo dokumentacion për vlerën e pakësuar. **b.** Nga auditimi i procesit rezulton se nuk rakordon vlera e detyrimit vjetor të subjekteve në sistemin e DTTV me atë të paraqitur në evidencat për raportim në kontabilitet. U përzgjodhën në mënyrë rastësore 11 subjekte nga sistemi dhe u ndoq procesi i përgatitjes së regjistrit të borxhit prej të cilit përgatiten evidenca të ndryshme nga DTTV. Rezultatet e testimit të këtij procesi për 11 subjektet e përzgjedhura në trajtë narrative shprehen si më poshtë: Për vitin 2021 Detyrimi i evidentuar në sistem krahasuar me detyrimin paraqitur në evidencën për kontabilitet për vitin 2021 rezulton me diferencë negative. Në sistem detyrimi është 1,084,371 lekë më pak se detyrimi i paraqitur në evidencën për kontabilitet. Për vitin 2022 detyrimi i evidentuar në sistem krahasuar me detyrimin paraqitur në evidencën për kontabilitet për vitin 2022 rezulton me diferencë pozitive. Në sistem detyrimi është 888,520 lekë më shumë se detyrimi paraqitur në evidencën për kontabilitet Detyrimi progresiv vetëm në vitet 2021 - 2022 i evidentuar në sistem për këto 11 subjekte rezulton me difrerencë pozitive krahasuar me detyrimin paraqitur në evidencën për kontabilitet për vitin 2021. Në sistem detyrimi është **7,315,195 lekë** më shumë se detyrimi paraqitur në evidencën për kontabilitet. DTTV Durrës nuk paraqet në kontabilitet vlerën e saktë të detyrimit vjetor për subjektet. Sipas rezultateve të përfituara nga testimi konstatohet një diferencë në vlerën 7,315,195 lekë midis Kontabilitetit dhe Sektorit të Manaxhimit të Borxhit.	E lartë	Bashkia Durrës të bëjë saktësimin e vlerës të kërkesave për arkëtim mbi debitorët për të gjitha subjektet tatimpagues, duke përllogaritur detyrimet tatimore bazuar në paketën fiskale të miratuar në vite dhe nëse dalin diferenca të planifikohen për t'u arkëtuar dhe identifikuar debinë aktuale. Të paraqesin në dokumentacionin kontabël dhe në pasqyrat financiare vlerën e saktë të tyre. Bashkia Durrës të ngrej një grup pune për identifikimin e personave përgjegjes dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse për ndryshimin e detyrimeve në kontabilitet (pasqyrat financiare vjetore) dhe për pasqyrimin jo të saktë të detyrimit vjetor për subjektet, në shumën prej 630,083,524 lekë vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Durrës. Bashkia Durrës të bëjë saktësimin e vlerës prej 7,315,195 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Durrës si dhe rakordimin e të dhënave midis drejtorive me qëllim unifikimin e detyrimeve të taksapaguesve.
9	Nga auditimi i procesit të ç'regjistrimit dhe ndjekjes së subjekteve debitore nga DTTV u konstatua se evidencat e DTTV dhe raportet e sistemit të DTTV kanë mospërputhje midis tyre dhe detyrimet nuk pasqyrohen korrekt në pasqyrat financiare të bashkisë. Nga grupi i auditimit u përzgjodhën 40 raste nga lista e bizneseve të cilëve ju është ndryshuar statusi në Sistem (nga Aktiv në mbyllur, pasiv, pezulluar). Në përzgjedhjen e rasteve është marrë në konsideratë trajtimi i të gjitha fashave të detyrimit (vlerat e vogla për shpeshtësinë e prezencës në listën analitike, vlerat e ndërmjetme dhe të larta për peshën në vlerën e totalit të analitikes. Evidencat që u trajtuan për testim janë si më poshtë: Nga shqyrtimi i evidencave u konstatua se: Për të 40 rastet të cilat kanë ndryshuar status nga aktiv në mbyllur në sistemin e DTTV detyrimet nuk janë pasqyruar korrekt në të gjitha raportet e DTTV.	E lartë	Bashkiak Durrës të vendosi rregulla dhe procedura për njoftimin shqyrtimin dhe raportimin e dobësive administrative ku të përshkruaj qartësisht linjën e brendëshme dhe të jashtme të raportimit. Procesi i përpunimit të informacionit nga raportet që gjeneron sistemi të monitorohet në vazhdimësi nga menaxherët e të gjitha niveleve, për të garantuar marrjen e vendimeve të duhura të cilat prodhojnë pasoja financiare. Bashkia Durrës të bëjë saktësimin e vlerës të kërkesave për arkëtim mbi debitorët për të gjitha subjektet tatimpagues, duke paraqitur në dokumentacionin kontabël dhe në pasqyrat financiare vlerën e saktë të tyre. Bashkia Durrës të ngrejë një grup pune për analizimin e të gjitha fazeve të procesit të çregjistrimit të subjekteve debitore duke përllogaritur detyrimet tatimore bazuar në

	Nga auditimi u konstatua se nga 40 subjekte e marra për testim, 17 subjekte rezultojnë Aktiv në Regjistrin Elektronik të QKB dhe 20 subjekte rezultojnë me statusin çregjistruar ose pezulluar. Vlera e detyrimit për subjektet e analizuara sipas evidencave të përgatitura nga DTTV për kontabilizimin e borxhit për vitin 2022 **është 0 lekë**; Vlera e detyrimit për subjektet e analizuara sipas Sistemit të DTTV ndjekja në vite është **72,114,783 lekë;** Vlera e detyrimit për subjektet më sipër sipas raportit vjetor për subjektet debitore nga sistemi është 4,020,611 lekë; Vlera e detyrimit për subjektet mësipër sipas regjistrit të borxhit në format excel është 29,638,437.41 lekë; Vlera e detyrimit për subjektet mësipër sipas vlerës që mungon si rezultat i ndalesës së faturimit është 13,164,247 lekë; Vlera e detyrimit të subjekteve sipas evidencave të përgatitura nga DTTV për njoftim bllokimet në Banka për vitin 2022 është 58,246,567 lekë; • Procesi i ç'rregjistrimit në Rregjistrin Elektronik të QKB bëhet pa u shlyer ose bllokuar vlera debitore e subjektit. • Mbyllja në sistemin e DTTV për këto subjekte bëhet si rezultat i çregjistrimit në QKB për shkak të vonesave në kthim përgjigjet e DTTV *(Në rast të mungesës së një konfirmimi në kohë nga DTTV, QKB proceson me çregjistrimin automatik*). • Statusi (mbyllur, pezulluar, pasiv) në sistemin e DTTV bën që ky subjekt mos të ngarkohet me detyrime për taksa dhe tarifa vendore dhe nuk pasqyrohet më në asnjë raport apo evidencë. Pasqyrime të ndryshme të statusit të Subjekteve midis dy sistemeve (QKB-DTTV).		paketën fiskale të miratuar në vite dhe nëse dalin diferenca të planifikohen për tu arkëtuar dhe identifikuar debinë aktuale.
10	Nga auditimi i të ardhurave të vitit 2022 u konstatua se Bashkia Durrës nuk ka pasqyruar në pasqyrat financiare informacion sa i përket transferimit të kredisë së marrë nga Banka Qendrore Europiane (CEB) me ndërmjetësimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rolin e institucionit garant të këtij detyrimi. Në kontabilitetin e bashkisë ky transferim nuk është pasqyruar si huamarrje dhe nuk ka të dhëna kontabël ku të tregohet historiku i transferimit të gjendjeve të llograive të kësaj veprimtarie.	E lartë	Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të llogarive në mënyrë që pasqyrat financiare të sigurojnë informacion të saktë për pozicionin financiar të kredisë e marrë nga Banka Qendrore Europiane (CEB). Drejtoria Ekonomike në çdo rast të kryej kontabilizime të sakta dhe të plota të veprimatrisë ekonomike të njësisë.
11	Nga auditimi i planifikimit dhe arkëtimit të taksës së pasurisë biznes (ndërtesës), u konstatua se ka pasaktësi në identifikimin e pasurive, sipërfaqeve dhe kontratave përkatëse për planifikimin e saktë të taksës mbi pasurinë kategoria biznes. Nga auditimi rezulton se, taksa e ndërtesës transferohet nga subjektet që ushtrojnë aktivet te pronarët e pasurive të cilat nuk e paguajnë në vite këtë detyrim. Procesi i transferimit të këtij detyrimi rezulton me probleme sa i takon, akt konstatimeve të mbajtura nga inspektoret e verifikimit në terren.	E lartë	Bashkia Durrës të identifikojë çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e bashkisë, si dhe të planifikojë detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë. DTTV të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve e prapambetura.
12	Menaxhimi i tregut Agrobujqësor Bashkia Durrës dhe zenia e hapsirave tregtuese nga tregtarët nuk llogaritet sipas Paketës Fiskale të miratuar me m^2 por me banak duke sjell mungesë të adhurash për Bashkinë Durrës në vlerën rreth 10,308,545 lekë.	E lartë	Bashkia Durrës të marrë masa për verifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregjet të cilat administrohen nga bashkia. Të llogaris detyrimet për të gjitha subjektet që nga data kur ka filluar shfrytëzimi i këtij tregu, bazuar në VKB nr.160, datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit", pika A.2.6.3 "*Tarifa për sipërfaqe të tregut në administrim të Bashkisë Durrës*".
13	Nga auditimit i procedura pë dhënien me qira të sipërfaqeve funksionele të tregut Agrobujqësor u konstatuan se Kontrata e qirasë lidhur midis Bashkisë Durrës dhe OE "A " Shpk siprfaqja e zën nga ky subjekt e tejkalon sipërfaqen e marr e qira duke mos respektuar kontratat e lidhura me Bashkinë Durrës sa i përket përcaktimeve në nenin 2, pika 2.1 qëllimin i përdorimit të kontratës.	E lartë	Bashkia Durrës, sektori i pronave dhe sektori i kontrollit të marrë masa për verifikimin e sipërfaqes së zënë më tepër nga subjekti "A " Shpk, të përllogarisë diferencën dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për vjeljen e detyrimit të krijuar si dhe të kerkoj lirimin e sipërfaqes së zënë më tepër.
14	Nga auditimi i të ardhurave në Bashkinë Durrës u konstatua se për kategorin "Të ardhurat e trashëguara" u konstatua se nga Bashkia nuk ka një listë analitike për evidentimin e këtij lloji të ardhurash por është vetëm vlera totale në kontabilitet. Kjo e bën të pamundur	E lartë	Bashkia Durrës, të marri masa që të ardhurat e papërdorura gjatë vitit buxhetor dhe që trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës, të kontabilizohen sipas burimit të krijimit të tyre. Në çdo rast të bëhet kontabilizimi i

	verifikimin e burimit nga është krijuar kjo e ardhur (e ardhura e trashëguar) e si pasojë nuk jep mundësinë për të kontrolluar mënyrën e përdorimit të tyre. Për vitin 2022, nuk ka evidenca të sakta për llojin e të ardhurave (të trashëguara) të cilat do të shërbejnë si bazë për destinimin e tyre në shpenzime (procesin e buxhetimit)		plotë, i saktë dhe në kohë i llogarive shoqëruar me një listë analitike për evidentimin e këtij lloji të ardhurash.
15	Nga auditimi i_strukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore u konstatua se ndërthurrja e veprimtarisë së DTTV Durrës me sistemin e menaxhimit të të dhënave nuk kryhet bazuar në komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk ka një rregullore të brendshme për funksionimin e sistemit apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem. "Përdoruesit" organizohen dhe funksionojnë vetëm sipas kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara në pozicionin e miratuar në strukturën organizative dhe si kuadër rregullator përdorin detyrat dhe kompetencat e miratuara në rregulloren e brendshme të institucionit. **a.** Nuk ka informacion mbi veprimtarinë e kryer në sistem nga jashtë rrjetit të brendshëm të institucionit. Nga intervistat me stafin e Bashkisë Durrës konstatohet se persona jashtë strukturës organizative të kësaj Bashkie, pa një urdhër apo kontratë kanë akses në këtë sistem pa një protokollim të veprimtarisë dhe procesojnë procese të rëndësishme si gjenerim i detyrimeve në sistem apo delegim dhe ndryshim kompetencash për përdoruesit etj. Rezultojnë veprime në sistem jashtë orarit zyrtar. Nuk ka informacion të saktë për identifikimin e 3 përdoruesve "1130", "1210" dhe "-1". **b.** Informacionit i Sistemit të manaxhimit të të dhënave nuk përputhet me evidencat zyrtare mbi të cilat DTTV planifikon dhe raporton. **c.** Struktura e kategorizimit të sistemit për bizneset dhe popullatën është e ndryshme nga paketa fiskale e miratuar. **d.** Numri i subjekteve të evidentuara në sistem sipas statusit (Aktiv, Mbyllur, Pasiv, Pezulluar) është i ndryshëm nga evidencat e DTTV . **f.** Raportet që prodhon ky system dhe që përpunohen më pas në formatin excel nga sektorët për të ndërtuar evidenca nuk protokollohen. **g.** Nuk ka monitorim dhe dokumentim të rakordimeve midis raporteve të gjeneruara nga sistemi me formatet e përpunuara në excel nga operatoret. **h.** Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk rakordojnë me DTTV lidhur me: -Realizimet e të ardhurave që kanë përgjëgjësi të manaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB-në nr. 160, datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit". -Kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Durrës për informacion sa i përket gjendjes debitore (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve. "A janë të rregjistruar këto subjekte në sistemin e DTTV" dhe "A kanë detyrime të pashlyera?".	E lartë	Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me strukturat drejtuese të bashkisë, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e sistemit, përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem (të hartohet manuali i proceseve të punës, harta e proceseve të punës, gjurmët e auditimit, regjistri i riskut), bazuar në komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive, shkeljeve si dhe moszbulimin e tyre. Drejtoritë të angazhohen në procesin e monitorimit të sistemit, ku evidencat të vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të bazës së të dhënave, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga sistemi në evidencat format excel dhe më pas shkresore për raportime midis drejtorive apo drejt titullarit. Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë të rakordojnë me DTTV lidhur me kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Durrës për informacion sa i përket gjendjes debitore (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve.
16	a. Bashkia Durrës nuk ka krijuar strukturën vendore të apelimit tatimor (komisioni i apelimit tatimor dhe rregullorja për funksionimin e tij) e cila shërben për apelim të akteve vendore që lidhen me taksat dhe tarifat vendore. b. Nuk realizohet në kohë njoftimi i subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore pasi përllogaritja dhe azhurnimi i detyrimeve vjetore në system bëhet manualisht. Mungon një adresar i plotë dhe i qartë për kategoritë Familjarë dhe Biznes (*nuk përdoren metoda alteranative "e-mail" për njoftimin e tatimpaguesve*).	E lartë	Nga Bashkia Durrës të merren masa për të krijuar strukturën vendore të apelimit si dhe optimizimin e arkitekturës së sistemit lidhur me përditësimin e detyrimeve vjetore në mënyrë që njoftimi i subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore të bëhet në kohë, me qëllim ndjekjen e të gjitha etapave administrive dhe proceduriale për menjanimin e pasojave që mund të sjellin efekte financiare.
17	Nga auditimi i përputhshmërisë të "Sistemit Të Manaxhimit Të Të Dhënave Për Të Ardhurat" në Bashkinë Durrës u konstatua se Bashkia Durrës ka krijuar dhe administron " *Bazë* të dhënash shtetërore" e cila nuk është krijuar dhe nuk e kryen funksionin bazuar në kuadrin regullator në fuqi. Ky institucion nuk ka paraqitur kërkesë për regjistrimin në regjistrin kombëtar të bazave	E lartë	Bashkia Durrës të marrë masa për regjistrimin në Regjistrin kombëtar të bazave të të dhënave shtetërore pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në vijim (AKSHI). Të ndërtojë programin e sigurisë së informacionit bazuar në elementët kyç të tij, konkretisht: mjedisin i sigurisë së informacionit,

	të të dhënave shtetërore pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në vijim (AKSHI), i cili është autoriteti rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore.		vlerësimi i riskut, politikat e sigurisë, organizimi i sigurisë së TIK, menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, menaxhimi i aseteve, siguria e burimeve njerëzore, siguria fizike dhe mjedisore, kontrolli i aksesit, menaxhimi i incidenteve të sigurisë së tik, menaxhimi i vazhdueshmërisë së aktivitetit të njësisë, përputhshmëria.
18	Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 5 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit, apo të paargumentuara teknikisht, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" .	E lartë	Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.
19	Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se në 5 raste, në vlerën totale të fondit limit prej 524,304,287 lekë, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 150-210 të Projektraportit të Auditimit).*	E lartë	Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, të vlerësohen objektivisht kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.
20	Nga auditimi i zbatimit të kontratës së shërbimit nr. 9853/8 prot., datë 08.10.2021, me objekt "Depozitimi i mbetjeve urbane", Bashkia Durrës, me vlerë të kontratës (pa tvsh) 281,508,800 lekë, realizuar nga OE "I " BV SPV (për 12 muaj), rezultoi se në kontratë nuk ekzistojnë specifikime teknike të detajuara, nuk ka një peshore dhe persona përgjegjës për peshimin e mbetjeve para transportit për në Landfill-in e Sharrës, veprime që krijojnë hapësira dhe mbartin riskun për shifra fiktive të ardhura nga Furnizuesi dhe për pagesa të pajustifikuara.	E lartë	Nga Titullari i Bashkisë Durrës të merren masa të menjëhershme dhe të gjenden rrugët ligjore për amendimin e kontratës në lidhje me specifikimet teknike të detajuara, si dhe për gjetjen e zgjidhjes për peshimin e mbetjeve para transportit për në Landfill-in e Sharrës, me qëllim kryerjen e pagesave sipas shërbimit real të këtij procesi jetik për qytetarët.
21	-Nga auditimi mbi ankesën e shtetasit K.K , protokolluar në KLSH, me nr.587/3 prot., datë 20.09.2023, u konstatua se ekzistonin mangësi në lidhje me ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor të Formës së Prerë. Bashkia Durrës, përfaqësuar nga titullari institucionit, si personi i ngarkuar nga ligji, duhet të kishte kryer ekzekutimin e Vendimit të Shërbimit Civil nr. 169 datë 20.12.2010, lënë në fuqi me Vendimin nr. 14, datë 06.04.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës. Në total detyrimi që Bashkia Durrës ka për të paguar në favor të palës kreditore deri në Gusht 2023 është në shumën 7,980,855 Lekë. -Nga auditimi mbi ankesën e shtetasit G.K , protokolluar në KLSH, me nr.884 prot., datë 09.10.2023, u konstatua se ekzistonin mangësi në lidhje me ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor të Formës së Prerë. Bashkia Durrës, përfaqësuar nga titullari institucionit, si personi i ngarkuar nga ligji, duhet të kishte kryer ekzekutimin e Vendimit me nr. 3289, datë 26.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Në total detyrimi që Bashkia Durrës ka për të paguar në favor të palës kreditore deri në Dhjetor 2022 është në shumën 7,457,014 Lekë.	E lartë	Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe të shmangin në të ardhmen ndjekjen e procedurave të gabuara për çështjet e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.
22	Nga auditimi mbi ankesën e shtetasit K.K , protokolluar në KLSH, me nr.587/3 prot., datë 20.09.2023, u konstatua se ekzistonin mangësi në lidhje me ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor të Formës së Prerë. Në total detyrimi që Bashkia Durrës ka për të paguar në favor të palës kreditore deri në Gusht 2023 është në shumën 7,980,855 Lekë. -Nga auditimi mbi ankesën e shtetasit G.K , protokolluar në KLSH, me nr.884 prot., datë 09.10.2023, u konstatua se ekzistonin mangësi në lidhje me ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor të Formës së Prerë. Në total detyrimi që Bashkia Durrës ka për të paguar në favor të palës kreditore deri në Dhjetor 2022 është në shumën 7,457,014 Lekë.	E lartw	Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për shtetasit K.K dhe G.K dhe të shmangin në të ardhmen ndjekjen e procedurave të gabuara për çështjet e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

23	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të 7 kontratave për punë publike me objekt "Riforcim godine banimi 12 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, rruga Neki Libohova" nr.70, kod GIS 5061, 5063", "FV Ndriçimi rruga Neki Libohova dhe "Marta Durda"", "FV Ndriçimi rruga "Shoqëria Bashkimi", "Aleks Komeni", "Krisaq Boshnjaku", "Paskal Prodani", "Përforcimi i terrenit nga rrëshqitja e dherave në zonën e ndodhur në lagjen nr. 10, në kodrën pranë Currilave, nga ana veriore dhe perëndimore të saj", "Rikonstruksioni rruga Ali Pashë Tepelena, At Gjergj Fishta dhe Migjeni", "Rikonstruksioni rruga "Azem Hajdari - Migjeni" dhe "Rikonstruksion rruga Currila, segmenti hotel Ferrara-Guest House", Bashkia Durrës, me vlerë totale prej 280,100,908 me TVSH, fituar nga sipërmarrësit e punimeve, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën totale prej 2,794,896 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratat e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe OE fitues	E lartë	Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës totale prej 2,794,896 lekë pa TVSH nga 7 OE fitues në objektet e punëve publike, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratat publike, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
24	Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 2 raste u konstatua përllogaritje e gabuar e fondit limit në vlerën 534,240 lekë më shumë për vendosje të zërit të punës në mënyrë të paarfumentuar dhe 5,982,745 lekë më shumë për vendosje të çmimit jo sipas manualin në fuqi të çmimeve të punimeve të ndërtimit	E lartë	Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të nxjerrë përgjegjësitë për rastet e përllogaritjes së fondit limit në mospërputhje me legjislacionin e punimeve të ndërtimit dhe të marrë masat e nevojshme për mospërsëritjen e tyre në të ardhmen, me qëllim përdorimin me ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Durrës.
25	Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me objekt "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel F. – Guest House" Bashkia Durrës, mne fond limit 37,248,896 lekë pa TVSh, fituar nga OE "B. ShPK me vlerë 23,239,590 lekë pa TVSh, u konstatua se është skualifikuar padrejtësisht OE "K." ShPK me ofertë ekonomike 20,871,590 lekë pa TVSh, ose 2,841,192 lekë pa TVSh më pak se OE I shpallur fitues	E lartë	Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e skualifikimit të padrejtë të këtij OE dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Durrës
26	Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me objekt "Shtimi i funksionaliteteve të konrollit dhe kalkulimeve të taksave, vjeljes së detyrimeve dhe menaxhimit më eficient të buxhetit fikal në sistemin ekzistues të Bashkisë Durrës", u konstatua se pas kërkesës së Bashkisë Durrës drejtuar AKSHI-t për miratimin miratimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike për përmirësimin e sistemit ekzistues, AKSHI nuk e ka bërë miratimin e specifikimeve teknike, duke njoftuar Bashkinë Durrës që po kryhet një procedurë prokurimi që përfshin procedurën e filluar nga kjo bashki. Edhe pas këtij njoftimi AK Bashkia Durrës, ka kryer prokurimin e këtij shërbimi me fond limit 32,989,483 lekë. Ky investim, me implementimin e projektit për të cilën ka filluar procedura e prokurimit në AKSHI, nuk do të funksionojë më, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve të Bashkisë Durrës në vlerën 32,989,483 lekë.	E lartë	Bashkia Durrës, të nxjerrë përgjegjësitë për kryerjen e këtij investimi, që mund të dublohet me përfundimin e investimit nga ana e AKSHI-t dhe të marrë masat e nevojshme për mospërsëritjen e tyre në të ardhmen, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve të Bashkisë Durrës.
27	Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është e rregullt, pasi nuk janë përfshirë të gjitha sipërfaqet e ndërtimit të objektit (ambjentet e përbashkëta), por vetëm sipërfaqet e shfrytëzueshme, jo në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014, për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 46 dhe Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Neni 27. Referuar Nenit 46 të Ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, si dhe, Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore".	E lartë	Nga Bashkia Durrës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,592,925 lekë**, që përbën të ardhura të munguara shkaktuar buxhetit të Bashkisë Durrës, si pasojë e përllogaritjes jo të rregullt të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
28	Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, Bashkia Durrës nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nga auditimi u evidentua se mungojnë raportimet periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit, nuk janë hartuar hartat apo manualet e proceseve të punës, nuk janë ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës dhe nuk monitorohet progresi në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.	E mesme	Nga Kryetari i Bashkisë Durrës, Koordinatori i Riskut dhe Koordinatori i MFK -së të merren masa për: **1.1** -Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performance, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme. -Hartimin e programeve të trajnimeve gjithëpërfshirëse për punonjësit lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës së institucionit si dhe vlerësimin periodik të nevojave për trajnimin e stafit në

			lidhje me zbatimin e instrumenteve të kontrollit të brendshëm. -Përfshirjen në takimet e Grupit të Menaxhimit Strategjik, çështjet që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara. -Hartimin e procedurave të shkruara mbi rregullat e raportimit, i cili nuk duhet të jetë i fokusuar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva. -Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrin e konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre. -Vlerësimin e mundësisë së riskut për mashtrime dhe të kryhen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve, në mënyrë që vlerësimi i riskut të mashtrimit të bëhet pjesë integrale e procesit të menaxhimit të riskut. -Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike. -Ngritjen dhe përmirësimin e sistemeve e teknologjisë së informacionit, duke zbatuar procedurat e brendshme në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen dhe rikuperimin e të dhënave. -Sigurimin e qasjes publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit. -Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.
29	Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Durrës përgjatë vitit 2022, u konstatua se: Karta e Auditimit të Brendshëm, nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në MAB si dhe nuk është ngritur Komiteti i Auditimit. Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm nuk ka të përcaktuara mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës. Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve. NJAB, nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, asetet, etj.	E mesme	**Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Durrës të merren masa për: -Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, si një organ i pavarur, i cili vlerëson rezultatet e auditimit të brendshëm, duke lejuar auditimin e brendshëm të raportojë planet, veprimtarinë dhe rezultatet e tij, si dhe duke forcuar pavarësinë e njësisë së auditimit të brendshëm nga titullari i njësisë publike. **Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të merren masa për: -Përditësimin e Kartës së Auditimit dhe Programit për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese, -Shqyrtimin e risqeve më të rëndësishëm për planifikimin dhe zbatimin e projekteve, programeve në të cilat janë fokusuar objektivat strategjikë, të njësisë publike, -Audituesit e brendshëm gjatë hartimit të raporteve të auditimit të mbështesin dhënien e opinionit mbi funksionimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për çdo sistem të audituar.
30	Nga Titullari i Bashkisë Durrës nuk është ngritur komisioni nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, duke mos u kryer procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe ajo e asgjesimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në vlerën 2,201,233 lekë. Për këto aktive janë kryer veprimet kontabël të pakësimit konkretisht në llog. 214 "Instalime teknike, makineri dhe paisje" në vlerën 573,162 lekë dhe llog. 1,628,071 lekë, pa u kryer procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe ajo e asgjesimit të këtyre aktiveve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 95-114.	e lartë	Titullari i Bashkisë Durrës të ngrejë komisionin për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimi për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimi në vlerën 2,201,233 lekëdhe të shoqërohet me dokumentacionin ligjor përkatës. Më pas nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi të bëhet ndarja e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi në material të riciklueshëm nëse s'ka të kryhet procedura e asgjesimit, duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur apo djegur të dokumentuar.
31	Gjendja e llogarisë *16 "Hua Afatgjata"* në pasiv të bilancit paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 dhe 2021 në vlerën 0 lekë**,** ndërkohë që Bashkia Durrës ka marrë në vitin 2014 Kredi të	e lartë	Drejtoria e Financës të marrë masa për kontabizimin e saktë të kredisë për banesat sociale të financuar nga CEB për Bashkinë Durrës në llogarinë përkatëse 16 *"Hua Afat*

	financuar nga CEB në vlerën 3,341,000 euro ose në 352,937,752 lekë për ndërtimin e Banesave Sociale investim I kryer që në ato vite. Në fakt për pagesat e kësteve të kredisë është rënduar më pa të drejtë *llogaria 231 "Investime në proces",* kur ky investim është kryer si punime dhe si financime dhe kjo vlerë ka kaluar në llogarinë e aktiveve *212"Ndërtesa dhe konstruksione"***.** Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II, pika 2.3 nënpika 22, 23.		*Gjata",* kun në mbyllje të vitit 2023 për pagesat e bëra të kësteve të kontabilizuara më parë në *llog.231 "Investime në proces"* të kryhen veprimet kontabël sistemuese, duke i kaluar ato në gjendjen e llog.16 *"Hua Afat Gjata"*dhe në vazhdim për pagesat e tjera deri në likujdimin e plotë të kredisë. ".

3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinioni i auditimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Durrës për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të parashkruara në paragrafin e "**Bazës për opinion me rezervë**" pasqyrat financiare vjetore paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit Bashkia Durrës më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrit rregullator; Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare..

Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar,e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-nNe i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipë rpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 10,260 mijë lekë.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese për pasqyrat fainanciare të vitit 2022 janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e

opinioni të modifikuar, me rezervë [1], ku ka rezultuar se anomalitë janë materiale, por jo të përhapura sipas përshkrimit të çështjeve të mëposhtme:
- Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 468 " Debitorë të ndryshëm" konstatohet se, vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 prej 165,047,159 lekë , është e pasaktë, pasi kjo vlerë i përket vlerës debitorëve të krijuar në vitin ushtrimor 2022 dhe jo vlerës progresive në fund tëvitit 2022 prej 799,162,272 lekë, duke mos rakorduar për vlerën 634,115,113 lekë.
- Gjendja e llogarisë *4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"* në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 36,767,298 lekë, kur në fakt duhet të ishte në vlerën 49,010,534 lekë, pasi nuk është përfshirë vlera prej 12,243,236 lekë e llog.401-404 "Furnitore e llogari te lidhura me to".
-Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 146,665,977 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime",* për 27 projekt-studime për investime të kryera apo për investime të pakryera, ku për një pjesë nuk ka të dhëna nëse janë kryer investimet dhe përse vlera e këtyre studimeve nuk i është shtuar vlerës së aktivit të kapitalizuar.
- Referuar analizës së gjendjes së llogarisë *212"Ndërtesa Konstruksione"* u konstatua se 9 aktive afatgjata materiale në vlerë 118,775,472 lekë, ku në 8 raste prej tyre kanë emërtesa të paplota, ta paqarta dhe të pasakta, dhe 1 rast në vlerën 1,157,939 lekë nuk ka emërtim, gjë që do të thotë se inventari kontabël nuk përputhet me gjendjen kontabël për këtë vlerë. Për këto aktive nuk është bërë asnjë inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre.
- Gjendja e llogarisë *16 "Hua Afat Gjata"* në pasiv të bilancit paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 dhe 2021 në vlerën 0 lekë**,** ndërkohë që Bashkia Durrës ka marrë në vitin 2014 Kredi të financuar nga CEB në vlerën 3,341,000 euro ose në 352,937,752 lekë për ndërtimin e Banesave Sociale investim I kryer që në ato vite. Në fakt për pagesat e kësteve të kredisë është rënduar më pa të drejtë *llogaria 231 "Investime në proces",* kur ky investim është kryer si punime dhe si financime dhe kjo vlerë ka kaluar në llogarinë e aktiveve *212"Ndërtesa dhe konstruksione".*
- Gjendja e llogarisë *4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"* paraqitet si në mbeyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që shuma e gjendjeve të debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit është në vlerën 592,148,550 lekë përkatësisht: (gjendja e llog.468 "debitorë të ndryshëm" në vlerën 591,457,852 lekë + gjendja e llog.423-429 "Personeli,paradhënie, deficite, gjoba" në vlerën 690,699 lekë). Këto gjendje janë paraqitur në mënyrë të gabuar në llogaritë në pasiv të bilancit në gjendjen e llog. 475 "Të ardhura për tu rregjistruar vitet pasardhëse" në vlerën 591,457,852 lekë dhe gjendjen e llog.480 të ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar në vlerën 690,699 lekë.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë.
Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Durrës, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.
Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Durrës, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin", të

[1] *Sipas* ***Manualit të Auditimit Financiar*** *të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 246, datë 29.12.2022, kapitulli VII.3.5, fq 55: "****Një opinion i kualifikuar/modifikuar me rezervë*** *duhet të shprehet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, ose nëse nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë material por jo të përhapura. Opinioni i kualifikuar me rezervë jepet kur anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale; nuk janë të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet.*

cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar për përputhshmërinë.

Baza për dhënien e opinionit të modifikuar:

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

- Nga 119 vendime për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm", janë të ekzekutuara vetëm 25 vendime për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm" të shoqëruar me Urdhër Ekzekutimi nga Kryeinspektori i IMT-së, ndërsa 94 vendime për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm" nuk është vijuar procedura nga Kryeinspektori i IMT-së, për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm;
- Në 34 raste edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, nuk është vjiuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm" dhe nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë", në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
- Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 5 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim dhe në 5 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST;
- Nga auditimi i zbatimit të kontratave në 8 objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën 2,794,896 lekë, si rezultat i diferencave në volume pune;
- Nga auditimi i veprimtarisë së IVMT, u konstatua se nga 119 vendime për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm", janë ekzekutuar vetëm 25 vendime të shoqëruar me Urdhër Ekzekutimi nga Kryeinspektori i IMT-së, ndërsa për 94 vendime nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Kalimi i afateve për ekzekutimin e Prishjeve të Objektit sjell si pasojë parashkrimin e tyre dhe pamundësi për ekzekutim.
- Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" më datën 01.01.2018, ka qenë në vlerën 733,273,353 lekë. Gjatë vitit 2018 për këtë llogari ka pasur pakësime në vlerën 630,083,524 lekë, ndërsa më datë 31.12.2018, gjendja e e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 103,189,829 lekë. Për pakësimi e kryer në vlerën 630,083,524 lekë e cila i përket detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore, nga Bashkia Durrës nuk administrohet asnjë vendim, shkresë apo dokumentacion për vlerën e pakësuar.
- Nga auditimi i procesit rezulton se nuk rakordon vlera e detyrimit vjetor dhe progresiv dhe numri i subjekteve në sistemin e DTTV me atë të paraqitur në evidencat për raportim në kontabilitet.
- Procesit i ç'regjistrimit të subjekteve dhe ndjekjes së subjekteve debitore nga DTTV kanë mospërputhje midis tyre (Raportet e sistemit të DTTV dhe evidencat e DTTV), detyrimet nuk pasqyrohen korrekt në pasqyrat financiare të bashkisë.
- Vlera e detyrimit për subjektet e analizuara (40 subjekte), sipas Sistemit të DTTV, ndjekja në vite është 72,114,783 lekë. Ndërkohë, nga auditimi u konstatua se vlera e detyrimit për subjektet e analizuara sipas evidencave të përgatitura nga DTTV për kontabilizimin e borxhit për vitin 2022 është 0 lekë;

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisëqë zhvillon Bashkia Durrës.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.
Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhjeme standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të programit të auditimit nr. 765/1 Prot., datë 13.09.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 14.09.2023, deri më 10.11.2023, në institucionin Bashkia Durrës u krye auditimi "Financiar dhe i Përputhshmërisë". Auditimi mbuloi periudhën prej datës 01.01.2022 deri me datën 31.12.2022.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:
1. A.Z (Përgjegjës grupi)
2. I.SH , anëtare
3. A.Ç, anëtare
4. S.S, anëtar
5. J.G, anëtar
6. O.F, anëtare
7. E.Rr, anëtar

Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie.

Marrësi: Projektraporti i Auditimit i drejtohet subjektit të audituar Bashkisë Durrës.

1. Objektivat e auditimit

Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë në Bashkinë Durrës kishte si objektiva kryesore:
-Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
-Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)[2];
-Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

[2]*Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.*

-Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Durrës është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Projektraporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Durrës dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- Auditim mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën nga data 01.01.2021, deri më 31.12.2022.
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Durrës, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Durrës është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Durrës. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019, "Për buxhetin e vitit 2020" i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020, "Për buxhetin e vitit 2021" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007, "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative";
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik";
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015, "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore";
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël";
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";
- VKM nr.165, datë 02.03.2016, "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014, "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura";
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016, "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve";
- Udhëzim i MFE nr. 23, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore";
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë në Bashkinë Durrës grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).*

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët:

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.,.

7. Intervistimi:

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Durrës me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione:

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale[3].

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

[3] ISSAI 1315

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon[4].

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur, *dhe së fundi kërkimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me Bashkinë Kurbin, në lindje me Bashkitë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me Bashkinë Kavajë. Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e Bashkisë Durrës banojnë 175,110 vetë ndërsa sipas regjistrit civil popullsia rezidente është 299,989 vetë. Me një sipërfaqe prej 338.30 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 517 banorë km^2 ndërsa sipas Regjistrit Civil është 680 banorë km^2.

Bashkia Durrës përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz. Të gjitha njësitë e bashkisë bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra. Durrësi është qyteti me aktivitetin më të madh ekonomik pas Tiranës.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

[4] *Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit*

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një koncept i rëndësishëm, i cili bazohet në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, për të ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve të përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre.
Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Durrës, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.
Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti "Mjedisi i kontrollit"

Mjedisi i kontrollit përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 1 – Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike;
Parimi 2 – Titullari/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje;
Parimi 3 – Titullari/ Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë;
Parimi 4 – Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave;
Parimi 5 – Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Durrës në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Nga analizimi i përgjigjeve të dhëna në pyetësorin e vetëvlerësimit evidentojmë se, institucioni vepron mbi bazën e rregullores e brendshme miratuar me Vendimin nr. 29, datë 09.04.2021 e ndryshuar sipas Vendimit nr.69 datë 05.08.2022 "*Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës".* Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.
Bashkia Durrës nuk ka Kod të Etikës, por në nenin 14 të rregullores së brendshme të kësaj bashkie është përfshirë edhe *"Etika për punonjësit e Bashkisë Durrës dhe kodi i veshjes"* si edhe në shkresën nr. 7160 prot., datë 16.06.2021 *"Mbi disa rregulla të etikës në Institucionin e bashkisë Durrës.* Një problematikë e evidentuar lidhur me këtë parim është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.
Me shkresën nr. 10708 prot., datë 01.10.2021 është miratuar një *"Rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Durrës"*.

Gjatë vitit 2022 janë marrë këto masa disiplinore:
1 masë "largim nga shërbimi civil" për konflikt interesi;
6 "vërejtje" për shkelje të rregullave të etikës;
3 masa për mbajtje 1/3 të pagës;
Lidhur me marrjen e masave për zbatimin e procedurave antikorrupsion, mund të përmendim se Bashkia Durrës zbaton kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin për sinjalizuesit, *por ende nuk ka procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla.*
Për rastet e raportimit lidhur me ankesat për korrupsion, funksionon Autoriteti Përgjegjës, i ngritur pranë Bashkisë Durrës në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 *"Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike"*, i ndryshuar.
Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj (ose dy herë në vit). Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.
Parimi 2 -Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Për vitin 2022, situata paraqitet pjesërisht efektive, ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion.
Evidentohet se ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE. Mungon plani i veprimit për kontrollin e brendshëm dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij plani.
Mungon plani i menaxhimit të risqeve të nivelit të lartë e të mesëm për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
Nëpërmjet shkresës nr.2312 prot., datë 27.02.2023 është dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit *"Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm"*
Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH, nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.
Nëpërmjet shkresës nr. 4354 prot., datë 17.05.2022, janë ndarë drejtoritë dhe njësitë administrative për tre nënkryetarët e bashkisë të cilët ndjekin mbarëvajtjen dhe problemet e punës dhe raportojnë pranë kabinetit të kryetarit.
Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.
Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit te delegimit të tyre.
Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.
Dokumenti i parë i Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 është miratuar me VKB nr.84 datë 28.06.2021, konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.479/1 prot., datë 08.07.2021. Ky dokument bashkë me Instrumentin e Planifikimit Financiar është dërguar në mënyrë elektronike në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

Me shkresën nr.10877 prot., datë 18.06.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcjellë mendimet mbi programin buxhetor afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Durrës.
Nëpërmjet VKB nr. 158 datë 23.12.2021, është miratuar dokumenti përfundimtar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, si dhe buxhetit vjetor i vitit 2022, i cili është bërë publik në portalin vendime.al.
Për vitin 2022 rezultojnë 3 raporte monitorimi, përkatësisht për 4 mujorin e I-rë, 4 mujorin e dytë (progresivi) dhe vjetori, të cilat janë dërguar elektronikisht në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë. Raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2022 është miratuar edhe në Këshill Bashkiak me VKB nr. 77 datë 30.03.2022.
Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se janë organizuar takime me drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve, si dhe janë organizuar takime me palët e treta si me grupet e interesit nëpërmjet dëgjesave me publikun. Gjatë vitit 2022 janë organizuar **33** Dëgjesa Publike, morën pjesë rreth **552** qytetarë, përfaqësues të komunitetit, grupe të interesuara, subjekte, institucione shtetërore, të zgjedhur vendore, përfaqësues të biznesit, shoqëri civile etj., të cilët përfshinë të gjithë territorin e Bashkisë. Numri i rekomandimeve të dala nga këto Dëgjesa Publike është **193**.
Institucioni vepron mbi bazën e rregullores e brendshme miratuar me vendimin nr. 29, datë 09.04.2021 e ndryshuar sipas vendimit nr. 69 datë 05.08.2022 "*Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës"* ku ishte bërë përshkrimi i vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
Bashkia Durrës për vitin 2022 ka pasur në strukturë **389** punonjës, ndër të cilat **33** vende të lira ku kanë konkurruar 127 konkurrente. Përgjatë vitit 2022 janë rekrutuar **20** punonjës të rinj.
Në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni dhe nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe as objektivat për secilin punonjës.
Bashkia Durrës ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila nuk përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.
Problematikë paraqet mungesa e planit strategjik me objektiva dhe tregues performance të përcaktuar duke kufizuar në këtë mënyrë matjen e progresit dhe realizimin e qëllimit final të institucionit.
Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku Bashkia Durrës përdor fare pak procedurat për delegimin e detyrave, kryesisht atë të delegimit në mungesë.

Struktura e Bashkisë Durrës për vitin 2022

		Nëpunës Civilë	**216**
Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	**389**	Nëpunës me kontratë	**159**
Numri i të punësuarve me kontratë provizore	-	-	-
Vende vakante	**33**	-	**14**

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Parimi 4 -Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave
Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.
Çdo nëpunës i bashkisë ka përshkrimin e punës në përputhje me strukturën aktuale ndërkohë që vlerësimet e performancës realizohen në mbështetje të ligjit nr. 152/2013 'Për nëpunësin civil'. Institucioni, kryen procesin e vlerësimit të performancës në punë të punonjësve në përputhje me formatet e përcaktuara në legjislacionin përkatës për nëpunësit civilë.
Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Për vitin 2022 janë kryer nga ASPA **17** trajnime ku kanë marrë pjesë **25** nëpunës të institucionit.
Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.
Nga analiza e këtij parimi, rezulton se Bashkia Durrës, nuk ka hartuar një plan strategjik dhe plane operacionale pune, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.
Për vitin 2022, me Urdhrin nr. 175 datë 13.04.2022 *"Për riformatimin e grupit për Menaxhimin Strategjik në Bashkinë Durrës"* është riformatuar GMS me 16 anëtarë dhe Kryetar Grupi është Titullari i Bashkisë (NA).
Nëpërmjet shkresës nr.3293/1 prot., datë 13.04.2022, janë informuar të gjitha drejtoritë e bashkisë për Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP).
GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. Bashkia Durrës zhvillon takimet e GMS, *por në pak raste diskutohen zhvillimet lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe kryesisht këto takime nuk dokumentohen me minuta takimi apo procesverbale.*
Me shkresën nr. 2312 prot., datë 27.02.2023 i është dërguar Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave "*Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Durrës dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm"* për vitin 2022. Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të bashkisë.
Referuar kësaj deklarate, Bashkia Durrës, ka parashikuar të marrë këto masa për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit:

1. Rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit, në lidhje me rolin dhe përgjegjësinë për ngritjen dhe zbatimin me sukses të sistemeve të MFK dhe rolin e AB;
2. Zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut;
3. Monitorimin e vazhdueshëm të planeve strategjike dhe operacionale të njësisë. Etj.

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 6 – Specifikimi i objektivave të përshtatshëm.
Parimi 7 – Identifikimi dhe analiza e risqeve.
Parimi 8 – Mundësia e riskut të mashtrimeve.
Parimi 9 – Identifikimi dhe analiza e ndryshimeve të rëndësishme.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.
Nga analiza e të dhënave, bashkia ka përgatitur PBA, në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin.
Nga auditimi rezulton se institucioni nuk ka plan-veprime vjetore operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme, që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkrete përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.
Nga analiza e këtij parimi rezulton se përgjithësisht institucioni nuk ka përcaktuar mekanizma të mire organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut. Evidentohen problematika në hartimin e strategjisë dhe regjistrit të konsoliduar të risqeve si dhe në monitorimin e raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë.
Nëpërmjet Urdhrit nr.175, datë 13.04.2022 është ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe është hartuar regjistri i riskut nga disa prej strukturave të Bashkisë Durrës. Nëpërmjet shkresës nr. 15184, datë 03.10.2019 *"Për caktimin e koordinatorit të deleguar të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në Bashkinë Durrës"*, titullari ka deleguar funksionet e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut tek dy punonjës, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.
Në këto kushte, evidentohet se Bashkia Durrës nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.
Nëpërmjet VKB nr.127 datë 28.10.2021 është miratuar Plani i Integritetit në Bashkinë Durrës i cili ka për qëllim parandalimin, zvogëlimin dhe të eliminimin e korrupsionit dhe parregullsive të tjera në institucion.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.
Nga vlerësimi i këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar. Bashkia Durrës në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

III. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të

kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 10 – Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit.
Parimi 11 – Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.
Parimi 12 – Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.
Në vijim të analizës së kryer, mund të themi se ende ka problematika për t'u adresuar, të cilat lidhen kryesisht me *mungesën e hartave apo manualeve të proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive.*
Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori Ekonomik (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i Kontabilitetit/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA).
Bashkia Durrës i ka të qarta procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, regjistër prokurimesh si dhe regjistër aktivesh të përditësuar në SIFQ. Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili përditësohet sa herë ka ndryshime fondesh.
Bashkia Durrës ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivet e rëndësishme (me vlera të konsiderueshme) dhe aktivet afatgjata nuk ruhen nga përdorimi i paautorizuar me anë të një procedure të shkruar.
Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit.
Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" i ndryshuar.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.
Bashkia Durrës nuk përdor sisteme të teknologjisë së informacionit përveç atyre fikse përdorimi i të cilëve është mundësuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si dhe nuk ka procedura të brendshme specifike për këtë fushë. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.
Përsa i përket ndarjes së detyrave për funksionimin e sistemit të teknologjisë së informacionit, ato janë kryesisht të evidentuara në rregulloret e brendshme dhe përshkrimet e punës.
Sektori i informatikës, teknologjisë së shërbimit ndjek procesin e informatizimit dhe kompjuterizimit në Bashki, konfigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK

dhe ofron asistencë teknike ndaj punonjësve për mire përdorimin dhe shfrytëzimin sa më të efektshëm të teknologjisë në dispozicion.
Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up)

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.
Bashkia Durrës nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.
Bashkia Durrës nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

Gjurma e auditimit

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.
Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësisë.

Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

Nga auditimi evidentohet se Bashkia Durrës nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Gjurmë auditimi ka vetëm Drejtoria Ekonomike.

IV. Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.
Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 13 – Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor.
Parimi 14 – Komunikimi i brendshëm
Parimi 15 – Komunikimi i jashtëm

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
Në vijim të analizës së kryer, rezulton se Bashkia Durrës i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit. Ajo ka një sistem komunikimi dhe raportimi , si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.
Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Durrës për mbajtjen e kontabilitetit operon me program të vetin të kontabilitetit, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij programi kontabilitetit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria Ekonomike. Monitorimi i të ardhurave kryhet me program të veçantë të cilin e menaxhon Sektori i Tatim-Taksave.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, bashkia sqaron se parimet bazë dhe procedurat e komunikimit janë përcaktuar në dokumentin e rregullores së brendshme të institucionit. Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë. Drejtuesit e bashkisë njoftohen nëpërmjet shkresave sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.
Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresor apo në rrugë elektronike nëpërmjet aksesit në adresat zyrtare të e-mailit.
Bashkia Durrës nuk siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.
Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Për vitin 2022 janë kryer **33** dëgjesa publike dhe numri i rekomandimeve për këto dëgjesa ka qenë **193** rekomandime.

V. Komponenti: "Monitorimi"

Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit realizohet, kryesisht, përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 16 – Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe/ose të veçanta;
Parimi 17 – Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.
Nga analiza e kryer, vlerësohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.
Raportohet mbi baza periodike pranë Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë dhe GMS për veprimtarinë financiar referuar parashikimeve të PBA.
Bashkia Durrës, monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave për vitin 2022 me shkresën nr. 2312 prot. datë 27.02.2023.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet nëpërmjet shërbimit të auditimit të brendshëm, performuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm e cila ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara.
Nga ana e Bashkisë Durrës nuk është hartuar një dokument i mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këtë institucion.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.
Në bazë të analizës dhe vlerësimit të kryer, titullarja e institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë deri diku mirë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:
"Mjedisi i kontrollit" Bashkia Durrës nuk ka hartuar planin vjetor të punës për vitin 2022 si edhe nuk janë evidentuar raporte për kryerjen e analizave periodike apo vjetore të punës mbi analizat e arritura. Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, Bashkia Durrës nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Një problematikë tjetër e evidentuar është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës. Bashkia i zbaton kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin për sinjalizuesit, *por ende nuk ka procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla.*
Institucioni ka mungesa të raportimeve të rregullta periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion.
Në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni dhe nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe as objektivat për secilin punonjës.
Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të.
Bashkia zhvillon takimet e GMS, por në pak raste diskutohen zhvillimet lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe kryesisht këto takime nuk dokumentohen me minuta takimi apo procesverbale.
"Menaxhimi i Riskut" Bashkia Durrës nuk ka plan-veprime vjetore operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që përmbajnë veprime, afate dhe persona konkrete përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

Evidentohen problematika në hartimin e regjistrit të konsoliduar të risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e bashkisë si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre.
Në këto kushte, evidentohet se institucioni nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.
"Aktivitetet e Kontrollit" Bashkia Durrës nuk ka hartuar hartat apo manualet e proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive.
Aktivet e rëndësishme (me vlera të konsiderueshme) dhe aktivet afatgjata nuk ruhen nga përdorimi i paautorizuar me anë të një procedure të shkruar.
Institucioni nuk përdor sisteme të teknologjisë së informacionit përveç atyre fikse përdorimi i të cilëve është mundësuar nga AKSHI si dhe nuk ka procedura të brendshme specifike për këtë fushë. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).
Bashkia Durrës nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.
Bashkia Durrës nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.
Nuk janë ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Gjurmë auditimi ka vetëm Drejtoria Ekonomike.
"Informimi dhe komunikimi" Bashkia Durrës ka një sistem komunikimi dhe raportimi , si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.
Institucioni nuk siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.
"Monitorimi" Bashkia Durrës nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.
***Përsa i përket sistemit të MFK*:** Gjatë auditimit të kryer në Bashkinë Durrës, u evidentua se institucioni duhet të bëjë më shumë përpjekje në implementimin e kërkesave të MFK-së, dhe të përfshihet në këtë proces i gjithë stafi i bashkisë. Pyetësori i vetëvlerësimit të këtij institucioni paraqet situatën reale të tij në lidhje me këtë fushë, ku mbi 75 % e përgjigjeve të pyetësorit janë të besueshme.
Funksionimi i sistemit të MFK ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht. Për ta përmirësuar atë në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.
Bashkia nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave elektronike (sistem rezervë back-up), si dhe ruajtjen e aktiveve. Nuk është hartuar një regjistër i konsoliduar risku, dokumenti i listës (hartës) së proceseve të punës, dokumenti i gjurmës së auditimit është krijuar vetëm nga drejtoria ekonomike dhe jo në nivel institucioni.
Mangësitë e evidentuara mbi zbatimin e këtyre parimeve janë në kundërshtim me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20, neni 21, pika 2, neni 22, pika 1, neni 23, pika 2, neni 24, pika 1;
-Ligjin nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, neni 13;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*, pika 2.2.1 "*Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK"* a,b,c,d, pika 2.2.4, pika 2.3.1, pika 3, pika 3.2.1, pika 4, pika 5.2.7;
-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"*, Kreu II. *"Dosja e Personelit";*
-*"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III *"Komponentët e MFK"* pika 3.1,3.2 , 3.3, 3.5, Kapitulli IV *"Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit"*, Kapitulli V, Anekset.

Nga përfaqësuesit e Bashkisë Durrës, zj. E.S me shkresën nr. 946/1 prot., datë 19.02.2024 janë paraqitur observacione si në vijim:

Pretendimi i subjektit:

Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit nr. 765/11 prot., datë 17.01.2024

Referuar auditimit të ushtruar në Bashkinë Durrës në bazë të programit të auditimit nr. 765/1, datë 13.09.2023, si dhe Raportit Përfundimtar të Auditimit nr. 765/11 prot., datë 17.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 946 prot., datë 18.01.2024, konkretisht "Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrolli i Brendshëm në Bashkinë Durrës" (ku citohet përgjegjësia e kryetarit të bashkisë), ju informoj sërish se në datën 03.10.2019 me shkresën nr. 15184, ju deleguan Znj N.Z dhe Znj. I.F disa nga detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit të Riskut.

Për sa trajtohet në këtë akt konstatim mendoj se vlerësimi i situatave të konstatuara nga audituesit duhet parë në kontekst të situatës në të cilat ka kaluar Bashkia Durrës në këtë periudhë si dhe specifikës së veçantë që paraqet implementimi i këtij sistemi në Bashkinë Durrës në këtë situatë.

Konkretisht është konstatuar nga ana e audituesve problemi i trajnimit të punonjësve për sa i përket rregullores dhe kodit të etikës, por theksoj se aktualisht trajnimi është një proces i cili zbatohet në vazhdimësi si për personelin ekzistues ashtu dhe për atë të rekrutuar sipas rregullave. Rregullorja e re është shpërndarë me e-mail në të gjithë personelin e Bashkisë Durrës për t'u njohur dhe natyrisht edhe zbatuar. Vlen të përmendet fakti që personeli i Bashkisë Durrës është i pajisur me adresë e-maili.

Për sa i përket etikës, trajnimi është kryer në vazhdimësi dhe rezultante e këtij procesi është fakti se gjatë periudhës që i referohemi nuk kemi patur situata për masa disiplinore për shkak të shkeljes së etikës.

Në lidhje me njohjen dhe trajnimet e punonjësve, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore janë bërë periodikisht njoftimet përkatëse drejtuar secilës Drejtori për të marrë masat dhe njohjen e stafit në varësi për çdo njoftim të dërguar nga Apa lidhur me trajnimet që zhvillohen. Çdo drejtori nëse e shikon të arsyeshme delegon punonjësit që kanë nevoje për të kryer trajnimet në fushat përkatëse. Ju sjellim në vëmendje së kohët e fundit nga stafi i Bashkisë Durrës pjesëmarrja në trajnime të ndryshme është në rritje.

Për sa i takon konstatimit për raportime apo situata me risk shpjegojmë se në situatat paraardhëse dhe në vazhdim Bashkia Durrës po punon akoma për përmbylljen e procesit të Rindërtimit.

Përveç kësaj Bashkia Durrës me të njëjtin personel, ka përballuar dhe po përballon edhe punën e saj aktuale dhe ky proces, po të mbështetemi statistikisht në volumin e punës së kryer, tregon një bashkërendim të të gjithë drejtorive, hallkave dhe sektorëve për mbarëvajtjen e punëve të ngarkuara. E përmendim këtë fakt për të shpjeguar situatën e konstatuar nga Audituesit në lidhje raportimet pasi, në gjykimin tonë, nuk mund të këtë rezultate për kryerjen e gjithë kësaj pune voluminoze pa një plan pune të mirë koordinuar dhe pa një komunikim të ndërsjellët urdhrash dhe raportimesh .

Për sa i përket procedurës theksoj se ajo ka qenë e kondicionuar nga situata specifike që ka kaluar kjo bashki gjatë tërmetit duke anashkaluar për shkaqet e treguara me sipër dokumentimin e saj nga ana proceduriale.

Për sa i përket situatës së riskut sqarojmë se Bashkia Durrës është institucion shpenzues në kuptimin që financohet nga buxheti i shtetit me fonde për ti përdorur sipas Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
Nga ana tjetër Bashkia Durrës krijon dhe menaxhon dhe të ardhura të veta nga faturimi i taksave dhe tarifave vendore të miratuara sipas Vendimeve të Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit dhe PBA si edhe të paketës fiskale.
Për këtë situatë, pra për këtë fushë, po t'i referohemi raportit dërguar pranë Agjencisë së Harmonizimit pranë Ministrisë së Financave, konstatojmë që është parashikuar me risk situata për arkëtimin e të ardhurave të veta vendore si dhe është parashikuar edhe strategjia për të minimizuar pasojat e kësaj situate.
Po ashtu edhe hartimi i regjistrit të riskut, dërguar si pjesë e këtij materiali, parashikon situatat me risk në këtë Bashki në gjykimin tonë si dhe paraqet mënyrat e minimizimit të pasojave të tij.
Risqet nuk janë parashikuar si risqe të nivelit të lartë apo të mesëm por si risqe potenciale dhe të mundshëm.
Pra situatat e konsideruara me risk janë parashikuar sipas specifikës së veçantë që paraqet Institucioni i Bashkisë po ashtu dhe planet për përballimin apo minimizimin e tyre.
Sektori i IT-së, si një sektor i cili luan një rol të rëndësishëm në gjithë procesin e punës së Institucionit është krijuar si drejtori e veçantë.
Gjatë periudhës së tërmetit dhe më pas të pandemisë, sipas konstatimit të raportit të KLSH-së për këtë periudhë, janë larguar nga Bashkia Durrës 58 punonjës (23 gjatë vitit 2020 dhe 35 gjatë vitit 2021).
Gjithashtu Bashkia Durrës ka kaluar një situatë të paprecedentë, pasi siç e dimë:
Tërmeti i 26 Nëntor 2019 pas te cilit u shpall dhe gjendje e jashtëzakonshme kombëtare.
Pandemia Globale
Situata e mësipërme lanë dhe pasojat e saj në vazhdimin e procesit të MFK pasi e gjithë vëmendja dhe puna, burimet njerëzore u drejtuan në procesin e eliminimit të pasojave të tërmetit dhe procesin e rindërtimit, një proces i gjatë , i panjohur , pa precedentë apo modele të mëparshme, me shumë përgjegjësi, shumë voluminoz, proces i cili duhej të kryhej nga personeli i Bashkisë krahas punës së zakonshme që kryente aktualisht Bashkia Durrës, dhe një proces që vazhdon akoma, por dhe shërbimit ndaj qytetareve në kohën e pandemisë, sfida të cilat u mbivendosen, pasi sjellim në vëmendjen tuaj që rastet e para në Shqipëri u shfaqen në fillim të marsit 2020, vetëm 4 muaj pas tërmetit shkatërrimtar të qytetit.
Për sa më sipër, ky është një përshkrim për situatën në të cilën ka kaluar Bashkia Durrës gjatë kësaj periudhe, objekt auditimi, pasi procesi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm është një proces gjithëpërfshirës dhe në këtë këndvështrim kërkojmë që situata e kaluar në Bashkinë Durrës të mbahet parasysh në vlerësimin përfundimtar.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Pas shqyrtimit të observacioneve, grupi i auditimit sqaron se:
-Në lidhje me observimin e zj. E.S , se në datën 03.10.2019 me shkresën nr. 15184, ju deleguan Znj N.Z dhe Znj. I.F disa nga detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit të Riskut, ritheksojmë se Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, neni 15, përcakton rregullat e përgjithshme për delegimin e detyrave ku ndër të tjera, në pikën 4 të tij, citon: "Delegimi i të drejtave dhe i detyrave nuk cenon të drejtat e menaxherit dhe **nuk e shkarkon atë nga përgjegjshmëria për realizimin e detyrave përkatëse apo për përzgjedhjen e vartësit, tek i cili delegohen të drejtat dhe detyrat".**
- Në lidhje me observimin se janë kryer në vazhdimësi trajnime për etikën dhe rezultat i këtij procesi është fakti se gjatë periudhës që i referohemi nuk kemi patur situata për masa disiplinore për shkak të shkeljes së etikës, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon pasi, *mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Durrës, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, rezulton se për vitin 2022, janë dhënë 6 masa disiplinore për shkelje të rregullave të etikës dhe nuk është zhvilluar asnjë trajnim për etikën.*
-Gjithashtu, edhe pse nga ana e subjektit pretendohet se ka një regjistër të konsoliduar risku, grupi i auditimit thekson se ka hartuar gjetjen mbi procedurat dhe praktikat e audituara të specifikuara sa më sipër. Referuar kërkesave të Udhëzimit nr. 15 dt. 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike",*

menaxhimi i riskut duhet të jetë në përpjesëtim me shkallën e riskut në njësi, në përputhje me aktivitetet e tjera të njësisë, të përfshijë të gjitha fushat, të jetë një aktivitet rutinë dhe dinamik, si dhe të ketë në konsideratë ndryshimin e rrethanave. Nga ana e Bashkisë Durrës nuk është hartuar një strategji risku që të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve (të ashtuquajturit pronarë të bisqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi, në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrit të riskut si dhe kriteret e matjes së riskut).
-Pretendimi se Bashkia Durrës ka qenë në një situatë të paprecedentë, pra siç e dimë: tërmeti i 26 nëntorit 2019 pas të cilit u shpall dhe gjendja e jashtëzakonshme kombëtare dhe pandemia globale, nuk ndikon mbi gjetjet e grupit të auditimit.
Një sistem i integruar i kontrollit të brendshëm duhet të ndërtohet në çdo strukturë të njësisë publike. Kontrolli i brendshëm efektiv arrihet vetëm nëse bëhet pjesë e detyrave të përditshme të kryera nga stafi në çdo nivel të strukturës organizative.
Për sa më sipër, observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi të gjitha pretendimet tuaja, referuar konstatimeve mbi menaxhimin e kontrollit të brendshëm nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

Titulli Gjetjes: KLSH ka konstatuar se, në Bashkinë Durrës funksionimi i sistemit të MFK ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht.
Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, Bashkia Durrës nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.
Funksionimi i sistemit të MFK ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht. Nga auditimi u evidentua se institucioni duhet të bëjë më shumë përpjekje në implementimin e kërkesave të MFK-së, dhe të përfshihet në këtë proces i gjithë stafi i bashkisë. Pyetësori i vetëvlerësimit të këtij institucioni paraqet situatën reale të tij në lidhje me këtë fushë, ku mbi 75 % e përgjigjeve të pyetësorit janë të besueshme. Rregullorja e Brendshme ka një konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar edhe kompetencave e akteve nënligjore në fuqi. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:
1.1"Mjedisi i kontrollit"
-Bashkia Durrës nuk ka hartuar planin vjetor të punës për vitin 2022 si edhe nuk janë evidentuar raporte për kryerjen e analizave periodike apo vjetore të punës mbi analizat e arritura;
-Nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit;
-Zbaton kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin për sinjalizuesit, *por ende nuk ka procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla;*
-Mungojnë raportimet periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion;
-Në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni dhe nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe as objektivat për secilin punonjës;
-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të;
-Zhvillon takimet e GMS, por në pak raste diskutohen zhvillimet lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe kryesisht këto takime nuk dokumentohen me minuta takimi apo procesverbale.
1.2 "Menaxhimi i Riskut"

-Bashkia Durrës nuk ka plan-veprime vjetore operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që përmbajnë veprime, afate dhe persona konkrete përgjegjës për çdo veprim të parashikuar;
-Evidentohen problematika në hartimin e regjistrit të konsoliduar të risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Durrës si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre;
-Nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

1.3 "Aktivitetet e Kontrollit"

-Bashkia Durrës nuk ka hartuar hartat apo manualet e proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive;
-Aktivet e rëndësishme (me vlera të konsiderueshme) dhe aktivet afatgjata nuk ruhen nga përdorimi i paautorizuar me anë të një procedure të shkruar;
-Nuk përdor sisteme të teknologjisë së informacionit përveç atyre fikse përdorimi i të cilëve është mundësuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si dhe nuk ka procedura të brendshme specifike për këtë fushë. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara;
-Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).
-Nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar;
-Nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit;
-Nuk janë ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës.

1.4 "Informimi dhe komunikimi"

-Bashkia Durrës ka një sistem komunikimi dhe raportimi , si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj;
-Nuk siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.

1.5 "Monitorimi"

-Bashkia Durrës nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

Mangësitë e evidentuara mbi zbatimin e këtyre parimeve janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20, neni 21, pika 2, neni 22, pika 1, neni 23, pika 2, neni 24, pika 1;
-Ligjin nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, neni 13;
-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*, pika 2.2.1 "*Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK"* a,b,c,d, pika 2.2.4, pika 2.3.1, pika 3, pika 3.2.1, pika 4, pika 5.2.7;
-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"*, Kreu II. *"Dosja e Personelit";*
-*"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III *"Komponentët e MFK"* pika

3.1,3.2 , 3.3, 3.5, Kapitulli IV *"Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit"*, Kapitulli V, Anekset.
Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar. Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e MF nr. 108, datë 17.11.2016. Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Durrës e miratuar me Vendimin nr. 29, datë 09.04.2021 e ndryshuar sipas Vendimit nr.69 datë 05.08.2022 "*Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës"*.
Impakti: Mosnjohja e plotë dhe sa duhet e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" nga niveli i lartë drejtues i kritereve të MFK, ka sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Shkaku: Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin në drejtim të njohjes së dispozitave të MFK dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.
Rëndësia: -I mesëm.

Mbi vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.
Në zbatim të Ligjit Nr.114/2015, datë 20.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se:
"Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në germat a-c të kësaj pike" është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Auditit të Brendshëm (DAB) në varësi funksionale nga Titullari i Bashkisë Durrës, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.
Kjo drejtori përgjatë periudhës 2022, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 29 dt. 09.04.2021, duke pasur në strukturën e saj 1 (një) Drejtor i Auditit të Brendshëm zj. M.P dhe 2 (dy) specialiste auditi, nga këto 1 specialiste në Sektorin e Kontrollit të Plotë zj. R.A dhe 1 (një) specialiste në Sektorin e Kontrollit Tematik zj. O.D , e cila duhet të certifikohet si Audituese e Brendshme brenda dy vitesh nga data e emërimit.
Bashkia Durrës në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së saj dhe përmbushjes së objektivave të vendosura ka miratuar rregulloren e brendshme. Në Kreun V të kësaj rregulloreje janë përcaktuar misioni i njësisë së auditimit të brendshëm, mënyra e organizimit, kuadri ligjor, përgjegjësitë e drejtuesit të NJAB dhe audituesve të brendshëm, detyrat funksionale të tyre, bashkëpunimi me menaxhimin dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm etj.
Në Raportin mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm në Bashkinë Durrës për vitin 2022, me nr.15/2 prot., datë 15.02.2023*"Mbi veprimtarinë audituese të drejtorisë së auditimit të brendshëm"*, në Kapitullin VII *"Kapacitetet Audituese"* evidentohet problematika lidhur me burimet njerëzore. *"*.. Theksojmë se numri i audituesve (2+1) nuk i mbulon me auditime të gjithë subjektet e Bashkisë.
Duke qenë se Bashkia Durrës është një nga njësitë vendore më të mëdha dhe më të rëndësishme, me një shtrirje të gjerë, me një kompleksitet veprimtarie dhe subjektesh në varësi, vlerësojmë se është i rëndësishëm fuqizimi i rolit të NJAB.
Stafi auditues u intervistua lidhur me njohuritë mbi rolin, përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë e tyre për shërbimin që ofrojnë, ku u evidentua se eksperienca profesionale e tyre në fushën e auditimit është (0-5) vite.

Struktura e njësisë AB për vitin 2022

Nr.	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime te vijueshme	Aktualisht në punë/larguar
	Për vitin 2022							
1	M.P	Drejtore	04.04.2004	Financë	15+vite	2005	1	Larguar
2	M.G	Audituese	16.03.2005	Financë	13+vite	2006	1	Larguar

Nr.	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime te vijueshme	Aktualisht në punë/larguar
3	R.A	Audituese	01.09.2018	Financë	4	2021	1	Në punë
4	O.D	Audituese	01.09.2022	Adm.Biznesi	0		0	Në punë

Burimi: NJAB Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Trajnimet e NjAB dhe certifikimet

Referuar ligjit nr.114/2015 *"Mbi Auditimin e Brendshëm"* dhe *"Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"* rendësi i është kushtuar trajnimeve të audituesve të NJAB sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Audituesit e brendshëm duhet të zgjerojnë njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përgjegjësia për trajnimin nuk është vetëm e Drejtuesit të auditimit të brendshëm ose struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo audites duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikat e reja të auditimit.

Për vitin 2022 trajnimet e audituesve të NJAB për Bashkinë Durrës pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Trajnimet e njësisë AB për vitin 2022

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i Punës /Drejtoria	Tema e trajnimit te ndjekur	Institucioni Trajnues	Data e trajnimit dhe mënyra e ndjekjes se trajnimit (online/Fizik)
1.	M.P	Drejtuese e NJAB	Auditim i detyrimeve të prapambetura në NJVV	Ministria e Financave	29-31.03.2022 Trajnim fizik
2.	M.P	Drejtuese e NJAB	Qasja audituese në risk	Ministria e Financave	12-16.12.2022 Trajnim fizik
3.	R.A	Audituese e NJAB	Auditim i detyrimeve të prapambetura në NJVV	Ministria e Financave	29-31.03.2022 Trajnim fizik
4.	R.A	Audituese e NJAB	Qasja audituese në ris	Ministria e Financave	12-16.12.2022 Trajnim fizik

Burimi: NJAB Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Komiteti i Auditit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj, nuk është krijuar nga Bashkia Durrës.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e organit që bashkërendon, harmonizon dhe monitoron veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, me shkresën nr.13893 prot., datë 22.07.2019 *"Mbi krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm,* ka ofruar asistencë në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Durrës nëpërmjet propozimit të disa hapave konkretë.

Referuar ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, neni 12, pika b, përcakton se *Titullari i Njësisë Publike është përgjegjës për vendimmarrjen e krijimit të Komitetit të Auditimit.*

Nga auditimi rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të.

Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

NJAB në mbështetje të Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik"* ka hartuar "Kartën e

Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr.2843/1, datë 25.2.2017 dhe rezulton se nuk është në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 *"Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016"*.

Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve.

Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publik edhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm.

Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE Nr.100, datë 25.10.2016, përcaktohet se:

"Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën **10 Tetor të çdo viti**. Planet pas dhënies së mendimit të KAB-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data **20 Tetor e çdo viti**, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm….."

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik 2022-2024. Plani strategjik për vitet 2022-2024 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2022 janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.9996/4 prot., datë11.10.2021, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*.

Në Planin Strategjik për vitet 2022-2024, planifikimi i subjekteve të cilat janë parashikuar të auditohen nuk është në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2022

Nga auditimi rezultoi se:

Për vitin 2022, janë planifikuar për t'u kryer **11** auditime dhe janë realizuar **10** si dhe me urdhër nr. 530 datë 26.10.2022 të Kryetares së Bashkisë Durrës, u realizua një angazhim auditimi jashtë planifikimit për Klubi i Shumë Sporteve "Teuta", pasqyruar si më poshtë:

Nr.	Planifikuar	Nr. Auditime	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr. Auditime	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar	Në proces
					Përputh	Perform	Financ	IT	Kombin		
1	Drejtoria e Taksave	1									
2	Drejtoria Ligjore	1									
3	Drejtoria e Shërbimit Social	1	Drejtoria e Shërbimit Social	1	1					1	
4	Drejtoria PIP	1	Drejtoria PIP	1	1					1	
5	Qendra Ekonomike e Arsimit	1	Qendra Ekonomike e Arsimit	1					1	1	
6	Ndërmarrjet me Drejtim Ekonomik	1	Ndërmarrjet me Drejtim Ekonomik	1					1	1	
7	Ndërmarrja Komunale Plazh	1	Ndërmarrja Komunale Plazh	1					1	1	
8	Ndërmarrja Komunale e Shërbimeve	1	Ndërmarrja Komunale e Shërbimeve	1					1	1	
9	Ndërmarrja e Rrugëve	1	Ndërmarrja e Rrugëve	1					1	1	

10	Qendra Kulturore e Fëmijëve	1	Qendra Kulturore e Fëmijëve	1					1	1	
11	Zbatim Detyrash		Zbatim Detyrash	1						1	
12	-	1	Klubi Shumë Sporteve "Teuta "	1	1				1	1	
		11	**Totali**	**10**	**3**	**0**		**0**	**7**	**10**	

Burimi: NJAB Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Ndryshimi i Planit Vjetor të NJAB është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 8725/5 prot., datë 30.12.2022.
Për aktivitetin e vitit 2022 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr.1862 prot., datë 15.02.2023.
Nga auditimi i raportimit për vitin 2022, rezulton se janë dhënë **52** rekomandime gjithsej, të cilat janë pranuar nga subjektet objekt auditimi. Nga rekomandimet e pranuara janë në proces zbatimi **26** prej tyre. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				Sipas Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Pranuar	Zbatuar	Ne proces	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2022	52	52	24	26	0			
TOTALI		**52**	**52**	**24**	**26**	**0**			

Burimi: NJAB Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

<u>Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB</u>
Grupi auditimit duke patur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në vitin 2022, zgjodhi të auditojë dosjet të cilat janë vlerësuar nga DAB me nivel të lartë risku siç janë:
-dosja e auditimit të kryer në *Drejtorinë e Shërbimit Social;*
-dosja e auditimit të kryer në *Klubin e Shumësporteve "Teuta*";
-dosja e auditimit të kryer në *Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale Plazh;*
-dosja e auditimit të kryer në *Qendrën Ekonomike të Arsimit;*
-dosja e auditimit të kryer në *Qendrën Kulturore të Fëmijëve;*
-dosja e auditimit mbi *"Zbatimin e rekomandimeve për vitin 2021".*

1.Dosja e auditimit të kombinuar për subjektin **Drejtoria e Shërbimit Social,** me objekt "Auditim i pjesshëm mbi përdorimin e fondit social të akorduar nga Bashkia për familjet në nevojë, vlerësimi i përshtatshmërisë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi, identifikimi i mangësive për periudhën 01.01.2015-31.12.2021*"*:
Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:
☞Të ndihmojë njësinë në përmbushjen e misionit, objektivave vjetore dhe strategjike, duke konntribuar sistematikisht në vlerësimin, disiplinimin dhe përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të riskut, të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe proçeseve të vendimëmarrjes.
Gjetja e konstatuar:
I.Konstatimi se ndër vite numri i kërkesave të familjeve në nevojë ka ardhur duke u rritur, fondi i ndihmës për këtë kategori nuk ka ndryshuar.
Rekomandimi i lënë:
"Drejtoria e Ndihmës Ekonomike gjatë proçesit për evidentimin, verifikimin e familjeve në nevojë, pranimin e dokumentacionit të kërkuar si dhe intervistimin e familjeve, të punojë për nxitjen e punësimit të personave të aftë për punë, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen e tyre në shoqëri".
Nga auditimi mbi zbatim e rekomandimeve për hapat e ndjekur nga **Drejtoria e Shërbimit Social,** konstatohet se rekomandimet janë zbatuar.

2.Dosja e auditimit të kombinuar për subjektin **Klubi i shumësporteve *"Teuta"*,** me objekt "Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme, sistemit të menaxhimit të aseteve dhe pronave publike në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi, identifikimi i mangësive për periudhën 01.01.2021-31.10.2022 dhe ndërmarrja e veprimeve korrigjuese*"*:
Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:
Të ndihmojë njësinë në përmbushjen e misionit, objektivave vjetore dhe strategjike, duke konntribuar sistematikisht në vlerësimin, disiplinimin dhe përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të riskut, të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe proçeseve të vendimëmarrjes.
Gjetjet e konstatuara:
I.Konstatimi se Klubi i Shumësporteve nuk ka të përcaktuar me shkrim marrëdhënien e ndërsjelltë me të gjithë sportistët e ekipeve, në mbështetje të ligjit 79/2017***"Për Sportin"*** të ndryshuar, dhe rregulloreve të federatave përkatëse.
Rekomandimi i lënë:
"Klubi i Shume sporteve të përcaktojë me shkrim marrëdhënien e ndërsjelltë me të gjithë sportistët e ekipeve".
II. Konstatimi se institucioni ka të paraqitura në inventarin fizik dy mjete transporti (Fugon), mjeti i transportit me targë DR 2548F ndodhet në ruajtje pranë ambjenteve të ish Parkut Urban, pronë e Bashkisë Durrës, vlera fillestare e tij është 1.500.000 lekë dhe viti i blerjes është 2004. Amortizimi i mjetit është llogaritur me normat pqe institucionet buxhetore, për kohën e përdorimit 2004-2018 dhe vlera e mbetur e mjetit është zero.
Rekomandimi i lënë:
"Institucioni duhet të marrë të gjitha masat për daljen jashtë perdorimit të mjetit të transportit me targë DR 2548F".
III. Fletë-Daljet e konsumit të karburantit nuk kanë të bashkëngjitur dokumentet justifikuese si: kuponin tatimor, për furnizimin e çdo mjeti dhe pasqyrën e harxhimit të karburantit për çdo mjet nga sistemi.
Rekomandimi i lënë:
"Të merren kuponët tatimore për çdo furnizim mjeti si dhe të bashkëngjitet pasqyra e harxhimit të karburantit për çdo mjet nga sistemi".
IV. Konstatimi se trajnerët e ekipeve janë të pa liçensuar në kundërshtim me nenin 28 të ligjit 79/2017***"Për Sportin"*.**
Rekomandimi i lënë:
"Çdo ekip sportiv pranë Klubit të shumësporteve "Teuta" duhet të ketë trajnerë të licencuar nga Federata Shqiptare e sportit përkatës".
V. Lista emërore e sportistëve të ekipeve përfaqësuese dhe niveli i trajtimit ushqimor të tyre, vendoset nga trajneri i ekipit sportiv dhe Sekretari i Klubit të Shumësporteve.
Rekomandimi i lënë:
"Të përcaktohet niveli i trajtimit ushqimor të sportistëve sipas rezultateve sportive me vendim të Këshillit Sportiv".
Nga auditimi mbi zbatim e rekomandimeve për hapat e ndjekur nga Klubi i shumësporteve *"Teuta*", konstatohet se 3 rekomandime janë zbatuar, 1 rekomandim është në proces zbatimi dhe 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht.
3.Dosja e auditimit të kombinuar për subjektin **Qendra Ekonomike e Arsimit,** me objekt "Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme, sistemit të menaxhimit të aseteve dhe pronave publike në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi, identifikimi i mangësive për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 dhe ndërmarrja e veprimeve korrigjuese*"*:
Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:

☞Të ndihmojë njësinë në përmbushjen e misionit, objektivave vjetore dhe strategjike, duke kontribuar sistematikisht në vlerësimin, disiplinimin dhe përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të riskut, të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe proçeseve të vendimëmarrjes.

Gjetjet e konstatuara:

I. Nga kontrolli i inventarëve konstatohet se formatet e pasqyrimit të inventarëve nuk plotësojnë standardet për inventarë.

Rekomandimi i lënë:

"Institucioni të plotësojë pasqyrat e inventarëve sipas standarteve, në to të pasqyrohet saktësisht vlera fizike, kontabile si dhe çmimi i tyre. Ato duhet të jenë të kuadruara dhe firmosura nga personat përgjegjës sipas Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik".

II. Me VKB nr.100, datë 31.08.2021 është vendosur për prishjen e detyruar të Kopshtit "Isuf Ferra" për shkak të dëmtimit nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe është ngarkuar Drejtoria Ekonomike, në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"i ndryshuar,* Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktivëve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, të kryejë veprimet për heqjen nga librat e inventarit ekonomik.

Rekomandimi i lënë:

"Të përfundojë procedura për heqjen nga inventari të godinës së kopshtit "Isuf Ferra" sipas VKB nr.100 datë 31.08.2021".

III. Konstatohet se nuk ka përfunduar proçedura për futjen e vlerës në inventar të shkollës 9-vjeçare "Kënetë" dhe të shkollës së mesme profesionale "Hysen Çela" pasi mungon dokumentacioni përkatës. Shkolla 9-vjeçare "Kënetë" është një investim i bërë nga Fondacioni Soros që në vitin 2001.Institucioni në pamundësi për të gjetur dokumentacionin e origjinës të bëjë vlerësimin e objektit me vlerësues pasurie. Shkolla e mesme profesionale "Hysen Çela" është një investim (rikonstruksion) i bërë nga Ministria e Arsimit në vitin 2009. Institucioni të ndjekë pranë Ministrisë së Arsimit marrjen e dokumentacionit të origjinës dhe në pamundësi të bëjë vlerësimit e objektit me vlerësues pasurie.

Rekomandimi i lënë:

"Të përfundojë procedura për vlerësimin dhe futjen në inventar të shkollës 9-vjecare "Kënetë" dhe të shkollës së mesme profesionale "Hysen Cela".

Nga auditimi mbi zbatim e rekomandimeve për hapat e ndjekur nga **Qendra Ekonomike e Arsimit,** konstatohet se 4 rekomandime janë zbatuar dhe 1 rekomandim nuk është zbatuar.

4.Dosja e auditimit të kombinuar për subjektin **Qendra Kulturore e Fëmijëve**, me objekt "Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme, sistemit të menaxhimit të aseteve dhe pronave publike në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi, identifikimi i mangësive për periudhën 01.01.2020-31.12.2021 dhe ndërmarrja e veprimeve korrigjuese*"*:

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:

☞Të ndihmojë njësinë në përmbushjen e misionit, objektivave vjetore dhe strategjike, duke kontribuar sistematikisht në vlerësimin, disiplinimin dhe përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të riskut, të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe proçeseve të vendimëmarrjes.

Gjetjet e konstatuara:

I. Nga kontrolli i llogarive të AAGJ dhe pasqyrave të inventarëve konstatohet se ndarja e tyre në llogaritë përkatëse në kontabilitet nuk është bërë sipas standardeve, konkretisht zëri "pajisje elektronike", me kosto historike 1,087,256 lekë dhe vlerë të mbetur 125,639 lekë është pasqyruar në llogarinë 218 "Inventar ekonomik".

"Institucioni të sistemojë sipas standardeve në kontabilitet dhe në pasqyrat e inventarëve zërin "pajisje elektronike" me kosto historike 1,087,256 lekë dhe vlerë të mbetur 125,639".

II. Nga vëzhgimi i bërë ndërtesës së institucionit u konstatua se i gjithë ambienti i sallës ku zhvilloheshin aktivitetet rezulton të jetë shumë i dëmtuar nga lagështia. Bashkia Durrës ka planifikuar rikonstruksionin e saj me fondet në vite dhe akoma gjendja është shumë e keqe.
Rekomandimi i lënë:
"Drejtuesi i Institucionit duhet të ndjekë procedurën e tenderimit pranë Bashkisë për të bërë të mundur kryerjen e investimit në mënyrë që salla të jetë funksionale për të zhvilluar aktivitetet e planifikuara për fëmijët".
Nga auditimi mbi zbatim e rekomandimeve për hapat e ndjekur nga **Qendra Kulturore e Fëmijëve**, konstatohet se rekomandimi i lënë është zbatuar.
5. Dosja e auditimit financiar dhe përputhshmërie për subjektin **Ndërmarrja Komunale Plazh**, me objekt "Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme, sistemit të menaxhimit të aseteve dhe pronave publike në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi, identifikimi i mangësive për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 dhe ndërmarrja e veprimeve korrigjuese*"*:
Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:
☞Të ndihmojë njësinë në përmbushjen e misionit, objektivave vjetore dhe strategjike, duke kontribuar sistematikisht në vlerësimin, disiplinimin dhe përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të riskut, të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe proçeseve të vendimëmarrjes.
Gjetjet e konstatuara:
I. Konstatohet se Ndërmarrja Komunale Plazh arkëton të ardhura nga qiratë e ambienteve në pronësi të saj. Në mbështetje të ligjit 9936 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH"* i ndryshuar, neni 8 si dhe Vendimit nr.54 *"Për përcaktimin e kritereve, procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"* i ndryshuar, të gjitha të ardhurat e siguruara nga subjektet e financuara nga buxheti duhet të depozitohen pranë Degës së Thesarit për llogari të Bashkisë Durrës.
Rekomandimi i lënë:
"Ndërmarrja Komunale Plazh, të ardhurat nga qiratë e ambienteve në pronësi të saj, ti depozitojë pranë Degës së Thesarit për llogari të Bashkisë Durrës".
II. Konstatohet se në dokumentacionin për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mungojnë referencat nga INSTAT, bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar.
Rekomandimi i lënë:
"Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të dokumentojë në dosje të gjithë dokumentacionin të cilit i është referuar për mënyrën e përllogaritjes"
III. Konstatohet se dosjet e prokurimit nuk janë te inventarizuara dhe arshivuara kërkesë e nenit nr.74 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* dhe ligjit nr.9154 datë 06.11.2003 *"Për arkivat"* Përgjegjësi mban njësia e prokurimeve.
Rekomandimi i lënë:
"Në përfundim të çdo proçedure tenderimi të inventarizohen dhe arshivohen dosjet e tenderave"
IV. Konstatohet se në zërin "Mjete transporti":
Me VKB NR.80, datë 28.06.2021 Ndërmarrja Komunale Plazh ka transferuar në ndërmarrjen Rruga një shumë prej 1,920,000 lekë dhe këtë veprim nuk e ka pasqyruar në kontabilitet.
Rekomandimi i lënë:
"Të kryhet veprimi në kontabilitet për trasferimin në Ndërmarrjen Rruga të mjetit traktor bujqësor me vlerë fillestare në vlerën 1,920,000 lekë"
"Të kryhet sistemimi në kontabilitet për gabimin matematikor me vlerën 400,000 lekë"
"Të pasqyrohet në shtesën e vlerës fillestare investimi i kryer për kamionin benz mercedes me targë 1828 në vlerën 946,200 lekë"
V. Konstatohet se sipas lëvizjeve të pasqyruara në bilanc, Ndërmarrja Komunale Plazh ka bërë blerje aktive të qëndrueshme pa pasur fonde buxhetore për investime.

Rekomandimi i lënë:
"Për të gjitha ndryshimet e zërave të buxhetit duhet të merret aprovimi i organit epror"
VI. Konstatohet se dhënia hua pa shpërblim karburët e llojit naftë dhe kthimi i sasisë së marrë është bërë në bazë të proces verbaleve të shoqëruar me flete-hyrje dhe fletë-dalje të paregjistruara në kontabilitet, fenomen i përsëritur në vitin 2020 dhe 2021.
Rekomandimi i lënë:
"Në të gjitha rastet, lëvizja e aktiveve qarkulluese të pasqyrohet në kontabilitetin e ndërmarrjes dhe për karburantin nafte të dyja ndërmarrjet në fund të vitit të bëjnë së bashku rakordimin me sistemin"
VII. Konstatohet se përdorimi i kartës gold nuk bëhet sipas grafikut të planifikuar
Rekomandimi i lënë:
"Të gjitha rastet emergjente të përdorimit të kartës gold të shoqërohen me urdhër të dokumentuar nga eprori përkatës".
Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve për hapat e ndjekur nga Ndërmarrja Komunale Plazh, konstatohet se 1 rekomandim është në proces zbatimi dhe 1 rekomandim nuk është zbatuar.
Dosja e auditimit mbi "<u>Zbatimin e rekomandimeve për vitin 2021</u>"
Gjatë verifikimit të rekomandimeve të dhëna gjatë 2021 janë verifikuar dhe vlerësuar gjithashtu statusi i rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme.
Në mbështetje të planit vjetor të miratuar për vitin 2022 me nr.9996/2 prot., datë 11.10.2021, ka qenë planifikuar edhe 1 angazhim auditimi, me objekt:" Vlerësimi i përputhshmërisë, në zbatim të rekomandimeve, të periudhës deri në 31.12.2021".
Në auditimet e kryera gjatë vitit 2021 janë dhënë gjithsej 67 rekomandime të cilat janë pranuar nga subjektet objekt auditimi. Nga rekomandimet e pranuara janë në proces zbatimi 12 rekomandime prej tyre dhe 10 rekomandime të pazbatuara. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:
Referuar Raportit të Auditimit rezulton se:

Niveli i zbatimit të rekomandimeve, për periudhën 2021 paraqitet si më poshtë:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2021	67	45	12	10	0			
TOTALI		**67**	**45**	**12**	**10**	**0**			

Burimi: NJAB Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka marrë në shqyrtim dhe ka mbikqyrur proçesin e monitorimit e ndjekjes së rekomandimeve të dhëna si nga struktura e auditimit të brendshëm, ashtu edhe nga KLSH. Nga rekomandimet e pranuara janë në proçes zbatimi 12 rekomandime prej tyre dhe 10 rekomandime të pazbatuara.
Grupi i auditimit nuk ka analizuar arsyet e mosrealizimit të rekomandimeve të mëparshme.
Referuar Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.13.3 përcaktohet se:
-Një njësi e mirë menaxhuar vendos procedura për t'u siguruar se çdo rekomandim i bërë nga njësia e AB, zbatohet ashtu siç duhet;
-Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkëpunim me menaxhimin cakton një punonjës me përvojë që të evidentojë të gjitha rekomandimet e bëra nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë dhe informojë për progresin që është bërë për zbatimin e tyre. Kjo do të ndihmojë që të sigurohet se përmirësimi i kontrolleve të brendshme është përgjegjësi e menaxhimit të njësisë publike dhe jo rol i Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

<u>Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm</u>

Për të analizuar mjedisin e kontrollit, në manual jepet formati standard 1 "Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm" në fund të kapitullit III i cili duhet të plotësohet një herë në vit dhe të bëhet si pjesë e procesit të planifikimit fillestar. Pyetësori i vlerësimit të

Mjedisit të Kontrollit ka për qëllim të ndihmojë njësinë e auditimit të brendshëm të kuptojë se sa mirë menaxhohet njësia dhe se cilat janë fushat/sistemet më me risk.
Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm është bërë vlerësimi i kontrollit të brendshëm si një nga detyrat themelore të auditimit të brendshëm. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm është bërë nga drejtuesi dhe dy audituesit e NJAB duke qenë se nuk ka një komitet auditimi për të pasur një vlerësim më të saktë e profesional.

Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm , si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë , vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.
Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Durrës ka miratuar me shkresën nr.3996/1, datë 15.02.2019 të Kryetarit të Bashkisë *"Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm"* dhe kryen vlerësimet e brendshme të cilësisë. Nga shqyrtimi i këtij programi dhe anekseve përkatëse rezulton se nuk janë të përcaktuar indikatorët e performacës, dhe evidentohet se anekset mbi monitorimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së njësisë, nuk janë hartuar në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Dosja e përhershme

Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësisë që auditohet.
Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.
Grupi auditimit zgjodhi të auditojë 3 dosje të përhershme që janë:
-dosja e përhershme e *"Ndërmarrjes Makina Impeks";*
-dosja e përhershme e *"Drejtorisë së Shërbimeve";*
-dosja e përhershme e *"Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore".*
NjAB në Bashkinë Durrës nuk ka përditësuar dosjet e përhershme pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e tyre.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Bashkia Durrës nuk ka krijuar Komitetin e Auditimit;
-Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 *"Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016"*;
-Për vitin 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Durrës, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve, auditime të teknologjisë së informacionit etj..
-*"Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm",* nuk ka të përcaktuara mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës. Programit të miratuar i mungon komponenti *"Reagimet e subjektit të audituar"* në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm Kapitulli VII, pika 7.1.1;
- Për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në Planin Strategjik për vitet 2022-2024, planifikimi i subjekteve të cilat janë parashikuar të auditohen nuk është në përputhje me

kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i cili përcakton se: Plani strategjik i veprimtarisë së NjAB bazohet në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve. Në vitin e parë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të lartë, në vitin e dytë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të ulët se në vitin e parë dhe në vitin e tretë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të ulët se në vitin e dytë por duhet respektuar frekuenca jo më shumë se 5 vjet.
-Audituesit e brendshëm nuk janë trajnuar në fushat e planifikuara në Planin Strategjik të Auditimit, miratuar me shkresën nr. 9996/3 datë 11.10.2021 dhe trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut;
-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;
-NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;
-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;
-Dosjet e auditimit nuk përmbajnë "Dokumentet e mbledhura përpara fillimit të angazhimit të auditimit" sipas kërkesave të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF "Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik" i ndryshuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 kapitulli VI "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese" pika 2;
- NjAB në Bashkinë Durrës nuk ka përditësuar dosjet e përhershme pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e tyre. Informacioni që ruhet në dosjen e përhershme të auditimit nuk është sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 *"Dosja e Përhershme",* Formatin Standard nr. 2 *"Indeksi i Dosjes së Përhershme".*

Nga përfaqësuesit e NJAB Bashkia Durrës me shkresën nr. 946/1 prot., datë 19.02.2024, janë paraqitur observacione si në vijim:
Pretendimi i subjektit:
Observacion gjetja nr.6, rekomandimi nr.6.1:
1.Referuar Krijimit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, sikurse parashikohet në nenin 12, pika b) dhe nenin 13 pika 2) të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", **në fuqi në vitin 2022**, është vetëm në gjykimin dhe vendimarrjen e titullarit të Bashkisë Durrës, krijimi i komitetit të auditimit që si organ i pavarur monitoron dhe ofron këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike, në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
2.Referuar trajnimit dhe certifikimit te audituesve, në zbatim të urdhërit nr.248, datë 31.12.2021 "Për miratimin e Programit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional të AB në sektorin publik për vitin 2022, procesi i trajnimit të audituesve të brendshëm është organizuar dhe zhvilluar nga Drejtoria e Harmonizimit te Audituesve të Brendshëm në Ministrinë e Financave, sipas kalendarit të miratuar prej tyre, e cila **përcakton edhe temat e zgjedhura** për trajnim në bazë të kërkesave që dërgohen në Drejtorinë e Harmonizimit të Audituesve të Brendshëm në Ministrinë e Financave nga të gjitha njësitë e auditimit të vendosura në institucione të ndryshme sipas nevojave. (bashkëngjitur emaili ardhur nga MF dhe kalendari për ditët e trajnimit.)
-Gjithashtu bazuar në shkresën me nr.6427prot. datë 21.07.2022 dhe urdhër nr.191 datë 19.07.2022, ka filluar procesin e certifikimit znj.O.D e cila ka perfunduar certifikimin vërtetuar me Certifikatë

Audituesi nr.2124 date 15.09.2023 dhe rezulton si audituese e certifikuar në regjistrin kombëtar të audituesve të brendshëm. (bashkelidhur Certifikate Audituesi dhe Regjistri Kombëtar i Audituesve të Brendshëm marrë nga faqa zyrtare e Ministrisë së Financave).
-Përsa i përket trajnimit për edukimin e vijueshëm, me konfirmim nga Drejtoria e Harmonizimit të Audituesve të Brendshëm ne Ministrinë e Financave, audituesit që ndoqën trajnimin e detyrueshëm nuk marrin pjesë në këto trajnime për vitin 2022-2023, por duke ju referuar nenit 16, pika dh, dh) të përditësojnë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorin ato me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit; znj.D. në vitin 2022 ka kryer trajnimin profesional të njohur nga Ministria e Financave me temë "Kontabiliteti praktik dhe financa 5" ne datat 16.05.2022 - 24.06.2022, dhe ka marre pjesë në trajnimin me temë " Integrimi i Shqipërisë në BE Roli i të rinjve, Shoqerise Civile dhe Administrates Publike" date 27.05.2022 dhe ne trajnimin me teme " Administrata Publike – Formimi i Institucioneve, Reformat, Shqyrtimi Administrativ & Procedurat Administrative date 15.09.2022. (bashkëlidhur 3 certifikatat)

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, audituesit e KLSH-së sqarojnë se:
-Vlen të theksojmë se, sikurse parashikohet në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", përcakton se: Krijimi i komitetit të auditimit si organ i pavarur monitoron dhe **ofron këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike,** në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
VKM nr. 160, datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimin, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm", në pikën 2 të tij përcakton se: **Komiteti i Auditimit të Brendshëm i jep titullarit të njësisë publike garanci të arsyeshme për mënyrën e funksionimit të njësisë publike**.
Ministri i Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e organit që bashkërendon, harmonizon dhe monitoron veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, me shkresën nr.13893 prot., datë 22.07.2019 "Mbi krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm", ka ofruar asistencë në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Durrës nëpërmjet propozimit të disa hapave konkretë.
Sa më sipër, krijimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm si organ këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm jo vetëm për të siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm, duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit por edhe për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit të brendshëm, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe audituesit e jashtëm.
-Ritheksojmë se audituesit e brendshëm nuk janë trajnuar në fushat e planifikuara në Planin Strategjik të Auditimit, miratuar me shkresën nr. 9996/3 datë 11.10.2021 dhe trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për MFK-në i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.
-Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. O.D lidhur me procesin e certifikimit, vërtetuar me çertifikatë audituesi nr.2124 date 15.09.2023, grupi i auditimit vlerëson se janë përgjithësisht të drejta dhe do të kryej reflektimin e tyre.
Për sa më sipër, observacionet merren pjesërisht në konsideratë dhe grupi i auditimit ka kryer reflektimin në këtë raport përfundimtar auditimi.

Observacion gjetja nr.6, rekomandimi nr.6.2:

Referuar shqyrtimit të risqeve më të rëndësishme për planifikimin, ju sqarojmë se në Planin Vjetor për vitin 2022, planifikimi i subjekteve të cilat janë parashikuar të auditohen është kryer në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm duke u bazuar në auditimin e subjekteve të vlerësuara me risk më të lartë, të mesëm dhe duke respektuar frekuencen e jo më shumë se 5 viteve. (bashkëlidhur dokumentacioni)
Bazuar në Kapitullin 3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, pika 3.1.3 "Faza3, Strategjia e auditimit (frekuenca e kryerjes se auditimeve)" janë planifikuar dhe janë audituar edhe tre subjektet Drejtoria e Shërbimit Social, Ndërmarrjet me Drejtim Ekonomik, Qendra Kulturore e Femijeve të cilat pavarësisht se vleresohen në nivel risku të ulët nuk duhet të planifikohen më rrallë se 5 vjet.

(vërtetuar kjo me shkresat e raporteve bashkangjitur për secilin angazhim të vitit 2022 si edhe shkresat e raporteve te angazhimit paraardhës brenda harkut kohor prej 5 vitesh).
Gjithashtu theksojmë faktin se subjekti i planifikuar "Drejtoria Ligjore" nuk është audituar, pasi në zbatim të Njoftimit të Auditimit te KLSH ardhur me shkresë nr.369 date 06.04.2022 dhe program auditimi prot.369/1 datë 08.04.2022, si dhe njoftimit të fundit për ndryshim prot. 369/7 date 27.07.2022, ky subjekt eshte audituar nga KLSH, program i cili ka filluar më datë 11.04.2022 dhe ka përfunduar më datë 16.09.2022. (bashkëngjitur njoftimi & programi & shtyrja e afatit të fundit të auditimit të KLSH)

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, audituesit e KLSH-së sqarojnë se:

Në planin strategjik nr. 999/6 prot., datë 11.10.2021, pika 4, janë identifikuar 41 subjekte objekt auditimi dhe janë planifikuar të auditohen përgjatë vitit 2022 11 subjekte. Janë audituar përgjatë periudhës objekt auditimi 10 subjekte dhe rezulton se **vetëm 2 subjekte kanë nivel të lartë risku.**

Për sa më sipër, observacionet nuk merren në konsideratë pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

Titulli Gjetjes: KLSH ka konstatuar se, ekzistonin mangësi në lidhje me organizimin dhe funksionin e Sektorit të AB.

Situata: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Durrës përgjatë vitit 2022, u konstatua se:

-Karta e Auditimit të Brendshëm, nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në MAB si dhe nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.

-Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm nuk ka të përcaktuara mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës.

-Audituesit e brendshëm nuk janë trajnuar në fushat e planifikuara në Planin Strategjik të Auditimit, miratuar me shkresën nr. 9996/3 datë 11.10.2021 dhe trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit.

-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve.

-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të MAB.

-NjAB nuk ka përditësuar dosjet e përhershme pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e tyre.

-NJAB, nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, asetet, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në mospërputhje me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

Kriteri: Ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 5, 6, 13, 14 i ndryshuar;

VKM nr. 160 datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit";

"Manuali i Auditimit të Brendshëm", miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.12, Kapitulli VI, pika 2, pika 6.3, Kapitulli VII, pika 7.1.1;

VKM nr. 160 datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit"
Impakti: Mos efektivitet të kontrollit e monitorimit të sistemit të MFK si dhe mosdhënie i një sigurie objektive e këshilluese për stafin menaxherial të kësaj njësie vendore.
Shkaku: Nga neglizhenca, dhe mos përmbushja e angazhimeve për auditim sipas planifikimit të bërë.
Rëndësia: -I Mesëm.

2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
1. Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2022-2024
Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024 rezultoi se:
- Për realizimin e fazave tëpërgatitjes ka dalë Urdhri i Titullarit nr.50 datë 29.01.2021, ndryshuar me Urdhrin nr. 435 mbi bazën e të cilit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i përbërë prej 16 punonjësish dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP). Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe buxheti i vitit 2022, si dhepjesa e buxhetit për fondet e trashëguara janë miratuar në Këshillin Bashkiak.
-Është përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor, i ciliështë miratuar me VKB nr.124 datë 24.12.2020 dhe konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.prot.998/2,datë05.01.2021në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33/1.
-Me VKB nr.84, dt.28.06.2021, konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.479/1 dt. 08.07.2021është miratuar dokumenti i pare i Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, në të cilën janë miratuar dhe tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34/6.
- Në këtë programim është përfshirë Instrumentii planifikimit financiar, shoqëruar me relacionin shpjegues, i ciliështë dërguar në MFE në mënyrë elektronike. Instrumenti i planifikimit financiar përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara,burimet e financimt të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashigimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogarija e konomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).
- Në dokumentin e PBA janë përcaktuar drejtimet e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, duke u bazuar në analizën e zërave të buxhetit në tre vitet e fundit dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin PBA-ja 2022-2023-2024.
- Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e arsimit dhe menaxhimit të mbetjeve.
- Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje", ku për të cilat ishin mbajtur relacionet dhe protokollet përkatëse.
- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2022-2024 dhe buxheteve vjetore, rezulton se janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Durrës në rolin e drejtuesve të programeve buxhetore përkatëse, si dhe nga kërkesat nga Ndërmarrjet dhe Institucionet në varësi të Bashkisë, që mbulojnë këto programe. Kërkesat për fonde janë hartuar për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat.
Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 158 dt.23.12.2021 është miratuar dokumenti përfundimtar i Programi buxhetor afatmesëm 2022-2024, si dhe buxhetit vjetor i vitit 2022, i cili është viti i parë i PBA-së 2022-2024

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2022

Për vitin 2022, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 158, datë 23.12.2021, pika 2, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr.08/1 date 10.01.2022, i paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2022	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	2,027,023	
2	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar	877,905	
3	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	778,890	
4	Paga (600)		1,198,680
5	Sigurime shoqërore (601)		192,783
6	Shpenzime operative (602)		1,176,442
7	Transferta (604 – 606)		62,000
8	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		36,000
9	Fondi Rezervë dhe kontigjences (609)		987,914
Totali i buxhetit		**3,683,818**	**3,683,818**

Me Vendim të KB nr.21, datë 31.03.2022 është miratuar edhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara nga viti paraardhës, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr.220/3, datë 31.03.2022, konkretisht këto fonde të trashëguar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2022	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura	653,321	
2	Transferta e Pakushtëzuar e papërdorur në 2021	96,018	
3	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale e papërdorur në 2021	107,465	
4	Paga (600)		54,521
5	Sigurime shoqërore (601)		7,188
6	Shpenzime operative (602)		79,953
7	Transferta (604 – 606)		11,700
8	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		52,996
9	Fondi Rezervë dhe kontigjences (609)		615,446
Totali i buxhetit		**856,804**	**856,804**

Sipas tabelës së mësipërme buxhetit i vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite,kutë ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 3.683.819 mijë lekë dhe trashëgimet e fondeve në vlerën 856.803mijë lekë. Buxheti i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak përfshijnë shpenzimet me fondet nga të ardhurat e veta , transferta e pakushëzuar dhe sektoriale.

Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

	Emërtimi	Plan fillestar 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Paga (600)	1,198,680	1,198,680	0
2	Sigurime shoqërore (601)	192,783	192,783	0
3	Shpenzime operative (602)	1,176,442	1,176,442	0
4	Transferta (604 – 606)	62,000	62,000	0
5	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike	36,000	36,000	**0**
6	Fondi Rezervë dhe kontigjences (609)	987,914	987,914	**0**
0	**Gjithsej**	**3,683,818**	**3,683,818**	

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave nga KLSH sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Sikurse shihet edhe nga tabela e mësipërme nuk ka diferenca midis PBA 2022-2024 dhe vitit 2022, për arsye se tavanet e PBA janë rishikuar në fund të vitit 2022.

2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizmit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Durrës dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve. Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Durrës dhe auditimi i tyre konstatohet se, buxhetivjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Durrës. Lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB. Për vitin 2022 ndryshimet në buxhet për shpenzimet në mënyrë të detajuar praqiten në Aneks:

Nga sa më sipër konstatojmë se, për vitin 2022 kanë ndodhur 10 ndryshime me VKB, dhe 1 me VKM. Këto ndryshime sikurse shihet nga tabela janë rialokime shpenzimesh,ndërmjet programeve, si dhe për efekt të fondeve ta alokuara nga buxheti i shtetit për efekt të rritjes së pagave dhe mbështetje financiare për zbutjen e impaktit të krizës .

3. Saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Durrës si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Durrës, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2022, të miratuar me Vendim të KB, ose të diktuara nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. nga auditimi i shkresave, evidencave të celjeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Durrësu konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për Bashkinë Durrës dhe ndermarrjet e institucionet e varesise referuar akt-rakordimet me thesarin sipas burimit të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2022		
		Plan	fakt	Realizimi ne %
I.	**BASHKIA**			
1	Paga (art.600)	410,188	376,223	92
2	Sigurime shoq. (art.601)	65,863	61,205	93
3	Shp. operative (art.602)	624,821	582,623	93
4	Transferime (art.604+606)	80,410	79,434	99
5	Fond I kushtezuar emergj.civile (Min.17 art. 604)	9,668	9,668	100
6	Nd.ekonomike+PAK (Min.13 art.606)	1,138,227	1,124,900	99
7	Bonus qeraje familjet ne nevoje (Min.10 art.606)	11,537	11,537	100
8	Subvencion nga enti banesave (Min.10 art.606)	3,078	3,078	100
9	Bonus qeraje termeti (Min.10 art.606)	964,582	876,690	91
10	Investime 230+231	859,795	536,380	62
	Totali I.1	**4,168,168**	**3,661,736**	**88**
	Rindertimi			
11	602 (transporti shembjeve) (grupi 00)	48,729	46,381	95

12	604-606 (grante rindertimi DS1,DS2,DS3,DS4,DS5)(grupi 00)	629,355	550,177	87
13	230+231 (investime rindertimi) (grupi 00)	3,802,519	2,976,871	78
	Totali 1.2 (fondet rindertimit)	**4,480,603**	**3,573,429**	**80**
	TOTALI I.1+I.2 (BASHKIA)	**8,648,771**	**7,235,165**	**84**
II.	**INSTITUCIONET DHE NDERMARRJET E VARESISE**			
14	Paga (art.600)	832,557	750,782	90
15	Sigurime shoq. (art.601)	135,838	124,726	92
16	Shp. operative (art.602)	677,698	667,551	99
17	Shp. operative (Min. linj 11 art.602)	23,429	23,226	99
18	Transferime (art.604+606)	27,935	27,885	100
19	Transferime (Min.linjes 10 art.604+606)	27,088	27,046	100
20	Investime 230+231	152,415	113,827	75
	TOTALI II (INSTITUCIONET DHE NDERMARRJET E VARESISE)	**1,876,959**	**1,735,044**	**92**
	TOTALI I+II	**10,525,730**	**8,970,210**	**85**

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme niveli i realizmit të treguesve të buxhetit të Aparatit të Bashkisë Durrës:

- Për **vitin 2022** fondet janë realizuar 7,235,165 mijë lekë nga 8,648,771 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 84%.

Në këtë masë realizim ka ndikuar realizimi në masë të konsiderueshme në zërat e buxhetit:

a) Shpenzimet për investime llog.231 nga buxheti i Bashkisë, si dhe transferta e kushtëzuar pa përfshirë rindërtimin nga pasojat e tërmetit i vitit 2019 janë realizuar në masën 62%. Realizimi nëkëtë masëtë ulët ka ardhur për shkak te zgjatjes së procedurave të prokurimit, nisur që nga specifikimet teknike e deri tek lidhja e kontratës, duke sjellë qërealizimi i kontratës dhe financimi të shtrihet përtej vitit ushtrimor.Theksojmë se në fund të periudhës nuk rezultojnë fatura për objekte investimesh të palikujduara për mungesë fondesh nga të ardhurat e Bashkisë.

b) Investimet nga rindertimi nga pasojat e tërmetit të vitit 2019 janë realizuar në masen 78%. Arsyet qe kanë ndikuar në këtë realizim kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit, problematikat që kanë patur gjatë realizimit të punimeve. Të gjitha fondet e alokuara për projekte investimesh për rindërtimin janë prokuruar. Gjate vitit 2022 janë lidhur 20 kontrata për projekte investimesh nga fondi i rindërtimit. Transfertat tek individët llog.604 dhe 606 për rindërtiminjanë realizuar në masën 87%, kjo për faktin se sipas metodologjisë së rindërtimit, rimbursimi i plote (40%) i grantit të rindërtimit të banesave individuale bëhet në momentin e përfundimit të ndërtesës. Këto ndërtesa në fund të vitit 2022 rezultojnë të papërfunduara. Fondet e papërdorura të rindërtimit (grupi 00) të papërdorura deri më 31 dhjetor 20022 janë trashëguar në vitin 2023 sipas aktrakordimit me Degën e Thesarit Durrës për fondet e trashëguara nga viti 2022.

Pesha specifike e shpenzimeve faktike sipas artikujve për vitin 2022 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi shpenzimit	**Pesha specifike në %**
Paga 600	5.20
Sigurime shoqërore 601	0.85
Shpenz.operative 602	8.69
Transferime 604 (kuota Qarkut, fondi kushtezuar emergjenca civile)	1.31
Transferme 606 (bonus strehimi, ndihma financiare)	35.39
Investime 230-231	48.56

Konkluzion: Mosrealizimet në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumetuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale.

Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë investimet për programin e Rindërtimit si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019 me 41% të fondeve të alokuara për vitin

2022, e ndjekur nga transferimet tek individët për ndihmë ekonomike e invaliditeti, subvencionimi i qirasëdhe grantet e shpërndara familjeve për riparim ose rindërtim të banesave të dëmtuara nga tërmeti. Shpenzimet e personelit zënë peshën më të vogël.

Nr.	EMËRTIMI	Përqindja ndaj totalit
		Viti 2022
1.	Investime Rindërtimi	41%
2.	Bonusi qerase per termetin	12%
3.	Grantet për demet DS1-DS5	8%
4.	Transferta Nd.Ek+Invalid	16%
5.	Shpenzime korente te tjera	8%
6.	Investime nga te ardhurat e veta te bashkise	7%
7.	Shpenzime personeli	6%

Referuar aktrakordimeve me Thesarin, planifikimi dhe realizimi i fondeve sipas njësive të varësisë dhe zërave të shpenzimeve paraqitet në Aneks:

Në 000/lekë

Emertimi i Njesise Shpenzuese	Paga (600)		Sig.shoqerore (601)		Shp.operative (602)		Transferime tek individ (604+606)		Investime (230+231)		Totali (000/lekë)	
	Plan	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**
Ndërmarrja Rruga	134,345	125,968	21,642	20,528	137,968	137,404	28,171	28,171	149,785	111,292	**471,911**	**423,363**
Qendra Ekono Arsimi	359,419	297,331	57,249	49,654	136,291	129,266	10,657	10,657	582	569	**564,197**	**487,477**
Ndërm.Shërb Komun	166,700	161,378	28,534	26,919	210,952	209,100	6,833	6,783	-	-	**413,019**	**404,179**
Ndërm.Komun Plazh	85,373	82,744	14,172	13,842	114,000	113,866	3,691	3,691	-	-	**217,236**	**214,143**
Klubi Futbollit Teuta	4,555	4,010	748	648	25,000	24,992	140	140	-	-	**30,443**	**29,789**
Qend Ditor Moshuar	23,434	21,623	3,816	3,628	8,460	8,217	4,097	4,055	-	-	**39,807**	**37,524**
Klub Shumsport Teut	12,293	12,293	2,053	2,053	39,000	39,000	414	414	100	100	**53,859**	**53,859**
Qend.Kulturor Fëmijë	8,669	7,748	1,401	1,294	3,500	3,500	140	140	-	-	**13,710**	**12,682**
Qend.Kultur A.Moisiu	26,320	26,316	4,275	4,259	20,156	20,138	700	700	1,949	1,866	**53,400**	**53,280**
Biblioteka	11,450	11,372	1,948	1,901	5,800	5,296	180	180	-	-	**19,378**	**18,749**
Totali	**832,557**	**750,782**	**135,838**	**124,726**	**701,127**	**690,778**	**55,023**	**54,931**	**152,415**	**113,827**	**1,876,959**	**1,735,044**

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës

Fondi rezervë i planifikuar për vitin 2022 në vlerën 40,000 mijë lekë është përdorur me 4 vendime të vecanta të Këshillit Bashkiak në masën 39,253 mijë lekë ose 96,3% , si më poshtë:

- ✓ Me VKB nr. 32 dt. 28.04.2022 është alokuar fondi prej 1,953 mijë lekë për financimin e projektit : "Rikonstruksion i terrenit sportiv ne shkollen 9 vjecare"Fshat Rinia", Njesia Administrative Katund i Ri", si nje kontribut i përbashket midis Bashkise Durres dhe World Vision Albania
- ✓ Me VKB nr. 73 dt. 12.07.2022 është alokuar fondi prej 300 mijë lekë për Festivalin veror të librit që u zhvillua në Durrës.
- ✓ Me VKB nr.105 dt. 9.10.2022 është alokuar fondi prej 3,000 mijë lekë për financimin e "Studim projektim Parku Urban Spitallë".
- ✓ Me VKB nr.113 dt. 27.10.2022 është alokuar fondi prej 34,000 mijë për financimin e kontratës së depozitimit të mbetjeve në Sharrë , pasi fondet e alokuara nga Qeveria gjatë vitit 2022 në formën e transfertës sektoriale për këtë qëllim prej 221,600 mijë lekë ishin të pamjaftueshme.

Fondi i kontigjences i planifikuar ne vlerën 25,000 mijë lekë është përdorur 100% me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 113 dt.27.10.2022 për shtesë fondi për shpenzime operative të Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale për përballimin e efektit financiar të rritjes së cmimeve.

- *Raportet e Monitorimit.*

Për vitin 2022, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 6.Për vitin 2022 janë 3 raporte monitorimi, të cilat janë dërguar me email në MFE, dhe raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2022 është miratuar edhe në Këshill Bashkiak me VKB nr. 77, dt. 30.03.2022.

Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit janë të plota me të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pikat 10, 12, 28, 29, 48.

4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizmit të të ardhurave.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikoje procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës**,** kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likujdimi i faturave të palikuiduara

Me fondet e vitit buxhetor 2022, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Bashkia, nga Ministritë e linjës, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës "*Detyrimet e prapambetura*", sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2022:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31.12.2021 (lekë)	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2022 - 31.12.2022 (lekë)	Total detyrime (lekë)	Shlyerja e detyrimeve 2022 (lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022 (lekë)
a	**1**	**2**	**3=1+2**	**4**	**5=3-4**
a. Investime nga Ministritë e linjës e FZHSH	36,370,104		36,370,104		36,370,104
b. Investime nga Bashkia	535,060		535,060		535,060
INVESTIME :					
Mallra dhe shërbime					
Vendime gjyqsore	119,982,794		119,982,794	46,513,566	73,469,228
c. Rindertimi					0
Totali :	**156,887,958**		**156,887,958**	**46,513,566**	**110,374,392**

Burimi: Nga të dhënat e subjekti sipas pasqyrave

Referuar shkresës nr.395/1 prot,datë.28.02.2022 "Dërgohet vetëvlerësimi financiar për vitin 2021" të Bashkisë Durrës dërguar në MFE e për rrjedhojë dhe publikimit të detyrimeve të prapambetura në faqen e MFE në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën 156,887,958 lekë dhe në fund të vitit 2022 referuar shkresës nr.prot.1366/1 datë 09.03.2022 "Dërgohet vetëvlerësimi për vitin 2022" në shumën 110,374,392 lekë. Gjatë vitit 2022 nuk janë krijuar detyrime të reja dhe është likuiduar vlera prej 46,513,566 lekë, dhe vlera e detyrimit është 110,374,392 lekë e ndarë:

-Detyrime te ministrive të linjës, FZHR…….. …….36,370,104 lekë;
- Detyrime fatura investime Bashkia ……535,060 lekë;
- Detyrime që rrjedhin nga vendimet gjyqësore …….. 73,469,228 lekë

Shënim: Detyrimet e raportuara në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë **për vitin 2022** me shkresën nr.1366/1 prot, datë 09.03.2023 janë në vlerën 74,004,288lekë dhe i përkasin detyrimeve tëmbartura nga ish komunat. Ndërsa vlera 36,370,104 lekë janë detyrime nga FZHSH për ish komunat,të cilat nuk janë përfshirë në raportim, pasi likujdimi i tyre është i varur nga alokimi i fondeve nga Pushteti Qendror.

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnëqë, në fund të vitit 2022 janë të pa likuiduara gjithsej 8 fatura me vlerë 535,060 lekë, të cilat janë fatura të mbartura nga ish komunat dhe kanë mbetur pa likuiduar për mungesë dokumentacioni. Gjithashtu në listën e detyrimeve bëjnë pjesë edhe detyrimet nga vendimet gjyqsore në vlerën 73,469,228 lekë. Detyrimet e prapambetura të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Nr.	Subjekti	Objekti I kontratës	Numri I faturës	Data e faturës	Gjendje me 31.12.2021	Pagesat gjatë vitit 2022	Shtuar gjatë vitit 2022	Gjendje në 31.12.2022
1	D.P	Kolaudim rr.brend. 2013	112134	09/01/2014	11,400			11,400
2	L.K	Kolaudim rik.rr. M.-shenp.	9790023	26/12/2013	1,200			1,200
3	R shpk	Sup.pastrim kanale kullues	10823710	31/10/2013	11,520			11,520
4	B.T	Kolaudim past.kanale kulluese	85035305	05/11/2013	4,740			4,740
5	G .	Sup.ndert.pusetash f.gjuricaj	1935398	05/12/2014	34,800			34,800
6	P .	Kolaudim rrug.brend.2014	13207683	26/11/2014	26,400			26,400
7	A shpk	Rik.Zyrave te Reja(ndertim i rrjetit elektrik)	19950641	31/03/2015	40,000			40,000
8	N shpk	Sistemim asfaltim rruge L.Erzen	12421480	29/01/2014	405,000			405,000
		Totali I			**535,060**			**535,060**
II		**Fatura palikujd me financim nga FZHR, Min. e linjes**						
10	V	Rik. Rruga Mamin. Sh. Pjeter			3,179,888			3,179,888
11	E Shpk	Rik.rr.Hoxha-Fortuzi ne fshatin Shkalle(LOTI I)			31,640,904			31,640,904
12	H	Rik. shkolle Rrashbull(pa fature)		Kontr15/9/2014	1,549,312			1,549,312
		Totali 2			**36,370,104**			**36,370,104**
III		**Vendime gjyqsore**						
1	C.V	Vend. gjyqsor nr.2 dt.30/01/2008 I Gjykat Apel Durres			1,893,376			1,893,376
2	J.M	Vendimi nr. 224, dt. 19.02.2014 i Gjykatës së Durrës & marrëveshja nr. 521 Prot, dt.06.03.2015			1,764,995	1,764,995		
3	K.K	Vendim gjyqsor nr.14 dt. 16.04.2011 I GJ.Apel.Durres			4,310,666			4,310,666
4	AMC	Vendimi nr.7512 dt.30.09.2011 i Gjykatës Tiranë			641,043	641,043		
5	UKD	Vend.nr. 224,dt. 19.02.2014 Gjykat Durrës & marrëvesh nr. 521 Prot, dt.06.03.2015 detyrim Ish-komu Rrashbull			64,128,642			64,128,642
6	N.N	Vendimi nr.258, dt.21.04.2014 i Gjykatës Durrës detyrime Ish-komun Ishëm (ndërt. ujsjellsi)			42,787,822	42,787,822		
7	B	Vendimi nr. 2058 dt.28/12/2016 i Gjykates Durres dhe Vendi I Gjykates se Apelit Durres nr. 798 dt.13.09.2017			1,319,706	1,319,706		
8	F.RR	Vendim gjyqsor pronesie			3,136,544			3,136,544
		Totali III			**119,982,794**			**73,469,228**
		TOTALI I+II+III MFE			**156,887,958**	**46,513,566**	**0**	**110,374,392**

Detyrimet e prapambetura për vitin 2022 të paraqitura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.1366/1 dt.09.03.2023 paraqiten në tabelën si më poshtë:

NR	Emërtimi	Stoku në vlerë (lekë)	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	**Borxhe (a+b)**	**0**		
a	**Hua afatgjatë**	**0**		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	**Hua afatshkurtër**	**0**		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	**Detyrime (a+b+c)**	**74,004,288**		**2.01%**
a	**Shpenzime korrente**	**0**		
a,1	Mallra dhe shërbime			
a,2	Paga dhe sigurime			
a.3	Të tjera			
b	**Shenzime kapitale**	**535,060**		
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private	535,060		
c	**Vendime gjyqësore**	**73,469,228**		
c,1	Marrëdhënie pune	6,204,042		
c,2	Mallra dhe shërbime	64,128,642		
c,3	Investime			
c,4	Të tjera (vendim gjyqës pronë)	3,136,544		
III	**Totali (I+II)**	**74,004,288**	**3,683,818,963**	**2.01%**

Shënim: Në tabelen e mësipërme nuk janë detyrimet me burim financimi nga FSHZH ose Ministri linje, tëcilat janë në vlerën 36,370,104 lekë.Këto detyrime nuk përfshihen në raportin e vetëvlerësimit të vështirësive financiare.

Analiza e vlerës së detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2022 dhe raportuar në MFE paraqitet më poshtë:

a. Shpenzime kapitale në vlerën 535,060 lekë.

- Janë fatura të palikujduara për mungesë dokumentacioni të mbartura nga ish komunatme vlerë535,060 lekë.

b. Vendime gjyqsore nëvlerën 73,469,228 lekë. Kjo vlerë përfaqëson vendimet gjyqsore për mospagim faturash të Ujësjellesit nga ish-Komuna Rrushbull në vlerën 64,128,642 lekë me kreditor UKD Durrës, për largim nga puna në vlerën 6,204,042 lekë dhe të tjera (1 shpronësim në vlerën 3,136,544 lekë.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2022 rezultoi se, nuk është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura në mospërputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.09, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit" pika 106, në të cilën përcaktohet se*: "Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim".*

Nga analiza e detyrimeve të pa likujduara konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2021 Bashkia Durrës ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën prej 156,887,958lekë, e cila në fund të vitit 2022 është ulur në masën 110,374,392lekë, ku peshën më të madhe e zënë detyrimet, që rrjedhin nga vendimet gjyqësore nëvlerën 73,469,228lekë.Sipas raportimit në

MFE nuk ka detyrime të krijuara gjatë vitit 2022, ndërsa sipas bilancit gjendja e llog. 467 " Kreditorë të ndryshëm" në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën **174,127,688 lekë** me një diferencë prej 63,753,296 lekë, e cila përfaqëson shumën e 3 faturave për investime të të mbërritura në dhjetor të vitit 2022, të cilat nuk janë konsideruar detyrime të prapambetura, sipas Udhëzimit plotësues nr.1 datë 10.01.2022 " Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022" kreu III pika 126 në të cilin përcaktohet se: *"Stok i detyrimeve të prapambetura konsiderohen të gjitha llojet e detyrimeve financiare të konstatuara dhe të paguara ndaj të tretëve ,të cilat rezultojnë të pa paguara prej mbi 60 ditë kalanderike që nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik ,si dhe ato pas afatit të përcaktuar në legjislacionin përkatës"*.
Për uljen e stokut të borxhit, pra të vlerës së detyrimeve të palikujduara nga MFE në bazë të te aktit normativ nr.17 dt.01.12.2022 është alokuar shtesë fondi në vlerën 41,789 mijë lekë me burim financimi transfertën e pakushtëzuar sektoriale, ku me VKB nr.98, datë21.10.2022 janë miratuar detyrimet që do të shlyhen me këto fonde.

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (*të akumuluara*) në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën74,004,288dhe i analizuam më sipër. Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 2,01 % kundrejt fondeve të miratuara.Kjo situatë tregon se, BashkiaDurrësnuk mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2022, por konsiderohet në një situatë normle financiare pasi raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është nën nivelin prej 25 %, sipas nenit 56 "Vështirësia financiare" të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për invetimeme burim financimi nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta të Bashkisë Durrës duke përfshirë edhe fondet e trashëguara të investimeve nga viti i kaluar.
- Për **vitin 2022** plani i investimeve në vlerën 859,795 mijë lekë, kurse realizimi është në vlerën 536,380 mijë lekë, ose 62.2%

Realizimi në masën 62.2% i investimeve ka ardhur si rezultat i disa shkaqeve si: nuk është prerë fatura nga ana e operatorit fitues, një pjesë e prokurimeve nuk kanë përfunduar brenda vitit dhe një pjesë kontratatve janë lidhur në muajt e fundit të vitit, gjë që ka sjellë që zbatimi i tyre të mos përfundojë brenda vitit. Për vitin 2022 planifikimi, realizimi i procedurave, zbatimi i kontratave dhe financimi i projekteve të investimeve me burim financimin nga të ardhurat e veta, transferta e pakushtëzuar dhe fondet specifike paraqiten në Aneks.

Referuar të dhënave dhe analizës sëinvestimeve për vitin 2022 duke u nisur nga planifikimi, realizimi i procedurave, zbatimi i kontratve dhe financimi i projekteve të investimeve me burim financimin nga të ardhurat e veta, transferta e pakushtëzuar fondet e specifike rezulton se, janë programuar dhe buxhetuar126 projekte investimi në vlerën 1,427,699,501 lekë për të cilat janë celur fonde në vlerën 859,794,522 lekë, ku në fakt fondet janë realizuar në vlerën 536,379,793 lekë, ndërsa vlera e mbetur pa financuar e 15 kontratave në proces perfundimiështë72,972,412 lekë dhe vlera prej 181,458,550 lekë e kredisë CEB (ndërtim banesa sociale principal + interes). Nga këto :
- 29 projekte investimi dhe shpronësimi në vazhdim të trashëguara nga periudhat paraardhëse, janë buxhetuar për vitin 2022 në vlerën 279,000,146 lekë, është celur fondi për 27 projekte në vlerën 273,627,243 lekë dhe janë financuar 19 projekte në vlerën 202,952,152 lekë, ku 10 projekte nuk janë financuar edhe pse janë celur fondet për në 9 raste për mosparaqitje të situcioneve të punimeve dhe në 1 rast shpronësimi për mungesë të listës së plotë të të shpronësuarve. Ndërsa në 2 rasteështë buxhetuar fondi në vlerën 5,372,903 lekë, por nuk është celur për arsyese në 1 rast nuk është kryer procedura e shpronësimit dhe në rastin tjetër është

detyrim i mbartur kontraktor për investim të kryer nga Ish-Komunat, për të cilat nuk është paraqitur situacion.
- Për 41 projekte investimi janë lidhur kontratat në vitin 2022, janë buxhetuar në vlerën 623,853,781 lekë,janë celur fondet në vlerën 534,355,857 lekë dhe janë financuar në vlerën 323,414,158 lekë, ku 13 projekte nuk janë financuar në vlerën 155,287,606 lekë edhe pse janë celur fondet për to, pasi është vonuar përfundimi i punimeve apo afatet e përfundimit të punimeve shtrihet përtej vitit ushtrimor pasi kontratat janë lidhur me vonesë në muajt e fundit të vitit buxhetor.
- Në buxhetin e vitit 2022 janë programuar 56 projekte investimi në vlerën 500,895,064lekë dhe çelur fonde për to në vlerën 37,000,000 lekë, ku për 14 projekte investimi kanë përfunduar më vonesë procedurat e prokurimit, duke u lidhur kontratat në vitin 2023 dhe në 3 raste janë anulluar procedurat e prokurimit, ndërsa për 32 projekte investimi të buxhetuar në vlerën 307,070,064 lekë nuk janë kryer procedurat e prokurimit, duke mos i realizuar ato gjatë vitit 2022 pavarësisht se ato janë programuar, gjë që ka sjellë planifikim të investimeve përtej mundësive.
Si rezultat i moskryerjes së objekteve të investimit nuk janë realizuar dhe fondet e akorduara për mbikqyrje kolaudime në vlerën 11,573 mijë lekë.
- 2 projekte në vazhdim janë me financim nga Ministritë e linjës si:
a. Mbikqyrje e objektit: Rehabilitim i Digës së Ujembledhesit Arapaj financuar nga Ministria e Bujqësisë celur fondi për 2022 në vlerën 375,860 lekë dhe realizuar në vlerën 317,676 lekë
b.TVSH per pajisjet e shkolles MB+kopshti Ismet Nanushi, projekti EU4-SCHOOLS financuar nga Ministria e Arsimit celur fondi për 2022 në vlerën 4,174,509 lekë dhe realizuar në vlerën 4,174,509 lekë.
Për vitin 2022 planifikimi, realizimi i procedurave, zbatimi i kontratave dhe financimi i projekteve të investimeve me burim financimi nga Fondi i Rindërtimit paraqiten në Aneks:
Referuar të dhënave dhe analizës sëinvestimeve për vitin 2022 duke u nisur nga planifikimi, realizimi i procedurave, zbatimi i kontratave dhe financimi i projekteve të investimeve me burim financimin nga fondet e rindërtimit për financimin e pasojave tëtërmetit rezulton se, janë programuar dhe buxhetuar 12 projekte investimi në vlerën 3,843,976,684 lekë, fonde të realizuara në fakt në vlerën 3,023,251,728 lekë ose në masën 50% dhe mbetur pa u financuar vlera e kontratave prej 4,831,737,014 lekë, ku shkak i këtij realizimi në masë të ulët është mos akordimi i fondeve nga buxheti i shtetit për mbylljen e këtyre investimeve.
Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e projekteve të investimeve Bashkia Durrës me financim nga fondet e veta dhe projekteve tëfinancuara nga fondet e Rindërtimit nga tërmeti, rezultoi se janë ndjekur hapat:
Për çdo procedure prokurimi, urdhri i prokurimit është regjistruar në kohë nësistemin AFMIS nga ana e Bashkisë dhe ka miratimin elektronik nga Dega e Thesarit Durrës. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në AFMIS nga ana e Bashkisë Durrës dhe të shtrira në kohë sipas vitit të financimit. Kontrata është regjistruar e plotëme qëllim pagesën e sajnë afate mujore apo vjetore, pra nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor.Duke qenë se Bashkia Durrës ka operuar në systemin AFMIS , urdhër prokurimet dhe kontratat nuk dërgohen fizikisht në Thesar, por ngarkohen nga ana e Bashkisë elektronikisht në systemin AFMIS me të cilin operon dhe Thesari.

Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Realizimi i buxhetit për vitin 2022, sipas burimit të financimit për Bashkinë Durrës (pa ndërmarrjet dhe institucionet e varësisë) paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Emërtimi	Viti 2022 (000/lekë)		
		plan	fakt	realizimi ne %
1.	**Paga 600**	**410,188**	**376,223**	**92**
	nga te ardhurat	35,273	25,059	71
	nga transferta pakushtezuar+sektoriale	346,596	323,770	93
	nga ministrite e linjes	28,319	27,394	97

Nr.	Emërtimi	Viti 2022 (000/lekë)		
		plan	fakt	realizimi ne %
2.	**Sigurime shoqërore 601**	**65,863**	**61,205**	**93**
	nga te ardhurat	4,598	4,190	91
	nga transferta pakushtezuar+sektoriale	58,115	54,153	93
	nga ministrite e linjes	3,150	2,862	91
3.	**Shpenz.operative 602**	**673,550**	**629,004**	**93**
	nga te ardhurat	206,881	181,501	88
	nga transferta pakushtezuar+sektoriale	367,673	352,466	96
	nga ministrite e linjes	1,683	1,248	74
	nga rindertimi (grupi 00)	97,312	93,790	96
4.	**Transfer 604 (kuota Qarkut, fondi kushtezu emergjen civil)**	**116,964**	**95,142**	**81**
	nga te ardhurat	40,060	40,060	100
	nga transferta pakushtezuar+sektoriale	-	-	0
	nga ministrite e linjes	9,668	9,668	100
	nga rindertimi (grupi 00)	67,236	45,415	68
5.	**Transferme 606 (bonus strehimi, ndihma financiare)**	**2,719,892**	**2,560,341**	**94**
	nga te ardhurat	20,458	19,786	97
	nga transferta pakushtezuar+sektoriale	19,333	19,109	99
	nga ministrite e linjes	1,153,400	1,139,993	99
	nga ministrite e linjes (bonusi qerase se termetit)	964,582	876,690	91
	nga rindertimi	562,119	504,763	90
6.	**Investime 230-231**	**4,662,313**	**3,513,251**	**75**
	nga te ardhurat	800,348	523,923	65
	nga transferta pakushtezuar+sektoriale	54,896	7,964	15
	nga ministrite e linjes	4,550	4,492	99
	nga rindertimi (grupi 00)	3,802,519	2,976,871	78
7.	**TOTALI**	**8,648,770**	**7,235,166**	**84**
	nga te ardhurat	1,107,618	794,518	72
	nga transferta pakushtezuar+sektoriale	846,613	757,462	89
	nga ministrite e linjes	2,165,353	2,062,348	95
	nga rindertimi	4,529,186	3,620,838	80

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se nga të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt:
- Shpenzimet në artikullin 600 "paga e shpërblime" për vitin 2022 në masën 0,35%
- Shpenzimet në artikullin 601 "kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore" për vitin 2022 në masën 0.06%.
- Shpenzimet në artikullin 602 "shpenzime operative për mallra e shërbime" për vitin 2022 në masën 2.51%.
- Shpenzimet në artikullin 604 dhe 606" transferime dhe transferta tek individët" për vitin 2022 në masën 0.82%.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 " investime" për vitin 2022 në masën 7.24 %.

Duke u nisur nga burimi i financimit **për vitin 2022** shpenzimet faktike buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 794,518 mijë lekë ose në masën 10.98 %, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 757,462 mijë lekë ose në masën 10.47%, nga transferta e kushtëzuar në shumën 2,062,348 mijë lekë ose në masën 28.5% dhe nga fondi i rindërtimit (grupi 00) në shumën 3,620,838 mijë lekë ose në masën 50.04%

Konkluzion: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2020 *u konstatua se*:

a. Realizimi i buxhetit për *vitin 2022* është 7,235,165 mijë lekë nga 8,648,771mijë lekë të planifikuara, ose në masën 84%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 230-231 "Shpenzime për investime" në masën 62%, që ka ardhur nga mos realizimi dhe finalizimi me kontratë i 56 projekteve të planifikuara, për të cilatnuk janë kryer procedurat e prokurimit, ndërsa për 41 projekte të planifikuara, për të cilatjanë celur edhe fondet janë financuar pjesërisht ose nuk janë financuar për arsye të mos mbylljes së punimeve Brenda vitit buxhetor nga lidhja e kontratave me vonesë.Gjithashtu 12 projekte investimi të Rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019 të planifikuara janë financuar nga fondet e rindërtimit në masën 50%, për shkak të mosakordimit të fondeve nga buxheti i shtetit për mbylljen e këtyre investimeve.

b. Nuk është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura të rezultuara në fund të vitit 2021 në vlerën 156,887,958 lekë. Detyrimet e papaguara në fund

të vitit 2022 paraqiten në shumën 110,374,392 lekë. Detyrimet e papaguara rakordojnë me gjendjet e llog. të klasë 4 të bilancit të vitit 2022, por nuk rakordojnë për shumën 36,370,104 lekë me raportimin në MFE të vitit 2022 në vlerën 74,004,288 lekë, diferencë që i përket e detyrimeve të prapambetura për investime të pa financuara nga Ministritë e linjës dhe FZHSH, të cilat nuk janë përfshirë në raportim. Ndërsa gjatë vitit 2022 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura.

c. Gjihashtu konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 89% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike) dhe 11% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat, që siguron njësia vendore nga burimet të tjera. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 43 paragrafi 4,47,48,52: ligji nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 40/h,42; Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Kreu "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar neni 12 pika 3, me Udhëzimin e MFE nr.09, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit" pika 106.

Titulli gjetjes*:* Mbi programimin, realizimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi.

Situata: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2022 *u konstatua se*:

a. Realizimi i buxhetit për *vitin 2022* është **7,235,165** mijë lekë nga **8,648,771** mijë lekë të planifikuara, ose në masën 84%.Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 230-231 "Shpenzime për investime" në masën 62%, që ka ardhur nga mos realizimi dhe finalizimi me kontratë i 56 projekteve të planifikuara, për të cilatnuk janë kryer procedurat e prokurimit, ndërsa për 41 projekte të planifikuara, për të cilatjanë celur edhe fondet janë financuar pjesërisht ose nuk janë financuar për arsye të mos mbylljes së punimeve Brenda vitit buxhetor nga lidhja e kontratave me vonesë. Gjithashtu 12 projekte investimi të Rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019 të planifikuara janë financuar nga fondet e rindërtimit në masën 50%, për shkak të mosakordimit të fondeve nga buxheti i shtetit për mbylljen e këtyre investimeve.

b. Nuk është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura të rezultuara në fund të vitit 2021 në vlerën 156,887,958 lekë. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 110,374,392 lekë. Detyrimet e papaguara rakordojnë me gjendjet e llog. të klasë 4 të bilancit të vitit 2022, por nuk rakordojnë për shumën 36,370,104 lekëme raportimin në MFE të vitit 2022 në vlerën 74,004,288 lekë, diferencë që i përket e detyrimeve të prapambetura për investime të pa financuara nga Ministritë e linjës dhe FZHSH, të cilat nuk janë përfshirë në raportim. Ndërsa gjatë vitit 2022 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura.

c. Gjithashtu konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 89% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike) dhe 11% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat, që siguron njësia vendore nga burimet të tjera.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 43 paragrafi 4,47,48,52: ligji nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 40/h,42; Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Kreu "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe

kontrollin", i ndryshuar neni 12 pika 3 me Udhëzimin e MFE nr.09, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit" pika 106.
Ndikimi: Realizim jo të kënaqshëm të shpenzimeve në disa zëra buxheti, realizim jo shumë të mirë të të ardhurave si dhe raportim jo i plotë e detyrimeve të papaguara.
Shkaku: Mos programimi i buxhetit mbi bazë prioritetesh dhe nevojash dhe mos likuidimi detyrimeve sjell rritjen e borxhit që ka Bashkia ndaj të tretëve.

Rëndësia: I mesëm

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: V.Q me detyrë Drejtoree Drejtorisë së Buxhetit.

***6.* Burimi i krijimit të të ardhurave, planifikimi dhe realizimi i tyre. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.**

Nga verifikimi i të dhënave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Durrës, konstatohet se:
Bashkia Durrës ka një numër popullsie prej **312,305 banorë**. Nën administrimin e saj janë 3 qytete (Durrës, Sukth dhe Mamëz), 6 njësi administrative **(**Durrës, Sukth, Ishëm, Katundi i Ri, Rrashbull, Mamëz) dhe 39 fshatra.

1.Burimi i krijimit të të ardhurave:
Për vitin 2022 burimet e financimit të Bashkisë Durrës, ndahen në 4 kategori (*Të ardhurat nga burimet e veta, Transferta nga Buxheti Qëndror, Huamarrja, Trashëgimi nga viti i shkuar*):

A. Të ardhura nga burimet e veta (zënë 38 % të të ardhurave të përgjithshme);
Sipas informacionit në evidencat për raportim të Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore (në vijim DTTV),
-Planifikimi për vitin 2022 është **2,027,023,000 lekë;**
-Realizimi faktik për vitin 2022 është **1,515,885,000 lekë;**
-Realizimi faktik për vitin 2021 është **1,575,084,000 lekë;**
-Realizimi faktik i vitit 2022 krahasuar me vitin 2021 në përqindje është **-4 %**, në vlerë absolute është **59,199,000** lekë më pak;
-Planifikimi për vitin 2022 është **128%** e realizimi faktik për vitin 2021, në vlerë absolute **451,939,000 lekë** më i lartë.

B. Transferta nga buxheti qëndror (zënë 40 % të të ardhurave të përgjithshme)
C. Huamarrja
Bashkia Durrës kryen pagesa për kredinë e marrë nga Njësia e Zbatimit të Projektit "PIU", tek Banka Qendrore Europiane (CEB) me ndërmjetësimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rolin e institucionit garant. Kjo hua është marrë për një afat 30 vjeçar (aktualisht viti i 5). Bazuar në kushtet e kësaj marrveshjeje bashkia ka marrë përsipër pagesën e këstit të kredisë me specifikimin se "*në rast të mosrespektimit të pagesave ministria e financës do ta mbajë këtë detyrim nga transfertat e buxhetit qendror"*. Kjo hua është transferuar në Bashkinë Durrës nga Njësia e Zbatimit të Projektit "PIU".

1. Titulli i gjetjes: Kontabilizim jo i saktë i llogarisë për kredinë e transferuar në Bashkinë Durrës nga Njësia e Zbatimit të Projektit "PIU".
Situata: Në pasqyrat financiare të vitit 2022 nuk ka informacion sa i përket transferimit të kredisë së marrë nga Banka Qendrore Europiane (CEB) me ndërmjetësimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rolin e institucionit garant të këtij detyrimi. Në kontabilitetin e

bashkisë ky transferim nuk është pasqyruar si huamarrje dhe nuk ka të dhëna kontabël ku të tregohet historiku i transferimit të gjendjeve të llograive të kësaj veprimtarie.
Bazuar në legjislacionin për kontabilitetin paraqitja e huasë në bilanc duhet:
Në kredi te Pasivet Afat Gjata/klasa 4 llogari të pagueshme, hua afat gjatë;
Në debi tek të tjera aktive afatshkurtra, llog 481, shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime;
Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; nenet 10-11, të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 3 pikat 4, 6,..., nenet 57-60, nenet 62, 63, 64, 67; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.02.2022, Aneksi 1, "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", si dhe në Udhëzimin e MFE nr. 34, datë 14.12.2022, "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022".
Ndikimi/Efekti: Moskryerja e saktë e kontabilizimit, nuk siguron informacion të saktë për pozicionin financiar.
Shkaku: Nuk janë zbatuar kërkesat ligjore për kontabilizimin e llogarive vjetore.
Rëndësia: E mesme.

Për veprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Drejtorisë Ekonomike në Bashkinë Durrës **z. E.L** dhe Përgjegjësi i Sektorit të Financës pranë kësaj Drejtorie **znj. H.H .**

D. Trashëgimi nga viti i shkuar (zënë 22 % të të ardhurave të përgjithshme)
Për vitin 2022 Bashkia Durrës një pjesë të nevojave për financim e ka mbuluar nga të ardhurat e trashëguara. Nga auditimi u konstatua se:

2. Titulli i gjetjes: Nuk ka një listë analitike për evidentimin e të ardhurave të trashëguara.
Situata: Në kontabilitetin e bashkisë nuk ka një listë analitike për evidentimin e këtij lloji të ardhurash (të ardhurat e trashëguara) por është vetëm vlera totale në kontabilitet. Kjo e bën të pamundur verifikimin e burimit nga është krijuar kjo e ardhur (e ardhura e trashëguar) e si pasojë nuk jep mundësinë për të kontrolluar mënyrën e përdorimit të tyre.
Për vitin 2022, nuk ka evidenca të sakta për llojin e të ardhurave (të trashëguara) të cilat do të shërbejnë si bazë për destinimin e tyre në shpenzime (procesin e buxhetimit).
Kriteri: Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 neni 35, neni 41; Ligji nr. 68/2017, datë 18.05.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 3 pikat 2, 3, 10, 11, neni 5 gërma "e", neni 12 pika 4, neni 13 pikat 1, 8, nenet 14-20, nenet 33-36; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" ,..., neni 11, neni 63 pika ç,...,; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 22/5, pika 3; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti: Evidenca të pasakta për të ardhurat sipas burimit të krijimit, të cilat janë baza për destinimin e shpenzimeve.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.
Rëndësia: E mesme.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Drejtori i Drejtorisë Ekonomike në Bashkinë Durrës **z. E.L ,** Përgjegjësi i Sektorit të Financës pranë kësaj Drejtorie **znj. H.H** ,

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit në Bashkinë Durrës **znj. V.Q ,** Përgjegjëse e Sektorit të Regjistrimit të të Ardhurave **znj. A.K .**

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Organizimi i veprimtarisë së DTTV bëhet duke u mbështetur në sistemin që manaxhon bazën e të dhënave në Bashkinë Durrës. Sistemi e manaxhimit të të dhënave Oracle Bussines Suite 11 (në vijim "Sistemi").

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të këtij ligji përcaktojnë kuadrin rregullator që shërben për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet e njësisë publike janë të përshtatshme dhe efektive për të ofruar shërbime publike dhe për të adresuar risqet me efikasitet dhe efektshmëri.

Objektivat e auditimit janë të sigurohet se njësia publike:

- Pajtohet me legjislacionin, aktet e brendshme dhe kontratat,
- Siguron informacione operative dhe financiare të besueshme dhe të plota,
- Mbron informacionin dhe aktivet e saj.

Nga informacioni i marrë në intervistat me punonjësit e DTTV, pyetësorët e drejtuar institucionit dhe evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se:

3. Titulli i gjetjes: Ndërthurja e veprimtarisë së DTTV Durrës me sistemin e manaxhimit të të dhënave nuk kryhet bazuar në komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. DTTV nuk ka një rregullore të brendshme për funksionimin e sistemit apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem.

Situata: Ndërthurrja e veprimtarisë së DTTV Durrës me sistemin e menaxhimit të të dhënave nuk kryhet bazuar në komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

"Përdoruesit" organizohen dhe funksionojnë vetëm sipas kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara në pozicionin e miratuar në strukturën organizative dhe si kuadër rregullator përdorin detyrat dhe kompetencat e miratuara në rregulloren e brendshme të institucionit. DTTV nuk ka një rregullore të brendshme për funksionimin e sistemit apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem. Më poshtë për efekt kohe dhe përqëndrimi të auditimit në DTTV parqiten vetëm përdoruesit që i përkasin DTTV dhe Drejtorisë së Buxhetit për pjesën takuese:

A. Ndërthurja e veprimtarisë së DTTV Durrës me sistemin e manaxhimit të të dhënave nuk kryhet bazuar në komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Drejtoritë nuk angazhohen në procesin e monitorimit të sistemit, nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të bazës së të dhënave, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga sistemi në evidencat format excel dhe më pas shkresore për raportime midis drejtorive apo drejt titullarit .

B. Nuk ka informacion për administrimin e përdoruesve, bashkëveprimin me burimet njerëzore për procedurat e gjenerimit në sistem të përdoruesve të rinj, përdoruesve që ndërrojnë pozicion pune apo që largohen nga detyra. Nuk ka informacion për procedurën që ndiqet për **përdorues të cilët janë larguar nga detyra apo kanë ndryshuar pozicion në strukturë (A janë aktive në sistem apo jo?).**

C. Nuk ka informacion mbi veprimtarinë e kryer në sistem nga jashtë rrjetit të brendshëm të institucionit. Nga intervistat me stafin e Bashkisë Durrës konstatohet se persona jashtë strukturës organizative të kësaj Bashkie, pa një urdhër apo kontratë kanë akses në këtë sistem pa një protokollim të veprimtartisë dhe proçesojnë procese të rëndësishme si gjenerim i detyrimeve në sistem apo delegim dhe ndryshim kompetencash për përdoruesit etj. Rezultojnë veprime në sistem jashtë orarit zyrtar. Nuk ka informacion të saktë për identifikimin e 3 përdoruesve "1130", "1210" dhe "-

1". Në përgjigjen të kërkesës paraqitur Bashkisë Durrës nga grupi auditimit nuk përmendet kush realizon proceset të cilat nuk janë në kompetencën e njohurive të stafit përdorues, ndërkohë që nuk ka asnjë kontratë me operatorë të jashtëm në periudhën objekt auditimi për procesin e optimizimit të bazës së të dhënave apo të procesve të përmenduara më sipër. Informacioni në përgjigje të kësaj kërkese për përdoruesit dhe pika të tjera të saj, paraqitur nga Bashkia Durrës nuk është i plotë.

D. Informacionit i Sistemit të manaxhimit të të dhënave nuk përputhet me evidencat zyrtare mbi të cilat DTTV planifikon dhe raporton.

E. Struktura e kategorizimit të sistemit për bizneset dhe popullatën është e ndryshme nga paketa fiskale e miratuar.

F. Numri i subjekteve të evidentuara në sistem sipas statusit (Aktiv, Mbyllur, Pasiv, Pezulluar) është i ndryshëm nga evidencat e DTTV .

G. Raportet që prodhon ky system dhe që përpunohen më pas në formatin excel nga sektorët për të ndërtuar evidenca nuk protokollohen.

H. Nuk ka monitorim dhe dokumentim të rakordimeve midis raporteve të gjeneruara nga sistemi me formatet e përpunuara në excel nga operatoret.

I. Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk rakordojnë me DTTV lidhur me:

-Realizimet e të ardhurave që kanë përgjëgjësi të manaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB-në nr. 160, datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit".

- Kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Durrës për informacion sa i përket gjendjes debitore (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve. "A janë të rregjistruar këto subjekte në sistemin e DTTV" dhe "A kanë detyrime të pashlyera?".

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5...., neni 11,...; Udhëzimi e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, **neni 9, neni 35, neni 41.;** ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika ç; ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë i ndryshuar", VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores "*Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*", i ndryshuar, Manuali për MFK i miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 108 datë 17.11.2016, kapitulli III. Rregulorja e Brendshme e Bashkisë Durrës.

Ndikimi/Efekti: Cënim i sigurisë, hyrje të paautorizuara dhe risk humbje të të dhënave, mos pasqyrim i saktë i situatës së njësisë.

Shkaku: Mungesa e kuadrit rregullator për funksionimin e sistemit apo përshkrimt të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem.

Rëndësia: E lartë.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi për pjesët takuese sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme të institucionit personat si më poshtë: Kryetari i Bashkisë **znj. E.S ,** zv. Kryetarët e Bashkisë **z. G.K , z. E.J , z.R.M ,** Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore **z. L.D ,** Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit, **znj. V.Q ,** Drejtori i Drejtorisë Ekonomike **z. E.L ,** Drejtor i Auditit të Brendshëm **znj. M.P,** Përgjegjëse e Sektorit të Rregjistrimit të të Ardhurave **znj. A.K ,** Përgjegjësi i Sektorit të Manaxhimit të Borxhit dhe Apelimit **z. L.B ,** Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave **znj. N.S .**

Për sa është trajtuar në Projektraportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 946/1prot, datë 19.02.2024 administruar nga KLSh me nr. 765/19 prot, datë 21.02.2024, nga Kryetari Bashkisë E.S , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimet e Subjektit:

Janë paraqitur të njëjtat pretendime si observimet e bëra për aktkonstatimin, në lidhje me Drejtoritë të cilat janë struktura organizative të Bashkisë Durrës dhe përgjigjen për përmbushjen e detyrave të një ose disa fushave të caktuara, sipas funksioneve të përcaktuara me ligj ose akte nënligjore për Bashkinë Durrës.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Komentet dhe pretendimet e paraqitura janë të njëjta me observacionet e paraqitura për aktkonstatimet për të cilat janë dhënë shpjegimet përkatëse gjatë hartimit dhe dërgimit të Raportit Përfundimtar të auditimit, pra nuk paraqiten prova, fakte apo referenca ligjore të reja për kundërshtimin e konkluzioneve të grupit të auditimit në lidhje sistemin e manaxhimit të të dhënave. Për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në Bashkinë Durrës struktura e taksave dhe tarifave vendore për periudhën e auditimit është e organizuar në nivel drejtorie. Sistemi ka të njëjtën strukturë organizative me drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore. Komponentët klientë në vijim "Përdoruesit" janë pjesë (softëare) e sistemit që përdor Bashkia për manaxhimin e të ardhurave. Përdoruesit janë instaluar në kompjuterat personal në vijim "PC" që janë në përdorim të punonjësve të drejtorive dhe njësive të varësisë. Sistemi nëpërmjet raporteve që gjeneron i mundëson drejtimit, (*sipas pozicioneve të Strukturës Organizative të miratuar dhe funksioneve të drejtorisë*) organizimin dhe monitrimin e punës për popullimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të sistemit. Informacioni që grumbullohet dhe përpunohet nga përdoruesit sipas kategorive biznes dhe familjarë, ka të bëjë me rregjistrimin e subjekteve të reja, modifikimin e përllogarijten e detyrimeve për taksat e tarifa vendore të subjekteve egzistuese, si dhe regjistrimin e të ardhura nga vjelja e tyre

Struktura Organizative është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 69, datë 05.08.2022, "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Durrës dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2022", me ndryshime. Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore në vijim (DTTV) është pjesë e strukturës organizative të miratuar dhe ka në varësi të saj katër sektorë. DTTV organizohet në nivel drejtorie struktura e saj sipas sektorëve paraqiten më poshtë:

Drejtor Drejtorie dhe Jurist

- Sektori i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore
    - Përgjegjës sektori dhe Specialist
- Sektori i kontrollit të taksave dhe tarifave
    - Përgjegjës sektori dhe inspektor
- Sektori i manaxhimit të borxhit dhe apelimit
    - Përgjegjës sektori dhe specialist
- Administrata e tregut Agro-Bujqësor me pakicë
    - Përgjegjës sektori dhe specialist

Veprimtaria e DTTV mbështetet në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi sikundërse dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për këtë qëllim.

Nga auditimi i dokumentacionit të përmendur më sipër ("*Vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës për miratimin e Paketës Fiskale", "Struktura organizative dhe Rregullorja e Brendshme për funksionimin dhe organizimin e Bashkisë Durrës"*) dhe kontrolli në ndërfaqen zyrtare të Bashkisë Durrës u konstatua se:

4. Titulli i gjetjes: Nuk është krijuar struktura vendore e apelimit tatimor.

Situata: Bashkia Durrës nuk ka krijuar strukturën vendore të apelimit tatimor (komisioni i apelimit tatimor dhe rregullorja për funksionimin e tij) e cila shërben për apelim të akteve vendore që lidhen me taksat dhe tarifat vendore.
Nuk realizohet në kohë njoftimi i subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore pasi përllogaritja dhe azhurnimi i detyrimeve vjetore në system bëhet manualisht. Mungon një adresar i plotë dhe i qartë për kategoritë Familjarë dhe Biznes (*nuk përdoren metoda alteranative "e-mail" për njoftimin e tatimpaguesve*).
Kriteri: Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 23, 27, 28, 30, 32, 36, 38,... neni 64 pika 3; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, në nenin 7, Ligji nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligji nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportele", Ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit".
Ndikimi/Efekti: Shmangie nga kuadri rregullator në fuqi që nuk i jep mundësi taksapaguesit për apelim të akteve vendore që lidhen me taksat dhe tarifat vendore, kufizim i transparencës dhe të drejtës për informim mbi detyrimet tatimore.
Shkaku: Mos e zbatim i akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifat vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.
Rëndësia: E lartë.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: zv. Kryetarët e Bashkisë **z. G.K , z. R.M** dhe Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore **z. L.D .**

Mbi përputhshmërinë e "Sistemit Të Manaxhimit Të Të Dhënave Për Të Ardhurat" në Bashkinë Durrës me kuadrin ligjor në fuqi.

Auditimin i "**Sistemit**" është vlerësuar i rëndësishëm, për shkak të shërbimit që ofron. Ky sistem administron "Regjistrin Elektronik" për tatimpaguesit në kategorinë Biznes dhe Familjar, në nivel lokal.
Si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkëpërdorimi i burimeve të informacionit, siguria e informacionit është bërë gjithnjë më e rëndësishme për institucionet e administratës shtetërore që administrojnë ose kanë në përdorim një sistem manaxhimi të dhënash.
Siguria e informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij.
Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit.

5. Titulli i gjetjes: Baza e të dhënave sa i përket funksionimit, organizimit, ndërveprimit me sisteme të tjera të ngjashme dhe të dhënave të cilat përpunon nuk funksionon bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi.
Situata: Bazuar në informacionin e venë në dispozicion të grupit të auditimit dhe nenin 3, pika "a" të Ligjit nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore" në të cilin citohet, "*Baza e të dhënave shtetërore" kuptohet grumbullimi i organizuar i informacionit, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të institucionit administrues*", rezulton se Bashkia Durrës ka krijuar dhe administron " *Bazë* të dhënash shtetërore". Kjo bazë të

dhënash ndërvepron me sistemin e "Ujësjellës Kanalizimeve Durrës" Sh.a (me aksioner të vetëm Bashkinë Durrës) për administrimin e taksapaguesve familjarë.
Bashkia Durrës krijimin dhe administrimin e bazave të të dhënave nuk e kryen bazuar në kuadrin rregullator në fuqi. Ky institucion nuk ka paraqitur kërkesë për regjistrimin në regjistrin kombëtar të bazave të të dhënave shtetërore pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në vijim (AKSHI), i cili është autoriteti rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore në vijim (ARK).
Struktura e tekonologjisë së informacionit në vijim "TI" nuk organizohet në nivel drejtorie por në nivel sektori brenda drejtorisë së burimeve njerëzore dhe përbëhet nga 3 punonjës (*Përgjegjës sektori, 2 specialist*). Sektori i TI kryen kryesish procesin Help desk në këtë institucion.
Për administrimin e sistemeve që përdor kjo bashki, specifikisht për sistemin e përmendur më sipër, ***nuk ka një person përgjegjës të autorizuar (marrësi në dorëzim i kodit të burimit) për administrimin e bazës së të dhënave. Shërbime të ndryshme në këtë bazë të dhënash kryhen nga personel që nuk është pjesë e strukturës organizative të personelit të Bashkisë Durrës*****.**
Nuk ka Auditues me profil të teknologjisë së informacionit për të zhvilluar burimet njerëzore të auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit. Nuk janë planifikuar, kryer misione auditimi mbi sistemet e TI-së duke mos përmbushur kriteret e **Manualit të Auditit të Brendshëm të miratuara me urdhërin nr.4, datë 10.01.2020 pika 2.4.4.**
Kriteri: Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore" nenin 3, Ligji nr. 2/2017, datë 26.01.2017, "Për sigurinë kibernetike" neni 4; Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore" Kreun II "Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave; Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar" nenet 2, 3,.5, 6....20...27,28..; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar nenet 25, 27, 28, 31; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, "Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore" i ndryshuar; Vendimin nr. 710, datë 21.08.2013, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", (ndryshuar me VKM nr. 755, datë 26.10.2016); Kreun II, pikën k, të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit", (ndryshuar me VKM nr. 36, datë 24.01.2018; nr. 88, datë 14.02.2018; nr. 448, datë 26.7.2018; nr. 872, datë 24.12.2019); pikën 4, "Kërkesat e sigurisë" shkronja b, të "Rregullores për Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike" miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; pikën 4, gërma a, të "Rregullores për menaxhimin e log-eve digitale në administratën publike", miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT); Manualin e Auditit të Brendshëm të miratuara me Urdhërin nr. 4, datë 10.01.2020, pika 2.4.4.
Ndikimi/Efekti: Mos pasqyrim i qartë i objektivave të bashkisë lidhur zhvillimet teknologjike dhe zbehje e ndikimit të strukturave TIK në vendimmarrje. Pasiguri në bazën e të dhënave shtetërore.
Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore dhe nënligjore për bazën e të dhënave .
Rëndësia: E lartë.

Për veprimet e mësipërme është përgjegjës: Kryetari i Bashkisë **znj. E.S .**

Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Komponentëve klientë ("Përdoruesit e sistemit") me kuadrin ligjor në fuqi.

"Përdoruesit" janë pjesë (softëare) e sistemit që përdor Bashkia Durrës për manaxhimin e të ardhurave. Përdoruesit janë instaluar në kompjuterat personal në vijim "PC" që janë në përdorim të punonjësve të Drejtorive dhe njësive të varësisë. Sistemi nëpërmjet raporteve që gjeneron i mundëson drejtimit, (*sipas pozicioneve të Strukturës Organizative të miratuar dhe funksioneve të drejtorisë*) organizimin dhe monitrimin e punës për popullimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të sistemit. Informacioni që grumbullohet dhe përpunohet nga ata për tatimpaguesit në kategoritë biznes dhe familjarë, ka të bëjë me rregjistrimin, modifikimin dhe përllogarijten e detyrimeve për taksat e tarifa vendore, si dhe për arkëtimin e të ardhura nga vjelja e tyre.
Raporti i detyrimeve të subjekteve gjenerohet nga sistemi nëpërmjet kërkesës që drejtuesit e drejtorive ose përgjegjësit e sektorëve aplikojnë në sistemin e manaxhimit të të dhënave.
Nga auditimi i këtij procesi u konstatua se:

6. Titulli i gjetjes: Niveli i cilësisë dhe sigurisë së informacionit të përpunuar.
Situata: Për perudhën në auditim nuk ka një protokollim të momentit kur është gjeneruar ky raport (Raporti i detyrimeve të subjekteve) nga sistemi. Mungon rakordimi analitik dhe i dokumentuar midis sektorëve dhe kontabilitetit. Kontabiliteti përdor për veprimtarinë e tij evidëncën e vënë në dispozicion nga Sektori i Manaxhimit të Borxhit dhe apelimit e cila krijohet nga procesi i përpunimit në formatin excel i informacionit të marrë nga raporti i përfituar prej sistemit (format PDF).
Procesi i përpunimit nga raporti i sistemit (format PDF)në formatin Excel bëhet manualisht duke ulur eficencën, nivelin e cilësisë dhe sigurinë e informacionit të përpunuar. Ky proces nuk ka një monitorim të dokumentuar.
Marrë parasysh ngarkesën e punës së sektorit, sensitivitetin e trajtimit të detyrimeve për subjektet dhe qëllimin e ndërtimit të sistemit të manaxhimit të të dhënave (*grumbullimi i përpunimi ruajtja e informacionit dhe gjenerimi i raporteve të sakta dhe në kohë për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Durrës me cilësi dhe konform standarteve te përcaktuara ne kuadrin rregullator)*. Ky proces nuk është efektiv, efiçent dhe i sigurt.
Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 5, neni 11,..neni 22, neni 23.....; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
Ndikimi/Efektiviteti: Informacioni i përpunuar nuk ka cilësi, siguri dhe saktësi.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit ligjor në fuqi mbi monitorimin proceseve dhe ndarjen e detyrave

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi personat si më poshtë: zv. Kryetarët e Bashkisë **z. G.K , z. R.M ,** Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore **z. L.D ,** Përgjegjësi i Sektorit të Manaxhimit të Borxhit dhe Apelimit **z. L.B .**

Mbi kontrollin e cilësisë së të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve

Informacioni që popullon bazën e të dhënave organizohet sipas kategorive:

1. Biznes
   - Biznes i madh
   - Biznes i Vogel
   - Ambulan
   - Transport
   - Institucione shteterore
   - Pa kategori(Janë subjekte të cilat nuk kanë specifikim të kategorisë që i përkasin)

Taksat dhe tarifat vendore që administron ky sistem për kategorinë biznes paraqiten si më poshtë:
Taksa mbi Ndertesën Biznes, Taksa e Truallit, Taksa e Tabelës,Taksa e Reklames,Taksa e Fjetjes në Hotel,Taksa e Përkohshme e Infrastrukturës Arsimore,Tarifë e Pastrimit Biznes, Tarifë Ndricimi, Tarifë Gjelbërimi, Tarifë Parkimi, Tarifa Plazh Privat.

2. Person

- Familje që kanë në pronësi/përdorim banesa private, toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj
- Pa kategori

Lidhur me sa më sipër veprimtaria e DTTV bazohet në proceset që manaxhojnë :

- Kërkesa për regjistrim të subjekteve të reja
- Ndryshime në të të dhënave rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet egzistuese
- Kërkesat për çregjistrim, pezullim të subjekteve egzistuese

Të dhënat e administruara nga sistemi i DTTV janë në funksion të identifikimit të subjektit tatimpagues dhe përcaktimit të detyrimit për tu paguar lidhur me taksat dhe tarifat vendore Bashkia Durrës nuk ka element kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve, pasi ky kontroll nuk është pjesë vetëm e aktivitetit të këtij institucioni por një ndërthurje midis Degës Rajonale të Tatimeve në vijim (DRT), Qëndrës Kombëtare të Biznesit në vijim (QKB) dhe sektorit të kontrollit në terren pranë DTTV. Sistemi nuk ka ndërveprim me QKB dhe DRT. Komunikimi midis DTTV dhe QKB është vetëm në rrugë shkresore dhë e- mail. Sektori i terrenit është hallka e vetme për të përcaktuar përputhjen midis të dhënave të deklaruara vullnetarisht nga subjekti në QKB, të dhënat faktike në terren dhe të dhënave që administron DTTV në dosjen e subjektit. Nëpermjet akt konstatimeve në terren ky sektor konfirmon saktësinë e të dhënave për të procesuar më tej me regjistrimin e subjekteve në sistemin e DTTV.
Nga auditimi lidhur me të dhënat elektronike të subjekteve, mënyrën e përllogaritjes së detyrimeve dhe përgatitjen e evidencave mbi raportet e perfituara nga sistemi i manaxhimit të të dhënave është konstatuar se:

7. Titulli i gjetjes: Nuk ka element kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve.
Situata: Popullimi i sistemit me kërkesa për rregjistrim të subjekteve të reja, ndryshimet në të dhënat rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet egzistuese **nuk realizohet duke rakorduar informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT.**
-Në kategorinë Biznes dhe Person nuk ka përputhje as në numër subjektesh dhe as në lloj aktiviteti me evidencat statistikore të paraqitura nga DTTV.
Në sistem konstatohen të dhëna të cilat kanë si burim Akt konstatimet nga sektori i terrenit. Këto të dhëna nuk shprehin qartë objektin për të cilin është kërkuar mbajtja e këtij akt konstaimi konkretisht:

- **Akt konstatimet e mbajtura mbi kërkesat për regjistrim të subjekteve të reja.**
- DTTV për çdo aplikim **për regjistrim të subjekteve të reja** i kërkon sektorit të terrenit verifikimin për konfirmimin e të dhënave të deklaruara vullnetarisht në QKB apo në sportele.

Akt konstatimet e mbajtura nuk japin informacion për përputhjen midis llojit të aktivitetit të deklaruar dhe dokumentacionit të administruar në praktikën për aplikim të subjektit, adresën ky ushtrohet ky aktivitet, sipërfaqen që administron, gjëndjen debitore që shfaqin aktivitete të

mëparshme të administruara prej tij në sistemin e DTTV dhe paqartësinë me masat e marrra për rastet debitore.
Rregjistrimi i subjekteve të reja në sistem kryhet bazuar në akt konstatimet nga Sektori i kontrollit të taksave dhe tarifave. Akt konstatimet nuk përcaktojnë përputhjen midis informacionit të deklaruar vullnetarisht nga subjekti në QKB me informacionin faktik në terren. Kjo ndikon në përgatitjen e evidencave të qarta sa i përket **identifikimit të subjektit dhe përcaktimit njoftim detyrimit për tu paguar lidhur me taksat dhe tarifat vendore** (Më shpesh në Akt Konstatime haset termi "rregjistrim nga zyra" ose "përdorim i metodës alternative të vlerësimit" ndërkohë që të dhënat për këto subjekte janë lehtësisht të verifikueshme në terren apo nga drejtoritë që administrojnë informacion për kryqëzimin e këtij informacioni).

- **Akt konstatimet e mbajtura nga sektori mbi kërkesat për ndryshime të dhënash nga subjektet tatim pagues**.

DTTV për çdo aplikim nga subjektet egzistuese lidhur me ndryshimin e të dhënave i kërkon sektorit të kontrollit në terren të kryej verifikimin për konfirmimin e të dhënave të deklaruara vullnetarisht në QKB apo në sportele.
Akt konstatimet e mbajtura nga ky sektor nuk japin informacion për përputhjen midis llojit të të dhënave që kërkohet të ndryshohen dhe të dhënave që administrohen në sistem apo në dosjen e subjektit pranë DTTV. Në sistem janë konstatuar raste ku subjekti ka gjendje debitore në kodin seli apo në kodet që i përkasin adresave dytësore. Në DTTV nuk konstatohen evidenca të ndjekjes së procedurës ligjore për mbledhjen e debisë së tyre, por procesohet me hapjen apo mbylljen e adresave dytësore të tjera. Për të gjitha subjektet të cilat kanë adrsesë dytësore është i pa përcaktuar në fushën adresë dytësore numri serial që lëshohet nga DRT për adresat dytësore sipas ligjit në fuqi.

- **Akt konstatimet e mbajtura mbi kërkesat për ndryshimin e statusit të aktivitetit (çregjistrim, pasiv apo pezullim të subjekteve ekzistuese).**

DTTV për çdo aplikim nga subjektet ekzistuese lidhur **ndryshimin e statusit të aktivitetit (çregjistrim, pasiv apo pezullim)** i kërkon sektorit të kontrollit në terren informacion lidhur me kërkesën e paraqitur nga QKB. (*<u>nëse subjekti i cili ka paraqitur kërkesën për ndryshim statusi ushtron aktivitet ose jo</u>*.)
Ky akt konstatim është shumë i rëndësishëm, ai duhet të realizohet konform kuadrit rregullator ligjor brenda afateve të përcaktuara në ligj sepse: **Në rast të mos respektimit të afateve të përcaktuara në kuadrin ligjor, QKb proceson automatikisht me ndryshimin e satusit. DTTV Durrës për të gjitha rastet kur statusi ka ndryshuar ndërpret faturimin e mëtejshëm të subjektit edhe pse ky çregjistrim ka ardhë si pasojë e mos përgjigjes në kohë ndaj kërkesës për evidentimin e gjendjes debitore nga QKB.**
Në sistem janë konstatuar raste ku subjekti edhe pse ka gjendje debitore, rezulton me statusin çregjistruar, pasiv apo pezulluar.
Në sistem janë konstatuar raste ku subjekti, ka gjendje debitore, rezulton me statusin aktiv në QKB por në sistem pasqyrohet me statusin mbyllur pasiv apo pezulluar. Ky status në sistem ndërpret njoftim detyrimin. Termi i përdorur më shpesh në akt konstatime është "Nuk u gjet në aktivitet" ose "Nuk u Gjet", pa përcaktuar numrin e procesverbaleve të mbajtura për të vërtetuar shpeshtësinë e kontrolleve apo faktin nëse ky subjekt nuk ushtron aktivitet.
Nga evidencat e trajtuar në DTTV nuk u konstatua asnjë dokument i cili tregon rakordimin me degët rajonale të tatimeve lidhur me klasifikimin e biznesit dhe llojin e aktivitetit që kryen.
<u>Kriteri:</u> Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 5, neni 11,...; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 1, **neni 2** gërmat a, ç, **neni 5** gërmat a, d, dh, f, g, gj, h, i, **neni 6** pikat 1, 2, 3, neni 12 **gërmat** a, b, dh..., **neni 13** gërma b, neni 15, **neni 23** pika 1, 4, neni 26, neni 27,neni 28 pika 1, **neni 29**, neni 31, neni 40, neni 41, neni42, **neni 43 pika1, 2, 3, neni 44,**

neni 45, neni 47 , **neni 48** pika 1, **neni 57** pikat 4**, 5**, **nenet 60, 61, 62**, neni 65 pika 5, nenet 68, 69 , **neni 70 pika 2, neni 71/1** pika 5 ; Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, nenet 28-40, **neni 42**, **neni 43** gërma d, **neni 59**; Manuali i Manaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhërin e MFE nr. 108, datë17.11.2016; Udhëzimi nr. 26, datë 16.12. 2014**;** Udhëzimi nr. 655/1 datë 06.02.2007, "Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proceduriale dhe të raportimit të sistemit të takses vendore;. VKB-në nr. 160, datë 23.12.2021, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit"; Rregulloren e brendshme të bashkisë.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e dokumentacionit ose pasaktësia e tij, çojnë në evidencave të pasakta sa i përket **identifikimit të subjektit dhe** përllogaritjes të saktë të detyrimeve për taksa e tarifa vendore.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit ligjor në fuqi. Akt konstatime nuk kryhen brenda afateve të përcaktuara në ligj, nuk janë të plota dhe nuk përcaktojnë përputhjen midis informacionit të deklaruar vullnetarisht nga subjekti me informacionin faktik në terren. Popullimi i sistemit **duke mos rakorduar informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT.**

Rëndësia: E lartë.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi personat si më poshtë: zv. Kryetari i Bashkisë **z. R.M ,** Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore **z. L.D ,** Përgjegjësi i Sektorit të Manaxhimit të Borxhit dhe Apelimit **z. L.B ,** Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit të Taksave dhe Tarifave Vendore, **z. SH.H .**

Planifikimi, vlerësimi i mbledhjes dhe realizimi i të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2022 paketa fiskale për taksat dhe tarifat vendore në Bashkisë Durrës është miratuar me VKB - në nr.160, datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit".

Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke u përgatitur fillimisht në formë relacioni nga DTTV. Në tabelat në vijim paraqitet i detajuar parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2022.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave

		2022		% Ndaj
NR.	**EMERTIMI TE ARDHURAVE**	**PLANI**	**FAKTI**	**Pl.Vj.**
A	**Te Ardhura nga burimet e veta**	**2,027,023,000**	**1,515,884,771**	**74.784**
A1	**Te ardhurat nga Taksat Vendore**	**865,068,000**	**646,621,419**	**74.748**
A1.1	**Tatim i thjeshtuar i fitimit per Biz.e vogel**	**0**	**5,371,607**	
A1.2	**Taksa mbi Pasurine e paluajtshme**	**479,733,000**	**274,049,427**	**57.125**
a	**Taksa mbi ndertesat**	**405,000,000**	**247,051,134**	**61**
1	Taksa e ndertesave nga Biznesi	270,000,000	212,944,605	78.868
2	Taksa e Ndertasave nga Popullata	135,000,000	34,106,529	25.264
b	**Taksa mbi token bujqesore**	**44,733,000**	**5,127,630**	**11.463**
1	Taksa mbi token bujqesore biznesi	11,133,000	283,239	2.5441
2	Taksa mbi token bujqesore popullata	33,600,000	4,844,391	14.418
c	**Taksa mbi truallin**	**30,000,000**	**21,870,663**	**72.902**
1	Taksa e truallit nga Biznesi	25,000,000	21,782,172	87.129
2	Taksa e truallit nga Popullata	5,000,000	88,491	1.7698
A1.3	**Taksa vendore ne sherbime ne hotel**	**30,000,000**	**24,914,475**	**83.048**
A1.4	**Takse Ndik.infra.nga ndertim.Reja+leg**	**280,880,000**	**303,424,136**	**108.03**
a	T. N.I.nga ndertim.Reja (leg.ALUIZNI)	0	48,799	
b	Taksa Ndik.infra.nga ndertim.Reja	280,880,000	303,375,337	108.01
A1,5	**Takse Tabele dhe Reklame**	**30,455,000**	**20,017,314**	**65.728**
a	Taksa e Tabelesper qellime identifikimi	12,000,000	10,226,414	85.22
b	Taksa e Tabeles per qellime reklamimi	18,455,000	9,790,900	53.053
A1,6	Taksa te perkoheshme (Infrast.Arsimore)	44,000,000	**18,844,460**	42.828

		2022		% Ndaj
NR.	**EMERTIMI TE ARDHURAVE**	**PLANI**	**FAKTI**	**Pl.Vj.**
A 2	**Te ardhurat nga taksat e ndara**	**370,525,000**	**300,268,936**	**81.039**
A2.1	Taksa e kalimit te drejtes se pronesisePP	210,000,000	75,353,330	35.883
A2.2	Taksa e mjeteve të perdorura	140,000,000	164,678,600	117.63
A2.3	Renta minerare	50,000	24,836	49.672
A2.4	Tatime mbi te ardhurat personale	20,475,000	60,212,170	294.08
A3	**Te ardhura nga tarifa vendor**	**723,248,000**	**484,006,892**	**66.921**
A3.1	**Tarifa e pastrimit dhe largimit mbetjeve**	**310,000,000**	**184,551,928**	**59.533**
a	Tarifa e past.dhe larg.mbet.nga fam.	130,000,000	40,502,926	31.156
b	Tarifa e past.dhe larg.mbet.nga biz.	180,000,000	144,049,002	80.027
A3.3	**Tarifa e ndricimit**	**71,000,000**	**43,350,053**	**61.056**
a	Tarifa e ndricimit nga familjet	30,000,000	13,876,484	46.255
b	Tarifa e ndricimit nga biznesi	41,000,000	29,473,569	71.887
A3.4	**Tarifa perkoheshme e gjelbrimit**	**52,000,000**	**38,285,559**	**73.626**
a	Tarifa perkoh.gjelbrimit nga familjet	12,000,000	7,462,218	62.185
b	Tarifa perkoh.gjelbrimit nga biznesi	40,000,000	30,823,341	77.058
A3.5	**Tarifa sherbimi nga administrata e Bashkise**	**221,030,000**	**181,324,072**	**82.036**
A3.5.2	Tarifa per dhenien e licensave, lejeve,autorizimeve	23,830,000	19,244,004	80.755
A3.5.3	Tarifa e kontrollit te zhv. Territorit (urbanistikes)	16,000,000	1,471,005	9.1938
A3.5.4	Tarifa per vulosje veterinare te bagetive te therura	400,000	180,550	45.138
A3.5.5	Tarifa e lincensimit te veprimeve te Transportit, autorizime	2,700,000	9,682,255	358.6
A.3.5.6	Tarifa e parkimit per mjete te lincensuara dhe parkime publike	30,000,000	24,666,590	82.222
A3.5.8	Nga tarifat e sherbimeve shtese nga zjarrfikset MKZ	3,100,000	3,823,005	123.32
A3.5.9	**Tarifa e zenies dhe perdorimit te hapesirave publike, fasada**	**145,000,000**	**122,256,663**	**84.315**
A3.5.9.1	Tarifa e zenies se sip. Publike	32,000,000	3,634,449	11.358
a	ZHP veprime te ndryshme ekonomike	2,000,000	2,364,723	118.24
b	ZHP tavolina	30,000,000	1,269,726	4.2324
A3.5.9.2	Tarifa e Plazheve Private	100,000,000	113,201,214	113.2
A3.5.9.3	Tarifa e zenies hapesirave te tregut agrobujqesor	13,000,000	5,421,000	41.7
A3.6	**Tarifa te institucioneve te arsim,kulture, sporte etj**	**38,018,000**	**36,495,280**	**95.995**
A.3.6.1	Te ardhurat nga Instituc. Kultur-Sport	2,269,000	2,468,460	108.79
A3.6.2	Te ardhura nga Konvikte	1,792,000	938,400	52.366
A3.6.3	Pagesat e prinderve per kopeshtet	22,717,000	26,929,600	118.54
A.3.6.4	Pagest e prinderve per çerdhet	11,240,000	6,158,820	54.794
A.3.7	**Tarifa te tjera(funerale)**	**31,200,000**	**0**	
A4	**Te ardhura te tjera(Shitje dhe dhenie me qera asete)**	**68,182,000**	**84,987,524**	**124.65**
A4.1	**Qera mbi asetet ne pronesi te bashkise(ndertese Toke Truall)**	**11,692,000**	**8,784,076**	**75.129**
a	Qera nga ndertesat	10,853,800	7,855,900	72.379
b	qera nga toka bujqesore	698,200	863,776	123.71
a	qera nga trojet	140,000	64,400	46
A4.2	Qera nga banesat sociale	32,000,000	30,741,306	96.067
A4.3	Shitja e mallrave dhe sherbimeve	0	1,026,382	
A4.4	**Kundervajtje administ. Gjobat**	**24,490,000**	**35,598,368**	**145.36**
a	Te tjera gjoba- DTTV	9,490,000	18,179,341	191.56
b	Te tjera gjoba- Mjedis, KLSH.Pol.Bashk.	15,000,000	16,838,357	112.26
d	Kamatvonese	0	580,670	
A4.5	**Grante dhe ndihma nderkombetare/ donacione**	**0**	**5,665,523**	
a	sponsorizime nga OJF	0	5,665,523	
A.4.6	**Te tjera**	**0**	**3,171,869**	

Burimi: Bashkia Durrës

Për arsye të planifikimeve dhe realizimeve mbi bazë vjetore, të dhënat janë paraqitur për të gjithë vitin 2022.

Për këtë vit të ardhurat nga burimet e veta, ku futen: a) të ardhurat nga taksat vendore dhe b) të ardhura jo tatimore (tarifat vendore etj), janë planifikuar në vlerën 2,027,023,000 lekë dhe janë realizuar në vlerën 1,515,884,771 lekë, ose në masën 75%.

Në këtë planifikim të ardhurash, të ardhurat nga taksat duke përfshirë dhe taksat e ndara janë planifikuar në vlerën 1,235,593,000 lekë dhe janë realizuar në vlerën 946,890,355 lekë, ose në masën 78%, ndërsa të ardhurat jo tatimore (peshën kryesore e zënë tarifat vendore), janë planifikuar në vlerën 723,248,000 lekë dhe janë realizuar në vlerën 484,006,892 lekë, ose në masën 67%.

Peshën specifike më të ulët në këtë mosrealizim e zëne: tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga popullata, e cila është planifikuar në vlerën 130,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 40,502,926 lekë, ose në masën 31%, taksa mbi tokën bujqësore biznesi është planifikuar në vlerën 11,133,000 lekë dhe është realizur në vlerën 283,239 leke ose 2.5%,

taksa mbi tokën bujqësore popullata është planifikuar 33,600,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 4,844,391 lekë ose 14.4%, taksa e truallit nga popullata është planifikuar në vlerën 5’000’000 lekë dhe është realizuar në vlerën 88,491 lekë ose 1.8%. Taksa e përkoheshme e infrastrukturës arsimore është planifikuar në vlerën 44,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 18,844,460 lekë ose 43%. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga familjet është planifikuar në vlerën 130,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 13’876’484 lekë ose 31%, tarifa e ndriçimit nga familjet është planifikuar në vlerën 30’000’000 lekë dhe është realizuar në vlerën 13’876’484 lekë ose 46%. Taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet që legalizohen është realizuar në vlerën 48,799 lekë, ndërsa vlera e planifikuar është zero lekë.

Në mënyrë të përmbledhur:

	Viti 2022	Plani	Fakti	% e realizimit
A	**Të Ardhura nga burimet e veta**	**2,027,023,000**	**1,515,884,771**	**75**
A1	Të ardhurat nga Taksat Vendore	865,068,000	646,621,419	75
A2	Të ardhurat nga taksat e ndara	370,525,000	300,268,936	81
A3	Të ardhura nga tarifa vendor	723,248,000	484,006,892	67
A4	Të ardhura të tjera	68,182,000	84,987,524	125

- Gjithashtu taksa mbi ndërtesën nga popullata ka realizim të ulët, nga 135,000,000 lekë e planifikuar, është realizuar 34,106,529 lekë ose në masën 25%.
- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave ka realizim të ulët, është planifikuar në vlerën 310,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 184,551,928 lekë, ose në masën 60%. Në këtë mosrealizim ka ndikuar si tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga popullata, e cila është planifikuar në vlerën 130,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 40,502,926 lekë, ose në masën 31%, edhe tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve nga e cila është planifikuar në vlerën 180,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 144,049,002 lekë, ose në masën 80%. **Planifikimi për tarifën e pastrimit** dhe rritja me 44% e detyrimit për të është bërë në mbështetje të realizimit të programit të manaxhimit të mbetjeve dhe jo si rezultat i një analize mbi realizimin e mëparshëm.

Mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara në këtë zë ka bërë që bashkia të përdorë për pagesat e programit të ardhura që janë planifikuar për programe të tjera.

- Taksa e fjetjes në hotel për vitin 2022 ka një planifikim prej 30,000,000 lekë dhe realizim 24,914,475 lekë ose në masën 83 %.

Në Taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Durrës taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe e planifikimit të territorit zënë një peshë të rëndësishme të të ardhurave të veta rreth 20% të saj. Për vitin 2022 në këtë drejtori janë miratuar, 146 leje zhvillimi dhe disa leje të tjera si ato për rindërtim prej 192 leje, 6 leje infrastrukture etj.

Tarifa e ndriçimit është planifikuar në vlerën 71,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 43,350,053 lekë, ose në masën 61%. Nivel të ulët të realizimit të kësaj takse ka si pjesa e popullatës e cila është planifikuar në vlerën 30,000,000 lekë dhe realizuar në vlerën 13,876,484 lekë, ose në masën 46%, ashtu edhe pjesa e biznesit, e cila është planifikuar në vlerën 41,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 29,473,569 lekë, ose në masën 72%.

Po analizojmë me zgjedhje disa nga taksat e tarifat:

Taksa mbi tokën bujqësore.

8. Titulli i gjetjes: Nuk ka regjistër të taksapaguesve për taksën e tokës bujqësore, për pasojë nuk janë llogaritur detyrimet të cilat duhet të mblidheshin nga UKD Sh.a në rolin e agjentit tatimor

Situata: Në paketën fiskale të Bashkisë Durrës është parashikuar:

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës. Është miratuar edhe niveli i taksës mbi tokën bujqësore, e cila në varësi të kategorisë së tokës varion nga vlerë 5,600

lekë/ha/vit deri në 1,800 lekë/ha/vit. Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe për familjarët shlyhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime sh.a. Durrës, në cilësinë e agjentit tatimor.
Nga auditimi konstatohet se :
Për të gjithë periudhën e audituar taksa mbi tokën bujqësore nuk është administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në kundërshtim me përcaktimet e bërë në paketën fiskale.
Për këtë taksë nuk ka regjistër të taksapaguesve. Për kategorinë familjar edhe pse është parashikuar në paketë fiskale të arkëtohet nga UKD, kjo nuk është realizuar as nga UKD dhe as nga vetë bashkia, pasi vetë struktura e taksave të bashkisë për mungesë të dhënash si të familjarëve edhe të sipërfaqes për secilën familje, nuk ka bërë llogaritje të detyrimeve për këtë taksë dhe si rrjedhim ngarkesa në faturën e ujit nuk është kryer.
Planifikimet janë të pa mbështetura në të dhëna reale. Për vitin 2022 taksa mbi tokën bujqësore është planifikuar në vlerën 44,733,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 5,127,630 lekë, ose në masën 11%. Në tabelën më poshtë paraqitet shpërndarja sipas njësive numri i familjeve që kanë përfituar tokë bujqësore.

Nr.	Bashkia Durrës	Nr. i familjeve të trajtuara me tokë bujqësore	Siperfaqja e tokës bujqësore në ha
1.	Nj. Administrative nr. 1		
2.	Nj. Administrative 2		
3.	Nj. Administrative 3		
4.	Nj. Administrative 4 e 6 (ish NB Spitalle)	1,820	2,129.97
5.	Nj. Administrative 5		
6.	Nj. Administrative Manez	2,230	2,500.3
7.	Nj. Administrative Sukth	3,500	3,980
8.	Nj. Administrative Ishem	1,919	2,274.99
9.	Nj. Administrative Katund i ri	4,410	3,857
10.	Nj. Administrative Rashbull	3,420	6,596.8
	Totali	**17,299**	**21,406.3**

Burimi i të dhënave Bashkia Durrës
Kriteri: Ligjin nr. 9632, datë. 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar ,neni 4 , neni 23; Paketa fiskale e miratuar nga Këshilli Bashkiak Durrës; VK- në nr. 160, datë 23.12.2021, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit", pika A.1.1.2 "Taksa e tokës bujqësore". kontrata nr. 641 prot., datë 03.02.2014.
Ndikimi/Efekti: Mos evidentim i taksapaguesve dhe mos arkëtimi i të ardhurave .
Rëndësia: E lartë

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. L.D , Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Taksa dhe tarifa lokale (familjarët).
Për kategorinë e taksapaguesve familjar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është hartuar regjistër i taksapaguesve familjar, në kundërshtim me pikën nr.7, të nenit nr.4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, ku thuhet: *Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar,*

Në VKB-në nr.160, datë 23.12.2021, "*Mbi sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Qytetin e Durrësit*", është përcaktuar se për kategorinë e taksapaguesve familjar, Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A do të luaj rolin e agjentit tatimor për 6 lloj taksash (ndërsa faktikisht ka mbledhur

5 lloje taksash). Në vijim paraqiten të dhëna për këto taksa si dhe për taksat e tjera për të cilat subjekte jashtë bashkisë luajnë rolin e agjentit tatimor.

Nr.	Lloji i taksës për taksapaguesit familjar	Agjenti tatimor	Akt marrëveshja midis Bashkisë dhe Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A
1	Taksae ndërtesës	UKT Durrës Sh.A	
2	Taksa e truallit		Kontrata nr.641 prot., datë 03.02.2014
3	Tarifa e pastrimit		Aneks kontrate nr. 849 prot. date 12.04.2016
4	Taksa e përkohshme e gjelbërimit		
5	Tarifa e ndriçimit		
	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës	Bazuar në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.
	Taksa e mjeteve të përdorura	Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor	Bazuar në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "për taksat kombëtare" i ndryshuar
	Taksa e së drejtës së pronësisë	Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Durrës	Bazuar në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Struktura që kryen aktet e rakordimit me agjentët tatimor është sektori i të ardhurave (i regjistrimit).

Në vijim vlerat e arkëtuara dhe numri i abonentëve të regjistruar për taksat për të cilat UKT Durrës Sh.A, luan rolin e agjentit tatimor:

Nr.	Lloji i taksës (familjarët)	Vlera e arkëtuar nga Ujësjellës Kanalizime Durrës (UKD)	
		Viti 2021	Viti 2022
1	Taksa e ndërtesës	98,351,722	29,776,115 29,776,115.15
2	Tarifa e pastrimit	67,186,034	39,670,533
3	Taksa e përkoh.e gjelbërimit	6,413,066	7,758,276
4	Tarifa e ndriçimit	15,809,708	13,635,544
5	Taksa e truallit	3,264,679	0
6	**Total**	**191,025,209**	**90,840,468**
	Nr. i familjeve (abonentëve familjar) të rregjistruar në UK Durrës.	40,778	70,783
	Nr. i familjeve sipas regjistrit të Gjendjes Civile.	104,959	120,454
	Diferenca sipas viteve midis numrit të familjeve sipas regjistrit të Gjendjes Civile dhe numrit të familjeve të rregjistruar në UK Durrës.	60,104	49,671

Bazuar në nenin nr. 1 dhe nr. 2 të kontratës nr. 641 prot., datë 03.02.2014, Bashkia Durrës ka detyrimin (neni1): të përcjellë periodikisht rekordet me detyrimet për taksat dhe tarifat e popullatës (TTP) pranë agjentit tatimor; (neni 2): Bashkia dërgon të dhëna të plota me rekordet për taksat dhe tarifat e popullatës (TTP), nëpërmjet sistemit informatik.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në vitin 2021 ka pasur të evidentuar 40,778 abonentë familjar, për vitin 2022 ky numër është 70,783 abonentë (rritur numri me 30,005 krahasuar me vitin 2021).

Bazuar në numrin e familjeve të marra nga gjendja civile, konstatohet një diferencë e konsiderueshme midis këtij numri dhe numrit të rregjistruar pranë agjentit tatimor UK Durrës. Për vitin 2022 diferenca midis numrit të familjeve sipas regjistrit të gjendjes civile me numrin e familjeve të përcjellë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore te agjenti tatimor UK Durrës, është 49,671 familje.

9. Titulli i gjetjes: Mungesa e një regjistri të plotë të taksapaguesve të kategorisë familjare, mosndjekja e zbatimit të kontratës nga agjenti tatimor.

Situata: Për periudhën 2022 nuk është hartuar një plan apo strategji, vjetore apo afatshkurtër (më shumë se një vit), për të evidentuar familjet e pa regjistruara te agjenti tatimor UKD, në mënyrë që të ndiqej arkëtimi i tyre jashtë agjentit tatimor, pra nga vetë administrata e taksave dhe tarifave vendore Durrës. DTTV nuk ka hartuar regjistër të taksapaguesve familjar duke mos evidentuar taksapaguesit familjar të cilët nuk kanë marrëdhënie me UK Durrës. DTTV ka lënë jashtë mbikëqyrjes së saj këtë kontingjent taksapaguesish familjar.
Nuk ka të dhëna për familjarët të cilët nuk kanë marrëdhënie me UKD. Edhe pse është rritur numri i taksapaguesve familjar në vitin 2022, kjo nuk është e plotë, pasi nuk ka evidentime konkrete për pjesën që nuk përfshihet në UK Durrës.
Në paketën fiskale është parashikuar një gjë e tillë, por nuk janë marrë masa konkrete. Në paketë thuhet: "Për ato familje që nuk janë regjistruar në faturat e ujësjellësit fatura do të llogaritet totale dhe do të paguhet në dy këste: kësti i parë deri më datë 20 prill të vitit korrent dhe kësti i dytë më datë 20 korrik të vitit korrent".
Për këta taksapagues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, duhet të ndiqeshin procedurat ligjore për njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me paketën fiskale.
Të ardhurat e arkëtuara nga UKD për vitin 2022 janë:

Nr.	Muaji	Te ardhurat sipas sistemit TTV/ Leke	Te ardhurat sipas Finances (Banka)/leke	Diferenca
1.	JANAR 2022	311,001	14,426,703	14,115,702.27
2.	SHKUR 2022	27,185	14,120,196	14,093,010.92
3.	MARS 2022			-
4.	PRILL 2022		3,021,242	3,021,241.75
5.	MAJ 2022			-
6.	QERSHOR 2022	19,235,764	27,184	- 19,208,579.67
7.	KORRIK 2022	645,291		- 645,291.24
8.	GUSHT 2022	8,341,707	19,235,343	10,893,636.03
9.	SHTATOR 2022	20,490,032	8,986,622	- 11,503,410.41
10.	TETOR 2022	5,416,097	20,489,224	15,073,127.19
11.	NENTOR 2022	5,118,094		- 5,118,094.44
12.	DHJETOR 2022	14,923,871	10,533,953	- 4,389,918.82
	SHUMA	**74,509,044**	**90,840,468**	**16,331,423.58**

Burimi të dhënave Bashkia Durrës .
Për vitin 2022 janë arkëtuar 90,840,468 lekë, ndërsa në sistem të ardhurat familjare janë 74,509,044 lekë. Diferenca midis sistemit të DTTV dhe të ardhurave të arkëtuara nga UKD ka edhe për vitin 2021. Pra nga UKD arkëtimet nuk janë mujore.
Rakordimet për të ardhurat nga taksat e familjarëve bëhen për të rakorduar shumën totale që UKD ka për detyrë të transferojë te bashkia, por nuk ka rakordime mbi bazën e detyrimeve që duhet të paguajnë familjarët për llogari të muajit të caktuar të vitit buxhetor, pra sa ishte detyrimi i muajit sipas paketës fiskale, sa është paguar dhe sa ngelen debitor, në numër abonentësh dhe në vlerë. Nuk njihet situata e debitorëve familjar pasi për të gjithë periudhën e audituar nuk janë hartuar evidenca për këtë qëllim dhe nuk i është kërkuar UKD të jap raporte të tilla, në cilësinë e agjentit tatimor.
Rakordimet me UKD paraqiten:

Muaji	Proces verbal rakordimi		vlera leke e rakorduar sipas proces verbaleve	Konstatime
	Nr. prot	data		
JANAR 2022	pa numër	11.02.2022	311,001	P.V.rakordimi nuk është brenda afatit të cilësuar në kontratë
SHKUR 2022	1822	15.04.2022	27,185	P.V.rakordimi nuk është brenda afatit të cilësuar në kontratë
MARS 2022				nuk ka rakordim
PRILL 2022				nuk ka rakordim
MAJ 2022				nuk ka rakordim
QERSHOR 2022	4984	18.07.2022	19,235,764	P.V.rakordimi nuk është brenda afatit të cilësuar në kontratë
KORRIK 2022	pa numër	02.09.2022	645,291	P.V.rakordimi nuk është brenda afatit të cilësuar në kontratë
GUSHT 2022	pa numër	12.09.2022	8,341,707	P.V.rakordimi nuk është brenda afatit të cilësuar në kontratë

SHTATOR 2022	8137	17.10.2022	20,490,032	P.V.rakordimi nuk është brenda afatit të cilësuar në kontratë
TETOR 2022	8878	11.11.2022	5,416,097	P.V.rakordimi nuk është brenda afatit të cilësuar në kontratë
NENTOR 2022	9663	19.12.2022	5,118,094	P.V.rakordimi nuk është brenda afatit të cilësuar në kontratë
DHJETOR 2022	350	23.01.2023	14,923,871	P.V.rakordimi nuk është brenda afatit të cilësuar në kontratë

Burimi i të dhënave Bashkia Durrës.

Sa më sipër nuk është zbatuar kontrata nr. 641 prot. datë 03.02.2014, neni 5 pika 4,5,6...., ku cilësohët *.....“agjenti tatimor bën rakordimet përkatëse mbi të ardhurat e arkëtuara brenda datës 10 të çdo muaji duke derdhur në buxhetin e bashkisë shumën përkatëse të të ardhurave të realizuara për kategorinë familje”,* dhe neni 7 pika 1, ku cilësohet *“përbën shkelje për agjentin, pika a. mospasqyrimi në faturat mujore dhe mosmbajtja në burim e TTP dhe mostransferimi në Bashkine Durrës, në menyrë korrekte dhe në afatin e përcaktuar”,* pika b. “*Mosmbajtja e regjistrimeve për të ardhurat e paguara nga tatimpaguesi duke saktësuar në mënyrë të rregullt çdo kategori dhe nivel takse me të ardhurat përkatëse”,* pika c. “*Mosdhënia e informacionit Bashkisë së Durrësit për kontrollin e saktësisë së llogaritjeve për pagesat e tatimpaguesve”.*

Sa më sipër nga Bashkia Durrës **duhet të zbatoheshin penalitete** bazuar në nenin 7, pika 2 të marrëveshjes, ku cilësohet *“shkeljet e mësipërme përbëjnë kundravajtje administrative ndaj të cilave vendosen gjoba në mbështetje të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7; Kontrata nr. 641 prot. datë 03.02.2014, neni 5 pika 4,5,6, neni 7 pika 1 dhe 2; Rregullore brendshme e institucionit.

Ndikimi/Efektiviteti: Mos evidentim i taksapaguesve dhe mos arkëtim i të ardhurave prej tyre, çojnë në mungesën e të ardhurave në buxhetin e bashkisë.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit ligjor në fuqi si dhe paketës fiskale.

Rëndësia: E lartë

Procesi i popullimit të bazës së të dhënave në DTTV dhe procesi i përpunimit e përgatitjes së evidencave të mos bëhet nga i njëjti përdorues.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi personat si më poshtë: zv. Kryetarët e Bashkisë **z. G.K , z. R.M ,** Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore **z. L.D ,** Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit, **znj. V.Q ,** Përgjegjëse e Sektorit të Rregjistrimit të të Ardhurave **znj. A.K ,** Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave **znj. N.S ,** Specialisti i Sektorit të Informatikës z. , Specialist i të ardhurave **z. G.B .**

Në paketën Fiskale të vitit 2022 të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Durrës dhe Njësitë Administrative, ndahen në 2 kategori si më poshtë:

- **Biznes**
- **Familjar**

Kategoritë e mësipërme ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

- Biznes i Madh; Biznes i Vogël; Tregtarët Ambulant.
- Familje që kanë në pronësi/përdorim banesa private, toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Nga auditimi i evidencave mbi planifikimin dhe realizimin vjetor të të ardhurave, paketës fiskale të miratuar dhe taksave e tarifave vendore që administron sistemi i DTTV u konstatua se:

10. Titulli i gjetjes: Procesi për përllogaritjen e detyrimeve tatimore nuk është i saktë.

Situata: **Në sistemin e DTTV rezultojnë mungesa sipas kategorizimeve** për nënkategoritë e taksave/ tarifave dhe përjashtimet nga detyrimi për tu krahasuar me paketën fiskale të miratuar nga Këshili Bashkiak Durrës.
Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj në sistemin e DTTV nuk është i plotë dhe i shoqëruar me dokumentacion shoqërues (sipas kërkesave në formularet për aplikim të miratuar nga bashkia Durrës). Procesi për përllogaritjen e detyrimeve sipas Paketës Fiskale nuk është i saktë.
Planifikimi për Taksa dhe tarifa vendore të cilat janë burimi kryesor në realizimin e të ardhurave të veta nuk është kryer bazuar në numrin e subjekteve sipas sistemit, analizën e rezultatit historik, pritshmërive të vitit korrent dhe kordinimit midis drejtorive që mbulojnë realizimin e tyre.
Në dispozicion të grupit të auditimit nuk është vendosur informacion mbi të dhënat financiare që administron sistemi. Përpunimi i informacionit është bërë duke krahasuar evidencat për raportim të DTTV dhe informacionit identifikues së subjektit në sistemin e DTTV.
Në paketën e fiskale të Bashkisë Durrës nuk identifikohen taksa dhe tarifa vendore të përcaktuara për pajisjet automatike të cilat krijon aktivitet dhe gjenerojnë të ardhura si: ATM, pajisje elektronike, lojra për fëmije, ekranet dixhital të reklamimit, karikues për mjetet lëvizëse (që janë të vendosura në hapsira publike apo biznes privat, pranë institucioneve të ndryshme etj) edhe pse janë të identifikueshme nuk janë të përfshira në taksat dhe tarifat vendore.
Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
Ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", Neni 2 pika 13: *"Subjekt" është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, që ka cilësinë e tregtarit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, shoqëritë tregtare dhe degët e shoqërive të huaja*, Neni 2 pika 16. *"Veprimtari" është veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionale apo tregtare, e ushtruar në mënyrë të vazhdueshme nga subjektet;* Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 4, pika 7; Udhëzimi nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3, pika 4.
Ndikimi/Efekti: Mungesa në sistem e kategorizimeve ose pasaktësia e tij, çojnë në planifikim dhe faturim jo të saktë për taksa e tarifa vendore. Pasaktësia e paketës fiskale çon në mosplanifikim të disa kategori biznesesh.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit ligjor në fuqi
Rëndësia: E lartë

Për kategorinë e taksapaguesve Biznes
Për vitin 2022 (sipas informacionit të marrë nga evidencat e vëna në dispocion të grupit të auditimit nga DTTV), në Bashkinë Durrës kanë zhvilluar aktivitet 14,100 subjekte dhe kanë mbyllur aktivitetin 1,394 subjekte.
Për vitin 2021 kanë zhvilluar aktivitet 14,017 subjekte, dhe kanë mbyllur aktivitetin 296 subjekte.
Të dhënat për numrin e subjekteve aktiv dhe mbyllur sipas kategorive paraqiten në tabelën në vijim:

Nr.	Lloji biznesit	Viti	Gjëndja në fillim	Regjistrime te reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të vitit
1	**Biznesi Vogël**	2021	**9,639**	923	244	**10,318**
		2022	**10,352**	1,005	1,235	**10,122**
2	**Biznesi Madh**	2021	**3,548**	203	52	**3,699**
		2022	**3,736**	401	159	**3,978**
(1+2)	**Gjithësej**	2021	**13,187**	1,126	296	**14,017**
		2022	**14,088**	**1,406**	**1,394**	**14,100**

Burimi të dhënave Bashkia Durrës.
Në vitin 2022 (duke marrë në konsideratë informacionin e marrë nga sistemi i DTTV), në Bashkinë Durrës deri më 31.12.2022 rezultojnë:
27,989 subjekte aktiv, nga të cilët,
Total Biznes i Madh janë 3,770 subjekte,
Total Biznes i Vogël janë 7,438 subjekte,
Institucione Publike është 1 subjekt,
Transport janë 449 subjekte,
Ambulant janë 829 subjekte,
Në sistemin e DTTV rezultojnë 15,502 subjekte aktiv të cilët nuk e kanë të specifikuar kategorinë e biznesit.
Në sistem për vitin 2022 rezultojnë 1,613 subjekte me status mbyllur, pasiv dhe pezulluar si më poshtë: **802** subjekte të mbyllur **389** subjekte pasiv dhe **422** subjekte të pezulluar.

Të dhënat për numrin e subjekteve sipas sistemit janë paraqitur në tabelën në vijim

Kategoria	Biznese aktiv deri me 31.12.2022	Total Biznese të mbyllur në vitin 2022	Biznese të cilët kanë kaluar me status mbyllur më 31.12.2022	Biznese të cilët kanë kaluar me status pasiv më 31.12.2022	Biznese Me status pezulluar deri më 31.12.2022
Biznes i Madh	3,770	459	281	104	74
Biznes i vogël	7,438	1,068	463	269	336
Ambulant	829	46	39	**2**	5
PUBLIC SECTOR COMPANIES	1	0	0	**0**	0
Transport	449	14	10	**3**	1
Pa Kategori	15,502	26	9	11	6
Total biznes	**27,989**	**1,613**	**802**	**389**	**422**

11. Titulli i gjetjes: Numri i subjekteve sipas sistemit tatimor është i ndryshëm me numrin e subjekteve të raportuar në evidencë, nuk ka gjurmë auditimi për të bërë vlerësimin e saktësisë së përllogaritjes së detyrimeve.
Situata: DTTV **Raportimin** në evidenca zyrtare dhe pasqyra financiare e bën nëpërmjet informacionit të përpunuar nga specialistat e sektorit mbi raportet që ofron sistemi. Sistemi i DTTV jep informacion në raportet që gjeneron vetëm për subjektet që kanë të përcaktuar kategorinë në fushën përkatëse.
Procesi i përpunimit të informacionit nga raportet që gjeneron sistemi në formatin excel nuk kalon në faza monitorimi. Për subjektet pa kategori planifikimi i taksave e tarifave vendore nuk është i saktë. Bazuar në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006"Për sistemin e taksave vendore", neni "5" "rregulla të përbashkëta për taksat vendore" cilësohet .....bashkia nëpërmjet këshillit bashkiak:

a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;

b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori e nënkategori të bazës së taksës.

Në kushtet kur nuk është përcaktuar kategoria nuk ka gjurmë auditimi për të bërë vlerësimin e saktësisë së përllogaritjes së detyrimeve.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni "5"; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e kategorizimit dhe monitorimit të sistemit sjell evidenca te pasakta.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi

Rëndësia: E lartë

Auditimit i ngarkesës me taksa dhe tarifa vjetore të subjekteve në sistemin e DTTV

Sipas informacionit identifikues në sistemin e DTTV rezulton se në Bashkinë Durrës për kategorinë biznes deri më datë 31.12.2022 janë 27 989 subjekte me statusin aktiv. Taksat dhe tarifat vendore që administron ky sistem paraqiten si më poshtë:

Taksa mbi Ndërtesën Biznes, Taksa Truallit, Taksa Tabelës, Taksa e Reklamës, Taksa Fjetjes në Hotel, Taksa Përkohshme Infrastrukturës Arsimore, Tarifë Pastrimi Biznes, Tarifë Ndricimi, Tarifë Gjelbërimi, Tarifë Parkimi, Tarifa plazh privat.

Në të dhënat e evidencave të DTTV (shkresa nr.1295 prot. datë 01.02.2023) rezulton se për vitin 2022 në kategorinë biznes janë 14,100 subjekte me statusin aktiv.

Më poshtë paraqiten të dhënat e krahasuara lidhur me planifikimet dhe realizimin për taksat dhe tarifat vendore që administrohen nga Sistemi DTTV.

Përpunimi i informacionit është bërë duke krahasuar evidencat për raportim të DTTV, informacionit identifikues të subjektit në sistemin e DTTV dhe informacionit në format excel për debitorët për vitin 2022.

Taksa Tarifa vendore që administrohen nga Sistemi DTTV kategoria Biznes	Nr. i subjekteve aktive sipas evidencave te DTTV për vitin 2022	Nr. subjekteve mbi të cilët është përllogaritur në sistemin e DTTV detyrim sipas taksa /tarifa vendore për vitin 2022	Diferenca në Nr. subjektesh midis subjekteve Aktiv në evidencn e DTTV dhe subjekteve për të cilët është bërë përllogaritja e detyrimit për taksa/tarifa vendore për vitn 2022	Panifikimi sipas evidencave të DTTV për 2022	Vlera e postuar si detyrim për numrin e subjekteve mbi të cilët është gjeneruar detyrimi për taksa /tarifa vendore në sistemin e DTTV për vitin 2022	Diferenca në vlerë absolute midis planifikimit në evidencat e DTTV dhe detyrimit të përllogaritur në Sistemin e DTTV për vitin 2022	Realizimi faktik sipas evidencave të DTTV për vitin 2022	Realizimi faktik sipas sistemit të DTTV për vitin 2022	Diferenca në vlerë absolute midis realizimit faktik në evidencat e DTTV dhe arkëtimeve në Sistemin e DTTV për vitin 2022
Të ardhura nga taksa e ndërtesës biznes	14,100	**8,873**	**-5227**	270,000,000	262,473,151	**7,526,849**	212,944,605	199,427,897	**13,516,708**
Të ardhura nga taksa mbi truallin	14,100	**987**		25,000,000	34,095,605	**-9,095,605**	21,782,172	21,504,431	**277,741**
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	14,100	**739**		30,000,000	29,667,050	**332,950**	24,914,475	24,914,475	**0**
Takse Tabele (identifikuese)	14,100	**162**	**-13938**	12,000,000	19,975,489	**-7,975,489**	10,226,414	18,094,989	**-7,868,575**
Takse Reklame	14,100	**1**	**14099**	18,455,000	86,225	**18,368,775**	9,790,900	86,625	**9,704,275**
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi	14,100	**1,1254**	**-2846**	180,000,000	175,700,840	**4,299,160**	144,049,002	139,064,370	**4,984,632**
Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi	14,100	**11,187**	**-2913**	41,000,000	33,857,450	**7,142,550**	29,473,569	27,463,072	**2,010,497**
Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi	14,100	**10,985**	**-3115**	40,000,000	36,747,707	**3,252,293**	30,823,341	28,767,820	**2,055,521**
Nga tarifa parkimi.	14,100	**3655**	**10445**	30,000,000	28,812,168	**1,187,832**	24,666,590	22,980,308	**1,686,282**
Të ardhura nga kundravajtjet administrative	14,100	**120**		15,000,000	927,000	**14,073,000**	16,838,357	768,000	**16,070,357**
Takse e perkoheshme (Infras. Arsimore)	14,100	**2537**	**-11563**	44,000,000	30,425,800	**13,574,200**	18,844,460	23,728,460	**-4,884,000**

Burimi i të Dhënave Bashkia Durrës,Sistemi DTTV dhe informacion i përpunuar nga grupi i auditimit.

Duke krahasuar të dhënat e evidencave të DTTV (shkresa nr. 1295 prot. datë 01.02.2023) dhe sistemit të DTTV (shkresa nr. 8366/5 prot.datë_01.11.2023), konstatohet se ka mospërputhje midis tyre në numrin e subjekteve taksapagues, planifikim dhe realizim.
Sipas evidencave të vëna në dispozion DTTV numri total i subjektve që zhvillojnë aktivitet për vitin 2022 është 14,100 subjekte.
DTTV në planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk i ngarkon detyrim secilit prej subjekteve për të gjitha taksat dhe tarifat e miratuara por vetëm për një pjese të tyre sipas tabelës së mësipërme. Për taksa e reklamës nga 14,100 subjekte të rregjistraur vetëm për njërin prej tyre planifikohet kjo taksë, taksa tabele identifikuese nga 14,100 subjekte të rregjistruar vetëm për 162 prej tyre planifikohet kjo taksë etj.
Po analizojmë një prej tyre**, taksa mbi ndërtesën për vitin 2022** është planifikuar në vlerën **405,000,000** lekë dhe është realizuar në vlerën **247,051,134** lekë, ose në masën 61 %, me mosrealizim në vlerën **206,551,134** lekë nga auditimi i listës analitike të subjekteve debitore për këtë taksë u konstatua se:
-. DTTV Durrës taksën mbi ndërtesën e ndan nga subjekti që ushtron aktivitet dhe e faturon pranë pronarit që ka në pronësi pasurinë ku zhvillohet aktiviteti. Kjo ndarje e bën të pamundur evidentimin në sistem dhe mbledhjen e këtij detyrimi. Subjektet debitore nga kjo taksë zënë një vlerë të madhe të borxhit në vite ndaj Bashkisë Durrës **195,486,376 lekë**
Po analizojmë, **taksën e ndërtesës për biznesin** .
Nga krahasimi i të dhënave sipas tabelës më sipër rezulton se:
Numri i subjekteve aktivë për vitin 2022 sipas evidences është 14,100 ndërsa numri i subjekteve që është ngarkuar kjo taksë sipas sistemit të DTTV është 8,873 (diferenca 5,227 subjekte nga totali sipas evidencës),
Plani të ardhurave për vitin 2022 sipas evidencës është 270,000,000 lekë, ndërsa plani sipas sistemit të DTTV është 262,473,151 lekë (diferenca 7,526,849 lekë)
Realizimi sipas evidencës për vitin 2022 është 212,944,605 lekë, ndërsa realizimi sipas sistemit të DTTV është 199,427,897 lekë (diferenca 13,516,708 lekë).
Ka diferenca në llogaritjen, planifikimin dhe arkëtimin e taksave e tarifave vendore.
Nuk ndahen të ardhurat që paguhen për llogari të vitit buxhetor aktual, nga të ardhurat të cilat paguhen me vonesë, për llogari të viteve të mëparshëm. Sipas paketës fiskale vjetore, të ardhurat duhet të mbahen të ndara, veç ato të cilat realizohen si rezultat i zbatimit të paketës fiskale dhe veç pagesat për detyrimet e prapambetura. Mos ndarja bën që edhe realizimi faktik sipas paketës fiskale të jetë më i vogël nga sa paraqesin shifrat e realizimit për secilin vit buxhetor.
Edhe fakti që realizimi i disa të ardhurave kalon vlerën 100%, shpjegohet me mos ndarjen e pagesave për llogari të vitit buxhetor, nga ato për llogari të detyrimeve të prapambetura.

Korrespodenca me institucionet.
DTTV në kuadrin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioneve me institucione të ndryshme jashtë bashkisë, ka kërkuar dhe njëkohësisht ka dhënë informacione në funksion të realizimit të detyrave dhe objektivave për të ardhurat vendore. DTTV ka mbajtur korrespodencë me institucione të ndryshme si QKB, ASHK, Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës, Banka të nivelit të dytë dhe institucione të tjera shtetërore.

12. Titulli i gjetjes: Korrespodenca jo korrekte me institucionet
Situata: Shkresat me objekt: "Kthim përgjigje" institucionit të QKB, e cila me shkresë zyrtare kërkon informacion periodik për subjektet të cilët aplikojnë për pezullim ose mbyllje u konstatua se:
Nga verifikimi me zgjedhje i shkresave në ***211 (dyqind e njëmbëdhjetë) raste*** shkresat kanë kaluar afatin kohor ligjor të dërgimit kthimit të përgjigjeve.

Në 29 (njëzet e nënte) raste për subjekte që është kërkuar informacion për çregjistrim në QKB rezulton se **nuk janë regjistruar** në sistemin e DTTV, e për pasojë nuk janë llogaritur detyrime për taksa e tarifa vendore që nga data e regjistrimit të tyre në QKB si biznes.
Tabela e subjekteve te paregjistruar nga DTTV:

Nr.	SUBJEKTET	NIPTI	Data e marrjes se shkreses nga sek. Kontrollit	Statusi ne sistemin e DTTV	Statusi QKB
1	F.B	M….C	10.02.2022	Nuk eshte regjistruar	Çregjistruar 10.5.2022
2	J.F	M….M	12.10.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
3	A.L	M….G	20.10.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
4	R.M	M….Q	20.10.2022	Nuk eshte regjistruar	aktiv
5	F.M	M….S	08.11.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
6	K.D	M….A	10.11.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
7	XH.L	M….A	14.01.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
8	K.S	M….R	12.01.2022	Nuk eshte regjistruar	aktiv
9	A.SH	M….S	24.02.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
10	J.H	M….A	01.03.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
11	N.M	L….K	22.04.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
12	O.H	M….O	29.06.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
13	A.S	M….C	30.06.2022	Nuk eshte regjistruar	Çregjistruar 13.10.2022
14	S.P	M….K	06.07.2022	Nuk eshte regjistruar	Çregjistruar 02.02.2023
15	A.D	M….M	06.07.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
16	B.T	M….F	06.07.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
17	A.A	M….H	06.07.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
18	A.K	L….E	06.07.2022	Nuk eshte regjistruar	Çregjistruar 29.08.2022
19	SH.K	M….C	15.07.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
20	G.J	L….C	15.07.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
21	F.I	M….H	15.07.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
22	R.A	M….G	15.07.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
23	A.D	L….O	18.07.2022	Nuk eshte regjistruar	Çregjistruar 7.9.2022
24	D.K	M….V	25.07.2022	Nuk eshte regjistruar	Çregjistruar 5.10.2022
25	B.T	M….E	25.07.2022	Nuk eshte regjistruar	Çregjistruar 14.9.2022
26	A.S	M….C	09.09.2022	Nuk eshte regjistruar	Çregjistruar 13.10.2022
27	E.GJ	M….D	12.01.2022	Nuk eshte regjistruar	CREGJ 30.9.2022
28	E.T	M….A	11.04.2022	Nuk eshte regjistruar	Aktiv
29	H.H	L….D	12.01.2022	Nuk eshte regjistruar	aktiv

Në 16 (gjashtëmbëdhjetë) raste për subjekte që është kërkuar informacion për çregjistrim në QKB rezulton se, nga QKB janë çregjistruar, ndërsa në sistemin e DTTV rezultojnë debitor. QKB dhe sektori i kontrollit në terren pranë DTTV nuk i ka kthyer përgjigje QKB, këto raste paraqiten sipas tabelës:

Nr.	SUBJEKTET	NIPTI	Data e marrjes se shkreses nga sek. Kontrollit	Vlera e debise sipas sistemit DTTV	Statusi QKB
1	T	K….Ë	11.05.2022	589,300	Çregjistruar 08.02.2023
2	D.B	L….D	06.07.2022	156,000	Cregjistruar 29.8.2022

Nr.	SUBJEKTET	NIPTI	Data e marrjes se shkreses nga sek. Kontrollit	Vlera e debise sipas sistemit DTTV	Statusi QKB
3	A.D	L….M	30.06.2022	114,690	Çregjistruar 15.08.2022
4	C	M….R	10.02.2022	108,445	Çregjistruar 01.04.2022
5	I.K	L….D	09.02.2022	93,671	Çregjistruar 25.03.2022
6	O.N	L….J	05.05.2022	88,448	Çregjistruar 13.06.2022
7	E.S	L….H	09.02.2022	65,901	Çregjistrua 01.06.2022
8	F.C	L….U	30.06.2022	45,001	Çregjistruar 24.10.2022
9	A.M	M….B	31.01.2022	38,500	Çregjistrua 23.03.2022
10	E.C	M…..V	11.04.2022	33,300	Çregjistruar 12.09.2022
11	R.T	L….O	06.07.2022	30,150	Çregjistruar 29.08.2022
12	P.M	M….M	07.03.2022	25,626	Çregjistruar 16.06.2022
13	M.H	L….J	12.01.2022	17,418	Çregjistrua 11.03.2022
14	V.J	L….A	03.02.2022	16,125	Çregjistruar 24.03.2022
15	M.H	L….H	30.06.2022	11,875	Çregjistruar 12.01.2023
16	A.H	L….G	29.03.2022	5,063	Çregjistruar 09.05.2022

Në 4 (katër) raste për subjekte që është kërkuar informacion për çregjistrim në QKB rezulton se **janë mbyllur** në sistemin e DTTV, ndërsa në QKB rezultojnë me statusin aktiv, të cilat paraqiten sipas tabelës:

Nr.	SUBJEKTET	NIPTI	Data e marrjes së shkresës nga sek. Kontrollit	Vlera e debise sipas sistemit DTTV	Statusi QKB	STATUSI SISTEM
1	Q.H	K….C	12.01.2022	**14,000**	Aktiv	Mbyllur
2	E.M	L….G	23.03.2022	**309,087**	Aktiv	Mbyllur
3	M.T	K….O	26.04.2022	**11,720**	Aktiv	Mbyllur
4	D.K	L….N	05.05.2022	**29,140**	Aktiv	Mbyllur

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 5, neni 11,...; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë i ndryshuar" neni 1, **neni 2** gërmat a, ç, **neni 5** gërmat a, d, dh, f, g, gj, h, i, **neni 6** pikat 1, 2, 3, neni 12 **gërmat** a, b, dh..., **neni 13** gërma b, neni 15, **neni 23** pika 1, 4, neni 26, neni 27,neni 28 pika 1, **neni 29**, neni 31, neni 40, neni 41, neni42, **neni 43 pika1, 2, 3, neni 44, neni 45,** neni 47 , **neni 48** pika 1, **neni 57** pikat 4**, 5**, **nenet 60, 61, 62**, neni 65 pika 5, nenet 68, 69 , **neni 70 pika 2, neni 71/1** pika 5 ; ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, nenet 28 –40, **neni 42**, **neni 43** gërma d, **neni 59** ; Manuali i Manaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhërin e MFE nr. 108 datë.17.11.2016; Udhëzimi nr. 26, datë 16.12. 2014**;** Udhëzimi nr. 655/1 datë 06.02.2007 "Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proceduriale dhe të raportimit të sistemit të takses vendore;. VKB - në nr.160, datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit"; Rregulloren e brendshme të bashkisë.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrim në DTTV dhe mos faturim i subjekteve tatimpagues, çregjistruar nga QKB subjekte debitore, mbyllur në sistemin e DTTV subjekte aktive në QKB....

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi

Rëndësia: E lartë

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore **z. L.D ,** Përgjegjësi i Sektorit të kontrollit **z. SH.H ,** Përgjegjësi i sektorit të Manaxhimit të Borxhit **z. L.B ,** Përgjegjës i sektorit të të ardhurave **znj. N.S .**

Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor

Struktura e detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Durrës sipas pasqyrave financiare në vite (llogaria 468) progresive dhe për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

Taksat dheTarifat Vendore	Gjendja e debitoreve për taksa dhe tarifa vendore sipas viteve në lekë							
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
	687,983,084	688,343,480	**733,273,353**	103,189,829	105,465,864	163,964,529	143,257,259	165,047,159

13. Titulli i gjetjes: DTTV Durrës nuk paraqet në kontabilitet (pasqyrat financiare vjetore) vlerën e saktë të detyrimit vjetor për subjektet.

Situata: Konstatohet se në vitin 2018, vlera debitore për taksa dhe tarifa vendore është ulur ndjeshëm konkretisht me **630,083,524 lekë.** Lidhur me sa më sipër nga grupi auditimit u bënë disa intervista dhe testime për të analizuar këtë ulje të ndjeshme të detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore.

Nga intervistat me Drejtorin e DTTV z.L.D dhe Përgjegjësin e Sektorit të Borxhit dhe Apelimit pranë DTTV z. L.B rezulton se:

Sipas DTTV pretendohet se detyrimi vjetor për sa më sipër paraqitet në financë nëpërmjet evidencave vjetore por nuk ka asnjë spjegim lidhur me këtë ulje në raportimin për vitin 2018.

Sipas Financës pretendohet se regjistrimet në bilancet kontabël bëhen vetëm bazuar në evidencat zyrtare të cilat paraiqten nga DTTV**.**

Nga grupi auditimit janë kryer disa testime për të verifikuar procesin e përpunimit të informacionit që bën sektori i borxhit të përfituar nga sistemi në format PDF drejt formatit excel. Informacioni i përpunuar në formatin excel (regjistri i borxhit) përdoret për të përgatitur evidencat që paraqiten në kontabilitet dhe njoftimet për bllokim detyrimi në bankat e nivelit të dytë,..etj. **DTTV** pretendon se në evidencën që paraqitet për kontabilitet paraqitet detyrimi i vitit dhe jo progresivi ndërsa në listat për njoftim bllokim detyrimi shkon si vlerë progresive e detyrimit të subjekteve. Detyrimi progesiv për evidencat në kontabilet trajtohet si përllogaritje e detyrimeve vjetore të paraqitura në evidenca respektivisht për çdo vit.

Nga auditimi i procesit rezulton se nuk rakordon vlera e detyrimit vjetor të subjekteve në sistemin e DTTV me atë të paraqitur në evidencat për raportim në kontabilitet.

Rezultatet e këtij testimi (për 11 subjekte) paraqiten si më poshtë:

NR	Nipti	Kode (adresa dytësore)	Statusi në sistem	Detyrimi në sistem vetëm për vitin 2021	Detyrimi në kontabilitet për vitin 2021	Detyrimi në sistem vetëm për vitin 2022	Detyrimi në kontabilitet për vitin 2022	Detyrimi progresiv Sistemit vetëm për vitet 2021-2022	Diferenca me kontabilitetin për vitin 2022	Detyrimi progresiv ne vite	Diferenca me kontabilitetin në vite
1	**J….J**	8	Aktiv	1,279,803	2,189,194	1,593,526	2,130,954	**2,873,329**	**-742,375**	4,951,848	2,820,894
2	**K….P**	2	AKTIV	526,268	526,268	0	0	**526,268**	**-526,268**	172,025	172,025
3	**L….E**	2	AKTIV	1,127,040	1,034,840	1,160,020	0	**2,287,060**	**-2,287,060**	4,832,585	4,832,585
4	**J….M**	3	AKTIV	1,543,060	1,361,740	112,972	0	**1,656,032**	**-1,656,032**	6,635,185	6,635,185
5	**L….K**	2	AKTIV	543,440	494,440	1,048,942	904,700	**1,592,382**	**-687,682**	5,832,992	4,928,292
6	**J….B**	10	AKTIV	0	570,129	0	0	**0**	**0**	0	0
7	**K….T**	7	AKTIV	636,655	28,500	649,505	0	**1,286,160**	**-1,286,160**	100,403	100,403
8	**L….H**	2	PEZULLUAR	288350	237,300	296,700	277,400	**585,050**	**-307,650**	580,475	303,075
9	**L….I**	9	AKTIV	39000	174,856	871,299	839899	**910,299**	**-70,400**	676,084	-163,815

10	**L….P**	3	AKTIV	397346	334,261	430,711	396161	**828,057**	**-431,896**	2,310,899	1,914,738
11	**L….O**	3	AKTIV	45713	559,518	0	726041	**45,713**	**680,328**	998,986	272,945
Totali				**6,426,675**	**7,511,046**	**6,163,675**	**5,275,155**	**12,590,350**	**7,315,195**	**27,091,481**	**21,816,326**

U përzgjodhën në mënyrë rastësore 11 subjekte nga sistemi dhe u ndoq procesi i përgatitjes së regjistrit të borxhit prej të cilit përgatiten evidenca të ndryshme nga DTTV. Rezultatet e testimit të këtij procesi për 11 subjektet e përzgjedhura në trajtë narrative shprehen si më poshtë:
Për vitin 2021 Detyrimi i evidentuar në sistem krahasuar me detyrimin paraqitur në evidencën për kontabilitet për vitin 2021 rezulton me diferencë negative.
Në sistem detyrimi është **1,084,371** lekë më pak se detyrimi i paraqitur në evidencën për kontabilitet.
Për vitin 2022 detyrimi i evidentuar në sistem krahasuar me detyrimin paraqitur në evidencën për kontabilitet për vitin 2022 rezulton me diferencë pozitive.
Në sistem detyrimi është **888,520** lekë më shumë se detyrimi paraqitur në evidencën për kontabilitet
Detyrimi progresiv vetëm në vitet 2021 - 2022 i evidentuar në sistem për këto 11 subjekte rezulton me difrerencë pozitive krahasuar me detyrimin paraqitur në evidencën për kontabilitet për vitin 2021.
Në sistem detyrimi është 7,315,195 lekë më shumë se detyrimi paraqitur në evidencën për kontabilitet.
DTTV Durrës nuk paraqet në kontabilitet vlerën e saktë të detyrimit vjetor për subjektet.
Sipas rezultateve të përfituara nga testimi konstatohet një diferencë në vlerën 7,315,195 lekë midis Kontabilitetit dhe Sektorit të Manaxhimit të Borxhit. Në sistem detyrimi është 7,315,195 lekë më shumë se në evidencën e paraqitur për kontabilizim (për 11 subjektet e zgjedhura).
Kriteri: Ligji 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 4 pika 26, neni 6; neni 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligji nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me UMF nr. 5 datë 21.02.2022, ...pika 32, ...Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik",
Ndikimi/Efekti: Informacion i pa saktë për pozicionin financiar të bashkisë.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.
Rëndësia: E lartë

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi për pjesët takuese sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme të institucionit personat si më poshtë: Kryetari Bashkisë **z. V.D** (për periudhën 2017-2018), zv. Kryetari **ZH.V** (për periudhën 201-2018), zv. Kryetarët e Bashkisë **z. G.K , z. E.J , z. R.M ,** Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore **z. L.D ,** Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit, **znj. V.Q ,** Drejtori i Drejtorisë Ekonomike **z. E.L ,** Drejtor i Auditit të Brendshëm **znj. M.P,** Përgjegjëse e Sektorit të Rregjistrimit të të Ardhurave znj A.K , Përgjegjësi i Sektorit të Manaxhimit të Borxhit dhe Apelimit **z. L.B ,** Përgjegjësi i Sektorit të Financës **znj. H.H .**

Evidentimi i problematikave të procesit të çregjistrimit dhe ndjekjes së subjekteve debitore nga DTTV
Për të marrë një panoramë më të qartë rreth këtij procesi u përzgjodhën 40 raste nga lista e bizneseve të cilëve ju është ndryshuar statusi në Sistem (nga Aktiv në mbyllur,pasiv,pezulluar). Në përzgjedhjen e rasteve më poshtë është marrë në konsideratë trajtimi i të gjitha fashave të detyrimit (vlerat e vogla për shpeshtësinë e prezencës në listën analitike, vlerat e ndërmjetme dhe të larta për peshën në vlerën e totalit të analitikes.

Evidencat që u trajtuan për testim janë si më poshtë:
- Lista analitike e subjekteve që kanë mbyllur aktivitetin në Bashkinë Durrës për vitin 2022
- Gjendja faktike a detyrimeve ndër vite dhe statusit të subjektit në Sistemin e DTTV.
- Raporti i debitorëve gjeneruar nga sistemi i DTTV për vitin 2022
- Regjistri i Borxhit në formatin excel që përgatit Sektori i Borxhit
- Evidenca të përgatitura nga DTTV për Drejtorinë Ekonomike,Sektorit të Financës lidhur me kontabilizimin e detyrimit për subjektet debitore,
- Lista e njoftimeve për bllokim shume debitore në Bankat e nivelit të dytë

Nga shqyrtimi i evidencave mësipër u konstatua se :

Për të 40 rastet të cilat kanë ndryshuar status nga aktiv në mbyllur në sistemin e DTTV detyrimet nuk janë pasqyruar korrekt në të gjitha raportet e DTTV.

Problematika e konstatuar paraqitet më poshtë në formë tabelore dhe në trajtë narrative.

NR	KODI	Nipt	Lloji Aktivitetit	Statusi në QKB	Statusi në Sistem	Debia në Sistem	Vlera e munguar në vit si perllog nga data e ndalesës se Faturimit	Raporti Debitoret Format PDF nga sistemi e paraqitur me shkresë nga bashkia	Evidenca per kontabilitet viti 2022	Regjistri Borxhit format ecxel	Njoftimet per bllokim ne Bankën 2022
1	**90985**	**J….P**	" V "Tregeti Materjale Ndertimi (B.J)	aktiv	MBYLLUR	**129,525**	471,480	0	NA	NA	NA
2	**98687**	**K….Ë**	Bar-Kafe (Sh.M.)	cregjistruar	MBYLLUR	**335,450**	579,560	NA	NA	NA	NA
3	**1162**	**K….Q**	Fast Food,(K. D.)	aktiv	MBYLLUR	**191,821**	116,655	NA	NA	NA	NA
4	**605**	**K….P**	Tregti materiale ndertimi, bv (K. D.,T.Pas. M.L.)	cregjistruar	MBYLLUR	**38,060**	197,811	NA	NA	NA	NA
5	**369**	**K….L**	Tregeti kompjutera (Q.S.)	aktiv	MBYLLUR	**188,725**	279,760	49,500	NA	**518,845**	**707,570**
6	**148**	**K….G**	Tregeti mat. peshkimi (E.G.)		MBYLLUR			NA	NA	NA	NA
7	**1276**	**K….L**	Fast Food (K. K.)	aktiv	MBYLLUR	**66,684**	123,295	NA	NA	NA	NA
8	**799**	**K….G**	Ushqimore (I.Th.)	cregjistruar	MBYLLUR	**I pa rregj per tarifa taksa vend**		NA	NA	5,996.00	NA
9	**3308**	**K….M**	Prodhim byreqe,bar(S.H.).	aktiv	MBYLLUR	**228,020**	29,290	11,393	NA	NA	NA
10	**336**	**K….K**	Bar - Bufe bv (L. D.)	aktiv	MBYLLUR	**78,751**	0	0	NA	NA	NA
11	**2472**	**J….O**	Prodhim konfeksione, BM (H.S.)	pezulluar	MBYLLUR	**I pa rregj per tarifa taksa vend**	NA	NA	NA	NA	NA
12	**2357**	**K….R**	Prodhim pj.elektrike+kepuce,BM (I/V.)	Nuk shfaqet E.H.	MBYLLUR	**966,820**	na	NA	NA	NA	NA
13	**2436**	**K….C**	Flesh Servis Tregeti Pjese kembimi (E. L.)	Shoq.likuj dim	MBYLLUR	**613,500**	698,400	NA	NA	NA	NA
14	**2537**	**J….K**	Prodhim art.plastike (T.B.)	pezulluar	MBYLLUR	**594,970**	1,057,248	NA	NA	NA	NA
15	**2995**	**K….U**	Karpentier (O.Xh.).	cregjistruar	MBYLLUR	**148,100**	239,920	NA	NA	NA	NA
16	**3647**	**K….A**	Transmetim TV kabllor (E. B.)	aktiv	MBYLLUR	**333,197**	157,500	NA	NA	NA	NA
17	**2548**	**J….P**	Tregti imp - exp,Z. Group(A. Z.)	aktiv	MBYLLUR	**1,394,245**	1,056,908	NA	NA	NA	NA
18	**3782**	**K….Q**	"D." shpk, Tregti Imp.Exp. (P. S.)	aktiv	MBYLLUR	**106,645**	359,880	NA	NA	NA	NA
19	**2428**	**K….O**	S.R.N.S Electronic - Instalime elektronike BM (J. A. Z)	cregjistruar	MBYLLUR	**269,596**	339,840	NA	NA	NA	NA
21	**480**	**K….U**	"Vetem Dru"-Prodhim dhe eksport druri-Juridik-BM (. K.)	aktiv	MBYLLUR	**601,050**	1,323,060	NA	NA	NA	NA
22	**4851**	**J….B**	"R. Bank"-Banke (Ch. C.)	aktiv	MBYLLUR	**22,630**	288,390	NA	NA	NA	NA
23	**8472**	**J….I**	"K. A.",Perpunim peshku (A. M.)	aktiv	MBYLLUR	**822,025**	2,689,343	NA	NA	NA	NA
24	**6286**	**K….M**	Tregtar ne Tregje (B. S.)		MBYLLUR	**52,175**		8,300	NA	NA	NA
25	**5700**	**K….O**	Byrektore (D. A.)	pezulluar	MBYLLUR	**311,220**	33,835	NA	NA	NA	NA
26	**128890**	**K….Ë**	Bilardo (I. K.)	cregjistruar	MBYLLUR	**112,060**	112,700	NA	NA	NA	NA
27	**7075**	**J….C**	Banka Kombetare Greke(J. K.)	cregjistruar	MBYLLUR	**225,672**	491,232	NA	NA	NA	NA
28	**7357**	**K….D**	G.shpk Ndertim (S.S.)	pezulluar	MBYLLUR	**81,120**	746,760	NA	NA	NA	NA

29	**8545**	**K….C**	M.BM(A.K.)	cregjistruar	MBYLLUR	**341,350**	553,880	NA	NA	NA	NA
30	**138314**	**J….E**	B.SHPK (A.T.)	Shoq.likuj dim	MBYLLUR	**862,698**	68,000	NA	NA	712,572.00	NA
66 66 66 66	**111212**	**K….K**	Prodhime te nenprodukteve te qumshtit (S. S.)	cregjistruar	MBYLLUR	**195,160**	203,000	NA	NA	NA	NA
32	**104820**	**K….V**	"U. P. G. Imp-Exp (P.M.)	Shoq.likuj dim	MBYLLUR	**454,350**	698,400	NA	NA	NA	NA
33	**108461**	**L….C**	A.-D.(Prodhim Detergjent)(S. M.)	aktiv	MBYLLUR	**611,910**	60,000	57,120	NA	613,437.00	613,437
34	**129998**	**J….E**	B. SH P K (Alban Tepshi)		MBYLLUR	**942,949**	NA	NA	NA	NA	NA
35	**148943**	**J….K**	"V. B." T.Pasurie1/578,1/580,1/517,1/518,1/516,1/579,1/519,truall 1/598,1/599,1/597,1/596,1/588	Cregjistruar	MBYLLUR	**6,401,028**	NA	NA	NA	**820,781.80**	**5,744,502**
36	**171074**	**L….F**	Zyre qendrore e shoqerise (M. R. J.P.Y SHPK)	aktiv	MBYLLUR	**597,393**	NA	NA	NA	**16,662**	**18,537**
37	**138000**	**L….L**	S.e sh p k (V. S.)	nuk ka rezulatnë qkb	MBYLLUR	**591,642**	NA	NA	NA	652,076.00	**652,076**
38	**161701**	**Haki Bajram Deda**	H.B. D.	Aktiv	aktiv	**26,864,154**	NA	2,970,473	NA	NA	26,864,154
39	**4976**	K….K	D.	aktiv	pasiv	**16,336,958**	NA	NA	NA	**16,336,958**	**13,191,560**
40	7421	**K….G**	**SHERBIM.TJERA**	aktiv	aktiv	**9,961,110**	NA	923,825	NA	**9,961,109.61**	**10,454,732**
Totali						**72,114,783**	**13,164,247**	**4,020,611**	**0**	**29,638,437.41**	**58,246,567**

Burimi të dhënave Bashkia Durrës dhe informacion i përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimi u konstatua se nga 40 subjekte e marra për testim, 17 subjekte rezultojnë Aktiv në Regjistrin Elektronik të QKB dhe 20 subjekte rezultojnë me statusin çregjistruar ose pezulluar.

Praktika për Përcaktimin e statusit mbyllur, pezulluar, pasiv në sistemin e DTTV bëhet si më poshtë:

- **A. Me kërkesën vullnetare për çrregjistrim pranë Qkb**
- **B. Nga ndjekja rutinë e DTTV për statusin e subjekjteve në Drejtorinë Rajonale Tatimore**
- **C. Nga ndjekja rutinë e DTTV për statusin e subjekteve në Regjistrin Elektronik Online të QKB .**

A. **Me kërkesën vullnetare për çrregjistrim pranë QKB**

Subjekti aplikon për çregjistrim në QKB dhe kjo e fundit njofton DTTV me shkrim për të evidentuar gjendjen debitor të subjektit para çregjistrimit brenda afatit ligjor. (*Në rast të mungesës së një konfirmimi nga DTTV, QKB proceson me çregjistrimin automatik*). DTTV regjistron në protokollin e brendshëm praktikën dhe drejtori i DTTV e nis praktikën për ndjekje nga Sektorët hapat janë si më poshtë:

1. Sektorit të Kontrollit në terren i cili mban akt konstatim me të cilin përcakton nëse ky subjekt ushtron aktivitet ose jo.
2. Sektori regjistrimit pas paraqitjes së akt konstatimit nga sektori terrenit përcakton vlerën debitore.
3. DTTV njofton QKB nëse ky subjket ka ose jo detyrime. (*Nëse rezulton debitor nga sektori regjistrimi dhe nese nuk ushtron aktivitet bën kërkesë për bllokimin Debie në vlerën e detyrimit të subjektit*)
4. Sektori i borxhit në rastet me detyrim përpunon në format excel (regj i borxhit) informacionin e përfituar në formatin PDF nga sistemi dhe përgatit:

a.Evidencën për kontabilizim që i paraqitet Drejtorisë Ekonomike ,Sektorit të Financës

b.Listat për njoftim Bllokimi në Bankat e nivelit të dytë

B. Nga ndjekja rutinë e DTTV për statusin e subjekjteve në Drejtorinë Rajonale Tatimore .

Kur DTTV konstaton se subjekti ka kaluar me status pasiv në DRT, nis praktikën për ndjekje nga Sektorët, hapat janë si më poshtë:
1.Sektorit të kontrollit në terren i cili mban akt konstatim në të cilin përcakton nëse ky subjekt ushtron aktivitet ose jo.
2. Sektori rregjistrimit pas paraqitjes se akt konstatimit nga sektori terrenit përcakton vlerën debitore nese ka.
3.DTTV nëse subjekti rezulton pasiv në DRT dhe nëse nuk ushtron aktivitet sipas akt konstatimit nga terreni bën ndryshimin e statusit në sistem nga aktiv në pasiv duke ndaluar faturimin për këtë subjekt.
4.Sektori i borxhit (ndjek të njëjtën praktikë si në rastin e paraqitur në pikën A).

C. Nga ndjekja rutinë e DTTV për statusin e subjekteve në Regjistrin Elektronik Online të QKB dhe korespodenca me institucionin.

DTTV kur konstaton se subjekti ka ndryshuar staus në QKB**,** nis praktikën për ndjekje nga Sektorët, hapat janë si më poshtë**:**

Hapat 1,2, janë të njëjtë me rastet më sipër,

Hapi 3. DTTV sipas statusit që rezulton në Regjistrin elektronik online të QKB (Aktiv, pezulluar, çregjistruar) dhe nëse nuk/ ushtron aktivitet sipas akt konstatimit nga terreni bën ndryshimin e statusit në sistemin e DTTV.

a. Për rastet kur nga Akt Konstatimi rezulton se nuk ushtron aktivitet dhe në Regjistrin Elektronik Online të QKB është Aktiv, pamvarësisht gjendjes debitore, *DTTV vendos statusin mbyllur në sistem dhe ndërpret ngarkesën me detyrime për taksa dhe tariva vendore për këtë subjekt në vazhdim. Vendosja e statusit mbyllur nuk e shfaq më këtë subjekt në raportin e detyrimeve vjetore që gjeneron sistemi*.

b. Për rastin kur nga akt konstatimi nga terreni rezulton me aktivitet DTTV bën përllogaritjen e detyrimit që nga momenti kur ka filluar të ushtrojë aktivitet dhe gjeneron faturën për njoftim në sistemin e DTTV.

Hapi 4. Sektori i borxhit në rastet me detyrim përpunon në format excel (regj i borxhit) informacionin e përfituar në formatin PDF nga sistemi dhe përgatit:

a. Evidencen për kontabilizim që i paraqitet Drejtorisë Ekonomike, Sektorit të Financës (*Vendosja e statusit mbyllur sipas hapit 3 nuk e shaq më këtë subjekt në raportin e detyrimeve vjetore që jep sistemi)*

b. Listat për njoftim Bllokimi në Bankat e nivelit të dytë.

Nga auditimi i procesit të mësipërm u konsatua se:

14. Titulli i gjetjes: Diskordancë midis Evidencat e DTTV dhe procesit të çregjistrimit të subjekteve.

Situata:

Nga auditimi i procesit të çregjistrimit dhe ndjekjes së subjekteve debitore nga DTTV u konstatuan se Evidencat e DTTV dhe raportet e sistemit të DTTV kanë mospërputhje midis tyre dhe detyrimet nuk pasqyrohen korrekt në Pasqyrat Financiare të Bashkisë.

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën 40 raste nga lista e bizneseve të cilëve ju është ndryshuar statusi në Sistem (nga Aktiv në mbyllur,pasiv,pezulluar). Në përzgjedhjen e rasteve është marrë në konsideratë trajtimi i të gjitha fashave të detyrimit (vlerat e vogla për shpeshtësinë e prezencës në listën analitike, vlerat e ndërmjetme dhe të larta për peshën në vlerën e totalit të analitikes.

Evidencat që u trajtuan për testim janë si më poshtë:

- Lista analitike e subjekteve që kanë mbyllur aktivitetin në Bashkinë Durrës për vitin 2022
- Gjendja faktike a detyrimeve ndër vite dhe statusit të subjektit në Sistemin e DTTV.
- Raporti i debitorëve gjeneruar nga sistemi i DTTV për vitin 2022
- Regjistri i Borxhit në formatin excel që përgatit Sektori i Borxhit

- Evidenca të përgatitura nga DTTV për Drejtorinë Ekonomike,Sektorit të Financës lidhur me kontabilizimin e detyrimit për subjektet debitore,
- Lista e njoftimeve për bllokim shume debitore në Bankat e nivelit të dytë

Nga shqyrtimi i evidencave mësipër u konstatua se :

Për të 40 rastet të cilat kanë ndryshuar status nga aktiv në mbyllur në sistemin e DTTV detyrimet nuk janë pasqyruar korrekt në të gjitha raportet e DTTV.

Nga auditimi u konstatua se nga 40 subjekte e marra për testim, 17 subjekte rezultojnë Aktiv në Regjistrin Elektronik të QKB dhe 20 subjekte rezultojnë me statusin çregjistruar ose pezulluar.

Vlera e detyrimit për subjektet e analizuara sipas evidencave të përgatitura nga DTTV për kontabilizimin e borxhit për vitin 2022 është = 0 lekë.

Vlera e detyrimit për subjektet e analizuara sipas Sistemit të DTTV ndjekja në vite është = 72,114,783 lekë.

Vlera e detyrimit për subjektet më sipër sipas raportit vjetor për subjektet debitore nga sistemi është = 4,020,611 lekë.

Vlera e detyrimit për subjektet mësipër sipas regjistrit të borxhit në format excel është = 29,638,437.41 lekë.

Vlera e detyrimit për subjektet mësipër sipas vlerës që mungon si rezultat i ndalesës së faturimit është = 13,164,247 lekë.

Vlera e detyrimit të subjekteve sipas evidencave të përgatitura nga DTTV për njoftim bllokimet në Banka për vitin 2022 është = 58,246,567 lekë.

1. Procesi i çrregjistrimit në Rregjistrin Elektronik të QKB bëhet pa u shlyer ose bllokuar vlera debitore e subjektit.
2. Mbyllja në sistemin e DTTV për këto subjekte bëhet si rezultat i çregjistrimit në QKB për shkak të vonesave në kthim përgjigjet e DTTV *(Në rast të mungesës së një konfirmimi në kohë nga DTTV, QKB proceson me çregjistrimin automatik*).
3. Statusi (mbyllur, pezulluar, pasiv) në sistemin e DTTV bën që ky subjekt mos të ngarkohet me detyrime për taksa dhe tarifa vendore dhe nuk pasqyrohet më në asnjë raport apo evidencë.
4. Pasqyrime të ndryshme të statusit të Subjekteve midis dy sistemeve (QKB-DTTV).


Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 5, 6, 10, 11,...; ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; ligji nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë i ndryshuar" neni 1, **neni 2** gërmat a, ç, **neni 5** gërmat a, d, dh, f, g, gj, h, i, **neni 6** pikat 1, 2, 3, neni 12 **gërmat** a, b, dh..., **neni 13** gërma b, neni 15, **neni 23** pika 1, 4, neni 26, neni 27,neni 28 pika 1, **neni 29**, neni 31, neni 40, neni 41, neni42, **neni 43 pika1, 2, 3, neni 44, neni 45,** neni 47 , **neni 48** pika 1, **neni 57** pikat 4**, 5**, **nenet 60, 61, 62**, neni 65 pika 5, nenet 68, 69 , **neni 70 pika 2, neni 71/1** pika 5 ; ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, nenet 28 –40, **neni 42**, **neni 43** gërma d, **neni 59** ; Manuali i Manaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhërin e MFE nr. 108 datë.17.11.2016; Udhëzimi nr. 26, datë 16.12. 2014**;** Udhëzimi nr. 655/1 datë 06.02.2007 "Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proceduriale dhe të raportimit të sistemit të takses vendore; **VKM nr. 945**, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores "*Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*", i ndryshuar; VKB - në nr.160, datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit"; të Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me UMF nr. 5 date 21.02.2022, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik"; Rregulloren e brendshme të Bashkisë Durrës.

Ndikimi/Efektiviteti: Informacion i pa saktë për pozicionin financiar të bashkisë.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.
Rëndësia: E lartë

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi për pjesët takuese sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme të institucionit personat si më poshtë: zv.Kryetarët e Bashkisë **z. G.K , z. E.J , z. R.M ,** Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore **z. L.D ,** Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit, **znj. V.Q ,** Drejtori i Drejtorisë Ekonomike **z. E.L ,** Drejtor i Auditit të Brendshëm **znj. M.P,** Përgjegjëse e Sektorit të Rregjistrimit të të Ardhurave znj A.K , Përgjegjësi i Sektorit të Manaxhimit të Borxhit dhe Apelimit **z. L.B ,** Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit të taksave dhe tarifave vendore **z. SH.H .**

Mbi auditimin për planifikimin dhe arkëtimin e taksës së pasurisë biznes (ndërtesës),

15. Titulli i gjetjes: Pasaktësi në planifikimin e taksës mbi pasurinë kategoria biznes.
Situata: Nga auditimi rezulton se, taksa e ndërtesës transferohet nga subjektet që ushtrojnë aktivet (B, C, D, E) te subjekte të cilat nuk e paguajnë në vite këtë detyrim ose të pronarë me të njëjtin konstatim (subjekti A) sipas skemës së mëposhtme:
Procesi i transferimit të këtij detyrimi rezulton me probleme sa i takon, akt konstatimeve të mbajtura nga inspektoret e verifikimit në terren.
-Pranë 2 qendrave tregëtare të kontrolluara zhvillojne aktivitet rreth 50 subjekte të cilat taksën e ndërtesës e kanë kaluar te personi që zotëron pronësinë e qëndrës. Këta persona janë debitor në këtë zë qysh prej vitit 2010 konkretisht H. D. 26,000,000 lekë dhe R. R. 9,961,000 lekë.
Praktikat shkresore për këtë proces janë jo të plota sa i përket dokumentacionit shoqërues sipas formatit të miratuar në kërkesën për aplikim (mungojnë dokumentacionet e noterizuara të çertifikatave të pronësisë, hartat treguese janë jo të qarta për sipërfaqen ku ushtron aktivitet subjekti që paraqit kërkesën, kontratat e qerasë në rast së janë në dosje nuk janë të rifreskuara sipas vitit "afati një vjecar ka përfunduar) .



Gjithashtu siç është e shpjeguar dhe më poshtë në disa raste subjekti A është qiradhënës i objektit të tij në disa subjekte (të tretë) të cilët nga shqyrtimi i praktikave përkatëse rezulton se ortaku i vetëm i subjekteve qiramarës është i njëjti pronar me atë qiradhënës. Pra pronari i subjektit qiradhës (subjekti A) në të njëjtin kohë ka në pronësi dhe subjektet e tjera qiramërrëse (B, C, D, E etj) ku një pjesë e tyre nuk rezultojnë të rregjistruar në sistemin e DTTV. Nga kjo skemë e dhënies me qira të objekteve subjekteve të tjera në pronësi të të njëjtit Ortak lind dyshimi i arsyeshëm i shmangies nga TVSH dhe tatimet si (subjekti i madh).
U bë verifikim me zgjedhje për dy raste:
Rasti nr. 1: Nga shqyrtimi i të dhënave që administrohen në sistemin e DTTV Bashkia Durrës dhe dokumentacionit të administruar në praktikën nr. 172175 për Subjektin Bedel Group konstatua se:
Të dhënat që administrohen në ekstaraktin historik të QKB nuk përputhen me të dhënat e paraqituara në akt konstatimin *nr. 0015309, mbajtur më datë 12.11.2019.* mbi të cilin bëhet rregjistrimi në sistemin DTTV konkretisht për:

- Përcaktimin e formës ligjore
- Përcaktimin e datës së rregjistrimit në QKB
- Përcaktimin e administratorit
- Përcaktimin e adresës së saktë ku tatim paguesi kryen aktivitetin ekonomik
- Përcaktimin e llojit të aktivitetit

Në Shkresën Nr.6762 Prot. Datë 08.11.2019 e përmendur në kthim përgjigjen Nr.6762/1 më datë 13.11.2019 të Sektorit të kontrollit **përcaktohet se ky subjekt rezulton i paregjistruar pranë DTTV** (informacioni mësipërm për këtë subjekt vjen si rezultat informacionit të konfirmuar nga Dega Rajonale e Tatimeve Durrës dhe jo si rezultat i akt konstatimit në terren) . **Sipas të dhënave të QKB** Subjekti B. group forma ligjore SHPK, Nipt L.....I rezulton i regjistruar me Datën e Regjistrimit 06/08/2018.

- Nuk ka informacion lidhur me penalitetet për mos rregjistrim në kohë nga ana e subjektit ose gjoba apo kamatevonesa.

Akt konstatimi me nr 0015309 mbajtur më datë 12.11.2019 për përcaktimin e sipërfaqes mbi të cilën përllogaritet detyrimi për taksën e ndërtesës dhe orientimi i sektorit të regjistrimit për të vazhduar përllogaritjen e këtij detyrimi bazuar në nenin 72 të ligjit 9920/ 2008 nuk është në përputhje me kuadrin rrregullator në fuqi. Ndërkohë që sektori i kontrollit në terren, në të dhënat që administrohen në QKB, pranë ASHK apo pranë Drejtorisë së Urbanistikës mund të marrin një informacion më të plotë për përcaktimin e sipërfaqes së objektit në fjalë për qëndrën tregëtare ku referon adresa.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar vullnetarisht nga subjekti pranë QKB u konstatua se sipërfaqet e pasurive nën administrim të subjektit qysh prej datës *14.12.2018* janë si më poshtë:

- Apartamente me nr 5/2650+ 1-2 vol 30 fq 75 zk 8515 me sipërfaqe 115. 70 m2.
- Njësi me nr 5/2650+1-N9 vol 30/q 71 zk 8515 me sipërfaqe 158.80 m2.
- Njësi me nr 5/2650+1-N7 vol 30 fq 69 zk 8515 me sipërfaqe 51.80 m2.
- Njësi me nr 5/2650+4-Nl vol 30 fq 193 zk 8515 me siperfaqe 78.50 m2.
- Njësi me nr 5/2650+4-N2 vol 30 fq 194 zk 8515 me siperfaqe 65.40 m2
- Njesi me nr 5/265o+l-Nll vol 30 fq 73 zk 8515 me siperfaqe 139 m2.
- Njesi me nr 5/265o+l-N10 vol 30 fq72 zk 8515 me siperfaqe 98.50 m2.
- Apartamente me nr 512650+1-6 vol 30/q 79 zk 8515 me siperfaqe 111.9 m2.

Sipërfaqja totale është njësi 592 m2, Apartament 239.5 m2 dhe jo 100 m2 sipas akt konstatimit me nr 0015309 mbajtur më datë 12.11.2019.

Në shkresën nr.2950 rregj DTTV datë 17.10.2022 , Lënda Aplikim i ri i subjektit për vitin 2022 drejtuar sektorit të rregjistrimit pranë DTTV.

- Rasti është trajtuar si subjek i ri për regjistrim.(ndërkohë subjekti rezulton në sistem si rregjistrim nga zyra)
- Mungon dokumentacioni i nënshkruar në formatin e miratuar të aplikimit bashkëngjitur
- Akt konstatimi është jo i plotë sa i përket përcaktimeve të përmendura më sipër dhe e trajton aplikimin vullnetar të subjektit për të përcaktuar sipërfaqet në të cilat zhvillon veprimtari si një proces të zhvilluar në terren.
- Përcaktimi i numrit të pasurisë nuk është ai që përmban certifikata e pronësisë . mungon specifikimi i llojit të pasurisë.
- Harta treguese e rregjistrimit nuk identifikon pasuritë e paraqitur nga subjekti.

Me Shkresën Nr.724 Prtot datë 28.10.2022 për sistemimin në sistem të taksës së ndërtesës për vitet 2018,2019,2020 është bërë sistemimi i kërkuar nga Drejtori i DTTV.

Nga verifikimi në Sistemin e manaxhimit të të dhënave të DTTV rezulton se më datë 11.11.2022 subjekti ka kryer pagesën e përllogaritur në sistem sipas akt konstatimit të fundit ky subjekt deri më dt 11.11.2022 ka rezultuar debitor për vitet 2018-2022 dhe ndaj tij nuk është marrë asnjë masë për mbledhjen e detyrimit.

Në praktikën nr. 172175 për Subjektin Bedel Group Shpk administrohet kërkesa drejtuar DTTV Bashkia Durrës, më datë 17.07.2023 sipas së cilës, Shoqëria B. Group me nipt L.....I dhe adresë **S.Z Xh.** – **Durrës** ,e cila ushtron Aktivitetin e dhënies me qera të ambienteve për qëllime Biznesi në lagja nr.17,Rruga Stefan Kaculini , pallati port Vie ë Kati II ,**Qëndra E Biznesit Maximum**, Ju bën me dije se ka paguar të gjithë tarifën e taksës mbi sipërfaqen për të gjithë vitet 2019 - 2023 për të gjithë sipërfaqen e ambjenteve që jep me qera. Kërkon të zhvishet nga tarifimi i dyfishtë me taksë mbi sipërfaqen Biznesi subjektet cilët ushtrojnë aktivitete tregetare në ambjentet e dhëna me qera nga ana e B.Group sh.p.k :

1. Nipt M.....F
2. Nipt L.....L
3. Nipt L.....M
4. Nipt L.....R
5. Nipt L.....E
6. Nipt M.....C
7. Nipt L.....L
8. Nipt M.....T
9. Nipt L.....T
10. Nipt M.....C
11. Nipt M.....V
12. Nipt L.....U

A. Nga verifikimi në QKB kjo kompani rezulton me adresë të vetme në " Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri Durrës ,Lagjja nr. 17, Rruga Stefan Kaculini, Pallati "Port Vie ë", Kati i dytë").

B. Subjekte të përmendura në kërkesë janë në administrimin dhe pronësinë e ortakut të vetëm të B. G. dhe janë me gjendje debitore në sistemin e DTTV.

C. 3 prej tyre rezultojnë të paregjistruar pranë DTTV

D. Nga DTTV konkretisht sektori i terrenit dhe sektori i manaxhimit të borxhit nuk është marrë asnjë masë për qartësimin e sipërfaqeve në administrim të B. Group apo situatës debitore te tij dhe subjekteve që administrohen prej tij.

Rasti nr. 2: Nga shqyrtimi i të dhënave që administrohen në sistemin e DTTV Bashkia Durrës dhe dokumentacionit të administruar në relacion mbi ngarkesën fiskale të vitit 2022 për Taksën e pasurisë të subjektit **F. C.0** u konstatua se:

Duke ju referuar Relacionit të mbajtur më datë 14.07.2014 në lidhje me identifikimin e pasurive dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet në ambientet e qëndrës tregëtare F. C.është konstatuar nje sipërfaqe totale 15,255.02 m2, nga të cilat janë të shpërndarë sipas pronarëve dhe subjekteve sipas tabelës së mëposhtme. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se në objektin **F.C.,** një nga pronarët R. R.nga vitit 2015 e në vazhdim nuk është ngarkuar me detyrimin sipas paketave fiskale të miratuara, nga përllogaritja e DTTV ky detyrim i pa ngarkuar kap vlerën e 1,867,416 lekë.

Pronari	**Sipërfaqe totale m^2**
Subjekti BGR	4,651.8
Subjekti C.	1,448.4
Pronari R.R.	1,173
Subjekti G. L.	3,107.86
Pronarë dhe Subjekte të ndryshëm	3,763.96
Tokë Shtet	1,110
Totali	**15,255.02**

Nga viti 2014 deri në vitin 2022 kanë ndodhur ndryshime të subjekteve dhe të pronarëve të cilët janë larguar nga aktiviteti, kanë ndarë pronën ose kanë shitur ambientet. Në lidhje me ngarkesën fiskale 2022 sipas të dhënave të sistemit është identifikuar se kjo qendër është taksuar për taksë ndërtesë për një sipërfaqe 11,234.36 **m^2** dhe pjesa e mbetur prej 2984.66 **m^2** nuk është arritur të identifikohet në sistem.

Më poshtë paraqitet një pasqyrë referuar ngarkesës fiskale të vitit 2014 dhe 2022 për **F. C.**

		Flagship Center	**Pronaret**				
NR	**Kodi**	**Nipt**	**Emer Mbiem. Pron.**	**Siperfaqe sipas relacionit m²**	**Siperfaqe 2022 sistem m²**	**Debi total**	**Debi takse ndertese**
1	7421	K…….G	R. R.BGR	4651.8	4562.1	9,566,674	7,969,199
2	96911	-	Familja Collaku	1080.7	1080.7	3,016,675	2,505,035
3	96909	-	R. R.	1173	0	1,055,700	938,400
4	100590	-	G.L.	3107.86	3107.86	-	-
5	97140	K……V	Pes. Alb.A.Sh.P.K	126	0	-	-
6	86040	K…..V	A. H.	157	0	-	-
7	97141		M. S.	70.6	70.6	-	-
8	97142		S. L.	64	64	-	-
9	97134		Ll. K.	138	0	69,000	55,200
10	97143	K……A	A.F.	143	71	-	-
11	97145		A. G.	250	0	125,000	120,000
12	92049	L……O	G. G.	188	188	-	-
13	97147	L……Q	K. N.	138	0	295,911	246,264
14	97146		N. M.	234.86	0	117,430	93,944
15	o998	K……R	I. J.	70.15	70.15	-	-
16	96647	…..	M.P.	93.6	93.6	226,106	101,088
17	97053	K……V	A.P.	93.6	0	-	-
18	90701	L…….O	N. M.	22.6	0	57,925	9,040
19	97148		I.A.	37	0	18,500	14,800
20	97149		A.K.F.Dh.	65	65	-	-
21	97150		E.B..M.B.	56	56	-	-
22	97151		A.K.S.k.	26	0	33,280	28,080
23	97137	L…….N	K.Y.	120	120	63,620	48,000
24	97152		A.M..A.M.	60	0	128,550	107,070
25	97153		E. Sh.	53.7	53.7	-	-
26	97154		Gj. M.	37	0	18,500	14,800
27	97155		F.K..I.K.	70.6	58	-	-
28	97156		Z. J.	60	60	187,567	155,670
29	97157		V. Ba.	65	60	187,511	155,482
30	97158		A.S.	60	0	15,070	12,150
31	97135		V. S.	39.5	39.5	114,791	94,485
32	97124		K. F.	85	0	374,500	68,000
33	86135		S.H.	23	23	-	-
34	94348		V. C.	367.7	367.7	1,008,802	444,916
35	96223	5050	Xh. K.	63.25	63.25	78,544	38,424
36	90807	5786	S. M.	67.5	67.5	-	-
37	95231	178742	M. H.	56	56	130,557	69,944
38	92940	177962	Y. K.	94.5	94.5	-	-
39	94384	178745	M. L.	62	62	-	-
40	100465		Sh. F.	60	60	-	-
41	7674	167956	Z. B.	97.5	97.5	156,176	135,198
42	178104		Z.B.	170	170	202,281	172,125
43	7183	149270	A.Sh.	70	70	14,175	14,175
44	90036		K. C.	60	60	27,650	12,150
45	95642		I.T.	60	0	-	-
46	96608		S. C.	80	0	-	-
47	94118		N. B.	250	0	-	-
48			K. L.	0	0	-	-
49	97152		A.M.	0	0	128,550	107,070
50			A. M.	0	0	-	-
51	137840	177277	A.D.	0	60	26,961	24,300
52			A. B.	0	0		
53	7437	K…..I	A.D.	0	27	-	-
54			A.dhe A.Dh.	0	0	-	-
55	133458	L…….M	B. H.	0	9	-	-
56	179654	L……..V	G. K.	0	50	180,299	79,600
57	89912	L…….V	Gj. C.	0	5	51,250	2,000
58	99679	L……P	K. M.	0	71.7	-	-
			Totali	**14,219.02**	**11,234.36**	**17,677,555**	**13,836,609**
			Tokë Shtet	1110			
			Sip. Totale m²	**15,329.02**	2,984.66		

Burimi i të dhënave: Bashkia Durrës

Nga sa më sipër konstatohet një debi e akumuluar për këtë subjekt në vlerën prej 17,677,555 lekë detyrim i akumuluar ndërvite e cila vjen si rezultat i mos pagesës së detyrimeve të disa nga subjekteve që ushtrojnë aktivitet në këtë objekt, në këtë vlerë taksa e ndërtesës kap vlerën e 13,836,609 lekë. Gjithashtu për këtë subjekt ka një diferencë prej 2984.6 **m²** të pa rregjistruar në sistemin e DTTV.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 20, neni 22/5..; në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ..neni 5, 8,...., neni 23 pika 4, 60, 61, 62, neni 71/1 pika 5, neni 73, neni 89, pika 2, neni 116; VKM nr. 132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës"; Udhëzimin nr. 17 datë 20.06.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve proceduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore "; VKB - në nr.160, datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit", pika A.1.1.1 "Taksa mbi ndërtesat".

Ndikimi/Efekti: Mosevidentimi i saktë i taksës së ndërtesës sjell mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi

Rëndësia: E lartë

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi për pjesët takuese sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme të institucionit personat si më poshtë: zv. Kryetarët e Bashkisë, **z. E.J , z. R.M ,** Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore **z. L.D ,** Përgjegjësi i Sektorit të Manaxhimit të Borxhit dhe Apelimit **z. L.B ,** Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit të taksave dhe tarifave vendore **z. SH.H .**

Masat e marra për vjeljen e detyrimeve:

16. Titulli i gjetjes: Nuk janë marrë masa për ndjekjen e etapave që parashikon legjislacioni në fuqi për vjeljen e detyrimeve.

Situata: Më poshtë janë paraqitur etapat që parashikon kuadri ligjor në fuqi për vjeljen e detyrimeve dhe parashkrimi i detyrimeve si pasojë e shmangies nga ndjekja e etapave që parashikon kuadri ligjor në fuqi për vjeljen e detyrimev. Mbështetur në nenin 89, pika 2, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",* procedura e detajuar e mbledhjes me forcë e detyrimit tatimor përcaktohen në Udhëzimin nr. 17 datë 20.06.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve proceduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ". (referuar më poshtë si U.M Nr. 17) Duhet me çdo kusht të ndiqen të gjitha hapat mbledhjes së detyrimeve të taksave e tarifave vendore. Ky udhëzim i rendit procedurat për mbledhjen me masa shtrënguese të detyrimeve tatimore në kreun III si më poshtë vijon :

Hapat dhe procedurat që ndiqen nga drejtoritë e taksave dhe tarifave vendore apo strukturat administrative tatimore të ngjashme me to, për mbledhjen e detyrimeve të papaguara të taksave e tarifave vendore:

U.M Nr. 17 pika 1 faqe 2: **Njoftimi dhe kërkesa për të paguar.**
U.M Nr. 17 pika 1/1.1 faqe 2 dhe 3 **Bllokimi i shitjes së aktiveve.**
U.M Nr. 17 pika 1/1.2 faqe 3. **Konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit.**
U.M Nr. 17 pika 1/1.3 faqe 3. **Kallëzimi për ndjekje penale.**
U.M Nr. 17 pika 2 faqe 4. **Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesit.**
U.M Nr. 17 pika 2 faqe 4 dhe 5. **Urdhëri i ekzekutimit**
U.M Nr. 17 pika 3 faqe 5. **Masa e sigurimit të detyrimit tatimor.**
U.M Nr. 17 pika 3.1.2 **Njoftimi për vendosjen e barrës hipotekore.**

U.M Nr. 17 pika 4 faqe 6-7 **Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë**
U.M Nr. 17 pika 5.1 faqe 9 . **E drejta e mbledhjes së detyrimit tatimor palës së tretë**
Mos ndjekja e etapave të përmendura më sipër dhe shtyrja në kohë e tyre bën që detyrimet e taksapaguesve të parashkruhen e si pasojë bëhet e pamundur vjelja e tyre.(Parashkrimi, Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë";
Neni 73, E drejta e administratës tatimore për të bërë vlerësim tatimor, si dhe e drejta e tatimpaguesit për të kërkuar tepricën kreditore); neni 100 Parashkrimi i së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi
Rëndësia: E lartë
Kriteri: Neni 73 , neni 89 pika 2, neni 100, i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008*, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë";* Udhëzimin nr. 17 datë 20.06.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve proceduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore".
Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore **z. L.D ,** Përgjegjësi i Sektorit të Manaxhimit të Borxhit dhe Apelimit **z. L.B ,** Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit të taksave dhe tarifave vendore **z. SH.H .**

Grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion të saktë dhe të qënësishëm për situatën e menaxhimit, identifikimit, regjistrimit dhe vjeljes së të ardhurave në DTTV Durrës për debin totale pasi ka pasaktësi në përcaktimet e sipërfaqeve që shërbejnë si bazë për përllogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat, gjithastu ka debitorë të identifikuar dhe aktiv për të cilat DTTV është mjaftuar vetëm me nisjen e njoftim bllokimit të shumës pranë bankave të nivelit të dytë dhe nuk ka marrë asnjë masë për ndjekjen e etapave që parashikon legjislacioni në fuqi për vjeljen e tyre.

TREGU AGROBUJQËSOR (Tregu fshatar/Markata)
Administrata e Tregut Agro - Bujqësor është në varësi të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Durrës.
Misioni i tij është të ofrojë kushtet optimale në zhvillimin e tregëtisë së lirë, për një shërbim bashkëkohor ndaj popullatës duke zbatuar detyrimet që rrjedhin nga dispozitat ligjore dhe normat higjeno – sanitare dhe normat e peshëmatjes.
Administratori është përgjegjës dhe ka në varësi të drejtpërdrejtë njësinë në fjalë, të përcaktuar në strukturën e miratuar nga Këshilli Bashkiak.
Administrata e tregut sipas funksioneve përkatëse:

- Kryen mirëmbajtjen për problemet e difekteve elektrike, hidraulike, saldaturë, muratori etj. Në raste të vecanta sipas kërkesave që parashtrohen në mbështetje të tij vihen dhe sektorët e mirëmbajtjes të ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë.
- Inspektori i financës arkëton të ardhurat mujore nga të gjithë tregtaret mbi bazën e kontratës dhe arkëtimet ditore për postet që mund të jenë ditore. Çdo ditë këto arkëtime i derdh në llogarinë bankare të Bashkisë. Raporton tek administratori në lidhje me të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e nevojshme për mirëmbajtjen e tregut.
- Rojet e pastruesit e tregut në zbatim të detyrave të percaktuara në kontratën e punës, kujdesen për higjenën dhe rregullin në ambientet ku tregëtohet.

Ky treg ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës me anë të Vendimit nr. 536, datë 01.05.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës të Qarkut të Durrësit". Për këtë pronë Bashkia Durrës **nuk disponon çertifikatë pronësie**. Nëpërmjet vendimit të përmendur më sipër **sipërfaqja e tregut që ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës është 2000 m^2 truall dhe 465 m^2 ndërtesë**.

Gjatë vitit 2021, e gjithë sipërfaqja e përmendur më sipër e cila është pjesë e Tregut Fshatar i është nënshtruar rikonstuksionit të plotë. Ky rikonstruksion ka zgjatur prej datës 12.07.2021-01.12.2021. Me shkresën nr. 77 prot.,datë: 01.12.2021, "Njoftim përfundim punimesh, drejtuar: AK Bashkisë Durrës.

Datën e fillimit të aktiviteteit e përcakton Proces Verbali për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave **mbajtur më datë 15.03.2022** bashkëngjitur shkresës nr. 2743/1 prot. datë13.04.2022 drejtuar Drejtorisë Ekonomike, për likujdim pas përmbushjes së kontratës me objekt: "Mobilimin në tregun fshatar (Faza II) konstatohet se komisioni i ngritur me urdhërin nr. 107, nr 238/7 prot. datë 03.03.2022, ka marrë në dorëzim mobilimin e ambjenteve të këtij tregu (*bashkëlidhur këtij dokumenti ilustrohet me foto pamje e ambienteve dhe sipas planimetrisë plani i vendosjes së tyre).*

Në paketë Fiskale të miratuar për vitin 2022, baza e taksës së përkohshme të tregut është në vlerën 50 lekë/m^2. (taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit). Tregëtarët që zhvillojnë aktivitet në tregjet që administrohen nga Bashkia Durrës ngarkohen me tarifa vendore gjithsej 3,500 lekë (tarifë pastrimi, tarifë gjelbërimi, tarifë ndriçimi). Në evidencat e drejtuar DTTV Durrës dhe të vëna në dispozicion të grupit të auditimit përllogaritja e deteyrimit bëhet sipas njësisë matëse "Banak". *Nuk u konstatua asnjë rakordim midis administratorit të tregut dhe DTTV, lidhur me gjendjen debitore të subjekteve për taksa dhe tarifa vendore në momentin e lidhjes së kontratave individuale*.

Sipas kontratës tip për tregëtarët që zhvillojnë aktivitet pranë tregut fshatar (AgroBujqesor) Bashkia Durrës jep me qera sipërfaqen **3 m^2 (duke përfshirë dhe banakun)** *(Përllogaritja bëhet sipas formulës 26 ditë x 3 m^2 =78 x 50 lekë /m^2 në ditë = 3,900 Lekë.).*

Bazuar në informacionit e marrë në dokumentacionin për specifikimet teknike "Banak për mobilimin e tregut fshatar" sipërfaqja e banakut paraqitet 1,75 m *0,9 m =1,575 m^2 **marrë parasysh nga konstatimi në terren dhe nga intervistat me administratorin e Tregut se një tregëtar ka dy banakë në dispozicion sipërfaqja për tregëtar vetëm për një banak është 1.575 m^2/banak* 2 banak për secilin tregëtar = 3.15 m^2** ndërkohë që hapësira funksionale në dispozicion të tregëtarit e cila është e domosdoshme për të shërbyer (përfshirë dhe sipërfaqen e banakut) **është minimumi 3.15m^2/banak*2 =6.3 m^2.**

Pra bazuar në faktin që një tregëtar ka në dispozicion 2 banakë me përmasat e specifikuara më lart (1.75m x 0.90cm secili) dhe në formulën e përllogaritjes të përcaktuar në kontratën tip të miratuar mund të themi se pagesa për një subjekt që ushtron aktivitetin në këtë treg duhet të jetë 26 dite x 6.3 m^2 = 163.8 x 50 lekë m^2 në ditë = **8,190 lekë në muaj.**

Bazuar në informacionin e marrë në intervistat me stafin e administratës së tregut, evidencat me DTTV dhe Konfirmimit me E- mail rezulton se:

- Gjatë vitit 2022 tregetarët ambulantë kanë zhvilluar aktivitet pranë Tregut Fshatar por vjelja e detyrimeve për sipërfaqen në përdorim (banaku) ka filluar pas datës 01.08.2022.
- Në Kufi me Tregun Fshatar por me komunikim midis tyre, zhvillon aktivitet të njëjtë me tregun Agrobujqësor OE "A " Shpk (me Nipt K.....M). Ky aktivitet zhvillohet në ambientin e marrë me qera *bazuar në Kontratën e Qirasë të vitit 2014, që është në dosjen e subjektit, të lidhur ndërmjet F. S. (Qiradhënës) dhe F. Z. (Qiramarrës) ku përcaktohet se jepet qira trualli 298 m^2.*) Sipas çertifikatës së pronësisë të përmendur në kontratë kjo pasuri është e llojit "Truall″ ndërkohë në sistemin e taksave është ngarkuar si "Ndërtesë″.

Nga verifikimi në terren në prezencë edhe të Administratorit të tregut konstatohet se në këtë ambient zhvillojnë aktivitet subjekte për të cilët nuk ka informacion të jënë të rregjistruar as nga kontrolli i terrenit as nga administata e tregut dhe as nga DTTV. Ky ambient rezulton në sistemin e DTTV thjesht si adresë sekondare e OE "A " Shpk, (me Kod në sistem 176478) dhe jo treg Agrobujqësor .

- OE “A ” Shpk, nëpërmjet kontratës së qerasë nr. 8077, prot., datë 07.07,2022, lidhur midis Bashkisë Durrës dhe OE “A ” Shpk, është palë në kontratën për të marrë me qera ambient brenda hapësirës së tregut bujqësor dhe zhvillon aktivitetin market me tabelë identifikuese “M.L.” dhe jo “A ” Shpk.

-Ambienti 49.2 m^2 në administrim të tregut agrobujqësor i cili ka pas marrdhënie të mëparshme kontraktuale midis Bashkisë Durrës dhe OE “A.” Shpk, nuk është në funkson dhe as paguhet qera pasi administrohet ende nga OE “A.” Shpk, me administrator z. B. T.

Sipas evidencës për të ardhurat e vitit 2022 dhe konfirmimit me email vënë në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se:

- **Vlera totale e arkëtuar për vitin 2022 ku përfshihen dhe të ardhura për vitin 2021 është 5,413,200 lekë.**

Vlera e arkëtuar për llogari vetëm të vitit 2022 është 5,175,300 lekë dhe i përket periudhës (Gusht – Dhjetor 2022) (një **kapacitet zënie mesatar mujor** prej 265 banakësh/muaj për periudhën Gusht – Dhjetor 2022.

Përllogaritja 5,175,300 (vlera e arkëtuar Gusht –Dhjetor 2022) / 3900 (vlera e detyrimit mujor për një subjekt) = 1327(subjekte total) / për 5 muaj (Gusht – Dhjetor 2022)= 265.4 banakë për 1 muaj.

- Vlera e arkëtuar për periudhën **15.03.2022** (data e përfundimit të mobilimit**) deri më 01.08.2022 (**data e fillimit të mbledhjes së detyrimeve për tregëtarët që ushtrojnë aktivitet pranë tregut**) është zero lekë.**

Për periudhën objekt auditimi në tregun fshatar Agrobujqësor, ushtrojnë aktivitet subjekte të cilët tregëtojnë prodhime agrobujqësore dhe subjekte të cilët kanë marrë ambiente me qera brenda këtij tregu nga Bashkia e Durrësit. si më poshtë:

- Banakë fruta perime
- Banakë bulmet
- Banak peshku
- Ambiente të dhëna me qera nga Bashkia Durrës, Drejtoria Ligjore, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit :

- kontratat individuale të subjekteve që shërbejnë në banak
- kontratave e lidhura nga subjekte me Bashkinë Durrës
- planimetrinë e objektit dhe vendosjes së aktiviteteve
- informacionin e marrë nga sektori i kontrollit në terren për kontrollet e zhvilluara në këtë treg

Veprimtarinë e dokumentuar nga administrata e tregut u konstatua se:

17. Titulli i gjetjes: Mosrakordimi midis DTTV-së dhe administratës së tregjeve Bashkia Durrës

Situata:

- Bashkia Durrës nuk disponon çertifikatë pronësie për këtë investim. Nëpërmjet vendimit të përmendur më sipër përcaktimi për sipërfaqen e tregut që ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës, është ende 2,000 m^2 truall dhe 465 m^2 ndërtesë dhe jo objekti i rikonstruktuar “Tregu Agrobujqësor“.
- Tregu agrobujqësor edhe pse ka funksionuar si treg qysh prej datës 15.03.2022 (konfirmuar nga informacioni bashkëngjitur proces verbalit datë 15.03.2022 dhe pyetësoreve me personelin që administron tregun agrobujqësor ka një vlerë të pa arkëtuar për 265 tregëtarë (**kapacitet zënie mesatar mujor**) x 3,900 lekë/ muaj =**1,033,500** për muaj x 4.5 muaj (15/03/2022-01/08/2022)= **4,650,750 lekë,** të ardhura të munguara si pasojë e mos arkëtimeve të detyrimeve për zënien e hapësirës në tregje.

- Një subjekt që ushtron aktivitet pranë tregut agrobujqësor, ka në dispozicion dy banakë me përmasa 1.75cm x 90 cm secili. Hapësira funksionale në dispozicion të tregëtarit e cila është e domosdoshme për të shërbyer në banak **është minimumi sa siperfaqja e banakut pra 1,75 m x 0.9 m x2 = 3.15 m^2 për një banaknë përdorim x 2 banak= 6.3 m^2 .**

Vlera e munguar në të ardhurat e Bashkisë Durrës si pasojë e përllogaritjes me banak dhe jo me m^2 sipas Paketës Fiskale të miratuar llogaritet si më poshtë:

265 taksapagues (kapacitet zënie mesatar mujor) x 3.15 m^2 (diferenca në sipërfaqe) = 834.75m^2 x26 ditë = 21,702.20 x 50 lekë /m^2 në ditë=1,085,110 lekë në muaj,

Vlera e munguar si pasojë e mosrespektimit të përcaktimeve të paketës fiskale për sa i përket përllogaritjes së detyrimeve për hapësirat në përdorim (për periudhën kohore nga data 15.03.2022 deri në datën 31.12.2022; 1,085,110 lekë në muaj x 9.5 muaj) **është në vlerën 10.308.545 lekë.**

Ambiente të dhëna me qera nga Bashkia Durrës, Drejtoria Ligjore, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.

Në ndërtesat brenda këtij tregu rezulton se ushtron aktivitet:

1. OE "A " Shpk, ushtron **aktivitetet si më poshtë në adresën lagjja nr. 12**:

A: Aktiviteti 1: Supermarket me tabelë identifikuese "M. L.dhe jo"A " Shpk.

OE "A " Shpk (me Nipt K.....M) me kontratën e qerasë nr.8077 prot., datë 07.07.2022 lidhur me Bashkinë Durrës, ka marrë me qera ambient brenda hapësirës së tregut agrobujqësor **sipërfaqen 147 m^2** ku zhvillon këtë aktivitet, n**uk ka gentplan bashkëngjitur kontratës.**

Sipas akt konstatimeve në terren Kodi 0587 L.12 Rr.K.Kazanxhi Rajoni 3, me administrator F. Z., Taksë pasurie J. S. Sipas Akt Konstatimit nr. 007952 mbajtur më datë 03/03/2015 të Sektorit të Kontrollit nga inspektorët A.H. dhe E. Gj,, me shkresë përcjellëse me nr.1008/1 datë 05.03.2015 nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit SH.H , në këtë adresë ushtrohet aktiviteti ″Supermarket″ **me sipërfaqe 240 m^2**).

Sipas dokumentacionit të rregjistruar në praktikat e dokumentuara pranë DTTV rezulton:

- Kontratë e qirasë të vitit 2011, të lidhur ndërmjet qiradhënësit z. Jorgji Spiru dhe qiramarrësit z. F, Z,, ku përcaktohet se jepet qira ndërtesa 240 m^2.
- Kontratë e qirasë nr. 2113, datë 16.04.2014 e lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe qiramarrësit z. F, Z, për një sipërfaqe 147 m^2, për një ambjent **të llojit "Magazinë Frigoriferike**″.
- Kontratë e qirasë nr.8077 prot.,datë 07.07.2021 lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe qiramarrësit OE "A " Shpk, me administratore znj. D. Z.
- Kontratë e qirasë nr. 8392 prot., datë 17.10.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe qiramarrësit OE "A " Shpk, me administratore znj. D. Z., për dhënien me qira të ambjentit magazinë pjesë e pronës tregu fshatar me pakicë, me sipërfaqe 147 m^2, nga ku 143 m^2 ndërtesë me afat 1 vjeçar. Vlen të theksohet se administratorja e OE "A " Shpk, ka mbajtur rregullisht korrespondencë me sektorin e Administrimit të Pronave në lidhje me qiramarrjen e ambjentit me sipërfaqe 143 m^2.

Sipas informacionit nga Administrata e Tregut Agrobujqësor rezulton se ky aktivitet zhvillohet në një sipërfaqe 300 m^2 .

Me rikonstruksionin e tregut sipërfaqja ku zhvillohet aktiviteti nr. 1 (Supermarket) është pjesë e planimetrisë dhe e investimit.

Sipërfaqja nga të dhënat e paraqitura në akt konstatimet me metodën alternative, informacionit në sistem dhe informacionit nga administrata **rezulton e ndryshme** dhe e papërcaktuar. Nuk ka dokumentacion që vërteton sipërfaqen, por vetëm informacioni në kontratat e qerasë pa gentplan bashkëngjitur.

B. Aktiviteti 2: Sipas Akt konstatimit nr. 0018130 mbajtur nga inspektorët J. H. dhe A. L. më dt. 16.11.2020, me shkresë përcjellëse nr. 3129/1 datë 19.11.2020 nënshkruar nga

përgjegjësi i sektorit SH.H , OE "A " Shpk nuk ka aplikuar për regjistrim të aktivitetit dhe është rregjistruar me 250 m^2 si rregjistrim nga zyra me metodën alternative.
Sipas dokumentacionit të rregjistruar në praktikat e dokumentuara pranë DTTV rezulton se **Kodi në sistemin e DTTV 176478 dhe adresë L.12** Rr.K.Kazanxhi Godina nr.405, me administrator D. Z.Subjekti nuk ka aplikuar për regjistrim, por është regjistruar sipas akt konstatimit "pv 3129/1, 19/11/20, ak 0018130, 16/11/20, parkimi k.10272" me metodën alternative **me 250 m^2** dhe me specifikimin **adresë sekondare, sipërfaqe 250 m^2**
C. Aktiviteti 3. Sipas Akt Konstatimit të Sektorit të Kontrollit me sipërfaqe 298 m^2. Akt Konstatimi mban nr. 007953 datë 03.03.2015 mbajtur nga inspektorët A. H. dhe E. Gj. Edhe në Kontratën e Qirasë të vitit 2014 që është në dosjen e subjektit, të lidhur ndërmjet F.S. (Qiradhënës) dhe F. Z. (Qiramarrës) përcaktohet se jepet qira trualli 298 m^2. Sipas çertifikatës së pronësisë kjo pasuri është e llojit ″Truall″ ndërkohë në sistemin e taksave është ngarkuar si ″Ndërtesë″. Kodi 96468 L.12 Rr.K.Kazanxhi te tregu fshatar me administrator F.Z., Taksë pasurie F. S. **Në këtë adresë ushtrohet aktiviteti ″Treg Agrobujqësor**″.
Sipas informacionit nga Administrata e Tregut Agrobujqësor rezulton se ky aktivitet: zhvillohet në një sipërfaqe afërsisht 350 m^2 dhe brenda kësaj sipërfaqe zhvillon aktivitet tregu fruta perime që administrohet nga OE "A " Shpk, **me 73 banakë**. Ky treg ka funksionuar edhe gjatë periudhës së rikonstruksionit.
Nuk ka akt verifikim në terren ku të përcaktohet qartë lloji i aktivitetit dhe sipërfaqja në të cilën ushtrohet ky aktivitet.

18. Titulli i gjetjes: Procedura jo e rregullt në dhënien me qira të pasurive shtetërore si dhe monitorimi dhe zbatimi i kontratave të qiradhënies.
Situata: Kontrata e qirasë lidhur midis Bashkisë Durrës dhe OE "A " Shpk nuk shoqërohet me gentplanin përkatës ku të përcaktohet sipërfaqja konkrete që jepet me qera.
Objekti i kontratës, është dhënia me qera e ambientit magazinë frigoriferike pjesë e aseteve të tregut fshatar me pakicë, me sipërfaqe 147 m^2 (nga kjo sipërfaqe ndërtimi 143 m^2) sipas genplanit bashkëngjitur. Nuk ka gentplan bashkëngjitur kontratës.
Qëllimi i kontratës është dhënia në gëzim të përkohshëm i ambientit të përcaktuar në nenin 1, për tu përdorur si magazinë frigoriferike për tregëtimin e produkteve të mishit me shumicë dhe produkteve blektorale.
Nga Akt konstatimet e sektorit të terrenit, informacioni në sistemin e DTTV dhe, informacioni i Administratës së tregut rezulton se **sipëfaqja është mbi 200 m^2**, subjekti nuk ka respektuar kontratat e lidhura me Bashkinë Durrës sa i përket përcaktimeve në nenin 2, pika 2.1 qëllimin i përdorimit të kontratës.
Diferenca në sipërfaqen e deklaruar sipas informacioneve të administruara në DTTV me Sektorin e pronave publike dhe menaxhimit të aseteve nuk është në përputhje me nenin 1 pika 1.1 të kontratave të lidhura midis palëve.
Sipërfaqja në m^2 është shumë e rëndësishme sa i përket:
- Përcaktimit të vlerës për tu arkëtuar nga dhënia në përdorim e këtij aseti.
- Përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore.

Bazuar në ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 3, **Prona që u transferohen njësive të qeverisjes vendore, dh) Pronat që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.**
Duke patur parasysh që tregu në fjalë është "Treg Agrobujqësor, kjo sipërfaqe prone ka kaluar në pronësi të bashkisë Durrës në mbështetje të pikës dh) të nenit të mësipërm si *Pronë që përdoret për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit. Në çdo rast pronat publike duhet të përdoren për të siguruar maksimumin e përfitimeve publike ose mbrojtjen e një karakteristike të veçantë të pronës.*

Prona e këtij tregu është e destinuar për produkte agro -bujqësore jo për veprimtari tregëtare të ndryshme nga karakteristika e pronës.

Dhënia me qira duke shmangur procesin e konkurimit e një pjese të kësaj prone tek subjektet private cënon barazinë e tregëtarëve që operojnë në tregun Agrobujqësor, favorizon një subjekt tregtar dhe çon në konkurencë jo të ndershme kundrejt bizneseve të ngjashme me të.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me **nenet 801-825 të kodit civil, Neni 812** ku cilësohet ..Qiramarrësi duhet: *1. të marrë në dorëzim sendin dhe ta përdorë për qëllimin që është parashikuar në kontratë dhe, kur nuk është parashikuar, sipas qëllimit që del nga natyra e sendit*; **Vendimin Nr. 54, Datë 5.2.2014** Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurës e të Mënyrës të Dhënies te Qira, Enfiteozë apo Kontrata të Tjera të Pasurisë Shtetërore (Ndryshuar Me VKM Nr.735, Datë 5.11.2014, Nr.445, Datë 20.05.2015, Nr.992, Datë 9.12.2015, Nr.299, Datë 20.04.2016, Nr.606, Datë 31.08.2016, Nr.693, Datë 5.10.2016) (I Përditësuar) ku cilësohet,.. I. Pasuritë Shtetërore Që Jepen Me Qira Ose Enfiteozë, Kriteret E Konkurrimit, E Drejta, Kompetencat Dhe Afatet 1. **Pasuritë shtetërore u jepen të tretëve, duke u transferuar të drejtën e përdorimit me qira ose enfiteozë, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.** 5. Përjashtohen nga konkurrimi: **a) dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m^2, të cilat jepen me afat deri në1 vit;** 7. Dokumentacioni për marrjen me qira, që paraqesin konkurrentët, i dorëzohet komisionit në orën e hapjes së konkurrimit dhe përmban.. d) NUIS-in dhe **vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;**. Ky dokumentacion duhet të plotësohet edhe në rastet kur objekti jepet me qira pa konkurrim.

Si konkluzion, nga mosrakordimi midis DTTV-së dhe administratës së tregjeve Bashkia Durrës ka një mungesë të ardhurash në vlerën **10.308.545 lekë** lekë. Kjo mungesë vjen nga disa arsye:

- Shfrytëzimi i posteve të shitjes në treg nga një numër më i vogël tregtarësh sa ajo e parashikuar në paketë fiskale.
- Tregu është parashikuar me 560 poste shitje me nga 3 m^2 ku përfshihet banaku dhe siperfaqja funksionale ndërkohë administrata e tregjeve ka lidhur kontratë me 280 poste shitje pasi në siperfaqen e miratur prej 3 m^2 për çdo kontratë kanë perfshirë vetëm banakun dhe jo sipërfaqen funksionale të tyre, duke keq menaxhuar sipërfaqen e tregut që kanë në dispozicion dhe sjell si pasojë mungesë të ardhurash për Bashkinë Durrës.
- Dhënia me qira duke shmangur procesin e konkurimit e një pjese të kësaj prone tek subjektet private cënon barazinë e tregëtarëve që operojnë në tregun Agrobujqësor, favorizon një subjekt tregtar dhe çon në konkurencë jo të ndershme kundrejt bizneseve të ngjashme .

Kriteri: Nenet 801-825 të kodit civil, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; VKB nr.160, datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit", pika A.2.6.3 "*Tarifa për sipërfaqe të tregut në administrim të Bashkisë Durrës*", Vendimin Nr. 54, Datë 5.2.2014, "Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurës e të Mënyrës të Dhënies te Qira, Enfiteozë apo Kontrata të Tjera të Pasurisë Shtetërore", i ndryshuar, Vendimin nr. 29, datë 09.04.2021 e ndryshuar sipas Vendimit nr.69 datë 05.08.2022 "*Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës", "*Sektori i pronave publike dhe menaxhimit të aseteve", pika e cila citon përgjegjësitë dhe

Ndikimi/Efektiviteti: Moszbatimi i kuadrit ligjor në fuqi sjell mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për verifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregjet të cilat administrohen nga bashkia. Të llogaris detyrimet për të gjitha subjektet që nga data kur ka filluar shfrytëzimi i këtij tregu, bazuar në VKB nr.160, datë

23.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”, pika A.2.6.3 “*Tarifa për sipërfaqe të tregut në administrim të Bashkisë Durrës*”.
Për sa më sipër ngarkohen, me përgjegjësi:

1. Zëvendëskryetar i Bashkisë Durrës – R.M , E.J
2. Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore – L.D
3. Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit në DTTV – SH.H
4. Specialist (Inspektor) i Sektorit të Kontrollit – A.L., J. H., E.Gj., A. H.
5. Administrator i Tregut AgroBujqësor – F. K.
6. Inspektore e Taksave pranë Tregut Agrobujqësor – M. P.
7. Përgjegjëse sektori i pronanave I.B.
8. Drejtor i Drejtorisë ligjore A. I.

Konkluzioni i Përgjithshëm mbi Situatën Debitore nga Taksat dhe Tarifat Vendore:
Borxhi tatimor progresiv i kontabilizuar në pasqyrat financiare më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 165,047,159 lekë. Ndërkohë që vlera e pasqyruar në kontabilitet nuk është e paraqitur në formë të saktë dhe mbi bazën e dokumentacionit justifikues përkatës për arsye se, janë konstatuar pakësime të debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore pa dokumentacionin përkatës ligjor në vlerën 630,083,524 lekë si dhe është konstatuar mosrakordim i të dhënave ndërmjet regjistrimeve në kontabilitet, sistemit elektronik të mbajtjes së të dhënave për taksave dhe tarifave vendore dhe dokumentacionit justifikues. Në kushte të tilla grupi i auditimit e ka të pa mundur të dalë me një opinion përfundimtar mbi gjendjen e borxhit vjetor dhe atë progresiv.

Për sa është trajtuar në Projektraportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 946/7 prot, datë 08.02.2024, administruar nga KLSh me nr. 765/16prot, datë 09.02.2024, nga Zv. Kryetaret e bashkisë z. G.K , z. E.J , z. R. M., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.
Pretendimet e Subjektit:
Bazuar në Projektraportin e auditimit, nga funksionarët e Bashkisë Durrës janë dërguar pretendimet për pjesën e përgjegjesive të përcaktuara si rezultat i gjetjeve gjatë auditimit të ushtruar. Për këto përgjegjësi observuesit pretendojnë se nuk janë persona përgjegjës.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Referuar pretendimeve të dërguara nga observuesit, rezulton se, nuk paraqitet asnjë dokumentacion, fakte apo prova ligjore të cilat kundërshtojnë gjetjet e grupit të auditimit pasi, përgjegjësitë e funksionarëve të Bashkisë Durrës, janë evidentuar gjatë hartimit të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe observasioneve për këtë pikë. Kjo situatë nuk e ndryshon opinionin e grupit të auditimit për përgjegjësitë e pretenduesve në lidhje me shkeljet e konstatuara për menaxhimin dhe administrimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.
Sa më sipër për arsyet e sipërpërmendura, pretendimet nuk merren në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të auditimit.

Për sa është trajtuar në Projektraportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 946/2 prot, datë 01.02.2024 nga znj. A. M. me objeksionet si më poshtë:
Pretendimet e Subjektit:
Per sa shkruhet sqarojmë:
Për shkeljet e konstatuara në lidhje me dhënien me qira të objekteve në pronësi të Bashkisë Durrës dhe nuk kam qënë asnjë herë pjesë e hartimit të kontratave dhe monitorimit për dhënien me qira të tyre.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Për sa i përket pretendimeve të observuesit sqarojmë se observacioni merret në konsideratë dhe bëhen reflektimet përkatëse në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve

Pika 2.6. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve dhe pika 3.4 Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

U shqyrtua dokumentacionit me zgjedhje i procedurave të ndjekura nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve Bashkia Durrës, në lidhje me procedurat e dhënies me qira mbi 200 m^2 sipërfaqe objekte të pasurisë shtetërore në zbatim të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" nga ku rezultoi se :

-Në 9 raste, nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve dhe nga Drejtoria Juridike nuk është Monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë në lidhje me mos pagesën e qirasë për sipërfaqen e objekteve pasuri shtetërore ***duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumen totale prej*** **939,832 lekë,** në kundërshtim me kreun VI pika 1 të VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar.

-Në 7 raste nga Bashkia Durrës, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve Bashkia Durrës dhe Administrativ e Ndërmarrjes BGT, është lejuar të ushtrohet aktivitet nga subjekte private në objekte pasuri shtetërore pa Kontratë-Qiraje.

-Në 7 raste nga Qiradhënësi Bashkia Durrës, (Administrata e Ndërmarrjes BGT) nuk është njoftuar me shkrim Qiramarrësi, për dorëzimin e objektit për "Zgjidhje Kontrate" pasi është mbyllur afatit i kontratës së qirasë për sipërfaqen e objektit të pasurisë shtetërore.

-Në të gjitha rastet, nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve nuk është kërkuar bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, për të kërkuar monitorim dhe konsulencë juridike për mosmarrëveshjet që kanë lindur nga zbatimi i kontratave apo marrëveshjeve në rastet e konflikteve civile, nga mosrespektimi korrekt i tyre.

-Nga Sektori i pronave publike dhe menaxhimit të aseteve për periudhen janar-dhjetor 2022 është aplikuar për regjistrim në DV ASHK Durrës vetëm 3 pasuri që janë vendosur në dispozicion të drejtorisë së urbanistikës për dhënien e lejes së zhvillimit për objektet të dëmtuara nga tërmeti, ndërsa për (asetet) pasuritë e tjera vazhdojnë të mos jenë të regjistruara në regjistrin publik në DV ASHK Durrës, që do të thotë se nuk ka kërkesë për aplikim "Regjistrim Akti" pajisje me certifikatë pronësie dhe kopje kartele dhe harte.

-Nga "Sektori i pronave dhe aseteve" në Bashkinë Durrës, janë të administruar vetëm 2 lista të pronave të miratuara me VKM dhe konkretisht ajo e Bashkisë Durrës e cila është e miratuar me VKM nr. 536, datë 1.5.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës" dhe e ish-Komunës Ishëm e miratuar me VKM, nr. 284, datë 12.3.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Ishëm, të Qarkut të Durrësit", ***ndërsa Njësitë e tjera Administrative që varen nga Bashkia Durrës janë me listë paraprake, jo përfundimtare të pa miratuar me VKM.***

<u>Pasuritë me listë të miratuara me VKM dhe me listë paraprake të pa miratuara janë si më poshtë:</u>

Njesite Administrative	Pronesi	Perdorim	Totali për Njesi
Bashkia Durrës	938	221	1159
Njësia Administrative Ishëm	115	29	144
Njësia Administrative Katund I Ri	81	197	278
Njësia Administrative Rrashbull	61	0	61
Njësia Administrative Sukth	423	7	430
Njësia Administrative Manzë	91	39	130
Totali	**1709**	**493**	**2202**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar, si dhe të VKM-së, nr. 536, datë 1.5.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës, të Qarkut të Durrësit" për pronat që janë të regjistruara dhe që janë të pajisur me certifikatë pronësie, Bashkia Durrës ka lidhur kontratë qiraje me 19 subjekte private, për objektet me sipërfaqe nën 200 m^2 dhe për sipërfaqe mbi 500 m^2, nga këto kontratë qiraje me afat 1-vjeçar për objektet me sipërfaqe nën 200 m^2 janë 13 kontrata ndërsa kontratë qiraje me afat mbi 5-vjeçar për objektet me sipërfaqe mbi 500 m^2 janë 6 kontrata.

Kontratë qiraje me afat 5-vjeçar për objektet me sipërfaqe mbi 500 m^2 janë lidhur nga viti 2017 dhe në vijim.

Pasqyra Kontratë-Qiraje për sipërfaqe mbi 200 m^2.

Nr.	Qiramarrësi	Objekti i dhënë me qira	Aktiviteti i subjektit	Data e lidhjes kontratës	Sip. m^2	Afati i qirasë	Detyrimi mujor në lekë	Detyrimi i prapambe. në lekë
1	C.P.	URT	Rrobaqepsi	01.9.2020	602	10	117,000	0
2	ICP I. & P.	URT	Servis Mak.	01.9.2020	251	5	45,000	45,000
3	U.	URT	Fasoneri	30.7.2019	930	8	1 E	0
4	T.P.	Shkollë	Tenis	9.11.2020	1420	5	25,810	0
5	Alzeta Shpk	BGT	Duroalumin	03.4.2017	585	3	56,104	336,624
6	Zeus-Al	NPA	Mag. Boje	04.9.2018	818	5	85,116	0
TOTALI								**381,624**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit me zgjedhje i procedurave të djekura nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve Bashkia Durrës në lidhje me procedurat e dhënies me qira mbi 200 m^2 sipërfaqe objekte të pasurisë shtetërore në zbatim të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" rezultoi se :

-Subjekti "A." Sh.p.k. (Qiramarrës) rezulton të ketë lidhur kontratë qiraje me datë 03.4.2017 me afat 3-vjeçar me sipërfaqe objekti 585.2 m^2 nëpërmjet procedurës së konkurrimit për ushtrimin e aktivitetit "Duralumin" me qiradhënësin Bashkia Durrës. Qiraje mujore në bazë të nenit 6 të kontratës, është 112,208 lekë, që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve për pjesën 50 % e detyrimit mujor (56,104 lekë) dhe 50 % e detyrimit mujor (56,104 lekë) nga Administrata e Ndërmarrjes së Tregtisë me Shumicë (BGT).

Nga auditimi rezulton se qiramarrësi nuk ka paguar qiranë e 6 muajve në shumen prej 336,624 lekë, duke mos respektuar nenin 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 03.4.2017, për shumën 56,104 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit për pjesën takuese.

Në bazë të kontratës, qiramarrësi detyrohet të paguajë detyrimin mujor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në nenin 5 pika 5.7, ku qiramarrësi për çdo ditë vonesë, do të paguajë një kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, që do të thotë se nga qiradhënësi Bashkia Durrës (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve) nuk ka përllogaritur kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore prej 56,104 lekë.

Kontrata e qirasë datë 03.4.2017 në nenin 5 "Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit" pika 5.3 qiramarrësi ka të përcaktuar se për çdo ditë vonesë do të paguajë një kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, që do të thotë se nga qiradhënësi (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve) nuk ka përllogaritur kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore prej 56,104 lekë.

Nga qiramarrësi nuk është respektuar neni 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 03.4.2017, për shumën 56,104 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit, që do të thotë se nga qiramarrësi nuk është paguar qiraja e dy muajve në shumen prej 336,624 lekë,
Nga Administrata e Ndërmarrjes së Tregtisë me Shumicë (BGT) që e ka në inventar pasurinë objekt qiraje që ka të drejtë të kontrollojnë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate, nuk është respektuar nenit 7.1 "Zgjidhja e Kontratës" ku citohet se "Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj kontrate", që do të thotë se ka 3 vjetë që subjekti **"A." Sh.p.k**, me përfaqësues A.Z. vazhdon aktivitetin pa pasur një kontratë qiraje për objektin me sipërfaqe 585.2 m^2.

Konkluzion: Nga Qiradhënësi Bashkia Durrës, (Administrata e Ndërmarrjes BGT) nuk është njoftuar me shkrim Qiramarrësi **"A." Sh.p.k**, **me përfaqësues A. Z.**, për dorëzimin e objektit me sipërfaqe 585.2 m^2 me aktivitet "Duralumin", por vazhdon aktivitetin pa një kontratë qiraje edhe pse rezulton ***debitor në shumën prej 336,624 lekë, duke shkaktuar të ardhura të munguara në Bashkinë Durrës,*** në kundërshtim me nenin 7.1 "Zgjidhja e Kontratës" e Kontratës së Qirasë lidhur në datë 03.4.2017 me afat 3 vjeçar,

-Subjekti ICP I. & P.(Qiramarrës) rezulton të ketë lidhur kontratë qiraje me datë 01.9.2020 me afat 5 vjeçar me sipërfaqe objekti 251 m^2 për aktivitet biznesi "Servis makinash" me qiradhënësin Bashkia Durrës. Qiraje mujore në bazë të nenit 6 të kontratës, është 45,000 lekë, që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.
Nga auditimi rezulton se qiramarrësi nuk ka paguar qiranë në shumen prej 45,000 lekë, duke mos respektuar nenin 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 01.9.2020, për shumën 45,000 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit.
Në bazë të kontratës, qiramarrësi detyrohet të paguajë detyrimin mujor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në nenin 5 pika 5.7, ku qiramarrësi për çdo ditë vonesë, do të paguajë një kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, që do të thotë se nga qiradhënësi Bashkia Durrës (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve) nuk ka përllogaritur kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore prej 45,000 lekë.
Kontrata e qirasë datë 01.9.2020 në nenin 5 "Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit" pika 5.3 qiramarrësi ka të përcaktuar se për çdo ditë vonesë do të paguajë një kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, që do të thotë se nga qiradhënësi (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve) nuk ka përllogaritur kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore prej 45,000 lekë.
Nga qiramarrësi nuk është respektuar neni 6.2 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 03.4.2017, për shumën 45,000 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 10 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit në emër të subjektit A.D.
Nga qiradhënësi nuk është respektuar neni 8 "Zgjidhja e Kontratës" e Kontratës së Qirasë datë 01.9.2020 ku citohet se: *"kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate. Kontrata pushon automatikisht së vepruari 30 ditë pas njoftimit me shkrim të qiradhënësit për zgjidhjen e kontratës para afatit sipa nenit 8.2".*

Konkluzion: : Nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve, nuk është monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë në lidhje me mos pagesën së qirasë prej 43,000 lekë në emër të Qiramarrësin "ICP I.& P".

-Në lidhje me qiramarrësin "U. " Sh.p.k. rezultoi se është dhënë objekti me kontratë qiraje me tarifë simbolike 1 Euro me sipërfaqe 930 m^2 me afat 8-vjeçar për aktivitet privat "F." të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
Nga Bashkia Durrës janë ndjekur të gjitha kriteret e konkurrimit për dhënien me qira të pasurisë shtetërore ku për çdo subjekt konkurrimi është kërkuar, niveli i investimit, niveli i punësimit, si dhe oferta e detyrimit mujor të qirasë.
Me datë 20.11.2018 kryetari i Bashkisë Durrës ka urdhëruar dhënien me qira me konkurrim, të pasurisë shtetërore, nr. 2/423 Z.K. 8513 me sipërfaqe 930 m^2 e cila përmban, të dhënat e pasurisë shtetërore që jepet me qira emërtimi, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, vlerën dysheme të detyrimit mujor të llogaritur sipas tarifave të këtij vendimi, afatin, veprimtaria që mund të ushtrohet në objekt, si dhe përbërjen e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve, të përbërë nga tre vetë, një kryetar e dy anëtarë si dhe dokumentacionin, që do të paraqitet në konkurrim nga konkurrentët.
Komisioni i shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve për dhënien me qira me çmim 1 (një) euro m^2 të pasurisë shtetërore për objektin me sipërfaqe 930 m^2 me marrjen në dorëzim të zarfit e mbyllur të konkurrentëve pjesëmarrës ka rezultuar se ka marrë pjesë në konkurrim vetëm një konkurrues që do të thotë se është paraqitur vetëm një ofertë.
Me datë 30.7.2019 nga Bashkia Durrës është lidhur kontratë qiraje me tarifë simbolike 1 Euro me sipërfaqe 930 m^2 me afat 8-vjeçar për aktivitet privat "F." ku bazuar në kreun VI të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar, nga sektori i asetëve pranë Bashkisë Durrës është vijuar edhe Monitorimi i zbatimit të kushteve të kontratës së qirasë me tarifë simbolike 1 Euro.

<u>Pasqyra e Kontratë-Qiraje për sipërfaqe nën 200 m^2 me afat 1-vjeçar</u>.

Nr.	Qiramarrësi	Objekti i dhënë me qira	Aktiviteti i subjektit	Data e lidhjes kontratës	Sip. m^2	Detyrimi mujor në lekë	Detyrimi i prapambetur në lekë
1	I.K.	URT	Prodhim Dyer	17.1.2022	200	39,690	79,380
2	A. K.	URT	Shtypshkronjë	16.5.2022	155	29,130	0
3	Xh. K.	URT	Agjensi Rekla.	18.1.2022	129	23,300	0
4	J. Sh.	URT	Repart Meka.	20.6.2019	160	29,300	263,700
5	L. H.	URT	Luçidim Maki.	14.5.2021	123	23,000	46,000
6	A. Gj.	URT	Fason	22.11.2021	152	27,216	0
7	S.Q.	Bash.	Bar-bufe	10.5.2022	36	7,166	0
8	D. Z.	Markat	Magazinë	17.10.2022	147	43,000	43,000
9	V. R.	B.Soci.	Furrë-Buke	28.07.2020	77	14,444	28,888
10	A. P.	B.Soci.	Marangoz	16.11.2020	78	16,180	0
11	E. Gj.	B.Soci.	Bilardo	02.04.2021	79	15,040	90,240
12	S. M.	B.Soci.	Mag. Bojrash	17.12.2020	41	7,400	7,000
	TOTALI						**558,208**

Nga shqyrtimi i procedurave të djegura nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve, Bashkia Durrës në lidhje me Monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratës së qirasë për sipërfaqe nën 200 m^2 me afat 1-vjeçar rezultoi se:
Nga ana e Bashkisë Durrës janë lidhur kontratë qiraje me afat 1-vjeçar për objektet me sipërfaqe nën 200 m^2 gjithsej 6 kontrata.
Këto kontratë qiraje të lidhura nga Bashkia Durrës me afat 1-vjeçar për objektet me sipërfaqe nën 200 m^2 janë bërë pa konkurim në zbatim të pikës 5/a të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore".
Për të gjitha rastet nga subjektet janë paraqitur pranë Bashkisë Durrës dokumentacioni për marrjen me qira të objekteve, duke filluar nga kërkesa e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, plan biznesin, të detajuar për vënien me funksionim të objektit, ku është përshkruar

qartë plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen, në zbatim të pikës 7 të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit me zgjedhje rezultoi:

Subjekti I.K. (Qiramarrës) rezulton të ketë lidhur kontratë qiraje me datë 17.1.2022 me afat 1 vjeçar me sipërfaqe objekti 200 m^2 për aktivitet biznesi prodhim "Dyer metalike" me Qiradhënësin Bashkia Durrës. Qiraje mujore në bazë të nenit 6 të kontratës, është 39,690 lekë, që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.

Nga auditimi rezulton se qiramarrësi nuk ka paguar qiranë e dy muajve në shumen prej 79,380 lekë, duke mos respektuar nenin 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 17.1.2022, për shumën 39,690 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit.

Në bazë të kontratës, qiramarrësi detyrohet të paguajë detyrimin mujor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në nenin 5 pika 5.7, ku qiramarrësi për çdo ditë vonesë, do të paguajë një kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, që do të thotë se nga qiradhënësi Bashkia Durrës (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve) nuk ka përllogaritur kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore prej 39,690 lekë.

Nga qiramarrësi nuk është respektuar neni 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 17.1.2022, për shumën 39,690 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve, që do të thotë se nga qiramarrësi nuk është paguar qiraja e dy muajve në shumen prej 79,380 lekë,

Konkluzion: Nga Qiradhënësi Bashkia Durrës është zgjidhur kontrata e qirasë me qiramarrësin **I. K.**, pa bërë më parë pagesën e dy muajve në shumen prej 79,380 lekë të shoqëruar me penalitet kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, ***duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Durrës,*** në kundërshtim me neni 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë lidhur në datë 17.1.2022.

Subjektin J. Sh. (Qiramarrës) rezulton të ketë lidhur kontratë qiraje me datë 20.6.2019 me afat 1 vjeçar me sipërfaqe objekti 160.1 m^2 për aktivitet biznesi "Repart mekanik për riparim qepenash" me qiradhënësin Bashkia Durrës. Qiraje mujore në bazë të nenit 6 të kontrates, është 29,300 lekë, që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.

Nga auditimi rezulton se qiramarrësit nuk i është rinovuar kontrata e qirasë edhe pse vazhdon të ushtrojë aktivitetin në objektin me sipërfaqe 160.1 m^2 "Repart mekanik për riparim qepenash" Qiramarrësi nuk ka paguar qiranë e 9 muajve në shumen prej 263,700 lekë, duke mos respektuar nenin 6 pika 6.2 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë, datë 20.6.2019, për shumën 29,300 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 10 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.

Në bazë të kontratës, qiramarrësi detyrohet të paguajë detyrimin mujor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në nenin 5 pika 5.7, ku qiramarrësi për çdo ditë vonesë, do të paguajë një kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, që do të thotë se nga qiradhënësi Bashkia Durrës (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve) nuk ka përllogaritur kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore prej 29,300 lekë.

Nga qiramarrësi nuk është respektuar neni 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 20.6.2019, për shumën 29,300 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 10 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve, që do të thotë se nga qiramarrësi nuk është paguar qiraja e 9 muajve në shumen prej 263,700 lekë,

Nga qiradhënësi nuk është respektuar neni 7.3 "Zgjidhja e Kontratës" e Kontratës së Qirasë datë 20.6.2019, ku citohet se: *"Kontrata pushon automatikisht së vepruari kur Qiramarrësi për 2 (dy) muaj rresht nuk kryen pagesën e qirasë, Qiramarrësi detyrohet të dorëzoj objektin 15 ditë pas marrjes së njoftimit me shkrim të Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës".*

Konkluzion: Nga qiradhënësi Bashkia Durrës nuk është njoftuar me shkrim Qiramarrësi **J. Sh.**, për dorëzimin e objektit me sipërfaqe 160.1 m^2 "Repart mekanik për riparim qepenash", por vazhdon aktivitetin pa një kontratë qiraje edhe pse rezulton debitor në shumen prej 263,700 lekë, në kundërshtim me nenin 7.3 "Zgjidhja e Kontratës" e Kontratës së Qirasë lidhur në datë 20.6.2019,

Subjekti L. H.(Qiramarrës) rezulton të ketë lidhur kontratë qiraje me datë 14.5.2021 me afat 1 vjeçar me sipërfaqe objekti 123 m^2 për aktivitet biznesi "Luçidim makine" me Qiradhënësin Bashkia Durrës. Qiraje mujore në bazë të nenit 6 të kontrates, është 23,000 lekë, që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.
Nga auditimi rezulton se qiramarrësi nuk ka paguar qiranë e dy muajve në shumen prej 46,000 lekë, duke mos respektuar nenin 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 14.5.2021, për shumën 23,000 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.
Në bazë të kontratës, qiramarrësi detyrohet të paguajë detyrimin mujor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në nenin 5 pika 5.7, ku qiramarrësi për çdo ditë vonesë, do të paguajë një kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, që do të thotë se nga qiradhënësi Bashkia Durrës (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve) nuk ka përllogaritur kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore prej 23,000 lekë.
Nga qiramarrësi nuk është respektuar neni 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 14.5.2021, për shumën 23,000 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve, që do të thotë se nga qiramarrësi nuk është paguar qiraja e dy muajve në shumen prej 46,000 lekë,
Nga qiradhënësi nuk është respektuar neni 7.3 "Zgjidhja e Kontratës" e Kontratës së Qirasë datë 20.6.2019, ku citohet se: *"Kontrata pushon automatikisht së vepruari kur Qiramarrësi për 2 (dy) muaj rresht nuk kryen pagesën e qirasë, Qiramarrësi detyrohet të dorëzoj objektin 15 ditë pas marrjes së njoftimit me shkrim të Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës".*

Konkluzion: Nga Qiradhënësi Bashkia Durrës nuk është njoftuar me shkrim Qiramarrësi **L. H.**, për dorëzimin e objektit me sipërfaqe 123 m^2 "Luçidim makine", por vazhdon aktivitetin pa një kontratë qiraje edhe pse rezulton debitor në shumen prej 46,000 lekë, në kundërshtim me nenin 7.3 "Zgjidhja e Kontratës" e Kontratës së Qirasë lidhur në datë 14.5.2021,

Subjekti D. Z. (Qiramarrës) rezulton të ketë lidhur kontratë qiraje me datë 17.10.2022 me afat 1 vjeçar me sipërfaqe objekti 147 m^2 për aktivitet biznesi "Magazinë" me Qiradhënësin Bashkia Durrës. Qiraje mujore në bazë të nenit 6 të kontratës, është 43,000 lekë, që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.
Nga auditimi rezulton se qiramarrësi nuk ka paguar qiranë muajve në shumen prej 46,000 lekë, duke mos respektuar nenin 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 14.5.2021, për shumën 23,000 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 10 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.
Në bazë të kontratës, qiramarrësi detyrohet të paguajë detyrimin mujor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në nenin 5 pika 5.7, ku qiramarrësi për çdo ditë vonesë, do të paguajë një kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, që do të thotë se nga qiradhënësi Bashkia Durrës (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve) nuk ka përllogaritur kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore prej 23,000 lekë.
Nga qiramarrësi nuk është respektuar neni 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 17.10.2022, për shumën 43,000 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 10 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve,

Konkluzion: Nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve, është lëshuar fatura e pagesës prej 43,000 lekë/muaj në emër të qiramarrësit D. Z., e pa shoqëruar me kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, për mos pagimin brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Subjekti V. R. (Qiramarrës) rezulton të ketë lidhur kontratë qiraje me datë 28.07.2020 me afat 1 vjeçar me sipërfaqe objekti 77.1 m^2 për aktivitet "Furrë Buke" me Qiradhënësin Bashkia Durrës. Qiraje mujore në bazë të nenit 6 të kontratës, është 14,444 lekë, që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.
Nga auditimi rezulton se qiramarrësi nuk ka paguar qiranë e dy muajve në shumen prej 28,888 lekë, duke mos respektuar nenin 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 28.07.2020, për shumën 14,444 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 10 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.
Në bazë të kontratës, qiramarrësi detyrohet të paguajë detyrimin mujor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në nenin 5 pika 5.7, ku qiramarrësi për çdo ditë vonesë, do të paguajë një kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, që do të thotë se nga qiradhënësi Bashkia Durrës (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve) nuk ka përllogaritur kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore prej 14,444 lekë.
Nga qiramarrësi nuk është respektuar neni 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë **V. R.**, për shumën 14,444 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve, që do të thotë se nga qiramarrësi nuk është paguar qiraja e dy muajve në shumen prej 28,888 lekë,
Nga qiradhënësi nuk është respektuar neni 7.3 "Zgjidhja e Kontratës" e Kontratës së Qirasë datë 28.07.2020, ku citohet se: *"Kontrata pushon automatikisht së vepruari kur Qiramarrësi për 2 (dy) muaj rresht nuk kryen pagesën e qirasë, Qiramarrësi detyrohet të dorëzoj objektin 15 ditë pas marrjes së njoftimit me shkrim të Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës".*

Konkluzion: Nga Qiradhënësi Bashkia Durrës nuk është njoftuar me shkrim Qiramarrësi **V.R.** për dorëzimin e objektit me sipërfaqe 123 m^2 "Luçidim makine", por vazhdon aktivitetin pa një kontratë qiraje edhe pse rezulton debitor në shumen prej 28,888 lekë, në kundërshtim me nenin 7.3 "Zgjidhja e Kontratës" e Kontratës së Qirasë lidhur në datë 28.07.2020,

Subjekti E. Gj. (Qiramarrës) rezulton të ketë lidhur kontratë qiraje me datë 02.04.2021 me afat 1 vjeçar me sipërfaqe objekti 79.3 m^2 për aktivitet "Bilardo" me Qiradhënësin Bashkia Durrës. Qiraje mujore prej 15,040 lekë, që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.
Nga auditimi rezulton se qiramarrësi nuk ka paguar qiranë e 12 muajve në shumen prej 90,240 lekë, duke mos respektuar Kontratën e Qirasë datë 02.04.2021, për shumën 15,040 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 10 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.
Në bazë të kontratës, qiramarrësi detyrohet të paguajë detyrimin mujor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në nenin 5 pika 5.7, ku qiramarrësi për çdo ditë vonesë, do të paguajë një kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, që do të thotë se nga qiradhënësi Bashkia Durrës (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve) nuk ka përllogaritur kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore prej 15,040 lekë.
Nga qiramarrësi nuk është respektuar neni 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 02.04.2021, për shumën 15,040 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve, që do të thotë se nga qiramarrësi nuk është paguar qiraja e dy muajve në shumen prej 90,240 lekë,

Nga qiradhënësi Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve nuk është Monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë për sipërfaqe nën 200 m^2 me afat 1-vjeçar, ku citohet se: *"Kontrata pushon automatikisht së vepruari kur Qiramarrësi për 2 (dy) muaj rresht nuk kryen pagesën e qirasë, Qiramarrësi detyrohet të dorëzoj objektin 15 ditë pas marrjes së njoftimit me shkrim të Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës".*

Konkluzion: Nga Qiradhënësi Bashkia Durrës, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve nuk është njoftuar me shkrim Qiramarrësi **E. Gj.** për dorëzimin e objektit me sipërfaqe 79.3 m^2 "Bilardo", por vazhdon aktivitetin pa një kontratë qiraje edhe pse rezulton debitor në shumen prej 90,240 lekë.

Në lidhje me subjektin S. M. (Qiramarrës) rezulton të ketë lidhur kontratë qiraje me datë 17.12.2020 me afat 1 vjeçar me sipërfaqe objekti 41 m^2 për aktivitet biznesi "Magazinë Bojrash" me Qiradhënësin Bashkia Durrës. Qiraje mujore në bazë të nenit 6 të kontratës, është 7,400 lekë, që do të paguhet brenda datës 20 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.
Nga qiramarrësi nuk është respektuar neni 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë datë 17.10.2022, për shumën 7,400 lekë/muaj që do të paguhet brenda datës 10 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve.

Konkluzion: Nga Qiradhënësi Bashkia Durrës, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve nuk është njoftuar me shkrim Qiramarrësi **S. M.** për dorëzimin e objektit me sipërfaqe 41 m^2 "Magazinë Bojrash" por vazhdon aktivitetin pa një kontratë qiraje edhe pse rezulton debitor.

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2022

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:
Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese "Aparati i Bashkisë Durrës" për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar meUdhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022.
Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.
Bashkia Durrës për vitin 2022 ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara.
Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare
Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Durrës për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr.prot. 478 datë 03.04.2023. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Durrës dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjësi Financës. Pra në këtë rast kemi delegime të këtyre detyrave.
Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.
Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klases 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në rregjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mosndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabiltetit të Aparatit Bashkisë

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel"
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjke dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj . Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi pershkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, permban te dhena per shkakun e veprimit, daten dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vleres, personat qe kane urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhenat te nevojshme qe i japin dokumentit forcen e nje prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financaiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhen nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të rregjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin rregjistruar janë rregjistruar,

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e rregjistruara dhe ngjarjet janë rregjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë rregjistruar në periudhen e saktë kontabël,

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë rregjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhes

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë rregjistruar, si dhe detyrimet janë rregjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilanc, me perjashtim te ndonje rasti ku janë rregjistruar në momemtin e pagesës në 6-mujorin e parë të vitit pasardhës, i cili është në vazhdim dhe i pa mbyllur.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të rregjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura .

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria Ekonomike. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabel ne llogarine e 520 "Disponibilitete në Thesar" dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në me formatin nr.5 "Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022"

Totali i Aktivit për vitin 2022 është në vlerën 7,091,654,523 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Formati nr. 1 Aktivi i Bilancit 2022 Në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	**A K T I V E T**	7,091,654,523	5,497,357,502
2		**I.Aktivet Afat shkurtra**	2,735,523,630	2,903,987,906
3		**1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre**	1,868,650,120	2,086,560,202

4	531	Mjrete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjrete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	1,868,650,120	2,086,560,202
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	8,850,174	12,202,444
12	31	Materiale	727,507	4,705,183
13	32	Inventar I imet	8,122,667	7,497,260
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		**3.Llogari te Arketushme**	**683,895,648**	**524,274,676**
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	690,698	690,699
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	646,437,652	488,960,133
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	36,767,298	34,623,844
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**174,127,688**	**280,950,584**
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	174,127,688	280,950,584
42		**II.Aktivet Afat gjata**	**4,356,130,894**	**2,559,414,668**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**136,807,117**	**111,720,854**
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	136,807,117	111,720,854
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**1,401,397,524**	**1,350,261,756**
48	210	Toka, T,roje, Terene	180,594,841	152,420,146
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesa e Konstruksione	1,133,027,482	1,156,231,413
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	3,292,177	4,297,221
53	215	Mjete Transporti	39,174,837	26,153,855
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	44,627,643	11,159,121
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		**4.Investime**	**2,823,268,556**	**1,131,386,986**
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	2,823,268,556	1,131,386,986

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 1,868,650,120 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI " Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor" në Formatin nr. 3 "Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË).

- ***Gjendja e llogarisë 520 "Disponibilitete në Thesar",*** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 1,868,650,120 lekë, gjëndje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 "Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022".

Në klasën 3 "Gjendja e inventarit qarkullues" të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,705,183 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 12,202,444 lekë , ku diferenca e tyre në zbritje në vlerën prej 3,352,270 lekë rakordon me gjëndjen e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në formatin nr.2 "Pasqyra e performancës financiare". Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- ***Gjendja e llogarisë 31 "Materiale"*** paraqitet paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,705,183 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 në vlerën 727,507 lekë, me një diferencë në zbritje për vitin ushtrimor prej 3,977,676 lekë, e cila përfaqëson pakesim të gjendjes së mallrave në fund te vitit 2022.
- ***Gjendja e llogarisë 32 "Inventari i imet "*** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 7,497,260 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 8,122,667 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 625,407 lekë, e cila përfaqëson hyrje nga blerjet te inventarit te imet per vitin 2022.

Klasa 4 "Llogari të arkëtueshme" paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 524,274,676 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 në vlerën 683,895,648 lekë, ku kemi shtim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i shtimit te debitoreve te ndryshem ne lidhje me investimet dhe sherbimet e ndryshme.

- ***Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm"*** përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, e cila paraqitet në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 488,960,133 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 591,457,852 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 102,497,719 lekë. Në vlerën e lartë të debitorëve ka ndikuar:

- Gjendja e debitorëve të krijuar nga detyrimet kontraktore të të tretëve ndaj Bashkisë në vlerën 82,638,512 lekë, ku nga trashëgimet nga vitet e kaluara janë në vlerën 62,628,107 lekë me objekt "shërbime", dhe rritja e këtyre debitorëve gjatë vitit 2022 është në vlerën 6,738,119 lekë. Analiza e këtyre debitorëve paraqitet në Aneks.
- Gjendja e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën 165,047,159 lekë,ku gjatë vitit 2022 debitorët janë shtuar në vlerën 21,789,900 lekë, ku analizat e tyre janë në drejtorinë e Taksave dhe tarifave Vendore.
- Gjendja e debitorëve të krijuar në vite nga mospagesa e gjobave të APP nga punonjës të ish-Komunave në vlerën 3,028,000 lekë dhe nga mos pagesa e tarfës së shfrytëzimit të hapësirave të plazhit në zonën e ish-Komunës së Ishmit në vlerën 6,126,400 lekë. Për këta debitorë nuk ka analiza.
- Gjendja e debitorëve të krijur nga mospagesa e gjobave për kundravajtje administrative nga ndërtimet pa leje ë vendosura nga IMTV në vlerën 210,289,700 lekë, ku gjatë vitit 2022 janë shtuar me vlerën 73,969,700 lekë.
- Gjendja e debitorëve të krijar në vite nga mospagesa e tarifave të Urbanistikës dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 137,600,367 lekë. Në këtë gjendje nuk është përfshirë vlera pjesore debitore e mbetur prej 22,722,660 lekë nga llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë të lejes së ndërtimit të dhënë me Vendimin nr. 84 datë 08.02.2019 të subjektit "R." shpk, pasi Drejtoria e Urbanistikës nuk ka kryer detyrat e saj funksionale dhe korespondencën shkresore për njohjen si debitor në Drejtorinë e të ardhurave dhe evidentimin në kontabilitet të vlerës debitore nga Drejtoria e Financës dhe pas konstatimit dhe rekomandimit të lënë për këtë problem nga auditimi paraardhës i KLSH.

Theksojmë se për këta debitorë nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkimit. Analiza e gjendjes së llog. "Debitorë të ndryshëm"

dhe lëvizjet e pësuara në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Gjendja e llogarise 468"Debitore te ndryshem" me date 31.12.2022

NR	DEBITORET LLOGARIA 468	GJENDJA ME 01.01.2022	Shtesa per vitin 2022	GJENDJA ME 31.12.2022
	BASHKIA DURRËS			0
	SHERBIMET ANALITIK	**62,628,107**	**6,738,119**	**69,366,226**
1	E.	1,186,929		1,186,929
2	E.	4,928,551		4,928,551
3	E.	871,760		871,760
4	H.	112,700		112,700
5	H.	86,000		86,000
6	V.	15,794,867		15,794,867
7	I. ASFALT	4,000		4,000
8	E. & BE -IS	894,255		894,255
9	E.	131,840		131,840
10	D.	79,400		79,400
11	B.-I.	159,000		159,000
12	A.Q. MBIKQYRJE PUNIMESH	50,000		50,000
13	S. SHPK	18,318,400		18,318,400
14	SHERB. V M.-SH. P.	2,757,795		2,757,795
15	F.SHPK , ND.RR. PARALEM MURI PORTIT	8,414,000		8,414,000
16	S.	2,651,640		2,651,640
17	SHERBIMET V MAMINAS - SHEN PJETER	583,350		583,350
18	SHERBIMET V RRUGA TEQES FSH. ARAPAJ	1,293,038		1,293,038
19	KOMUNA RRASHBULL, KLSH OE H shpk	4,310,582		4,310,582
20	BOE R.NDERTIM& V.		2,759,640	2,759,640
21	C.+KMK+S.AB SHPK		140,880	140,880
22	B.&C.SHPK		1,333,400	1,333,400
23	E. SHPK		312,240	312,240
24	LIQENI VII+E.SHPK		2,061,564	2,061,564
25	R.NDERTIM SHPK		130,395	130,395
	NGA ISH KOMUNAT	**426,332,026**	**95,759,600**	**522,091,626**
26	DEBITOR ISH KOMUNAT NGA APP (JO ANALITIK)	3,028,000		3,028,000
27	ISHMI QERA PLAZHE (JO ANALITIK)	6,126,400		6,126,400
28	DEBITOR IMTV (JO ANALITIK)100000	136,320,000	73,969,700	210,289,700
29	TAKSAT (JO ANALITIK)	143,257,259	21,789,900	165,047,159
30	URBANISTIKA (JO ANALITIK)	137,600,367		137,600,367
	Totali	**488,960,133**	**102,497,719**	**591,457,852**

Konkluzion: Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 468 " Debitorë të ndryshëm" konstatohet se vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 prej 165,047,159 lekë , është e pasaktë, pasi kjo vlerë i përket vlerës debitorëve të krijuar në vitin ushtrimor 2022. Nga të dhënat e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vlera progresive në datë 31.12.2022 e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 799,162,272 lekë. Informacioni jo real në gjendjen e kësaj llogarie me një diferencë prej 634,115,113 lekë është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",

- **Pika 2** në të cilën përcaktohet se: *"Pasqyrat Financiare kanë për qëllim që të japin një pamje të strukturuar të pozicionit financiar dhe transaksioneve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme, të sigurojnë informacion për pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare. Qëllimi i përgjithshëm është që me informacionin që disponojnë, pasqyrat financiare, në rradhë të parë të japin informacion të besueshëm për vendimmarrje për vetë njësinë apo institucionin raportues....."*

Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik "pika 3.3 " Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8., ku përcaktohet se:

- Në bilanc këto detyrime do të pasqyrohen me vlerën e tyre kontabël të matshme. Nëqoftëse rezulton një ndryshim (rritje ose zvogëlim) me karakter përfundimtar i vleftës së detyrimeve, diferenca do të pasqyrohet si rritje apo zvogëlim i tyre, duke ngarkuar përkatësisht shpenzimet ose të ardhurat e periudhës.

***- "Të drejtat.** Funksionimi i llogarive të të drejtave 411, 468 e të tjera, në rastet e përdorimit të tyre në sektorin publik debitohen (në rastin e konstatimeve), në kredi të llogarive respektive të klasës 7 dhe klasës 1 (116)".*

Në fakt kjo DTTV/sektori Menaxhimit dhe Apelimit të Borxhit i ka dërguar Drejtorisë Ekonomike më shkresën nr.prot.926 datë 24.01.2023 me lëndë: **"***Subjektet debitore në sistemin informatik të DTTV për kontabilizim.*

*Drejtorisë Ekonomike Këtu**:***

"Për vitin fiskal 2022 në sistemin informatik të Drejtorisë së taksave dhe tarifave Vendore, janë gjithsej 2377 subjekte debitore me vlerë 165,047,159 lekë.Në zbatim të ligjit për kontabilitetin po ju dërgojmë listën e subjekteve konform ligjit. Borxhi i fiksuar me datë 31.12.2022, fillon në faqen e parë me Niptin K……1 dhe mbaron me niptin L…….P. Vlera e debisë nga Borxhi është 165,047,159 lekë."

Titulli gjetjes:*Mbi kontabizimet e gabuara në llog.468 "Debitorë të ndryshëm"*

Situata: Gjendja e llogarisë *468 "Debitorë të ndryshëm",* përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, e cila paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 591,457,852 lekë, ku në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 102,497,719 lekë. Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 468 " Debitorë të ndryshëm" konstatohet se vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 prej 165,047,159 lekë , është e pasaktë, pasi kjo vlerë i përket vlerës debitorëve të krijuar në vitin ushtrimor 2022. Nga të dhënat e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vlera progresive në datë 31.12.2022 e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 799,162,272 lekë, duke sjellë një mosrakordim për vlerën 634,115,113 lekë.

Kriteri: Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu III. "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 2, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik"pika 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)

Impakti: Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk tregon gjendjen reale.

Shkaku: Drejtoria e Financës ka kontabilizuar gabim vlerat e debitorëve, duke mos paraqitur vlerën reale, si pasojë e informacionit të gabuar nga DAV.

Rëndësia: E lartë

Konkluzion: *Gjendja e llogarisë 4342* *"Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"* në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 36,767,298 lekë, e cila përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Kjo gjendje në fakt duhet të ishte në vlerën 49,010,534 lekë, pasi në analizë përfshin gjëndjet e llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasivin e bilancit: llog.401-404 "Furnitore e llogari te lidhura me to" ne vlerën 12,243,236 lekë, llog.42 "Detyrime ndaj personelit" për vlerën 25,440,333 lekë, llog.431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" për vlerën 2,393,534 lekë, llog.435"Sigurime shoqërore" për vlerën 7,862,602 lekë, llog.436 "Sigurime shëndetësore" për vlerën 1,070,830 lekë. Pra gjendja e llog. *4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"*nuk rakordon për shumën prej 12,243,236 lekë me shumën e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, vlerë kjo që i përket llog.401-404 "Furnitore e llogari te lidhura me to", e cila nuk është përfshirë edhe pse është detyrim, që i ka shteti/Bashkia të tretëve. Kjo procedurë është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II

"Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"pika 15/b,59 /a, Kreu III, pika 32, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik "pika 3.3 " Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8.

Titulli gjetjes*:* *Mbi kontabizimet e gabuara në llog.* ***4342*** *"Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"*

Situata: Gjendja e llogarisë *4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"* në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 36,767,298 lekë, kur në fakt duhet të ishte në vlerën 49,010,534 lekë, pasi në analizë përfshin gjëndjet e llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasivin e bilancit: llog.401-404 "Furnitore e llogari te lidhura me to" ne vlerën 12,243,236 lekë, llog.42 "Detyrime ndaj personelit" për vlerën 25,440,333 lekë, llog.431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" për vlerën 2,393,534 lekë, llog.435 "Sigurime shoqërore" për vlerën 7,862,602 lekë, llog.436 "Sigurime shëndetësore" për vlerën 1,070,830 lekë. Pra gjendja e llog. *4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"* nuk rakordon për shumën prej 12,243,236 lekë me shumën e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, vlerë kjo që i përket llog.401-404 "Furnitore e llogari te lidhura me to", e cila nuk është përfshirë edhe pse është detyrim, që i ka shteti/Bashkia të tretëve

Kriteri: Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II pika 15/b,59 /a, Kreu III, pika 32, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik "pika 3.3 " Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8.

Impakti: Gjendja e llogarisë *4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"* nuk tregon gjendjen reale.

Shkaku: Drejtoria e Financës ka kontabilizuar gabim vlerat e detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara.

Rëndësia: E mesme

Klasa 4 "Të tjera aktive afatshkurtra" e cila përbëhet nga:

- Gjendja e llogarisë ***486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"*** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 174,127,688 lekë, gjendje e cila përfaqëson detyrimet të prapambetura ndaj të tretëve dhe rakordon me gjendjen e llogarisë kunderparti në pasiv të bilancit llog.467 "Kreditorë të ndryshëm" .

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave te UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 **"Aktivet Afatgjata" në aktiv të bilancit** paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,543,691,455 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,097,855,542 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)"paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,912,845,568 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,546,376,842, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 "Aktive Afatgjata jo materiale" që përbëhet nga**:**

- **Gjëndja e llogarisë 202** ***"Studime dhe kërkime"*** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 111,720,854 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën prej 136,807,117 lekë, diferenca është vlerë e krijuar nga studime te reja. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 184,213,112 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 136,807,117 lekë, Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon.

Inventari i llogarise 202 "Studime dhe kerkime "

NR	Emërtimii I aktiveve sipas Njësive Administrative	Gjendja me 31.12.2021	Shtesa gjate vitit 2022	Pakesime gjate vitit 2022	Gjendja më 31.12.2022	Realizimi I Investimit
1	Studime e Projekte	45,000			45,000	
2	STUDIM Projektim KUL DHE KANALE te mbyllura	2,930,000			2,930,000	0
3	STUDIM PROJEKTIM KUZ Kallmi	3,980,000			3,980,000	nuk kemi
4	STUDIM PROJEKTIM Infrastrastrukture ne Zonen	3,950,000			3,950,000	perfunduar
7	STUDIM PLANIFIKIM ZHVILLIM ZONE NEN	393,000			393,000	
8	STUDIM PER PLANIFIKIM E ZHVILLIM TE	395,000			395,000	
9	STUDIM PER ZHVILLIMIN E TURIZMIT DHE TIPET	395,000			395,000	
10	STUDIM PER RISHIK. E PLANIT URBAN DHE	399,000			399,000	
11	STUDIM MBI RISHIKIMIN E RREGULLORES	399,000			399,000	
12	NDERFAQESIMI ËEB SERVIS SISTEM UJESJELLES	2,758,800			2,758,800	
13	Plan Stud. Zhvillim I sektoreve te ndryshem ekonomik	474,000			474,000	
14	STUDIM PLAN INVESTIMI STRATEGJIK PER	462,000			462,000	
17	STUD. PROJ. RIKUAL. NE ANET E RRUG.	9,974,400			9,974,400	
18	PROMENADA BREGD.PLAZHI PUBLIK - BRYLI	8,395,200			8,395,200	

19	STUDIM PROJEKTIM PROJEKT ZBATIMI I SHESHI	29,868,000			29,868,000	Proces
20	STUDIM PROJEKTIM PROJEKT ZBATIMI I SHESHI	36,348,000			36,348,000	
21	Gjeokonsult & Co shpk Studim Projektim "Realizimi	14,880,000			14,880,000	
22	FSHZH KONTRIBUT LOKAL PER FZHR Fond sipas	7,500,000			7,500,000	
23	RIKONCEPTIM DHE RIKONSTRUKSION SHK.	7,679,136			7,679,136	
24	SHETITORJA BREGDETARE PERGJET PLAZHIT SH.	17,294,225			17,294,225	
25	RIKONCEPTIM DHE RIKONSTRUKSION QENDRES	1,960,388			1,960,388	
26	RINDERTIM SHK. J. PUKA	5,890,924			5,890,924	
27	ITINERARI RI ZONES TURISTIKE	6,144,310			6,144,310	
28	PORTA JALLISE	1,479,736			1,479,736	
29	KATUN I RI	1,296,000			1,296,000	nuk ka fare
30	Rikualifikimi I hapesirave midis kuartallit nga rruga	394,174			394,174	
31	Programi Fatura	1,155,600			1,155,600	
32	Studim Projektim :Rehabilitim I shetitores Taulantia	7,892,400			7,892,400	Proces
33	Mbledhje dhe analiz I te dhenave Modelimi I rap.modelare	9,479,820			9,479,820	
34	Hartim projekti per rikualifikimin e Pallatit te Kultures			3,396,000	3,396,000	Proces
35	Hartimi dhe studimi projektimit per rehailitimin e infrastr			27,145,535	27,145,535	Proces
36	Projekt zbatimi per ndertimin e Shetitores se plazhit Durrës			4,565,725	4,565,725	Proces
37	Studim projektim unaza Spital-Currila			2,587,248	2,587,248	Proces
38	Studim projektim unaza Spitalle-Currila			4,149,883	4,149,883	Proces
	TOTALI	**184,213,112**		**41,844,391**	**226,057,503**	

Ndërsa 10 projekt-preventiv janë për ndërtime e rikonstruksione, ku nga këto nuk janë vënë në përdorim 10 projekte investimesh, të cilat priten të vihen në funksionim në vitet e mëvonshme. Nga këto 5 projekte janë vënë në shfrytëzim në vitin 2022-2023. Këto projekte janë bërë hyrje dhe ruhen në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit Urban dhe Arshivën e Institucionit.

Konkluzion: Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 146,665,977 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime",* për 27 projekt-studime për investime të kryera apo për investime të pakryera, ku për një pjesë nuk ka të dhëna nëse janë kryer investimet dhe përse vlera e këtyre studimeve nuk i është shtuar vlerës së aktivit të kapitalizuar. Në gjendjen e kësaj llogarije një pjesë e vlerave të këtyre studim-projektimeve kanë mbetur në vite dhe një pjesë janë trashëguar nga ish-Komunat. Nga analiza e kësaj llogarije rezulton se në këtë gjendje janë përfshirë 3 zëra në vlerën 10,275,736 lekë, që nuk mund të jenë pjesë e gjendjes së llog. *202 "Studime dhe Kërkime",* referuar nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik si:

NR	Emërtimii I aktiveve sipas Njësive Administrative	Gjendja me 31.12.2021	Shtesa gjate vitit 2022	Pakesime gjate vitit 2022	Gjendja më 31.12.2022	Realizimi I Investimit
22	FSHZH KONTRIBUT LOKAL PER FZHR Fond sipas	7,500,000			7,500,000	
28	PORTA JALLISE	1,479,736			1,479,736	
29	KATUN I RI	1,296,000			1,296,000	nuk ka fare
	TOTALI	**10,275,736**			**10,275,736**	

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika16/b.d, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik **"Pika2. Klasa 2,** "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: *"Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm:*
a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicionit financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:
- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;
*- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera qëi shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivit (**kosto projektimi**, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).*

***Aktivet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si**: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM"*

Kreu II."Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes se kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" **Pika 16/b.d** të cilat përcaktojnë: "*Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit, ndiqet procedura e mëposhtme:*

b) Për shpenzimet e njohura të investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (të grupit 23); dhe

- Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4).

d) Në rastin e kapitalizimit të aktiveve afatgjata, të përfituara nëpërmjet shpenzimeve të investimeve (të regjistruar sipas pikës "b" më sipër), bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e grupit 20 ose 21 të aktiveve afatgjata; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23).

- Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik.

Titulli gjetjes*: Mbi kontabilizimet e aktiveve jo materiale në llogarinë 202"Studime dhe Kërkime"në aktiv të bilancit dhe mos llogaritja e amortizimit për to.*

Situata: Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 146,665,977 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime",* për 27 projekt-studime për investime të kryera apo për investime të pakryera, ku për një pjesë nuk ka të dhëna nëse janë kryer investimet dhe përse vlera e këtyre studimeve nuk i është shtuar vlerës së aktivit të kapitalizuar. Në gjendjen e kësaj llogarije një pjesë e vlerave të këtyre studim-projektimeve kanë mbetur në vite dhe një pjesë janë trashëguar nga ish-Komunat. Nga analiza e kësaj llogarije rezulton se në këtë gjendje janë përfshirë 3 zëra në vlerën 10,275,736 lekë, që nuk mund të jenë pjesë e gjendjes së llog. *202 "Studime dhe Kërkime",* referuar nomenklaturës së llogarive të planit kontabël public.

Kriteri: Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II pika16/b.d, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik "pika 2 Klasa 2 dhe me Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik.

Impakti: Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë në llogari te shpenzimeve të studim-projektimit.

Shkaku: Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizmit të aktiveve.

Rëndësia:I lartë

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2020.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) "Aktivet afatgjata materiale" paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,497,357,502 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 7,042,017,027 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,934,278,209 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,538,204,642 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- ***Gjendja ellog. 210 "Toka, Troje, Terrene"*** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 152,420,145 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në në vlerën 180,594,841 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" si në mbyllje

të vitit 2021dhe në mbyllje të vitit 2022 është në të njëjtën vlerë prej 28,174,696 lekë, pasi nuk ka shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2022. Amortizimi i llogaritur gabim nga ish Komunat është sistemuar. Këto gjendje paraqiten të analizuara sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabel i llogarise 210 "Toka Troje Terrene" me date 31.12.2022

Nr	Emërtimii I aktiveve sipas Njësive Administrative	Gjendja me 31.12.2021	Shtesa gjate vitit 2022	Gjendja më 31.12.2022
I.	**Aparati Bashkia Durrës Shuma**	**152,420,145**	**28,174,696**	**180,594,841**
1	IB ALBANIA ELEKTRONIK (URT) trual	113,501,372		113,501,372
2	KOMUNA RRASHBULL	1,000,000		1,000,000
3	MZSH	25,056,989		25,056,989
4	Q. shend L. 13 truall	5,723,160		5,723,160
5	Q. shend L. 15	4,795,579		4,795,579
6	Q. shend L. 16	2,343,045		2,343,045
7	Terrene sportive NJ.A.		28,174,696	28,174,696
	BASHKIA DURRËS TOTALI	**152,420,145**	**28,174,696**	**180,594,841**

Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Plantacione" paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 0 lekë. Kjo gjendje është në vlerën 0 lekë për arsyen se nuk është bërë hipotekimi dhe vlerësimi i aseteve/aktiveve "Pyje dhe kullota" të kaluara nga pushteti qendror Bashkisë Durrës.

- Gjendja e llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,369,715,545 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,404,323,186 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,369,737,545 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,133,027,482 lekë. Diferenca në rritje prej Gjatë vitit 2022 janë shtuar nga rikonstruksione në ndërtesën e MZSH dhe qendrat shëndetësore.

NR.	EMERTIMI	VLERA	NR.	EMERTIMI	VLERA
	Bashkia	**239,038,048**		**MANZA**	**8,056,770**
1	Ndertesa e Bashkise	107,709,938	28	Ambulanca Rade	1,022,770
2	Rajoni nr. 1	10,947,943	29	Ambulanca kamarras	1,520,000
3	Rajoni nr. 2	1,582,920	30	Ambulanca Kucok	990,000
4	Rajoni nr. 3	1,216,063	31	Ambulanca hamalle	568,000
5	Rajoni nr. 4	3,850,486	32	Ambulanca Manez fshat	980,000
6	Rajoni nr. 5	125,166	33	Ambulanca Shkalle	1,500,000
7	Tregu Agro Bujqesor	48,713,091	34	Ambulanca Borce	1,476,000
8	I.B. Albania Elektronik Ish. URT	17,126,406		**SUKTHI**	**138,455,021**
9	Qendra shendetesore lagja nr. 13, Plazh	5,398,825	35	Ndertesa	4,273,114
10	Qendra shendetesore Porto Romano	3,787,551	36	Zyrat e Bashkise	22,020,207
11	Qendra shendetesore lagja nr. 17	83,151	37	Qendra shendetsore Rrushkull	2,967,413
12	Qendra shendetesore lagja nr. 16	2,140,672	38	Qendra shendetsore Perlat	1,479,784
13	Qendra shendet nr. 15(ish zyrat e N.B. Spitalle)	31,917	39	RRETHIME sukthi ndertime	28,266,905
14	Qendra shendetes lagja nr. 14 (Shkozet)	696,717	40	Ambulanca katund I Ri	79,447,598
15	Qendra shendetesore Kenete	7,398,521		**RRASHBULL**	93,984,591
16	Qendra shendetesore lagja nr. 2-3	10,761	41	12-Ndertese.Q.shendetsore	1,085,682
17	shtuar vlera rikonst Qendra Shendetesore	23,725,774	42	8- ndertese .Q.shendet 212	2,980,536
18	Poliklinika nr. 2 per lagjet nr. 5-6	3,135,344	43	5-Ndertese. Q.shendetesore 212	1,729,254
19	MURE RRETHUES	1,356,802	44	5-Ndertese. Q.shendetesore 212	611,007
	ISHMI	**22,006,799**	45	3-Ndertesa qender.shend 2 COP	8,614,908
20	Qendra shendetsore Ishem	13,477,900	46	10-Ndertes.qender Sh.	13,000
21	119 Qendra shendetsore 119119 Shkafane	30,000	47	13-lapidar	69,500
22	119 Qendra shendetsore 119119 Fushe Bize	1,549,128	48	15- Ndertese lavanteri	11,559
23	119 Qendra shendetsore 119119 Fushe Gjuricaj	1,549,128	49	17-Ndertese Gjen.Civile	4,897,153
24	119 Qendra shendetsore 119119 kapedane	1,499,572	50	18-Ndertese Zyrat e Komu.212	5,795,352
25	Pallati 119kulture119(xhamia)	9,000	51	19-Ndertese Zyrat e Reja 212	67,701,200
26	119Busti119 119Brahim Kodra	2,038,132	52	6-Obelisku Shinavlash	475,440
27	Busti Adem Roda	696,000		**Totali I Njësive Administrativ**	**501,541,229**
28		**1,157,939**	53	**MZSH DURRËS**	**70,826,951**
			54	**Pallatet PIU**	**831,955,005**
				TOTALI	**1,404,323,186**

Konkluzion: Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" u konstatua se 9 aktive afatgjata materiale në vlerë **118,775,472 lekë, ku në 8 raste prej tyre** kanë emërtesa të paplota, ta paqarta dhe të pasakta, dhe 1 rast në vlerën 1,157,939 lekë nuk ka emërtim, gjë që do të thotë se inventari kontabël nuk përputhet me gjendjen kontabël për këtë vlerë. Për këto aktive nuk shtë bërë asnjë inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu III, Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", **pika 31** e cila përcakton: 30. *Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet",*
Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik **"Pika2. Klasa 2,** "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël). Rastet e trajtuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMERTIMI	VLERA
	Bashkia	
1	MURE RRETHUES	1,356,802
	ISHMI	
2		**1,157,939**
	SUKTHI	
	Ndertesa	4,273,114
3	RRETHIME sukthi ndertime	28,266,905
4	Ndertesa	4,273,114
5	Ambulanca	79,447,598
	Shuma	**118,775,472**

Titulli gjetjes*: Mbi kontabilizimet e pasakta të aktiveve afatgjata materiale në llogarinë 212 "Ndërtesa Konstruksione" në aktiv të bilancit.*
Situata: Referuar analizës së gjendjes së llogarisë *212 "Ndërtesa Konstruksione"* u konstatua se 9 aktive afatgjata materiale në vlerë 118,775,472 lekë, ku në 8 raste prej tyre kanë emërtesa të paplota, ta paqarta dhe të pasakta, dhe 1 rast në vlerën 1,157,939 lekë nuk ka emërtim, gjë që do të thotë se inventari kontabël nuk përputhet me gjendjen kontabël për këtë vlerë. Për këto aktive nuk është bërë asnjë inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre.
Kriteri: Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu III, Seksioni 3.1, pika 31 Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik "pika 2 Klasa 2 dhe me me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve" pika 74.
Impakti: Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale në llogarinë *212 "Ndërtesa Konstruksione"* .
Shkaku: Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite**.**
Rëndësia: *I lartë*

- Gjendja e Llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" paraqitet në vlerën neto 0 lekë, për arsye se të gjitha shpenzimet për investime në rrugë, rrjete, vepra ujore janë pjesë e bilancit të Ndërmarrjes Komunale të Shërbimeve.

- Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,297,221 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,972,721 lekë. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 29,277,486 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 29,797,957 lekë, aktive të cilat janë shtuar nga hyrjet e reja në vlerën 1,093,633 lekë nga shtesat e inventarit të MZSH me vlerë 418,503 lekë dhe blerjet e 7 kondicionerëve me vlerë 675,130 lekë si dhe pakësimet nga nxjerrja jashtë përdorimi në vitin 2021 e vlerës prej 573,162 lekë.

- Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti" në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 106,424,184 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 124,675,938 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 106,424,184 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 39,174,837 lekë. Shtesat gjatë vitit 2022 përfaqësojnë blerjen e mjeteve për Policine Bashkiake 12,696,000 lekë, dhe dhurimet per MZSH në vlerën 5,555,754 lekë. Analiza e gjëndjes së kësaj llogarije dhe lëvizjet e këtyre aktiveve në fund të vitit 2022 paraqiten në Aneks:

Inventari kontabel i llogarise 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2022

	BASHKIA DURRËS llog.215	Gjendja me 31.12.2021	Shtesa Viti 2022	Gjendja me 31.12.2022
1	Aut.Land Rover Sall. AA 786 AS	5,993,400		5,993,400
2	Aut. Ë Transportier DR 4387 D	4,297,000		4,297,000
3	Aut. Ë polo DR 1513 D	1,695,000		1,695,000
4	Aut. Ë polo DR 1512 D	1,695,000		1,695,000
5	TOYOTA Rav 4	2,388,000		2,388,000
6	TOYOTA Rav 4	2,388,000		2,388,000
7	Mitshubish L-200	3,739,800		3,739,800
8	Hyndei Accente	2,173,920		2,173,920
9	Hyndei Accente	2,173,920		2,173,920
10	BICIKLETA	140,000		140,000
11	FUORISTRAD 4+1, FORD		4,200,000	4,200,000
12	AUTOVETURE 4+1, HYUNDAI		2,148,000	2,148,000
13	AUTOVETURE 4+1, HYUNDAI		2,148,000	2,148,000
14	FURGON 8+1, FORD		4,200,000	4,200,000
15	Autobot zjarrfikes Benz AA841SJ	266,000		266,000
16	Automjet zjarrfikes Iveco pol 13-19	2,555,000		2,555,000
17	Autobot zjarrfikes Iveco VL 95-36	5,838,602		5,838,602
18	Automjet zjarrfikes Benz DR56-04	3,040,000		3,040,000
19	Autoshkalle Benz DR46-74D	21,146,155		21,146,155
20	Ambulance Opel AA842SJ	1,064,000		1,064,000
21	Autopomp zjarrfikesBenz DR46-72	851,109		851,109
22	Automjet zjarrfikes Benz DR 56-03	2,990,000		2,990,000
23	Automjet zjarr. Benz AtegoAA302LS	29,023,260		29,023,260
24	Varke me motor plastike	1516018		1516018
25	Autoshkalle	6,600,000		6,600,000
26	Iveco Eurofire	4,850,000		4,850,000
27	Karrel I Pajisur me Depozit Uji , pompe shuarje zjarri		5,555,754	5,555,754
	TOTALI	**106,424,184**	**18,251,754**	**124,675,938**

- Gjendja e llogarisë 218 "Inventar Ekonomik" në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 92,205,736 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 115,929,405 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 92,205,736 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 44,627,643 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 37,291,740 lekë. Pakësimet janë në vlerën 2,285,499 lekë, që përfaqësojnë aktivet e inventarit ekonomik të nxjerrë jashtë përdorimi për llogari të vitit 2021, sipas vendimit te KB nr.38,datë 04.05.2022.

- Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" të PF si më poshtë:

- ***Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale*** paraqitet në bilanc në vlerën 82,891,738 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.
"Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara" është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"pika 36 Përllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje te periudhes ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikmit.
Për aktivet e llogarisë 218 "Inventar Ekonomik", në të cilat përfshihen paisjet kompjuterike llogaritja e amortizimit është bërë në grup dhe jo aktiv për aktiv dhe nuk mund të verifikoheshin se si janë grupuar dhe llogaritur amortizimi për paisjet kompjuterike.

<u>Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Durrës</u>

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:
Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 për Bashkinë Durrës dhe Njësitë Administrative në varësi.
Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit per vitin 2022 kanë dalë:
- Urdhri nr. 505, datë 14.10.2022 "Per ngritjen e komisionit te inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të panevojshme të NJA dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit ", ku komisioni përbëhet prej 5 vetësh: E.L (kryetar), F. P. (anetar), A. Zh. (anetar), E. K. (anetar), M. L. (anetar).
- Urdhri nr. 511 datë 17.10.202 "Per ngritjen e komisionit te inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të panevojshme të Bashkisë Durrës dhe Drejtorisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe Policisë Bashkiake" ku komisioni përbëhet nga 5 vetësh: Ha. R. (kryetar), A. M.i (anetar), A.G. (anetar), F. M. (anetar), J. M. (anetar).
Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit në Aparatin e Bashkisë Durrës, MZSH, NJA dhe Policinë Bashkiake rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventareve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive 31 "Materiale",llog.32 "Inventar i imët", llog.214 "Instalime teknike, makineri dhe paisje" dhe llog. llog.2018 "Inventar ekonomik". Fletët e inventareve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2022 dhe rezultojnë pa diferenca. Në rubrikën e e srezultati/shënime nga komisionet e inventarizimit janë evidentuar aktivet që propozohen për nxjerrje jashtë përdorimi. Në fund të procesit të inventarizimit nga grupi i nventarizimit është hartuar raporti përmbledhës për gjithë inventarin e AAGJM, ku përshkruhen mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit. Me shkresën nr.prot.extra datë 14.12.2023 nga komisioni i inventarizimit është hartuar procesverbali i vlërsimit të inventarit ekonomik, pajisjeve elektronike e informatike dhe inventarit të imët. Në këtë dokument janë listuar 130 artikuj aktivesh në sasi dhe vlerën prej 2,201,233 lekë (llog. 214 "Instalime teknike, makineri dhe paisje" në vlerën 573,162 lekë dhe llog. 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 1,628,071 lekë) dhe në fund komisioni është shprehur se këto aktive janë të konsumuara e nuk kanë më vlerë përdorimi dhe nuk mund të riparohen.
Nga titullari nuk është ngritur komisioni I vlerësimi dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve. Pra nuk është kryer procesi I nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjesimi i tyre.
Konkluzion: Nga Titullari i Bashkisë Durrës nuk është ngritur komisioni nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, duke mos u kryer procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe ajo e asgjesimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në vlerën 2,201,233 lekë. Për këtëo aktive janë kryer veprimet kontabël të pakësimit konkretisht në llog. 214 "Instalime teknike, makineri dhe paisje" në vlerën 573,162 lekë dhe llog. 1,628,071 lekë, pa u kryer procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe ajo e asgjesimit të këtyre aktiveve. Këto veprime janë në kundërshtim me

UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"pikat 95-109.

Titulli gjetjes*: Mbi mos realizimin e plotë të prcedurave të nxjerrjes jashtë përdorimi dhe mos asgjesimit të AAGJM*

Situata: Nga Titullari i Bashkisë Durrës nuk është ngritur komisioni nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, duke mos u kryer procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe ajo e asgjesimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në vlerën 2,201,233 lekë. Për këto aktive janë kryer veprimet kontabël të pakësimit konkretisht në llog. 214 "Instalime teknike, makineri dhe paisje" në vlerën 573,162 lekë dhe llog. 1,628,071 lekë, pa u kryer procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe ajo e asgjesimit të këtyre aktiveve.

Kriteri: UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" I ndryshuar, pika 95-114

Impakti: Nuk është kryer procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe procedura e asgjesimit të aktiveve në vlerën 2,201,233 lekë.

Shkaku: Nga Titullari i Bashkisë nuk është ngritur komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi.

Rëndësia: I lartë

Konkluzion: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2022 në vlerën 1,401,397,524 lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivi. Nuk është kryer inventari fizik i aktiveve materiale gjendje në fund të vitit 2022 në llogaritë: *210 "Toka, Troje, Terrene"* është në vlerën 180,594,841 lekë; *212 "Ndërtesa Konstruksione"* në vlerën 1,133,027,482 lekë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve" **pika 74** në të cilën përcaktohet se: *" Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*

Konkluzion: Gjendja e ***llog. 231"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"*** në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 2,823,268,556 lekë.

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

në lekë

Nr.Reshti	Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur 2022	Ushtrimi Paraardhes 2021
65	**B**	**PASIVET(DETYRIMET)**	**1,111,667,670**	**1,089,792,923**
66		**I.Pasivet Afat shkurtra**	**1,111,667,670**	**1,089,792,923**
67		**1. Llogari te Pagushme**	**519,519,119**	**600,142,090**
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	12,243,236	303,236
69	42	Detyrime ndaj personelit	25,440,333	23,749,538
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	2,393,534	2,177,535
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	7,862,602	7,387,753
76	436	Sigurime Shendetsore	1,070,829	1,005,782
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	296,380,889	284,567,662
82	467	Kreditore te ndryshem	174,127,696	280,950,584
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime		
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		**2.Te tjera pasive afatshkurtra**	**592,148,551**	**489,650,833**
86	419	Kreditore, Parapagime		

87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese	591,457,852	488,960,134
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar	690,699	690,699
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit		
91		**II.Pasivet Afat Gjata**	**1,111,667,670**	**1,089,792,923**
92	Klase 4	Llogari te pagushme	**519,519,119**	**600,142,090**
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	**C**	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**5,930,349,357**	**4,407,564,579**
97	**D**	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**5,930,349,357**	**4,407,564,575**
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,534,811,570	1,474,185,049
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	1,572,269,231	1,801,992,540
101	111	Rezerva		0
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		0
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne		0
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	0	0
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	0	0
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
107		Te Tjera	2,823,268,556	1,131,386,986
108	**E**	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**7,042,017,027**	**5,497,357,498**

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,111,667,670 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- Gjendja e llogarisë 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarije në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 303,236 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 12,243,236 lekë, vlerë e cila ka ardhur në rritje, duke shtuar faturat e palikujduara për mallra, shërbime dhe investime të periudhës së fundvitit ushtrimor.Sipas analizës së gjëndjes së kësaj llogarie rezulton se, përbëhet nga 3 fatura të palikujduara ndaj të tretëve, borxh i krijuar në nentor-dhjetor të vitit 2022, ku në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analiza e llogarisë 401 "Furnitorë e llogari të lidhura me to (mallra e shërbime)"

NR	EMERTIMI	PERSHKRIMI	NR	DATE	Vlera e pa likujduar
1	E.	Blerje pajisje Zyrash	1320/2022	12.12.2022	11,940,000
		T O T A L I I LLOGARISE 401			**11,940,000**

Analiza e llogarisë 404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to(për investime)"

Nr.	Subjekti	Pershkrimi I Kontrates	Numri fatures	Data	Gjendje 31.12.2022
1	V. H.shpk	Rehabilitimi i infrastruktures se rrjetit ne zonen e Porto-Romanos-Kenete	146/2022	16.12.2022	51,528,000
2	P.C.	Mbikqyrje, Rikonstruksion Ruga Njesia Ad.Ishem	56/2022	29.12.2022	285,296
		TOTALI I			**51,813,296**

Konkluzion: ***Gjendja e llogarisë 16 "Hua Afat Gjata"*** paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 dhe 2021 në vlerën 0 lekë**,** ndërkohë që Bashkia Durrës ka marrë në vitin 2014 Kredi të financuar nga CEB në vlerën 3,341,000 euro ose në 352,937,752 lekë për ndërtimin e Banesave Sociale investim I kryer që në ato vite. Kjo kredi është ratifikuar në parlament dhe lëvrimi i kredisë është bërë nëpërmjet Marrëveshjes së nënshkruar nga Bashkia Durrës me MFE, pagesa e sëcilës ndiqet nga kjo e fundit. Nuk kemi një evidentim të shumës së kësaj huaje në kredi të llog. ***16 "hua afatagjata"*** dhe për pagesat e kryera në vlerën 171,479,202 lekë në debi të kësaj llogarije, në mënyrë që gjendja e kësaj llogarie të paraqesë vlerën e kredisë së mbetur pa paguar prej 181,458,550 lekë. Në fakt për pagesat e kësteve të kredisë është rënduar më pa të drejtë *llogaria 231 "investime në proces",* kur ky investim është kryer si punime dhe si financime dhe është pasqyruar në llogarive e aktiveve *212"Ndërtesa dhe konstruksione"***.** Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së

përgjithshme"Kreu II, pika **2.3 "**Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik" nënpika **22,23** Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik".

Titulli gjetjes*: Mbi kontabilizimin e gabuar të kredisë të financuar nga CEB për ndërtimin e banesave sociale.*

Situata: Gjendja e llogarisë *16 "Hua Afat Gjata"* në pasiv të bilancit paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 dhe 2021 në vlerën 0 lekë**,** ndërkohë që Bashkia Durrës ka marrë në vitin 2014 Kredi të financuar nga CEB në vlerën 3,341,000 euro ose në 352,937,752 lekë për ndërtimin e Banesave Sociale investim I kryer që në ato vite. Kjo kredi është ratifikuar në parlament dhe lëvrimi i kredisë është bërë nëpërmjet Marrëveshjes së nënshkruar nga Bashkia Durrës me MFE, pagesa e sëcilës ndiqet nga kjo e fundit. Nuk ka një evidentim të shumës së kësaj huaje në krdi të llog. *16 "hua afatagjata"* dhe për pagesat e kryera në vlerën 171,479,202 lekë në debi të kësaj llogarije, në mënyrë që gjendja e kësaj llogarie të paraqesë vlerën e kredisë së mbetur pa paguar prej 181,458,550 lekë. Në fakt për pagesat e kësteve të kredisë është rënduar më pa të drejtë *llogaria 231 "Investime në proces",* kur ky investim është kryer si punime dhe si financime dhe është pasqyruar në llogaritë e aktiveve *212"Ndërtesa dhe konstruksione".*

Kriteri: Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II, pika 2.3 "Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik" nënpika 22, 23, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik".

Impakti: Gjendje e pasaktë e llogarisë 231 "Shpenzime për investime në proces"dhe llog.16 "Hua Afat Gjata".

Shkaku: Drejtoria e Financës nuk ka marrë masa për evidentimin dhe kontabilizimin e saktë dhe në llogarinë e duhur të kredisë për banesa sociale.

Rëndësia: I lartë

- ***Gjendja e llogarisë 42 "Detyrime ndaj personelit"*** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 25,440,333lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2023.
- ***Gjendja e llogarisë 431 "Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat"*** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën kontabël 2,393,534 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.
- ***Gjendja e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore"*** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 7,862,602 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasaardhës e analizuar si vijon:.

b.Sigurimet shoqërore 15% punëdhënësi vlera 3,034,321 lekë.

- ***Gjendja e llogarisë* 436** "*Sigurime shëndetësore*" në fund të vitit 2022 është në vlerën kontabël 1,070,829, e cila përbëhet nga:

a.Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarsi vlera 343,886 lekë

b.Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlera 343,886 lekë.

Konkluzion: ***Gjendja e llogarisë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"*** paraqitet si në mbeyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që shuma e gjendjeve të debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit është në vlerën 592,148,550 lekë përkatësisht: (gjendja e llog.468 "debitorë të ndryshëm" në vlerën 591,457,852 lekë + gjendja e llog.423-429 "Personeli,paradhënie, deficite,gjoba" në vlerën 690,699 lekë). Këto gjendje janë paraqitur në mënyrë të gabuar në llogaritë në pasiv të bilancit në gjendjen e llog. 475 "Të ardhura për tu rregjistruar vitet pasardhëse" në vlerën 591,457,852 lekë dhe gjendjen e llog.480 të ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar në vlerën 690,699 lekë, kur duheshin paraqitur në gjendjen e llog. *4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"*.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu III. "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 42, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik"pika 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 "Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin" në të cilën përcaktohet se:

- ***Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"*** *është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe perfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Konkretisht, trajtimi kontabël është si më poshtë: a) Pasi ka ndodhur situata dhe është bërë veprimi kontabël:*

- *Debitohet llogaria 411/468, klientë apo debitorë të ndryshëm për konstatimin e një të ardhure (pavarësisht raportit të pjesëmarrjes (buxhet apo institucion);*
- *Kreditohen llogaritë respektive të klasës 7 për të ardhurën e konstatuar.*

- ***Llogaria 475 "Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse".*** *Edhe kjo llogari hyn në grupin e llogarive rregulluese. Në të, sipas rastit të çdo institucioni, evidentohen të ardhurat që janë arkëtuar përpara ngjarjes ose veprimit që krijon të ardhura.*
- ***Llogaria 480 "Të ardhura për t'u klasifikuar ose rregulluar".*** *Në këtë llogari pasqyronhen të ardhura të arkëtuara, por me dokumentacion të paplotësuar ose të paqartë deri në datën e mbylljes së bilancit kontabël të institucionit. Teprica kreditore e kësaj llogarie kërkon sqarime në të dhënat shpjeguese. a) Funksionimi kontabël kur hyjnë arkëtimet:*

- *Kreditohet llog.480 "Të ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar";*
- *Debitohet klasa 5 " Llogaritë financiare".*

Titulli gjetjes*: Mbi kontabilizimin e gabuar të* detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit si debitorët në llog. *4341 "Operacione me shtetin (detyrime)".*

Situata: Gjendja e llogarisë *4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"* paraqitet si në mbeyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që shuma e gjendjeve të debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit është në vlerën 592,148,550 lekë përkatësisht: (gjendja e llog.468 "debitorë të ndryshëm" në vlerën 591,457,852 lekë + gjendja e llog.423-429 "Personeli,paradhënie, deficite, gjoba" në vlerën 690,699 lekë). Këto gjendje janë paraqitur në mënyrë të gabuar në llogaritë në pasiv të bilancit në gjendjen e llog. 475 "Të ardhura për tu rregjistruar vitet pasardhëse" në vlerën 591,457,852 lekë dhe gjendjen e llog.480 të ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar në vlerën 690,699 lekë, kur duheshin paraqitur në gjendjen e llog. *4341 "Operacione me shtetin (detyrime)".*

Kriteri: Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu III. "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 42, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik"pika 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 .

Impakti: Gjendje pasktë e llog. *4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"*

Shkaku: Drejtoria e Financës nuk ka marrë masa për kontabilizimin e saktë të detyrimeve ndaj shtetit

Rëndësia: I mesëm

- Gjendja e llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 284,567,662 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 296,380,889 lekë. Këto detyrime mund të evidentohen ose në llog.4341*"Operacione me shtetin (detyrime)".* Për

gjendjen e llog 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Durrës, ku në mënyrë analitike paraqitet në Aneks.

LLOGARIA 466	2021	2022
Qendra Ekonomike e Arsimit	4,706,000	4,706,000
TRASHEGUAR NGA TE ARDHURAT	1,875,902	1,875,902
TRASHEGUAR NGA TE ARDHURAT KOMUNAT	1,712,080	1,712,080
VITI 2010 4662104	2,795,338	2,795,338
VITI 2011 4662104	9,144,116	9,144,116
VITI 2012 4662104	2,761,328	2,761,328
VITI 2013 4662104	378,913	378,913
VITI 2014 4662104	1,275,466	1,275,466
VITI 2015 4662104	12,512,864	12,512,864
VITI 2016 4662104	6,234,333	5,401,988
VITI 2017 4662104	15772280	14222769
VITI 2018 4662104	25015094	23772930
KOMUNAT 4662104	11,168,112	11,168,112
VITI 2019	45594301	27933634
VITI 2020	26575597	16677888
VITI 2021	117045938	116404850
VITI 2022		43,636,711
TOTALI 466	**284,567,662**	**296,380,889**

- Gjendja e llogarisë 467 ***"Kreditorë të ndryshëm"*** në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 280,950,584 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 174,127,696 lekë me një diferencë në zbritje prej 106,822,888 lekë lekë ne krahasim me vitin 2021. Kjo gjendje përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të të vonesave të krijuara në kryerjen e procedurave të prokurimit, në lidhjen e kontratave apo në mbërritjen me vonesë të faturave dhe si rezultat i bllokimit të transaksioneve financiare nga MFE në ditët e fundit të dhjetorit të vitit ushtrimor. Nga analiza e kësaj gjendje rezulton se, janë kryesisht detyrimet të lindura nga mbajtja e penaliteteve nga Bashkia dhe nga rekomandimet shpërblim dëmi të lënë nga KLSH-ja, të cilat janë në procese gjyqësore, të evidentuara në kontabilitet. Analiza e kësaj llogarije paraqitet në Aneks:

Nr	Subjekti	Pershkri i kontratës	Numri i faturës	Data e fatures	Celje ne fillim 2022	Likuiduar gjate 2022	Shtuar gjat vitit 2022	Gjendje 31.12.2022
1	D.P	Kolaudim rr.brend. 2013	112134	1/9/2014	11,400			11,400
2	L.K.	Kolaudim rik.rr. M.-shenp.	9790023	12/26/2013	1,200			1,200
3	R shpk	Sup.pastrim kanale kullues	10823710	10/31/2013	11,520			11,520
4	B.T	Kolaudim past.kanale kulluese	85035305	11/5/2013	4,740			4,740
5	G .	Sup.ndert.pusetash f.gjuricaj	1935398	12/5/2014	34,800			34,800
6	P	Kolaudim rrug.brend.2014	13207683	11/26/2014	26,400			26,400
7	A shpk	Rik.Zyrave te Reja(ndertim i rrjetit elektrik)	19950641	3/31/2015	40,000			40,000
8	N shpk	Sistemim asfaltim rruge L.Erzen	40337193	2/28/2011	405,000			405,000
9	V	Rr. Mamin. Sh. Pjeter			3,179,888			60,000
10	E shpk	Rik rr.Hoxha-Fortuzi ne fshatin Shkalle(LOTI I)	ature	prere fature	31,640,904			120,000
11	H	RRASHBULL			1,549,312			226,808
12	V. H.shpk	Rehabilitimi i infrastruktures se rrjetit ne zonen e Porto-Romanos-Kenete	146/2022	16.12.2022			51,528,000	51,528,000
13	E.	Blerje pajisje Zyrash	1320/2022	12.12.2022			11,940,000	11,940,000
14	P. c.	Mbikqyrje	56/2022	29.12.2022			285,296	285,296
I		**TOTALI I**			36,905,164	11,250,279	63,753,296	100,658,460
		VENDIMET GJYQESORE TE PA LIKUJDUARA						
		EMRI I PERSONIT/SUBJEKTIT						
1		K.K			4,310,666			4,310,666
2		CEL V.			1,893,376			1,893,376
3		F.RR			3,136,544			3,136,544
4		UKD			64,128,642			64,128,642
5		B (Bashkia Durrës)			1,319,706	1,319,706		
6		AMC			641,043	641,043		
7		N.N D. S.			42,787,822	42,787,822		
8		J.M			1,764,995	1,764,995		

		TOTALI II			119,982,794	46,513,566		73,469,228
		TOTALI I PERGJITHSHEM dt 31.12.2022 I+II			162,216,873	57,763,845		174,127,688

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 "Pasqyra e përformancës financiare" të PF të vitit 2022 paraqitet në Aneks.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 7,766,282,692 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Durrës paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike ***70*** **"Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"**paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 949,928,752 lekë, i cili kuadron me Akrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisëanalitike ***7002*** **"*Tatim mbi Biznesin e vogël*"** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 5,371,607 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël* , ecila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë ***7020 "Tatim mbi pasurinë e palujtshme"***pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 252,328,595 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, ecila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë ***7035 "Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 616,875,220 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndricimit, zënie hapësire publike, qirate për truallin.etj.

- Gjendja e llogarisë ***71*** **"Të ardhurat jo tatimore"**paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 335,374,889 lekë, i cila kuadron me Akrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë ***7109*** "***Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndermarrjet dhe pronesia"*** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 39,525,382 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet i cili kuadron me Akrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b.Gjendja e llogarisë ***711*** "***Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare"*** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 57,755,010 lekë, e cila përfshin tarifat e parkimit, kamatvonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me Akrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve ***7206 "Financim i pritshëm nga buxheti"*** është në vlerën prej 57,755,010 lekë.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2022 , të cilat në total janë në vlerën 6,194,013,461 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë ***600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"*** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 376,222,626 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 376,222,626 lekë diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë ***601 'Kontribute për sigurime"*** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 376,222,626 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 376,222,626 lekë, diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë ***602 "Blerje mallra e shërbime"*** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 629,004,137 lekë dhe sipa aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 629,004,137 lekë , diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë së fondeve ***604 "Transferime korente te brendshme"*** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 95,141,914 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 95,141,914 lekë, diferencanuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve ***606 "Transferime per Buxhetet familjare e Individe"*** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 2,560,340,715 lekë, e cila rakordon me aktrakordimin me Thesarin.

Për vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 7,766,282,692 lekë dhe totali shpenzimeve është 6,194,013,461 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 1,572,269,231 rakordon me gjendjen e llog. 85 "Rezultatin e ushtrimit".

Gjithashtu, gjendja e llogarisë ***63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"*** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën -3,352,270 lekë .

Formati nr.6 "Investimet dhe burimet e financimit"

- Zeri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën 3,471,406,156 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 3,471,406,156 lekë fonde të akorduara per investime,vlera prej 0 lekë investime te dhuruara nga donatore vendas.
- Zëri **"Shpenzime per Aktive Afatgjata materiale"** formati 6 e plotësuar për shumën 119,419,464 lekë në analizë rakordon me pasqyrën "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata" kolona 4 formati 7/b.

Nga testi kontrollit për vitet 2022 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit nuk e kalon limit e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likujduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 *"Për limitin e arkës"*.

Ligjshmëria dhe saktësia e e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet sistemit SIFQ te Ministrise se Financave janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- *Pagesat e kryera jashtë afatit 30 ditë të paraqitjes së faturës.*

Konkluzion: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2022 me urdhër-shpenzime në **21** raste faturash me vlerë 406,300,574 lekë lekë, *mbi afatin 30 ditor të faturave* për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Durrës, *të cilat 23* raste në vlerën 10,502,565 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llog. 602 "shpenzime operative" dhe në 39 raste në vlerën 395,798,009 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llog.231

"investime", ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar për mungesë fondesh nga Ministria, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve. Likuidimi me vonese i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52[5], me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 44 "Kontrolli i shpenzimeve". Rastet më konkretisht paraqiten në tabelat e Aneksit.

Titulli gjetjes: *Mbi pagesat nëpërmjet bankës mbi afatin 30 ditor të faturave të mbërritura.*

Situata: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2022 me urdhër-shpenzime në **21** raste faturash me vlerë 406,300,574 lekë lekë, *mbi afatin 30 ditor të faturave* për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Durrës, *të cilat 23* raste në vlerën 10,502,565 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llog. 602 "shpenzime operative" dhe në 39 raste në vlerën 395,798,009 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llog.231 "investime", ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar për mungesë fondesh nga Ministria, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve.

Kriteri: Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 44 "Kontrolli i shpenzimeve".

Impakti: Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të pa likuiduara.

Shkaku: Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh i pjesës më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh.

Rëndësia: I mesëm

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj. E.L me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe zj. H.H me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës në cilësinë e hartueses së pasqyrave financiare.

(Për sa më sipër është trajtuar më gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 7, datë 17.11.2023).

- Mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimi i tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Në zbatim të pikës 2.6 të programit të auditimit "Mbi ligjshmërinë e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të fondit pyjor, kullosor dhe tokës bujqësore të pa ndara" ***u shqyrtua dokumentacioni*** në lidhje me procedurat e dhënies me qira të fondit pyjor, kullosor dhe tokës bujqësore të pa ndara nga ku rezultoi se :

-Në 2 raste, nga Sektori i Administrimit të Pyjeve, nuk është Monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë në lidhje me mos pagesën e qirasë në kohën dhe në mënyrën e caktuar në kontratë***, duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumen totale prej 18,922,298 lekë***, në kundërshtim me nenet e përcaktuar në kontratë dhe në kundërshtim me nenin 830 të Kodit Civil.

-Në 2 raste, nga Sektori i Administrimit të Pyjeve, nuk është ndjekur rruga gjyqësore me kërkesëpadi drejtuar gjykatës për rastet e moszbatimit të kushteve të kontratave të qirasë për ekzekutimin e detyrimit për debitorët (qiramarrësit) për shlyerjen e qirasë në kohën dhe në mënyrën e caktuar në kontratë, në kundërshtim me nenin 830 të Kodit Civil.

[5]në të cilën përcaktohet se*: "Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik."*

-Në 1 rast, nga Bashkia Durrës është lejuar ndërtimi i kompleksit për ushtrimin e veprimtarisë turistike në një zonë bregdetare me përparësi të zhvillimit të turizmit, pa pasur më parë një "Leje zhvillimi dhe Ndërtimi", në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar dhe në kundërshtim me neni 20 të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit".
-Në 1 rast, nga Bashkia Durrës është lejuar shfrytëzimi i sipërfaqes prej 1.5 ha jo aty ku është miratuar pranëvendosja në bazë të koordinatave të miratuar nga ish-Komuna Ishëm, por në një pozicion tjetër që nuk ka lidhje me pranëvendosjen e miratuar, në kundërshtim me kordinatat e miratuara në kontratën e qirasë datë 02.04.2015 midis qiradhënësit dhe qiramarrësit.
-Në 2 raste, nga qiradhënësi Bashkia Durrës nuk është kërkuar zgjidhja e njëanshme e kontratës për sa kohë qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas nenit 4 dhe 5 të përcaktuar në kontratën e qirasë.
-Në 13 raste, Kontrata Tip "Për dhënien me qira të fondit pyjor, kullosor dhe të tokës bujqësore të pandara" e lidhur midis qiradhënësit dhe qiramarrësit me afat mbi 9 vjet, nuk janë të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë DV ASHK Durrës, në kundërshtim me nenin 826 të Kodit Civil.
-Në të gjitha rastet, nga Sektori i Administrimit të Pyjeve nuk është kërkuar bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, për të kërkuar monitorim dhe konsulencë juridike për mosmarrëveshjet që kanë lindur nga zbatimi i kontratave apo marrëveshjeve në rastet e konflikteve civile, nga mosrespektimi korrekt i tyre.

Monitorimi i zbatimit të kushteve të kontratës për dhënien me qira të fondit pyjor, kullosor që janë aktive deri në periudhën objekt auditimi rezultoi se janë lidhur 6 kontrata me qiradhënës Bashkinë Durrës dhe konkretisht:

Kontrata për dhënien me qira të fondit pyjor e kullosor që vazhdojnë të jenë aktive.

Nr.	Qiramarësi	Zona	Objekti	Afati	Kontrate Data	Detyrim vjetor lekë	Paguar	Pa paguar Lekë
1	S. A.	Ishem	Për veprimtari turistike.	10 vite	25.09.2017	139,425	Po	0
2	Eco-A 1.0 ha	Ishem	-||-	10 vite	02.04.2015	75,000	Jo	412,500
3	Eco-A 1.5 ha	Ishem	-||-	10 vite	02.04.2015	112,500	Jo	618,750
4	E. T.	Rrashb.	-||-	10 vite	24.05.2019	175,000	Po	0
5	A.J.	Ishem	-||-	10 vite	02.04.2015	123,750	Po	0
6	L.	Ishem	-||-	10 vite	17.09.2015	635,496,301	Po	0
TOTALI								**1,589,458**

Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit në lidhje me monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratës për dhënien me qira të fondit pyjor, kullosor, tokë bujqësore, nga Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimi Veterinar dhe Emergjencave Civile, që janë aktive deri në periudhën objekt auditimi rezultoi:
-Në lidhje me subjektin E.-A GROP (Qiramarrës) rezulton të jenë lidhur 2 kontratë qiraje me datë 02.04.2015 midis qiradhënësit ish-Komuna Ishëm dhe qiramarrësit E.-A me afat 10 vjeçar për sipërfaqen 1,5 ha, me një vlerë vjetor prej 112,500 lekë dhe për sipërfaqen 1 ha, me një vlerë vjetor prej 75,000 lekë, për veprimtari turistike "Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore shoqërore dhe veprimtari turistike, kampingje" me adresë: Fshati Shetaj, Kepi i Rodonit ngastra pyjore me nr. 2/a, ekonomia pyjore Rrotull, Z.K. 3365 me nr. pasurie 45, me sipërfaqe 1,5 ha dhe 1 ha, pronë e ish-Komuna Ishëm.
Qiramarrësi Subjekti E.-A G. rezulton të mos ketë paguar qiranë për 6 vite, që do të thotë se qiramarrësi është debitor në shumën totale prej 1,589,458 lekë.
Në bazë të kontratës me datë 02.04.2015 qiramarrësi detyrohet të paguajë detyrimin vjetor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në nenin 5 pika 5.3. Në raste se qiramarrësi nuk do të kryeje

pagesën sipas kushteve të vendosura në kontratë, qiramarrësi për çdo ditë vonesë, do të paguajë një kamatë vonese prej 0.01% të vlerës së qirasë, që do të thotë se nga qiradhënësi ish-Komuna Ishëm (Bashkia Durrës) nuk është Monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë.
Nga qiramarrësi nuk është respektuar neni 5 "Pagesa dhe regjimi i saj" i Kontratës së Qirasë datë 02.04.2015, për shumën totale prej 187,500 lekë që do të paguhet brenda 10 ditëshit të parë të muajt janar të viteve pasardhëse, sipas faturës së lëshuar nga Bashkia Durrës, që do të thotë se nga qiramarrësi nuk është paguar qiraja e 6 viteve në shumen prej 1,589,458 lekë,
Nga qiradhënësi Bashkia Durrës nuk është Monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë për sipërfaqe 1.5 ha dhe 1 ha. me afat 10-vjeçar, ku në nenin 6 pika 6.3 citohet se: *"Qiradhënësi ka të drejtë të kërkoje zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas përcaktimeve të nenit 4 dhe 5 të kësaj kontrate..."*.
Gjithashtu 2 kontratat e qirasë rezultojn që të mos jenë të regjistruara në ZVRPP Durrës, në kundërshtim me nenin 826 të Kodit Civil.

Konkluzion:
-Nga qiradhënësi Bashkia Durrës nuk është kërkuar zgjidhjen e njëanshme të kontratës për sa kohë qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë në shumën totale prej 1,589,458 lekë sipas përcaktimeve të nenit 4 dhe 5 të kësaj kontrate.
-Nga ana e Bashkisë Durrës (Drejtoria juridike) nuk është ndjekur rruga gjyqësore për mosmarrëveshjet që kanë lindur nga zbatimi i kontratave apo marrëveshjeve në rastin e konflikteve civile, ku rezulton të jetë debitor prej 6 vitesh duke mos shlyer qirasë në kohën dhe në mënyrën e caktuar në kontratë, ***duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumen totale prej 1,589,458 lekë***, në kundërshtim me nenin 830 të Kodit Civil.

-Në lidhje me Subjektin A.J.(Qiramarrës) rezulton të jetë lidhur kontratë qiraje me datë 02.04.2015 me qiradhënës ish-Komuna Ishëm, me afat 10 vjeçar për sipërfaqen 1,5 ha, me një vlerë vjetore prej 123,750 lekë, për aktivitet biznesi "Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësorë shoqërore dhe veprimtari turistike, kampingje", me adresë Fshati Shetaj, Kepi i Rodonit ngastra pyjore me nr. 2/a, ekonomia pyjore Rrotull, sipas hartës kadastrale pasuria nr. 72, Z.K. 3365 me sipërfaqe 1,5 ha, pronë e ish-Komuna Ishëm.
Në dosje është administruar e gjithë dokumentacioni fotokopje.
Kontrata e qirasë me datë 02.04.2015 me qiradhënës ish-Komuna Ishëm, me afat 10 vjeçar për sipërfaqen 1,5 ha, me një vlerë vjetore prej 123,750 lekë, për aktivitet biznesi "Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësorë shoqërore dhe veprimtari turistike, kampingje" nuk është me akt noterial në zbatim të nenit 826 të Kodit Civil.
Nisur nga pranëvendosja e sipërfaqes së tokës "Pyll" me sipërfaqe 1.5 ha që është dhënë me qira "Për qëllime pushimi argëtimi, shëndetësorë shoqërore dhe veprimtari turistike, si sheshe për kampingje, kënde lojërash për fëmijë etj" me vëndodhje Fshati Shetaj, Kepi i Rodonit Komuna Ishëm rezulton se objektet e ndërtuar qëllime pushimi etj. janë të spastrua nga pozicioni fillestar i miratuar nga topografi me licence dhe nga qiradhënësi ish-Komuna Ishem, ky fakt provohet nga imazhet në geoportal.asig.gov.al. (hartën dixhitale) dhe në Google Earth (sipas ortofotos).
Nga Bashkia Durrës është lejuar ndërtimi i kompleksit për ushtrimin e veprimtarisë turistike në një zonë bregdetare me përparësi të zhvillimit të turizmit, pa pasur më parë një "Leje zhvillimi dhe Ndërtimi", në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr.107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar dhe në kundërshtim me neni 20 të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit".

Konkluzion:
-Nga Bashkia Durrës është lejuar shfrytëzimi i sipërfaqes prej 1.5 ha jo aty ku është miratuar pranëvendosja në bazë të koordinatave të miratuar nga ish-Komuna Ishëm, por në një pozicion

tjetër që nuk ka lidhje me pranëvendosjen e miratuar, në kundërshtim koordinatat e miratuara me kontratën e qirasë datë 02.04.2015 midis qiradhënësit ish-Komuna Ishëm dhe qiramarrësit subjekti A. J.
-Nga Bashkia Durrës është lejuar ndërtimi i kompleksit për ushtrimin e veprimtarisë turistike në një zonë bregdetare me përparësi të zhvillimit të turizmit, pa pasur më parë një "Leje zhvillimi dhe Ndërtimi", në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr.107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar dhe në kundërshtim me neni 20 të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit".

Monitorimi i zbatimit të kushteve të kontratës për dhënien me qira të tokës bujqësore të pa ndara që janë aktive deri në periudhën objekt auditimi rezultoi se janë lidhur 7 kontrata me qiradhënës Bashkinë Durrës dhe konkretisht:
Kontrata për dhënien me qira të tokës bujqësore, që janë aktive deri në vitin 2022, janë sipas tabelës:

Nr	Qiramarësi	Zona	Llpji i pasu.	Afati vjet	Kontratë Nr. Datë	Debia progres. 31.12.21	Dety. vjetor lek/ha 2022	Paguar	Debia progres. 31.12.22	Sip. Ha
1	B.sh.p.k	Rrashb.	Tokë "buqj"	99	27.12.2012		6500	Likujd.	-	6
2	N.B.	Manez	Tokë "buqj"	99	01.07.2013		8000	Likujd.	-	3.43
3	A. D.	Manez	Tokë "buqj"	35	20.05.2013		7000	Likujd.	-	0.6
4	"SH.-E-CO"	Rrash.	Tokë "pa frut"	30	27.11.2008	7623200	20000		8209600	29.32
5	"SH.-E-CO"	Rrashb.	Tokë "pa frut"	30	27.11.2008	4223180	20000		4548040	16.44
6	"SH.-E-CO"	Rrashb.	Tokë "pa frut"	30	27.11.2008	2714400	20000		2923200	10.44
7	"SH.-E-CO"	Rrashb.	Tokë "pa frut"	30	27.11.2008	1534000	20000		1652000	5.09
TOTALI									**17,332,840**	

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratës për dhënien me qira të tokës bujqësore, nga Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve, Sherbimi Veterinar dhe Emergjencave Civile, që janë aktive deri në periudhën objekt auditimi rezultoi:
- Subjekti B. sh.p.k (Qiramarrës) rezulton të jetë lidhur kontratë qiraje me datë 27.12.2012 me qiradhënës Komuna Rrashbull, me afat 99 vjeçar me sipërfaqe 6 ha, me nr. pasurie 106/4-1 dhe pasurinë nr. 42/25-1 Z.K. 3385 Fshati Shkallnur, Njësia Administrative Rrashbull.
- Subjekti A. D. (Qiramarrës) rezulton të jetë lidhur kontratë qiraje me datë 21.06.2013 me qiradhënës Bashkia Manëz, me afat 35 vjeçar me sipërfaqe 0.6 ha, me nr. pasurie 275/19, Z.K. 3137 Fshati Radë Njësia Administrative Manëz.
-Subjekti N. B. (Qiramarrës) rezulton të jetë lidhur kontratë qiraje me datë 01.07.2013 me qiradhënës Bashkia Manëz, me afat 99 vjet me sipërfaqe 03.43 ha, me nr. pasurie 15/4, Z.K. 3383 Fshati Shkallë Njësia Administrative Manëz, rezultoi se:

Bazuar në Udhëzimin e KM nr.1 datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokës bujësore të pandara" nga Kryetari i Bashkisë është urdhëruar ngritja e grupit të punës për monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratave të qiradhënies të pasurive tokë bujqësore e pa ndarë, të lidhura midis ish-Bashkisë Manëz dhe subjektit A. D. dhe subjektit N. B. mbi realizimin e detyrave të palëve sipas kontratës, realizimi i zërave të plan-biznesit bashkëlidhur kontratëve si dhe gjendja e bilancit financiar mbi investimeve të realizuar dhe afatet e pagesave të qirasë.

Në lidhje me monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratave të qiradhënies të pasurive tokë bujqësore e pa ndarë, nga grupi i punës është dërguar informacion Kryetarit të Bashkisë Durrës me shkresën nr. 7086/4 prot., datë 17.9.2019 "Mbi monitorimin e kontratës të qiradhënëse të tokë bujqësore me subjektin qiramarrës Buna sh.p.k, subjetin A. D. dhe subjektin N. B., ku rezulton se nga kryetari i grupit të monitorimit Z. L. G. nuk është konstatuar dhe evidentuar fakti se Kontrata Tip "Për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandara" e lidhur midis qiradhënësit ish-Komuna Rrashbull dhe ish-Bashkia Mamëz dhe qiramarrësit subjekti B. sh.p.k, subjekti A. D. dhe subjekti N. B., me afat 99 vjet, 35 vjet dhe 99 vjet, nuk janë të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë DV ASHK Durrës, ku kjo e fundit pajise qiramarrësin me "Certifikatë për dhënie me qira" ku vërteton se qiradhënësi ka dhënë me qira pasurinë e paluajtshme sipas kontratës datë 27.12.2012, me qiradhënës Komuna Rrashbull me subjektin qiramarrës B. sh.p.k sipërfaqen 6 ha, me nr. pasurie 106/4-1 dhe pasurinë nr. 42/25- në llojin e pasurisë "Arë" regjistruar në vol. dhe faqe, Z.K. 3385 Fshati Shkallnur, për qiramarrësin subjektin A. D.për sipërfaqen 0.6 ha, me nr. pasurie 275/19, në llojin e pasurisë "Arë" regjistruar në vol. dhe faqe, Z.K. 3137 dhe për qiramarrësin N. B.për sipërfaqen 03.43 ha, me nr. pasurie 15/4, Z.K. 3383 Fshati Shkallë, Njësia Administrative Manëz, veprime këto në kundërshtim me dispozitat e Kodit Civil neni 826 vijues, ku përcaktohet se:

Neni 826.
"Kontrata e qirasë të pasurisë së paluajtshme që shërben për kultivimin bujqësor për një kohë mbi nëntë vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.

Konkluzion:
Kontrata Tip "Për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandara" e lidhur midis qiradhënësit Komuna Rrashbull dhe qiramarrësit B. sh.p.k me afat 99 vjet si dhe midis qiradhënësit Bashkia Mamëz dhe qiramarrësit A. D. dhe N. B.me afat 35 vjet dhe 99 vjet, nuk janë të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë DV ASHK Durrës, në kundërshtim me nenin 826 të Kodit Civil.

-Në lidhje me **subjektin SH.E-CO/E. sh.p.k** (Qiramarrës) rezulton të jetë lidhur 4 kontratë qiraje midis qiradhënësit Drejtoria e Administrimit të Ndërmarrjeve të Përbashkëta të Braktisura (rilidhura nga Komuna Rrashbull) dhe qiramarrësit SH.-E-CO/E. sh.p.k dhe konkretisht:

1- Kontratë-Qiraje për vendin e quajtur "Kodra e Vaut të Gjosë" lidhur me datë 27.11.2008, me afat 30 vjeçar, në fshatin Shkallnur, me sipërfaqe 293.225 m^2.

2- Kontratë-Qiraje për vendin e quajtur "Kodra e Beut" lidhur me datë 27.11.2008, me afat 30 vjeçar, në fshatin Shkallnur, me sipërfaqe 162.425 m^2.

3- Kontratë-Qiraje për vendin e quajtur "Kodra e Kuqe" lidhur me datë 27.11.2008, me afat 30 vjeçar, në fshatin Shkallnur, me sipërfaqe 104.400 m^2.

4- Kontratë-Qiraje për vendin e quajtur "Kodra e Gurit të Bardhë" lidhur me datë 27.11.2008, me afat 30 vjeçar, në fshatin Shkallnur, me sipërfaqe 59.000 m^2.

Nga auditimi rezulton se kontratat e qirasë midis qiradhënësit Drejtoria e Administrimit të Ndërmarrjeve të Përbashkëta të Braktisura (rilidhura nga ish-Komuna Rrashbull) dhe

qiramarrësit SH.-E-CO/E. sh.p.k nuk janë pjesë e listës se pronave në pronësi të Komunës Rrashbull, bazuar në VKM "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Rrashbull, të Qarkut të Durrësit" që do të thotë që pasuritë që nuk janë në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme dhe të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të Komunës Rrashbull nuk mund të jepen me kontratë qiraje, gjithashtu 4 kontratat e qirasë rezultojnë që të mos jenë të regjistruara në ZVRPP Durrës, në kundërshtim me dispozitat e nenit 826 të Kodit Civil.

Qiramarrësi Subjekti SH.-E-CO/E. sh.p.k rezulton të mos ketë paguar qiranë nga momenti i lidhjes së kontratës e deri në periudhën e auditimit, që do të thotë se qiramarrësi është debitor në shumën totale prej 17,332,840 lekë.

Në lidhje me monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratave të qiradhënies të pasurive tokë bujqësore e pa ndarë, të lidhura midis ish-Komunës Rrashbull dhe subjektit **SH.-E-**CO/E. sh.p.k rezulton se nga qiramarrësi nuk janë paraqitur dokumentacioni bazuar në piken 4.1 të kontratës së qirasë për të justifikuar mos pagesën e shumës prej 17,332,840 lekë si:

-Relacioni në lidhje me menaxhimin dhe realizimin investimeve nga administratori i shoqërisë.

-Akt ekspertimi nga ekspertet kontabël të miratuar ku të përshkruhen dhe të pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në progresiv nga lidhja e kontratës deri në vitin e fundit ushtrimor 2022 nga subjekti qiramarrës në pasuritë e marra me qira.

-Faturat tatimore për situacionet përfundimtar.

-Bilancat vjetore të dorëzuara në Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe të konfirmuara nga kjo e fundit.

Konkluzion:

-Nga ish-Komuna Rrashbull janë lidhur 4 kontratë qiraje midis qiradhënësit Drejtoria e Administrimit të Ndërmarrjeve të Përbashkëta të Braktisura (rilidhura nga Komuna Rrashbull) dhe qiramarrësit SH.-E-CO/E. sh.p.k, në një pasuri ku nuk është e miratuar me VKM "Listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish-Komunen Rrashbull".

-Nga ana e Bashkisë Durrës (Drejtoria juridike) nuk është ndjekur rruga gjyqësore për mosmarrëveshjet që kanë lindur nga zbatimi i kontratave apo marrëveshjeve në rastin e konflikteve civile, ku rezulton që qiramarrësi të jetë debitor, ***duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumen totale prej 17,332,840 lekë***.

-Kontrata Tip "Për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandara" e lidhur midis qiradhënësit ish-Komuna Rrashbull dhe qiramarrësit subjekti SH.-E-CO/E. sh.p.k me afat 30 vjet, nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë DV ASHK Durrës, në kundërshtim me nenin 826 të Kodit Civil.

Titulli i Gjetjes: Nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve dhe nga Drejtoria Juridike nuk është Monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë.

Situata: Në 9 raste**,** nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve dhe nga Drejtoria Juridike nuk është Monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë në lidhje me mos pagesën e qirasë për sipërfaqen e objekteve pasuri shtetërore ***duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumen totale prej*** **939,832 lekë,** në kundërshtim me kreun VI pika 1 të VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar.

Kriteri: VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar, kreu VI pika 1.

Shkaku: Mos monitorimi i zbatimit të kushteve të kontratës së qirasë.

Ndikimi: Të ardhura të munguara në shumen totale prej 939,832 lekë

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike ti drejtohen Gjykatës së Shkalles së Parë Durrës, rastë pas rasti për shlyerjen e detyrimeve të parashikuara në kontratë në shumen totale prej 939,832 lekë të shoqëruar me penalitet kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore.

Titulli i Gjetjes: Nga Bashkia Durrës, është lejuar të ushtrohet aktivitet nga subjekte private në objekte pasuri shtetërore pa Kontratë-Qiraje.
Situata: Në 7 raste nga Bashkia Durrës, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve Bashkia Durrës dhe Administrata e Ndërmarrjes BGT, është lejuar të ushtrohet aktivitet nga subjekte private në objekte pasuri shtetërore pa Kontratë-Qiraje në kundërshtim me kreun VI pika 2/b të VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar.
Kriteri: VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar, kreu VI pika 2/b..
Shkaku: Lejuar i ushtrimit të aktivitetit nga subjekte private në objekte pasuri shtetërore pa Kontratë-Qiraje.
Ndikimi: Shfrytëzimi i objekteve pasuri shtetërore pa Kontratë-Qiraje.
Rëndësia: I mesëm.
Rekomandimi: Nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve Bashkia Durrës dhe Administrata e Ndërmarrjes BGT, të njoftohen me shkrim Qiramarrësit, për "Zgjidhje Kontrate" pasi është mbyllur afatit i kontratës së qirasë për sipërfaqen e objektit të pasurisë shtetërore si dhe të merret në dorëzim me procesverbal objektet që ka në administrim pa Kontratë-Qiraje.

Titulli i Gjetjes: Mungon bashkëpunimi midis Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve dhe Drejtorisë Juridike, për asistencë ligjore.
Situata: Në të gjitha rastet, nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve nuk është kërkuar bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, për të kërkuar asistencë ligjore për mosmarrëveshjet që kanë lindur nga zbatimi i kontratave apo marrëveshjeve në rastet e konflikteve civile, nga mosrespektimi korrekt i tyre, në kundërshtim me rregulloren e brendshme të Bashkisë Durrës.
Kriteri: Rregulloren e brendshme të Bashkisë Durrës "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së bashkisë Durrës"
Ndikimi: Mo**s** mbështetjen dhe sigurimin e asistencës ligjore nga ana e Drejtorisë Juridike.
Rëndësia: I mesëm.

Titulli i Gjetjes: Mungon VKM-ja për miratimin e listës përfundimtare për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore.
Situata: Nga "Sektori i pronave dhe aseteve" në Bashkinë Durrës, janë të administruar vetëm 2 lista të pronave të miratuara me VKM dhe konkretisht ajo e Bashkisë Durrës e cila është e miratuar me VKM nr. 536, datë 1.5.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës" dhe e ish-Komunës Ishëm e miratuar me VKM, nr. 284, datë 12.3.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Ishëm, të Qarkut të Durrësit", ndërsa Njësitë e tjera Administrative që varen nga Bashkia Durrës janë me listë paraprake, jo përfundimtare të pa miratuar me VKM, në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 i ndryshuar "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore".
Kriteri: Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 i ndryshuar, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore", neni 17.

Ndikimi: Mos tjetërsimi ose dhënie në përdorim e pronës së fituar nga transferimi.
Rëndësia: I mesëm.

Titulli i Gjetjes: Nga Bashkia Durrës është zgjidhur kontrata e qirasë me qiramarrësin pa bërë më parë pagesën e qirasë.
Situata: Nga qiradhënësi Bashkia Durrës është zgjidhur kontrata e qirasë me qiramarrësin I.K., pa bërë më parë pagesën e dy muajve në shumen prej 79,380 lekë të shoqëruar me penalitet kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore, ***duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Durrës,*** në kundërshtim me neni 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë lidhur në datë 17.1.2022.
Kriteri: Kontratës së Qirasë lidhur në datë 17.1.2022 neni 6 "Pagesa e Qirasë".
Ndikimi: Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Durrës,
Rëndësia: I mesëm.
Rekomandimi: Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve në bashkëpunim me Drejtorinë juridike, të kërkoje në rrugë gjyqësore pagesën e dy muajve nga qiramarrësi I. K., në shumen prej 79,380 lekë të shoqëruar me penalitet kamatë ditore prej 01% të vlerës së qirasë mujore.

Për sa është trajtuar ne këtë pjesë të Raportit Përfundimtar té Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 765/11 prot., datë 17.01.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga Z. A. P. me detyrë specialist Jurist pranë Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
Gjetja me nr. 28, ku trajtoni: "… Në 7 raste nga Bashkia Durrës, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Durrës dhe Administrata e Ndërmarrjes BGT është lejuar të ushtrohet aktivitet nga subjektet private në objekte pasuri shtetërore, pa kontratë qiraje në kundërshtim me kreun VI, pika 2/b, të VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.
Lidhur me këtë gjetje, për vetë pozicionin që kam në Sektorin e Pronave, që ndërmjet të tjerave ka për detyrë dhe menaxhimin e asteteve të dhëna në përdorim, në asnjë rast nuk ka qenë dhe nuk është funksion i specialistit jurist monitorimi i kontratave, por është ushtrim i detyrës së personit (specialistit) që merret me monitorimin e qirave, i cili është në organikë dhe përgjigjet vetëm për këtë detyrë.
Gjetja me nr. 30, ku trajtoni: "… nga Sektori i Pronave dhe Aseteve në Bashkinë Durrës janë administruar vetëm dy lista të pronave të miratuara me VKM dhe konkretisht ajo e Bashkisë Durrës e cila është miratuar me VKM nr. 536, datë 01.5.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë durrës", dhe e ish Komunës Ishëm e miratuar me VKM nr nr. 295, datë 2.5.2012 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Ishëm, të qarkut të Durrësit"**,** ndërsa Njësitë Administrative që varen nga Bashkia Durrës janë me lista paraprake, jo përfundimtare të pa miratuar me VKM në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar.
Sqaroj se Gjetja me numër 30, nuk mund të gjejë zgjidhje nga ana e specialistit Jurist. Ky dokumentacion realizohet në të gjitha rastet nga specialisti i fushës, i ngarkuar për evidentimin, inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të kaluara në pronësi të Bashkisë Durrës. Pra, edhe kjo gjetje nuk gjen zbatim nga specialist Jurist, i cili për raste të tilla nuk vepron me iniciativë, që të vërë në lëvizje specialistin që merret me evidentimi, inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të bashkisë, por ky specialit vihet në lëvizje nga eprorët e vet.
Gjetja me nr.1, ku trajtoni: "…Në 9 raste nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asteve dhe nga Drejtoria Juridike nuk është monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë në lidhje me mospagesën e qirasë për sipërfaqen e objekteve pasuri shtetërore duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumën totale prej 939,832 lekë në kundërshtim me kreun VI, pika 1 të VKM-së nr. 54, datë

05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.
Siç e trajtova edhe më lart, edhe kjo gjetje lidhet me mosveprimin e specialistit që merret me monitorimin e kontratave të qirasë dhe në asnjë rast nuk është detyrë dhe funksion i specialistit jurist. Specialisti jurist vihet në lëvizje nëse mëson faktin se një subjekt është debitor, nuk ka zbatuar kushtet e kontratës së qirasë, ku në të gjitha rastet i është dhënë zgjidhje brenda kuadrit ligjor.
Gjetja me nr.2, ku trajtoni: "…Nga Qiradhënësi Bashkia Durrës është zgjidhur kontrata e qirasë më qiramarrësin I. K. pa bërë më parë pagesën e dy muajve në shumën prej 79,380 lekë të shoqëruar me penalitete kamatë ditore prej 0,1% të vlerës së qirasë mujore, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Durrës, në kundërshtim me nenin 6 "Pagesa e qirasë", e kontratës së qirasë lidhur në datën 17.01.2022.
Edhe për rastin e mësipërm nuk është bërë me dije se subjekti I. K. është debitor për vlerën e sipërshënuar, mbasi nëse do të isha bërë me dije, do të njoftoja Bankën e nivelit të dytë, ku subjekti ka të ngurtësuar vlerën e qirasë e barabartë me vlerën e tre muajve që kjo vlerë të kalonte në llogari të Bashkisë Durrës. Edhe kjo gjetje është detyrë e specialistit që merret me monitorimin e qirasë dhe të eprorëve që kontrollojnë punën e specialistit dhe jo e juristit.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në lidhje me komentin e bërë nga subjekti i audituar, sqarojmë se observacioni juaj merret në konsideratë fakti i mos mbajtjes së përgjegjësisë në detyrën e specialistit jurist.

Pretendimi i subiektit:
Gjetja me nr. 29, ku trajtoni: "… Në të gjitha rastet, nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve nuk është kërkuar bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, për të kërkuar asistencë ligjore për mosmarrëveshjet që kanë lindur nga zbatimi i kontratave apo marrëveshjeve në rastet e konflikteve civile, nga mosrespektimi korrekt i tyre, në kundërshtim me rregulloren e brendshme të Bashkisë Durrës.
Lidhur me këtë gjetje sqaroj, se nuk ka pas raste që të kemi hasur pengesa apo vështirësi për zgjidhjet ligjore, që lidhen me kontratat e qiraje, apo të huapërdorjes. Problematikat e raportuara janë zgjidhur me mirëkuptim me subjektin dhe për rastet kur subjekti është deklaruar debitor dhe megjithë njoftimin për detyrimin e papaguar, nuk ka pranuar ta shlyejë atë, duke braktisur dhe pasurinë objekt kontrate, i jemi drejtuar me padi Gjykatës.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se observacioni nuk merret në konsideratë pretendimi i subjektit të audituar për sa kohë ka raste si Qiramarrësi Subjekti SH.-E-CO/E. sh.p.k, ku nga Drejtoria juridike nuk është ndjekur rruga gjyqësore për mosmarrëveshjet që kanë lindur nga zbatimi i kontratave apo marrëveshjeve në rastin e konflikteve civile, ku rezulton që qiramarrësi të jetë debitor.

2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik

Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara
Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*
Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Durrës *(regjistrat e parashikimit dhe realizmit)*, për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në mijë lekë në pasqyrën si më poshtë:

Procedura 01/01/2022- 31/12/2022	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHSEJ	103	4,987,058	4,872,812

Procedura 01/01/2022- 31/12/2022	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
Të hapura	17	522,833	447,827
Të kufizuara (Rindertim)	28	4,324,340	4,307,034
Kërkesë me propozim / e hapur thjeshtuar	21	120,154	101,533
Me negocim pa shpallje	0	0	0
Sherbim konsulence	3	9,569	8,721
Blerje me vlere te vogel	34	10,159	7,694

Burimi: Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Durrës

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë realizuar gjithsej 103 proçedura me fond limit 4,987,058 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 4,872,812 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 114,254 mijë lekë pa tvsh.
Sipas llojit të aktivitetit, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë 61 procedura me fond limit 4,844,213 mijë lekë pa tvsh dhe me vlere kontrate 4,787,748 mijë lekë pa tvsh dhe në të tjera janë 42 procedura me fond limit 142,844 mijë lekë pa tvsh dhe me vlerë kontrate 85,063 mijë lekë pa tvsh.

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit nr. 765/1, datë 13.09.2023, *"Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve", bazuar në kërkesat e Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* nga audituesit e KLSH-së u audituan procedurat e nëposhtme:

Nr	Objekti	Fondi limit	Operatori fitues
1	"Sistemim KUB në rrugën "Taulantia"", Bashkia Durrës	36,666,667	"A." ShPK
2	"Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House", Bashkia Durrës	37,248,896	"B." SHPK
3	"Shtimi i funksionaliteteve të kontrollit dhe kalkulimeve të taksave, vjeljes së detyrimeve dhe menaxhimit më eficient të buxhetit fikal në sistemin ekzistues të Bashkisë Durrës"	32,989,483	OE "D. L." ShPK & "A.-C." ShPK
4	Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 1)	176,469,000	OE "E. 2000" ShPK
5	Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 2)	206,886,000	BOE "R. N." ShPK & "GPG Co."
6	"Riforcimi i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501"	67,033,724	BOE "A&M&A" ShPK & "S." ShPK

1. Procedura e prokurimit me objekt "Sistemim KUB në rrugën "Taulantia"", Bashkia Durrës

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemim KUB në rrugën "Taulantia"", Bashkia Durrës, Nr. REF-41760, datë 09-14-2022.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 6577/2 prot., datë 09.09.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 401, datë 25.07.2022 1. D.Sh.Kryetar, UKD	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 448, datë 09.09.2022, i ndryshuar me Urdhrin nr. 454, datë 13.09.2022 1. A. I.,Kryetar
2. Lloji i Procedurës – "E hapur"	2. A. K. UKD 3. M. B.UKD	

	1. Urdhër Prokurimi Nr. 6577/2 prot., datë 09.09.2022 Njësia e Prokurimit 1. E, G., Personi përgjegjës Inxhiniere 2. I.F., Menaxhim biznesi 3. A.Xh., Jurist	2. L. F. 3. B.M.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 36,666,667 lekë,	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "A." ShPK me ofertë 35,762,900 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 6577/7 prot, dt. 24.11.2022 me afat 100 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit 903,767 lekë, ose 2.5 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 30.09.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S'kualifikuar 1 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 36,666,667 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi
Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë shkresë, sipas të cilës duhet të kishte filluar realizimi i procedurës së prokurimit të objektit. Bashkëlidhur observacionit u administrua VKB nr: 158, datë 23.12.2021 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022 dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2022-2024", VKB nr: 21, datë 31.03.2022 "Për miratimin e përdorimit të fondeve të trashëguara nga viti 2021, të cilat i shtohen buxhetit të vitit 2022 të Bashkisë Durrës për vitet 2022-2024", në të cilin është parashikuar edhe realizimi i këtij investimi.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:
- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga grupi i projektimit me përbërje ing. A. K., Ing. D. Sh., ing. M. B. dhe ing. M. Zh.. Projekti i administruar në dosjen fizike nuk ka miratim (nënshkrim, vulë) nga Kryetari i Bashkisë Durrës, znj. E.S . Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 100 ditë nga fillimi i punimeve.
Në dosjen e prokurimit administrohet Oponenca Teknike, dërguar me shkresën nr. 340/2, datë 03.03.2023 të Institutit të Ndërtimit, ose rreth 4 muaj pas lidhjes së kontratës me OE fitues. Në oponencë konkludohet gjithashtu që ka mangësi dhe rregullimet duhet të bëhen para fillimit të zbatimit të punimeve. Zhvillimi i procedurës së prokurimit pa Oponencën teknike të Projektit të zbatimit, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik..." dhe ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit dhe Titullarin e AK (TAK).

Situata 1
Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
Me Urdhër nr. 401, datë 25.07.2022 të TAK është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe për përllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë. Ky grup pune është ngritur me përbërje inxhinierë që nuk janë në strukturën e Bashkisë Durrës, por i Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.. Ky veprim është në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë

19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 74, pika 2, sipas të cilit "Në rast mungese personeli, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm" dhe pikës 4, sipas të cilës "*4. Në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme, detyrat e mëposhtme kryhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit:*

- *Hartimi i specifikimeve teknike;*
- *Përllogaritja e fondit limit;*
- *Hartimi i kërkesave për kualifikim, lidhur me kapacitetin teknik;*
- *Hartimi i kritereve për shpalljen e ofertës fituese, nëse është rasti;*
- *Përcaktimi i çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafiku i lëvrimit).*

Në rast se detyrat e sipërpërmendura në këtë pikë nuk janë hartuar nga struktura të posaçme, si më sipër, ato do të kryhen nga njësia e prokurimit për objektin që prokurohet". Në rastin konkret, Bashkia Durrës ka në organikën e saj, por edhe në Njësinë e Prokurimit, specialist të fushës së objektit që prokurohet. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi TAK znj. E.S.

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga Grupi i punës nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 25.07.2022.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin nr. 401, datë 25.07.2022, është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 02.09.2022, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 4 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier ndërtimi, inxhinier topograf, inxhinier mekanik, inxhinier hidroteknik) të jenë në licencë, si dhe staf mbështetës 1 inxhinier elektrik dhe 1 teknik ndërtimi. Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet (inxhinieri i ndërtimit, inxhinieri elektrik dhe tekniku).

2- Është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të disponojë Paisje per largimin e ujerave nentoksore me sistem gjilpërthithese (Sistemi ell Point i pajisur me pompe thithese, age, kolektor dhe aksesor bashkues), Sonde per pastrimin e tubacioneve te ujerave te ndotura me kapacitet pompe mbi 200 bar, Automjet teknologjik per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ dhe KUSH dhe pusetave te shiut e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 4 ton, e pajisur me kove hidraulike per ngarkimin e materialeve te ngurta dhe vinc me kapacitet ngrites jo me pak se 0.3 ton, Pajisje per testim tubash sipas standartit EN 805 me printer te inkorporuar. Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

3- Është kërkuar NS-1/A Punime per prishjen e ndertimeve. Ky kritere është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kane **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi hartuesit e dokumenteve të tenderit D. Sh., A. K.UKD dhe M. B. UKD.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike
Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga grupi i punës të ngritur për këtë qëllim.
Nga verifikimi i preventivit të administruar në dosje u konstatua si më poshtë:
- Është shtuar në mënyrë të paargumentuar zëri i punës "Largimi uji me sistemin well point gjatë gërmimit për godinën", kur bëhet fjalë për punimet e gërmimit të tubacionit dhe kur në specifikimet teknike të hedhura në SPE, kostoja e këtij zëri pune (534,240 lekë) duhet të përballohet nga Kontraktori;
- Prerja e asfaltit është marrë në m^2 dhe jo në ml;
- Analiza e zërit të punës nr. 38 "V. Pompë zhytëse Q=80l/s, H=10 m" me çmim *500,000 lekë/copë*, është bërë gabim, pasi janë marrë në mënyrë të paargumentuar 24 op Specialist + punëtori, 12 op vinç derrik 50 ton, 2 op kompresor, troko, trapan etj, 3 op gjenerator, 2.8159 (!!!!) op pompë uji, 250,000 lekë fiksuese dhe 60,000 lekë materiale elektrike. Sa sipër, vlera prej 1,000,000 lekë pa TVSH, nuk është plotësisht e justifikuar.
Sa sipër, është rritur fiktivisht fondi limit të paktën në vlerë 534,240 lekë pa TVSH, e cila përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve dhe ngarkon me përgjegjësi hartuesit e fondit limit D. Sh., A. Ko. UKD dhe M. B.UKD.
Nga verifikimi me zgjedhje sipas vlerave më të larta, i disa prej zërave të preventivit të ofertës (vetëm ato me nr analize sipas manualeve), rezultoi se çmimet janë vendosur përgjithësisht sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", por disa prej tyre nuk janë marrë me njësinë dhe zërin e manualit, por nuk kanë ndikuar në rritjen e vlerës së objektit.

Situata 2
Mbi vlerësimin e ofertave
AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 12.10.2022. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE "B." ShPK	32,726,046
2	**OE "A." ShPK**	**35,762,900**

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën me nr. 6577/6 prot, datë 10.11.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.S .
Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se OE "B." ShPK, është skaulifikuar nga KVO-ja, pasi:

- Për ofertuesin **"B." shpk me NIPT: J98624801V** me vlerë të ofertës **32,726,046 lekë**, Komisioni i Vleresimit te Ofertave,gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per përmbushjen e kritereve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **"B." shpk:**

1. Nuk permbush piken 1.e) te kritereve te pergjitheshme , i cili nuk ka paraqitur vërtetim debie OSHEE per adresen "Fier Portez PORTEZ Fshati Portez, Fier me nr Pasurie 270/20, Zona Kadastrale nr 3031, vol.8, faqe 232".
2. Nuk permbush pikën 2.3.h të Kapacitetit Teknik për mjetet dhe pajisjet, nuk disponon:

- Referuar kontrates e qerasë me Nr.616 rep Nr. 280 kol me shoqerinë "D." shpk me nipt J.S nuk disponon setin e plotë **" Pajisje per largimin e ujërave nëntoksorë me sistem gjilpërthithese (Sistemi Well Point i paisur me pompe thithese, age, kolektor dhe aksesor bashkues)"**, por vetem nje pompe thithëse e cila nuk ploteson specifikimin e mjetit të kërkuar.
- Referuar kontratës së qerasë me Nr.3571 rep Nr. 1044 kol me shoqerinë "T." shpk me nipt K.T nuk disponon **"Sistem makineri e drejtuar me lazer për realizimin e miktotuleli me diameter 100÷300mm**" por vetem "Makineri per mikrotunele me diameter deri ne 300 mm" per shpim vertikal e cila sherben per shpim pilotash te pa paisur me sistem lazer si ne specifikimet e kerkuar.
- Referuar kontrates e qeras me Nr.3569 rep Nr. 1042 kol me shoqerin "A. R." shpk me nipt L…..N nuk disponon "**Automjet teknologjik per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ dhe KUSH dhe pusetave te shiut e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 4 ton, e pajisur me kove hidraulike per ngarkimin e materialeve te ngurta dhe vinc me kapacitet ngrites jo me pak se 0.3 ton**." si ne specifikime teknike te kerkuara ne DST. Automjeti i paraqitur eshte "Sonde per pastrimin e tubacioneve te ujerave te ndotura me kapacitet pompe mbi 200 bar" siç specifikohet ne te dhenat teknike te skedes teknike te mjetit.
- Referuar kontrates së qerasë me Nr.3570 rep Nr. 1043 kol me shoqerinë "F." shpk me nipt K……T nuk disponon **"Paisje per testim tubash sipas standartit EN 805 me printer te inkorporuar",** por fabrikë për prodhimin e tubave korogate.

Referuar kontrates së qerasë me Nr.3572 rep Nr. 1045 kol me shoqerinë "G…" shpk me nipt K…..U nuk disponon **"Dedektor rrjetesh nentokesore",** por instrument topografike.

Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga OE "B." ShPK, rezulton se:

1. Përsa i takon vërtetimit nga OSHEE, vërtetimi i paraqitur është i saktë dhe arsyeja e cituar nga KVO për skualifikim pasi nuk ka paraqitur vërtetim për një adresë ku ushtron aktivitet, nuk qëndron, pasi adresa e aktivitetit, nuk tregon domosdoshmërisht që ky OE është klient i OSHEE-së në këtë adresë.
2. Arsyeja që ka paraqitur KVO në lidhje me "Paisje per largimin e ujerave nentoksore me sistem gjilperthithese (Sistemi Well Point i paisur me pompe thithese, age, kolektor dhe aksesor bashkues" nuk qëndron, pasi nuk citon se cilin specifikim nuk plotëson nga specifikimet e kërkuara.
3. Arsyeja që ka paraqitur KVO në lidhje me "Sistem makineri e drejtuar me lazer per realizimin e miktotuleli me diameter 100÷300mm" qëndron, pasi nuk është cituar që sistemi është i pajisur me lazer, por nga ana e KVO-se duhet të ishin kërkuar sqarime, pa ndryshuar ofertën, pasi në shumë raste, makineritë/pajisjet nuk paraqiten kaq të detajuara sa janë kërkuar në DT.
4. Arsyeja që ka paraqitur KVO në lidhje me "Automjet teknologjik per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ dhe KUSH dhe pusetave te shiut e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 4 ton, e pajisur me kove hidraulike per ngarkimin e materialeve te ngurta dhe vinc me kapacitet ngrites jo me pak se 0.3 ton" nuk qëndron, pasi fakti që është përmendurkapaciteti

i pompës, nuk tregon që nuk përmbush kërkesat e paraqitura në DT, të cilat janë treguar në skedën e mjetit.
5. Arsyeja që ka paraqitur KVO në lidhje me "Paisje per testim tubash sipas standartit EN 805 me printer te inkorporuar" qëndron por jo ajo e cituar nga KVO, por pasi dokumenti bashkëlidhur që është për këtë pajisje, nuk është i përkthyer në gjuhën shqipe.
6. Arsyeja që ka paraqitur KVO në lidhje me "Dedektor rrjetesh nentokesore" qëndron por jo ajo e cituar nga KVO, por pasi dokumenti bashkëlidhur që është për këtë pajisje, nuk është i përkthyer në gjuhën shqipe, edhe pse është i nënvizuar me ngjyrë të verdhë.
Në dosje administrohet edhe një kërkesë për verifikim mjetesh drejtuar OE "B." ShPK.

-Gjithashtu, nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të OE fitues "A." SHPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:
-Të gjitha objektet që ka paraqitur si punime të ngjashme, nuk i plotësojnë kriteret e DT, pasi, për dy objekte me Bashkinë Tiranë ("Përmirësimi i furnizimit me ujë në rrugën Thoma Koxhaj" me vlerë 40,487,084 lekë me TVSH dhe "Ndërtim linje transferimi nga puseta Yzberisht – Depo Kombinat" me vlerë 58,889,233 lekë me TVSH), ky OE ka qenë pjesë e BOE dhe në formularin e vlerësimit dhe kontratat e punëve nuk janë të përcaktuara pjesët takuese, ndërsa dy objektet e paraqitura si nënkontraktor "Ndërtim ujësjellësi Lushnjë" (dy faza), një fazë ka përfunduar në 16.10.2016 dhe nuk merret në konsideratë, ndërsa dokumentacioni i fazës tjetër, është paraqitur sikur të jetë investim privat dhe jo investim publik;
- Për inxhinierin topograf është paraqitur inxhinier markshejdër;
- Nuk përmbush pikën 1.e) te kritereve te pergjitheshme , pasi nuk ka paraqitur vërtetim debie OSHEE per adresën "Dushnik, Berat, me nr Pasurie 1579/25, Zona Kadastrale nr 1587", të cilën e ka mbyllur në 21.01.2022 (në analogji me një nga arsyet e skualifikimit të OE "B." ShPK).
Në dosje nuk administrohet asnjë kërkesë për ndonjë verifikim, drejtuar OE "A." ShPK.

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit në datën 15.07.2022, i cili është nënshkruar nga titullari i AK z. E.S dhe dërguar për publikim, me shkresën nr. 2259/4, datë 15.07.2022.
Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 98, pika 1/b, sipas të cilit "*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: ...*
b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme", KVO nuk duhet të kishte shpallur fitues këtë OE dhe duhet të kishte bërë anulimin e procedurës së prokurimit dhe propozimin për një procedurë të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 40,915,480 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së A. I., Kryetar, L. F. dhe B. M., anëtarë.

Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Durrës, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

I. Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 946/11, datë 19.02.2024, është observuar nga Kryetari i Bashkisë znj. E. S. (edhe me CD e përcjellë me dosjen e observacioneve), si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
1. Në vijim të konstatimeve për pikën 1, ju citoni se me urdhërin nr. 401, datë 25.07.2022 të TAK është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe për përllogaritjen e fondit limit, me përbërje inxhinierë që nuk janë në strukturën e Bashkisë Durrës, por i Ujësjellës Kanalizime sh.a.
Dua t'ju sqaroj përsëri se Ujësjellës Kanalizime sh.a. në kohen e ngritjes së urdherit të sipërcituar, ishte një ndërmarrje varësie e institucionit tonë, me specialistë të fushes për hartimin e specifikimeve teknike.
Qyteti i Durrësit për arsye të kuotës në nivelin e detit, situatës urbane ekzistuese dhe rrjetit të ngarkuar të kanalizimeve, ka një risk të lartë të përmbytjeve në kohë reshjesh. Thënë këtë, Bashkia Durrës ndër vite ka realizuar ndërhyrje në territor, sipas zonave të identifikuara problematike, dhe ka sjellë zgjidhje dhe përmirësim të situatës në këto zona (përmend këtu nyjen pranë stacionit të trenit, rrugën Egnatia në lagjen nr .3, etj, në të cilat përpara investimeve, situata e menaxhimit të këtyre zonave gjatë reshjeve ishte e vështire, duke sjellë probleme për biznesin, për qytetarët, por edhe të lëvizshmerisë në zonë).
Në të gjitha rastet bashkëpunimi ka qenë me specialistët e ujësjellës-kanalizime, si detyrë funksionale dhe përgjegjësi e UKD për rrjetet e kanalizimeve. Sa më lart, është e vërtetë që në strukturën e institucionit tonë ka inxhinier me profilin përkatës, por pa eksperiencë projektimi në këtë fushë me një nivel kompleksiteti të lartë (kjo është një zonë që përmbytet thuajse çdo vit gjatë periudhës së reshjeve).
Arsyeja tjetër pse janë zgjedhur si projektues inxhinierë të UKD është sepse ky projekt ka lidhje të ngushtë me rrjetin e kanalizimeve ekzistues, mirëmbajtja dhe riparimet e të cilit kryhen nga kjo ndërmarrje.
Për këtë arsye, për të pasur një material sa më të detajuar dhe funksional, angazhova personel të specializuar dhe me eksperiencë nga një ndërmarrje varësie.
Në këtë kontekst, përcaktimi i inxhinierëve të specializuar dhe me eksperiencë nga një ndërmarrje varësie nuk mund të trajtohet nëpërmjet nenit 74, pika 2, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i cituar nga ana juaj.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
2. Në lidhje me ngritjen e grupit të punës për hartimin e DT, grupi i auditimit i qëndron konstatimit të cituar në aktkonstatimi. Përcaktimi i inxhinierëve jashtë organikës së Bashkisë Durrës, kur në organikë ka inxhinierë të këtij profili është në shkelje të legjislacionit të prokurimeve. Cilësimi nga ana e observuesit që janë zgjedhur inxhinierë të UKD, pasi inxhinierët e Bashkisë Durrës nuk kanë eksperiencë në projektim, nuk qëndron, pasi në këtë rast nuk është duke u bërë projektimi i veprës, por vendosja e kritereve të kualifikimit dhe llogaritja e fondit limit dhe inxhinierët e Bashkisë Durrës kanë hartuar dokumentacion të tillë në objektet e tjerat të prokuruara në bashkinë Durrës. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

II. Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 946/11, datë 19.02.2024, është observuar nga KVO me përbërje A. I., G. D. dhe K. B., si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
Bazuar në Projekt Raportin e Auditimit date Nr.946 Prot datë 18.01.2024 dhe Akt Konstatimin Nr.10 me Nr.8366/23 Prot datë 20.11.2023, të mbajtur nga audituesit e KLSH-së, mbi auditimin e ushtruar në bashkinë Durrës, per objektin "Sistemim K.U.B në rrugën "Taulantia" Bashkia Durrës, paraqesim vërejtjet tona sipas rendit të gjetjeve të **paraqituara** në Akt Konstatim.
Fillimisht shprehemi se çdo gjetje dhe sugjerim krijon premisat për përmirësim dhe do të jetë në vëmendjen e punës sonë.

1) **Gjetja per operatorin ¨B. ¨ Shpk:**

- Operatori Ekonomik B. shpk nuk permbush pikën 2.3.h) të Kapacitetit Teknik për mjetet dhe pajisjet, sepse nuk disponon:

Referuar kontrates se qerase me Nr.616 rep Nr. 280 kol me shoqerine "D." shpk me nipt J.....S **nuk disponon setin e plote " Paisje per largimin e ujerave nentoksore me sistem gjilperthithese (Sistemi Well Point i paisur me pompe thithese, age, kolektor dhe aksesor bashkues)"**, por eshte vetem nje pompe thithese e deklaruar dhe me fature dhe foto e cila nuk ploteson specifikimin e mjetit te kerkuar kjo eshte verifikuar dhe nga fotot e paraqitura ne dokumentacionin shkresa percjellese Nr.7305 prot. datë 10.10.2022 nga OE "**B.**" Sh.p.k. Nga fotot dhe faturat e zhdoganimit te dorezuara nga OE rezulton se pompa qe ka marre me qera OE "**B.**" Sh.p.k. eshte **nje pompe uji elektrike e markes varisco** e perdorur dhe **nuk eshte sipas specifikave** te kerkuara sepse; **mungon sistemi gjilperthithes** (pra aget gjelper thithese qe zhyten ne toke per te thithur ujerat nentokesore, kolektori qe lidh keto gjilpera me pompen dhe aksesoret e rakorderit lidhese me te).
Pra, sqarojme faktin e rendesishem se pompa e deklaruar nga OE "**B.**" Sh.p.k. **nuk kryen funksionin per thithjen e ujerave nentokesor** sepse i **mungon sistemi gjilperthithes**.

- Operatori Ekonomik "**B.**" Sh.p.k. nuk permbush pikën 2.3.h) të Kapacitetit Teknik për mjetet dhe pajisjet, sepse nuk disponon:

Referuar kontrates e qeras me Nr.3571 rep Nr. 1044 kol me shoqerin "T." shpk me nipt K.....T **nuk disponon "Sistem makineri e drejtuar me lazer per realizimin e miktotuleli me diameter 100÷300mm**", sepse komisioni i vleresimit te ofertave i ka kerkuar dokumentacionin provues me shkrese date 07.10.2022 dhe me shkrese date 10.10.2022 ka paraqitur dokumentacionin e mjeteve dhe rezulton qe mjeti i paraqitur nga OE "**B.**" Sh.p.k. **eshte nje mjet (sonde per pilota) per hapjen e puseve te shpimit dhe pilotave vertikale** dhe nuk eshte "...**makineri per realizimin e miktotuleli me diameter 100÷300mm..**" sikurse eshte kerkuar ne DST.
Pra, sqarojme faktin e rendesishem se **sondae pilotave** e deklaruar nga OE "**B.**" Sh.p.k. **nuk kryen funksionin** "...**realizimin e miktotuleli me diameter 100÷300mm..**" sikurse eshte kerkuar ne DST.

- Operatori Ekonomik "**B.**" Sh.p.k. nuk permbush pikën 2.3.h) të Kapacitetit Teknik për mjetet dhe pajisjet, sepse nuk disponon:

Referuar kontrates se qerase me Nr.3569 rep Nr. 1042 kol me shoqerine "AM R." shpk me nipt L.....N **nuk disponon** "**Automjet teknologjik per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ dhe KUSH dhe pusetave te shiut e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 4 ton, e pajisur me kove hidraulike per ngarkimin e materialeve te ngurta dhe vinc me kapacitet ngrites jo me pak se 0.3 ton**" sepse ne dokumentacionin (formularin e vetedeklarimit dhe te dhenat teknike te skedes teknike te mjetit) te paraqitur nga OE "**B.**" Sh.p.k. **eshte ("Sonde per pastrimin e tubacioneve te ujerave te ndotura me kapacitet pompe mbi 200 bar")** dhe nuk eshte "...**Automjet teknologjik per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ dhe KUSH..**" sikurse eshte kerkuar ne DST.
Automjeti i paraqitur ne formularin e vetdeklarimit eshte "Sonde per pastrimin e tubacioneve te ujerave te ndotura me kapacitet pompe mbi 200 bar" sikuse specifikohet edhe ne te dhenat teknike te skedes teknike te mjetit te paraqitur ne dokumentacionin e kontrates se qeras. Ne formularin e vetdeklarimit ka deklaruar te njejtim mjet per te permbushur kerkesat e specifikime tekmike per dy mjete qe jane procese teknollogjike te ndryshme, sikurse rezulton edhe ne skeden teknike ky automjet nuk permbush kerkesen per "...Automjet teknologjik per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ dhe KUSH..".

Automjet teknologjik per pastrimin e KUZ dhe KUSH dhe pusteve te shiut me bote me kapacitet mbartes jo me pak se 4ton	AA982DJ	FRF0674312	XLPE6V220 004476586	Nr.3569 rep Nr. 1042 kol	29.09.2022 29.09.2024
sonde per pastrimin e tubacioneve te ujrave te ndotura me kapacitet pompe mbi 200 bar	AA982DJ	FRF0674312	XLPE6V220 004476586	Nr.3569 rep Nr. 1042 kol	29.09.2022 29.09.2024

Pra "**...sonde per pastrimin e tubacioneve te ujerave te ndotura...**" e deklaruar nga OE "**B.**" Sh.p.k. **nuk kryen funksionin e** "**Automjet teknologjik per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ dhe**

KUSH dhe pusetave te shiut e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 4 ton, e pajisur me kove hidraulike per ngarkimin e materialeve te ngurta dhe vinc me kapacitet ngrites jo me pak se 0.3 ton" sikurse eshte kerkuar ne DST.

- Operatori Ekonomik "**B.**" Sh.p.k. nuk permbush pikën 2.3.h) të Kapacitetit Teknik për mjetet dhe pajisjet, sepse nuk disponon:

Referuar kontrates se qerase Nr.3570 rep Nr. 1043 kol me shoqerin "F." shpk me nipt K4.....T **nuk disponon "Paisje per testim tubash sipas standartit EN 805 me printer te inkomporuar",** sepse referuar dokumentacionit dhe faturave te paraqitura bashkelidhur kontrates se qerase subjekti "F." shpk disponon **"...paleta per formim me kallepe ose ritjetimin e gomave pneumatikeose per makineri per prodhimin e tubave plastike te korruguar..."** e cila nuk eshte "...**Paisje per testim tubash sipas standartit EN 805 me printer te inkomporuar.."** dhe nuk mund te kryeje fuknsionin e kerkuar ne DST.
Pra "**...paleta per formim me kallepe ose ritjetimin e gomave pneumatikeose per makineri per prodhimin e tubave plastike te korruguar..."** e deklaruar nga OE "**B.**" Sh.p.k. **nuk kryen funksionin e** "**Paisje per testim tubash sipas standartit EN 805 me printer te inkomporuar**" sikurse eshte kerkuar ne DST.

- Operatori Ekonomik "**B.**" Sh.p.k. nuk permbush pikën 2.3.h) të Kapacitetit Teknik për mjetet dhe pajisjet, sepse nuk disponon:

Referuar kontrates se qeras Nr.3572 rep Nr. 1045 kol me shoqerin "G." shpk me nipt K.....U nuk disponon **"Dedektor rrjetesh nentokesore",** sepse referuar dokumentacionit dhe faturave te paraqitura bashkelidhur kontrates se qerase subjekti "G." shpk disponon **"...pajisje topogjeodezike GPRS i cili sherben per matje topografike dhe rilevim terreni..."** e cila nuk eshte "...**Dedektor rrjetesh nentokesore.."** dhe nuk mund te kryeje fuknsionin qe eshte kerkuar ne DST per dedektim rrjetetesh nentoksore.
Pra "**...pajisje topogjeodezike GPRS..."** e deklaruar nga OE "**B.**" Sh.p.k. **nuk kryen funksionin e** "**...dedektor rrjetesh nentokesore...**" sikurse eshte kerkuar ne DST.

Opinioni i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të këtij observacioni, sqaron se ka të njëjtin qëndrim me atë të cituar në aktkonstatimi, ku, nga verifikimi në SPE, ka konstatuar mangësi të dokumentacionit të paraqitur nga ky OE, duke e quajtur të drejtë skualifikimin nga KVO-ja, por jo për të gjitha arsyet e cituara në Raportin Përmbledhës të Prokurimit dhe në observacion.

2) **Gjetja per operatorin ¨A.¨ Shpk:**

1. Eksperienca e ngjashme nuk plotësohet për arsyet e paraqitura edhe në aktkonstatim, pasi në dokumentet e paraqitura për dy objektet e realizuara me UKT nuk del se cila është pjesa takuese e këtij OE në BOE. Për objektet e paraqitura si nënkontraktor i "Giovani Putignano & Figli" Srl, përfundimi i objektit në të gjitha llojet e kontratave është në momentin e njoftimit të përfundimit të punimeve. Certifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim të objektit lëshohet pas përfundimit të periudhës së garancisë. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Sqarojmë: OE "A." shpk ka paraqitur punë të ngjashme :

1. Projektin Permisim i furnizimit me uje ne rrugen ''Thoma Koxhaj'' me financues dhe punëdhënës Usjësjellës Kanalizimeve Tirane. Me vlere te kontrates se objektit 40.487.084,436 leke dhe Ndertim linje transferimi nga puseta Yberisht - Depo Kombinal" me viere 58,889,233 leke me TVSH. me financues dhe punëdhënës Usjësjellës Kanalizimeve Tirane, te paraqitura si pune te ngjashme nga operatori ekonomik . Per te vertetuar perqindjen e punimeve te marra persiper nga operatori ekonomik A. shpk ne kontratat e puneve publike te mesiperme, Komisioni Vlerisimit te ofertave ka marre ne konsiderat faturat tatimore te shitjes te cilat vertertojne se likujdimi nga autoriteti kontraktor eshte realizuar per perqindjen dhe zerat e punes qe ky operator ka marre persiper te realizoj.

2. Projektin " Rehabilitimi i Rrjetit te Furizimit me uje ne Lushnje" si Nënkontraktor i kompanise " G.P. & F. srl". ku perfundimi i punimeve sipas Certifikates Finale të marrjes në dorëzim e ka më datë 16/10/2017 pas përfundimit të Garancisë . Kjo kontratë është aplikuar bazuar në rregulloren FIDIC (*The International Federation of Consulting Engineers) ku puna quhet e perfunduar pas marrjes së certifikatës finale të perfundimit të punimeve dhe jo të Certifikates pjesore të perfundimit të punimeve* .

Referuar pretendimit se Formulari i lëshuar nga operatori ekonomik dhe jo nga Autoriteti kontraktor është në kundershtim me DST.

Ju bëjmë me dije se referuar pikës 2.3 paragrafi 2 i DST ku kërkohet :

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vërtetime të lëshuara nga një **autoritet/ent publik**, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, kërkohet: ,Vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Pra punët e ngjashme të kompanise Adriatik shpk janë të plotesuara si nga Pika 1, gjithashtu edhe nga Pika 2 .Formulari i vlerësimit i lëshuar nga kompania G.P. & F.srl është vertetimi ku përmban te gjitha informacionet e kërkuara nga pika 2.3 paragrafi "a" i DST-ve. Ky kriter sipas i DST-ve plotësohet nga kompania "A." shpk .

3. Lidhur me paraqitjen e dokumentacionit të inxhinierit markshejdër për inxhinier topograf, KVO duhet të vlerësojë dokumentet e paraqitura sipas atyre të kërkuara në DT, në të cilat nuk është lënë alternativë që mund të jetë edhe inxhinier markshejdër. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

- Referuar profilit të kërkuar nga autoriteti kontraktor profili inxhinier Topograf , si dhe profili deklaruar nga operatori ekonomik, konkretisht inxhinier M., Komisioni konstaton se janë dy profile të ngjashme dhe nuk eshte kushte per skualifikim, kjo referuar pikave te licences se shoqeris qe eshte kerkuar ne DST dhe VENDIM Nr.759, datë 12.11.2014 PËR LICENCIMIN PROFESIONAL TË INDIVIDËVE DHE SUBJEKTEVE JURIDIKE QË DO TË USHTROJNË VEPRIMTARI NË FUSHËN E STUDIMIT E TË PROJEKTIMIT NË NDËRTIM DHE MBIKËQYRJES E KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM, Lidhja 5, Kushte dhe kritere specifike për të fituar kategoritë në fushat e punimeve të zbatimit në ndërtim .
  NS-18 Punime topogjeodezike - Inxhinier profili gjeodet/topograf/ markshaider.

4. Në lidhje me kërkesën për paraqitjen e vërtetimit të OSHEE për pagesat e energjisë, KVO ka detyrë të vlerësojë, së pari, sipas kritereve të vendosura në DT dhe së dyti, me të njëjtën "lupë" për të gjithë OE pjesëmarrës në tender. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

- *Ju bëjmë me dije se referuar Shtojca 7 te DST ku kërkohet:*

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në **territorin e Republikës së Shqipërisë**.

- Komisioni i vleresimit te ofertave nuk mund te kerkoje vertetim te OSHEE per nje nipt sekontare i cili eshte mbyllur ne date 21.01.2022 me Numri i ceshtjes: CN-850970-01-22 ndryshe nga operatori tjeter ku niptin sekondare ne QKR eshte aktive ne daten e zhvillimit te tenderit.

11/03/2021	Numri i ceshtjes: CN-670319-03-21 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit, datë 04.03.2021 për hapje adrese dytësore. Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit: eshte Shtuar Adresa: "**Berat; BERAT; Berat; ; BERAT; Zona kadastrale nr. 1587, numer pasurie 1579/25, Dushnik;** " Lista e Dokumenteve: Dokumenti i autorizimit Vendim i asamblese se pergjithshme

21/01/2022	Numri i ceshtjes: CN-850970-01-22 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit të asamblesë së ortakëve datë 21.01.2022, ku është vendosur: Mbyllja e 1 (një) adrese dytësore. Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit: eshte Hequr Adresa: "*Berat; BERAT; Berat; ; BERAT; Zona kadastrale nr. 1587, numer pasurie 1579/25, Dushnik;* " Lista e Dokumenteve: Vendim i asamblese se pergjithshme

Pra operatori B. shpk **nuk ka paraqitur vërtetim debie** OSHEE per adresen “Fier Portez PORTEZ Fshati Portez, Fier me nr Pasurie 270/20, Zona Kadastrale nr 3031, vol.8, faqe 232”, nga ana jone si komision vleresimit te ofertave eshte pare qe ky operator per kete adrese **ka te paraqitur ne QKR dhe eshte aktive ne daten e zhvillimit te tenderit** .

15/05/2020	Numri i ceshtjes: CN-505655-05-20 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i kërkesës datë 12.05.2020 për hapjen e adresës dytësore. Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit: eshte Shtuar Adresa: "**Fier; FIER; ; Portez; PORTEZ; Fshati Portez, Fier me nr Pasurie 270/20, Zona Kadastrale nr 3031, vol.8, faqe 232.;** " Lista e Dokumenteve: Vendim i asamblese se pergjithshme Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar) Dokumenti i autorizimit

Ne linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13849, ku aplikohet per tu pajisur me **vërtetim debie OSHEE, parashikohet shprehimisht se “...Dokumentacioni i nevojshëm, A.1 Subjektit Aplikues Jo-familjar: - Numrat e kontratave të energjisë që i korrespondojnë të gjitha adresave të rregjistruara në QKB/...”.**

Vërtetim Debie OSHEE

Vërtetimi i debisë lëshohet në zbatim të: "Rregullorja mbi kushtet e pergjithshme te kontrates se shërbimit universal te furnizimit me Energji Elektrike për klientët fundor" Miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018; Çdo kërkese e individëve ose subjekteve tregtare të cilët janë mbajtës të një kontratë furnzimi të shërbimtit universal me energji elektrike; Vendim Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar; Procedurave për marrjen e lejeve minerare; Rregullores uniforme të kontrollit dhe zhvillimit të territorit për ndërtimet e reja; Kërkesave për përftimin e kompensimit të energjisë elektrike; Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Per mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Dokumentacioni i nevojshëm

A.1 Subjektit Aplikues Jo-familjar:

- Numrat e kontratave të energjisë që i korrespondojnë të gjitha adresave të rregjistruara në QKB/ Rregjistrin e OJF;
- Në rast se kërkuesi nuk është administrator i shoqërisë mbajtëse e kontratës/ve, është e nevojshme paraqitja e një dokumenti autorizimi me shkrim shoqëruar me kopjen e kartës ID të administratorit të shoqërisë mbajtës i kontratës/ve.

Pra OE B. shpk **nuk ka paraqitur vërtetim debie** nga OSHEE per adresen "Fier Portez PORTEZ Fshati Portez, Fier me nr Pasurie 270/20, Zona Kadastrale nr 3031, vol.8, faqe 232" duke mos permbushur detyrimet ligjore te legjislacionit ne fuqi per sektorin e energjise, per tu pajisur me kontrate, rrjedhimisht me **vertetim debie per të gjitha adresat e rregjistruara në QKB**.

Opinionin i Grupit të auditimit:

Pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumeteve shoqëruese (disku me materialet e OE "Adriatik" ShPK), grupi i auditimit sqaron si më poshtë:

1. Eksperienca e ngjashme nuk plotësohet për arsyet e paraqitura edhe në aktkonstatim, pasi në dokumentet e paraqitura për dy objektet e realizuara me UKT nuk del se cila është pjesa takuese e këtij OE në BOE. Për objektet e paraqitura si nënkontraktor i "Giovani Putignano & Figli" Srl, përfundimi i objektit në të gjitha llojet e kontratave është në momentin e njoftimit të përfundimit të punimeve. Certifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim të objektit lëshohet pas përfundimit të periudhës së garancisë. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.
2. Për sistemin wellpoint dhe pompën e sondës, observacioni merret në konsideratë.
3. Lidhur me paraqitjen e dokumentacionit të inxhinierit markshejdër për inxhinier topograf, KVO duhet të vlerësojë dokumentet e paraqitura sipas atyre të kërkuara në DT, në të cilat nuk është lënë alternativë që mund të jetë edhe inxhinier markshejdër. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.
4. Në lidhje me kërkesën për paraqitjen e vërtetimit të OSHEE për pagesat e energjisë, KVO ka detyrë të vlerësojë, së pari, sipas kritereve të vendosura në DT dhe së dyti, me të njëjtën "lupë" për të gjithë OE pjesëmarrës në tender. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Komisioni i vleresimit te ofertave nuk i ka derguar shkrese operatorit ekonomik A. shpk sepse ne sistemin ekeltronik eshte paraqitura i gjithe dokumentacioni i deklaruar ne shtojcen 8, ndryshe nga operatori tjeter i cili nuk kishte paraqitur asnje dokument shoqerues sipas kesaj shtojce.

Konkluzioni : Për sa më sipër mbështetur në të gjithë argumentat e paraqitur dhe materialet bashkelidhur, i kërkojme grupit të auditimit të mos ngarkojë me përgjegjësi anëtarët e Komisionit Vleresimit te Ofertave mbi auditimin e ushtruar në bashkinë Durrës, per objektin "Sistemim K.U.B në rrugën "Taulantia Bashkia Durrës, paraqesim.

Duke besuar se grupi i auditimit do të marë në konsiderate sqarimet e paraqitura në këtë observacion mbasi ekzistojnë të gjitha faktet në dokumentacionin teknik përkatës, jemi të gatshëm për sqarime dhe dokumentacion mbështëtes shtesë.

Opinioni i grupit të auditimit:

1. Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të këtij observacioni, sqaron se ka të njëjtin qëndrim me atë të cituar në aktkonstatimi, ku, nga verifikimi në SPE, ka konstatuar mangësi të dokumentacionit të paraqitur nga OE "B.", duke e quajtur të drejtë skualifikimin nga KVO-ja, por jo për të gjitha arsyet e cituara në Raportin Përmbledhës të Prokurimit dhe në observacion.

2. Pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumeteve shoqëruese (disku me materialet e OE "A." ShPK), grupi i auditimit sqaron si më poshtë:
- Eksperienca e ngjashme nuk plotësohet për arsyet e paraqitura edhe në aktkonstatim, pasi në dokumentet e paraqitura për dy objektet e realizuara me UKT nuk del se cila është pjesa takuese e këtij OE në BOE. Për objektet e paraqitura si nënkontraktor i "G. P.& F." Srl, përfundimi i objektit në të gjitha llojet e kontratave është në momentin e njoftimit të përfundimit të punimeve. Certifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim të objektit lëshohet pas përfundimit të periudhës së garancisë. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.
- Lidhur me paraqitjen e dokumentacionit të inxhinierit markshejdër për inxhinier topograf, KVO duhet të vlerësojë dokumentet e paraqitura sipas atyre të kërkuara në DT, në të cilat nuk është lënë alternativë që mund të jetë edhe inxhinier markshejdër. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me kërkesën për paraqitjen e vërtetimit të OSHEE për pagesat e energjisë, KVO ka detyrë të vlerësojë, së pari, sipas kritereve të vendosura në DT dhe së dyti, me të njëjtën "lupë" për të gjithë OE pjesëmarrës në tender. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House", Bashkia Durrës

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House", Bashkia Durrës, Nr. REF-29978, datë 05-19-2022.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 3473/2 prot., datë 17.05.2022</td><td rowspan="2">3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit
Urdhër nr. 189, datë 19.04.2022
1. R. D. Kryetar,
2. J. K.
3. M. J.
1. Urdhër Prokurimi
Nr. 3473/2 prot., datë 17.05.2022
Njësia e Prokurimit
1. A. K., Personi përgjegjës Jurist
2. M. D., Inxhiniere
3. A.Xh., Jurist</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 248, datë 17.05.2022,
1. A. I., Kryetar
2. K. B.
3. G.D.</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –
"E hapur"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
37,248,896 lekë,</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh)
OE "B." ShPK
me ofertë 23,239,250 lekë pa tvsh,
sipas kontratës nr. 3473/7 prot, dt. 29.08.2022
me afat 72 ditë nga data e lidhjes së kontratës.</td><td>7. Diferenca me fondin limit
14,009,646 lekë, ose 37.6 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
Datë 16.06.2022</td><td>9. Burimi Financimit
Buxheti i Bashkisë</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender 23 OE/BOE
b) S'kualifikuar 10 BOE,
c) Kualifikuar 13 OE/BOE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; nuk ka ankesë.</td><td>12. Përgjigje Ankesës nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës
nuk ka</td></tr>
</table>

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 37,248,896 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit.

Mbi project preventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga grupi i projektimit me përbërje ing. R. D., ing.J. K. dhe ing.M. J.. Projekti i administruar në dosjen fizike nuk ka miratim (nënshkrim, vulë) nga Kryetari i Bashkisë Durrës, znj. E.S . Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 72 ditë nga fillimi i punimeve.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi TAK znj. E. S.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Me Urdhër nr. 189, datë 19.04.2022 të TAK është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe për përllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë.

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga Grupi i punës nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 07.05.2022.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin nr. 189, datë 19.04.2022, është mbajtur procesverbalit i përcjellë në Sektorin e Prokurimeve me shkresën me nr. extra prot., datë 17.05.2022, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se në kriterin për llojet e makinerive, janë kërkuar në mënyrë të paargumentuar teknikisht, 2 mjete vetëshkarkuese me masë maksimale 3.5 – 7.5 ton, 2 mjete 7.5 – 18 ton dhe 2 mjete mbi 18 ton.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet**.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi hartuesit e dokumenteve të tenderit ing. R. D., ing.J. K. dhe ing.M. J.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga grupi i punës të ngritur për këtë qëllim.

Nga verifikimi me zgjedhje i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet përgjithësisht janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", përveç çmimit të zërit me nr. 2.288 analize "Trotuar me pllaka, pa bordurat e betonit", i cili është marrë me çmimin 8525 lekë/m^2, nga 2140 lekë/m^2 që është në manualin në fuqi të çmimeve, ose 6385 lekë/m^2 më shumë, e cila për 937 m^2 trotuar të preventivuar, kap vlerën **5,982,745 lekë të shtuara fiktivisht në fondin limit**, vlerë kjo që përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve publike dhe ngarkon me përgjegjësi hartuesit e fondit limit R. D. Kryetar, J. K.dhe M.J.

Situata 3

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 06.06.2022. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

1. K. Sha Vlera 20.871.590 (njëzetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e nentëdhjetë) lekë.

2. B. shpk Vlera 23.239.250 (njëzetë e tre milion e dyqind e tridhjetë e nentë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.

3. "M." shpk Vlera 24.917.770 (njëzetë e katër milion e nentëqind e shtatëmbedhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) lekë.

4. K.M.K shpk + C.M shpk Vlera 25.272.930 (njëzetë e pesë milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nentëqind e tridhjetë) lekë.

4. **"N." Shpk** Vlera 25.503.350 (njëzetë e pesë milion e pesëqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë.

5. **"SH. 07 shpk** Vlera 27.000.000 (njëzetë e shtatë milion) lekë.

7. "E.-ALB" shpk & **"M." shpk** Vlera 27.304.174 (njëzetë e shtatë milion e treqind e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

8. "L. VII" sh.a Vlera 27.506.670 (njëzetë e shtatë milion e pesëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë.

9. A.-2A CO shpk & 2Z K. shpk, Vlera 28.435.706 (njëzetë e tetë milion e katërqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtë) lekë.

10. K. C. shpk Vlera 28.673.230 (njëzetë e tetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind e tridhjetë) lekë.

11. "S. 2F" shpk Vlera 28.703.703 (njëzetë e tetë milion e shtatëqind e tre mijë e shtatëqind e tre) lekë.

12. M. I. GROUP shpk & **I.C.C GROUP shpk** Vlera 29.417.335 (njëzetë e nentë milion e katërqind e shtatëmbedhjetë mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë.

13. I. shpk Vlera 29.520.520 (njëzetë e nentë milion e pesëqind e njëzetë mijë e pesëqind e njëzetë) lekë.

14. S. shpk Vlera 30.716.652 (tridhjetë milion e shtatëqind e gjashtëmbedhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

15. "B. Construction" sh.p.k & "S." sh.p.k Vlera 30.110.370 (tridhjetë milion e njëqind e dhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë.

16. E. 2000 shpk Vlera 30.462.395 (tridhjetë milion e katëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e treqind e nentëdhjetë e pesë) lekë.

17. B.–I. shpk Vlera 31.086.490 (tridhjetë e një milion e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e nentëdhjetë) lekë.

18. L.T.E.C. Vlera 31.304.140 (tridhjetë e një milion e treqind e katër mijë e njëqind e dyzetë) lekë.

19. "U." Shpk Vlera 31.567.060 (tridhjetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë) lekë.
20. L. K. Shpk Vlera 31.644.985 (tridhjetë e një milion e gjashtëqind e dyzetë e katër mijë e nentëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.
21. BOE A. K." Shpk & 2T Shpk B. Shpk, Vlera 34.871.605 (tridhjetë e katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesë) lekë.
22. "AL-A." shpk Vlera 35.192.200 (tridhjetë e pesë milion e njëqind e nentëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë.
23. V. E J……S
Nuk ka paraqitur ofertë
Nga auditimi rezulton se nga KVO, pas procesverbalit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave me datë 10.06.2022, është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën me nr. 3473/6 prot, datë 17.08.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.S . Ky Raport rezulton të jetë i pafirmosur nga antari i KVO-së, z. G.D.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua janë skualifikuar nga KVO-ja, OE/BOE të mëposhtëm:
1. K. Sha K…..1 *arsyet e mëposhtme:*
- Për ofertuesin K. Sha Nipt: K…..J me vlerë të ofertës 20.871.590 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per përmbushjen e kritereve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik K. Sha:
1. Nuk permbush piken 2.3.d te Kapacitetit Teknik per punonjesit e thjeshte, pasi per Z.Q. H. sipas licences është me profesion drejtues teknik i shoqërise, në vetedeklarim në shtojcen Nr.8 e ka deklaruar si punëtor të thjeshtë ndertimi.
KVO vendos qe ofertuesi K. Sha të mos kualifikohet.

2. BOE K.M.K Shpk + C. M Shpk, *arsyet e mëposhtme:*
- Për ofertuesin BOE K.M.K Shpk Nipt: L…..E+ C. M shpk Nipt: L…..O, me vlerë të ofertës 25.272.930 lekë, Komisioni I Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per përmbushjen e kritereve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, per operatoret ekonomik BOE K.M.K Shpk + C. M shpk :
1. Nuk përmbush piken 1. Kriteret e pergjithshme te pranimit ; Sipas marrveshjes se bashkepunimit ndermjet operatoreve ekonomik ndarja e punimeve ne preventiv nuk perputhet me ndarjen e perqindjeve qe kan deklaruar operatoret ekonomik ne marrveshjen e bashkepunimit.
KVO vendos qe ofertuesit BOE K.M.K Shpk + C. M shpk *të mos kualifikohet.*

3. "SHKELQIMI 07" *arsyet e mëposhtme:*
- Për ofertuesin SH. 07 Shpk Nipt: K…..Ë, me vlerë të ofertës 27.000.000 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kritereve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik SH. 07 Shpk:
1. Nuk përmbush piken 1. a) b) c) ç) d) e) i) te Kriteret e pergjithshme të kualifikimit, sipas Shtojcës Nr.8 keto kritere duhet te permbushen ne Formularin Përmbledhes se Vetedeklarimit.
KVO vendos qe ofertuesi SH. 07 Shpk *të mos kualifikohet.*

4. BOE A.-2A CO Shpk & 2Z K. Shpk *arsyet e mëposhtme:*
- Për ofertuesin BOE ASI-2A CO Shpk Nipt: K…C+ 2Z K. Shpk Nipt:J……K me vlerë të ofertës 28.435.706 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te

dokumentacionit per permbushjen e kritereve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, per operatoret ekonomik BOE ASI-2A CO Shpk + 2Z K. Shpk:
1. Ne Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3, KVO konstaton se vlera e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik nuk perputhet me shumen e kerkuar ne dokumentat e tenderit, gjithashtu formulari ka periudhe vlefshmerie te ofertes 180 dite, ne dokumentat e tenderit periudha e vlefshmerise se ofertes eshte kerkuar per 150 ditë.
KVO vendos qe ofertuesit BOE ASI-2A CO Shpk + 2Z K. Shpk *të mos kualifikohet.*

***5.* K. C.** *arsyet e mëposhtme:*
-Për ofertuesin K. C. Shpk Nipt: K7……Ë me vlerë të ofertës 28.673.230 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kritereve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik K. C. Shpk:
1.Nuk permbush piken 2.3 g) per mjetet me qira Grejder, Asfaltoshtruese, Eskavator ABM07, mungon numri i kontrates se qirase, afati i kontrates sipas formularit te vetdeklarimit shtojca Nr.8.
KVO vendos qe ofertuesi K. C. Shpk *të mos kualifikohet.*

6. **BOE B. C. Shpk & S. Shpk,** *arsyet e mëposhtme:*
- Për ofertuesin BOE B. C. Shpk Nipt L…..I+S. Shpk Nipt K……Ë, me vlerë të ofertës 30.110.370 lekë, Komisioni I Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per përmbushjen e kritereve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, per operatoret ekonomik BOE B. C.+ S. Shpk:
1. Ne Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3, KVO konstaton se vlera e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik nuk perputhet me shumen e kerkuar ne dokumentat e tenderit, gjithashtu formulari ka periudhe vlefshmerie te ofertes 72 dite dhe ne dokumentat e tenderit periudha e vlefshmerise se ofertes eshte kerkuar per 150 ditë.
KVO vendos qe ofertuesit BOE B. C. Shpk +SARDO Shpk *të mos kualifikohet.*

7. U. Shpk *arsyet e mëposhtme:*
-Për ofertuesin U. Shpk Nipt: K…..Q me vlerë të ofertës 31.567.060 lekë , Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kritereve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik U. Shpk:
1. Nuk permbush piken 2.3 d) te Kapacitetit Teknik per punonjesit e thjeshte te cilet nuk jane deklaruar sipas formularit te vetdeklarimit Shtojca Nr.8.
KVO vendos qe ofertuesi U. Shpk *të mos kualifikohet.*

8. L. K., a*rsyet e mëposhtme*
-Për ofertuesin L.K.Nipt: K……I me vlerë të ofertës 31.644.985 lekë
,Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kritereve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik L. K.:
1.Nuk permbush piken 2.3 d) te Kapacitetit Teknik per punonjesit e thjeshte te cilet nuk jane deklaruar sipas formularit te vetdeklarimit Shtojca Nr.8.
KVO vendos qe ofertuesi L. K. *të mos kualifikohet.*

9. BOE A. K." Shpk & 2T Shpk B. Shpk, *arsyet e mëposhtme:*
- Për ofertuesin BOE A.K.Shpk Nipt: L…..H+ 2T Shpk Nipt: K…..M + B.Shpk Nipt: K…..E me vlerë të ofertës 34.871.605 lekë,

Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kritereve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, per operatoret ekonomik BOE A. K. Shpk + 2T Shpk + B. Shpk:
1. Nuk përmbush piken 1. Kriteret e pergjithshme te pranimit ; Sipas Marrveshjes se Bashkepunimit ndermjet operatoreve ekonomik ndarja e punimeve ne preventiv nuk perputhet me ndarjen e perqindjeve qe kan deklaruar operatoret ekonomik ne marrveshjen e bashkepunimit.
KVO vendos qe ofertuesit BOE A. K. Shpk + 2T Shpk + B. Shpk *të mos kualifikohet.*
10. BOE V. E + K. K. *arsyet e mëposhtme:*
-Për ofertuesin BOE V. E Nipt: J…..S + K. K. Nipt K…..P, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kritereve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik BOE V. E + K. K.:
1.Operatoret ekonomik nuk kane paraqitur oferte.
KVO vendos qe ofertuesit V. E+ K. K. *të mos kualifikohet.*

Në Procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, rezulton që oferta e OE "B." ShPK të jetë anomalisht e ulët. Nga ana e KVO-së, nëpërmjet sistemit, i është kërkuar këtij OE shpjegim për këtë ofertë, e cila ka ardhur me shkresën e protokolluar në Bashkinë Durrës me nr. 3473/4 prot., datë 15.06.2022.

Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga OE "K." Sh.a, rezulton se:
- Arsyeja për skualifikim, e cituar nga KVO për z. Q. H., sipas të cilës, ky person figuron si drejtues teknik dhe është paraqitur si punëtor i thjeshtë, qëndron, por nga ana e KVO-së, duhet të ishte kërkuar sqarim, nëse ky person është i vetëm, pra është apo jo i njëjti person, apo janë dy persona me të njëjtin emër. Ndërkohë, në DT përcaktohet që "*...për punëtori të thjeshtë, të disponojë një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë*" dhe nga ana e OE ky kriter është plotësuar. Fakti se OE do të përdor një drejtues teknik si punëtor, është marrëdhënie private dhe nuk ka të bëjë me dokumentacionin e kësaj procedure. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të OE fitues "B." SHPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi rezulton se ka patur aktivitet në Durrës në vitin 2021-2022 dhe nuk e ka ndryshuar ekstraktin historik të veprimtarisë së shoqërisë, referuar ligjit 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, "Për procedurat tatimore pika 1/1 ku citohet: "Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia në cdo rast bëhet përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë me numer unik identifikimi të njëjtë me ate të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendodhjen e ushtrimit të vëprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia. Për këtë rast OE duhet të ishte pajisur me certifikatë dhe të regjistrohej në QKB.
- Nga verifikimi i listëpagesës së muajit Prill 2022 të paraqitur nga OE në versionin letër, rezulton se punëtorë të thjesht krahu figurojnë 15 persona (kodi i profesioneve 9312.06) nga 54 të punësuar gjithsej. Ky fakt është evidentuar nga grupi i auditimit për shkak të skualifikimit nga KVO-ja të OE "K." ShPK për të njëjtën arsye.
Gjithashtu, ky subjekt ka paraqitur vërtetim nga OSHEE, njësoj si në procedurën "Sistemim KUB në rrugën "Taulantia", në të cilën është vlerësuar si i pamjaftueshëm dhe ka qenë një nga arsyet e skualifikimit.

Sa sipër, skualifikimi i OE "Kombeas" ShPK dhe kualifikimi i OE "B." është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit me nr. 3473/5, datë 28.06.2022, i cili është nënshkruar nga titullari i AK z. E.S .

Me kualifikimin e OE "K. ShPK, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 7, pika 1, sipas të cilit "*Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit*", KVO duhet të kishte shpallur fitues këtë OE dhe të bënte propozimin tek TAK për lidhjen e kontratës. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 27,887,100 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP, ose 2,841,192 lekë më shumë se OE i skualifikuar padrejtësisht dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së A.I., Kryetar, K.B. dhe G.D., anëtarë.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Durrës, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 946/11, datë 19.02.2024, është observuar nga KVO me përbërje A.I., G. D. dhe K. B., si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
1. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se operatori ekonomik **"K. Sha"** skualifikuar padrejtësisht ***KVO*** sqaron si me poshte:
Z.Q. H. figuron si drejtues teknik ne licensen e shoqerise K. Sha , nderkohë është paraqitur si puntor i thjeshte ne vetedeklarimin e stafit puntor te thjeshte. ***KVO*** e ka bere verikimin ne listepagesen e paraqitur ku Z.Q. H. me Nr.ID F……D eshte person i vetem. (Bashkelidhur listpagesa).
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.
2. Sa i përket Operatorit Ekonomik të shpallur fitues **"B. Shpk** ", operator i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit. SQAROJMË se përsa i përket kësaj pike, ***KVO*** nuk është në kundërshtim me kërkesat e DST, ***sepse Nipti sekondar për eksperiencat e ngjashme nuk është kërkuar*** dhe përfshirë në DST. ***KVO*** nuk ka të drejtë të kërkojë kritere shtesë, përvec atyre që janë përcaktuar në DST. Pavarësisht kësaj kjo detyrë i takon grupit të zbatimit të kontratë që në momentin e marrjes në dorëzim të kontratës. Për aq kohë sa nuk ekziston një Nipt OE i ka plotësuar detyrimin për shlyerjen e taksave vendore për të gjitha selitë sekondare që posedon.
Për sa i përket vertetimit nga OSHEE, ***KVO*** sqaron se ky vertetim eshte paraqitur se bashku me letrat kerkuara ne DST e objektit te mesiperm. (Bashkelidhur Vertetimi OSHEE).
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.
Qëndrimi i grupit të auditimit
1. Siç është cituar edhe në aktkonstatimin nr. 10, datë 20.11.2023 dhe Projektraport, KVO duhet të kishte kërkuar sqarim në lidhje me të punësuarin Q. H. dhe të konsideronte marrëveshjen private në lidhje me detyrën për këtë objekt.
2. Në DT është kërkuar që të paraqitet "*...Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore*". Kjo referencë ligjore ka të përcaktuar që taksat

vendore paguhen në të gjitha njësitë ku ka punuar ofertuesi. Në rastin konkret, OE i shpallur fitues, nuk ka paraqitur vërtetimin pikërisht nga Bashkia Durrës.
3. Vërtetimi për pagesat në favor të OSHEE, është cituar që është i njëjtë me atë të paraqitur në një tjetër procedurë, ku nga kjo KVO është quajtur si e pamjaftueshme.
Sa sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

II. Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 8366/51, datë 23.11.2023, është observuar nga Grupi i specifikimeve teknike dhe fondit limit me përbërje R. D., J. K. dhe M. J., si më poshtë:
Pretendimi I subjektit:
1.Përsa i përket numrit të punëtorëve, grupi i punës në propesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, të dorëzuar pranë njësisë së prokurimit me datë 17.05.2022 në faqen 4 të saj ka cituar:
Numri i stafit kryesor dhe mbeshtetes është llogaritur në bazë të zbërthimit të grafikut të punimeve. Zbërthimit të preventivit, natyrës së objektit dhe kombinimeve të mundshme të punonjësve. Numri prej 50 personash përfshin personelin kryesor, drejtues teknik, punonjës të specializuar / kualifikuar si dhe numrin e punëtorëve të thjeshtë përllogaritur nga zbërthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.
Gjithashtu ju sqarojmë se grafiku i punimeve i hartuar nga projektuesit është analitik. Nga zbërthimi i grafikut për objektin numri i punëtorëve që nevojiten në pikun e punimeve rezulton 93 punëtorë. Grupi i punës duke marrë shkas nga rekomandimet e vazhdueshme te APP-së e cila sygjeron që numri i punonjësve të kërkuar të bëhet në bazë të zbërthimit të grafikut dhe duke marrë në konsiderate edhe kombinimet e mundshme të grafikut të ekzekutimit të punimeve të parashikuara, për realizimin e objektit te kontratës, ka kërkuar një numër prej 50 punonjësish për realizimin e këtij objekti.
2. Sqarojmë se mjetet e kërkuara janë llogaritur duke u bazuar në grafikun e punimeve, proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh gjithashtu edhe kombinimet e mundshme të punës së mjeteve për zbatimin e këtij projekti.

Opinioni i grupit të auditimit:
1. Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumentacionit shoqërues, merr në konsideratë argumentin mbi kriterin e numrit të punonjësve dhe do ta pasqyrojë në Projektraportin e Auditimit.
2. Në lidhje me kriterin për mjetet me tonazhe të ndryshme, grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë pretendimin e observuesve, pasi nuk ka asnjë argument bindës në lidhje me tonazhet e kërkuara.

Pretendimet e subjektit:

1. Çmimi për zërin me nr. 2.288 analize "Trotuar me pllaka, pa bordurat e betonit" i përcaktuar me VKM nr. 629, date 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", është 2140 leke/m^2, ndërkohë që në preventiv çmimi i këtij zëri është vendosur 8525 leke/m^2.
Ju sqarojmë se grupi i punës gjatë hartimit të preventivit në programin excel, gjatë përdorimit të tastierës dhe të komandave, **është marrë gabimisht vlera e zërit të punës nr.2.262/4 "Shtresë betoni C 16/20" prej 8525 lekë dhe e ka vendosur gabimisht në zërin 2.288 analizë "Trotuar me pllaka, pa bordurat e betonit" të preventivit final**, pasqyruar në tabelën e mëposhtme të marrë në manualin 2 të VKM- së nr. 629, date 15.7.2015.
Referuar zbatimit të punimeve në këtë objekt, subjekti fitues ka ofertuar dhe është likujduar nga bashkia Durrës për zërin 2.288 analize "Trotuar me pllaka, pa bordurat e betonit" , në vlerën 1300 leke/m^2, pra rreth 40% më ulet se cmimi i këtij zëri i bazuar në manual. Përsa më sipër ju paraqesim një analizë reale të zbatimit të punimeve:
-Zëri "Trotuar me pllaka, pa bordurat e betonit", sasia 937 m^2 * 2140 lekë (cmimi manualit) = 2,005,180 lekë.
-Zëri "Trotuar me pllaka, pa bordurat e betonit", i ofertuar: sasia 937 m^2 * 1300 leke = 1.218.100 lekë.

Duke qenë se në preventiv paraqitja e numrit të manualit është i saktë dhe përshkrimi i zërit të punës është i saktë (në përputhje me VKM-në nr.629 datë 15.7.2015), ofertimi nga subjekti për këtë procedurë është bërë i saktë dhe në përputhje me VKM-në nr. 629 datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Opinioni i grupit të auditimit:
Grupi i auditimit e ka cituar këtë devijim për arsyet që edhe ju i keni pranuar. Fakti që OE fitues ka ofertuar me çmimin "real" është një rrethanë lehtësuese për cilësimin e diferencës së fondit limit, por që nuk ju liron nga përgjegjësia për vendosjen e çmimit jo sipas manualit të çmimieve, miratuar me VKM-në nr. 629 datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

3. Procedura e prokurimit me objekt "Shtimi i funksionaliteteve të konrollit dhe kalkulimeve të taksave, vjeljes së detyrimeve dhe menaxhimit më eficient të buxhetit fikal në sistemin ekzistues të Bashkisë Durrës"

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Shtimi i funksionaliteteve të konrollit dhe kalkulimeve të taksave, vjeljes së detyrimeve dhe menaxhimit më eficient të buxhetit fikal në sistemin ekzistues të Bashkisë Durrës", Nr. REF-49365 datë 11-10-2022.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 7976/16, datë 07.11.2022 2. Lloji i Procedurës – "E hapur -mallra"	3. Hartuesit e specifikimeve teknike dhe përllogarirja e fondit limit Urdhër nr. 475, datë 29.09.2022 1. L.D , Kryetar, 2. L.B , 3. L. S. 4. F. M. 5. Er. I. Urdhër nr. 7976/16, datë 07.11.2022 Njësia e Prokurimit 1. A. Xh., (Personi përgjegjës), Jurist 2. I. F., Ekonomiste 3. A. T., Arkitekt	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 554, datë 07.11.2022 G.K , Kryetar F. Pj. A. D.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 32,989,483 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE "D. L." ShPK & "A.-C." ShPK me ofertë 29,531,500 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 588 prot, dt. 16.01.2023 me afat 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 3,457,983 lekë ose 10.5 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 30.11.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Durrës	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S'kualifikuar 0 BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Durrës
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E hapur -mallra", me vlerë 32,989,483 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Durrës. Nga verifikimi i preventivit të këtij objekti, konstatohet se pjesa e "Shërbimit" është më e lartë se pjesa "mallra" (29,150,816 lekë shërbim dhe 3,838,666 lekë mallra) dhe për këtë arsye, procedura e prokurimit, duhet të ishte përcaktuar si "Shërbim", në zbatim të nenit 5, pika 2 të Ligjit 192/2020 "Për prokurimin publik", sipas të cilit "*Në rastin e kontratave të përziera, që përbëhen pjesërisht nga shërbimet e parashikuara në kreun XII të këtij ligji dhe nga shërbime të tjera, ose kontrata të përziera, që përbëhen pjesërisht nga shërbimet dhe pjesërisht nga furnizimet, objekti kryesor përcaktohet në përputhje me vlerën më të lartë të parashikuar për shërbimet ose furnizimet përkatëse*". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjëi Njësia e Prokurimit dhe TAK.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e Bashkisë Durrës me nr. 7976/12, datë 21.10.2022, drejtuar AKSHI-t "Kërkesë për miratimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike për përmirësimin e sistemit ekzistues", sipas të cilës kërkohet shqyrtimi dhe miratimi i këtij projekti, në përputhje me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e AKSHI-t" dhe Udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 të Ministrit të ITIK "Për standardizimin e hartimit të Termave të Referencës për projektet TIK në administratën publike". Pas kësaj shkrese, AKSHI me shkresën nr. 6602/1, datë 26.10.2022 i përgjigjet Bashkisë Durrës, duke e bërë me dije se në AKSHI "*...po zhvillohet procedura me objekt "Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës dhe shërbimeve online për qeverisjen vendore"... Ju informojmë se në këtë procedurë përfshihen edhe komponentët e kërkuar nga ana juaj*".

Pas kësaj shkrese, në Kartelën Shoqëruese të Praktikës, nga ana e TAK është lënë shënimi që "**Të vijohet procedura sipas VKB Buxhetit 2021**". Pas këtij shënimi, grupi i punës i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë objekt, ka mbajtur Procesverbal me datë 07.11.2022, ku citohet që janë vënë në dijeni për informimin nga AKSHI që procedura që do të kryhet në Bashkinë Durrës është e përfshirë në atë që do të kryhet nga AKSHI, duke cituar që në Kartelën Shoqëruese të Praktikës, nga ana e TAK janë urdhëruar që "Të vijohet procedura sipas VKB Buxhetit 2021". Më pas, ka vijuar hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit nga grupi i punës dhe të gjitha hapat e tjera të procedurës së prokurimit.

Nga sa sipër, ky investim, me implementimin e projektit për të cilën ka filluar procedura e prokurimit në AKSHI, nuk do të funksionojë më, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve të Bashkisë Durrës në vlerën 32,989,483 lekë. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi titullari i Autoritetit Kontraktor znj. E.S .

Situata 1

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 10.11.2022.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 10.11.2022.

Në zbatim të VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar, pika k, sipas të cilës "AKSHI *përgjigjet për ngritjen, mirëmbajtjen e sistemeve dhe të aplikacioneve të teknologjisë së informacionit e komunikimit për infrastrukturën e qendërzuar dhe infrastrukturën TIK, për njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) (bashkitë), me kërkesë të tyre"* dhe pika j, sipas të cilës *"Jep mendim për institucionet e tjera të administratës publike, me kërkesë të tyre, për: - specifikimet teknike të prokurimeve, që do të realizohen me fonde të buxhetit të shtetit, hua dhe/ose grante të dhëna nga donatorë; - procedurat që kanë lidhje me projekt-propozime/projekte të ndryshme, dhurata apo ndihma materiale. AKSHI jep mendim brenda afatit prej 20 ditësh pune nga data e marrjes së dokumentacionit të sipërpërmendur",* Bashkia Durrës duhet të kishte marrë miratimin nga AKSHI për termat e referencës dhe specifikimet teknike, për realizimin e kësaj procedure prokurimi. Sa sipër, grupi i auditimit nuk mund te shprehet për korrektësinë e vendosjes se kritereve të kualifikimit nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Me Urdhrin nr. 475, datë 29.09.2022 të TAK, është ngritur Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike si dhe Përllogaritjen e fondit limit me përbërje L.D , L.B , L. S., F.Mera dhe E. I., anëtarë.
Në dosje administrohen tre oferta financiare, pa datë, nga shoqëritë "I. & C.D." ShPK me vlerë 34,550,910 lekë pa TVSH", "ATD" ShPK me vlerë 32,328,000 lekë pa TVSH dhe "A. – C., me vlerë 32,089,540 lekë pa TVSH, të cilat i kanë shërbyer grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit. Fondi limit ka dalë nga mesatarja e këtyre tre ofertave të tregut.
Hartimi i specifikimeve teknike është bërë nga po ky grup pune në tetor 2022 dhe procesverbali ndodhet në dosjen e prokurimit.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur -mallra".
Hapja e ofertave është bërë në datën 30.11.2022. Nisur nga procesverbali i hapjes së ofertave, rezulton se ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në këtë procedurë 2 ofertues, si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"D. L." ShPK & "A.-C." ShPK	29,531,500
	" I.S." ShPK	31,052.000

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Me procesverbalin datë 12.12.2022 është bërë vlerësimi i ofertave.
Është hartuar Raporti Përmbledhës i prokurimit në datën 28.12.2022, me nr. 7976/19 prot., i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (TAK) z. E.S .
Nisur nga ky Raport dhe verifikimi në SPE, janë kualifikuar nga KVO të dy këta OE.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE fitues "D. L." ShPK & "A.-C." ShPK dhe krahasimi i tij me Formularin e Vetdeklarimit nr. 8, rezulton se ky OE është kualifikuar me të drejtë nga KVO.

Nga grupi i auditimit u konstatua gjithashtu se për të plotësuar kriterin si eksperiencë të ngjashme, OE "D. L." ShPK ka paraqitur edhe dy kontrata shërbimi me vlera të kontratës 12,000,000 lekë pa TVSH, me shoqërinë "I.+" Shpk, e cila ka administrator z. S. S., që njëkohësisht është edhe ortak i vetëm i shoqërisë "D. L." ShPK. Në objektin e këtyre dy kontratave (por edhe të dy kontratave të tjera datë 06.07.2020 dhe 03.07.2020 me shoqërinë "I. & C.D." ShPK) citohet që "...*Furnizuesi* ("D. L." ShPK*) do të kryejë për Kontraktuesin shërbimet e nënkontraktimit nëpërmjet personave të specializuar...*", duke lënë të kuptohet që ka patur një kontratë shërbimi me Kontraktuesit, por nuk citohet se me kë ent publik/privat i ka kryer këto shërbime. KVO duhet të kishte kërkuar sqarim për këto dokumente të paraqitura si eksperiencë e ngjashme.

Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit në datën 29.12.2022, i cili është nënshkruar nga titullari i AK z. E.S .

I. Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 946/11, datë 19.02.2024, është observuar nga Kryetari i Bashkisë znj. E. S. (edhe me CD e përcjellë me dosjen e observacioneve), si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
Në konstatimin tuaj ju citoni shkresën nr. 7976/12 prot., datë 21.10.2022, me objekt "Kërkesë për miratimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike për përmirësimin e sistemit ekzistues", si edhe kthim përgjigjen nr. 6602/1 prot., datë 26.10.2022, nëpërmjet të cilës AKSHI na informon mbi ngritjen e grupit të punës për proçedurën me objekt "Digjitalizimi dhe automatizimi i proçeseve të punës dhe shërbimeve online për qeverisjen vendore", përgjigje në këndvështrimin tim mjaft përgjithësuese, pa dhënë një afat të përcaktuar dhe konkret për parashikimin e realizimit dhe implementimit të kësaj proçedure (nënvizoj këtu që ende Bashkia Durrës nuk është informuar nëse janë marrë hapa konkret për realizimin e këtij projekti, pasi përveç këtij dokumenti nuk është njoftuar

apo të jenë kërkuar të dhëna për fillimin apo realizimin e tij), dhe mbi të gjitha në përgjigjen e tyre nuk i kanë refuzuar specifikimet teknike.

a. Së pari, baza ligjore me të cilën veprojnë bashkitë është Ligji nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore".

b. Sjell në vëmendjen tuaj se mandati i Kryetarit të Bashkisë është për një periudhë 4 vjeçare, dhe qëllimi është rritja e performancës gjatë këtij mandati, në shërbim të qytetit dhe qytetarëve, nëpërmjet edhe maksimizimit dhe mirëmenaxhimit të të ardhurave, për t'i përkthyer në shërbime për qytetin.

Gjithashtu, Bashkia po merr masat për t'i paraprirë projektit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila po harton skemën e re të financimit të bashkisë nëpërmjet grantit të performancës, cka do të thotë se do të përfitojnë ato bashki të cilat performojnë më mirë, dhe përmirësimi i sistemit ekzistues është baza për të përmirësuar treguesit e performancës.

Dua të theksoj faktin që sistemi ekzistues i bashkisë është i vitit 2009, dhe nëpërmjet këtij investimi nuk është synuar një sistem i ri menaxhimi, por përditësimi i sistemit ekzistues, duke parashikuar edhe shtimin e funksioneve shtesë për sektorë të tjerë të bashkisë dhe institucioneve të varësise, me objektivat si më poshte, të cilat kanë qenë pjesë e programit tim:

1. Krijimi i një strategjie afatgjatë për digjitalizimin e bashkisë. Kjo do të permbajë planifikimin e investimeve të nevojshme, identifikimin e nevojave dhe prioriteteve të digjitalizimit, si dhe vlerësimin e kosto-benefiteve të projekteve të ndryshme.
2. Ndërtimi i një infrastrukture të qendrueshme dhe moderne të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), blerja e pajisjeve dhe teknologjive të reja, për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të shpejtë të komunikimit.
3. Zvogëlimi i burokracisë dhe rritja e efikasitetit në shfrytezimin e teknologjisë, duke integruar proçeset administrative dhe të shfrytëzimit të shërbimeve nëpërmjet një platforme të përbashkët online, duke u mundësuar qytetarëve dhe bizneseve që të aplikojnë, paguajnë dhe marrin shërbime pa nevojën e vizitimit fizik në zyrat administrative.
4. Mbështetja e një kulture të hapur dhe të bashkëpunimit, duke inkurajuar qytetarët, bizneset dhe organizatat në bashki, që të kenë akses në informacione dhe të bashkëpunojnë në projekte inovative të ndryshme, si dhe duke u nxitur për të dhënë sugjerime dhe këshilla për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet teknologjisë.
5. Përmirësimi i sigurisë nëpërmjet teknologjisë, duke rritur standardet e sigurisë ne proçeset e shfrytëzimit të teknologjisë, duke u siguruar që informacioni dhe të dhënat e qytetarëve dhe bizneseve të jenë të mbrojtura nga sulmet në internet, si dhe duke zhvilluar një plan emergjencash për të reaguar ndaj incidenteve të mundshme të sigurisë në infrastrukturën e TIK.
6. Zhvillimi i aplikacioneve dhe platformave të specializuara. Kjo do të përmbajë krijimin e aplikacioneve dhe platformave të dedikuara për shërbime specifike si p.sh. menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, menaxhimin e taksave, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe pagave, menaxhimin e aseteve, si dhe menaxhimin e të ardhurave nga policia bashkiake. Kjo do të ndihmojë qytetarët dhe bizneset në përpunimin e informacionit dhe në shfrytëzimin e shërbimeve publike në mënyrë të thjeshtë dhe të shpejtë.
7. Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies, duke ofruar qasje të plotë dhe të lehtë në të dhënat publike, duke siguruar që proçeset administrative të jenë transparente dhe të ndjekshme, dhe duke u angazhuar për të llogaritur për përdorimin e fondeve publike në projektet e digjitalizimit të bashkisë.
8. Një program politik i mirëplanifikuar dhe të shpërndarjes së përgjegjshme për digjitalizimin e bashkisë do të ndikojë në përmirësimin e jetëve të qytetarëve dhe të bashkëpunimit mes bizneseve dhe administratës publike, duke i bërë ato të afërta me teknologjinë dhe efikase në ofrimin e shërbimeve publike.
9. Zhvillimi i një portali të integruar të shërbimeve publike të taksave dhe tarifave vendore. Ky portal do të lejojë qytetarët dhe bizneset të aksesojnë të gjitha shërbimet publike të taksave dhe tarifave vendore në një vend, duke u ndihmuar në shfrytëzimin e tyre në mënyrë të lehtë dhe të shpejtë. Ky portal gjithashtu do të ndihmojë në përmirësimin e komunikimit mes qytetarëve dhe administratës publike.

10. Ndërtimi i një sistemi të sigurisë së të dhënave. Një aspekt i rëndësishëm i digjitalizimit është siguria e të dhënave. Bashkia duhet të krijojë një sistem të sigurt të të dhënave që do të lejojë të mbrojnë informacionin dhe të minimizojnë rrezikun e sulmeve kibernetike.

Ndër të tjera, referuar Udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2023, "Për standardizimin e hartimit të Termave të Referencës për projektet TIK në administratën publike", në pikën 2 të tij përcaktohet se "*Qëllimi i këtij udhëzimi është që institucionet e administratës publike, në praktikën e tyre të punës, të udhëhiqen nga zbatimi i standardeve dhe rregullave për zhvillimin dhe implementimin e projekteve të e-Qeverisjes*".

Në vazhdim, në pikën 4 dhe 5 të këtij udhëzimi parashikohet se:

"*4. Ky udhëzim zbatohet nga institucionet e administratës publike, në nivel qendror, ku përfshihen aparatet e Kryeministrisë dhe të ministrive, degët e ministrive, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit dhe ministrave të linjës, degët e tyre si dhe administrata e prefektit.*

5. ***Rekomandohen*** *institucionet qendrore të pavarura, duke përfshire ato të sistemit gjyqësor e të prokurorisë, të universiteteve shtetërore, si dhe te fondeve speciale,* ***Njësite e Qeverisjes Vendore,*** *të zbatojnë këtë udhëzim gjatë hartimit të projekteve të teknologjisë së informacionit e të komunikimit, për institucionet e tyre*".

Sa më lart, referuar Ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore", Udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2023 pika 5, vlerësojmë që kemi vepruar në zbatim të ligjit për të përmirësuar punën e drejtorive përkatëse si dhe për të rritur transparencën e insitucionit të Bashkisë Durrës, me qëllim të qartë per t'i shërbyer sa më mirë qytetarëve të Durrësit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa është observuar më sipër, grupi i auditimit konstaton se është i njëjtë me observacionin e sjellë për aktkonstatimin e mbajtur nga grupi i auditimit. Megjithatë, grupi i auditimit sqaron përsëri si më poshtë:

a. Përsa i përket pretendimit se AKSHI nuk i ka refuzuar specifikimet teknike, sqarojmë se AKSHI nuk ka kthyer asnjë përgjigje në lidhje me specifikimet teknike, pasi është shprehur që procedura e prokurimit për këtë shërbim, nuk duhej bërë nga Bashkia Durrës.

Përsa i përket pikës së observacionit qe ka të bëjë me anashkalimin e AKSHI-t në lidhje me zhvillimin e kësaj procedure, sqarojmë se baza ligjore që veprojnë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, vërtetë është Ligji nr. 139/2015, por kjo nuk do të thotë që në veprimtarinë e tyre, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore nuk duhet të zbatojnë legjislacionin në fuqi, për të gjitha fushat ku operojnë. Ndërkohë që edhe nga ana e Bashkisë Durrës është bërë kërkesa drejtuar AKSHI-t, bazuar në legjislacionin për funksionimin e AKSHI-t.

b. Në asnjë pikë të aktkonstatimit të hartuar nga grupi i auditimit nuk është cituar që Bashkia Durrës nuk duhet të bëjë përmirësimin e sistemeve, ndërtimin e infrastrukturave moderne IT, etj. Nga ana e Grupit të Auditimi është cituar që ky investim duhet të realizohej konform legjislacionit që rregullon kryerjen e investimeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe të konsiderohej fakti që ky investim do të realizohej nga AKSHI, si institucioni që përgjigjet për ngritjen, mirëmbajtjen e sistemeve dhe aplikacioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për infrastrukturën e qendërzuar dhe infrastrukturën TIK, për njësitë e qeverisjes vendore, me kërkesën e tyre.

c. Përsa i përket pikës 4 dhe pikës 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 të Ministrit të ITIK "Për standardizimin e hartimit të Termave të Referencës për projektet TIK në administratën publike", në lidhje me institucionet që janë të detyruara ose jo për zbatimin e këtij Udhëzimi, grupi i auditimit sqaron se nga ana e Bashkisë Durrës është bërë kërkesë për miratimin e specifikimeve teknike dhe refuzimi i miratimit nga AKSHI nuk është marrë në konsideratë. Gjithashtu, nuk është marrë në konsideratë edhe fakti që për këtë shërbim kishte filluar procedura e prokurimit në AKSHI, duke urdhëruar që të vijojë edhe nga Bashkia Durrës.

Sa sipër, ku observacion nuk merret në konsideratë.

4. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 1+Loti 2)", Bashkia Durrës

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz", Nr. REF-17599 datë 01-21-2022 (Loti 1) dhe Nr. REF-17601 datë 01-21-2022 (Loti 2)		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 588, datë 20.01.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 588, datë 20.01.2022 Njësia e Prokurimit 1. M.D., Inxhinier 2. K. Dh., Ekonomist 3. A.Xh., (Personi përgjegjës), Jurist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 25, datë 20.01.2022 A. I., Kryetar K. B. I. F.
2. Lloji i Procedurës – "E kufizuar" në kuadër të procesit të rindërtimit.		
5. Fondi Limit (pa TVSh) Loti I: 176,469,000 lekë, Loti II, 206,886,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) Loti I : OE "E.2000" ShPK me ofertë 176,327,975 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 588/17 prot, dt. 01.04.2022 me afat 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Loti II : BOE "R.N." ShPK & "GPG C." me ofertë 206,840,255.6 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 588/19 prot, dt. 01.04.2022 me afat 168 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit Loti I: 141,025 lekë, ose 0.08 % Loti II: 45,744 lekë, ose 0.022 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 03.02.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit, Fondet e rindërtimit	
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Durrës
Punoi: KLSH

LOTI I-rë

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E kufizuar ", me vlerë 176,469,000 pa TVSH. Burimi i Financimit: Fonde të vëna në dispozicion nga buxheti shtetit sipas VKM Nr.715, date 24.11.2021 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit dhe riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), në Bashkinë Durrës", dhe VKB Nr. 154, datë 06.12.2021 "Për miratimin e përdorimit dhe detajimit të fondit".

Situata 1
Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 21.01.2022.

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Në pikën 2.3. të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 2 inxhinierë ndërtimi, 1 arkitekt, inxhinier elektrik dhe 6 teknikë. Kriteri për arkitektin është i paargumentuar teknikisht.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me volumin e objektit që prokurohet**.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi grupin e punës të ngritur për këtë qëllim me përbërje A.T., O.G., E. T., I.H., A K., J. K. dhe M. J.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike
Argumentimi i fondit limit dhe preventivit të përafërt, janë hartuar grupi i punës i ngritur me urdhrin e TAK nr. 614, datë 17.12.2021 (i cili nuk administrohet në dosje), me përbërje A.T. Kryetar, O. G., E.T., I. H., A K., J. K. dhe M. J., anëtarë.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

Nga auditimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se është përdorur procedurë "E kufizuar," (Narrëveshje kuadër-Procesi i Rindërtimit). Ky prokurim është kryer me dy faza, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", neni 42, pika 6.

Faza 1 - Parakualifikimi: Kandidatët do të paraqesin dokumentet e kërkuara në DT. Autoriteti / Enti Kontraktor do të shqyrtojë dokumentet e paraqitura nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Faza 2 - Ftesa për oferta: Autoriteti / Enti Kontraktor i dërgon ftesë për ofertë Kandidatëve të cilët kanë përmbushur kërkesat e parakualifikimit, **me anë të së cilës i fton këta Kandidatë të paraqesin një ofertë teknike dhe ekonomike.** Ofertat do të rishikohen dhe vlerësohen nga Autoriteti / Enti Kontraktor për të përcaktuar ofertën fituese.

Në dosje administrohet procesverbali për hapjen, datë 03.02.2022 procesverbali i shqyrtimit të ofertave, datë 11.02.2022. Nisur nga verifikimi në SPE dhe Proceverbalet e hapjes dhe shqyrtimit të ofertave për Lotin I, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 10 OE, si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës
1	BOE "Sh. 07" ShPK & "F." ShPK
2	BOE "B." ShPK & "M." ShPK
3	BOE "E. D. K." ShPK & "St." ShPK
4	**OE "E. 2000" ShPK**
5	OE "K.K." ShPK
6	BOE "K.K." ShPK & "I." ShPK
7	OE "L.K." ShPK
8	BOE "P. G." ShPK & "J." ShPK
9	OE "S." ShPK
10	BOE "Z." ShPK & "B." ShPK

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga verifikimi i procesverbalit të shqyrtimit të ofertave për Lotin I dhe Raporti Përmbledhës, u konstatua se:

1. BOE "Sh. 07" ShPK & "F." ShPK është skualifikuar për shkak të mungesës së marrëveshjes për ndarjen e punëve ndërmjet anëtarëve të BOE.
2. BOE "B." ShPK & "M." ShPK, është skualifikuar, pasi ka marrë pjesë në të dy lotet dhe duhet të plotësojë numrin e fuqisë punëtore për të dy lotet së bashku (187).
3. BOE "E. D. K." ShPK & "S.j" ShPK është skualifikuar për shkak të mungesës së marrëveshjes për ndarjen e punëve ndërmjet anëtarëve të BOE dhe të mungesës së vërtetimit që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike nga OE "E.D.K." ShPK.
4. OE "E.2000" ShPK, kualifikohet.
5. OE "K. K." ShPK është skualifikuar, pasi ka marrë pjesë në të dy lotet dhe duhet të plotësojë numrin e fuqisë punëtore për të dy lotet së bashku (187).
6. BOE "K.K." ShPK & "I." ShPK është skualifikuar, pasi ka marrë pjesë në të dy lotet dhe duhet të plotësojë numrin e fuqisë punëtore për të dy lotet së bashku (187).
7. OE "L.K." ShPK është skualifikuar, pasi ka marrë pjesë në të dy lotet dhe duhet të plotësojë numrin e fuqisë punëtore për të dy lotet së bashku (187).
8. BOE "P.G." ShPK & "J." ShPK, është skualifikuar për shkak të mungesës së marrëveshjes për ndarjen e punëve ndërmjet anëtarëve të BOE.
9. OE "S." ShPK, është skualifikuar, pasi ka marrë pjesë në të dy lotet dhe duhet të plotësojë numrin e fuqisë punëtore për të dy lotet së bashku (187).

10. BOE “Z.” ShPK & “B.” ShPK është skualifikuar pasi nuk është paraqitur vërtetimi i shlyerjes së taksave vendore për vitin 2021 në Bashkinë Rrogozhinë nga OE “B. N” ShPK si dhe nuk disponojnë dokumentacion që të vërtetojë profesionin (dëshmi profesionale) për tre punonjës.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës, me nr. 588/10 prot. datë 17.03.2022.
Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se në fazën e parë, atë të vlerësimit të dokumentacionit teknik, është kualifikuar vetëm një OE dhe janë skualifikuar 9 OE pjesëmarrës.
Nga verifikimi i procesverbalit të shqyrtimit të ofertave për Lotin I dhe Raporti Përmbledhës, u konstatua se:

1. BOE “Sh.07” ShPK & “F.” ShPK ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit datë 02.02.2022, në të cilën është shprehur për ndarjen e punëve ndërmjet anëtarëve të BOE, respektivisht “80% me 20% për secilin element të punimeve të preventivit”. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.
2. BOE “B.” ShPK & “M.” ShPK, ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit datë 02.02.2022, në të cilën është shprehur për ndarjen e punëve ndërmjet anëtarëve të BOE, respektivisht “80% me 20% për secilin element të punimeve të preventivit”. Numri i punonjësve të muajit të fundit, të paraqitur nga dy shoqërisë pjesëmarrëse në BOE është 174 punonjës (respektivisht 123 dhe 51), nga 97 që kërkohet në DT. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.
3. BOE “E. D. K.” ShPK & “S.” ShPK ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit datë 31.01.2022, në të cilën është shprehur për ndarjen e punëve ndërmjet anëtarëve të BOE, respektivisht “40% me 60% të totalit të punimeve”, ndërsa si vëtetim nga OSHEE, shoqëria “E.D. K.” ShPK ka paraqitur një vërtetim me datë 20.04.2018, të shoqërisë “E. & O. K.” ShPK. Sa sipër, ky OE është skualifikuar me të drejtë nga KVO, por jo për arsyet e cituara në Raportin Pëmbledhës.
5. OE “K. K.” ShPK, e plotëson kriterin e vendosur në DT për numrin e punonjësve për Lotin I-rë, pasi ka paraqitur listëpagesën e muajit të fundit me 108 punonjës, nga 97 që kërkohet në DT. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.
6. BOE “K. K.” ShPK & “I.” ShPK ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit datë 02.02.2022, në të cilën është shprehur për ndarjen e punëve ndërmjet anëtarëve të BOE, respektivisht “75% me 25% të punimeve”. Numri i punonjësve të muajit të fundit, të paraqitur nga dy shoqërisë pjesëmarrëse në BOE është 188 punonjës (respektivisht 85 dhe 103), nga 97 që kërkohet në DT. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.
7. OE “L. K.” ShPK e plotëson kriterin e vendosur në DT për numrin e punonjësve për Lotin I-rë, pasi ka paraqitur listëpagesën e muajit të fundit me 162 punonjës, nga 97 që kërkohet në DT. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.
8. BOE “P. G.” ShPK & “J.” ShPK, ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit datë 02.02.2022, në të cilën është shprehur për ndarjen e punëve ndërmjet anëtarëve të BOE, respektivisht “90% me 10% të punimeve në total të kontratës”. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.
9. OE “S..” ShPK, e plotëson kriterin e vendosur në DT për numrin e punonjësve për Lotin I-rë, pasi ka paraqitur listëpagesën e muajit të fundit me 152 punonjës, nga 97 që kërkohet në DT. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.
10. BOE “Z.” ShPK & “B.” ShPK ka paraqitur “dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik”, ku citohet edhe profesioni, konform DT ku citohet “Dëshmi kualifikimi/ekuivalent”. për të tre punonjësit (A. D., H. Sh., Z. M.) dhe nuk ka paraqitur vërtetimin e shlyerjes së taksave vendore për vitin 2021 në Bashkinë Rrogozhinë nga OE “B. N” ShPK. Ky BOE ka paraqitur gjithashtu në fazën e parë edhe ofertën ekonomike, fakt që nuk është trajtuar në vlerësimin nga KVO dhe

që bie ndesh me përcaktimet e bëra ne DT, në kapitullin II, Seksioni 3 (Faza 2), pika 3.2 sipas të cilës "*Oferta duhet të përfshijë: a) Formularin e ofertës (Preventivi), plotësuar sipas shtojcës 3...).* Sa sipër, ky BOE është skualifikuar me të drejtë nga KVO, por jo për arsyet e cituara në Raportin Përmbledhës.

- Në datën 15.02.2022 i është bërë "Kërkesa për ofertë" OE të kualifikuar "E.2000" ShPK për të paraqitur dokumentacionin e Fazës 2, sipas DT.
- Në datën 21.02.2022 është mbajtur Provesverbali i hapjes publike të ofertave dhe procesverbali i vlerësimit të ofertës së kualifikuar, sipas të cilit, ky OE është vlerësuar me 100 pikë, relatuar kjo edhe me shkresën "Klasifikimi Përfundimtar", datë 28.02.2022.
- Është hartuar Formulari i Njoftimit fituesit me nr. 588/7 prot., datë 02.03.2022, i cili është nënshkruar nga titullari i AK z. E.S .
- Është hartuar Raporti Përmbledhës me nr. 588/10 prot., datë 17.03.2022, i cili është miratuar nga TAK znj. E.S .

Nga verifikimi i dokumenteve të paraqitur në SPE nga shoqëria që ka rezultuar e kualifikuar "Eurondërtim 2000", u konstatua:
- Nga kontrolli i bërë dokumentacionit të paraqitur për eksperiencat e ngjashme, rezulton se gjatë vitit 2021 është punuar edhe në Bashkinë Durrës (objekti: "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 9)" në periudhën 11.01.2021 – 07.05.2021. Në këto kushte, OE ofertues duhet që të kishte hapur NIPT sekondar pranë Bashkisë Durrës. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 i ndryshuar, "Për procedurat tatimore, pika 1/1, ku citohet: "Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia në çdo rast bëhet përpara nisjes efektive të veprimtarisë enë atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë me numer unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia". Për këtë rast OE duhet të ishte pajisur me NIPT sekondar dhe të regjistrohej në QKB. Nisur nga fakti që nuk e ka kryer këtë veprim, OE i është shmangur detyrimeve tatimore vendore në Bashkinë Durrës. Përsa sipër, OE nuk e ka plotesuar detyrimin për shlyerjen e taksave vendore.

Për arsyen e lartpërmendur, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Neni 93 "Sigurimi i konkurrencës", pika 2.b, sipas të cilës "*Në rast mungese të sigurimit të konkurrencës, autoriteti/enti kontraktor anulon procedurën, si më poshtë vijon:*
a).....
b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re.
Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 176,327,975 lekë pa TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së A. I., Kryetar, K. B. dhe I. F., anëtarë.

Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Durrës, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

LOTI II-të

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E kufizuar ", me vlerë 206,886,000 pa TVSH. Burimi i Financimit: Fonde të vëna në dispozicion nga buxheti shtetit sipas VKM Nr.715, date 24.11.2021 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit dhe riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), në Bashkinë Durrës", dhe VKB Nr. 154, datë 06.12.2021 "Për miratimin e përdorimit dhe detajimit të fondit".

Situata 1
Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 21.01.2022.

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Në pikën 2.3. të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 2 inxhinierë ndërtimi, 1 arkitektë, inxhinier elektrik dhe 4 teknikë. Kriteri për arkitektin është i paargumentuar teknikisht.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me volumin e objektit që prokurohet**.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi grupin e punës të ngritur me urdhrin e TAK nr. 614, datë 17.12.2021, me përbërje A.T.Kryetar, O. G., E. T., I. H., A K., J. K.dhe M. J., anëtarë.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike
Argumentimi i fondit limit dhe preventivit të përafërt, janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e TAK nr. 614, datë 17.12.2021 (i cili nuk administrohet në dosje), me përbërje A. T. Kryetar, O. G., E.T., I. H., A.K., J. K. dhe M.J.., anëtarë.

Situata 2
Mbi vlerësimin e ofertave
Nga auditimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se është përdorur procedurë "E kufizuar," (Marrëveshje kuadër-Procesi i Rindërtimit). Ky prokurim është kryer me dy faza, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", neni 42, pika 6. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen, datë 03.02.2022 procesverbali i shqyrtimit të ofertave, datë 11.02.2022. Nisur nga verifikimi në SPE dhe Proceverbalet e hapjes dhe shqyrtimit të ofertave për Lotin II, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 8 OE, si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës
1	BOE "B. X" ShPK & "P." ShPK

2	BOE “B.” ShPK & “M.” ShPK
3	OE “K.K.” ShPK
4	BOE “K.K.” ShPK & “Inerti” ShPK
5	OE “L. K.” ShPK
6	BOE “N.” ShPK & “N. 2014” ShPK
7	**BOE “R.N.” ShPK & “CPG C.” ShPK**
8	OE “S.” ShPK

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga verifikimi i procesverbalit të shqyrtimit të ofertave për Lotin II dhe Raporti Përmbledhës, u konstatua se:
1. BOE “B. X” ShPK & “P.” ShPK është skualifikuar për shkak të mungesës së përcaktimit të pjeëve të punës që do të kryejë secili nga antarët e kërij bashkimi.
2. BOE “B.” ShPK & “M.” ShPK, është skualifikuar, pasi ka marrë pjesë në të dy lotet dhe duhet të plotësojë numrin e fuqisë punëtore për të dy lotet së bashku (187).
3. OE “K.K.” ShPK është skualifikuar, pasi ka marrë pjesë në të dy lotet dhe duhet të plotësojë numrin e fuqisë punëtore për të dy lotet së bashku (187).
4. BOE “K. K.” ShPK & “I.” ShPK është skualifikuar, pasi ka marrë pjesë në të dy lotet dhe duhet të plotësojë numrin e fuqisë punëtore për të dy lotet së bashku (187).
5. OE “L. K.” ShPK është skualifikuar, pasi ka marrë pjesë në të dy lotet dhe duhet të plotësojë numrin e fuqisë punëtore për të dy lotet së bashku (187).
6. BOE “N.” ShPK & “N. 2014” ShPK është skualifikuar për shkak të mungesës së përcaktimit të pjeëve të punës që do të kryejë secili nga antarët e kërij bashkimi, si dhe të mungesës së vërtetimit që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike (vërtetimi i paraqitur është pa përfshirë faturën koheerente të muajit Gusht 2021) nga OE “N. 2014” ShPK.
7. BOE “R.N.” ShPK & “C. C.” ShPK është kualifikuar.
8. OE “S.” ShPK, është skualifikuar, pasi ka marrë pjesë në të dy lotet dhe duhet të plotësojë numrin e fuqisë punëtore për të dy lotet së bashku (187).

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës, me nr. 588/11 prot. datë 17.03.2022.
Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se në fazën e parë, atë të vlerësimit të dokumentacionit teknik, është kualifikuar vetëm një OE dhe janë skualifikuar 7 OE/BOE pjesëmarrës.
Nga verifikimi i procesverbalit të shqyrtimit të ofertave për Lotin II dhe Raporti Përmbledhës, u konstatua se:

1. BOE “B.X” ShPK & “P.” ShPK ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit datë 02.02.2022, në të cilën është shprehur për ndarjen e punëve ndërmjet anëtarëve të BOE, respektivisht “45% me 55% të punëve të parashikuara në punimet e preventivit”. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.
2. BOE “B.” ShPK & “M.” ShPK, ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit datë 02.02.2022, në të cilën është shprehur për ndarjen e punëve ndërmjet anëtarëve të BOE, respektivisht “80% me 20% për secilin element të punimeve të preventivit”. Numri i punonjësve të muajit të fundit, të paraqitur nga dy shoqërisë pjesëmarrëse në BOE është 174 punonjës (respektivisht 123 dhe 51), nga 90 që kërkohet në DT. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.
3. OE “K. K.” ShPK, e plotëson kriterin e vendosur në DT për numrin e punonjësve për Lotin I-rë, pasi ka paraqitur listëpagesën e muajit të fundit me 108 punonjës, nga 90 që kërkohet në DT. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.
4. BOE “K. K.” ShPK & “I.” ShPK ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit datë 02.02.2022, në të cilën është shprehur për ndarjen e punëve ndërmjet anëtarëve të BOE, respektivisht “75% me 25% të punimeve”. Numri i punonjësve të muajit të fundit, të paraqitur

nga dy shoqërisë pjesëmarrëse në BOE është 188 punonjës (respektivisht 85 dhe 103), nga 90 që kërkohet në DT. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.
5. OE OE "L. K." ShPK e plotëson kriterin e vendosur në DT për numrin e punonjësve për Lotin I-rë, pasi ka paraqitur listëpagesën e muajit të fundit me 162 punonjës, nga 90 që kërkohet në DT. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.
6. BOE "N." ShPK & "N.2014" ShPK ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit datë 03.02.2022, në të cilën është shprehur për ndarjen e punëve ndërmjet anëtarëve të BOE, respektivisht "85% me 15% të punimeve në total të kontratës"., si dhe vërtetimin që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike deri në muajin Korrik 2021 nga OE "N. 2014" ShPK. Sa sipër, ky BOE është skualifikuar me të drejtë nga KVO, por jo për arsyet e cituara në Raportin Përmbledhës.
7. BOE "R. N." ShPK & "C. C." ShPK është kualifikuar
8. OE OE "S." ShPK, e plotëson kriterin e vendosur në DT për numrin e punonjësve për Lotin I-rë, pasi ka paraqitur listëpagesën e muajit të fundit me 152 punonjës, nga 97 që kërkohet në DT. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO.

- Në datën 15.02.2022 i është bërë "Kërkesa për ofertë" BOE të kualifikuar "R. N." ShPK & "G.C." ShPK për të paraqitur dokumentacionin e Fazës 2, sipas DT.
- Në datën 21.02.2022 është mbajtur Provesverbali i hapjes publike të ofertave dhe procesverbali i vlerësimit të ofertës së kualifikuar, sipas të cilit, ky OE është vlerësuar me 100 pikë, relatuar kjo edhe me shkresën "Klasifikimi Përfundimtar", datë 28.02.2022.
- Është hartuar Formulari i Njoftimit fituesit me nr. 588/8 prot., datë 02.03.2022, i cili është nënshkruar nga titullari i AK z. E.S .
- Është hartuar Raporti Përmbledhës me nr. 588/11 prot., datë 17.03.2022, i cili është miratuar nga TAK znj. E.S .

Nga verifikimi i dokumenteve të paraqitur në SPE nga ofertuesi që ka rezultuar i kualifikuar BOE "R.N." ShPK & "GPG Company" ShPK, u konstatua:
- Në Marrëveshjen e bashkëpunimit, të hartuar në datën 29.01.2022 nuk përcaktohet se kush do të jetë udhëheqësi i BOE, me qëllim që të përcaktohet nëse plotësohet kriteri për eksperiencën e ngjashme dhe i fuqisë punëtore të kërkuar ("Rajli Ndërtim" ka vetëm 13 punëtorë), në kundërshtim me nenin 88 të VKM nr. 285, datë datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*
2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.
3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së

tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.
Eksperienca e ngjashme e paraqitur nga OE "R. N." ShPK është 28% e vlerës 52,402,640 lekë në objektin "Rikonstruksion i shkollës në Fshatin Rinia", 45.6% e vlerës 29,750,959 lekë në objektin "Rikonstruksion i godinave arsimore", 31.3% e vlerës 46,735,610 lekë në objektin "Ndërtim shkolla Qerret", 40% e vlerës 45,033,757 lekë në objektin "Ndërtim shkolla e mesme e bashkuar Rrëmbec" dhe 30.4% e vlerës 24,331,648 lekë në objektin "Rikonstruksioni i shkollës Jusuf Puka". Nga sa sipër, mungesa e përqindjes së punimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit, nuk e bën të mundur përcaktimin e plotësimit/mosplotësimit të kriterit të eksperiencës së ngjashme për këtë OE.
- Nga verifikimi i dokumentacionit të OE fitues "R. N." SHPK, rezultoi se ka patur aktivitet në Maliq (objekti "Ndërtim shkolla e mesme e bashkuar Rrëmbec") në vitin 2016-2017 dhe nuk e ka ndryshuar ekstraktin historik të veprimtarisë së shoqërisë, referuar ligjit 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, "Për procedurat tatimore pika 1/1 ku citohet: "*Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia në cdo rast bëhet përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë me numer unik identifikimi të njëjtë me ate të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendodhjen e ushtrimit të vëprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia*". Për këtë rast OE duhet të ishte pajisur me certifikatë dhe të regjistrohej në QKB.
Për arsyet e lartpërmendura, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Neni 93 "Sigurimi i konkurrencës", pika 2.b, sipas të cilës "*Në rast mungese të sigurimit të konkurrencës, autoriteti/enti kontraktor anulon procedurën, si më poshtë vijon:*
a).....
b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re.
Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 206,840,255.6 lekë pa tvsh me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së A.I., Kryetar, K.B.dhe I. F., anëtarë.
Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Durrës, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

I. Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 946/11, datë 19.02.2024, është observuar nga KVO me përbërje A. I., I.F dhe K. B., si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për procedurën e prokurimit me objekt ***"Loti 1 me objekt: "Rikonstruksioni dhe riparimi mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Durrës, Njësitë Administrative Nr.1, 2, 3, 4, 5, Sukth, Manëz"***, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave paraqet shpjegimet si më poshtë:

1. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se operatori ekonomik **"Sh. 07" shpk** është skualifikuar padrejtësisht pasi ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit me përqindje 80% me 20 % për secilin element.

KVO-ja Referuar nenit 88 të VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 neni 80 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" kandidati BOE "SH. 07" shpk + FLED shpk nuk ka përcaktuar pjesët e punës, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje; në këto kushte nuk vërtetohet plotesimi që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi për kapacitetin teknik pika 2.3 gërma "b, c, d, e, f". KVO ka vendosur kështu pasi ka punonjës që i zotëron vetëm njëri nga operatorët rasti i teknikëve të ndërtimit, **operatori "Sh.07" nuk ka ne stafin e tij teknik asnje teknik ndertimi nga 6 teknike qe jane kerkuar ne kete procedure dhe sipas ndarjes se perqindjes ai duhet te kishte 80% te teknikeve te ndertimit pra diku tek 5 teknike ndertimi ndersa operatori "F." shpk 1 teknik ndertimi nderkohe qe operatori "F." Shpk ka te gjithe tekniket e kerkuar ne procedurë** duke mos e plotësuar ndarjen e përqindjes prandaj duhet të ishte bërë ndarja respektive se cilat pjesë të punëve do të kryente secila firmë.

Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

2. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se operatori ekonomik **"B.C. shpk + M. shpk"** shpk është skualifikuar padrejtësisht pasi ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit me përqindje 80% me 20 % për secilin element. KVO Referuar nenit 88 të VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 neni 80 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" kandidati **BOE B. C. shpk + M. shpk** nuk ka përcaktuar pjesët e punës, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje; në këto kushte nuk vërtetohet plotesimi që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi për kapacitetin teknik pika 2.3 gërma "b, c, d, e, f". KVO ka vendosur kështu pasi ka punonjës që i zotëron vetëm njëri nga operatorët duke mos e plotësuar ndarjen e përqindjes prandaj duhet të ishte bërë ndarja respektive se cilat pjesë të punëve do të kryente secila firmë. Sa i përket pjesës së punonjësve duke qenë se kanë të dy së bashku 174 punonjës sqarojmë që me dokumentat standarte të tenderit thuhet se:

Referuar dokumentacionit të publikuar (DST):

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per më tepër se një Lot ne rastet kur kerkohet, duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, te marra se bashku.

BOE B.C. shpk + M. shpk, nuk plotëson fuqinë punëtore pasi kanë ofertuar për të dy lotet. Duke qene se lotet kërkojnë respektivisht: 97 fuqi punetore loti 1 dhe 90 fuqi punetore loti 2= 187 fuqi punetore, operatori BOE B.C. shpk + M. shpk duhet të kishte ofertuar vetëm për një lot. Gjithashtu pika e Licences NP-3 D – Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada, ndersa operatori ekonomik **B. C. shpk** kete pike e ka NP-3A pra nuk mund të kryej 80% të punimeve për këtë zë punimesh, gjithashtu të gjitha kontratat e punës i ka të lidhura me date 02.02.2022 dhe nuk figurojne ne list pagese ose te rregjistruara tek sigurimet shoqerore konkretisht E. L.- teknik ndertimi, R. P.- teknik ndertimit etj.

Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

3. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se operatori ekonomik **"K. K."** shpk ka paraqitur 108 punonjës sqarojmë që me dokumentat standarte të tenderit thuhet se:

Referuar dokumentacionit të publikuar (DST):

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.
Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per më tepër se një Lot ne rastet kur kerkohet, duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, te marra se bashku.
"K.K." shpk ka paraqitur 108 punonjës, nuk plotëson fuqinë punëtore pasi ka ofertuar për të dy lotet. Duke qene se lotet kërkojnë respektivisht: 97 fuqi punetore loti 1 dhe 90 fuqi punetore loti 2= 187 fuqi punetore, operatori **"K.K."** shpk ka paraqitur 108 punonjës duhet të kishte ofertuar vetëm për një lot.
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.
4. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se bashkimi i operatorëve ekonomik **BOE "K. K. shpk + I. shpk"** shpk është skualifikuar padrejtësisht pasi ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit me përqindje 75% me 25 % për secilin element dhe KVO Referuar nenit 88 të VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 neni 80 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" kandidati **BOE "K. K. shpk + I. shpk** nuk ka përcaktuar pjesët e punës, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje; në këto kushte nuk vërtetohet plotesimi që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi për kapacitetin teknik pika 2.3 gërma "b, c, d, e, f". KVO ka vendosur kështu pasi ka punonjës që i zotëron vetëm njëri nga operatorët duke mos e plotësuar ***ndarjen e përqindjes pra 75% i 188 është i barabartë me 141 punonjës ndërkohë Inerti ka 103 duke mos e plotësuar ndarjen sic duhet dhe Operatori tjetër 25% 188= 47 ndërkohë ka 85 punonjës*** prandaj duhet të ishte bërë ndarja respektive se cilat pjesë të punëve do të kryente secila firmë dhe respektivisht të ndaheshin punonjësit sipas punëve që do të kryente secila.
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.
5. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se operatori ekonomik **"L. K."** shpk ka paraqitur 162 punonjës sqarojmë që me dokumentat standarte të tenderit thuhet se:

> *Referuar dokumentacionit të publikuar (DST):*
> *Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.*
> *Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per më tepër se një Lot ne rastet kur kerkohet, duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, te marra se bashku.*

"L. K." shpk ka paraqitur 162 punonjës ndersa ne listepagese 155, nuk plotëson fuqinë punëtore pasi ka ofertuar për të dy lotet. Duke qene se lotet kërkojnë respektivisht: 97 fuqi punetore loti 1 dhe 90 fuqi punetore loti 2= 187 fuqi punetore, operatori **"L. K."** shpk ka paraqitur 162 punonjës te deklaruar dhe 155 ne listepagese duhet të kishte ofertuar vetëm për një lot.
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

6. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se bashkimi i operatorëve ekonomik BOE **"P.Group" shpk+ "J." shpk** është skualifikuar padrejtësisht pasi ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit me përqindje 90% me 10% për secilin element dhe *KVO Referuar nenit 88* të VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 neni 80 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" kandidati BOE **"P. G." shpk+ "J." shpk** nuk ka përcaktuar pjesët e punës, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje; në këto kushte nuk vërtetohet plotesimi që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi për kapacitetin teknik pika 2.3 gërma "b, c, d, e, f". KVO ka vendosur kështu pasi ka punonjës që i zotëron vetëm njëri nga operatorët duke mos e plotësuar ndarjen e përqindjes prandaj duhet të ishte bërë ndarja respektive se cilat pjesë të punëve do të kryente secila firmë. Kjo sepse ndarja e puntorise nuk eshte bere sipas perqindjes se caktuar ne kontraten e bashkepunimit.
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

7. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se operatori ekonomik **"S."** shpk ka paraqitur 152 punonjës sqarojmë që me dokumentat standarte të tenderit thuhet se:
Referuar dokumentacionit të publikuar (DST):
Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.
Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per më tepër se një Lot ne rastet kur kerkohet, duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, te marra se bashku.
"S." shpk ka paraqitur 152 punonjës, nuk plotëson fuqinë punëtore pasi ka ofertuar për të dy lotet. Duke qene se lotet kërkojnë respektivisht: 97 fuqi punetore loti 1 dhe 90 fuqi punetore loti 2= 187 fuqi punetore, operatori **"S. K."** shpk ka paraqitur 152 punonjës duhet të kishte ofertuar vetëm për një lot.
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

8. Sa i përket Operatorit Ekonomik të shpallur fitues **"E. 2000 shpk**", operator i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit. SQAROJMË se përsa i përket kësaj pike, KVO nuk është në kundërshtim me kërkesat e DST, ***sepse NIPTi sekondar për eksperiencat e ngjashme nuk është kërkuar*** dhe përfshirë në DST. KVO nuk ka të drejtë të kërkojë kritere shtesë, përvec atyre që janë përcaktuar në DST. Pavarësisht kësaj kjo detyrë i takon grupit të zbatimit të kontratë që në momentin e marrjes në dorëzim të kontratës. Për aq kohë sa nuk ekziston një Nipt OE i ka plotësuar detyrimin për shlyerjen e taksave vendore për të gjitha selitë skondare që posedon. Lidhur dhe me faktin se sa rëndësi ka procesi i rindërtimin për bashkinë Durrës KVO kurrsesi nuk mund të anulonte një procedurë të tillë kur operatori në fjalë plotëson kriteret e DST, pasi anullimi i tij do të kushtonte kohë dhe financiarisht (bonuset e qerasë).
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.
Konkluzion: Duke u mbështetur në faktet e mësipërme, kërkojmë pranimin e këtij observacioni dhe rishikimin e Akt Konstatimit nga ana juaj.

<u>Opinioni i grupit të auditimit:</u>
Për observacionin më sipër, i cili është tekstualisht i njëjtë me taëtë ardhur për aktkonstatimin, grupi i auditimit, risqaron si më poshtë:
Së pari, në observacion citohet që 7 subjekte janë skualifikuar pasi nuk plotësojnë numrin e punonjësve për të dy lotet (kur kanë ofertuar në të dy lotet), ndërkohë që kriteri i cituar në observacion citon që "*Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per më tepër se një Lot* ***<u>ne rastet kur kerkohet</u>****, duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, te marra se bashku"*. Por në kriteret e kualifikimit nuk është kërkuar që duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve. Për këtë arsye, skualifikimi i 6 OE me këtë argument, është i pabazuar në KVK të vendosura në DT.
Së dyti, përsa i përket kualifikimit të padrejtë të OE "E. 2000"ShPK, në DT është kërkuar që të paraqitet "*...Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2021 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore*". Kjo referencë ligjore ka të përcaktuar që taksat vendore paguhen në të gjitha njësitë ku ka punuar ofertuesi. Në rastin konkret, OE i shpallur fitues, ka punuar dhe nuk ka hapur NIPT sekondar dhe nuk ka bërë ndryshime në QKB, pikërisht për punimet e kryera në Bashkinë Durrës, duke mbartur riskun për mospagesë të taksave vendore.
Gjithashtu, rëndësia e këtij objekti nuk është shkak që për të kryer procedurën e prokurimit për realizimin e tij, duhet të shkelet legjislacioni i Prokurimit Publik.
<u>Sa sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.</u>

III. Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 8366/36, datë 24.11.2023, është observuar nga KVO me përbërje A. I., I.F dhe K. B., si më poshtë:
Për procedurën e prokurimit me objekt ***"Loti 2 me objekt: "Rikonstruksioni dhe riparimi mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Durrës, Njësitë Administrative Nr.5 dhe Rrashbull"***, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave paraqet shpjegimet si më poshtë:

1. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se bashkimi i operatorëve ekonomik BOE **"B. X" shpk & "P." shpk** është skualifikuar padrejtësisht pasi ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit me përqindje 80% me 20 % për secilin element.
KVO-ja Referuar nenit 88 të VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 neni 80 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" kandidati **BOE "B. X" shpk & "P." shpk** nuk ka përcaktuar pjesët e punës, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje; në këto kushte nuk vërtetohet plotesimi që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi për kapacitetin teknik pika 2.3 gërma "b, c, d, e, f". KVO ka vendosur kështu pasi ka punonjës që i zotëron vetëm njëri nga duke mos e plotësuar ndarjen e përqindjes prandaj duhet të ishte bërë ndarja respektive se cilat pjesë të punëve do të kryente secila firmë.
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

2. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se operatori ekonomik **"B. C. shpk + M. shpk"** shpk është skualifikuar padrejtësisht pasi ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit me përqindje 80% me 20 % për secilin element. KVO Referuar nenit 88 të VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 neni 80 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" kandidati **BOE B. C. shpk + M. shpk** nuk ka përcaktuar pjesët e punës, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje; në këto kushte nuk vërtetohet plotesimi që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi për kapacitetin teknik pika 2.3 gërma "b, c, d, e, f". KVO ka vendosur kështu pasi ka punonjës që i zotëron vetëm njëri nga operatorët duke mos e plotësuar ndarjen e përqindjes prandaj duhet të ishte bërë ndarja respektive se cilat pjesë të punëve do të kryente secila firmë. Sa i përket pjesës së punonjësve duke qenë se kanë të dy së bashku 174 punonjës sqarojmë që me dokumentat standarte të tenderit thuhet se:
Referuar dokumentacionit të publikuar (DST):
Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.
Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per më tepër se një Lot ne rastet kur kerkohet, duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, te marra se bashku.
BOE B. C. shpk + M. shpk, nuk plotëson fuqinë punëtore pasi kanë ofertuar për të dy lotet. Duke qene se lotet kërkojnë respektivisht: 97 fuqi punetore loti 1 dhe 90 fuqi punetore loti 2= 187 fuqi punetore, operatori BOE B. C. shpk + M. shpk duhet të kishte ofertuar vetëm për një lot. Gjithashtu pika e Licences NP-3 D – Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada, ndersa operatori ekonomik **B. C. shpk** kete pike e ka NP-3A pra nuk mund të kryej 80% të punimeve për këtë zë punimesh, gjithashtu të gjitha kontratat e punës i ka të lidhura me date 02.02.2022 dhe nuk figurojne ne list pagese ose te rregjistruara tek sigurimet shoqerore konkretisht E. L.i- teknik ndertimi, R. P.- teknik ndertimit etj.
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

3. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se operatori ekonomik **"K. K."** shpk ka paraqitur 108 punonjës sqarojmë që me dokumentat standarte të tenderit thuhet se:
Referuar dokumentacionit të publikuar (DST):
Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.
Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per më tepër se një Lot ne rastet kur kerkohet, duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, te marra se bashku.
"K. K." shpk ka paraqitur 108 punonjës, nuk plotëson fuqinë punëtore pasi ka ofertuar për të dy lotet. Duke qene se lotet kërkojnë respektivisht: 97 fuqi punetore loti 1 dhe 90 fuqi punetore loti 2= 187 fuqi punetore, operatori **"K. K."** shpk ka paraqitur 108 punonjës duhet të kishte ofertuar vetëm për një lot.

Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

4. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se bashkimi i operatorëve ekonomik **BOE "K. K. shpk + I. shpk"** shpk është skualifikuar padrejtësisht pasi ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit me përqindje 75% me 25 % për secilin element dhe KVO Referuar nenit 88 të VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 neni 80 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" kandidati **BOE "K. K. shpk + I. shpk** nuk ka përcaktuar pjesët e punës, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje; në këto kushte nuk vërtetohet plotesimi që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi për kapacitetin teknik pika 2.3 gërma "b, c, d, e, f". KVO ka vendosur kështu pasi ka punonjës që i zotëron vetëm njëri nga operatorët duke mos e plotësuar ***ndarjen e përqindjes pra 75% i 188 është i barabartë me 141 punonjës ndërkohë Inerti ka 103 duke mos e plotësuar ndarjen sic duhet dhe Operatori tjetër 25% 188= 47 ndërkohë ka 85 punonjës*** prandaj duhet të ishte bërë ndarja respektive se cilat pjesë të punëve do të kryente secila firmë dhe respektivisht të ndaheshin punonjësit sipas punëve që do të kryente secila.
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

5. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se operatori ekonomik **"L. K."** shpk ka paraqitur 162 punonjës sqarojmë që me dokumentat standarte të tenderit thuhet se:
Referuar dokumentacionit të publikuar (DST):
Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.
Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per më tepër se një Lot ne rastet kur kerkohet, duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, te marra se bashku.
"L. K." shpk ka paraqitur 162 punonjës ndersa ne listepagese 155, nuk plotëson fuqinë punëtore pasi ka ofertuar për të dy lotet. Duke qene se lotet kërkojnë respektivisht: 97 fuqi punetore loti 1 dhe 90 fuqi punetore loti 2= 187 fuqi punetore, operatori **"L. K."** shpk ka paraqitur 162 punonjës te deklaruar dhe 155 ne listepagese duhet të kishte ofertuar vetëm për një lot.
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

6. Sa i përket Operatorit Ekonomik të shpallur fitues **BOE "R.N."shpk& "G.P.G C." shpk** , operator i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit.

SQAROJMË :
1 -**BOE "R. N."shpk& "G.P.G C." shpk** ka paraqitur ne SPE kontraten e bashkepunimit Nr315Rep ,Nr 131Kol date 29.01.2022, ku pika 1 e kesaj kontrate percakton perfaqesimin e ketij partneriteti qe eshte shoqeria "Rajli Ndertim" shpk,duke perfshire maredhenien me investitorin,drejtruesin e punimeve dhe ndaj cdo pale te trete qe lidhen me zbatimin e kesaj kontrate. Gjithashtu pika 2 e kesaj kontrate e bashkepunimit sqaron ndarjen e punimeve siopas tabeles se paraqitur per sejcilin operator, ku sipas preventivit te paraqitur se bashku me formularin e ofertes shoqeria "R. Ndertim" shpk ka 17.28% =35.766.797.leke,kurse shoqeria "G.P.G C." ka 82.72% =170.722.458.leke.(bashkelidhur prokure,kontrate bashkepunimi,formular oferte dhe preventiv)
Gjithashtu **BOE "R. N."shpk& "G.P.G C." shpk** ka paraqiturne SPE prokure te Posacme nr 314Rep dhe Nr 130Kol date 29.01.2022 ku percaktohet perfaqesuesi ligjor per objektin e mesiperm i cili eshte shoqeria "R. N."shpk.

2-Shoqeria "R.N." ka parqitur ne SPE list pagesa muaji Dhjetor 2021 prej (13+15) 28 persona,kontratat e punes ,certifikatat sipas profesioneve per sejcilin punonjes, nga 90 te kerkuar ne DST, staf i angazhuar per kete kontrate,i shprehur ne perqindje 28/90=31 %,kur sa sqaruam me lart shoqeria R. N. shpk ka 17.28% te punimeve ne kete kontrate.(bashkelidhur list pagesat dhe deklarata e stafit teknik).
3-Per sai perket sigurimit te ofertes KVO sqaron qe ky sigurim eshte bere ne emer te **BOE "R. N."shpk& "G.P.G C."** shpk sipas formatit te kerkuar ne DST(bashkelidhur sigurimi i ofertes).

3-Eksperienca e ngjashme e paraqitur nga OE "R.N." shpk i vertetuar sipas Formularit te Vleresimit eshte si meposhte:
-Ndertim shkolla fshat Rinia vlera 52.402.640.leke R. N. 28% =14.672.739 leke.
-Ndertim shkolla e mesme e bashkuar Rembec,Bashkia Maliq vlera 54.004.290 leke R. N.40%=21.601.716.leke
-Ndertim shkolla 9 vjecare Qerret vlera 46.735.610.leke R. N.31.3%=14.628.246.leke.
-Rikonstruksion godina arsimore viti 2017 vlera 29.750.959.leke R. N. 45.6% =13.566.437leke.
-Rikonstruksion shkolla vjecare "Jusuf Puka" vlera 24.331.648 leke R. N. shpk 30.7%=7.469.816.leke
Shumatorja e te gjitha objekteve me siper eshte 71.938.954.leke per operatorin 'R.N."shpk
Ne DST 2.3 Kapaciteti teknik pika b pune te ngjashme deri ne nje kufi,ku vlera monetare totale e puneve te kryera,te marra se bashku gjate pese viteve te fundit eshte jo me e vogel se 360.000.000.leke, eshte respektuar nga operatori "R. N." shpk 71.938.954 /360.000.000 = 19.98% nga 17.28% e ofertes. Pjesa tjeter e punimeve te ngjashme eshte plotesuar nga shoqeria "G.P.G C."shpk (bashkelidhur formularet e vleresismit per objektet e mesiperme).

3-Nga grupi i auditimit eshte verifikuar qe OE "R.N."shpk ka patur aktivitet ne Maliq (objekti: Ndertim shkolla e mesme e Bashkuar Rrembec) ne vitin 2016-2017, ku ky subjekt nuk ka ndryshuar ekstraktin historik te veprimtarise se shoqerise referuar ligjit 9920,date 19.05.2008 i ndryshuar "Per proceduart tatimore pika 1/1 ku subjekti ne fjale duhet te pajiset me certifikate me numer unik identifikimi te njejte me ate te regjistrimit, por me numer serial te ndryshem per te identifikuar vendodhjen e ushtrimit te veprimtarise, kur eshte e ndryshme nga selia. Per kete OE duhet te pajiset me kete certifikate dhe te regjistrohet ne QKB.

KVO sqaron se ne Kriteret e Vecanta pika :

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2021 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë ketë dokument).
Eshte respektuar nga OE "R. N." i cili ushtron aktivitetin ndertim ne qytetin e Durresit.

KVO nuk është në kundërshtim me kërkesat e DST, ***sepse Nipti sekondar për eksperiencat e ngjashme nuk është kërkuar*** dhe përfshirë në DST. KVO nuk ka të drejtë të kërkojë kritere shtesë, përvec atyre që janë përcaktuar në DST. Pavarësisht kësaj kjo detyrë i takon grupit të zbatimit të kontratë që në momentin e marrjes në dorëzim të kontratës. Për aq kohë sa nuk ekziston një Nipt OE i ka plotësuar detyrimin për shlyerjen e taksave vendore për të gjitha selitë skondare që posedon. Lidhur dhe me faktin se sa rëndësi ka procesi i rindërtimin për bashkinë Durrës KVO kurrsesi nuk mund të anulonte një procedurë të tillë kur operatori në fjalë plotëson kriteret e DST, pasi anullimi i tij do të kushtonte kohë dhe financiarisht (bonuset e qerasë).
Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

Konkluzion: Duke u mbështetur në faktet e mësipërme, kërkojmë pranimin e këtij observacioni dhe rishikimin e Akt Konstatimit nga ana juaj.

Opinioni i grupit të auditimit:
Për observacionin më sipër, i cili është tekstualisht i njëjtë me taëtë ardhur për aktkonstatimin, grupi i auditimit, risqaron si më poshtë:
Së pari, në observacion citohet që 6 subjekte janë skualifikuar pasi nuk plotësojnë numrin e punonjësve për të dy lotet (kur kanë ofertuar në të dy lotet), ndërkohë që kriteri i cituar në observacion citon që "*Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per më tepër se një Lot, **ne rastet***

***kur kerkohet**, duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, te marra se bashku"*. Por në kriteret e kualifikimit nuk është kërkuar që duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve. Për këtë arsye, skualifikimi i 6 OE me këtë argument, është i pabazuar në KVK të vendosura në DT.
Së dyti, përsa i përket kualifikimit të padrejtë të BOE "R. N." ShPK & "G. C." ShPK, sqarojmë se:
- Marrëveshja e administruar në SPE dhe bashkelidhur edhe observacionit, nuk ka ndarje me përqindje të punimeve dhe të fitimit. Preventivi i paraqitur nga ky ofertues për ndarjen e punimeve është pa çmime dhe nuk mund të përcaktohet nëse është reale në vlerë përqindja takuese e punëve apo jo (sipas asaj të cituar në observacion 17.28%). Preventivi i paraqitur me çmime, i përket fazës së dytë;
- OE "R.N." ShPK ka paraqitur listëpagesën e muajit Dhjetor 2021 për 13 të punësuar (citimi në observacion 13 + 15 = 28, është e pakuptimtë);
- Përsa i përket eksperiencës së ngjashme, duke qenë se në Marrëveshjen e Bashkëpunimit nuk ka ndarje punimesh me përqindje, KVO mund të gjykonte edhe sipas faktit që, meqënëse OE "R. N." ShPK është edhe kryesuese e BOE sipas marrëveshjes me "GPG C." ShPK, ajo nuk e plotëson eksperiencën e ngjashme me objekt të vetëm 90 mln lekë, ose të gjitha objektet 180 mln lekë (të paktën 50% të vlerës totale, si kryesuese e BOE);
-Në DT është kërkuar që të paraqitet "*...Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2021 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore*"". Kjo referencë ligjore ka të përcaktuar që taksat vendore paguhen në të gjitha njësitë ku ka punuar ofertuesi. Në rastin konkret, OE i shpallur fitues, ka punuar dhe nuk ka hapur NIPT sekondar dhe nuk ka bërë ndryshime në QKB, për punimet e kryera në Bashkinë Maliq, në kundërshtim me këtë referencë ligjore.
Gjithashtu, rëndësia e këtij objekti nuk është shkak që për të kryer procedurën e prokurimit për realizimin e tij, duhet të shkelet legjislacioni i Prokurimit Publik.
Sa sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

IV. Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 8366/44, datë 23.11.2023, është observuar nga Grupi i specifikimeve teknike dhe fondit limit me përbërje E. T., A .K., J. K. dhe M. J., si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
Në vijim të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr.765/11 Prot, protokolluar me tonën Nr. 946 Prot datë 19.01.2024 , ju paraqesim obsvervacionet tona si më poshtë vijon:
4. Proçedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), Njësitë Administrative 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 1+ Loti2)., sipas opinionit të grupit të auditmit faqe 198 :
".... Arkitekti është i pajustifikuar teknikisht , pasi projekti është hartuar dhe kjo është procedura e prokurimit të zbatimit."
Për opinionin e sipërcituar po ju sqarojmë si më poshtë:
Arkitekti eshte i nevojshem per drejtimin e punimeve te rifinitures, përzgjedhjen e materjaleve dhe te bojrave.
Gjithashtu kërkesa për arkitekt i referohet njërës prej pikave të liçencave profesionale që duhet të disponojë shoqëria sipas DT konkretisht pikës:
NS-4 – Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.
Vendosja e këtij kriteri është bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

Opinion i grupit të auditimit:
Argumenti i sjellë nëpërmjet këtij observacioni, nuk merret në konsideratë. Arkitekti është i pajustifikuar teknikisht, pasi projekti është hartuar dhe kjo është procedura e prokurimit të zbatimit.

5. Procedura e prokurimit me objekt "Riforcimi i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501", Bashkia Durrës

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Riforcimi i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501", Nr. REF-48357 datë 11-02-2022.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 8293/2 prot, datë 31.10.2022
2. Lloji i Procedurës –
"E kufizuar" në kuadër të procesit të rindërtimit.</td><td>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit
Urdhër nr. 498, datë 12.10.2022
1. R. D. Kryetar,
2. E.T.
3. A. K.
4. O. G.
5. M. J.
1. Urdhër Prokurimi
Nr. 8293/2 prot., datë 31.10.2022
Njësia e Prokurimit
1. A.Xh., Jurist
2. K. Dh., Ekonomist
3. I. F., Menaxhim Biznesi
4. A. T.Arkitekt
5. E. Gj. inxhinier
Persona përgjegjës gjithë NJP</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 539, datë 31.10.2022
A. I., Kryetar
K.B.
L.B</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh) 67,033,724 lekë,</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh)
BOE "A&M&A" ShPK & "S." ShPK
me ofertë 66,296,189.33 lekë pa tvsh,
sipas kontratës nr. 185/1 prot, dt. 09.01.2023 me afat 224 ditë nga data e fillimit të punimeve.</td><td>7. Diferenca me fondin limit
737,535 lekë, ose 1.1 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
Datë 14.11.2022</td><td>9. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit, Fondet e rindërtimit</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE
b) S'kualifikuar 1 OE,
c) Kualifikuar 1 BOE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; nuk ka ankesë.</td><td>12. Përgjigje Ankesës nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës
nuk ka</td></tr>
</table>

Burimi i të dhënave: Bashkia Durrës
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E kufizuar ", me vlerë 67,033,724 pa TVSH. Burimi i Financimit: Fonde të vëna në dispozicion nga buxheti shtetit sipas VKM Nr.181, date 30.03.2022 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të ndërtimit në ndërtesa pallat, në Bashkinë Tiranë, Durrës, Shijak Lezhë dhe Krujë", dhe VKB Nr. 62, datë 16.06.2022 "Për miratimin e ndryshimit të tabelës së detajimit të fondit".

Situata 1
Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga NjP nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 02.11.2022, si më poshtë:

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Në pikën 2.3. të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 2 inxhinierë ndërtimi (njëri strukturist), 1 inxhinier hidroteknik, inxhinier elektrik dhe 3 teknikë ndërtimi. Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin e punimeve në objektin që prokurohet (nje inxhinier ndërtimi).
2- Në seksionin 4 të DT, "Procedura", citohet që kjo procedurë përfshin 2 faza, 1- Kualifikimi dhe 2- Paraqitja e ofertës/lidhja e kontratës. Në fazën e parë kandidatët do të dorëzojnë kapacitetet teknike, ligjore, ekonomike me ose pa detyrimin për paraqitjen e ofertës financiare (më poshtë citohet që nuk duhet sjellë oferta financiare në fazën e parë) dhe dokumentet e

kërkuara në DT. Autoriteti përgjegjës do të shqyrtojë dokumentet e dorëzuara nga kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kandidatët, që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit, skualifikohen dhe njoftohen menjëherë për këtë skualifikim. Autoriteti përgjegjës, kur e vlerëson të nevojshme, mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të dorëzojnë me dokumentacionin edhe një çmim/ofertë referues/e, e cila gjatë fazës së dytë nuk duhet të jetë më e lartë.
Nga ana tjetër në shtojcën 15 "Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit", citohet që "**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës**", pa cituar se cilës shtojcë. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk ka asnjë shtojcë për vetëdeklarimin e kritereve të përgjithshme të kualifikimit. Sa sipër, informacioni për ofertuesit është i cunguar dhe jo i qartë, duke sjellë konfuzion në paraqitjen e ofertave, veprim që ngarkon me përgjegjësi NjP..

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me volumin e objektit që prokurohet**.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi grupi i hartimit të dokumenteve të tenderit, me përbërje R. D.Kryetar, O.G., E.T., A K.dhe M. J., anëtarë.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike dhe Projektpreventivi i objektit
Projektpreventivi, dhe specifikimet teknike janë hartuar nga projektuesi BOE "A." ShPK, "E.-G" ShPK dhe A. & G. 2000" ShPK
Argumentimi i fondit limit është hartuar grupi i punës i ngritur me urdhrin e TAK nr. 498, datë 12.10.2022, me përbërje R. D.Kryetar, O. G., Eni Turkeshi, A. K. dhe M.J., anëtarë, të cilët kanë cituar që janë mbështetur në preventivin që ka hartuar projektuesi.
Nga auditimi me zgjedhje i çmimeve të vendosura për disa zëra pune (ato me vlerë më të madhe), rezultoi se çmimet e zërave të cilat janë edhe në manualin e çmimeve, janë vendosur sipas manualit.

Situata 2
Mbi vlerësimin e ofertave
Nga auditimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se është përdorur procedurë "E kufizuar," (Marrëveshje kuadër-Procesi i Rindërtimit). Ky prokurim është kryer me dy faza, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", neni 42, pika 6.
Faza 1 - Parakualifikimi: Kandidatët do të paraqesin dokumentet e kërkuara në DT. Autoriteti / Enti Kontraktor do të shqyrtojë dokumentet e paraqitura nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Faza 2 - Ftesa për oferta: Autoriteti / Enti Kontraktor i dërgon ftesë për ofertë Kandidatëve të cilët kanë përmbushur kërkesat e parakualifikimit, **me anë të së cilës i fton këta Kandidatë të paraqesin një ofertë teknike dhe ekonomike.** Ofertat do të rishikohen dhe vlerësohen nga Autoriteti / Enti Kontraktor për të përcaktuar ofertën fituese.

Në dosje administrohet procesverbali për Fazën 1, datë 14.11.2022 për hapjen e ofertave dhe procesverbali i shqyrtimit të ofertave, datë 14.11.2022. Nisur nga verifikimi në SPE dhe Proceverbalet e hapjes dhe shqyrtimit të ofertave, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 2 OE/BOE, si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës
1	BOE "A&M&A" ShPK & "S." ShPK
2	OE "N." ShPK

Burimi i të dhënave: SPE

Nga verifikimi i procesverbalit të shqyrtimit të ofertave dhe Raporti Përmbledhës, u konstatua se në fazën e parë, atë të vlerësimit të dokumentacionit teknik, është kualifikuar BOE "A&M&A" ShPK & "S." ShPK dhe është skualifikuar OE "N." ShPK:
1. OE "N." ShPK është skualifikuar për shkak të mungesës së inxhinierit strukturist dhe për shkak se nuk është paraqitur vërtetimi i shlyerjes së taksave vendore për vitin 2022 në Bashkinë Berat.
2. BOE "A&M&A" ShPK & "S." ShPK, është kualifikuar për fazën e dytë.
Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës, me nr. 8293/15 prot. datë 22.12.2022.

Nga verifikimi në SPE i dokumentacionit të paraqitur nga këta dy ofertues, u konstatua se:
1. OE "N." ShPK ka paraqitur si inxhinier ndërtimi z. A. K., i cili në licencën profesionale të ngarkuar në SPE, rezulton të ketë edhe projektimin e objekteve civile industriale deri në 5 kate. Nga KVO ky inxhinier, mund të ishte trajtuar si inxhinier ndërtimi strukturist, duke e cilësuar këtë kriter të plotësuar.
- OE "N." Shpk ka paraqitur në SPE vërtetim për pagimin e taksave vendore në 9 bashki të vendit, të cilat i ka të deklaruara në Ekstraktin historik të QKB dhe nuk ka sjellë vërtetimin që ka paguar taksën vendore në Bashkinë Berat (siç edhe citohet nga KVO në procesverbal), adresa e të cilës është shtuar në 25.08.2022.
Sa sipër, ky OE është skualifikuar vetëm për mungesën e vërtetimit për pagimin e taksës vendore në Bashkinë Berat. Sa sipër, KVO duhet të kishte kërkuar sqarime nga OE, pa ndryshuar ofertën, në zbatim të Neni 82 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 2.

2. Nga verifikimi i dokumenteve të paraqitur në SPE nga BOE që ka rezultuar e kualifikuar BOE "A&M&A" ShPK & "S." ShPK, u konstatua:
- OE "A&M&A" ShPK nuk ka paraqitur asnjë dokument nga QKB, në mënyrë që të gjykohet mbi gjeneralitetet, statusin, objektin e veprimtarisë, adresën, etj.
- Shtojca 13 për diponueshmërinë e mjetev/makinerive nuk është e plotësuar;
- Nuk ka vërtetim për xhiron vjetore;
- Bilancet 2020 dhe 2021 (që figurojnë me fitim/humbje 0 lekë), nuk janë të shoqëruara me Akt ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar dhe janë në emrin e subjektit "Lindja e Re 2014";
- Nuk ka paraqitur asnjë eksperiencë të ngjashme;
- Në marrëveshjen e bashkepunimit ka deklaruar se do të bëjë 51% të punimeve, por nuk ka paraqitur listëpagesë për të vërtetuar numrin e të punësuarve.
- Mungon prokura e posaçme për të parë se kush e përfaqëson BOE-në;
- Nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton pagesën e taksave dhe detyrimeve tatimore.

BOE "A&M&A" ShPK & "S." ShPK (së bashku) ka këto mangësi:
-Nuk plotësojnë eksperiencën e ngjashme prej 32,000,000 lekë në një objekt të vetëm (edhe OE "S." ShPK ka paraqitur vetëm një eksperiencë të ngjashme "Rikonstruksioni i godinës së vjetër Dega e Doganës Vlorë" me vlerë 26,466,570 lekë pa TVSH dhe ku ky OE ka 95% të punimeve);
- Nuk plotësohet nga asnjë nga anëtarët e BOE kategoria NS 4-B e licencës profesionale;
- Nuk është paraqitur inxhinier strukturist;
- Është paraqitur vetëm 1 teknik ndërtimi, nga 3 të kërkuar;
- Mungon numri i kërkuar për hidroizoluesit, bojaxhinjtë (asnjë), hekurkthyesit (asnjë), karpentierët, muratorët, etj.;

- Nuk plotësohet numri i fuqisë punëtore të kërkuar, 78 (ka paraqitur 38 punonjës vetëm OE "S." ShPK;
- Mungon autobetoniera, fadroma dhe skeleritë (vetëm 300 m^2 nga 2000 m^2 të kërkuar në DT).
Për arsyet e lartpërmendura, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Neni 93 "Sigurimi i konkurrencës", pika 2.b, sipas të cilës "*Në rast mungese të sigurimit të konkurrencës, autoriteti/enti kontraktor anulon procedurën, si më poshtë vijon:*
a).....
b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re.
Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 66,289,189.33 lekë pa TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së A. I., Kryetar, K. B.dhe L.B , anëtarë.

Pas kualifikimit të këtij OE, AK ka bërë ftesën për ofertë me shkresën nr. 8293/6, datë 22.11.2022 për OE të kualifikuar. KVO ka bërë vlerësimin e ofertës së këtij OE, duke e vlerësuar me pikë të plota, 100 pikë.
Para lidhjes së kontratës, nga OE fitues është paraqitur formulari i sigurimit të kontratës në emër të shoqërisë "Lindja e re 2014" ShPK & "S." ShPK, pra jo të BOE të shpallur fitues "A&M&A" ShPK & "S." ShPK. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit dhe TAK znj. E.S .
Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Durrës, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

I. Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 946/11, datë 19.02.2024, është observuar nga KVO me përbërje A. I., I.F dhe K. B., si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:
1-Sipas audituesit : ***OE A&M&A Shpk*** nuk ka paraqitur asnje dokument nga QKB, ne menyre qe te gjykohet mbi gjeneralitetet, statusin, objektin e veprimtarise, adresen, etj.
Sipas shtojces 15
KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT
Ofertuesi duhet të deklarojë se:
a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 42 të Aktit Normativ.

ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.
Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës.
Në rasti se kemi grupe operatorësh ekonomikë, seicili prej operatorëve duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.
Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

KVO sqaron se :
1- Lidhur me kete shoqeria ***A&M&A Group shpk*** ka paraqitur shtojcen Nr.10 Deklarate mbi permbushjen e kritereve te pergjithshme ku ka deklaruar qe eshte i regjistruar prane QKB nuk eshte i denuar, nuk eshte ne proces falimentimi,statusi aktiv dhe ka paguar te gjithe detyrimet per pagimin e tatimeve dhe te kontributeve te sigurimeve shoqerore sipas legjislacionit ne fuqi ne kete rast ***KVO*** ka kryer verifikimet e nevojshme te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper.
2-Per sa i perket vendosjes se mases se sigurimit dhe detyrimit tatimor Nr.37300Prot, date 20.12.2022 ,nga DPT mbi tatimpaguesi ***A&M&A Group shpk***, sqarojme se data 20.12.2022 eshte jashte kohes se procedures se tenderit,date 14.11.2022 pra KVO nuk mban pergjegjesi mbi procedurat tatimore jashte kesaj date.
3-Sipas audituesit ; Nuk ka vertetim per xhiron vjetore, ***KVO*** sqaron se ***OE A&M&A Group shpk*** ne baze te bilanceve te paraqitura per vitin 2020,2021 xhiro vjetore per vitin 2021 jane ***16.857.224 leke*** dhe per vitin 2020 jane ***13.442.171 leke*** ne total ***30.299.395 leke***, pjesa tjeter eshte plotesuar nga OE ***S.*** sipas vertetimit Nr.T07202457 date 09.11.2022 ku vlera e xhiros per tre vitet e fundit eshte***154.385.999 leke***,pra ne total BOE ka ***184.685.394 leke*** ne DST e kerkuar vlera e xhiros eshte kerkuar ***65.000.000 leke.*** Gjithashtu sqarojme se bilancet 2020,2021 nuk jane shoqeruar me akt ekspertize te ekspertit kontabel pasi per te realizuar nje Ekspertiz Kontabel duhet te plotesohen disa kritere baze ne te cilat kjo shoqeri nuk i ka plotesuar,por Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabel eshte plotesuar nga ***OE S. Shpk*** bashkelidhur ketij Observacioni.
4-Sipas audituesit Nuk ka paraqitur asnje eksperienc te ngjashme,***KVO*** sqaron se ky kriter eshte plotesuar nga ***OE S. shpk*** , ndermjet kontrates
Rikonstruksioni i Godines se Vjeter Dega e Doganes Vlore" me vlere ***26.466.570 leke*** ku si pas Formularit te Vlersimit zoteron 95% te punimeve e perkthyer kjo ne vlere ***25.143.236 leke*** ne perqindje rreth 39% . ***KVO*** ka vlersuar kete pune pasi shoqeria Sardo ka kryer dhe pune te tjera prane Bashkise Durres me cilesi dhe sipas kushteve teknike te ndertimit KTN, KTZ. Gjithashtu OE ***A. Group shpk*** eshte nje shoqeri ndertuese ne qytetin e Durresit e cila ka mar pjese ne rindertimin e qytetit kryesisht ne demet e termetit duke bere dhe akte bamiresie per njerzit ne nevoje.
5-Sipas audituesit ; Nuk plotesohet nga asnje anetaret e BOE kategoria NS 4-B e licenses profesionale***.*** ***KVO*** sqaron se shoqeria ***A. Group shpk*** e zoteron licensen me Nr. NZ.7106/1. Bashkelidhur Licensa.
6-Sipas audituesit ; Mungon prokura e posacme per te pare se kush e perfaqson BOE-në. ***KVO*** sqaron se në Akt-Marrveshjen e Bashkepunimit data 10.11.2022 operatoret ekonomik kanë percaktuar perfaqesuesin e ketij bashkimi shoqerine ***A. Group shpk*** me Administrator Z.M. B. i cili do te kryej te gjitha veprimet per llogari te BOE-së. Bashkelidhur Akt Marreveshja.
7- Sipas audituesit ; Nuk eshte paraqitur Ing Strukturist. ***KVO*** sqaron se OE Sardo ka drejtues teknik Ing Ndertimi Z.K. Sh. i cili ka perfunduar studimet sipas diplomes Nr.Serial 1226-B ne vitin 1972 sistem (5 vjecar) i cili ka perfshire te gjitha llojet e ndertimeve qe nga strukturat rruget veprat hidroteknike etj. Shoqeria ***A. Group shpk*** ka Ing Strukturist Z.B. M. me Nr.3631 date 09.10.2009 sipas Kontrates se Punes date 20.10.2022. Bashkelidhur Diplomat Kualifikuese dhe Kontratat.
8- Sipas audituesit ; Eshte paraqitur nje Teknik Ndertimi nga 3 te kerkuar. ***KVO*** sqaron te dyja shoqerite kane drejtues teknik 11 ne total ku jane Inxhinjere ndertimi,elektrik,hidroteknik,mekanik te perfshire ne license. Sipas pikes 2.3 Kapacitetit Teknik pika c) Jane kerkuar :

- Inxhinier ndertimi 1 (një)
- Inxhinier ndertimi profil strukturist 1 (nje)

- Inxhinier elektrik 1 (nje)
- Inxhinier hidroteknik 1 (nje)
- Teknik Ndërtimi 3 (tre)

KVO sqaron se duke qene se ne stafin drejtues jane 11 Inxhiniere mungesa e dy teknikeve nuk perben problem ne realizimin e punimeve pasi duke studiuar Licensat Diplomat dhe CV-të e tyre,realizojne me sukses Kontraten.

9- Sipas audituesit ; Shtojca 13 mbi disponueshmerine e mjeteve nuk eshte e plotesuar.
KVO sqaron se shoqeria **S.** ka plotesuar Formularin e Vetedeklarimit Shtojca 8 ku deklaron : Mjetet (Kamion 5 ton,Kamion 7.5-18 ton), Skeleri 300 m^2 me dokumentat perkatese te tyre. Shoqeria ***A. Group shpk*** ka deklaruar Skeleri 2000 m^2 sipas kontrates se qirase date 25.10.2022 ,gjithashtu ka deklaruar Kontrate Qiraje Mjetesh per: Kamion AA542SI,Fadrome me fature tatimore Seria 26471310 Nr. Fature 7160 date 13.10.2015, Autobetoniere me targe AA652. Bashkelidhur Kontrata e Qirase.

10-Sipas Audituesit; Nuk plotesohet Nr i fuqise puntore te kerkuar 78 dhe Mungon Nr i kerkuar per hidroizoluesit,bojaxhinjte,hekurthyesit,karpentieret,muratoret.
KVO sqaron se ***A. Group shpk*** disponon karpentier 4, hekurthyes 4,bojaxhinje 2,muratore 2,hidrozioues 2,elektriciste 1,drejtues mjeti 2 ,puntore ndertimi 20 sipas deklarimit Bashkelidhur Kontrata Individuale Certifikatat sipas profesioneve . Totali i punonjesve per shoqerine ***A. Group shpk*** eshte 43 punonjes, nga ku jane 6 jane Ing, 20 puntore dhe 17 specialiste. Shoqeria **S.** disponon 38 punonjes Ing+ Puntore +Specialiste .Totali i punonjesve per kete kontrate eshte 81, ku ne DST eshte kerkuar 78.

2- Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së per operatorin ekonomik ***N. shpk*** është skualifikuar padrejtësisht.

KVO sqaron si më poshtë :
Në DST tek Kritert e Vecanta 2.3 Kapaciteti Teknik pika c) nuk eshte kerkuar Ing me license Projektimi por Zbatimi,gjithashtu nga verifikimet e ***KVO-se*** Z.Ardian Kalamishi figuron drejtues ligjor prane kompanise K.A.N sh.p.k . Bashkelidhur dokumentin e Ministrise Se Infrastruktures dhe Energjise,Zyres se Licensave .

Ju bejmë me dije se kontrata "Riforcim i godinave pallat kod GIS 1569,27348,27501" BOE "A. Shpk & S. Shpk" nuk është realizuar sepse një nga objektet me kod gis 27501 ndodhet në zonë arkeologjike dhe nga projeketi hartuar per rehabilitimin e zones arkeologjike është me status prishje, dhe nga Ministria e Kultures do të kaloj në proces shpronësimi, gjitashtu theksojmë se ky objekt ka vlerën me të madhe se 20 % të vleres totale dhe Bashkia Durrës po negocion për prishjen e kontratës dhe rihedhjen të procedurës nga e para per dy objektet e tjera.

KVO ka pranuar disa devijacjone te vogla per BOE "A. Shpk & S. Shpk firma te cilat jane angazhuar ne procesin e rindertimit si dhe kjo procedure ka deshtuar disa here, presioni i banoreve ka qene shume i madh prane Bashkise Durres per keto objekte, pjesa me e madhe e ketyre familjeve trajtoheshin dhe me bonus qeraje, zgjatja e afateve krijonte grope financiare ne buxhet nisur nga keto arsyje bem shpalljen e BOE "A. Shpk & S. Shpk.

<u>Opinioni i grupit të auditimit:</u>
Për observacionin më sipër, i cili është tekstualisht i njëjtë me atë të ardhur për aktkonstatimin, grupi i auditimit, risqaron si më poshtë:
1. Përsa i përket paraqitjes së ekstraktit nga QKB, ky kriter duhet plotësuar për të parë KVO-ja Njësitë vendore ku ka operuar ky OE, me qëllim verifikimin nëse i ka paguar taksat vendore. Ky pretendim nuk merret në konsideratë;
2. Argumenti merret pjesërisht në konsideratë (vetëm për Vendosjen e Masës së Sigurimit të Detyrimit Tatimor) dhe do të reflektohet në Projektraportin e Auditimit;

3. Nëse Xhiro vjetore do të shihej nga bilanci, Njësia e Prokurimit nuk duhet ta kishte kërkuar këtë vërtetim. Ndërkohë, KVO nuk duhet të gjykojë, por të kontrollojë plotësimin e kritereve të vendosura në DT. Ky pretendim nuk merret në konsideratë;
4. Nisur nga arsyetimi i KVO-së në këtë pikë, gjykohet lehtësisht që vlerësimi i saj është subjektiv. Eksperienca e ngjashme plotësohet nga të dy pjesëmarrësit në BOE, sipas përqindjes, ndërkohë që OE "A. ShPK është shoqëria që ka marrë përsipër pjesën më të madhe të punimeve (51%) dhe duhet të plotësojë kushtin që të ketë kryer punime në një objekt të vetëm sa 50% e vlerës së objektit që prokurohet. Në këtë BOE nuk e plotëson eksperiencën e ngjashme, jo vetëm ky OE, por edhe antari tjetër i BOE **dhe ky nuk është devijim i vogël**. Ky pretendim nuk merret në konsideratë;
5. Nga dokumentet e paraqitura në SPE, konstatimi i grupit të auditimit është i saktë dhe për kualifikimin e BOE, KVO-ja duhet të kishte gjykuar mbi dokumentacionin e hedhur në sistem. Licenca e paraqitur bashkëlidhur observacionit është lëshuar në datën 23.11.2022, ose 9 ditë pas hapjes së procedurës. Ky pretendim nuk merret në konsideratë;
6. Është cituar që mungon Prokura e Posaçme dhe jo Marrëveshja e Bashkëpunimit. Ky pretendim nuk merret në konsideratë;
7. Nga dokumentet e paraqitura në SPE, konstatimi i grupit të auditimit është i saktë dhe për kualifikimin e BOE, KVO-ja duhet të kishte gjykuar mbi dokumentacionin e hedhur në sistem. Ing. K. Sh. është ing hidroteknik dhe jo ndërtimi. Ky pretendim nuk merret në konsideratë;
8. Teknikët janë kërkuar në DT dhe KVO-ja duhet të vlerësojë dokumentet e paraqitura dhe jo të gjykojë mbi kriteret. Ky pretendim nuk merret në konsideratë;
9. Nga dokumentet e paraqitura në SPE, konstatimi i grupit të auditimit është i saktë dhe për kualifikimin e BOE, KVO-ja duhet të kishte gjykuar mbi dokumentacionin e hedhur në sistem. Ky pretendim nuk merret në konsideratë;
10. Nga dokumentet e paraqitura në SPE, konstatimi i grupit të auditimit është i saktë dhe për kualifikimin e BOE, KVO-ja duhet të kishte gjykuar mbi dokumentacionin e hedhur në sistem. Ky pretendim nuk merret në konsideratë;

Përsa i përket pretendimeve për skualifikimin e OE "N." ShPK:

1. Në SPE është paraqitur dokumentacioni i z. Ardian Kalamishi si drejtues teknik i OE "N." ShPK, i cili është diplomuar para vitin 1990, ku nuk ka qenë e ndarë me inxhinierë strukturistë, por të gjithë të diplomuarit në degën "Ndërtime civile dhe industriale" kanë qenë njëkohësisht inxhinierë strukturistë dhe zbatimi. KVO duhet të kishte bërë "gërmimin" për informacion për inxhinierin e mësipërm në kohën e vlerësimit të ofertave dhe të kërkonte sqarime, pasi shoqëria që ky person është Drejtues Ligjor, mund të mos jetë duke kryer aktivitet. Pas verifikimeve, KVO duhet ta kishte shkruar si arsye skualifikimi në kohën e vlerësimit të ofertave.

Si përfundim, grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë pretendimet e ardhura nëpërmjet observacionit. Fakti që për këtë objekt, Bashkia Durrës po negociion për prishjen e kontratës (bashkëlidhur nuk ka ndonjë dokument shoqërues që ta vërtetojë këtë fakt), nuk përbën arsye për shmangien nga përgjegjësia gjatë vlerësimit të ofertave.

III. Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 946/11, datë 19.02.2024, është observuar nga Grupi i specifikimeve teknike dhe fondit limit me përbërje E. T., A. K., R. D. dhe M. J., si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:

Në vijim të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr.765/11 Prot, protokolluar me tonën Nr. 946 Prot datë 19.01.2024 , ju paraqesim obsvervacionet tona si më poshtë vijon:
5. Proçedura e prokurimit me objekt "Riforcimi i godinave pallat me kod gis 1569,27348,27501", sipas opinionit të grupit të auditmit faqe 211 :
".... Inxhinieri strukturist është i pajustifikuar, pasi projekti është hartuar dhe kjo është procedura e prokurimit të zbatimit."
Për opinionin e sipërcituar po ju sqarojmë si më poshtë:
Inxhinier Ndërtimi profili strukturist, edhe pse projekti është hartuar, është i nevojshëm për:

- Zbërthimin e projektit gjatë zbatimit në mënyrë të detajuar nga ana strukturore.
- Të konsultuar stafin mbështesës gjatë punimeve të prishjeve duke patur kujdes në shpërndarjen e ngarkesave në elementet strukturore duke qënë se këto elemente strukturore të objektit janë të dëmtuar nga tërmeti.
- Për të dhënë zgjidhje momentale në kantier për çdo të papritur dhe çdo problem konstruktiv që mund të dalë gjatë zbatimit të punimeve, deri ardhjen grupit të projektimit.

Vendosja e këtij kriteri është bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

Opinioni i grupit të auditimit:

Pretendimi i sjellë nëpërmjet këtij observacioni, nuk merret në konsideratë. Inxhinieri strukturist është i pajustifikuar, pasi projekti është hartuar dhe kjo është procedura e prokurimit të zbatimit. Detyrat e parashtruara më sipër, i kryen inxhinieri i ndërtimit i kërkuar.

Pretendimi i subjektit:

... Sqarojmë se grupi i punës i ngritur sipas urdhërit Nr.498,datë 12.10.2022 nuk është përgjegjës për seksionin 4 te DT. Përgatitja e DT-së bëhet nga specialistë të Sektorit të Prokurimeve.

Opinioni i grupit të auditimit:

Përsa i përket përgjegjësisë për informacionin e paqartë të Dokumenteve të Tenderit, argumentet e sjella nëpërmjet këtij observacioni, merren në konsideratë. Përgjegjësia është e Njësisë së Prokurimit.

2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 765/1 Prot., datë 13.09.2023, i ndryshuar, në Bashkinë Durrës, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, janë përzgjedhur për auditim në bazë të vlerës së kontratës objektet:

Nr.	Objekti	Vlera e kontratës	Kontraktori
1	"Depozitimi i mbetjeve urbane""	279,113,874	"I " BV SPV
2	"FV Ndriçimi rruga Neki Libohova dhe "Marta Durda""	10,306,880	"A.-2A Co" SHPK
3	"FV Ndriçimi rruga "Shoqëria Bashkimi", "Aleks Komeni", "Krisaq Boshnjaku", "Paskal Prodani"	8,679,007	"S. U." SHPK
4	"Riforcim godine banimi 12 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, rruga Neki Libohova" nr.70, kod GIS 5061, 5063"	204,334,356	"E.-A." SHPK & "Ll." ShPK & "Ed K." ShPK
5	"Përforcimi i terrenit nga rrëshqitja e dherave në zonën e ndodhur në lagjen nr. 10, në kodrën pranë Currilave, nga ana veriore dhe perëndimore të saj"	10,320,229	"N." SHPK
6	"Rikonstruksioni rruga Ali Pashë Tepelena, At Gjergj Fishta dhe Migjeni"	9,853,620	"B." SHPK
7	"Rikonstruksioni rruga "Azem Hajdari - Migjeni" NjA Rrashbull	8,719,716	"V. E" ShPK & "S.2F" SHPK
8	Rikonstruksion rruga Currila, segmenti hotel Ferrara-Guest House	27,887,100	"B." SHPK

1. "Depozitimi i mbetjeve urbane", Bashkia Durrës

Kontratat
Objekti i mësipërm është kryer sipas Marrëveshjes Kuadër (ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara) për shërbime me nr. 9853/7 prot., datë 08.10.2021 dhe kontratës me nr. 9853/8 prot., datë 08.10.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Durrës, të përfaqësuar nga Kryetari znj. E.S dhe të OE "I " BV SPV, të përfaqësuar nga administratori znj. A. K. z. Vlera e kontratës është 281,508,800 lekë pa TVSh për 12 muaj. Në kriteret e kontratës citohet që sasitë e kërkuara në kontratë (80000 ton) parashikiojnë të mbulojnë nevojat e Bashkisë Durrës për 12 muaj, por duke qenë se sasitë e parashikuara nuk janë faktike, afati i kontratës do të jetë deri në përfundim të sasive.

Për mbikëqyrjen e këtij shërbimi, sipas urdhrit nr. 22, datë 18.01.2022 është ngritur grupi i punës me përbërje z. F.A. kryetar, K. D. dhe E. K. anëtarë. Në këtë urdhër citohet që *"...mbikëqyrësi e shërbimit do të kryejnë mbikëqyrjen e shërbimit të depozitimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Durrës deri në qendrën e menaxhimit të mbetjeve urbane (Landfill Sharrë) në administrim të I BV SPV, proces që do të dokumentohet me faturat përkatëse për secilin depozitim, ku secila faturë e lëshuar duhet të ketë numrin e referencës së dokumentit përkatës... Mbikëqyrësi i shërbimit ka përgjegjësi ligjore, teknike për përpunimin e të dhenave të të gjitha faturave që lëshohen për çdo depozitim në këtë landfill dhe duhet të hartojë një material që përfshin relacionin teknik mbi shërbimin dhe tabelën mbi totalin e ngarkesave ditore... Raporti teknik duhet të paraqitet zyrtarisht pranë Bashkisë Durrës*.
Në KPK neni 8, pika 8.18.2 "Detyrimet e veçanta të furnizuesit" citohet që Furnizuesi duhet të kryejë të gjitha shërbimet siç specifikohet në Termat e Referencës. Në Aneksin nr. 1 të Kontratës (Specifikimet teknike (Termat e referencës)) është cituar që "*Në këtë shërbim përfshihet procesi i trajtimit të mbetjeve urbane pas depozitimi, që do të realizohet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Plazh, të cilat evadojnë mbetje urbane çdo ditë dhe depozitimi i tyre do të realizohet çdo ditë... Bashkia Durrës bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", kryen vetëm shërbimin e mbledhjes largimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake...*". Sa sipër, në kontratë nuk ka specifikime teknike (terma reference) të detajaura mbi kryerjen e këtij shërbimi.
Ky veprim, krijon hapësira për moskryerjen me cilësi dhe në sasi të këtij shërbimi, duke mbartuar edhe riskun për pagesa të pajustifikuara dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor znj. E.S .
Me Urdhrin nr. 234, datë 10.05.2022 është bërë zëvendësimi i anëtarit të grupit, z. K.D., me z. E.K.

Zbatimi i Kontratës
Në Raportin Përfundimtar të Auditimit (RPA) Bashkia Durrës në vitin 2022, në gjetjen nr. 23 citohet: *Nga auditimi i zbatimit të mbikëqyrjes së kontratës me objekt "Depozitimi i mbetjeve urbane Bashkia Durrës", me fond limit 1,148,864,000 lekë pa TVSh, për muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2021, rezulton se nga Bashkia Durrës nuk kryhet matja e sasisë së mbetjeve që do të depozitohen në landfillin e Sharrës përpara se ato të nisen me mjetet e saj për në landfill.*
Gjithashtu mbikëqyrësit e caktuar për ndjekjen e kësaj kontrate nuk janë fizikisht prezent në momentin që mjetet e Bashkisë Durrës bëjnë depozitimin e mbetjeve në landfill. Autoriteti Kontraktor Bashkia Durrës mjaftohet vetëm me faturat e lëshuara nga ana e koncesionarit përsa i përket sasisë së mbetjeve të depozituara çdo ditë në landfillin e Sharrës. Mungesa e kryerjes së procesit të mbikëqyrjes nga ana e dy punonjësve të caktuar për këtë qëllim, ka sjellë si pasojë që të mos ofrohet siguri mbi sasinë e saktë të mbetjeve që depozitohen çdo ditë në landfillin e Sharrës nga ana e Bashkisë Durrës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1 faqe 106-190 të Raportit Përfundimtar të auditimit)*", grupi i auditimit ka bërë Rekomandimin nr. 23.1,

sipas të cilit "*Kryetari i Bashkisë Durrës, nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procesit të mbikëqyrjes së sasisë së mbetjeve që depozitohen çdo ditë nga Bashkia Durrës në landfillin e Sharrës*".
Nga auditimi i dokumentacionit të sjellë nga mbikëqyrësit e kontratës, nuk gjendet asnjë material ku të jenë marrë masa për përmirësimin e situatës dhe konstatohet se:
- Vazhdon situacionimi i sasive të depozituara të mbetjeve, sipas sasive të ardhuara nga strukturat e Furnizuesit, pa bërë më parë asnjë verifikim të këtyre sasive me një peshore të Blerësit (Bashkia Durrës) dhe verifikim për depozitimin nga ana e mjeteve të Blerësit në Landfillin e Sharrës, si dhe më pas, rakordimin me të dhënat e ardhura nga Furnizuesi. Kjo gjendje, vazhdon të mbartë riskun për shifra fiktive të ardhura nga Furnizuesi, por nga mungesa e kontrollit, edhe nga shifra fiktive nga ana e drejtuesve të mjeteve, të cilëve u është lënë në dorë ky kontroll.
- Nuk janë marrë masa për hartimin e specifikimeve teknike, të cilat janë cituar në kontratë dhe nuk ekzistojnë.
- Nuk ka persona përgjegjës të caktuar nga Investitori, për peshimin e mbetjeve para transportit, apo në Landfillin e Sharrës.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Kontrata;
2. Relacionet teknike mujore
3. dokumentaciioni i mjeteve, etj.

Zbatimi i Kontratës së shërbimit "Depozitimi i mbetjeve urbane", Bashkia Durrës				
14.Lidhja e kontratës Nr. 9853/8 prot., datë 08.10.2021	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 337,810,560 lekë **OE fitues "I " BV SPV**			
17- Situacioni Përfundimtar **Vlera me tvsh 279,113,874 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 365 ditë			
20. **Mbikëqyrësi i shërbimit** F.A., Kryetar K.D. E.K.	Licenca Nr:	Urdhër me nr. 22 prot., datë 18.01.2022		

Në takimin e ballafaqimit të mbajtur në zyrat e KLSH-së në datën 25.03.2014, nga z. F. A., në cilësinë e kryetarit të grupit të punës për mbikëqyrjen e kësaj kontrate, u kundërshtua gjetja dhe rekomandimi i bërë nga grupi i auditimit në Projektraportin e auditimit, në lidhje me zbatimin e kontratës "Depozitimi i mbetjeve urbane", si më poshtë:
- Nuk është grupi mbikëqyrës që sugjeron plotësimin e kontratës me specifikimet teknike;
- Grupi i punës, punën e vetë e ka të bazuar në Urdhrin e dalë nga Bashkia për mbikëqyrjen e kontratës, ku janë të specifikuara detyrat e grupit. Po të ishin shprehur në urdhër monitorimi i peshave në landfill, ne nuk do ta kishim pranuar, pasi kemi edhe punët në pozicionet që mbajmë në ndërmarrjet përkatëse.
- Sugjerimet tona pranë bashkisë, janë bërë verbalisht, për monitorimin e peshave në landfill nga punonjës të tjerë, ose ngritjen e një peshoreje nga Bashkia;
- Nuk ka dëm ekonomik, pasi nuk duhet marrë pesha bosh sipas lejes së qarkullimit, por pesha bosh e çdo mjeti pas shkarkimit të ngarkesës;
- Ne ju vemë përballë peshat bosh të automjeteve, të bëra në peshore të kolauduar dhe me licencën përkatëse, të cilat dalin të njëjta me mjetet që depozitojnë sot në landfillin e Sharrës;

- Pesha e mjetit sipas lejes së qarkullimit, është ajo e mjetit të sapo dalë nga fabrika dhe me kalimin e kohës, si pasojë e amortizimit, pesha e mjetit bosh, ndryshon;
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia: E ulët
Rekomandime: Nga Bashkia Durrës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **170,200** lekë pa tvsh nga BOE "B,." SHPK & "J." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4616 prot., datë 23.10.2018 me objekt "Rikonstruksion rruga Currila, segmenti hotel Ferrara-Guest House", Bashkia Durrës, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 170,200 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. A. Q., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. M. K., me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për këtë objekt, nuk është paraqitur asnjë observacion.

2.5 Mbi organizimin, funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit
Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me Nr. 765/1 Prot, datë 13.09.2023, me objekt: "**Auditim mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar**, *prej datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022,* u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- *Dokumentacioni në sistemin "E leje";*
- *Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;*
- *Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë e financës;*
- *Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë juridike;*
- *Dokumente të tjera nga arkiva, etj*

Bashkia Durrës ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor me Vendimin e KKT-së Nr.4, datë 27.07.2022. Zbardhja e këtij vendimi është realizuar në muajin shkurt të vitit 2023. Gjatë periudhës së auditimit, lejet e miratuara që janë brenda kufirit të Planit, janë miratuar në bazë të Planit të Përgjithshëm ekzistues dhe VKM-së 502. Ndërsa lejet e miratuara jashtë kufirit të

Planit janë bazuar në VKM-në 408, datë 13.05.2015, për "Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar dhe ligjit 107/ 2014, datë 31.07.2014,për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit.", i ndryshuar.

Auditimi konsiston në këto fusha:
1.Dhënia e Lejes së Zhvillimit,krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit,dokumentacioni,krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukture.
4.Dhënia e Certifikatës së Përdorimit.
5.Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik.

- **Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për vitin 2022**

Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Durrës, gjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 janë miratuar **146 leje zhvillimi**, **33 leje** ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2, **72 leje ndërtimi** me sipërfaqe deri në 250 m^2,**1 leje ndërtimi** për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2, **6 leje ndërtimi** për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2, **192 leje rindertimi**, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni, **42 çertifikata përdorimi**, **241 deklarata paraprake** për kryerje punimesh dhe **6 leje infrastrukture**, të paraqitura në Aneksin L1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Durrës, leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2, të paraqitura në Aneksin L2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar rastet e lejeve së ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2 , të paraqitur në Aneksin L3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **1 praktikë** tek të cilat pasqyrohej situata në lidhje me mosrespektimin e kritereve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes 1: Mosrespektimi i kritereve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor
Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se nuk respektohen të gjitha kriteret e përcaktura në Planin e Përgjithshëm Vendor. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:
1."*Strukturë industriale 2 dhe 3 kate dhe 1 kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 2884, datë 14/02/2022, me zhvillues "P. B. " ShPK, në adresën Rruga " Athina ", Durrës. Duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 27, datë 10.05.2013 "Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës" të njësisë 1.2, kategoria e lejuar e përdorimit të tokës është aktivitete industriale dhe dyqane me shumicë e pakicë. Ndërsa përdorime të ndaluara janë funksionet rezidenciale, magazina, bar dhe restorante. Në rregulloren e planifikimit të parcelës së njësisë 1.2, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, përcaktohen parametrat e përgjithshëm të zonës, në të cilën përcaktohet që volumi total mbi sipërfaqen e plotit, nuk duhet të tejkalojë volumin 4 m3/ m2.

Nga verifikimi i volumeve që zhvillohen mbi tokë, volumet tejkalon kriteret e përcaktura në rregulloren e njësisë në 4.43 m3/ m2, sipas llogaritjes së mëposhtme:
82.5m x 31m x12.8 m (lartësia e objektit)=32.736 m^3
677 m^2 objekti ekzistues x 4 m (lartësia e objektit) = 2708 m^3
Shuma totale = 35.444 m^3
Sipërfaqja totale e parcelës = 8000 m^2
Raporti i volumit total mbi sipërfaqen e parcelës = 4.43 m3/ m^2
Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr.8, datë 20.11.2023
Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:
-Ligji Nr.107/2014, datë 31.07.2014, "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, Neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor
-Planin i Përgjithshëm Vendor i miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 27, datë 10.05.2013 "Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës".
- VKM Nr. 502, datë 13.07.2011, "*Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, Neni 39, Treguesit e planifikimit dhe të zhvillimit që garantohen në çdo nënnjësi strukturore apo zonë për prioritet zhvillimi.
Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i kushteve të përcaktuara sipas Planit të Përgjithshëm Vendor ndikon në shtimin e sipërfaqeve e volumeve të ndërtimit për njësinë përkatëse, duke cënuar edhe zhvillimin e ndërtimeve të reja.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Durrës
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Nga DPKZHT Durrës të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje me të gjitha kriteret dhe kondicionet përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.
Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. R. D.i, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 30/03/2022; Znj.J. M., me detyrë SPECIALISTE në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021;Znj.K. A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009;Znj.A. H.,me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nga periudha 09/06/2021.
Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **2 praktika** tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospërputhshmërinë ndërmjet planvendosjes së miratuar në lejen e ndërtimit e projektit të ndërtimit të ngarkuar në sistemin e-Leje dhe mospërputhja ndërmjet projektit kontrukstiv dhe atij arkitektonik.

Titulli i gjetjes 2: Mospërputhja ndërmjet planvendosjes së miratuar në lejen e ndërtimit e projektit të ndërtimit të ngarkuar në sistemin e-Leje dhe mospërputhja ndërmjet projektit kontrukstiv dhe atij arkitektonik.
Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se plani i vendosjes së strukturës të miratuar për leje ndërtimi nuk përputhet plotësisht me projektin e ndërtimit, pasi në të nuk pasqyrohen daljet dhe faqet konsol të objektit. Mospasqyrimi i saktë i konturit të njollës së ndërtimit, ndikon në parametrat e lejuar sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi, të tilla si sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit, intensiteti, distanca nga kufiri i pronës/ nga objektet/ nga trupi i rrugës. Gjithashtu u konstatua që projekti konstruktiv nuk përputhet me projektin arkitektonik. Gjetjet e konstatuara u evidentuan në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:
1.*"Godinë shërbimi dhe banimi 6 kat+1 kat nën tokë dhe banesë 2 kat +1 kat nën tokë",* miratuar me vendimin Nr. 104, datë 29.04.2022, me zhvillues "A. K. 2019" ShPK, në adresën Lagjja 17, Rruga

"Doktor Remzi", Durrës. Plani i vendosjes së strukturës të miratuar për leje ndërtimi nuk përputhet me projektin e ndërtimit, pasi në të nuk janë pasqyruar daljet konsol (ballkonet) të objektit, në bazë të VKM-së 502, datë 13.07.2011, neni 40:
- *Neni 40, pika 4*, përcakton që distancat minimale maten gjithmonë midis faqeve që përballin njëra-tjetrën në dy struktura që përballin njëra-tjetrën. Nëse dy faqet që përballin njëra-tjetrën kanë në përbërje të tyre plane të ndryshme, qoftë edhe konsol, distanca minimale është ajo e përcaktuar për dy planet, një nga çdo strukturë, që ndodhen më afër njëri-tjetrit, dhe e matur nga pikat që ndodhen më afër njëra-tjetrës në secilin nga planet.

2. "*Kompleks Vila Banimi 2 kat + 1 kat nëntokë, "B. R. D. H.*", miratuar me vendimin Nr. 2737, datë 18/01/2022, me zhvillues shoqëria "B. C." ShPK, në adresën rruga "Kont Urani", Lagja 1, Durrës. Objekti zhvillohet në njësisë A.1.1, brenda kufirit të zonës arkeologjike B. Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin nr.23, datë 14.10.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit, për objektin "B. R. D. H.", me vendodhje në Bashkinë Durrës. Projekti konstruktiv i ngarkuar në projektin e ndryshuar në sistemin e-leje, nuk përkon me projektin për të cilin aplikohet leja e ndërtimit, në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 15, pika 1/1, ii) projektin konstruktiv;
Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr.8, datë 20.11.2023

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:
-VKM Nr. 502, datë 13.07.2011, "*Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit*" neni 40, pika 4.
-VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 15, pika c dhe pika 1/1, ii

Ndikimi/Efekti: Mospasqyrimi i saktë i planvendosjes ndikon në mosrespektimin e kritereve të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit të territorit, respektimin e distancave nga kufiri i pronës, distanca nga objekti në objekt dhe nga trupi i rrugës.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Durrës.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Nga DPKZHT Durrës të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit pa shqyrtuar me vëmendje përputhshmërinë ndërmjet planit të vendosjes së strukturave e projekti të ndërtimit dhe përputhshëmrinë e projektit arkitektonik me atë konstruktiv.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z.R. D., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 30/03/2022; Znj.J. M., me detyrë specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021;Znj.K. A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009;
Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. E. L., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 21.07.2021-29/03/2022 Znj.Klarita Agasi, me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Znj.A. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nga periudha 09/06/2021.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **2 praktika** tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospasqyrimin e të gjitha distancave nga kufiri i pronës dhe nga trupi i rrugës në planvendosje dhe mosrespektimi i të gjitha distancave nga kufiri i pronës.

Titulli i gjetjes 3: Mospasqyrimi i të gjitha distancave nga kufiri i pronës dhe nga trupi i rrugës në planvendosje dhe mosrespektimi i të gjitha distancave nga kufiri i pronës.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se nuk janë pasqyruar të gjitha distancat nga trupi i rrugës dhe nga kufiri i pronës dhe mosrespektimi i të gjitha distancave nga kufiri i pronës dhe distanca ndërmjet objekteve. Gjetjet e konstatuara u evidentuan në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

1.*"Godinë shërbimi dhe banimi 6 kat+1 kat nën tokë dhe banesë 2 kat +1 kat nën tokë",* miratuar me vendimin Nr. 104, datë 29.04.2022, me zhvillues "Arela Konstruksion 2019" ShPK, në adresën Lagjja 17, Rruga "Doktor Remzi", Durrës. Distancat e objektit nga kufiri i pronës dhe nga trupi i rrugës nuk janë pasqyruar duke përfshirë edhe daljet konsol.

- në orjentimin jugor nuk pasqyrohet distanca nga kufiri i pronës, duke përfshirë edhe daljen konsol prej 1.75 metrash.

-në orjentimin perëndimor nuk pasqyrohet distanca në të gjitha skajet e godinës

-në orjentimin lindor distanca nga 6.8 metra e pasqyruar në planvendosje, nuk respekton distancën minimale të lejuar, duke përfshirë edhe daljen konsol 1,6 metra, mbetet 5.2 metra.

Objekti në orjentimin perëndimor kufizohet nga infrastruktura rrugore, me një gjerësi rruge më të vogël se 7 metra. Në bazë të VKM-së 502, neni 40, pika 14/ a, për gjerësi rruge, me ose pa trotuare, më të vogël se 7 (shtatë) metra, distanca minimale është 2.5 (dy pikë pesë) metra. Në bazë të VKM-së 502, neni 40, pika 13, përcaktohet se për strukturat gjatë rrugëve çdo dalje konsol, vlerësohet si faqe ndërtimi dhe duhet të respektojë normat minimale për distancën e strukturave nga kufiri i trupit të rrugës. Në orjentimin perëndimor, nuk është pasqyruar distanca nga trupi i rrugës në të gjitha skajet e objektit, në të cilën duhet të përfshihen edhe dalja konsol prej 1.3 metrash.

2. "*Struktura akomoduese turistike 2 dhe 3 kat dhe rrethim i pronës*", miratuar me vendimin Nr. 925-22/6, datë 21/12/2022, me zhvillues "Ch. G." ShPK, në adresën Hamallë, Njësia administrative Manëz, Durrës. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në neni 35, në pikën 1, nuk është respektuar distanca minimale nga kufiri i pronës prej 4 metrash, për objektin në lartësinë e 3 kateve të ndërtimit. Distanca e pasqyruar në planvendosje është 3.1 metër.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr.8, datë 20.11.2023

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-VKM Nr. 502, datë 13.07.2011,"Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit", neni 40, treguesit e distancave.

-VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, neni 35, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i distancës nga kufiri i pronës cënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cënon zhvillimin e ndërtimve të reja në parcelat kufitare, në orjentimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Durrës

Rëndësia: E mesme.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z.R. D., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 30/03/2022; Znj.J. M., me detyrë SPECIALISTE në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021;Znj.K. A.i, me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009;

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z.R. D., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 30/03/2022; Znj.K. A.i, me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Znj.A. H., me detyrë

specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021.
Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **2 praktika** në të cilën pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me mospërcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe në lejen e ndërtimit të miratuar, në përputhje me rregullloren dhe legjislacionin në fuqi.

Titulli i gjetjes 4: Mospërcaktimi i saktë i numri të kateve në planvendosje dhe në lejen e ndërtimit të miratuar, në përputhje me rregullloren dhe legjislacionin në fuqi.
Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në planvendosje dhe në lejen e ndërtimit të miratuar, nuk pasqyrohej saktë numri i kateve dhe lartësia e objektit sipas projektit të ndërtimit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:
1."*Shtëpi banimi 2 kat + podrum + papafingo dhe mur rrethues*", miratuar me vendimin Nr. 2859, datë 08/02/2022, me zhvillues Vladmir dhe Natasha Paço, në adresën rruga "Idriz Xhafi", Shkallnur, Durrës.Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 9, në pikën 1, përcaktohet se dokumenti i lejes së zhvillimit i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit për ndërtime të reja. Leja e zhvillimit është miratuar për zhvillimin e një objekti në lartësinë e dy kateve me një kat nëntokë, ndërsa leja e ndërtimit është miratuar për një objekt në lartësinë e dy kateve, plus papafingo, me një kat nëntokë. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit, objekti është në lartësinë e 4 kateve mbi tokë, në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në Nenin 37, në pikën c, përcaktohet se lartësia e ndërtimeve e shprehur në metra matet sipas rastit: "Në rastin e ndërtesave të vendosura në terrene me pjerrësi, lartësia në metra jepet në mënyrë të posaçme për të dyja faqet e strukturës në secilën anë të terrenit të pjerrët dhe në përputhje me shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike."
a) Nga kuota mesatare e sistemimit të trotuarit rrethues të ndërtimit, deri në pikën më të lartë të fundit të parapetit rrethues të mbulesës së sheshtë të objektit;
b) Nga kuota mesatare e sistemimit të trotuarit rrethues të objektit në terren të sheshtë, deri në kulmin e mbulesës nga jashtë, për mbulesa të pjerrëta; Më poshtë pasqyrohen fragmente nga projekti i ndërtimit, prerje dhe pamje 3D, në të cilën pasqyrohet lartësia e objektit.
2."*Struktura akomoduese dhe shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore*", miratuar me vendimin Nr.3009, datë 10/03/2022, me zhvillues R. S. dhe V. S., në adresën Lalëz, njësia administrative Ishëm, Durrës. Në bazë të vendimit Nr.12, datë 27.02.2019, "*Për miratimin e lejes së zhvillimit / ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban, bujqësor dhe natyror*", në pikën 4, përcaktohet që strukturat agroturistike nuk duhet të kalojnë lartësinë e 2 kateve me nënçati. Në projektin e ndryshuar gjatë ndërtimit, objekti i shërbimit në bazë të VKM-së 408, neni 37, pika 1, lartësia e ndërtimit mbi tokë është në lartësinë e një objekti 3 kate, duke tejkaluar përcaktimin e kuadrit ligjor në fuqi. Në projektin teknik pasqyrohet lartësia e objektit që është 12.55 metra.
Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:
-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, Neni 37, Lartësia e ndërtimeve.
- Në bazë të vendimit Nr.12, datë 27.02.2019, "*Për miratimin e lejes së zhvillimit / ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban, bujqësor dhe natyror*", në pikën 4.
Ndikimi/Efekti: Mosparaqitja e saktë e numrit të kateve në planvendosje dhe në lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në elementët e mëposhtëm:
-lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re;
-respektimin dhe normat e lejuara të distancave;
-vlerat mjedisore dhe ekologjike në zonë;

-diellëzimin dhe orientimin;
-respektimin e normave mjedisore;
Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Durrës
Rëndësia: E lartë

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E. S., Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. E. ., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 21.07.2021-29/03/2022 Znj.K. A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Z.V.S., me detyrë me detyrë specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve ,nga periudha 09/06/2021-22/12/2021.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E. S., Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. E. L., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 21.07.2021-29/03/2022 Znj.K. A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Znj.A. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021; Z. D. M., me detyrë kryeinspektor nga periudha 21/04/2021; Z. S. M., me detyrë inspektor nga periudha 17/06/2019.
Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua **4 praktika** tek e cila pasqyrohej e njëjta situata në lidhje me mungesën e paraqitjes së dokumentacionit të plotë të pronësisë, përpara miratimi të lejes të ndërtimit.

Titulli i gjetjes 5: Mosparaqitja e dokumentacionit të plotë të pronësisë përpara miratimit të lejes së ndërtimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje nuk paraqitet dokumentacioni i plotë i pronësisë, në bazë të legjislacionit në fuqi. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtme të miratuar me objekt:
1."*Struktura akomoduese turistike 2 dhe 3 kat dhe rrethim i pronës*", miratuar me vendimin Nr. 925-22/6, datë 21/12/2022, me zhvillues "Ch. G." ShPK, në adresën Hamallë, Njësia administrative Manëz, Durrës. Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, nuk pasqyrohet kartela e pasurisë, në bazë të Ligjit 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "*Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar*."
2."*Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat*", miratuar me vendimin Nr. 2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B. M., në Lalz, Durrës. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 15, në pikën 1, gërma b, përcaktohet se në dokumentacionet që duhen për tu pajisur me leje ndërtimi janë dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta; Në dokumentacionin që vërteton pronësinë të ngarkuar në sistemin e-leje, evidentohet që parcela me numër pasurie 192/5, në zonën kadastrale 2375, me sipërfaqe 1162, të llojit të pasursisë arë, në pronësi të B. R. M., në pikën D të kartelës së pasurisë së paluajtshme ka kufizim të pronësisë, në të cilën përcaktohet se:"Pezullohen veprimet me urdhër regjistruesi nr.2815, datë 04.05.2012." Në rastin e trajtuar mësipër, në dokumentacionet që janë ngarkuar në sistem vërtetohet që *pasuria në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, ka kufizime të pronësisë.*

3."*Struktura akomoduese dhe shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore*", miratuar me vendimin Nr.3009, datë 10/03/2022, me zhvillues R. S. dhe V. S., në adresën Lalëz, njësia administrative Ishëm, Durrës.Në aplikimin për ndryshim projekti, të dhënat e sipërfaqes në dokumentacionin e pronësisë janë ndryshuar në miratimin e lejes së ndërtimit. Sipërfaqja e pasurisë me numër pasurie 161/6, në zonën kadastrale 2375 nga 6000 m2 është reduktuar në sipërfaqen 4800 m2 të pasurie me numër 161/25, në zonën kadastrale 2375. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në nenin 9, në pikën 5, përcaktohet se në rast ndryshimi të kufijve të pronës/ave, për të cilën/at është miratuar leja e zhvillimit, zhvilluesi duhet të aplikojë për leje të re zhvillimi.
4."*Shtëpi banimi 2 kat + podrum + papafingo dhe mur rrethues*", miratuar me vendimin Nr. 2859, datë 08/02/2022, me zhvillues V. dhe N. P., në adresën rruga "Idriz Xhafi", Shkallnur, Durrës. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 15, në pikën 1, gërma b, përcaktohet se në dokumentacionet që duhen për tu pajisur me leje ndërtimi janë dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta; Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, nuk pasqyrohet kartela e pasurisë, në bazë të Ligjit 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "*Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar*."
Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr.8, datë 20.11.2023
Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:
-Ligjit 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4
-VKM 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në nenin 15, në pikën 1, gërma b
Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i kritereve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, ndikon në mosmarrjen e sigurisë së lartë në lidhje me shmangien e mundësisë së tjetërsimit të pronave.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Durrës.
Rëndësia: E lartë.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z.R. D., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 30/03/2022; Znj.K. A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Znj.A. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021.
Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.2 dhe nr.3, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. E. L., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 21.07.2021-29/03/2022 Znj.K. A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Znj.A. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021;

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.4, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.Emirian Sako, Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. Ermal Lama, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 21.07.2021-29/03/2022 Znj.Klarita Agasi, me detyrë specialiste në Sektorin e

Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Z.V. S., me detyrë me detyrë specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve ,nga periudha 09/06/2021-22/12/2021.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan ***1 praktikë*** tek të cilat pasqyrohej situata në lidhje me miratimin e lejes së ndërtimit për një funksion të ndryshëm përdorimi nga ai i lejuar në njësinë strukturore.

Titulli i gjetjes 6: Miratimi i lejes së ndërtimit për një funksion të ndryshëm përdorimi nga ai i lejuar në njësinë strukturore përkatëse, në bazë të legjislacionit në fuqi.
Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se, në lejet e ndërtimit të miratuara për zhvillimin e objekteve në përputhje përdorimet e lejuara në zonë, në projektin e ndërtimit dhe relacionin teknik janë propozuar edhe funksione të tjera, që nuk janë në përputhje me përdorimet e lejuara në njësiën struktukturore përkatëse. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:
1."*Godinë industriale 1 dhe 2 kat + vendroje + kabinë elektrike dhe mur rrethues*", miratuar me vendimin Nr. 2775, datë 28/01/2022, me zhvillues "M.O." ShPK, në adresën rruga "Vath Turja", Spitallë, Durrës. Duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 27, datë 10.05.2013 "Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës" të njësisë 1.1, kategoria e lejuar e përdorimit të tokës është aktivitete logjistike dhe industriale (me efekt të mesëm e të lartë), zyra dhe kapanone (me funksion prodhimi). Ndërsa përdorime të ndaluara janë funksionet rezidenciale, magazinimi, bar/restorante dhe mikronismarrje. Në relacionin teknik nuk përshkruhet funksioni i objektit. Në projektin arkitektonik evidentohet që godina në lartësinë e dy kateve ka funksion për zyra/ administratë dhe shoëroom. Gjithashtu edhe në verifikimin në QKB, objekti i aktivitetit të subjektit është import-eksport dhe tregtim i artikujve elektroshtëpiake, pajisje industriale ,dhe mallra te konsumit të gjerë të lejueshëm ,riparim, montim pajisje elektroshtëpiake dhe tregti me shumice dhe pakice te produkteve ushqimore, funksion që nuk është i lejuar në bazë të përcaktimeve të njësisë 1.1.
Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr.8, datë 20.11.2023
Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:
-Ligji Nr.107/2014, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor
-Planin i Përgjithshëm Vendor i miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 27, datë 10.05.2013 "Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës".
Ndikimi/Efekti: Mungesa e verifikimit të projektit të ndërtimit dhe funksionit të propozuar, ndikon në lejimin e ndërtimit me funksione të ndryshme nga ajo e lejuar, në mospërputhje me njësinë në të cilën zhvillohet dhe kriteret të cilat lejohen në njësinë përkatëse.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Durrës.
Rëndësia: E lartë.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1 dhe nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. E. L., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 21.07.2021-29/03/2022 Znj.Klarita Agasi, me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Z. E.V., me detyrë specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nga periudha 09/06/2021-22/12/2021.
Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua **1 praktikë** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me miratimin e ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit duke tejkaluar masën 2% të sipërfaqes ndërtimore.

Titulli i gjetjes 7: Miratimi i lejes për ndryshim projekti gjatë ndërtimit, duke tejkaluar masën 2% të sipërfaqes ndërtimore.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se projekti i propozuar për ndryshim projekti gjatë ndërtimit, në ndryshim nga projekti i miratuar në lejen e ndërtimit sipërfaqja ndërtimore tejkalon masën 2% të lejuar. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtme të miratuar me objekt:

1."*Struktura akomoduese dhe shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore*", miratuar me vendimin Nr.3009, datë 10/03/2022, me zhvillues R.S. dhe V. S., në adresën Lalëz, njësia administrative Ishëm, Durrës.

Leja e ndërtimit është miratuar duke u bazuar në lejen e zhvillimit me objekt "Struktura akomoduese dhe shërbimi për promovimin, përpunimin tregtimin e produkteve bujqësore", të miratuar me vendimin Nr. 2170, datë 10.08.2021. Në bazë të shkresës së Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, mbi kontrollin e konformitetit për pajisjen me leje zhvillimi parcela e propozuar për zhvillim bën pjesë në rastet përjashtimore sipas pikës 2, gërma dh), të Vendimit Nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore". Gjithashtu në zbatim të Vendimit Nr.5, datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban", parcela e propozuar për zhvillim nuk ndodhet brenda zonës së shpallur të urbanizuar. Leja e ndërtimit është miratuar në bazë të kushteve të zhvillimit të mëposhtme:

- Sipërfaqja e pasurisë 1 (m2): 6000
- Sipërfaqja e pasurisë 2 (m2): 7000
- Sipërfaqja e pasurisë 3 (m2): 10364
- Sipërfaqja totale e pasurive në studim (m2): 23364
- Sipërfaqja totale për mbjellje (m2): 13000
- Kufiri i sheshit të ndërtimit (m2): 10364
- Sipërfaqja e ndërtimit për 14 objektet 2 kat dhe objektin 1 kat (m2): 798 + 456 = 1254
- Sipërfaqja e ndërtimit totale për 14 objektet 2 kat dhe objektin 1 kat (m2):1705 + 456 = 2161.2
- Koeficienti i shfrytëzimit të truallit: 12 %
- Intensiteti i ndërtimit: 0.2
- Numri i kateve mbi tokë: 1 dhe 2 kat
- Numri i kateve nën tokë: 0 kat
- Vëllimi i 14 objekteve 2 kat dhe objektit 1 kat (m3): 5371.4 + 3328.8 = 8699.8
- Lartësia maksimale e strukturës (m): 7.30 – 8.30

Në verifikimin e projektit të ndërtimit u konstatua që të dhënat e sipërfaqeve të pasqyruara në lejen e ndërtimit, nuk përputhen me sipërfaqen sipas projektit. Në projektin e ndërtimit të pasqyruar për ndryshim projekti, kushtet e zhvillimit të objekteve janë si më poshtë:

Sipërfaqja e ndërtimit për 13 objektet është 150 m2 (sipërfaqe ndërtimi e vilës tip) x13 objekte = 1950 m2

Sipërfaqja e ndërtimit për një nga vilat e ndryshuar nga vila tip është 172 m2

Sipërfaqja e objektit të shërbimit është 998 m²

Sipërfaqja e objektit në hyrje është 20 m2

Sipërfaqja totale e ndërtimit është 3140 m2

Sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është 2684 m2

-Numri i kateve mbi tokë: 1 dhe 2 kat

-Numri i kateve mbi tokë në bazë të lartësisë 12.55 metra = 3 kate

-Numri i kateve nën tokë: 1 kat 456 m2

- Lartësia maksimale e strukturës (m): 12.55 metra

Në bazë të të dhënave të treguesve të zhvillimit të paraqitura në lejen e ndërtimit dhe të dhënave të verifikuara në projektin e ndryshuar, sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është 2684 m2, nga 2161.2 m2 të pasqyruar në të dhënat e treguesve të zhvillimit në lejen e ndërtimit, duke shtuar një sipërfaqe ndërtimi 522.8 m2, sipërfaqe që tejkalon 2 % e ndryshimit të projektit në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në nenin 17, në pikën 1, gërma e, përcaktohet që ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit mund të realizohet në ndryshime të cilat konsistojnë në shtimin apo zvogëlimin e sipërfaqes ndërtimore të objektit, mbi tokë apo/dhe nën tokë, me kusht që për lejet e miratuara nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit, në rastet e rritjes së sipërfaqes ndërtimore mbi tokë, shtesa të mos tejkalojë masën 2% në projektin e miratuar; Zhvilluesi duhet të aplikonte për leje ndërtimi për shtesë të sipërfaqes së ndërtimit dhe jo për ndryshim projekti gjatë ndërtimit. Në bazë të vendimit Nr.12, datë 27.02.2019, "Për miratimin e lejes së zhvillimit / ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban, bujqësor dhe natyror", në pikën 4 përcaktohet që strukturat agroturistike nuk duhet të kalojnë lartësinë e 2 kateve me nënçati. Në projektin e ndryshuar gjatë ndërtimit, objekti i shërbimit në bazë të VKM-së 408, neni 37, pika 1, lartësia e ndërtimit mbi tokë është në lartësinë e një objekti 3 kate, në lartësinë 12.55 metra, duke tejkaluar përcaktimin e kuadrit ligjor në fuqi.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr.8, datë 20.11.2023

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 17, pika e.

-Vendimi Nr.12, datë 27.02.2019, "*Për miratimin e lejes së zhvillimit/ ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban, bujqësor dhe natyror*", në pikën 4.

Ndikimi/Efekti: Miratimi i ndryshimit të projektit gjatë ndërtimit duke tejkaluar sipërfaqen ndërtimore kërkon aplikimin për një leje të re ndërtimi, pasi ndikojnë në ndryshimin e kondicioneve urbane që janë miratuar në lejen e zhvillimit dhe lejen e ndërtimit. Realizimi i ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin e ndërtimeve në mospërputhje me parametrat dhe kriteret e zhvillimit urban, të tilla si distanca nga kufiri i pronës, distanca ndërmjet objekteve, në orjentimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Durrës

Rëndësia: E lartë

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. E. L., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 21.07.2021-29/03/2022 Znj.K. A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Znj.A. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021; Z. Dorjan Mema, me detyrë kryeinspektor nga periudha 21/04/2021; Z. S. M., me detyrë inspektor nga periudha 17/06/2019.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **2 praktika** tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitja në sistemin e-Leje të dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e çertifikatës së përdorimit.

Titulli i gjetjes 8: Mosparaqitja në sistemin e-Leje e dokumentacionit të nevojshëm për

miratimin e çertifikatës së përdorimit.
Situata: Nga auditimi i çertifikatave të përdorimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e çertifikatës së përdorimit. Në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë përdorimi është projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti "as build" (i zbatuar); Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet vetëm projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, por nuk paraqitet projekti "as build" i zbatuar. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratur për certifikatë përdorimi, me objekt:
1."*Godinë Banimi dhe Shërbimi 2-4 dhe 6 Kate me 1 Kat Nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 3004, datë 10/03/2022, me zhvillues "Kristi Konstruksion 2003", në adresën lagjia 6, Rruga "Aleksander Goga ", Durrës. Në shqyrtimin e dokumentacionin të ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet vetëm projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, por nuk paraqitet projekti "as build" i zbatuar.
-Në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë janë edhe aktet përkatëse, të lëshuara nga shoqëria"Ujësjellës-Kanalizime" sh.a.,Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të cilat nuk pasqyrohen në dokumetacionin e ngarkuar në sistemin e-leje.
-Gjithashtu aplikuesi duhet të paraqesë fotografi të objektit në të gjitha orientimet.Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje nuk paraqiten fotografi të objektit të realizuar
2. "*Rikonstruksion dhe ndryshim funksioni të godinës banimi dhe shërbimi 6 kat mbi tokë dhe një kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr.2763, datë 26/01/2022, me zhvillues Shoqeria IL-FA, në adresën lagjia 14, Shkozet, Durrës.Në dokumentacionin që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë është projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti "as build" (i zbatuar); Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet vetëm projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, por nuk paraqitet projekti "as build" i zbatuar. Gjithashtu në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë janë fotografi të objektit në të gjitha orientimet. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqiten fotografi në të gjitha orjentimet, të cilat janë të fragmentura dhe nuk evidentohen të gjtha ndërhyrjet në godinë.
Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:
-VKM 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin Neni 27/2, në pikën 1.
- Ligji 107/2014, datë 31.7.2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, Neni 42.
Ndikimi/Efekti: Mospasqyrimi i dokumentacionit të plotë për pajisjen me çertifikatë përdorimi ndikon në miratimin e saj jo në konformitet me të gjitha kriteret që duhet të plotësojë, duke ndikuar në realizimin e projektit të ndërtimit në terren jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Durrës.
Rëndësia: E lartë

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. E. L., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 21.07.2021-29/03/2022 Znj.K. A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Z.V.S., me detyrë me detyrë specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve ,nga periudha 09/06/2021-22/12/2021;
Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. E. L., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha

21.07.2021-29/03/2022 Znj.K.A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Z.E. V.i, me detyrë specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve, nga periudha 09/06/2021-22/12/2021; Znj.A. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021;

Gjatë auditimit të procedurave së miratimit të "Certifikatave të përdorimit" u konstatuan ***2 praktika*** në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në të cilat zbatimi i punimeve në terren nuk përputhej me lejet e ndërtimit të miratuara.

Titulli i Gjetjes 9: Miratimi i certifikatës së përdorimit jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar dhe zbatimin e punimeve në terren.
Situata: Nga auditimi i procedurave së miratimit të "Certifikatave të përdorimit" u konstatua se leja e ndërtimit e miratuar nuk përputhej me zbatimin në terren të objektit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara me objekt:
1."*Godinë Banimi dhe Shërbimi 2-4 dhe 6 Kate me 1 kat Nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 3004, datë 10/03/2022, me zhvillues "K. K. 2003", në adresën lagjia 6, Rruga "Aleksander Goga ", Durrës. Nga verifikimi në terren i objektit dhe nga foto ajrore, u konstatua që gjurma e ndërtimit nuk përputhet me planvendosjen e miratuar, duke tejkaluar kufirin e pronës. Gjithashtu në objekt janë shtuar volume anësore të cilat nuk përkojnë me projektin e ndërtimit.
2."*Rikonstruksion dhe ndryshim funksioni të godinës banimi dhe shërbimi 6 kat mbi tokë dhe një kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr.2763, datë 26/01/2022, me zhvillues Shoqeria I.-F., në adresën lagjia 14, Shkozet, Durrës. Nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve të ndërtimit, u konstatuan ndryshime në realizimin e punimeve të ndërtimit nga projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, pasi është shtuar sipërfaqe ndërtimi në katin e fundit në katin e fundit, me kontruksion metalik.
Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr.8, datë 20.11.2023
Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:
-Ligji 107/2014, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Neni 42, në pikën 3
-VKM-në 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 27/1, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, nevojitet plotësimi me dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me certifikatë përdorimi,
-Ligji Nr.9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.
Ndikimi/Efekti: Zbatimi i realizmit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar, ndryshimi/shtimi i volumeve të ndërtimit, të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Durrës
Rëndësia:E lartë

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. E. L., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 21.07.2021-29/03/2022 Znj.K. A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Z.V. S., me detyrë me detyrë specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve ,nga periudha

09/06/2021-22/12/2021; Z.D. M., me detyrë kryeinspektor i IMT-së, nga periudha 21/04/2021; Z.G.H., me detyrë inspektor i IMT-së, nga periudha 27/12/2017.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. E. L., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 21.07.2021-29/03/2022 Znj.K.A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Z.E. V., me detyrë specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve, nga periudha 09/06/2021-22/12/2021; Znj.A. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021; Z.D. M., me detyrë kryeinspektor i IMT-së, nga periudha 21/04/2021; Z.A. H., me detyrë inspektor i IMT-së, nga periudha 10/5/2021

Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimeve dhe zhvillimit të territorit, u konstatua **1 praktikë** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me zhvillimin e ndërtimit pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh.

Titulli i Gjetjes 10: Zhvillimi i ndërtimeve pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh.
Situata: Në bazë të verifikimeve për realizimin në terren të zhvillimit të territorit, u evidentuan disa struktura të cilat janë ndërtuar pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh, të pasqyruara si më mëposhtë:
Gjatë vitit 2022, në rrugën Vath Turja, Durrës, janë evidentuar ndërtimi i disa strukturave në funksion shërbimi, të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi ose deklaratë paraprake punimesh.
Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr.8, datë 20.11.2023
Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:
-Ligji Nr. 107/2014, për "*Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, neni 51, Inspektimi.
-Ligji Nr.9780, datë 16.7.2007," *Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", i ndryshuar, neni 5, detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës; neni 12, ushtrimi i kontrollit.
Ndikimi/Efekti: Ndërtimi i objekteve pa u pajisur me leje ndërtimi, ndikon në mosrespektimin e kondicioneve urbane, në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e IVMT Durrës
Rëndësia: E lartë

Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për kontrollin në terren të zhvillimit të territorit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. D. M., me detyrë kryeinspektor i IMT-së, nga periudha 21/04/2021;Z. Klaidi Lame, me detyrë inspektor i IMT-së, nga periudha 5/5/2014.

Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimeve dhe zhvillimit të territorit, u konstatuan **2 praktika** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me realizimin e punimeve në terren jo në përputhje me projektin e ndërtimit.

Titulli i Gjetjes 11: Realizimi në terren i punimeve të ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit.

Situata: Në bazë të verifikimeve për realizimin në terren të punimeve të ndërtimit, u evidentua 1 objekt në të cilin realizimi i punimeve të ndërtimit në terren nuk përkon me projektin e ndërtimit të miratuar:
1."*Struktura akomoduese dhe shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore*", miratuar me vendimin Nr.3009, datë 10/03/2022, me zhvillues R.S. dhe V. S., në adresën Lalëz, njësia administrative Ishëm, Durrës. Nga verifikimi i objektit në terren, objekti nuk është realizuar në përputhje me projektin e ndërtimit, pasi në katin përdhe ndryshe nga projekti i ndërtimit të miratuar, nga trajtim i hapësirës së sistemimin të jashtëm është realizuar shtim në sipërfaqen e ndërtimit, në të njëjtën kuotë me katin përdhe.
Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr.8, datë 20.11.2023
Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:
-Ligji Nr.107/2014, për "*Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, neni 51, Inspektimi.
-Ligji Nr.9780, datë 16.7.2007,"*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", i ndryshuar, neni 5, detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës; neni 12, ushtrimi i kontrollit.
Ndikimi/Efekti:Realizimi i punimeve të ndërtimit në ndryshim nga leja e ndërtimit e miratuar, ndikon në mosrespektimin e kondicioneve urbane, në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në ndryshimin e destinacionit.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e IVMT Durrës
Rëndësia: E lartë

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. D. M., me detyrë kryeinspektor nga periudha 21/04/2021; Z. S. M., me detyrë inspektor nga periudha 17/06/2019.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua **1 praktikë** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mungesën e pajisjes me çertifikatës së përdorimit, pas miratimit të lejes së ndërtimit.

Titulli i gjetjes 12: Mungesa e çertifikatës së përdorimit pas miratimit të lejes së ndërtimit.
Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se objekti pas miratimit të lejes së ndërtimit, nuk ka zhvilluar njoftim fillim punimesh dhe është në përdorim pa u pajisur me çertifikatë përdorimi. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtme të miratuar me objekt: 1."*Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat*", miratuar me vendimin Nr. 2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B. M., në Lalz, Durrës. Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të ndërtimit, objekti ka përfunduar punimet, është në përdorim dhe nuk është pajisur me leje çertifikatë përdorimi. Gjithashtu objekti ka ndryshuar destinacion përdorimi, nga objekt banimi, në objekt në funksion të turizmit.
Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr.8, datë 20.11.2023
Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:
-Në bazë të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "*Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, Neni 50.
-Në bazë të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "*Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, Neni 52, pika g, përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit.
-Në bazë të VKM-në 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve.

Ndikimi/Efekti: Përdorimi i objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi, ndikon në verifikimin e përputhshmërisë së objektit me lejen e ndërtimit të miratuar, mungesën e akteve të kontrollit të objektit gjatë punimeve të ndërtimit, duke ndikuar konformitetin e realizimit të punimeve, në sigurinë, në qëndrueshmërinë e objektit dhe në ndryshimin e destinacionit.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Durrës
Rëndësia: E lartë

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z.E. L., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 21.07.2021-29/03/2022 Znj.K. A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009; Znj.A. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021;Z.D. M., me detyrë kryeinspektor i IMT-së, nga periudha 21/04/2021; S. M., me detyrë kryeinspektor i IMT-së, nga periudha 17/06/2019.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua **1 praktikë** tek e cila pasqyrohej situata, në lidhje me mosllogaritjen e rregullt të taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes 13: Mosllogaritja në mënyrën e duhur e taksës së ndikimit në infrastrukturë.
Situata : Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt:
1."*Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat*", miratuar me vendimin Nr.2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B. M., në Lalz, Durrës. Fatura e përllogaritur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Bashkisë Durrës është 281,047.18 lekë, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën 377,362.17 lekë. Mënyra e përllogaritjes nuk është e rregullt, pasi nuk është verifikuar projekti i ndërtimit në dëg dhe ka një diferencë në llogaritjen e sipërfaqeve të objektit. Diferenca ndërmjet dy vlerave të mësipërme prej 96,315 lekë, përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Durrës.
Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr.8, datë 20.11.2023
Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:
-Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Neni 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë.
-Ligji Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 46, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
-Vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës, nr. 160, datë 23.12.2021 " Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit të vitit 2022", pika A.1.3.
Ndikimi/Efekti: Diferenca e konstatuar e vlerës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, përbën dëm ekonomik për Bashkinë Durrës.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Durrës
Rëndësia: E lartë

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Znj.E.S , Kryetar i Bashkisë Durrës; Z. E. L., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Durrës, nga periudha 21.07.2021-29/03/2022;Znj.A. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021;

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e administruar në KLSH me Nr.765/19 Prot., datë 21.02.2024 dhe me shkresën Nr. 946/1, datë 19.02.2024, është observuar nga Kryetarja e Bashkisë Znj. E.S , nga Drejtori i DPZHT-së Durrës, Z.R. D., nga ish drejtori i DPZHT-së Z.E. L., nga specialistët Znj.K. A., Z.E. V., Z.V. S., Znj.A. H. dhe nga specialisti Znj. J. M., si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:


Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt"Kompleks Vila Banimi 2 kat + 1 kat nëntokë, "B. R. D. Hill", miratuar me vendimin Nr. 2737, datë 18/01/2022, me zhvillues shoqëria "B. C." ShPK, në adresën rruga "Kont Urani", Lagja 1, Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se: "*Në konstatimin nga ana Juaj, ku projekti konstruktiv i ngarkuar në projektin e ndryshuar në sistemin e-leje, nuk përkon me projektin për të cilin aplikohet leja e ndërtimit, Ju bëjmë me dije se është projekti konstruktiv për objektin "Strukturë banimi 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat", me vendndodhje Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Durrës me porositës B. M., dhe është i firmosur elektronikisht nga inxh. A. K.Praktika për leje ndertimi me nr. prot. 8280-21, datë 15.07.2011 dhe numër AN150720210002, ka të ngarkuar që në momentin fillestar projektin konstruktiv nga inxh. B. M. me nr. licence K.1448/2, i cili ka firmosur edhe Deklaratën e Përgjegjësisë Profesionale, me anë të së cilës deklaron me vullnetin e tij të lirë e të pakushtëzuar dhe nën përgjegjësinë e tij të plotë, se ka hartuar projektin konstruktiv për objektin.Me shresën Nr. 8280-21 Prot., datë 28.12.2021, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit i është drejtuar aplikuesit, shoqërisë "J&F A. D." sh.p.k. për njoftim për detyrimin e ndryshimit të projektit, ku një ndër pikat e kërkuara ka qenë "Të plotësohet projekti konstruktiv me planin e strukturave dhe në relacion të paraqiten llogaritjet".Pika e kërkuar është plotësuar dhe është e firmosur nga inxh. B. M. Projekti konstruktiv i firmosur nga inxh. A. K. është ngarkuar nga aplikuesi por nuk ka lidhje me pikën e kërkuar".*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të mbështetura ligjërisht, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Godinë shërbimi dhe banimi 6 kat+1 kat nën tokë dhe banesë 2 kat +1 kat nën tokë", miratuar me vendimin Nr. 104, datë 29.04.2022, me zhvillues "A. K. 2019" ShPK, në adresën Lagjja 17, Rruga "Doktor Remzi", Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se:*" Mbi konstatimin që kjo leje është miratuar në kundërshtim me PPV-në e njësisë A.3.4, pasi intensiteti i ndërtimit nuk është në përputhje me të dhënat e pasqyruara në planvendosjen e miratuar, pasi është 2.4 nga 2.2, pra është shkelur intensiteti i ndërtimit të territorit, duke mos përfshirë sipërfaqen e ballkoneve konsol në llogaritje. Ky konstatim nuk qëndron, pasi bazuar në pikën 4.1.28 të rregullores së planit të përgjithshëm të bashkisë Durrës, citohet se në sipërfaqe kati nuk përfshihen sipërfaqet e ballkoneve. Bazuar në Nenin 40, pika 4, distancat minimale maten gjithmonë midis faqeve që përballin njëra-tjetrën në dy struktura që përballin njëra-tjetrën, duke përfshirë edhe konsolat dhe bazuar në nenin 40, pika 4, në të cilin citohet se në distancat minimale përfshihen edhe konsolat (ballkonet), është riprodhuar një planvendosje, ku mbi planin e vendosjes të miratuar të objektit të propozuar janë vendosur konturi i ballkoneve përçdo kat duke riprodhuar një planvendosje që përfshin edhe gjyrmët e ballkoneve. Distancat e evidentuara në planvendosje: Në kufirin verior distanca nga trupi i rrugës me gjerësi 3m, është 2.5 m, bazuar në nenin 40, pika 14, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011. Në kufirin perëndimor, duke përfshirë edhe ballkonet ekzistuese, distanca nga trupi i rrugës me gjerësi 5m, është 3m, bazuar në nenin 40, pika 14, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011. Në kufirin jugor, distanca nga kufiri i pronës është 6.6 m, bazuar në nenin 40, pika 8.a, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011, ku përcaktohet se në nënjësitë strukturore me funksion banimi, distanca nga kufiri i pronës është 6.6 m, për objekte me 6 kate. Në kufirin lindor, distanca nga kufiri i pronës e objektit 6k është 6.8 m.*



Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, në bazë të Rregullores së Planifikimit të Territorit të Bashkisë Durrës, të miratuar me Vendimin e KKT-së, referuar pikës 4.1.28, në të cilën përcaktohet që në sipërfaqen e kateve për llogaritjen e intensitetit nuk përfshihen daljet konsol, merret në konsideratë. Ndërsa nga shqyrtimi i mbivendosjes së riprodhuar nga ana juaj duke përshirë edhe daljet konsol, sipas VKM-së 502, datë 13.07.2011,"Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit", pretendimet tuaja merren pjesërisht në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Godinë shërbimi dhe banimi 6 kat+1 kat nën tokë dhe banesë 2 kat +1 kat nën tokë", miratuar me vendimin Nr. 104, datë 29.04.2022, me zhvillues "Arela K.2019" ShPK, në adresën Lagjja 17, Rruga "Doktor Remzi", Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se:*" Pretendimi juaj, duke u bazuar në ligjin nr. 99632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 160, datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit të vitit 2022", pika A1.3, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, ku niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet me funksion banimi ose shërbimi nga zhvillues me qëllim përfitimi është 8%, dhe duke u bazuar tek ndryshimi i të dhënave në lidhje me përcaktimin e sipërfaqes së ndërtimit, llogaritja e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë përbën një diferencë me vlerë, me të dhënat si më poshtë:*

Mënyra e përllogaritjes nuk është e rregullt, pasi nuk është verifikuar projekti i ndërtimit në dëg dhe ka një ndryshim në llogaritjen e sipërfaqeve të objektit, nga të dhënat e pasqyruara. Diferenca ndërmjet dy vlerave të mësipërme prej 3,952,925 lekë, përbën të ardhura të munguara shkaktuar buxhetit të Bashkisë Durrës. Bazuar sa më lart, më poshtë gjeni faturën e gjeneruar për diferencën:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

FATURË ARKËTIMI

Nr.: L91526505H179744 Datë: 12.02.2024

NIPT: **L91526505H** **Tip.Aktivitetit:**
Kodi Klientit: **179744** **Arela Konstruksion 2019**
Adresa: **Durres, Durres, Albania**

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka juaj të pranojë nga klientë (persona / persona fizik / persona juridik) arkëtime të të ardhurave, për llogari të institucionit tonë, me emërtimet, kodet dhe shumat si më poshtë:

Emri i Institucionit përfitues: **BASHKIA DURRËS**
Kodi i Institucionit: **2107001**
Kodi i Degës së Thesarit ku vepron: **1010007**

Përshkrimi i të Ardhurave			Shuma që Arkëtohet (Lekë)
Emërtimi	Nr. Fature	Kodi i Llog. Ekonomike	
Taksa ndikimit ne infrastr. nga ndertime te reja	131	7035003	3,952,925.00
		Totali	3,952,925.00

INSTITUCIONI **ADMINISTRATORI**
BASHKIA DURRËS **Arela Konstruksion 2019**

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me pretendimin tuaj në observacionin e dërguar, përsa i përket diferencës së taksës së ndikimit në infrastrukturë të evidentuar gjatë fazës së auditimit në terren për subjektin A. K. është paraqitur fatura e arkëtimit me nr.L91526505H179744, datë 12.02.2024, për likujdimin e taksës në vlerën 3,952,925 lekë. Përsa më sipër, pretendimi juaj merret në konsideratë dhe u reflektua në raportin përfundimtar të auditimit.

Pretendimet e subjektit:
Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Strukturë industriale 2 dhe 3 kate dhe 1 kat nëntokë", miratuar me vendimin Nr. 2884, datë 14/02/2022, me zhvillues "P. B. " ShPK, në adresën Rruga " Athina ", Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se:
"Në projektin arkitektonik të miratuar, të ngarkuar në sistemin elektronik, në folderin: Të tjera, të aplikimit me numër AN131020210148, ku janë reflektuar të gjitha korrigjimet dhe saktësimet e rekomanduara projektuesit dhe aplikuesit me prokurë, sipas llogaritjeve të bëra rezultojnë vlerat si më poshtë:Objekti përbëhet nga dy volume me lartësi 2 kat 3 kat. Përllogarisim secilin volum më vehte;
Volumi 3 kat: Kati përdhe 481m2 x 4,8m = 2'308,8m3
Kati i parë 560,3m2 x 4,3m = 2'409,3m3
Kati i dytë 581m2 x 3,7m = 2'149,7m3
Shuma = 6'867,8m3
Volumi 2 kat:gjurma 1'891m2 x lartësinë e përgjithshme 12,8m = 24'204,8m3
Shumorja e dy volumeve: 6'867,8m3 + 24'204,8m3 = 31'072,6m3 është volumi total i ndërtimit në zhvillimin që propozohet dhe raporti i këtij volumi mbi sipërfaqen e plotit është 3,88m3/m2. Ndërsa streha ekzistuese me sipërfaqe 677m2, propozohet të shkurtohet si rrjedhojë e zhvillimit të ri që propozohet, duke mbuluar një sipërfaqe prej 592,5m2 dhe duke mbetur përsëri strehë dhe për rrjedhojë nuk përbën volum. Leja e ndërtimit është lëshuar për "Strukturë industriale 2 dhe 3 kate dhe 1 kat nëntokë".

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se nga verifikimi i dokumentacionit të pronësisë dhe verifikimit në terren, gjurma e cila përshkruhet si strehë në planvendosje është objekt dhe përfshihet në sipërfaqen e ndërtimit të parcelës. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Struktura akomoduese dhe shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore", miratuar me vendimin Nr.3009, datë 10/03/2022, me zhvillues R.S. dhe V. S., në adresën Lalëz, njësia administrative Ishëm, Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se*:" Leja e ndërtimit është miratuar në bazë të kushteve të zhvillimit të mëposhtme:*

-Sipërfaqja e pasurisë 1 (m²): 6000
-Sipërrfaqja e pasurisë 2 (m²): 7000
-Sipërrfaqja e pasurisë 3 (m²): 10364
-Sipërfaqja totale e pasurive në studim (m²): 23364
-Sipërrfaqja totale për mbjellje (m²): 13000
-Kufiri i sheshit të ndërtimit (m²): 10364
-Sipërfaqja e ndërtimit për 14 objektet 2 kat dhe objektin 1 kat (m²): 798 + 456 = 1254
-Sipërfaqja e ndërtimit totale për 14 objektet 2 kat dhe objektin 1 kat (m²): 1705 + 456 = 2161.2
-Koeficienti i shfrytëzimit të truallit: 12 %
-Intensiteti i ndërtimit: 0.2
-Numri i kateve mbi tokë: 1 dhe 2 kat
-Numri i kateve nëntokë: 0 kat
-Vëllimi i 14 objekteve 2 kat dhe objektit 1 kat (m³): 5371.4 + 3328.8 = 8699.8
-Lartësia maksimale e strukturës (m): 7.30 – 8.30

Në projektin e ndërtimit të pasqyruar për ndryshim projekti, sipas Jush, konstatohet se të dhënat e sipërfaqeve të pasqyruara në lejen e ndërtimit, nuk përputhen me sipërfaqen sipas projektit. Në projektin e ndërtimit të pasqyruar për ndryshim projekti, kushtet e zhvillimit të objekteve janë si më poshtë:

-Sipërfaqja e ndërtimit për një nga vilat e ndryshuar nga vila tip është 172 m²
-Sipërfaqja e objektit të shërbimit është 998 m²
-Sipërfaqja e objektit në hyrje është 20 m²
-Sipërfaqja totale e ndërtimit është 3140 m²
-Sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është 2684 m²
-Numri i kateve mbi tokë: 1 dhe 2 kat
-Numri i kateve mbi tokë në bazë të lartësisë 12.55 m = 3 kate
-Numri i kateve nëntokë: 1 kat 456 m²
-Lartësia maksimale e strukturës (m): 12.55 m

Në bazë të të dhënave të treguesve të zhvillimit të paraqitura në lejen e ndërtimit dhe të dhënave të verifikuara në projektin e ndryshuar, sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është 2684 m², nga 2161.2 m² të pasqyruara në të dhënat e treguesve të zhvillimit në lejen e ndërtimit, duke shtuar një sipërfaqe ndërtimi 522.8 m², sipërfaqe që tejkalon 2 % e ndryshimit të projektit në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në nenin 17, në pikën 1, gërma e. Zhvilluesi duhet të aplikonte për leje ndërtimi për shtesë të sipërfaqes së ndërtimmit dhe jo për ndryshim projekti gjatë ndërtimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, ndryshimet në projekt konsistojnë në:

-Objektet struktura akomoduese 2 kat në perëndim pësojnë rotacion 180º;
-Objektet struktura akomoduese në perëndim pësojnë rotacion 180º;
-Në Lejen e Ndërtimit Miratuar me Vendimin Nr. 2358, datë 07.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Durrës, janë miratuar 14 struktura akomoduese tip, ndërkohë në aplikimin për ndryshime në projekt, 13 struktura akomoduese mbeten siç kanë qenë në Lejen fillestare, dhe vetëm 1 strukturë akomoduese pëson ndryshim.

Pavarësisht të dhënave të paraqitura në planvendosjen e miratuar me Vendimin Nr. 2358, datë 07.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Durrës, parametrat duke shtuar edhe ballkonet janë:

Struktura akomoduese tip – 14 copë
K 0 = 57 m²
K1 = 71.52 m²
Totali = 128.52 m²
14 struktura akomoduese = 14 x 128.52 m² = 1799.28 m²
Struktura akomoduese e cila pëson ndryshime:

K 0 = 65 m²
K1 = 71.52 m²
Totali = 151.82 m²
Struktura akomoduese tip – 13 copë:
K 0 = 57 m²
K1 = 86.82 m²
Totali = 128.52 m²
13 struktura akomoduese = 13 x 128.52 m² = 1670.76 m²
-Para strukturës akomoduese që pëson ndryshime, shtohet një pishinë;
-Pishina e miratuar në Lejen e parë pëson ndryshime në formë;
-Struktura e shërbimit 2 kat, pëson ndryshime në fasadë dhe lartësi, duke shkuar në kuotën +11.55 m, dhe realizohet dalje në tarracë, për të bërë tarracën të shfrytëzueshme. Gjithashtu shtohet kat nëntokë për parkim;
Sipërfaqja e miratuar në Lejen e Ndërtimit miratuar me Vendimin Nr. 2358, datë 07.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Durrës, është 456 m².
Në aplikimin për Leje ndryshim projekti, struktura e shërbimit 1 kat ka këto parametra:
K -1 = 456 m²
K 0 = 456 m²
Kafazi i shkallës = 21.8 m²
Totali mbi tokë = 477.8 m²
Sipërfaqja totale e miratuar në Lejen e Ndërtimit miratuar me Vendimin Nr. 2358, datë 07.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Durrës, duke përfshirë edhe ballkonet të cilat nuk janë paraqitur në planvendosjen e miratuar:
14 struktura akomoduese = 14 x 128.52 m² = 1799.28 m²
Struktura e shërbimit = 456 m²
Totali = 2255.28 m²
Sipërfaqja totale e miratuar në Lejen e Ndërtimit për ndryshime në projekt, duke përfshirë edhe ballkonet të cilat nuk janë paraqitur:
13 struktura akomoduese = 13 x 128.52 m² = 1670.76 m²
1 strukturë akomoduese = 151.82 m²
Struktura e shërbimit mbi tokë = 477.8 m
Totali = 2300.38 m²
Bazuar në Nenin 17, pika 1. e) të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, citohet: "Rastet, në të cilat mund të ndryshohet projekti i ndërtimit, sipas nenit 48, të ligjit, në përputhje me dokumentet e planifikimit në fuqi, janë ndryshime që zbatohen brenda kufijve dhe kushteve urbane të zhvillimit, të cilat konsistojnë në shtimin apo zvogëlimin e sipërfaqes ndërtimore të objektit, mbi tokë apo/dhe nën tokë, me kusht që për lejet e miratuara nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit, në rastet e rritjes së sipërfaqes ndërtimore mbi tokë, shtesa të mos tejkalojë masën 2% në projektin e miratuar."
Sipërfaqja totale mbi tokë e miratuar në Lejen e Ndërtimit me Vendimin Nr. 2358, datë 07.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Durrës është 2255.28 m².
2% x 2255.28 m² = 45.11 m² - sipërfaqja që lejohet të shtohet
Sipërfaqja totale mbi tokë, duke përfshirë edhe ballkonet, të cilat nuk janë pasqyruar në Lejen e miratuar me Vendimin Nr. 2884, datë 14.02.2022 të Kryetarit të Bashkisë Durrës Për ndryshime në projekt është 2300.38 m².
Diferenca = 2300.38 m² - 2255.28 m² = 45.1 m²
Pra sipërfaqja totale e shtuar nuk e kalon 2% e lejuar, sipas VKM 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar.
Nga ana Juaj, është konstatuar edhe se, në aplikimin për ndryshim projekti, të dhënat e sipërfaqes në dokumentacionin e pronësisë janë ndryshuar në miratimin e lejes së ndërtimit. Sipërfaqja e pasurisë me numër pasurie 161/6, në zonën kadasttrale 2375 nga 6000 m² është reduktuar në sipërfaqen 4800 m² të pasurisë me numër 161/25, në zonën kadastrale 2375. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregulloress së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në nenin 9, në pikën 5, përcaktohet se në rast ndryshimi të kufijve të pronës/ave, për të cilën/at është miratuar leja e zhvillimit, zhvilluesi duhet të aplikojë për leje të re zhvillimi.

Në lidhje me këtë pikë, sqarojmë seKondicionet urbane te miratuara ne vendimin Nr. 2358, datë 07.10.2021 jane:

1.Sipërfaqja e pasurisë 1 (m2): 6000
2.Sipërfaqja e pasurisë 2 (m2): 7000
3.Sipërfaqja e pasurisë 3 (m2): 10364
4.Sipërfaqja totale e pasurive në studim (m2): 23364
5.Sipërfaqja totale për mbjellje (m2): 13000
6.Kufiri i sheshit të ndërtimit (m2): 10364

Kondicionet urbane te miratuara ne vendimin Nr. 3009, datë 10/03/2022 jane:

1.Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës: 22164 m²
2.Sipërfaqja totale për mbjellje: 11800 m²
3.Kufiri i sheshit të ndërtimit: 10364 m²

Pra kufiri i sheshit për ndërtim nuk ka ndryshuar prandaj nuk ka qenë i nevojshem që zhvilluesi të aplikojë për leje të re zhvillimi pasi kufijtë e sheshit të ndërtimit kanë mbetur të pandryshuara. Një pikë tjetër e konstatuar nga ana juaj është edhe se në bazë të vendimit Nr. 12, datë 27.02.2019 "Për miratimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban, bujqësor dhe natyror", në pikën 4 përcaktohet që strukturat agroturistike nuk duhet të kalojnë lartësinë e 2 kateve me nënçati. Në projektin e ndryshuar gjatë ndërtimit, objekti i shërbimit në bazë të VKM-së 408, neni 37, pika 1, lartësia e ndërtimit mbi tokë është në lartësinë e një objekti 3 kate, duke tejkaluar përcaktimin e kuadrit ligjor në fuqi. Lartësia e objektit është 12.55 metra.Nga sa më sipër sqarojmë se, në Lejen e Ndërtimit miratuar me Vendimin Nr. 2358, datë 07.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Durrës, Lartësia e objektit 1 kat është miratuar 8.30 m. Objekti me ndryshime në projekt është 11.55 m i lartë. Bashkëlidhur prerjet teknike të objektit, në të cilat mund të shikohet qartë që objekti është 1 kat, por ka vetëm 1 ndarje në pjesën e kuzhinës: Gjithashtu, në aplikimin për ndryshime në projekt, instituti Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka kthyer përgjigje dhe konkretisht:Subjekti R. S. – P.F. është pajisur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me "Certifikatën Paraprake për Veprimtarinë e Agroturizmit" më datë 09.09.2021, për pronat me nr.pasurie 161/5, 161/6, 137/20, sipas Lejes së Zhvillimit nr.2170, datë 10.08.2021, të lëshuar nga Bashkia Durrës".Subjekti është pajisur me Çertifikatë paraprake për veprimtarinë e turizmit, me objektin e shërbimit 1 kat dhe lartësi 8.30 m. Në rastin e ndryshimit në projekt lartësia shkon 11.55 m. Pra kemi ngritje të lartësisë me 3.25 m. Në këto kushte, objekti nuk mund të quhet 3 kat.Strukturat akomoduese jane dy kat bazuar ne vendimin Nr. 12, date 27.02.2019, "Për miratimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i perkasin sistemeve urban, bujqësor dhe natyror", pika Struktura e shërbimit për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore nuk ka përcaktim për lartësinë pasi bazuar ne VKM-së 408, neni 37, pika 1, lartësia e ndërtimit mbi tokë është në lartësine e një objekti 3 kate, kjo është e vlefshme për objektet e banimit ndërsa duke qenë se kemi të bëjmë me një "Strukturë shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore" bazuar ne piken 4 po të këtij neni thuhet:"Për përdorime, funksione dhe aktivitete të tjera, lartësia e katit përcaktohet nga legjislacioni i posaçëm në fuqi dhe nga rregullorja e ndërtimit."Për më tepër, subjekti është pajisur me certifikatë agriturizmi ku janë përcaktuar që objekti plotëson kriteret ligjore për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave dhe objekteve në funksion të tij."

<u>Qëndrimi i Grupit të auditimit:</u>

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në nenin 17, në pikën 1, gërma e, përcaktohet që ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit mund të realizohet në ndryshime të cilat konsistojnë në shtimin apo zvogëlimin e sipërfaqes ndërtimore të objektit, mbi tokë apo/dhe nën tokë, me kusht që për lejet e miratuara nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit, në rastet e rritjes së sipërfaqes ndërtimore mbi tokë, shtesa të mos tejkalojë masën 2% në projektin e miratuar. Në bazë të të dhënave të treguesve të zhvillimit të paraqitura në lejen e ndërtimit dhe të dhënave të verifikuara në projektin e ndryshuar, sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është 2684 m2, nga 2161.2 m2 të pasqyruar në të dhënat e treguesve të zhvillimit në lejen e ndërtimit, duke shtuar një sipërfaqe ndërtimi 522.8 m2, sipërfaqe që tejkalon 2 % e ndryshimit të projektit. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në nenin 9, në pikën 5, përcaktohet se në

rast ndryshimi të kufijve të pronës/ave, për të cilën/at është miratuar leja e zhvillimit, zhvilluesi duhet të aplikojë për leje të re zhvillimi. Sipërfaqja e pasurisë me numër pasurie 161/6, në zonën kadastrale 2375 nga 6000 m^2 është reduktuar në sipërfaqen 4800 m^2 të pasurie me numër 161/25, në zonën kadastrale 2375, duke ndryshuar kushtet e zhvillimit. Në bazë të vendimit Nr.12, datë 27.02.2019, "Për miratimin e lejes së zhvillimit / ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban, bujqësor dhe natyror", në pikën 4 përcaktohet që strukturat agroturistike nuk duhet të kalojnë lartësinë e 2 kateve me nënçati. Në projektin e ndryshuar gjatë ndërtimit, objekti i shërbimit në bazë të VKM-së 408, neni 37, pika 1, lartësia e ndërtimit mbi tokë është në lartësinë e një objekti 3 kate, duke tejkaluar përcaktimin e kuadrit ligjor në fuqi. Objekti i propozuar me funksion shërbimi (bar-kafe-restorant) bën pjesë në strukturën agroturistike dhe jo në strukturat e shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, për të cilat aplikohen kritere dhe kondicione të tjera. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Struktura akomoduese turistike 2 dhe 3 kat dhe rrethim i pronës", miratuar me vendimin Nr. 925-22/6, datë 21/12/2022, me zhvillues "Ch. G." ShPK, në adresën Hamallë, Njësia administrative Manëz, Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se: "*Në lidhje me konstatimin Tuaj, ku nuk është respektuar distanca minimale nga kufiri i pronës prej 4 metrash, për objektin në lartësinë e 3 kateve të ndërtimit. Distanca e pasqyruar në planvendosje është 3.1 metër, ju informojmë se:Në lidhje me këtë pikë, sqarojmë se, objekti është 2 dhe 3 kat. Distanca prej 3.1 m është për volumin 2 kat dhe për volumin 3 kat është 5.3 m. Konstatimi tjetër, ku nuk është respektuar distanca minimale ndërmjet dy ndërtimeve në lartësinë e 3 kateve. Kjo distancë duhej të ishte 8 metra, nga 1.5 metra e pasqyruar në planvendosje, ju bëjmë me dije se: Në lidhje me këtë pikë, sqarojmë se, po të shikohet projekti arkitektonik këto dy faqe që përballen me njëra-tjetrën në distancë 1. 5 m janë faqe kallkan."*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se objektet janë në lartësinë e 3 kateve dhe distanca që duhet respektuar nga kufiri i pronës është 4 metra, në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në neni 35, në pikën 1. Përsa më sipër, pretendimet tuaja merren në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Struktura akomoduese turistike 2 dhe 3 kat dhe rrethim i pronës", miratuar me vendimin Nr. 925-22/6, datë 21/12/2022, me zhvillues "Ch. G." ShPK, në adresën Hamallë, Njësia administrative Manëz, Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se:"Konstatimi nga ana Juaj, në lidhje me mënyrën e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, ku sipas jush rezulton me diferencë të papaguar prej 262,843.63 lekë, Ju bëjmë me dije se: Është gjeneruar fatura për diferencën sipas rekomandimit tuaj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

FATURË ARKËTIMI

Nr.: L61725505F129725 Datë: 12.02.2024

NIPT: L61725505F **Tip.Aktivitetit:**
Kodi Klientit: 129725 **Subj. "Chelsea Gardens"**
Adresa: Ishem, Kuraten, rr. Shkafane, Godine 1 kat, ZK 2332, Nr. pasurie 386/51, Durres, Albania

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka juaj të pranojë nga klientë (persona / persona fizik / persona juridik) arkëtime të të ardhurave, për llogari të institucionit tonë, me emërtimet, kodet dhe shumat si më poshtë:

Emri i Institucionit përfitues: **BASHKIA DURRËS**
Kodi i Institucionit: **2107001**
Kodi i Degës së Thesarit ku vepron: **1010007**

Përshkrimi i të Ardhurave			Shuma që Arkëtohet (Lekë)
Emërtimi	Nr. Fature	Kodi i Llog. Ekonomike	
Taksa ndikimit ne infrastr. nga ndertime te reja	132	7035003	262,843.63
		Totali	262,843.63

INSTITUCIONI
BASHKIA DURRËS

ADMINISTRATORI
Subj. "Chelsea Gardens"

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me pretendimin tuaj të paraqitur në observacionin e dërguar, përsa i përket diferencës së taksës së ndikimit në infrastrukturë të evidentuar gjatë fazës së auditimit në terren për subjektin Ch. G. është paraqitur fatura e arkëtimit me nr.L6.....5, datë 12.02.2024, për likujdimin e taksës në vlerën 262,843.63 lekë. Përsa më sipër, pretendimi juaj merret në konsideratë dhe u reflektua në raportin përfundimtar të auditimit.

Pretendimet e subjektit:
Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Godinë industriale 1 dhe 2 kat + vendroje + kabinë elektrike dhe mur rrethues", miratuar me vendimin Nr. 2775, datë 28/01/2022, me zhvillues "M. O." ShPK, në adresën rruga "Vath Turja", Spitallë, Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se*:"Objekti i ushtrimit të aktivitetit në QKB-në e zhvilluesit nuk është kusht për zhvillimin e një ndërtimi të ri në një drejtim të ndryshëm dhe/ose të ri të aktivitetit. Funksioni i objektit nga vetë emërtimi është godinë industriale. Çdo aktivitet prodhues industrial ka nevojë për ambiente mbështetëse për administratën/stafin si zyra apo ambient për reklamimin e mallit siç mund të jetë sallë ekspozimi/shoëroom. Konstatimi juaj nuk qëndron.Në fragmentin e rilevimit dhe në planin e vendosjes së strukturës është i pasqyruar se si bëhet aksesi për në pronë. Konstatimi juaj nuk qëndron"*.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 27, datë 10.05.2013 "Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës" të njësisë 1.1, kategoria e lejuar e përdorimit të tokës është aktivitete logjistike dhe industriale (me efekt të mesëm e të lartë), zyra dhe kapanone (me funksion prodhimi). Ndërsa përdorime të ndaluara janë funksionet rezidenciale, magazinimi, bar/restorante dhe mikronismarrje. Në projektin arkitektonik evidentohet që godina në lartësinë e dy kateve ka funksion për zyra/ administratë dhe shoëroom. Në raport me aksesin për në parcelë, nuk ka një akses të drejtpërdrejtë por kalon nëpërmjet një pasurie tjetër me të cilën kufizohet. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Pretendimet e subjektit: Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat", miratuar me vendimin Nr. 2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B. M., në Lalz, Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se: " *Ju konstatoni me të drejtë se në pikën D të kartelës së pasurisë së paluajtshme 192/5, ZK 2375, me sipërfaqe 1162 m2, përcaktohet se:Pezullohen veprimet me urdhër regjistruesi nr. 2815, datë 04.05.2012.Për të vazhduar më tej, po këtu shënohet se data e regjistrimit është 01/01/1900.Mirëpo, në shkresën e datës 14.12.2021 të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, konfirmohen të gjitha pasuritë që aplikohen për lejen e ndërtimit. Në projekt raportin e auditimit, ju citoni se Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës shpreh vetëm miratimin që pronësia i përket zhvilluesit, por nuk përshkruan kufizimet ligjore..Ju bëjmë me dije se Drejtoria Vendore e ASHK Durrës në rastet kur prona është e kufizuar apo nuk është e lirë nga çdo barrë hipotekore, e shpreh në përgjigjen përkatëse. Fakti që Drejtoria Vendore e ASHK Durrës ka konfirmuar pronësinë, ka konfirmuar pikërisht që prona nuk është e kufizuar dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekore. Në përgjigjet e mëvonshme, Drejtoria Vendore e ASHK Durrës e ka riformuluar përgjigjen e saj mbi informacionin që jep mbi çdo pronë që propozohet të zhvillohet, duke mos lënë shkak për keqkuptime apo interpretime të pasakta. Ka eliminuar fjalinë "Konfirmohet nga institucioni jonë", me "Nga verifikimi i të dhënave në sistemin multifunksional rezulton se pasuria nuk ka kufizim dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekore".Konkretisht, po ju paraqisim një shkresë kthim përgjigje të Drejtorisë Vendore të ASHK Durrës."*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, prona ka kufizime ligjore. Drejtoria e Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës shpreh vetëm miratimin që pronësia është i përket zhvilluesit, por nuk përshkruan kufizimet ligjore. Në lidhje me sipërfaqet e ndërtimit të objektit, janë verifikuar nga projekti i ndërtimit në versionin dëg dhe janë pasqyruar sipërfaqet konkrete të ndërtimit. Përsa më sipër, nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të mbështetura ligjërisht, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Pretendimet e subjektit: Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat", miratuar me vendimin Nr. 2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B. M., në Lalz, Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se: *"Për konstatimin Tuaj, se duhet paguar diferencë në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, sqaroj se:Sipërfaqja shtesë në planvendosje është 291.8 m². Sipërfaqe e shënuar edhe në Vendimin e miratimit. Llogaritja është bërë sipas kësaj sipërfaqe. Nëse keni pretendime, Ju lutem na informoni pasi vlera e përllogaritur është në bazë të cmimit të kostos sipas sipërfaqes të sipërshënuar."*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të Ligjit Nr. 107/2014, për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 46 dhe Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Neni 27, mënyra e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur. Diferenca e taksës së ndikimit në infrastrukturë të konstatuar në shumën 96,315 lekë duhet dëmshpërblyer nga zhvilluesi B. M., për objektin :"Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat", miratuar me vendimin Nr.2736, datë 18/01/2022, në bazë të rekomandimit në pikën 1.1.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Shtëpi banimi 2 kat + podrum + papafingo dhe mur rrethues", miratuar me vendimin Nr. 2859, datë 08/02/2022, me zhvillues V.dhe N. P., në adresën rruga "Idriz Xhafi", Shkallnur, Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se: "*Në lidhje me pikën 1, theksoj se dokumenti Leje Zhvillimi është lëshuar me Vendimin Nr. 220, datë 20.04.2017. Projekt-Ideja e paraqitur në aplikimin me Nr. 3088 Prot. datë 05.04.2017 propozon një shtëpi banimi 2 kat + podrum me treguesit e mëposhtëm:*

Sipërfaqja e tokës që zhvillohet	*4'534m²*
Sipërfaqja e tokës e zënë nga struktura	*782m²*
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit	*1'614,8m²*
Koeficienti i shfrytëzimit të territorit	*17,2%*
Intensiteti i ndërtimit	*0,35*

Ky propozim është pajisur me konformitetin përkatës me Nr. 1002 Prot. datë 20.04.2017 nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, e cila si autoriteti i ngarkuar për kontrollin e konformitetit të zhvillimit të propozuar me rastet përjashtimore, pasi ka shqyrtuar kërkesën ka konstatuar se parcela e propozuar për zhvillim bën pjesë në rastet përjashtimore sipas pikës 2, gërma ë), të Vendimit Nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore".

Këtë konformitet AZHT e jep bazuar në përditësimin e Vendimit të KKT-së Nr. 1, datë 30.07.2015, i cili me Vendim të KKT-së Nr. 15, datë 07.06.2016 në gërmën a) të pikës 1. bën ndryshimin në pikën 2, gërma "ë", e cila zëvëndësohet me fjalët e mëposhtëme:

"banesë një familjare, kërkuar nga pronari i truallit, duke respektuar kushtet urbane sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

Pra propozimi i zhvilluesit dhe lëshimi i Lejes së Zhvillimit kanë ndodhur pas ndryshimeve të mësipërme dhe për rrjedhojë Leja e Zhvillimit konfirmon përputhjen e projekt-idesë me rregullat e projektimit në fuqi.

Në lidhje me pikën 2, Në propozimin për leje ndërtimi zhvilluesi paraqet kërkesën për shtëpi banimi 2 kat + podrum + papafingo dhe mur rrethues, me treguesit e mëposhtëm:

Sipërfaqja e tokës që zhvillohet	*4'534m²*
Sipërfaqja e tokës e zënë nga struktura	*481,34m²*
Sipërfaqja e katit nëntokë	*240,3m² (nga 383m² në projekt-ide)*
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit	*872,89m²*
Koeficienti i shfrytëzimit të territorit	*10,6%*
Intensiteti i ndërtimit	*0,19*

Pra siç dallohet qartë në propozimin për leje ndërtimi kemi një zvogëlim të ndjeshëm të të gjithë treguesve të zhvillimit dhe ndryshimi tjetër konsiston në propozimin e një papafingo me sipërfaqe 58,18m² ndërtim dhe 123,12m² verandë (duke përmbledhur funksione të nevojshme si daljen e kafazit

të shkallëve dhe ashensorit në tarracë dhe një nyje sanitare). Këto ndryshime nuk janë të ndaluara për deri sa janë në përputhje me rregullat e projektimit në fuqi.
Bazuar në detyrimin që u la në Lejen e Zhvillimit në përputhje edhe me konformitetin e AZHT-së, në lidhje me konvertimin e tokës në truall, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, zhvilluesi ka paraqitur dokumentin e ri të pronësisë, në të cilën 500m^2 janë konvertuar në truall dhe kjo është e mjaftueshme bazuar në faktin që gjurma e strukturës së propozuar është 481,34m^2.
Në lidhje me pikën 3, Sqarojmë se në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit ", i ndryshuar dhe procesit të bashkërendimit institucional me marrjen e pëlqimeve/konformiteteve përkatëse, zhvilluesi ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sikurse edhe në aplikimin për Leje Zhvillimi edhe në aplikimin për Leje Ndërtimi, dokumenti që vërteton të drejtën pasurore të zhvilluesit, me numër 41/17, ZK 3385, vol. 22, fq. 244, është konfirmuar nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës në procesin e bashkërendimit institucional me kthimin e përgjigjes me datë 17.01.2022.
Në lidhje me pikën 4, Propozimi si në aplikimin për leje zhvillimi ashtu dhe në aplikimin për leje ndërtimi paraqiste podrumin si një hapësirë në të cilën pozicionoheshin funksione kryesisht teknike si depo, lavanteri, dhomë teknike kaldajë e pompa, kantinë si dhe garazh për mjetet. Ky kat zhvillohet në të tre anë të tijë i zhytyr në tokë dhe vetëm në njërën anë, duke shfrytëzuar pjerrësinë e terrenit dhe mundësuar hyrjen e mjeteve, ka komunikim me ambjentin e jashtëm. Pra teknikisht ky kat është podrum dhe nuk mund të konsiderohet si kat mbi tokë."

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të Ligjit 111/2018, për "Kadastrën", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar.", në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje nuk pasqyrohet kartela e pasurisë. Në lidhje me përcaktimin e lartësisë së objektit në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në Nenin 37, në pikën c, përcaktohet se lartësia e ndërtimeve e shprehur në metra matet sipas rastit: "Në rastin e ndërtesave të vendosura në terrene me pjerrësi, lartësia në metra jepet në mënyrë të posaçme për të dyja faqet e strukturës në secilën anë të terrenit të pjerrët dhe objekti i miratuar në lejen e ndërtimit është në lartësinë e 4 kateve mbi tokë, nga 2 kate të miratuar në lejen e zhvillimit. Për sa më sipër sqarojem se nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të mbështetura ligjërisht, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: **"**Godinë Banimi dhe Shërbimi 2-4 dhe 6 Kate me 1 Kat Nëntokë", miratuar me vendimin Nr. 3004, datë 10/03/2022, me zhvillues "K. K. 2003", në adresën lagjia 6, Rruga "Aleksander Goga", Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se:" *Në piken 2, ku ne zbatim të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, ne nenin 27/2, pika 1, germa ë, ku zhvilluesi ka detyrimin ligjor te depozitoje aktet e leshuara nga shoqeria Ujesjelles –Kanalizime, OSHE, institucioni per menaxhimin e mbetjeve urbane, sqaroj qe aktet perkatese jane ne sistem. Në piken 3, ku ne zbatim të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, ne nenin 27/2, pika 1, germa j, percaktohet qe aplikuesi duhet te paraqese fotografi te objektit ne te gjitha orjentimet.Gjithashtu ne konstatimin tuaj, ju citoni qe gjurma e objektit nuk perputhet me planvendosjen e miratuar.Ky konstatim nuk qendron, pasi fotot jane ne sistem dhe aktet e mbajtura nga specialistet perkates, mbi zbatimin e projektit te miratuar, gjithashtu jane ne sistem."*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk pasqyrohen fotografi të objektit. Nga verifikimi në terren i objektit, gjurma e ndërtimit nuk përputhet me planvendosjen e miratuar dhe shkallët e jashtme të godinës, zhvillohen jashtë kufirit të pronësisë. Për sa më sipër sqarojmë që nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të

mbështetura ligjërisht, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:
Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Rikonstruksion dhe ndryshim funksioni të godinës banimi dhe shërbimi 6 kat mbi tokë dhe një kat nëntokë", miratuar me vendimin Nr.2763, datë 26/01/2022, me zhvillues Shoqeria I.-F., në adresën lagjia 14, Shkozet, Durrës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se*:" Ju bëjmë me dije se projekti i miratuar në lejen e ndërtimit është i njëjtë me projektin "as build" të zbatuar, nëse nuk ka ndryshime në projekt. Në rast të kundërt, duhet të aplikohet per leje ndërtimi për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit në bazë të nenit 17 të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.Ndërhyrjet në godinë janë kryesisht të sipërfaqeve të brendshme. Sipërfaqet e katit të parë, të dytë dhe të tretë janë kthyer nga ambient shërbimi në ambient banimi. Gjithashtu, fotografitë për të gjitha orientimet janë të depozituara në sistem.Në këto kushte, kërkojmë rishikimin e konstatimeve të bëra nga ana juaj."*
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqiten fotografi në të gjitha orjentimet, të cilat janë të fragmentura dhe nuk evidentohen të gjtha ndërhyrjet në godinë. Nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve të ndërtimit, u konstatuan ndryshime në realizimin e punimeve të ndërtimit nga projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit. Për sa më sipër sqarojmë se nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të mbështetura ligjërisht, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e administruar në KLSH me Nr.765/19 Prot., datë 21.02.2024 dhe me shkresën Nr. 946/1, datë 19.02.2024 është observuar nga kryeinspektori D. M. dhe inspektorët G. H., A. Gj., K. L., S. M., E. L., A. H., si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:
Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt:"Struktura akomoduese dhe shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore", miratuar me vendimin Nr.3009, datë 10/03/2022, me zhvillues R. S. dhe V. S., në adresën Lalëz, njësia administrative Ishëm, Durrës, kryeinspektori Z.D. M. dhe inspektori z. S.M. shprehen se:"*Subjekti R. dhe V.S. është pajisur me leje ndertimi për objektin "Ndryshim të Projektit gjate Ndërtimit "Stuktura akomoduese dhe sherbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqesore" Nr.Vendimi 3009 dt 10.03.2022 Vendim "Leje për ndryshimin e projektit gjate ndertimit" nr.225-22/1prot dt 10.03.2022.Bashkengjitur dokumentacioni përkatës i projektit.Në zbatim të detyrave funksionale të ngarkuara nga ligji Nr.9780 , datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar VKM-së 894 date 04.11.2015 "Për unifikimin ë procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit dhe ai i njesise vendore" si dhe VKM Nr.408/2015 "Për miratimin ë rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar. Në mbeshtetje të neneve dhe 39 të ligjit 107 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tyre, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Durres*".
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve të ndërtimit, objekti nuk është realizuar në përputhje me projektin e ndërtimit, pasi në katin përdhe ndryshe nga projekti i ndërtimit të miratuar, nga trajtim i hapësirës së sistemimin të jashtëm është realizuar shtim në sipërfaqen e ndërtimit, në të njëjtën kuotë me katin përdhe.Në bazë të ligjit Nr. 9780 përcaktohet se është detyrë funksionale e inspektorëve dhe e kryeinspektorit për kontrollin e ndërtimeve në territorin e Bashkisë Durrës dhe për zbatimin e ndërtimeve sipas projekteve të miratuara në lejen e ndërtimit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat", miratuar me vendimin Nr. 2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B. M., në Lalz, Durrës, kryeinspektori dhe inspektorët e imt-së shprehen se: **"***Lidhur me gjetjen tuaj për kete objekt ku cilesoni mungese kontrolli të punimeve të ndertimit ku si pasoje ka sjelle perdorimin ë objektit pa u paisur me certefikate perdorimi dhe ndryshim destinacioni .Në zbatim të detyrave funksionale të ngarkuara nga ligji Nr.9780 , datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar VKM-së 894 date 04.11.2015 "Për unifikimin ë procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit dhe ai i njesise vendore" si dhe VKM Nr.408/2015 "Për miratimin ë rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tyre, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Durres. Neni 7/1 pergjegjesia e mbikëqyrësit. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë mezbatuesin e objektit që do të drejtojë.*

-Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

-Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojëmenjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut.

Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e mbikëqyrësit caktohet një punonjës i investitorit, gjithmonë i pajisur me licencën përkatëse. Neni 8/1. Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Referuar ligjit 8402, dt 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin ë pubnimeve të ndertimit i ndryshurar, ligji Nr.9780 , datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar. Pas perfundimit të punimeve nga subjekti ndertues apo mikqyresi i punimeve nuk ka bërë kërkesë për paisjen me certefikate përdorimi pranë Inspektorati i Mbrojtjes se Territorit Bashkia Durres konform legjislacionit në fuqi,dhe për kete nuk është pergjegjese Inspektorati i Mbrojtjes se Territorit Bashkia Durres Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut."

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve të ndërtimit, objekti ka përfunduar punimet, është në përdorim dhe nuk është pajisur me leje çertifikatë përdorimi. Gjithashtu objekti ka ndryshuar destinacion përdorimi, nga objekt banimi, në objekt në funksion të turizmit. Në bazë të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 52, pika f, përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit përbën kundravajtje administrative. Në bazë të nenit 51, të Ligjit Nr.107/2014, në pikën 1 përcaktohet që: *"Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji."*Në bazë të ligjit Nr. 9780 përcaktohet se është detyrë funksionale e inspektorëve dhe e kryeinspektorit për kontrollin e ndërtimeve në territorin e Bashkisë Durrës dhe për zbatimin e ndërtimeve sipas projekteve të miratuara në lejen e ndërtimit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara për ndërtimin e disa strukturave në funksion shërbimi, të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi ose deklaratë paraprake punimesh, inspektori i imt-së Klajdi Lame shprehet se:"*Gjate verifikimit në terren te objektit të pasqyruar në foto une si inspektor prane Inspektorati i Mbrojtjes se Territorit Bashkia Durres kam bërë verifikimin në terren dhe ka rezultuar së objekti ishte ekzistues në pronësi të pronarit Ardian Fadil Avdalli, i pajisur me çertefikatë pronësie për truallin dhe kërkesë për legalizim të objektite ndertuar mbi këtë truall. Neni 12 i Ligjit Nr.9780, date 16.07.2007 'Per Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndertimet e Kunderligjshme"i ndryshuar.Ushtrimi i kontrollit. Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kryeinspektorët/inspektorët kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrojnë kontroll në mjediset ku kryhet ndërtimi. Subjekti që kontrollohet (sipas rastit, investitori, projektuesi, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi, kolaudatori, prodhuesi i materialeve të ndërtimit) dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e ndërtimit janë të detyruar të ndihmojnë në kryerjen e kontrollit, si dhe në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Kryeinspektori/inspektori duhet të identifikohet me dokument zyrtar. Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Mbajtja e procesverbalit është e detyrueshme në çdo rast kontrolli dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar, kur ky i fundit është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar. Kur subjekti i kontrolluar nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin ose nuk është i pranishëm, ky fakt pasqyrohet në procesverbal dhe i jepet një kopje e procesverbalit brenda 5 ditëve nga data e kontrollit. Nëse identiteti dhe adresa e subjektit të kontrolluar nuk dihen, një kopje e procesverbalit të konstatimit afishohet për 10 ditë në vendpublikimet e bashkisë/komunës/qarkut përkatës dhe në kantierin e ndërtimit. Me kalimin e këtij afati, vlerësohet se subjekti i kontrolluar është njoftuar për rezultatin e kontrollit. Nenin 14/2 i ligjit nr.10279date 20.05.2010 "Per Kundravajtje Administrative" ku thuhet "Në rastet kur kundërvajtësi kundërshton nënshkrimin e procesverba lit, ky fakt evidentohet në atë procesverbal."V.K.M Nr.894,date 04.11.2015 "Per unifikimin e procedurave te kontrrollit te territorit nga Inspektorati Kombetare i Mbrojtjes se Territorit dhe ai i Njesise Vendore"; Bashkengjitur fotokopje dokumentacioni përkatës.*

-Kërkese për legalizim të ndertimit pa leje

-Kartele e pasurise së paluajtshme"

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve të ndërtimit, në rrugën Vath Turja, Durrës, janë evidentuar ndërtimi i disa strukturave në funksion shërbimi, të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi ose deklaratë paraprake punimesh. Gjithashtu edhe nga dokumentacioni që keni vendosur në dispozicion, përkatësisht të kërkesës për legalizimin e ndërtimit pa leje ndërtimi, qartësohet që objekti është ndërtuar pa u pajisur me leje ndërtimi. Në bazë të nenit 51, të Ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, në pikën 1 përcaktohet që: "Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji."Në bazë të ligjit Nr. 9780 përcaktohet se është detyrë funksionale e inspektorëve dhe e kryeinspektorit për kontrollin e ndërtimeve në territorin e Bashkisë Durrës dhe për zbatimin e ndërtimive sipas projekteve të miratuara në lejen e ndërtimit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Godinë Banimi dhe Shërbimi 2-4 dhe 6 Kate me 1 Kat Nëntokë", miratuar me vendimin Nr. 3004, datë 10/03/2022, me zhvillues "K. K. 2003", në adresën lagjia 6, Rruga "Aleksander Goga ", Durrës, inspektori i imt-së G. H. shprehet se:*"Subjekti "K. K. 2003" eshte pajisur me leje për ndryshimin e projektit gjate ndertimit me nr.957, dt 01.09.2020. Gjithashtu referuar volumeve anesore të cilat jane me konstruksione druri dhe metalike do meren masa në vijim."*

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se nga verifikimi në terren i objektit dhe nga foto ajrore, u konstatua që gjurma e ndërtimit nuk përputhet me planvendosjen e miratuar, duke tejkaluar kufirin e pronës. Për këtë devijim duhet të merreshin masa përpara miratimit të çertifikatës së përdorimit duke u bazuar në ligjin Nr. 9780, në të cilin përcaktohet që është detyrë funksionale e inspektorëve dhe e kryeinspektorit për kontrollin e ndërtimeve në territorin e Bashkisë Durrës dhe për zbatimin e ndërtimive sipas projekteve të miratuara në lejen e ndërtimit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë. Ndërsa në raport me volumet e shtuara të cilat nuk përkojnë me projektin e ndërtimit, ju shpreheni që do të merrni masa dhe do të jetë në vëmendje gjatë procesit të auditimeve të ardhshme.

Pretendimet e subjektit:
Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt: "Rikonstruksion dhe ndryshim funksioni të godinës banimi dhe shërbimi 6 kat mbi tokë dhe një kat nëntokë", miratuar me vendimin Nr.2763, datë 26/01/2022, me zhvillues Shoqeria I.-F., në adresën lagjia 14, Shkozet, Durrës, inspektori i imt-së A. H. shprehet se: "Në zbatim të detyrave funksionale të ngarkuara nga *ligji Nr.9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar* VKM-së 894 date 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit dhe ai i njesise vendore" si dhe VKM Nr.408/2015 "Për miratimin ë rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar. Në mbeshtetje të neneve dhe 39 të ligjit 107 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar* si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tyre, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit."

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, nuk paraqiten argumente dhe fakte që kundërshtojnë problematikat e ngritura nga grupi i auditimit.Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtës së Territorit

-Për periudhën janar-dhjetor 2022 nga Inspektoret e Inspektoratit të Mbrojtjes të Territorin në Bashkinë Durrës, ***janë proceduar gjithsej 154 subjekte*** për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit të pa shoqëruara të gjitha me Vendim për "Prishje të Objektit të Kundërligjshëm" dhe me Vendim për "Dënim me Gjobë" në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
-Në 35 raste edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, ***nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm"*** në kundërshtim me nenin 5 pika "d" dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
-Në 34 raste, edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, ***nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë",*** në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
-Në 94 raste, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektit të Kundërligjshëm", që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishje**.** vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Durrës, duke u bërë shakatarë i rritjes së numrit të ndërtimeve informale që kalojnë në procesin e legalizimit, ku subjektet kanë përfituar parcela ndërtimore në pronësi

publike, në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" dhe nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe në kundërshtim me nenin 52 pika 6 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.

-Në 9 raste, nga inspektoret e ngarkuar për zbatimin e procedurave për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm nuk janë prishur me justifikimin se "*…mjeti tip ekskavator nuk mund të përshkoj distancën mbi 5 m për shkak se çdo defekt që mund ti ndodhi gjatë rrugëtimit të gjatë mund të nxjerrë mjetin jashtë përdorimit"*, që do të thotë se të gjitha objektet që janë për prishje mbi 5 km nuk janë të ekzekutueshëm nga IMT-ja e Bashkisë Durrës.

-Në 17 raste nga Kryeinspektori nuk është bërë "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Institucioneve ligj zbatuese, në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm.

-Në 7 raste nga IMT-ja e Bashkisë Durrës është punuar me dy standarde në lidhje më kallëzimet penale të dërguara në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, në vende që të dërgohen për kallëzim penal subjekte që kanë kryerja e punimeve pa leje ndërtimi për banesa apo lokale sherbimi, janë referuar subjekte për kallëzim penale për ndërtime të mureve rrethues apo vendosje porte hyrëse në banese.

-Në lidhje me ekzekutimin e dënimit me gjobë rezultoi se janë gjithsej 117 vendime nga 154 procedime të kryera, me një shumë totale për tu arkëtuar 22,570,000 lekë, nga këto janë ekzekutuar (arkëtuar) vetëm 46 vendime në një vlerë prej 5,170,000 lekë e përkthyer në përqindje rrethe 23%, ndërsa 71 vendime të tjera janë të pa paguara nga subjektet, në një vlerë prej 17,400,000 lekë.

-Në 10 raste nga IMT-ja janë vendosur "Për Dënimin me Gjobë" për ndërtime pa leje në shuma minimale, në kundërshtim me nenin 52 shkronja "e" të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.

-Në 34 raste nga Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës nuk është vijuar më vendim "Dënim me Gjobë" që do të thotë se nga IMT-ja është punuar me dy standarde në lidhje më vendimin e dënimit me gjobë.

-Në të gjitha rastet nga IMT-ja, arkëtimin e shumave të detyrimeve, nuk është shoqëruar me kamatë vonesë bazuar në masën e gjobës, në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar.

-Në të gjitha rastet nga Zyra Përmbarimore Durrës, edhe pse ka kaluar afati 10 ditor i ekzekutimit vullnetar i ekzekutimit për shlyerjen e detyrimit nga debitori, nuk është vijuar me nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit të detyrueshëm, që do të thotë se përformanca në arkëtimin e detyrimeve ndaj debitorëve nga Zyra Përmbarimore Durrës është shumë e dobët (ku deri në periudhën e auditimit rezulton të mos jetë ekzekutuar asnjë rast nga zyra përmbarimore).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar me zgjedhje i procedurave të ndjekura nga IMTV-ja për inspektimin e bërë në terren në lidhje me ndërtimet in formalë të ndërtuar pa leje ndërtimi si dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit rezultoi:

Dosja e subjektit Sh. Sh.:

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 17.01.2022 nga Inspektoret **A. Gj. dhe A. H.,** në subjektin **Sh. Sh.** me adresë Lagjja nr. 15, Rr.'Miqësia', rrethë rrotullimi i 'Shena Vlashit', është konstatuar kryerja e punimeve pa leje ndërtimi, i ngritur me armatur kollona dhe tra, shtrim solete me mbajtese puntela/h për mbulesen e objektit me soletë (në fazen e pa hedhur betoni) e shoqëruar me fotot e objektit pa leje ndërtimi.

Nga inspektoret e terrenit të IMTV-së me datë 17.01.2022 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 18.01.2022 inspektoret e terrenit kanë përgatitur relacion ku janë drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore.

Me datë 24.01.2022 nga inspektoret është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën ***prej 200,000 lekë*** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, ku edhe pse ky vendim është dërguar subjektit, përsëri ky i fundit nuk e ka shlyer gjobën në shumën prej 200,000 lekë.
Me datë 24.01.2022 nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm, edhe pse kan kaluar afatet e prishjes vullnetar nga ana e subjektit, nga IMT-ja nuk ka pasur një bashkëpunim me institucionet ligj zbatuese për të bërë të mundur ekzekutimin prishjen e objektit të kundërligjshëm.
Mungon Urdhri Ekzekutimit nga Kryeinspektori për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhëri duhet të ngarkohen inspektoret e IMT-së, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
Në dosje mungon e administruar njoftimi "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, Policisë Bashkiake, Njësisë Administrative, Ndërmarrjes së Shërbimit Komunal "Për mbështetje me mjetet e ndryshme" për të bërë të mundur ekzekutimin e këtij vendimi.
Mungon procesverbali ***i ekzekutimit të objektit*** në subjekt në adresë Lagjja nr. 15, Rr.'Miqësia', rrathë rrotullimi i 'Shena Vlashit' për prishjen e shtesës pa leje ndërtimi.

Konkluzion:
-Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm*** në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe në kundërshtim me nenin 52 pika 6 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.
-Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës edhe pse ka konstatuar se subjekti ka konsumuar të gjithë elementet e veprës penale të parashikuar në kodin penal, nuk është përgatitur dosja për të vijuar me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit **Sh. Sh.** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi kur vepra penale cenonë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimit, neni 199/a "Ndërtimi i paligjshëm".

Dosja e subjektit L.M. Me.:
Nga inspektimi i bërë me datë 19.01.2022 në terren nga Inspektoret **G. H.dhe A. Gj.**, në subjektin **L.M. M.** me adresë Lagjia "Akaçe", Kullë, Njësia Adm. Sukth, është konstatuar kryerja e punimeve pa leje ndërtimi, ***objekt 1kat*** me plate betoni, kolona/betoni, mure/tulle, fitila/h, armatur/drase puntela/hekuri, materiale inerte e guri, në ndërtim e sipër.
Nga inspektoret e terrenit të IMT me datë 19.01.2022 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, pas një dite është bërë edhe relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore.
Në dosje janë të administruar edhe fotot e objektit pa leje ndërtimi.
Me datë 24.01.2022 nga inspektoret e terrenit është vendosur edhe dënimi me gjobë në shumën ***prej 500,000 lekë*** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, e cila është shlyer nga subjekti me datë 07.02.2022.
Me datë 24.01.2022 nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyrë vullnetare të objektit të kundërligjshëm edhe pse kan kaluar afatet e prishjes vullnetar, ***nga ana e IMT-së nuk është vijuar*** ndërhyrja për ekzekutimin e këtij vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës me datë 07.02.2022 është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Durrës me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit **L.M. M.**, duke parashtruar të gjithë elementet e veprës penale të parashikuar në nenin 193/a të Kodit Penal.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm*** në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Dosja e subjektit D. Z. B.:

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 21.02.2022 nga Inspektoret **G.H. dhe A.Gj.**, në subjektin D. Z. B. me adresë Lagjia. 15, Rr.'Shen Pali', Portoromano, është konstatuar kryerja e punimeve pa leje ndërtimi (plate/betoni, mure ndarëse/tulle, kollona/drase e mbules/drase) e shoqëruar me fotot e objektit pa leje ndërtimi.

Nga inspektoret e terrenit të IMTV me datë 21.02.2022 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi,

Proces-verbali datë 21.02.2022 i mbajtur nga inspektoret **G. H. dhe A. Gj.** për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi ***nuk është shoqëruar me vendim për dënimin me gjobë*** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi edhe pse sipas fotove të administruara në dosje, objekti pothuajse është e ngritur plotësisht në strukturë, në kundërshtim me nenin 52 shkronja "e" të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.

Neni 52 Kundërvajtjet administrative.
e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera;

Me datë 21.02.2022 nga inspektoret është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore ***pa përcaktuar më parë dënimin me gjobë*** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 24.02.2022 nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Me datë 25.02.2022 nga Kryeinspektori është bërë "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, Policisë Bashkiake, Ndërmarrjes së Shërbimit Komunal "Për mbështetje me mjetet e ndryshme për të bërë të mundur ekzekutimin e këtij vendimi", Njësisë Administrative etj., që do të thotë se nga ana e IMT-së është vijuar ndërhyrja për ekzekutimin e këtij vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm.

Me datë 28.02.2022 nga Kryeinspektori është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku ngarkohet për ekzekutimin e këtij urdhëri 3 inspektoret e IMT-së.

Me datë 28.02.2022 nga 2 inspektoret e IMT-së në praninë e inspektorit të Policisë Bashkiake është mbajtur procesverbali i ekzekutimit të objektit pa leje në emër të subjektit D. Z. B. me adresë Lagjia. 15, Rr.'Shen Pali', Porto Romano, për prishjen e objektit pa leje, i shoqëruar me fotot e objektit të prishur, e cila është e administruar në dosjen e subjektit.

Konkluzion:

-Nga inspektoret e terrenit **G. H. dhe A. Gj.** edhe pse kanë konstatuar se subjekti D. Z.B. me adresë Lagjia. 15, Rr.'Shen Pali', Porto Romano, ka kryer punimeve pa leje ndërtimi (plate/betoni, mure ndarese/tulle, kollona/drase e mbules/drase) ***nuk është vendosur dënim me gjobë*** në shumën deri në 500,000 lekë për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, në kundërshtim me nenin 52 shkronja "e" të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.

-Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Durrës me kallzim penal në ngarkim të shtetasit **D. Z.B.**, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Dosja e subjektit E. M. M.:

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 04.03.2022 nga Inspektoret **K. L. dhe G. H.**, në subjektin Engjellushe Muharrem Mata me adresë: Lagje nr. 15, Rr.''A. Goga", Porto Romano, është konstatuar kryerja e punimeve pa leje ndërtimi (armatur/drase, puntela/hekuri) mbi katin përdhe që është edhe kjo pa leje ndërtimi.

Sipas fotove të administruar në dosjen e subjektit konstatohet se objekti pa leje ndërtimi ka përfunduar katin përdhe dhe është në vazhdim për ngritjen e katit të parë ku sipas fotove kanë mbaruar kolonat dhe vijojnë me shtrimin e soletës, që do të thotë se nga inspektoret e terrenit nuk janë të përshkruara shkeljet e konstatuara në objektin pa leje.

Nga inspektoret e terrenit të IMTV me datë 04.03.2022 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 07.03.2022 nga inspektoret është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 04.03.2022 nga inspektoret e terrenit është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej ***50,000 lekë*** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim nuk është shlyer nga subjekti.

-Vendimi "Për Dënimin me Gjobë" prej 50,000 lekë i vendosur nga inspektoret e terrenit është minimal dhe është në kundërshtim me nenin 52 shkronja "e" të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.

Neni 52 Kundërvajtjet administrative.
e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera;

Me datë 09.03.2022 nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm edhe pse kane kaluar afatet e prishjes vullnetar, ***nga ana e IMT-së nuk është vijuar*** procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm.

Në dosje mungon "Kërkesë për mbështetje" nga Kryeinspektori i IMT-së, drejtuar Institucioneve ligj zbatuese

Me datë 27.09.2022 është bërë kërkesë Zyrës Përmbarimore Durrës për zbatimin e Urdhrit të Ekzekutimit të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës për ekzekutimin e gjobës në shumën prej 50,000 lekë, e cila akoma nuk është ekzekutuar nga kjo e fundit.

Konkluzion:

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm*** në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Vendimi "Për Dënimin me Gjobë" prej 50,000 lekë i vendosur nga inspektoret e terrenit është minimal, në kundërshtim me nenin 52 shkronja "e" të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.

-Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Durrës me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit **E. M.M.**, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 193/a të Kodit Penal.

Dosja e subjektit A.V. K.:

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 15.03.2022 nga Inspektoret **A. H.dhe K.L.**, në subjektin A.V. K. me adresë: Shkëmbi i Kavajes, Perbri hotel 'K.', është konstatuar kryerja e punimeve pa leje ndërtimi, tende me trar/drase kollona/drase mbulese/ristela drase,, pllaka/betoni trotuari të levizshme, e shoqëruar me fotot e objektit.

Nga inspektoret e terrenit të IMTV me datë 15.03.2022 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.
Me datë 15.03.2022 nga inspektoret është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.
Me datë 18.03.2022 nga inspektoret e terrenit është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej ***50,000 lekë*** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim nuk është shlyer nga subjekti.
Me datë 18.03.2022 nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm edhe pse kan kaluar afatet e prishjes vullnetar, nga ana e IMT-së nuk është vijuar ndërhyrja për ekzekutimin e këtij vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm konform kompetencave që i jep ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, neni 5.
Në dosje mungon "Kërkesë për mbështetje" nga Kryeinspektori i IMT-së, drejtuar Institucioneve ligj zbatuese.
Me datë 03.07.2022 është bërë kërkesë Zyrës Përmbarimore Durrës për zbatimin e Urdhërit të Ekzekutimit të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës për ekzekutimin e gjobës në shumën prej 50,000 lekë.
Në dosje mungon e administruar Urdhëri i Ekzekutimit i nxjerrë nga Kryeinspektori për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhëri ngarkohen inspektoret e IMT-së.
Mungon procesverbali i ekzekutimit të objektit pa leje në emër të subjektit.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm*** në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Dosja e subjektit P. A. :
Nga inspektimi i bërë në terren me datë 17.03.2022 nga Inspektoret **K.L. dhe G. H.**, në subjektin P. A.me adresë: Hamallaj, Hidrovor. Njesia Adm. Sukth, është konstatuar kryerja e punimeve pa leje ndërtimi shtese/ans, kollona/b, trar/b, mur/rreth brez/b e kollona, ***e pa shoqëruar me fotot e objektit.***
Nga inspektoret e terrenit të IMTV-së me datë 17.03.2022 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.
Me datë 17.03.2022 nga inspektoret është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.
Me datë 23.03.2022 nga inspektoret e terrenit është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej ***100,000 lekë*** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim nuk është shlyer nga subjekti.
Me datë 23.03.2022 nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.
Me datë 23.03.2022 nga Kryeinspektori është nxjerrë Urdhëri i Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhëri janë ngarkuar inspektoret e IMT-së.
Me datë 23.03.2022 nga Kryeinspektori është bërë "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Institucioneve ligj zbatuese.
Mungon procesverbali i ekzekutimit të objektit pa leje në emer të subjektit.
Me datë 03.07.2022 është bërë kërkesë Zyrës Përmbarimore Durrës për zbatimin e Urdhërit të Ekzekutimit të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës për ekzekutimin e gjobës në shumën prej 100,000 lekë.

Konkluzion:
-Nga ana e IMT-së Bashkia Durrës ***nuk është vijuar ndërhyrja për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm,*** në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
-Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Durrës me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit P. A., për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 193/a të Kodit Penal.

Dosja e subjektit Myrvete Halilaj:
Nga inspektimi i bërë në terren me datë 17.03.2022 nga Inspektoret **K.L. dhe G. H.**, në subjektin M. H. me adresë: Hamallaj, Hidrovor. Njesia Adm. Sukth, është konstatuar kryerja e punimeve pa leje ndërtimi objekt 1kat plus grazhd, themele/b, kollona/b, solete i shoqëruar me fotot e objektit.
Nga inspektoret e terrenit të IMTV-së me datë 17.03.2022 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.
Me datë 17.03.2022 nga inspektoret është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.
Me datë 23.03.2022 nga inspektoret e terrenit është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **500,000 lekë** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim nuk është shlyer nga subjekti.
Me datë 23.03.2022 nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.
Me datë 23.03.2022 nga Kryeinspektori është nxjerrë Urdhëri i Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhëri janë ngarkuar inspektoret e IMT-së.
Me datë 23.03.2022 nga Kryeinspektori është bërë "Kërkesë për mbeshtetje" drejtuar Institucioneve ligj zbatuese.
Në dosje nuk është e administruar procesverbali i ekzekutimit të objektit pa leje në emër të subjektit.
Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës me datë 30.03.2022 është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Durrës me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit **M.H.**, duke parashtruar të gjithë elementet e veprës penale të parashikuar në nenin 193/a të Kodit Penal.
Me datë 23.09.2022 është bërë kërkesë Zyrës Përmbarimore Durrës për zbatimin e Urdhërit të Ekzekutimit të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës për ekzekutimin e gjobës në shumën prej 500,000 lekë.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Durrës ***nuk është vijuar ndërhyrja për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm***, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Dosja e subjektit Mine Ismail Alla:
Nga inspektimi i bërë në terren me datë 23.03.2022 nga Inspektoret **S. M.dhe E. L.** në subjektin M. I. A. me adresë: Fshati Bize. Njesia Adm. Ishem, është konstatuar kryerja e punimeve pa leje ndërtimi, kollona/betoni, brez me blloqe/betoni, *e shoqëruar me fotot e objektit.*
Nga inspektoret e terrenit të IMTV-së me datë 23.03.2022 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.
Me datë 23.03.2022 nga inspektoret është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 28.03.2022 nga inspektoret e terrenit është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **300,000 lekë** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim nuk është shlyer nga subjekti.
Me datë 28.03.2022 nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyrë vullnetare të objektit të kundërligjshëm.
Me datë 28.03.2022 nga Kryeinspektori është bërë "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Institucioneve ligj zbatuese.
Me datë 06.04.2022 nga Kryeinspektori është nxjerrë Urdhëri i Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhëri janë ngarkuar inspektoret e IMT-së.
Me datë 06.04.2022 nga Inspektoret S. M. dhe E. L. është mbajtur procesverbali ***i mos ekzekutimit të objektit*** në subjekt në adresë: Fshati Bize. Njesia Adm. Ishem. ***Arsyja për mos Ekzekutimin e prishjes të objektit të kundërligjshëm sipas inspektorëve të terrenit është sepse mjeti tip ekskavator nuk mund të përshkoj distancën mbi 5 km për shkak se çdo defekt që mund ti ndodhi gjatë rrugëtimit të gjatë mund të nxjerrë mjetin jashtë përdorimit.***
Procesverbali datë 06.04.2022 ***është mbajtur pa prezencën*** e Policisë së Rendit, Policisë Bashkiake apo të një përfaqësuesi të Njësisë Administrative Ishëm.
Me datë 23.09.2022 është bërë kërkesë Zyrës Përmbarimore Durrës për zbatimin e Urdhërit të Ekzekutimit të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës për ekzekutimin e gjobës në shumën prej 300,000 lekë, që deri në datën e auditimit rezulton të mos jetë ekzekutuar nga zyra përmbarimore.

Konkluzion:
-Nga ana e IMT-së Bashkia Durrës nuk është vijuar ndërhyrja për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, por është justifikuar me arsyen se objekti pa leje ndërtimi ka një distancë mbi 5 km dhe nuk mund të ndërhyhet, veprime këto në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
-Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Durrës me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit **M. I. A.**, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 193/a të Kodit Penal.

Dosja e subjektit F. G.:
Nga inspektimi i bërë në terren me datë 25.03.2022 nga Inspektoret **G. H. dhe A.H.**në subjektin F. G. me adresë: Lagjia nr. 6, Rr.'Dëshmorët', është konstatuar vendosje tendë dielli me profile metalik pa leje përkatëse, *e shoqëruar me fotot e objektit.*
Nga inspektoret e terrenit të IMTV-së me datë 25.03.2022 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi por ***nuk është vendosur dënimi me gjobë*** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, në kundërshtim me nenin 52 të ligjit ligj nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar.

Neni 52 Kundërvajtjet administrative
d) mos deklarimi i punimeve që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje, sipas nenit 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 150 000 lekë;

Me datë 25.03.2022 nga inspektoret është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.
Me datë 30.03.2022 nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje të objektit.
Mungon Urdhëri i Ekzekutimit nga Kryeinspektori për prishjen e objektit të kundërligjshëm, që do të thotë se objekti nuk është prishur.

Konkluzion:
-Nga inspektoret e terrenit nuk është vendosur dënimi me gjobë për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, në kundërshtim me nenin 5 pika "b" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhërit t Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar..

Dosja e subjektit M. D.:
Nga inspektimi i bërë në terren me datë 28.03.2022 nga Inspektoret **A. H. dhe G. H.** në subjektin M.D. me adresë: Fshati Hamallaj, Njesia Adm. Sukth, është konstatuar ndërtim 1 katë të përfunduar pa leje ndërtimi, *e shoqëruar me fotot e objektit.*
Nga inspektoret e terrenit të IMTV-së me datë 28.03.2022 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi pa prezencën e subjektit.
Me datë 28.03.2022 nga inspektoret është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.
Me datë 31.03.2022 nga inspektoret e terrenit është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **500,000 lekë** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, e cila është njoftuar me anë të afishimit në objektin pa leje ndërtimi.
Me datë 31.03.2022 nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyrë vullnetare të objektit të kundërligjshëm. (Me afishim)
Me datë 01.04.2022 nga Kryeinspektori është bërë "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Institucioneve ligj zbatuese.
Mungon i administruar në dosje Urdhëri i Ekzekutimit nga Kryeinspektori për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhëri duhet të ngarkohen inspektoret e IMT-së, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar..
Mungon procesverbali ***i ekzekutimit të objektit*** në subjekt në adresë Fshati Hamallaj, Njësia Adm. Sukth, për ndërtimin e objektit 1 katë pa leje ndërtimi.
Me datë 26.09.2022 është bërë kërkesë Zyrës Përmbarimore Durrës për zbatimin e Urdhërit të Ekzekutimit të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës për ekzekutimin e gjobës në shumën prej 500,000 lekë, që deri në datën e auditimit rezulton të mos jetë ekzekutuar nga zyra përmbarimore.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Durrës ***nuk është vijuar ndërhyrja për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm***, në kundërshtim me neni 5/d i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Dosja e subjektit R. K.:
Nga inspektimi i bërë në terren me datë 28.03.2022 nga Inspektoret **K.L. dhe A.Gj.** në subjektin **R. K.** me adresë: Lagjia nr. 13, Rr.'Pavarsia', Plazh, është konstatuar ndarje e mureve te brendshme mur/tulle, suvatime, zëvendësim dritareve, e shoqëruar me fotot e objektit.
Nga inspektoret e terrenit të IMTV-së me datë 28.03.2022 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje, duke ***vendosur dënimi me gjobë*** në masën e ***50 000 lekë.***
Me datë 28.03.2022 nga inspektoret është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje.
Me datë 31.03.2022 nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje të objektit.

Me datë 01.04.2022 nga Kryeinspektori është bërë "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Institucioneve ligj zbatuese.
Me datë 07.04.2022 nga Kryeinspektori është nxjerrë Urdhëri i Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm (por muret ndarëse etj. nuk janë prishur).
Me datë 07.04.2022 nga Inspektoret K. L. dhe A. G. është mbajtur procesverbali i mos ekzekutimit të objektit. ***Arsyeja për mos Ekzekutimin e prishjes të objektit të kundërligjshëm sipas inspektorëve të terrenit është sepse objekti ndodhet në katë të 2 dhe mjeti tip ekskavator nuk mund të arrije.***
Me datë 29.09.2022 është bërë kërkesë Zyrës Përmbarimore Durrës për zbatimin e Urdhërit të Ekzekutimit të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës për ekzekutimin e gjobës në shumën prej 50,000 lekë, që deri në datën e auditimit rezulton të mos jetë ekzekutuar nga zyra përmbarimore.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Durrës ***nuk është vijuar ndërhyrja*** për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, por është justifikuar me arsyen se objekti pa leje ndërtimi ***ndodhet në katë të 2 dhe se mjeti tip ekskavator nuk mund të arrije***, veprime këto në kundërshtim me nenin 5/d të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Dosja e subjektit Q. D. D.:
Nga inspektimi i bërë në terren me datë 14.04.2022 nga Inspektoret **G.H. dhe A. Gj.** në subjektin Q.D. D. me adresë: Lagjia nr. 16/1, Rr. "Vllazerimi", është konstatuar kollona/betoni, solet/betoni, puntela/hekuri, ermatur/druri, midis 2 objekteve ekzistuese (objekti është në ndërtim), e shoqëruar me fotot e objektit.
Situata: Nga Kryeinspektori i IMT-së e Bashkisë Durrës është nxjerrë "Urdhëri i Ekzekutimit" për prishjen e objektit të kundërligjshëm, por nuk është vijuar prishja e objektit me justifikimin se "*…mjeti tip ekskavator nuk mund të përshkoj distancën mbi 5 km për shkak se çdo defekt që mund ti ndodhi gjatë rrugëtimit të gjatë mund të nxjerrë mjetin jashtë përdorimit"*, që do të thotë se të gjitha objektet që janë për prishje mbi 5 km nuk janë të ekzekutueshëm nga IMT-ja e Bashkisë Durrës, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, nenin 5 pika "d".
Shkaku: Mos ekzekutimi i prishjes i objekteve të kundërligjshëm.
Ndikimi: Ndërtime in formalë të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe zaptime në prona publike.
Rëndësia: I lartë.

Titulli i Gjetjes: Nga Kryeinspektori i IMT-së në 20 raste nuk është bërë "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Institucioneve ligj zbatuese, në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm.
Situata: Nga Kryeinspektori i IMT-së e Bashkisë Durrës edhe pse ka nxjerrë "Urdhër Ekzekutimi" për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nuk ka bërë "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Institucioneve ligj zbatuese, në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, nenin 6.
Shkaku: Mos kërkesë për mbështetje.
Ndikimi: Mos ekzekutim për prishjen e objektit të kundërligjshëm.
Rëndësia: I mesëm.

Titulli i Gjetjes: Nga IMT-ja në 30 raste nuk është vijuar me kallëzim penal për subjektet ndërtuese.
Situata: Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës është punuar me dy standarde në lidhje më kallëzimet penale të dërguara në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, në vend që të dërgohen për kallëzim penal subjekte që kanë kryerja e punimeve pa leje ndërtimi për banesa apo lokale shërbimi, janë referuar subjekte për kallëzim penale për ndërtime të mureve rrethues apo vendosje porte hyrëse në banese, në kundërshtim me nenin 5 pika "dh" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, nenin 5 pika "dh" .
Shkaku: Mos referimi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.
Ndikimi: Ndërtime in formalë të ndërtuar pa leje ndërtimi.

Rëndësia: I mesëm.

Titulli i Gjetjes: Në 71 vendime "Për Dënimin me Gjobë" nuk janë paguar gjobat nga subjektet, në një vlerë prej 17,400,000 lekë.
Situata: Nga zyrës përmbarimore nuk është vijuar ekzekutimi i detyrueshëm për shlyerjen e detyrimit nga debitori konformë nenit 606 të K.Pr.Civile që do të thotë se IKM-ja nuk ka një korrespondence me zyrat përmbarimore për të verifikuar ecurinë e ekzekutimit për shlyerjen e detyrimit nga debitorët.
Kriteri: Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile" i ndryshuar, nenin 519 "Fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm".
Shkaku: Mos vijimi i ekzekutimit të detyrueshëm për shlyerjen e detyrimit nga debitori nga zyra përmbarimore.
Ndikimi: Mungesa e të ardhurave në buxhetin e Bashkisë në vlerë prej 17,400,000 lekë.
Rëndësia: I lartë.

Titulli i Gjetjes: Nga IMT-ja nuk është kërkuar kamatë vonesë bazuar në masën e gjobës.
Situata: Në 31 raste kur nga IMT-ja është bërë kërkesë Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Durrës për nxjerrjen e "Urdhrit të Ekzekutimit" për arkëtimin e shumave të detyrimeve, nuk është kërkuar kamatë vonesë bazuar në masën e gjobës, në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar.
Kriteri: Ligji nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar nenin 30.
Shkaku: Mungesa e kamatë vonesë bazuar në masën e gjobës.
Ndikimi: Mungesa e të ardhurave në buxhetin e Bashkisë nga kamatë vonesat bazuar në masën e gjobës.
Rëndësia: I mesëm.

Për sa është trajtuar ne këtë pjesë të Raportit Përfundimtar té Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 765/11 prot., datë 17.01.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga Z. D. M., me detyrë Kryeinspektor i IMT-së dhe Inspektoret G. H., A. Gj. S.M. dhe E.L., me detyrë Inspektorë pranë IMT-së Bashkia Durrës, janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
-Në shumicën e gjetjeve tuaja referuar akt–konstatimit nr.3, konkretisht pikat e para , ju citoni se 82 vendime nuk është vijuar procedura për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
-Gjithashtu cilësoni se disa raste nga inspektoret e ngarkuar për zbatimin e procedurave për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm nuk janë prishur me justifikimin se "…mjeti tip ekskavator nuk mund të përshkoj distancën mbi 5 km për shkak se çdo direkt që mund ti ndodhi gjatë rrugëtimit të gjatë mund të nxjerrë mjetin jashtë përdorimit", që do të thotë se të gjitha objektet që janë për prishje mbi 5 km nuk janë të ekzekutueshëm nga IMT-ja e Bashkisë Durrës.
Ju sqarojmë se:
-Gjithashtu cilësoni se disa raste nga inspektoret e ngarkuar për zbatimin e procedurave për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm nuk janë prishur me justifikimin se "…mjeti tip ekskavator nuk mund të përshkoj distancën mbi 5 km për shkak se çdo divekt që mund ti ndodhi gjatë rrugëtimit të gjatë mund të nxjerrë mjetin jashtë përdorimit", që do të thotë se të gjitha objektet që janë për prishje mbi 5 km nuk janë të ekzekutueshëm nga IMT-ja e Bashkisë Durrës.
Referuar pikave 1,2,3 dhe 4, lidhur me arsyet e mos-ekzekutimit të vendimeve për prishje të objekteve të kundërligjshme që (IMT- nuk ka ekzekutuar vendimet e prishjes me "justifikimin" se "Mjeti tip ekskavator nuk mund të përshkojë distancën mbi 5 km etj...") ju bëjmë me dije se:
Për sa kohe nga Kryeinspektori i IMT-së është bërë njoftim për prishjen e objektit të kundërligjshëm, në zbatim të detyrave funksionale të ngarkuara nga ligji, për të ndërhyrë për ekzekutim e "atyre vendimeve që është bërë planifikimi për prishje" është nxjerre urdhër ekzekutimi si dhe për keto raste

është kërkuar mbështetje Komisariatit të Policisë Durrës, Policisë Bashkiake Ndërmarrjes së Shërbimit Komunal Durrës dhe Njësive Administrative Durrës kjo e pasqyruar me shkresat përkatëse të ju kemi vënë në dispozicion në tabelat ë procedurave.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se observacioni nuk merret në konsideratë pretendimi i subjektit të audituar për faktin së mos ekzekutimi i vendimeve për prishjes nuk mund të "justifikohet" se "Mjeti tip ekskavator nuk mund të përshkoje distancën mbi 5 km", për sa kohe ka pas raste që ekskavatori ka përshkruar distanca edhe mbi 5 km.

Pretendimi i subjektit:

-Për sa i përket gjetjes nga KLSH në dosjen e shtetasit M. T.dhe A. Sh. A. lidhur me kallëzimin penal që nuk është referuar nga Inspektorati i Mbrojtjes se Territorit Bashkia Durrës, ku dhe është përdorur termi me dy standarde.

Ju bëjmë me dije për kundërvajtësit e cituar me lart është referuar kallëzimi penal nga Policia pranë organit të Prokurorisë Durrës, për sa kohe policia Shtetit ka referuar kallëzim penal për ndërtim të pa ligjshëm, njofton Inspektoratin e Mbrojtjes se Territorit Bashkia Durrës e cila mban proceduren ligjore për kundërvajtjen përkatëse vendim prishje dhe vendim denimi me gjobe.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se observacioni nuk merret në konsideratë pretendimi i subjektit të audituar për faktin së subjekti i audituar, pretendimet e paraqitura nuk i ka shoqëruar me dokument shkresor që të provoje Drejtoria e Policisë Durrës ka referuar kallëzimi penal.

Pretendimi i subjektit:

Nisur nga fakti dhe gjetjet qe KLSH ka dale ne konkluzion sqarojmë se, pretendimet janë të pa mbështetura në prova qe IMT ka depozituar si dhe rruga e ndjekur nga Inspektorati i Mbrojtjes se Territorit Bashkia Durrës është tërësisht e mbështetur në ligj.

-Për procedurat 34 raste që nuk është vijuar me vendim për dënimin me gjobë, lidhur me gjetje tuaj,

Sqarojmë se :

Bazuar ne *piken 13, kreu I, te vendimit nr.7, datë 06.01.2020, të Këshillit te Ministrave" Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit", i ndryshuar,* Ju njoftojmë se:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit Bazuar *ne piken 5, të Vendimit nr.7, datë 06.01.2020, të Këshillit të ministrave, i ndryshuar*, me shkresën nr.2771prot., datë 16.09.2022 protokolluar në Agjencia Shtetërore për Shpronësim (ASHSH) ka kërkuar shpronësimin dhe /ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim Bashkia Durrës, Rikonstruksion i rrugëve' 'Miqësia" dhe" Azem Hajdari", Loti III- Rruga "Azem Hajdari", Rruga "Vala Deti" Rruga 'Apulja' ''Kashta e Kumrit', ''Rruga Shkumbini".

Nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve Bashkia Durrës është dërguar njoftim për shpronësim dhe/ose për shkëmbim të pronës, për interes publik,

Për sa më sipër,

Sqarojmë se për të gjitha ato objekte që nuk është vijuar me vendim për dënimin me gjobë objekti i konstatuar i kundërligjshëm është ne zbatim te projektit të bashkisë për tu prishur, si dhe disa prej rasteve te cilat nuk janë pjese e këtij projekti/plani të bashkisë ka rezultuar që këto objekte janë të skualifikuara nga ASHK Durrës.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se observacioni nuk merret në konsideratë pretendimi i subjektit të audituar për faktin së subjekti i audituar, pretendimet e paraqitura nuk i ka shoqëruar me dokument justifikues (listën emërore të skualifikuara nga DV ASHK Durrës si dhe listën emërore të Agjencia Shtetërore për Shpronësim).

Pretendimi i subjektit:

-Lidhur me kërkesat e bëra pranë Zyrës Përmbarimore dhe korrespondencës të mbajtur nga ana jone, sqarojmë se gjate kërkesave të bëra nga IMT drejtuar Zyrës Përmbarimit kemi hasur problematika të vazhdueshme të gjeneraliteteva/të dhënave/lagjeve të subjekteve të dënuar me vendim gjobe.

IMT në momentin qe do të vihen në dispozicion saktësimi i dokumentacioneve, konfirmimit te adresave, gjeneraliteteve, afishimeve dhe konfirmimit nga Shërbimi postar zyrtar, do të beje të mundur ndjekjen e procedurës konformë ligjit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se observacioni merret në konsideratë pretendimi i subjektit të audituar për faktin së subjekti i audituar ka bashkangjitur kërkesat, nr. 734 prot datë 08.05.2023 "Kërkim informacioni", nr.1730 prot., datë 09.11.2023, Kthim përgjigje nr. 1730/1 prot., datë 13.11.2023, nr. 1755 prot., datë 14.11.2023 Kërkese për informacion, nr. 1555/1prot., datë 20.11.2023 Kthim përgjigje.

2.7 Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Mbi verifikimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civil në detyrë në lidhje me ankesat e ardhura nga qytetarët në KLSH.

I. *Ankesa e shtetasit K.K , me nr.587/3 prot., datë 20.09.2023 në KLSH, me objekt "Vënie në dijeni për moszbatim të Vendimit Gjyqësor të Formës së Prerë dhe Rekomandimit të Avokatit të Popullit për marrjen e masave".*

Grupi i auditimit u njoh me problemin dhe hapat e procedurës së ndjekur nga shtetasi K.K nëpërmjet dokumentacionit bashkëngjitur kërkesës të tij, të cilat janë:

-Vendimi nr. 169 datë 20.12.2010 të Komisionit të Shërbimit Civil për ankesën e z. K.K me objekt "Shfuqizimi i Vendimit nr. 5 datë 30.04.2010 të Kryetarit të Bashkisë Durrës, për dhënien e masës disiplinore largim nga shërbimi civil, rikthim në detyrën e mëparshme si dhe pagesën e plotë për periudhën e qëndrimit pa punë;

-Vendimi nr. 14 dhe nr. 07 Regj. Themeltar të Gjykatës së Apelit Durrës me paditës Bashkia Durrës dhe objekt "Shfuqizim i Vendimit të KSHC nr. 169 datë 20.12.2010";

-Vendimin nr. 7561 Akti të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë i shpallur më datë 21.12.2011, me objekt "Lëshimin e Urdhrit të ekzekutimit për Vendimin nr. 169 datë 20.12.2010 të Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi me Vendimin nr. 14 datë të Gjykatës së Apelit Durrës";

-Vendimi nr. 500 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për Kërkesën nga Bashkia Durrës me objekt "Pezullim i ekzekutimit të Vendimit nr. 169 datë 20.12.2010 të Komisionit të Shërbimit Civil si dhe Vendimin nr.14 datë 06.04.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës";

-Vendimi nr. 44 datë 01.03.2021 dhe nr. Regj. Them 184278/253/85 datë 14.11.2017 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Durrës për padi të z. V.D me objekt "Anulimi i Vendimit nr. 0451/15 prot., datë 04.10.2017 "Vendim gjobe në masën 50,000 lekë" të përmbaruesit gjyqësor";

-Vendimi nr. 404 datë 11.04.2022 me nr. regj. 2250/1344 datë 06.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për çështjen e paditur nga Bashkia Durrës me objekt "Deklarimin e shuarjes së detyrimit të paditësit Bashkia Durrës kundrejt të padituri K.K , lidhur me pjesën e mbetur të detyrimit sipas titullit ekzekutiv, Vendimit nr. 169 datë 20.12.2010 të Komisionit të Shërbimit Civil; Pezullimin e Vendimit nr. 169 datë 20.12.2010 të Komisionit të Shërbimit Civil";

-Vendimin nr. 554 datë 11.05.2022 me nr. Regj. Them 2044 datë 29.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me ankues Bashkia Durrës dhe objekt "Pezullimin e ekzekutimit të veprimeve përmbarimore; Anulimin e Urdhrit nr. 0451/39 prot., datë 19.04.2022 të Zyrës Përmbarimore Hoti Bailiff Service Durrës";

-Shkresën me nr. K-94/2 prot., datë 25.10.2021 e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatorë e Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë me objekt "Kthim përgjigje z. K.K ndaj pretendimit të tij për mosveprim të Përmbaruesit Gjyqësor L. H. për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore si dhe vënie në dijeni Përmbaruesit Gjyqësor Privat L. H.";

-Shkresën me nr. K3/K13-7 prot. datë 16.12.2021 të Avokatit të Popullit me objekt "Rekomandohet marrja e masave për ekzekutimin e Vendimit të Shërbimit Civil nr. 169 datë

20.12.2010, lënë në fuqi me Vendimin nr. 14, datë 06.04.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës (diferencën)";
-Shkresën me nr.4839/1 prot., datë 09.06.2022 me lëndë "Përgjigje shkresës tuaj datë 24.05.2022 protokolluar pranë Bashkisë Durrës me nr. 4839 prot., datë 27.05.2022"të Bashkisë Durrës drejtuar z. K.K ;
-Shkresën me nr.16968 prot., datë 12.11.2019 me lëndë "Shkresë për zbatimin e vendimeve të formës së prerë" të Drejtorisë Ligjore të Bashkisë;
-Shkresën me nr.7182/2 prot., datë 14.09.2017 me lëndë "Përgjigje tuaj ës me nr. 0451/13 prot., datë 14.09.2017" të Bashkisë Durrës drejtuar Shoqërisë Përmbarimore Private "H. B.S.".
Për ankesën e Z. K.K nga verifikimi rezultoi që:
Grupi i auditimit i kërkoi Drejtorisë Ligjore të Bashkisë Durrës një informacion të detajuar si dhe praktikën e çështjes (dokumentacionin përkatës)
Për Drejtorinë Ligjore, Zëvendëskryetari **z. E.J** na dha këtë informacion në rrugë elektronike datë 30.10.2023 dhe fizikisht praktikën fotokopje të njehsuar me origjinalin.
Lënda: Informacion lidhur me zbatimin e urdhrit të Ekzekutimit Nr. 7561, datë 21.12.2011 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor, Tiranë në favor të kreditorit K.K .
Lidhur me zbatimin e urdhrit të Ekzekutimit Nr. 7561, datë 21.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë në favor të kreditorit K.K , sqarojmë sa më poshtë vijon:
Me Vendimin nr. 169, datë 20.12.2010 Komisioni i Shërbimit Civil ka vendosur pranimin e ankesës së kërkuesit, Z. K. V. K., duke shpallur absolutisht të pavlefshëm vendimin nr.5, datë 30.04.2010 të Kryetarit të Bashkisë Durrës si të pa bazuar në procedurën e përcaktuar në ligj, duke vendosur:
-Rikthimin e ankuesit në detyrën e mëparshme, specialist në sektorin e Operatorëve pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;
-Kryerjen e pagesës së plotë të ankuesit, nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi.
Vendimi i sipërcituar është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 14, datë 06.04.2011.
Me Vendimin nr. 7561 Akti, datë 21.12.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë "Për Lëshimin e Titullit Ekzekutiv" është vendosur pranimi i kërkesës së kreditorit K.K për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit në zbatim të vendimeve të mësipërme.
Bashkia Durrës në zbatim të akteve të sipërcituara, ka likuiduar shumën totale prej 1'340'854 (një milion e treqind e dyzet mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër) lekë në favor të kreditorit K.K , për periudhën nga 30.04.2010 deri në datën 11.05.2012, periudhë e cila korrespondon me momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në shërbimin civil, deri në momentin e punësimit të tij po në administratën publike, bashkia Tiranë.
Pas likuidimit të shumës së mësipërme nga Shoqëria Përmbarimore Private "H. B.S." është pretenduar me shkresa të njëpasnjëshme që bashkia Durrës ka ende detyrim ndaj kreditorit K.K , ku citojmë se: Detyrimi i bashkisë Durrës rritet çdo muaj deri në momentin e ekzekutimit të plotë të titullit ekzekutiv, duke pretenduar në shkresën me Nr. 0451/28, datë 03.06.2021, Urdhër për përmbushje detyrimi se shuma deri në muajin maj të vitit 2021 në zbatim të titullit ekzekutiv në total është në masën 6'407'406 lekë.
Për të qenë korrekt me zbatimin e ligjit dhe për të mos keqpërdorur fondet publike, bashkia Durrës me shkresën nr. 7005 prot., datë 11.06.2021 i është drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtorisë Rajonale Durrës me anë të cilës ka kërkuar informacion lidhur me punësimin e shtetasit K. V.K. me NID I.....A.
Në përgjigje të saj, me shkresën nr.6914/1 Prot, datë 16.06.2021, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Durrës dhe me "Vërtetimin për Bazën e Vlerësuar" me Nr. 1766 Prot, datë 15.06.2021 ka konfirmuar se shtetasi K. V. K. për periudhën Maj 2012 – Mars 2016 ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Tiranë, dhe ne vijim e deri në muajin Maj 2021 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë.

Bashkia Durrës pretendon se detyrimi i saj në zbatim të vendimeve të sipërcituara është përmbushur me likuidimin e vlerës prej 1'340'854 (një milion e treqind e dyzet mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër) lekë në favor të kreditorit K.K , për periudhën nga 30.04.2010 deri në datën 11.05.2012, pra nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, deri në momentin e ri punësimit të tij në shërbimin civil. Në këto kushte, gjykojmë se detyrimi përtej kësaj vlere nuk ekziston, kjo falë fakteve të reja të ngjara pas daljes së vendimeve.
Zyra përmbarimore "H. B. S." ka ndjekur të gjitha hapat ligjore në përmbushje të detyrimit të pretenduar, deri në kallzimin penal ndaj shtetasit V.D në cilësinë e ishkryetarit të bashkisë Durrës, njëkohësisht edhe ndaj shtetases E.S në cilësinë e titullares së bashkisë Durrës, për veprën penale të "Pengimit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës" parashikuar në nenin 320 të KP.
Me vendimin e datës 07.07.2021 Prokuroria Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.
Nisur nga kjo, Zyra përmbarimore "H. B.S." i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesë, duke kundërshtuar vendimin e sipërcituar.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 427, datë 14.10.2021, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr. 10-2022-48 (10), datë 12.01.2022, ndër të tjera ka arsyetuar si më poshtë vijon:
4.3. Kërkesa e Zyrës përmbarimore "H.B. S." shpk, për vazhdimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv nr. 169 datë 20.12.2010 i Komisionit të Shërbimit Civil është i paligjshëm, mbasi vjen në kundërshtim me nenin 609 të K.Pr.C, kjo për faktin se nga data 11.05.2012 që kreditori K.K. ka filluar punë pranë bashkisë Tiranë, titulli ekzekutiv nuk ekziston më dhe detyrimi i bashkisë Durrës për marrjen e tij në punë është shuar.
4.5. Kreditori K.K. nuk mund të jetë i punësuar njëkohësisht në punë publike, në dy institucione të ndryshme në bashkinë Durrës dhe në bashkinë Tiranë dhe ka qënë kjo arsyeja që pas fillimit të punës në bashkinë Tiranë nga ana e përmbaruesit nuk është kërkuar ekzekutimi i vendimit.
4.6. Në aspektin penal nuk kemi vepër penale pasi nga ana e bashkisë Durrës është ekzekutuar pjesa e vendimit ku kreditori K.K duhet të merrte pagën deri më datën 11.05.2012, kohë në të cilën ai ka filluar punë pranë bashkisë Tiranë.
4.7. Në këto rrethana me të drejtë bashkia Durrës ka ndërprerë pagimin e pagës së kreditorit, pasi në rast se ajo do të vazhdonte të kryente pagesën e tij do të konsiderohej si shkelje ligjore nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit.
Në përfundim të gjykimit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës vendosi mospranimin e kërkesës së kërkuesit, Zyrës përmbarimore "H. B. S." si të pabazuar në prova dhe në ligj.
Në këtë vendim, gjykata e rrethit Gjyqësor Durrës orjenton Bashkinë Durrës, që në zbatim të nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile duhet ti drejtohet gjykatës ku të kërkojë pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, pasi ai nuk ekziston më.
Në këto kushte, referuar sa më sipër, mbështetur në neni 35 e në vijim i Kodit të Proçedurës Civile dhe neni 609 e në vijim i Kodit të Proçedurës Civile, duke e konsideruar të përmbushur detyrimin që rrjedh nga vendimi nr. 169, datë 20.12.2010 i Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi me vendimin nr. 14, datë 06.04.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 7561, datë 21.12.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Bashkia Durrës i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, duke kërkuar fillimisht pezullimin e titullit ekzekutiv, Vendimit nr. 169, datë 20.12.2010 të Komisionit të Shërbimit Civil dhe pasi të shqyrtohet themeli i kërkimit të padisë sonë, të vendosë deklarimin e shuarjes së detyrimit të paditësit Bashkia Durrës, kundrejt të padituri K.K , lidhur me pjesën e mbetur të detyrimit sipas titullit ekzekutiv, Vendimit nr. 169, datë 20.12.2010 të Komisionit të Shërbimit Civil, pasi ai nuk ekziston më.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me Vendimin Nr. (11-2022-1760) 404 datë 11.04.2022 ka vendosur: Rrëzimin si të pabazuar në prova dhe në ligj kërkesëpadinë e paditësit Bashkia

Durrës me të paditur K.K , me persona të tretë Zyra përmbarimore Private "H.B.S." shpk dhe Komisionin e Shërbimit Civil Tiranë.
Vendimi i sipërcituar është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
Njëkohësisht, lidhur me zbatimin e vendimit nr. 169, datë 20.12.2010 të Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, Zyra e Përmbarimit "H. B.S.", Durrës përfaqësuar nga përmbaruesi gjyqësor z. L.H. nëpërmjet Urdhërit me nr. 0451/39 Prot., datë 19.04.2022 ka urdhëruar Degën e Thesarit Durrës: Të vendosë masën e sekuestros konservative në llogarinë e palës debitore bashkia Durrës deri në masën 6'990'164 lekë, në zbatim të urdhërit të Ekzekutimit Nr. 7561, datë 21.12.2011 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor, Tiranë, me qëllim shlyerjen e detyrimit.
Përsa më sipër, Bashkia Durrës ka kundërshtuar veprimet përmbarimore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, duke kërkuar:
-Anullimin e Urdhërit me nr. 0451/39 Prot., datë 19.04.2022 të zyrës së përmbarimit "H. B.S.", Durrës.
-Sa më sipër, sipas fakteve të narratuara dhe ligjit i kërkoj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës pranimin e ankimit duke shpallur edhe pezullimin e ekzekutimit të tyre deri në përfundimin e gjykimit.
Me Vendimin nr. 11-2022-2270 (554), datë 11.05.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur rrëzimin e ankimit të ankimuesit, Bashkia Durrës si të pabazuar në prova dhe ligj.
Vendimi i sipërcituar është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
Sqarojmë se titullari i institucionit të bashkisë Durrës, znj E.S nuk është bërë pengesë për zbatimin e titullit ekzekutiv, veprimet e së cilës mbështeten në pikat 4.3, 4.5, 4.6, 4.7 (cituar më sipër) të vendmimit të Gjykaës së Rrethit Gjyqësor Durrës me nr. 427, datë 14.10.2021, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr. 10-2022-48 (10), datë 12.01.2022.
Njëkohësisht kjo gjykatë orienton bashkinë Durrës, ***që në zbatim të nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile duhet t'i drejtohet gjykatës ku të kërkojë pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, pasi ai nuk ekziston më***.
Me shkresën Nr. 0451/41 Prot., datë 07.09.2023 protokolluar pranë bashkisë Durrës me Nr. 8233 Prot., datë 08.09.2023, Zyra Përmbarimore "H. B.S.", Durrës ka urdhëruar bashkinë Durrës për të përmbushur detyrimin, kthimin e pagës (përllogaritur deri në muajin Gusht 2023), në masën totale 7'980'855 lekë, dhe rikthimin në vendin e punës për palën kreditore, duke e caktuar atë në detyrën që përcakton vendimi i gjykatës (titulli ekzekutiv), në zbatim të Urdhërit të ekzekutimit nr. 7561, datë 21.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
Në përgjigje të saj, me shkresën me Nr. 8233/1 prot., datë 22.09.2023, bashkia Durrës ka sqaruar se mbetet në pritje të vendimeve përfundimtare nga Gjykata e Apelit dhe njëkohësisht ka shprehur gatishmërinë dhe angazhimin e saj që të zbatojë me përpikmëri vendimet gjyqësore të formës së prerë, por pa shpërdoruar fondet publike, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.
Me Vendimin me nr. 0451/42 Prot., datë 26.09.2023 Zyra Përmbarimore "H. B.S.", Durrës ka vendosur të gjobisë shtetasen, znj. E.S me detyrën e titullarit të Institucionit debitor Bashkia Durrës, në cilësinë e personit të ngarkuar nga ligji për kryerjen e veprimeve të caktuara..., në masën 50'000 lekë.
Nga sa me sipër, me Ankimin me Nr. 8974/1 prot., datë 02.10.2023, në zbatim të neneve 610, 615 e vijues të K. PR. Civile bashkia Durrës ka kërkuar pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës:
-Pezullimin e ekzekutimit të veprimeve përmbarimore, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
-Anulimin e Vendimit me nr. 0451/42 Prot., datë 26.09.2023 të zyrës së përmbarimit "H. B. S.", Durrës: "Për gjobitjen e personit të ngarkuar nga ligji".
Njëkohësisht, ju bëjmë me dije se pas një korrespondencë të kryer nga drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë bashkisë Durrës ne vitet 2016-2017, lidhur me faktin e punësimit të z. K.K në institucione të tjera të administratës publike, bashkia Durrës është vënë në dijeni nga Drejtoria

e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore në bashkinë Tiranë me shkresën nr. 247 Prot, datë 05.01.2017 e cila ka konfirmuar se shtetasi K.V. K., i datëlindjes 28.01.1982 ka qenë punonjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, njësi në varësi të bashkisë Tiranë, për periudhën nga data 11.05.2012 deri në datën 30.03.2016 me detyrë Specialist i Verifikimit në Terren.
Gjithashtu me shkresën nr. 12710 prot, datë 25.10.2016 bashkia Durrës ka kërkuar informacion edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila me shkresën nr. 35540 Prot, datë 08.11.2016 ka konfirmuar se z. K. V. K. është punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me detyrë Inspektor zbatimi në Sektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor që prej datës 29.09.2016.
Me daljen e fakteve të reja renditur më sipër, mbështetur në nenin 494/a të Kodit të Procedurës Civile me kërkesën me Nr. 11561/2 Prot., datë 13.06.2017 i kemi kërkuar Gjykatës së Lartë "Rishikimin e vendimit nr. 14, datë 06.04.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës për lënien në fuqi të Vendimit nr. 169, datë 20.12.2010 të Komisioni i Shërbimit Civil" vetëm për periudhën që z. K.K ka qenë në marrëdhënie pune në administratën publike, duke marrë pagë nga shteti shqiptar.
Çështja është në Gjykatën e Lartë me Nr. 31003-01763-00-2017. Statusi i çështjes është: Studimi i çështjes. Relatori: E. M.
Më pas bashkia Durrës me kërkesën me Nr. 7182/1 Prot., datë 12.09.2017 drejtuar Gjykatës së Lartë ka kërkuar "Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit (titull ekzekutiv) nr. 169, datë 20.12.2010 të Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi me Vendimin nr. 14, datë 06.04.2011 nga Gjykata e Apelit Durrës", kërkesë e cila nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë.
Sqarojmë se Drejtoria Ligjore, përveç ndjekjes së proceseve gjyqësore lidhur me shuarjen e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, për shkak të daljes së fakteve të reja, në zbatim të nenit 609 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, vazhdimisht ka komunikuar shkresërisht më njësitë përgjegjegjëse, si me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civil në detyrë, në zbatim të nenit 66/1, të Ligjit nr. 152, datë 30.5.2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, ashtu edhe me Drejtorinë e Ekonomike.

Grupi i auditimit i kërkoi Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës një informacion të detajuar si dhe praktikën e çështjes (dokumentacionin përkatës)
Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Drejtoresha **zj. Dh. Gj.** na dha këtë informacion në rrugë elektronike datë 02.11.2023.
Nëpërmjet shkresës nr. 12710 prot, datë 25.10.2016 bashkia Durrës ka kërkuar informacion edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila me shkresën nr. 35540 Prot, datë 08.11.2016 ka konfirmuar se z. K. V.K. është punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me detyrë Inspektor zbatimi në Sektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor që prej datës 29.09.2016. Shtetasi K.K , ka filluar punë më datë 03.04.2006 dhe është larguar më datë 08.05.2010 nga detyra Inspektor në Sektorin e Kontrollit, DTTV.

Grupi i auditimit i kërkoi Drejtorisë së Buxhetit të Bashkisë Durrës një informacion të detajuar si dhe praktikën e çështjes (dokumentacionin përkatës).
Për Drejtorinë e Buxhetit, Drejtoresha **zj. V.Q** na dha këtë informacion në rrugë elektronike datë 08.11.2023 dhe fizikisht praktikën fotokopje të njehsuar me origjinalin.
Lidhur me informacionin e kërkuar nga ju në datë 02.11.2023 mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për K.K ju bëj me dije sa më poshtë:
Drejtoria Ligjore në Bashkinë Durrës me shkresën e saj nr.16968 dt.12/11/2019 të firmosur nga drejtoresha e Drejtorisë së Përgjithshme Ligjore, AKRSKF dhe DBNJ, i është drejtuar Drejtorisë së Buxhetit për të përcjellë listën e plotë të kreditorëve në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Kjo liste përbëhet nga 13 kreditorë dhe ndërmjet tyre është edhe

K.K . Në këtë shkresë në paragrafin e fundit i kërkohet Drejtorisë së buxhetit shprehimisht: *"Për sa më sipër kërkohet nga ju mundësia e përfshirjes së detyrimeve që rrjedhin prej tyre në projektbuxhetin e vitit 2020".*
Në vijim të kësaj kërkese, ku kërkohet që drejtoria e buxhetit të planifikojë fonde për vendimet gjyqësore, çdo vit në buxhet janë parashikuar fonde nga të ardhurat e Bashkisë për shlyerje të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore. Në relacionet shoqëruese të buxheteve vjetore, të cilat janë të firmosura nga grupi i menaxhimit strategjik dhe janë pjesë e buxhetit janë të përcaktuara edhe fondet e planifikuara për vendime gjyqësore, pra niveli i këtyre fondeve është përcaktuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik .
Në buxhetin e vitit 2020 miratuar me VKB nr. 647 dt.23.12.2019 fondi për shlyerje të vendimeve gjyqësore është planifikuar 19,000,000 lekë .
Ne buxhetin e vitit 2021 miratuar me VKB nr. 123 dt. 24.12.2020 fondi për shlyerje të vendimeve gjyqësore është planifikuar 18,000,000 lekë.
Ne buxhetin e vitit 2022 miratuar me VKB nr.158 dt.23.12.2021 fondi për shlyerje të vendimeve gjyqësore është planifikuar 14,000,000 lekë.
Drejtoria e buxhetit udhëheq procesin e hartimit të planit buxhetor afatmesëm dhe buxhetin vjetor, si dhe monitoron zbatimin e buxhetit. Drejtoria e buxhetit nuk ekzekuton pagesa.
Sipas të dhënave të marra nga drejtoria ekonomike rezulton se z. K.K është paguar nga Bashkia në zbatim të vendimeve gjyqësore si më poshtë:
K.K shkarkuar më datë. 8 maj 2011, paguar **1,340,854 lekë,** fillon punë pranë Bashkisë Tiranë më datë. 5 maj 2012.

Nga trajtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me veprimet ligjore të ndërmarra nga Bashkia Durrës, grupi i auditimit konstatoi:
Me Vendimin nr. 169, datë 20.12.2010 Komisioni i Shërbimit Civil ka vendosur pranimin e ankesës së kërkuesit, Z. K.V.K., duke shpallur absolutisht të pavlefshëm vendimin nr.5, datë 30.04.2010 të Kryetarit të Bashkisë Durrës si të pa bazuar në procedurën e përcaktuar në ligj, duke vendosur:
-Rikthimin e ankuesit në detyrën e mëparshme, specialist në sektorin e Operatorëve pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;
-Kryerjen e pagesës së plotë të ankuesit, nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi.
Vendimi i sipërcituar është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 14, datë 06.04.2011.
Bashkia Durrës, përfaqësuar nga titullari institucionit si personi i ngarkuar nga ligji, duhet të kishte kryer ekzekutimin e Vendimit të Shërbimit Civil nr. 169 datë 20.12.2010, lënë në fuqi me Vendimin nr. 14, datë 06.04.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës.
Me daljen e fakteve të reja renditur në sqarimin e dhënë nga Drejtoria Ligjore, me kërkesën me Nr. 11561/2 Prot., datë 13.06.2017 i është kërkuar Gjykatës së Lartë "Rishikimi i vendimit nr. 14, datë 06.04.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës për lënien në fuqi të Vendimit nr. 169, datë 20.12.2010 të Komisioni i Shërbimit Civil" vetëm për periudhën që z. K.K ka qenë në marrëdhënie pune në administratën publike, duke marrë pagë nga shteti shqiptar.
Nga auditimi rezultoi se çështja është në Gjykatën e Lartë me Nr. 31003-01763-00-2017. *Vlen të sqarojmë se referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 500 'Pezullimi i ekzekutimit' përcakton se: Paraqitja e kërkesës për rishikim nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Bashkia Durrës ka vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore duke ndërprerë në mënyrë arbitrare ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.*
Më pas bashkia Durrës me kërkesën me Nr. 7182/1 Prot., datë 12.09.2017 drejtuar Gjykatës së Lartë ka kërkuar "Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit (titull ekzekutiv) nr. 169, datë 20.12.2010 të Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi me Vendimin nr. 14, datë 06.04.2011 nga Gjykata e Apelit Durrës", **kërkesë e cila nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë.**

Fakti që institucioni i është drejtuar gjykatës me padi për pezullimin e ekzekutimit apo për shuarjen e detyrimit, nuk zëvendëson efektet juridike për të cilat ligji ofron mbrojtje të posaçme për palët.
Vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë, në aspektin e ekzekutueshmërisë, sipas nenit 451, shkronja "ç", të Kodit të Procedurës Civile i cili përcakton se vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur: "vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë". ***Si rrjedhojë i vetmi mjet që ligji parashikon për pezullimin e ekzekutimit të tij, është kërkesa drejtuar Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.***
Bashkia Durrës, me pretendimin se detyrimi ndaj kreditorit K.K është përmbushur, ka paraqitur padi e cila është rrëzuar me vendimin nr. (11-2022-1760) 404, datë 11.04.2022 të ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili është ankimuar, e për të cilin nuk ka ende vendimmarrje nga Gjykata e Apelit.
Në këto kushte, vendimi i formës së prerë, është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që e ka dhënë, si dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera (neni 451/a, paragrafi i parë K.Pr.Civile). ***Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë, nuk mund të gjykohet përsëri (neni 451/a paragrafi i dytë K.Pr.Civile). Si i tillë, ai nuk mund të vihet në diskutim por vetëm të zbatohet.***
Nëse eventualisht, gjykata e apelit do të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me padinë për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv, për shkak se detyrimi është shuar, Bashkia Durrës ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumave monetare të dhëna kreditorit K.K .
Në total detyrimi që Bashkia Durrës ka për të paguar në favor të palës kreditore deri në Gusht 2023 është në shumën **7,980,855 Lekë.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:
-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Neni 142, pika 3 që përcakton se: *Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.* Neni 42, pika 2 që përcakton se: Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik *brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.*
-Kodin e procedurës civile, Neni 451, pika ç që përcakton se: *Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur 'është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë'*, Neni 451/a *Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.*
Neni 500 'Pezullimi i ekzekutimit' përcakton se: *Paraqitja e kërkesës për rishikim nuk pezullon ekzekutimin e vendimit.*
Neni 609 që përcakton se: Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas. *Afati për të paraqitur këtë kërkesëpadi është 30 ditë nga marrja dijeni për fillimin ekzekutimit të detyrueshëm.*
Neni 615 pika a që përcakton se: *Ekzekutimi pezullohet me vendim të gjykatës në rastet e parashikuara nga ligji.*
-Kodin civil, Neni 112 që përcakton se: *E drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet më me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent.*
-Udhëzimin nr. 1, Datë 04.06.2014 '*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit'* pika 2 që përcakton se: Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjate vitit buxhetor, mbajnë data basë për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës. Këto parashikime i bëhen të njohura edhe njësisë së qeverisjes së përgjithshme nga e cila varet.
-Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 *'Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së presë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil',* Kreu III, Mbikëqyrja/ Ekzekutimi i Vendimeve Gjyqësore të Formës së Prerë, pika 4 që përcakton se: *Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, njësitë debitorë, vihen në lëvizje me kërkesë/lajmërim me shkrim të kreditorit, përfaqësuesit ligjor të tij apo përmbaruesit.*

II. ***Ankesa e shtetasit G.K , me nr. 884 prot., datë 09.10.2023 në KLSH, me objekt "Vënie në dijeni për moszbatim të Vendimit Gjyqësor të Formës së Prerë".***
Grupi i auditimit u njoh me problemin dhe hapat e procedurës së ndjekur nga shtetasi G.K nëpërmjet dokumentacionit bashkëngjitur kërkesës të tij, të cilat janë:
-Kërkesë drejtuar KLSH, datë 05.09.2016 me objekt "Konstatimi i veprimeve abuzive dhe dëmin ekonomik të Bashkisë Durrës";
-Kthim Përgjigje nr. 933/1 prot., datë 07.02.2017 nga KLSH;
-Vendimin nr. 96 datë 04.06.2007 të Komisionit të Shërbimit Civil për ankesën e z. G.K me objekt "Kundërshtimin e aktit administrativ nr. 825 datë 27.03.2007 të Kryetarit të Bashkisë Durrës, me objekt 'Largim nga Shërbimi Civil";
-Vendimin nr. 3289 Akti të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i shpallur më datë 26.03.2012, me objekt "Lëshimin e Urdhrit të ekzekutimit për Vendimin nr. 96 datë 04.06.2007 të Komisionit të Shërbimit Civil";
-Shkresën me nr. 2002 prot., datë 06.06.2023 me objekt "Njoftim për ekzekutim detyrimi 'te zyrës përmbarimore private 3L ShPK, drejtuar Bashkisë Durrës";
-Shkresën me nr. 2186 prot., datë 05.07.2023 me lëndë "Kërkohet informacion mbi zbatimin e shkresës 'Njoftim për ekzekutim detyrimi' nr.2002 prot., datë 06.06.2023, të zyrës përmbarimore private 3L ShPK, drejtuar Bashkisë Durrës";
-Shkresën me nr.5772/2 prot., datë 29.06.2023 me lëndë "Kthim përgjigje tuaj ës me nr. 2002 prot., datë 06.06.2023" të Bashkisë Durrës drejtuar Shoqërisë Përmbarimore Private "3L";
-Shkresën me nr.1833/1 prot., datë 01.12.2022 "Urdhër i brendshëm për vendosjen e masës së sekuestro konservatore "të Degës së Thesarit Durrës drejtuar Sektorit të Shpenzimeve e për dijeni Bashkisë Durrës dhe z. H. A. C. përmbarues gjyqësor privat;
-Shkresën me nr.2131/3 prot., datë 02.03.2020 me lëndë "Kërkesë për paraqitje" të Bashkisë Durrës, drejtuar z. G.K.;
-Shkresën me nr.923 prot., datë 12.04.2021 me lëndë "Kërkesë për rikthim në punë të z. G.K "drejtuar Bashkisë Durrës;
-Vërtetim i gjendjes gjyqësore; vërtetim i aftë për punë; vërtetim gjykate; vërtetim prokurorie.
Për ankesën e Z. G.K nga verifikimi rezultoi që:

Grupi i auditimit i kërkoi Drejtorisë Ligjore të Bashkisë Durrës një informacion të detajuar si dhe praktikën e çështjes (dokumentacionin përkatës)
Për Drejtorinë Ligjore, Zëvendëskryetari **z. E.J** na dha këtë informacion në rrugë elektronike dt. 30.10.2023 dhe fizikisht praktikën fotokopje të njehsuar me origjinalin.
Lënda: Informacion lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 3289, datë 26.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë në favor të kreditorit G.K .

Lidhur me zbatimin e Vendimit me Nr. 3289 Akti, datë 26.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë në favor të kreditorit G.K , lidhur me Vendimin e Komisionit të Shërbimit Civil nr. 96, datë 04.06.2007, sqarojmë sa më poshtë vijon:
Me Vendimin nr. 825, datë 27.03.2007 të kryetarit të bashkisë Durrës është vendosur largimi nga Shërbimi Civil për z. G.K me pozicionin specialist në Sektorin e prokurimeve, në Departamentin Ligjor, pranë Bashkisë Durrës.
Me Vendimin nr. 96, datë 04.06.2007 Komisioni i Shërbimit Civil, sipas kërkesës së z. G.K , Komisioni i Shërbimit Civil vendosi:
-Pranimin e ankesës së paraqitur nga z. G.K , duke shfuqizuar aktin administrativ nr. 825, datë 27.03.2007 të kryetarit të bashkisë Durrës;
-Kthimin e ankuesit në pozicionin e mëparshëm të punës, specialist në Sektorin e prokurimeve, në Departamentin Ligjor, pranë Bashkisë Durrës;
-Detyrimin e bashkisë Durrës për pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në ekzekutimin e këtij vendimi.
Lidhur sa me sipër, z. G.K , ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë: "Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit" të Vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil nr. 96, datë 04.06.2007.
Me Vendimin me Nr. 3289 Akti, datë 26.03.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka vendosur:
-Pranimin e Kërkesës;
-Lëshimin e Urdhrit të ekzekutimit për Vendimin nr. 96, datë 04.06.2007 të Komisionit të Shërbimit Civil (Titull Ekzekutiv).
Drejtoria Ligjore, lidhur me vendimet e sipërcituara ka komunikuar shkresërisht më njësitë përgjegjëse, si me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civil në detyrë, në zbatim të nenit 66/1, të Ligjit nr. 152, datë 30.5.2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, ashtu edhe me Drejtorinë e Ekonomike.
Grupi i auditimit i kërkoi Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës një informacion të detajuar si dhe praktikën e çështjes (dokumentacionin përkatës)
Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Drejtoresha zj. Dh.Gj. na dha këtë informacion në rrugë elektronike datë 02.11.2023.
Nëpërmjet shkresës nr. 9346 prot., datë 06.10.2023 bashkia Durrës ka kërkuar informacion edhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Durrës, i cili me shkresën nr. 17923/1 Prot., datë 19.10.2023 ka konfirmuar se z. G. K. ka filluar punë më datë 16.06.2004 me detyrë Specialist Sektori i Prokurimeve dhe është larguar më datë 26.03.2007.
Grupi i auditimit i kërkoi Drejtorisë së Buxhetit të Bashkisë Durrës një informacion të detajuar si dhe praktikën e çështjes (dokumentacionin përkatës)
Për Drejtorinë e Buxhetit, Drejtoresha zj. V.Q na dha këtë informacion në rrugë elektronike datë 08.11.2023 dhe fizikisht praktikën fotokopje të njehsuar me origjinalin.
Lidhur me informacionin e kërkuar nga ju në datë 02.11.2023 mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për z. G.K ju bëj me dije sa më poshtë:
Drejtoria Ligjore në Bashkinë Durrës me shkresën e saj nr.16968 dt.12/11/2019 të firmosur nga drejtoresha e Drejtorisë së Përgjithshme Ligjore, AKRSKF dhe DBNJ, i është drejtuar Drejtorisë së Buxhetit për të përcjellë listën e plotë të kreditorëve në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Kjo liste përbëhet nga 13 kreditorë dhe ndërmjet tyre është edhe G.K . Në këtë shkresë në paragrafin e fundit i kërkohet Drejtorisë së buxhetit shprehimisht: "Për sa më sipër kërkohet nga ju mundësia e përfshirjes së detyrimeve që rrjedhin prej tyre në projektbuxhetin e vitit 2020".
Në vijim të kësaj kërkese , ku kërkohet që drejtoria e buxhetit të planifikojë fonde për vendimet gjyqësore, çdo vit në buxhet janë parashikuar fonde nga të ardhurat e Bashkisë për shlyerje të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore. Në relacionet shoqëruese të buxheteve vjetore, të cilat janë të firmosura nga grupi i menaxhimit strategjik dhe janë pjesë e buxhetit

janë të përcaktuara edhe fondet e planifikuara për vendime gjyqësore, pra niveli i këtyre fondeve është përcaktuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik .
Në buxhetin e vitit 2020 miratuar me VKB nr. 647 dt.23.12.2019 fondi për shlyerje të vendimeve gjyqësore është planifikuar 19.000.000 lekë .
Ne buxhetin e vitit 2021 miratuar me VKB nr. 123 dt. 24.12.2020 fondi për shlyerje të vendimeve gjyqësore është planifikuar 18,000,000 lekë
Ne buxhetin e vitit 2022 miratuar me VKB nr.158 dt.23.12.2021 fondi për shlyerje të vendimeve gjyqësore është planifikuar 14,000,000 lekë
Drejtoria e buxhetit udhëheq procesin e hartimit të planit buxhetor afatmesëm dhe buxhetin vjetor, si dhe monitoron zbatimin e buxhetit. Drejtoria e buxhetit nuk ekzekuton pagesa.
Sipas të dhënave të marra nga drejtoria ekonomike rezulton se z. G.K është paguar nga Bashkia në zbatim të vendimeve gjyqësore si më poshtë:
G.K larguar nga Bashkia me datë. 27.03.2007 dhe është paguar me një shumë totale prej 2,643,045 lekë.

Nga trajtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me veprimet ligjore të ndërmarra nga Bashkia Durrës, grupi i auditimit konstatoi:

Me Vendimin nr. 96, datë 04.06.2007 Komisioni i Shërbimit Civil, sipas kërkesës së z. G.K , Komisioni i Shërbimit Civil vendosi:
-Pranimin e ankesës së paraqitur nga z. G.K , duke shfuqizuar aktin administrativ nr. 825, datë 27.03.2007 të kryetarit të bashkisë Durrës;
-Kthimin e ankuesit në pozicionin e mëparshëm të punës, specialist në Sektorin e prokurimeve, në Departamentin Ligjor, pranë Bashkisë Durrës;
-Detyrimin e bashkisë Durrës për pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në ekzekutimin e këtij vendimi.
Me Vendimin nr. 3289 Akti të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i shpallur më datë 26.03.2012, me objekt "Lëshimin e Urdhrit të ekzekutimit për Vendimin nr. 96 datë 04.06.2007 të Komisionit të Shërbimit Civil";
Drejtoria Ligjore, lidhur me vendimet e sipërcituara ka komunikuar shkresërisht më njësitë përgjegjëse, si me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civil në detyrë, në zbatim të nenit 66/1, të Ligjit nr. 152, datë 30.5.2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, ashtu edhe me Drejtorinë e Ekonomike.
Në total detyrimi që Bashkia Durrës ka për të paguar në favor të palës kreditore deri në Dhjetor 2022 është në shumën **7,457,014 Lekë.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Neni 142, pika 3 që përcakton se: *Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.* Neni 42, pika 2 që përcakton se: Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik *brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.*
-Kodin e procedurës civile, Neni 451/a që përcakton se: *Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.*
-Udhëzimin nr. 1, Datë 04.06.2014 '*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit'* pika 2 që përcakton se: Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen detyrimeve që rrjedhin prej tyre.
Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjate vitit buxhetor, mbajnë data basë për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve

të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës. Këto parashikime i bëhen të njohura edhe njësisë së qeverisjes së përgjithshme nga e cila varet.
Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 'Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së presë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil', Kreu III, Mbikëqyrja/ Ekzekutimi i Vendimeve Gjyqësore të Formës së Prerë, pika 4 që përcakton se: *Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, njësitë debitorë, vihen në lëvizje me kërkesë/lajmërim me shkrim të kreditorit, përfaqësuesit ligjor të tij apo përmbaruesit.*
(Për sa më sipër është trajtuar më gjerësisht në Akt Verifikimin nr.1 datë 20.11.2023).

Titulli Gjetjes: KLSH ka konstatuar se ekzistonin mangësi në lidhje me ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore të Formës së Prerë.
Situata: I. Mbi ankesën e shtetasit K.K , me nr.587/3 prot., datë 20.09.2023 në KLSH, me objekt "Vënie në dijeni për moszbatim të Vendimit Gjyqësor të Formës së Prerë dhe Rekomandimit të Avokatit të Popullit për marrjen e masave".
Me Vendimin nr. 169, datë 20.12.2010 Komisioni i Shërbimit Civil ka vendosur pranimin e ankesës së kërkuesit, Z. K. V. K., duke shpallur absolutisht të pavlefshëm vendimin nr.5, datë 30.04.2010 të Kryetarit të Bashkisë Durrës si të pa bazuar në procedurën e përcaktuar në ligj, duke vendosur:
-Rikthimin e ankuesit në detyrën e mëparshme, specialist në sektorin e Operatorëve pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;
-Kryerjen e pagesës së plotë të ankuesit, nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi.
Vendimi i sipërcituar është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 14, datë 06.04.2011.
Bashkia Durrës, përfaqësuar nga titullari institucionit si personi i ngarkuar nga ligji, duhet të kishte kryer ekzekutimin e Vendimit të Shërbimit Civil nr. 169 datë 20.12.2010, lënë në fuqi me Vendimin nr. 14, datë 06.04.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës.
Me daljen e fakteve të reja renditur në sqarimin e dhënë nga Drejtoria Ligjore, me kërkesën me Nr. 11561/2 Prot., datë 13.06.2017 i është kërkuar Gjykatës së Lartë "Rishikimi i vendimit nr. 14, datë 06.04.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës për lënien në fuqi të Vendimit nr. 169, datë 20.12.2010 të Komisioni i Shërbimit Civil" vetëm për periudhën që z. K.K ka qenë në marrëdhënie pune në administratën publike, duke marrë pagë nga shteti shqiptar.
Nga auditimi rezultoi se çështja është në Gjykatën e Lartë me Nr. 31003-01763-00-2017. *Vlen të sqarojmë se referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 500 'Pezullimi i ekzekutimit' përcakton se: Paraqitja e kërkesës për rishikim nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Bashkia Durrës ka vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore duke ndërprerë në mënyrë arbitrare ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.*
Më pas Bashkia Durrës me kërkesën me Nr. 7182/1 Prot., datë 12.09.2017 drejtuar Gjykatës së Lartë ka kërkuar "Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit (titull ekzekutiv) nr. 169, datë 20.12.2010 të Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi me Vendimin nr. 14, datë 06.04.2011 nga Gjykata e Apelit Durrës", **kërkesë e cila nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë.**
Fakti që institucioni i është drejtuar gjykatës me padi për pezullimin e ekzekutimit apo për shuarjen e detyrimit, nuk zëvendëson efektet juridike për të cilat ligji ofron mbrojtje të posaçme për palët.
Vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë, në aspektin e ekzetueshmërisë, sipas nenit 451, shkronja "ç", të Kodit të Procedurës Civile i cili përcakton se vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur: "vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë". ***Si rrjedhojë i vetmi mjet që ligji parashikon për pezullimin e ekzekutimit të tij, është kërkesa drejtuar Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.***

Bashkia Durrës, me pretendimin se detyrimi ndaj kreditorit K.K është përmbushur, ka paraqitur padi e cila është rrëzuar me vendimin nr. (11-2022-1760) 404, datë 11.04.2022 të ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili është ankimuar, e për të cilin nuk ka ende vendimmarrje nga Gjykata e Apelit.
Në këto kushte, vendimi i formës së prerë, është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që e ka dhënë, si dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera (neni 451/a, paragrafi i parë K.Pr.Civile). ***Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë, nuk mund të gjykohet përsëri (neni 451/a paragrafi i dytë K.Pr.Civile). Si i tillë, ai nuk mund të vihet në diskutim por vetëm të zbatohet.***
Nëse eventualisht, gjykata e apelit do të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me padinë për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv, për shkak se detyrimi është shuar, Bashkia Durrës ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumave monetare të dhëna kreditorit K.K .
Në total detyrimi që Bashkia Durrës ka për të paguar në favor të palës kreditore deri në Gusht 2023 është në shumën **7,980,855 Lekë.**
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:
-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 142, pika 3, neni 42, pika 2;
-Kodin e procedurës civile, neni 451, pika a, neni 500, neni 609, neni 615;
-Kodin civil, neni 112;
-Udhëzimin nr. 1, Datë 04.06.2014 '*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit'* pika 2;
-Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 *'Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së presë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil',* Kreu III, Mbikëqyrja/ Ekzekutimi i Vendimeve Gjyqësore të Formës së Prerë, pika 4.
II. Mbi ankesën e shtetasit G.K , me nr. 884 prot., datë 09.10.2023 në KLSH, me objekt "Vënie në dijeni për moszbatim të Vendimit Gjyqësor të Formës së Prerë".
Me Vendimin nr. 96, datë 04.06.2007 Komisioni i Shërbimit Civil, sipas kërkesës së z. G.K , Komisioni i Shërbimit Civil vendosi:
-Pranimin e ankesës së paraqitur nga z. G.K , duke shfuqizuar aktin administrativ nr. 825, datë 27.03.2007 të kryetarit të bashkisë Durrës;
-Kthimin e ankuesit në pozicionin e mëparshëm të punës, specialist në Sektorin e prokurimeve, në Departamentin Ligjor, pranë Bashkisë Durrës;
-Detyrimin e bashkisë Durrës për pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në ekzekutimin e këtij vendimi.
Me Vendimin nr. 3289 Akti të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i shpallur më datë 26.03.2012, me objekt "Lëshimin e Urdhrit të ekzekutimit për Vendimin nr. 96 datë 04.06.2007 të Komisionit të Shërbimit Civil";
Drejtoria Ligjore, lidhur me vendimet e sipërcituara ka komunikuar shkresërisht më njësitë përgjegjëse, si me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civil në detyrë, në zbatim të nenit 66/1, të Ligjit nr. 152, datë 30.5.2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, ashtu edhe me Drejtorinë e Ekonomike.
Bashkia Durrës, përfaqësuar nga titullari institucionit si personi i ngarkuar nga ligji, duhet të kishte kryer ekzekutimin e Vendimit me Nr. 3289 Akti, datë 26.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
Në total detyrimi që Bashkia Durrës ka për të paguar në favor të palës kreditore deri në Dhjetor 2022 është në shumën **7,457,014 Lekë.**
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:
-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 142, pika 3, neni 42, pika 2;
-Kodin e procedurës civile, neni 451, pika a;
-Udhëzimin nr. 1, Datë 04.06.2014 '*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit'* pika 2;

-Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 *'Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së presë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil',* Kreu III, Mbikëqyrja/ Ekzekutimi i Vendimeve Gjyqësore të Formës së Prerë, pika 4.
Kriteri: -Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 142, pika 3, neni 42, pika 2;
-Kodin e procedurës civile, neni 451, pika a, neni 500, neni 609, neni 615;
-Kodin civil, neni 112;
-Udhëzimin nr. 1, Datë 04.06.2014 '*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit'* pika 2;
-Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 *'Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së presë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil',* Kreu III, Mbikëqyrja/ Ekzekutimi i Vendimeve Gjyqësore të Formës së Prerë, pika 4.
Shkaku: Mos ekzekutimi në kohë i Vendimeve Gjyqësore të Formës së Prerë**.**
Rëndësia: I lartë
Rekomandimi: -Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe të shmangin në të ardhmen ndjekjen e procedurave të gabuara për çështjet e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk është hartuar plani vjetor i punës. Nga auditimi rezulton se nuk ka raportime periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit. Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të. Takimet e GMS nuk dokumentohen me minuta takimi apo procesverbale. Bashkia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime.
Aktivet e rëndësishme (*me vlera të konsiderueshme*) dhe aktivet afatgjata nuk ruhen nga përdorimi i paautorizuar me anë të një procedure të shkruar. Bashkia nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Bashkia nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*"; *"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 20-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1 Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Durrës, Koordinatori i Riskut dhe Koordinatori i MFK -së të merren masa për:
-Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performancë, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
-Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrin e konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.
-Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike.

Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Durrës përgjatë vitit 2022, u konstatua se bashkia nuk ka ngritur Komitetin e Auditimit. Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në MAB. Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm nuk ka të përcaktuara mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës. Programit të miratuar i mungon komponenti "*Reagimet e subjektit të audituar*" sipas kërkesave e MAB, Kapitulli VII, pika 7.1.1.
Nga auditimi rezulton se audituesit e brendshëm nuk janë trajnuar në fushat e planifikuara në Planin Strategjik të Auditimit,
Në raportet e auditimit audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar sipas kërkesave të MAB, kapitulli IV, pika 4 .1.12. Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të MAB, kapitulli IV, pika 4.1.12. Dosjet e auditimit nuk përmbajnë "Dokumentet e mbledhura përpara fillimit të angazhimit të auditimit" sipas kërkesave të MAB, kapitulli VI, pika 2;
NJAB, nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, asetet, etj. Planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në mospërputhje me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 20-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Durrës, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të merren masa për:
-Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, si një organ i pavarur.
-Përditësimin e Kartës së Auditimit dhe Programit për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese,
-Shqyrtimin e risqeve më të rëndësishëm për planifikimin dhe zbatimin e projekteve, programeve në të cilat janë fokusuar objektivat strategjikë, të njësisë publike,

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2022 *u konstatua se*:
a. Realizimi i buxhetit për *vitin 2022* është 7,235,165 mijë lekë nga 8,648,771mijë lekë të planifikuara, ose në masën 84%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi i zërit 230-231 "Shpenzime për investime" në masën 62%, që ka ardhur nga mos finalizimi i 56 projekteve të planifikuara, për të cilat nuk janë kryer procedurat e prokurimit, ndërsa për 41 projekte të planifikuara, për të cilat janë çelur edhe fondet, janë financuar pjesërisht ose nuk janë financuar për arsye të mos mbylljes së punimeve brenda vitit buxhetor, për shkak të lidhjes së kontratave me vonesë. Gjithashtu 12 projekte investimi të Rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019 të planifikuara janë financuar nga fondet e rindërtimit në masën 50%, për shkak të mosrakordimi të fondeve nga buxheti i shtetit për mbylljen e këtyre investimeve.
b. Nuk është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura të rezultuara në fund të vitit 2021 në vlerën 156,887,958 lekë**.** Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 110,374,392lekë.Detyrimet e papaguara rakordojnë me

gjendjet e llog. të klasë 4 të bilancit të vitit 2022, por nuk rakordojnë për shumën 36,370,104 lekë me raportimin në MFE të vitit 2022 në vlerën 74,004,288 lekë, diferencë që i përket e detyrimeve të prapambetura për investime të pa financuara nga Ministritë e linjës dhe FZHSH, të cilat nuk janë përfshirë në raportim. Ndërsa gjatë vitit 2022 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura.

c. Gjithashtu konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 89% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike) dhe 11% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat, që siguron njësia vendore nga burimet të tjera. Këto veprime janë në kundërshtim me ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 43 paragrafi 4,47,48,52: ligji nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 40/h,42; Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Kreu "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar neni 12 pika 3 me Udhëzimin e MFE nr.09, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit" pika 106. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës, nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit, të kryejë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të jenë sa më të argumentuara.

- Gjithashtu Bashkia të sigurojë realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara, sipas prioriteteve strategjike, duke shmangur vonesat në procedurat e prokurimit, në lidhjen e kontratave dhe eliminuar limitimin e likuidimeve për angazhime të marra.
- Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Buxhetit të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, duke hartuar një grafik me radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë *468 "Debitorë të ndryshëm",* përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, e cila paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 591,457,852 lekë, ku në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 102,497,719 lekë. Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" konstatohet se, vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 prej 165,047,159 lekë, është e pasaktë, pasi kjo vlerë i përket vlerës debitorëve të krijuar në vitin ushtrimor 2022. Nga të dhënat e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vlera progresive në datë 31.12.2022 e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 799,162,272 lekë, duke sjellë një mosrakordimi për vlerën 634,115,113 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu III., pika 2, Aneksi 1 pika 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat që të bëjë kontabilizimin e saktë të të drejtave të arkëtueshme nga të tretët në llog. 468 "Debitorë të ndryshëm". Të bashkëpunojë me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për saktësimin e vlerës, duke rakorduar zyrtarisht si për vlerën debitore të krijuar gjatë vitit ushtrimor dhe për vlerën progresive të akumuluar në fund të vitit ushtrimor të argumentuar me dokumentacion.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë *4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"* në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 36,767,298 lekë, kur në fakt duhet të ishte në vlerën 49,010,534 lekë, pasi në analizë përfshin gjendjet e llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasivin e bilancit: llog.401-404 "Furnitore e llogari te lidhura me

to" ne vlerën 12,243,236 lekë, llog.42 "Detyrime ndaj personelit" për vlerën 25,440,333 lekë, llog.431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" për vlerën 2,393,534 lekë, llog.435 "Sigurime shoqërore" për vlerën 7,862,602 lekë, llog.436 "Sigurime shëndetësore" për vlerën 1,070,830 lekë. Pra gjendja e llog. *4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"* nuk rakordon për shumën prej 12,243,236 lekë me shumën e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, vlerë kjo që i përket llog.401-404 "Furnitore e llogari te lidhura me to", e cila nuk është përfshirë edhe pse është detyrim, që i ka shteti/Bashkia të tretëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II pika 15/b,59 /a, Kreu III, pika 32, Aneksi 1 pika 3.3 nënpika 8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa që të bëjë kontabilizimin e saktë në llog. *4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"*të detyrimit që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, duke përfshirë edhe gjendjen e llog.*401-404 "Furnitore e llogari te lidhura me to",* detyrim që i ka shteti/Bashkia të tretëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 146,665,977 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime",* për 27 projekt-studime për investime të kryera apo për investime të pakryera, ku për një pjesë nuk ka të dhëna nëse janë kryer investimet dhe përse vlera e këtyre studimeve nuk i është shtuar vlerës së aktivit të kapitalizuar. Në gjendjen e kësaj llogarie një pjesë e vlerave të këtyre studim-projektimeve kanë mbetur në vite dhe një pjesë janë trashëguar nga ish-Komunat. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se në këtë gjendje janë përfshirë 3 zëra në vlerën 10,275,736 lekë, që nuk mund të jenë pjesë e gjendjes së llog. *202 "Studime dhe Kërkime",* referuar nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II pika16/b.d, Aneksi 1 pika 2 Klasa 2 dhe me Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Durrës të verifikojë dhe të shqyrtojë dokumentacionin financiar në lidhje me blerjen e AAGJM dhe të kryejë kontabilizimet përkatëse për shpërndarjen e vlerës të studim-projektimeve, sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 "Studime dhe Kërkime" dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë sistemimet e duhura për vlerën 10,275,736 lekë, duke e shpërndarë në investimet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Referuar analizës së gjendjes së llogarisë *212 "Ndërtesa Konstruksione"* u konstatua se 9 aktive afatgjata materiale në vlerë 118,775,472 lekë, ku në 8 raste prej tyre kanë emërtesa të paplota, ta paqarta dhe të pasakta, dhe 1 rast në vlerën 1,157,939 lekë nuk ka emërtim, gjë që do të thotë se inventari kontabël nuk përputhet me gjendjen kontabël për këtë vlerë. Për këto aktive nuk është bërë asnjë inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu III, Seksioni 3.1, pika 31 Aneksi 1 pika 2 Klasa 2 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve" pika 74. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Titullari e Bashkisë Durrës të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në llog. *212 "Ndërtesa Konstruksione"* dhe vlerësimit të tyre nëse ekzistojnë e nëse kanë vlerë përdorimi dhe më pas të marrë masa për ndjekjen procedurave ligjore në rast dëmtimesh apo shembjesh. Ndërsa Drejtoria e Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga Titullari i Bashkisë Durrës nuk është ngritur komisioni nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, duke mos u kryer procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe ajo e asgjësimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në vlerën 2,201,233 lekë. Për këto aktive janë kryer veprimet kontabël të pakësimit konkretisht në llog. 214 "Instalime teknike, makineri dhe paisje" në vlerën 573,162 lekë dhe llog. llog. 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 1,628,071 lekë, pa u kryer procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe ajo e asgjësimit të këtyre aktiveve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 95-114. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Durrës të ngrejë komisionin për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimi në vlerën 2,201,233 lekë, të cilat të shoqërohen me dokumentacionin ligjor përkatës. Më pas nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi të bëhet ndarja e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi në material të riciklushme dhe nëse s'ka, të kryhet procedura e asgjësimit, duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur apo djegur, të dokumentuar.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë *16 "Hua Afatgjata"* në pasiv të bilancit paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 dhe 2021 në vlerën 0 lekë**,** ndërkohë që Bashkia Durrës ka marrë në vitin 2014 Kredi të financuar nga CEB në vlerën 3,341,000 euro ose në 352,937,752 lekë për ndërtimin e Banesave Sociale investim I kryer që në ato vite. Kjo kredi është ratifikuar në Parlament dhe lëvrimi i kredisë është bërë nëpërmjet Marrëveshjes së nënshkruar nga Bashkia Durrës me MFE, pagesa e secilës ndiqet nga kjo e fundit. Nuk ka një evidentim të shumës së kësaj huaje në kredi të llog. *16 "hua afatgjata"* dhe për pagesat e kryera në vlerën 171,479,202 lekë në debi të kësaj llogarie, në mënyrë që gjendja e kësaj llogarie të paraqesë vlerën e kredisë së mbetur papaguar prej 181,458,550 lekë. Në fakt për pagesat e kësteve të kredisë është rënduar më pa të drejtë *llogaria 231 "Investime në proces",* kur ky investim është kryer si punime dhe si financime dhe kjo vlerë ka kaluar në llogarinë e aktiveve *212 "Ndërtesa dhe konstruksione"***.** Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II, pika 2.3 nënpika 22, 23, Aneksi 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për kontabilizimin e saktë të kredisë për banesat sociale të financuar nga CEB për Bashkinë Durrës në llogarinë përkatëse 16 *"Hua Afatgjata",* ku në mbyllje të vitit 2023 për pagesat e bëra të kësteve të kontabilizuar më parë në *llog.231 "Investime në proces"* të kryhen veprimet kontabël sistemuese, duke i kaluar ato në gjendjen e llog.16 *"Hua Afatgjata"* dhe në vazhdim për pagesat e tjera deri në likujdimin e plotë të kredisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë *4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"* paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që shuma e gjendjeve të debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit është në vlerën 592,148,550 lekë përkatësisht: (gjendja e llog.468 "debitorë të ndryshëm" në vlerën 591,457,852 lekë + gjendja e llog.423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" në vlerën 690,699 lekë). Këto gjendje janë paraqitur në mënyrë të gabuar në llogaritë në pasiv të bilancit

në gjendjen e llog. 475 "Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse" në vlerën 591,457,852 lekë dhe gjendjen e llog.480 të ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar në vlerën 690,699 lekë, kur duheshin paraqitur në gjendjen e llog. *4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"*. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu III., pika 42, Aneksi 1 pika 3.3 nënpika 8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa që të kryejë veprimet e sakta kontabël për vlerat e të drejtave të konstatuara në lidhje me detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit si debitorët, duke i përfshirë në gjendjen e llogarisë *4341 "Operacione me shtetin (detyrime)",* me qëllim që të kontabilizohet në mënyrë të saktë detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2022 me urdhër-shpenzime në **21** raste faturash me vlerë 406,300,574 lekë, *mbi afatin 30 ditor të faturave* për shpenzime mallra e shërbime/ investime të mbërritura në Bashkinë Durrës, *të cilat 23* raste në vlerën 10,502,565 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llog. 602 "shpenzime operative" dhe në 39 raste në vlerën 395,798,009 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llog.231 "investime", ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar për mungesë fondesh nga Ministria, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 44 "Kontrolli i shpenzimeve". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1.Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përjashtuar kufizimet e MFE)*, për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **8 praktika**, tek të cilat pasqyrohen situatat në lidhje me:

- mosrespektimin i kritereve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi;

- plani i vendosjes së strukturës të miratuar për leje ndërtimi nuk përputhet plotësisht me projektin e ndërtimit, pasi në të nuk pasqyrohen daljet dhe faqet konsol të objektit;

- projekti konstruktiv nuk përputhet me projektin arkitektonik;

- mosrespektimin i distancave nga kufiri i pronës dhe distancave nga trupi i rrugës;

- mos përcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosjen dhe në lejen e ndërtimit të miratuar, në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi;

-mungesa e dokumentacionit të plotë të pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje;

- në lejen e ndërtimit janë miratuar zhvillimi i objekteve që nuk janë në përputhje me përdorimet e lejuara në njësinë struktukturore përkatëse, të evidentuara në projektin e ndërtimit dhe në relacionin teknik pasi janë propozuar edhe funksione të tjera;

- miratimi i ndryshimit të projektit gjatë ndërtimit duke tejkaluar masën 2% të sipërfaqes ndërtimore.

Situatat e mësipërme janë evidentuar përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt:

1."Godinë industriale 1 dhe 2 kat + vendroje + kabinë elektrike dhe mur rrethues", miratuar me vendimin Nr. 2775, datë 28/01/2022, me zhvillues "M. O." ShPK, në adresën rruga "Vath Turja", Spitallë, Durrës;

2."Godinë shërbimi dhe banimi 6 kat+1 kat nën tokë dhe banesë 2 kat +1 kat nën tokë",

miratuar me vendimin Nr. 104, datë 29.04.2022, me zhvillues "A. K.2019" ShPK, në adresën Lagjja 17, Rruga "Doktor Remzi", Durrës;
3."Strukturë industriale 2 dhe 3 kate dhe 1 kat nëntokë", miratuar me vendimin Nr. 2884, datë 14/02/2022, me zhvillues "P. B." ShPK, në adresën Rruga "Athina", Durrës.
4. "K.V. Banimi 2 kat + 1 kat nëntokë, "B. R. D. H.", miratuar me vendimin Nr. 2737, datë 18/01/2022, me zhvillues shoqëria "B. C." ShPK, në adresën rruga "Kont Urani", Lagja 1, Durrës;
5."Struktura akomoduese turistike 2 dhe 3 kat dhe rrethim i pronës", miratuar me vendimin Nr. 925-22/6, datë 21/12/2022, me zhvillues "Ch. G." ShPK, në adresën Hamallë, Njësia Administrative Manëz, Durrës;
6."Shtëpi banimi 2 kat + podrum + papafingo dhe mur rrethues", miratuar me vendimin Nr. 2859, datë 08/02/2022, me zhvillues V. dhe N. P., në adresën rruga "Idriz Xhafi", Shkallnur, Durrës;
7."Struktura akomoduese dhe shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore", miratuar me vendimin Nr.3009, datë 10/03/2022, me zhvillues R.S. dhe V. S., në adresën Lalëz, njësia administrative Ishëm, Durrës; 8."Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat", miratuar me vendimin Nr.2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B. M., në Lalz, Durrës.
Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin Nr.107/2014, datë 31.07.2014, "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, Neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor, me Planin e Përgjithshëm Vendor i miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 27, datë 10.05.2013 "Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës"; me VKM Nr. 502, datë 13.07.2011, "*Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, Neni 39; Neni 40; me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 15, pika c dhe pika 1/1, ii; neni 35, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës; neni 37, lartësia e ndërtimeve; neni 17, pika e; me Vendimin Nr.12, datë 27.02.2019, "Për miratimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban, bujqësor dhe natyror", në pikën 4. me Ligjin 111/2018, për "Kadastrën", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4; VKM nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në nenin 15, në pikën 1, germa b. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 214-246 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
12.1. Rekomandimi: DPKZHT Durrës të marrë masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje me të gjitha kriteret dhe kondicionet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të certifikatave të përdorimit u konstatuan **2 praktika**, tek të cilat pasqyrohen situatat në lidhje me mosparaqitjen në sistemin e-Leje e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e çertifikatës së përdorimit dhe zbatimi i punimeve në terren nuk përputhet me lejet e ndërtimit të miratuara. Situatat e mësipërme janë evidentuar përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt:
1."*Godinë Banimi dhe Shërbimi 2-4 dhe 6 Kate me 1 Kat Nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 3004, datë 10/03/2022, me zhvillues "Kristi Konstruksion 2003", në adresën lagjja 6, Rruga "Aleksander Goga ", Durrës;
2."*Rikonstruksion dhe ndryshim funksioni të godinës banimi dhe shërbimi 6 kat mbi tokë dhe një kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr.2763, datë 26/01/2022, me zhvillues Shoqeria IL-FA, në adresën lagjja 14, Shkozet, Durrës.
Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin nenin 27/1; në nenin 27/2, në pikën 1; me Ligjin 107/2014, datë 31.7.2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, Neni 42; me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e*

rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 27/1, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit; (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 214-246 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Durrës të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm përpara miratimit të certifikatës së përdorimit dhe për të verifikuar aktet e kontrolleve të mbajtura gjatë realizimit të zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i **2 praktika** u konstatua se realizimi i punimeve në terren nuk ishte në përputhje me projektin e ndërtimit, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt:

1."*Struktura akomoduese dhe shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore*", miratuar me vendimin Nr.3009, datë 10/03/2022, me zhvillues R.S. dhe V. S., në adresën Lalëz, njësia administrative Ishëm, Durrës; 2."*Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat*", miratuar me vendimin Nr. 2736, datë 18/01/2022, me zhvillues Besim Muharremi, në Lalz, Durrës.

Konstatimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin Nr.107/2014, për "*Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, neni 51, Inspektimi; me Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007,"*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", i ndryshuar, neni 5, detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës; neni 12, ushtrimi i kontrollit *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 214-246 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Nga IVMT Durrës të merren masat për të realizuar kontrolle të vazhdueshme në terren, me qëllim realizimin e punimeve në terren në përputhje me projektin e ndërtimit të miratuar dhe për çdo rast që evidentohen ndryshime të realizimit të punimeve, mbajtjen e proces-verbalëve për konstatimin e kundërvajtjes.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimeve dhe zhvillimit të territorit, u konstatua **1 praktikë** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me zhvillimin e ndërtimit pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh, përkatësisht në rrugën Vath Turja, Durrës, janë evidentuar ndërtimi i disa strukturave në funksion shërbimi. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, neni 51, Inspektimi; me Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007," Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, neni 5, detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës; neni 12, ushtrimi i kontrollit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 214-246 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Nga IVMT Durrës të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua **1 praktikë** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mungesën e pajisjes me çertifikatës së përdorimit, pas miratimit të lejes së ndërtimit, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt "Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat", miratuar me vendimin Nr. 2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B. M., në Lalz, Durrës. Anomalia e mësipërme nuk është në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 50; me Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 52, pika g, përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit; me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve. *(Më hollësisht*

trajtuar në pikën 2.5, faqe 214-246 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Pas miratimit të lejes së ndërtimit, DPZHT Durrës dhe IVMT të marrë masa për të zhvilluar mbikëqyrjen e punimeve dhe verifikime e ndërtimit të objektit në terren dhe nëpërmjet proces-verbalëve të bëjë konstatimin e kundërvajtjes, duke mos lejuar përdorimin e objekti pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në 7 raste nga Bashkia Durrës, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve Bashkia Durrës dhe Administrata e Ndërmarrjes BGT, është lejuar të ushtrohet aktivitet nga subjekte private në objekte pasuri shtetërore me Kontratë-Qiraje jashtë afatit, në kundërshtim me kreun VI pika 2/b të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve Bashkia Durrës dhe Administrata e Ndërmarrjes BGT, të njoftohen me shkrim Qiramarrësit, për "Zgjidhje Kontrate", pasi është mbyllur afatit i kontratës së qirasë për sipërfaqen e objektit të pasurisë shtetërore si dhe të merren në dorëzim me procesverbal objektet që ka në administrim bashkia dhe janë pa kontratë qeraje.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga "Sektori i pronave dhe aseteve" në Bashkinë Durrës, janë të administruar vetëm 2 lista të pronave të miratuara me VKM dhe konkretisht ajo e Bashkisë Durrës e cila është e miratuar me VKM nr. 536, datë 1.5.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës" dhe e ish-Komunës Ishëm e miratuar me VKM, nr. 284, datë 12.3.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Ishëm, të Qarkut të Durrësit", ndërsa Njësitë e tjera Administrative që varen nga Bashkia Durrës janë me listë paraprake, jo përfundimtare të pa miratuar me VKM, në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 i ndryshuar "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

18.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës të hartojë dhe paraqesë për miratim pranë Këshillit të Ministrave listën përfundimtare me dokumentacionin e nevojshëm shoqërues të pronave të paluajtshme publike të të gjitha Njësive Administrative, që të transferohen në pronësi apo përdorim të saj.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IVMT, në 34 raste, edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë" dhe "Prishje Objekti të Kundërligjshëm", në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 246-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

19.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës, të vijojë procedurën për nxjerrjen e Vendimit për "Dënim me Gjobë" dhe "Prishje Objekti të Kundërligjshëm", për 34 subjekte që janë me procesverbal konstatimi për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, sipas tabelës bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.06.2024

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IVMT, u konstatua se nga 119 vendime për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm", janë ekzekutuar vetëm 25 vendime të shoqëruar me Urdhër Ekzekutimi nga Kryeinspektori i IVMT-së, ndërsa për 94 vendime nuk

është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Kalimi i afateve për ekzekutimin e Prishjeve të Objektit sjell si pasojë parashkrimin e tyre dhe pamundësi për ekzekutim, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe nenin 46 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet administrative" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 246-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

20.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës, të nxjerrë Urdhër Ekzekutimi për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për 94 raste të konstatuara, për të cilat akti administrativ (vendimi për dënim për prishje) nuk është parashkruar.

Brenda datës 30.06.2024

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IVMT, u konstatua se nga Kryeinspektori i IMT-së i Bashkisë Durrës është nxjerrë "Urdhri i Ekzekutimit" për prishjen e objektit të kundërligjshëm, por nuk është vijuar prishja e objektit me justifikimin se "…*mjeti tip ekskavator nuk mund të përshkojë distancën mbi 5 km, për shkak se çdo difekt që mund t'i ndodhë gjatë rrugëtimit të gjatë, mund të nxjerrë mjetin jashtë përdorimit"*, që do të thotë se të gjitha objektet që janë për prishje mbi 5 km nuk janë të ekzekutueshëm nga IMT-ja e Bashkisë Durrës, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 246-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

21.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa, që në të gjitha rastet kur ka një Urdhër Ekzekutimi nga Kryeinspektori i IMT për prishjen e objektit të kundërligjshëm, që nuk mund të ekzekutohen me mjetet e veta, të kërkohet mbështetje me mjete nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, për prishjen e objektit të kundërligjshëm.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) Bashkia Durrës, u konstatua se për 71 vendime me "*Dënimin me Gjobë*" nuk janë likuiduar gjobat nga subjektet, në një vlerë prej 17,400,000 lekë. Nga zyra përmbarimore nuk është vijuar ekzekutimi i detyrueshëm për shlyerjen e detyrimit nga debitori, konformë nenit 519 të K. Pr. Civile, që do të thotë se IVMT-ja nuk ka informacion nga zyrat përmbarimore mbi ecurinë e ekzekutimit për shlyerjen e detyrimit nga debitorët. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 246-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1 Rekomandimi: IVMT-së Bashkia Durrës, që ndjek zbatimin e ekzekutimit të vendimeve, të kërkojë informacion nga Zyra Përmbarimore për ecurinë e ekzekutimeve të detyrimit që kanë debitorët dhe vënien në "Ekzekutim të Detyrueshëm" të Titullit Ekzekutiv, për shlyerjen e detyrimeve nga subjektet (debitorët).

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IVMT, u konstatua se në 31 raste që kjo strukturë i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Durrës për nxjerrjen e "Urdhrit të Ekzekutimit", për arkëtimin e shumave të detyrimeve, nuk është kërkuar kamatë vonesë bazuar në masën e gjobës, në kundërshtim me nenin 30, pika 1/a të Ligjit Nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 246-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

23.1. Rekomandimi: IVMT Bashkia Durrës të marrë masa që në kërkesat drejtuar Gjykatës Administrative për nxjerrjen e "Urdhrit të Ekzekutimit" për arkëtimin e shumave të detyrimeve, të kërkojë edhe kamatë vonesat, bazuar në masën e gjobës.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave në Bashkinë Durrës, u konstatua se për kategorinë "*Të ardhurat e trashëguara*" ky institucion nuk ka një listë analitike për evidentimin e këtij lloji të ardhurash por është vetëm vlera totale në kontabilitet. Kjo e bën të pamundur verifikimin e burimit nga është krijuar kjo e ardhur (e ardhura e trashëguar) e si pasojë nuk jep

mundësinë për të kontrolluar mënyrën e përdorimit të tyre. Për vitin 2022, nuk ka evidenca të sakta për llojin e të ardhurave (të trashëguara) të cilat do të shërbejnë si bazë për destinimin e tyre në shpenzime (procesin e buxhetimit). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligjin nr. 68/2017, datë 18.05.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3 pikat 2, 3, 10, 11, neni 5 germa "e", neni 12 pika 4, neni 13 pikat 1, 8, nenet 14-20, nenet 33-36; Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", neni 11, neni 63 pika ç, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 22/5, pika 3, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 6, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës, të marrë masa që të ardhurat e papërdorura gjatë vitit buxhetor dhe që trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës, të kontabilizohet sipas burimit të krijimit të tyre. Në çdo rast të bëhet kontabilizimi i plotë, i saktë dhe në kohë i llogarive, shoqëruar me një listë analitike për evidentimin e këtij lloji të ardhurash.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i **s**trukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore u konstatua se ndërthurja e veprimtarisë së DTTV Durrës me sistemin e menaxhimit të të dhënave nuk kryhet bazuar në 5 komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk ka një rregullore të brendshme për funksionimin e sistemit apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem. "Përdoruesit" organizohen dhe funksionojnë vetëm sipas kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara në pozicionin e miratuar në strukturën organizative dhe si kuadër rregullator përdorin detyrat dhe kompetencat e miratuara në rregulloren e brendshme të institucionit.

- Nuk ka informacion mbi veprimtarinë e kryer në sistem nga jashtë rrjetit të brendshëm të institucionit. Nga intervistat me stafin e Bashkisë Durrës konstatohet se persona jashtë strukturës organizative të kësaj Bashkie, pa një urdhër apo kontratë kanë akses në këtë sistem pa një protokollim të veprimtarisë dhe proçesojnë procese të rëndësishme si gjenerim i detyrimeve në sistem apo delegim dhe ndryshim kompetencash për përdoruesit etj. Rezultojnë veprime në sistem jashtë orarit zyrtar. Nuk ka informacion të saktë për identifikimin e 3 përdoruesve "1130", "1210" dhe "-1".
- Informacionit i Sistemit të manaxhimit të të dhënave nuk përputhet me evidencat zyrtare mbi të cilat DTTV planifikon dhe raporton.
- Struktura e kategorizimit të sistemit për bizneset dhe popullatën është e ndryshme nga paketa fiskale e miratuar.
- Numri i subjekteve të evidentuara në sistem sipas statusit (Aktiv, Mbyllur, Pasiv, Pezulluar) është i ndryshëm nga evidencat e DTTV .
- Raportet që prodhon ky system dhe që përpunohen më pas në formatin Excel nga sektorët për të ndërtuar evidenca nuk protokollohen.
- Nuk ka monitorim dhe dokumentim të rakordimeve midis raporteve të gjeneruara nga sistemi me formatet e përpunuara në Excel nga operatoret.
- Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk rakordojnë me DTTV lidhur me:
- Realizimet e të ardhurave për të cilat kanë përgjegjësi që ti menaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB nr. 160, datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit".
- Kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Durrës për informacion, sa i përket gjendjes debitore (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5...., neni 11,...; Udhëzimi e MFE nr. 8, datë 9.3.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika ç ; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr. 945, datë 02.11.2012, "Për miratimin e rregullores për *Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*" i ndryshuar, Manuali për MFK i miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III. Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Durrës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me strukturat drejtuese të bashkisë, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e sistemit, përshkrimin e proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem (*të hartohet manuali i proceseve të punës, harta e proceseve të punës, gjurmët e auditimit, regjistri i riskut*), bazuar në komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive dhe shkeljeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore u konstatua se:

-Bashkia Durrës nuk ka krijuar strukturën vendore të apelimit tatimor (komisioni i apelimit tatimor dhe rregullorja për funksionimin e tij) e cila shërben për apelim të akteve vendore që lidhen me taksat dhe tarifat vendore.

-Nuk realizohet në kohë njoftimi i subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore pasi përllogaritja dhe azhurnimi i detyrimeve vjetore në system bëhet manualisht. Mungon një adresar i plotë dhe i qartë për kategoritë Familjarë dhe Biznes (*nuk përdoren metoda alteranative "e-mail" për njoftimin e tatimpaguesve*). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 23, 27, 28, 30, 32, 36, 38,... neni 64 pika 3; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, në nenin 7, Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligjin nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportele", Ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe DTTV të marrë masa për të krijuar strukturën vendore të apelimit si dhe optimizimin e arkitekturës së sistemit lidhur me përditësimin e detyrimeve vjetore në mënyrë që njoftimi i subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore të bëhet në kohë, me qëllim ndjekjen e të gjitha etapave administrive dhe proçeduriale për mënjanimin e pasojave që mund të sjellin efekte financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë të "Sistemit Të Menaxhimit të të Dhënave për të Ardhurat" në Bashkinë Durrës u konstatua se Bashkia Durrës ka krijuar dhe administron " *Bazë* të dhënash shtetërore" e cila nuk është krijuar dhe nuk e kryen funksionin bazuar në kuadrin rregullator në fuqi. Ky institucion nuk ka paraqitur kërkesë për regjistrimin në "Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave Shtetërore" pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në vijim (AKSHI), i cili është autoriteti rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore" nenin 3, Ligjin nr. 2/2017, datë 26.01.2017, "Për sigurinë kibernetike" neni 4; Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e

të dhënave shtetërore" Kreun II "Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave; Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar" nenet 2, 3,.5, 6....20...27,28..; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar nenet 25, 27, 28, 31; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, "Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore" i ndryshuar; Vendimin nr. 710, datë 21.08.2013, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", (ndryshuar me VKM nr. 755, datë 26.10.2016); Kreun II, pikën k, të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", (ndryshuar me VKM nr. 36, datë 24.01.2018; nr. 88, datë 14.02.2018; nr. 448, datë 26.7.2018; nr. 872, datë 24.12.2019); pikën 4, "Kërkesat e sigurisë" shkronja b, të "Rregullores për Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike" miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; pikën 4, germa a, të "Rregullores për menaxhimin e log-eve digitale në administratën publike", miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT); *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për regjistrimin në "Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave Shtetërore" pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), të ndërtojë programin e sigurisë së informacionit bazuar në elementët kyç të tij, konkretisht, mjedisin i sigurisë së informacionit, vlerësimin e riskut, politikat e sigurisë, organizimi i sigurisë së TIK, menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, menaxhimi i aseteve, siguria e burimeve njerëzore, siguria fizike dhe mjedisore, kontrolli i aksesit, menaxhimi i incidenteve të sigurisë së tik, menaxhimi i vazhdueshmërisë së aktivitetit të njësisë dhe përputhshmëria.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se struktura e teknologjisë së informacionit (TI) nuk organizohet në nivel drejtorie. Për administrimin e sistemeve që përdor kjo bashki, specifikisht për sistemin e përmendur më sipër *nuk ka një person përgjegjës të autorizuar (marrësi në dorëzim i kodit të burimit) për administrimin e bazës së të dhënave. Shërbime të ndryshme në këtë bazë të dhënash kryhen nga personel që nuk është pjesë e strukturës organizative të personelit të Bashkisë Durrës* apo në marrëdhënie kontraktuale me Bashkinë.
Nuk ka Auditues me profil të teknologjisë së informacionit për të zhvilluar burimet njerëzore të auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit. Nuk janë planifikuar, kryer misione auditimi mbi sistemet e TI-së duke mos përmbushur kriteret e Manualit të Auditit të Brendshëm të miratuara me urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 pika 2.4.4. Këto veprime janë në mospërputhje me Manualin e Auditit të Brendshëm të miratuara me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, pika 2.4.4 dhe Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore" neni 2 dhe 5 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Durrës, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme, të analizojnë mundësinë e ndryshimeve të strukturës ekzistuese IT, me qëllim rritjen e rolit të saj dhe të marrin masa për ngritjen në nivel të strukturës së IT nga nivel sektori në nivel Drejtorie. Të caktohet një person përgjegjës i autorizuar (marrësi në dorëzim i kodit të burimit) për administrimin e bazës së të dhënave. Të merren masa që sistemi të përfshijë në arkitekturën e tij procesin e auditimit dhe analizës së të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i "*Regjistrit Elektronik të Subjekteve*" pranë DTTV , u konstatua se popullimi i sistemit me kërkesa për regjistrim të subjekteve të reja, ndryshimet në të dhënat rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet ekzistuese realizohet pa rakorduar informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB, me sektorin

e verifikimeve në terren dhe DRT.
- Akt konstatimet e mbajtura nga sektori i terrenit nuk japin informacione për përputhjen midis llojit të të dhënave që kërkohet të ndryshohen dhe të dhënave që administrohen në sistem apo në dosjen e subjektit pranë DTTV.
- Në sistem janë konstatuar raste ku subjekti ka gjendje debitore në kodin seli apo në kodet që i përkasin adresave dytësore dhe nga DTTV nuk konstatohen evidenca të ndjekjes së procedurës ligjore për mbledhjen e debisë së tyre.
- DTTV Durrës për të gjitha rastet kur statusi ka ndryshuar (*çregjistrim, pasiv apo pezullim*) ka ndërprerë faturimin e mëtejshëm të subjektit edhe pse ky çregjistrim ka ardhur si pasojë e mos përgjigjes në kohë ndaj kërkesës për evidentimin e gjendjes debitore nga QKB.
-Nga evidencat e trajtuar në DTTV nuk u paraqit asnjë dokument mbi rakordimin me degët rajonale të tatimeve lidhur me klasifikimin e biznesit dhe llojin e aktivitetit që kryen.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, neni 5, neni 11,...; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "*Për regjistrimin e biznesit*" i ndryshuar, nenet 28-40, neni 42, neni 43 germa d, neni 59; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe kontrollit, VKB nr. 160, datë 23.12.2021, "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit*"; Rregulloren e brendshme të bashkisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1 Rekomandimi: Drejtoria e TTV të rakordojë informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT Durrës.
Akt konstatimet e mbajtura nga sektori i kontrollit në terren të realizohen konformë kuadrit rregullator ligjor, brenda afateve të përcaktuara në ligj dhe të përllogariten detyrimet tatimore bazuar në paketën fiskale të miratuar në vite.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për të gjithë periudhën e audituar taksa mbi tokën bujqësore nuk është administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në kundërshtim me përcaktimet e bërë në paketën fiskale.
Për këtë taksë nuk ka regjistër të taksapaguesve. Për kategorinë "familjar" edhe pse është parashikuar në paketë fiskale që të arkëtohet nga UKD, kjo nuk është realizuar as nga UKD dhe as nga vetë bashkia, pasi vetë struktura e taksave të bashkisë për mungesë të dhënash si të familjarëve edhe të sipërfaqes për secilën familje, nuk ka bërë llogaritje të detyrimeve për këtë taksë dhe si rrjedhim, ngarkesa në faturën e ujit, nuk është kryer.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë. 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar ,neni 4 , neni 23; Paketa fiskale e miratuar nga Këshilli Bashkiak Durrës; VKB nr. 160, datë 23.12.2021, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit", pika A.1.1.2 "Taksa e tokës bujqësore". kontrata nr. 641 prot., datë 03.02.2014. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

31.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për hartimin e regjistrit të taksapaguesve privat dhe familjar për taksën e tokës bujqësore, duke evidentuar qytetarët të cilët kanë marrë tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saj, në hektar për secilin dhe mbi bazën e këtij regjistri të llogariten dhe të arkëtohen detyrimet për taksën e tokës bujqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i DTTV Durrës u konstatua se në këtë subjekt nuk ka një strategji afatshkurtër apo afatmesme, për të evidentuar familjet e paregjistruara te agjenti tatimor UKD, në mënyrë që të ndiqet arkëtimi i tyre jashtë agjentit tatimor, pra nga vetë administrata e taksave dhe tarifave vendore Durrës. DTTV nuk ka hartuar regjistër të taksapaguesve familjarë, duke mos evidentuar taksapaguesit familjarë, të cilët nuk kanë marrëdhënie me agjentin tatimorë.

Edhe pse numri i taksapaguesve familjar në vitin 2022 është rritur, nuk ka evidentime konkrete për pjesën që nuk përfshihet në UK Durrës.
Për vitin 2022 janë arkëtuar 90,840,468 lekë, ndërsa në sistem të ardhurat familjare janë 74,509,044 lekë. Diferenca midis sistemit të DTTV dhe të ardhurave të arkëtuara nga UKD ka edhe për vitin 2021.
Sa më sipër nuk është zbatuar kontrata nr. 641 prot. datë 03.02.2014, neni 5 pika 4,5,6 dhe neni 7 pika 1, pika c.
Nga Bashkia Durrës nuk janë zbatuar penalitete bazuar në nenin 7, pika 2 të marrëveshjes, ku për shkeljet e mësipërme të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative nuk janë vendosur gjoba në mbështetje të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar", veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 4, pika 7; Kontrata nr. 641 prot. datë 03.02.2014, neni 5 pika 4,5,6, neni 7 pika 1 dhe 2; Rregullore brendshme e institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

31.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të hartojë një program pune për evidentimin e të gjitha taksapaguesve familjar, si dhe të evidentohen familjet e pa regjistruara të agjenti tatimor UKD, të rakordohet periodikisht me agjentin tatimor në përputhje me kushtet e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i paketës fiskale për vitin 2022 rezultojnë mungesa sipas kategorizimeve për nënkategoritë e taksave/ tarifave dhe përjashtimet nga detyrimi për tu krahasuar me paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Durrës.
Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj në sistemin e DTTV nuk është i plotë dhe i shoqëruar me dokumentacion shoqërues (*sipas kërkesave në formularët për aplikim të miratuar nga bashkia Durrës*). Procesi për përllogaritjen e detyrimeve sipas Paketës Fiskale nuk është i saktë.
Planifikimi për Taksa dhe tarifa vendore të cilat janë burimi kryesor në realizimin e të ardhurave të veta nuk është kryer bazuar në numrin e subjekteve sipas sistemit, analizën e rezultatit historik, pritshmërive të vitit korrent dhe koordinimit midis drejtorive që mbulojnë realizimin e tyre.
Në paketën fiskale të Bashkisë Durrës nuk janë parashikuar taksa dhe tarifa vendore të përcaktuara për pajisjet automatike (*Edhe pse janë të identifikueshme*) të cilat kanë aktivitet dhe gjenerojnë të ardhura si: ATM, pajisje elektronike, lojëra për fëmijë, ekranet dixhitale të reklamimit, karikues për mjetet lëvizëse etj., (*që janë të vendosura në hapësira publike apo biznes privat, pranë institucioneve të ndryshme etj).*
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar; Ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 "*Për regjistrimin e biznesit"*, Neni 2 pika 13, Neni 2 pika 16, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 4, pika 7; Udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
32.1 Rekomandimi: Drejtoria e TTV të marrë masa për rishikimin dhe saktësimin e regjistrit të taksapaguesve kategoria biznes, duke përshtatur kategorinë/nënkategorinë me "*Veprimtarinë"* që ushtron, në mënyrë që përllogaritja e detyrimeve të bëhet e saktë sipas parashikimeve në Paketën Fiskale. Të rishikohet paketa fiskale duke parashikuar taksa e tarifa për të gjitha kategoritë e biznesit që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i korrespondencave zyrtare ndërmjet institucioneve në shkresat me objekt: "*Kthim përgjigje*" institucionit të QKB, "*Informacion periodik për subjektet të cilët aplikojnë për pezullim ose mbyllje*" u konstatua se:
Në 211 *(dyqind e njëmbëdhjetë) raste* shkresat kanë kaluar afatin kohor ligjor të dërgimit të kthimit të përgjigjeve.
Në 29 (njëzet e nënte) raste për subjekte që është kërkuar informacion për çregjistrim në QKB rezulton se nuk janë regjistruar në sistemin e DTTV, e për pasojë nuk janë llogaritur detyrime për taksa e tarifa vendore që nga data e regjistrimit të tyre në QKB si biznes.
-Në 16 (gjashtëmbëdhjetë) raste për subjekte që është kërkuar informacion për çregjistrim në QKB rezulton se, nga QKB janë çregjistruar, ndërsa në sistemin e DTTV rezultojnë debitor, pasi Sektori i kontrollit në terren pranë DTTV nuk i ka kthyer përgjigje QKB;
-Në 4 (katër) raste për subjekte që është kërkuar informacion për çregjistrim në QKB rezulton se janë mbyllur në sistemin e DTTV, ndërsa në QKB rezultojnë me statusin aktiv.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 5, neni 11,...; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
33.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të koordinojë punën me institucionet e ndërlidhura, me qëllim marrjen dhe dhënien e informacioneve ne kohë reale për shmangien e problematikave të konstatuara.
-Të kryejë inventarizimin e të gjithë subjekteve të cilët janë objekt i taksave vendore, plotësimin e një regjistri me të dhënat përkatëse dhe duke plotësojë dosjet e subjekteve me dokumente që informojnë në mënyrë kronologjike veprimtarinë e tatimpaguesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të tregjeve bashkiake që operojnë në Bashkinë Durrës u konstatua se: Në adresën ″L.12 Rr.K.Kazanxhi te tregu fshatar″ në objektin ″Ndërtesë″ me kodi në sistem nr. 96468 me administrator F. Z., ushtrohet aktiviteti ″Treg Agrobujqësor". Sipas informacionit nga Administrata e Tregut Agrobujqësor rezulton se ky aktivitet zhvillohet në një sipërfaqe afërsisht 350 m^2 dhe brenda kësaj sipërfaqe zhvillon aktivitet tregu fruta perime që administrohet nga OE "A " Shpk, me 73 banakë të pa regjistruar në sistemin e taksave dhe nuk është ngarkuar detyrimet përkatëse. Sa më sipër veprimet nuk janë në përputhje me , ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; VKB nr.160, datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit", pika A.2.6.3 "*Tarifa për sipërfaqe të tregut në administrim të Bashkisë Durrës*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
34.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës, DTTV të marrë masa për identifikimin, verifikimin dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet brenda këtij tregu pa licencat përkatës dhe pa paguar detyrimet për taksa dhe tarifa vendore sipas paketës fiksale.

Menjëherë dhe në vijimësi

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 5 raste dhe konkretisht në procedurat e prokurimit me objekt "Sistemim KUB në rrugën "Taulantia", "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House", "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 1 + Loti 2)" dhe "Riforcimi i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501", u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit, apo të paargumentuara teknikisht, në mospërputhje me Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*"

dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

35.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

36. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se në 5 raste dhe konkretisht në procedurat e prokurimit me objekt "Sistemim KUB në rrugën "Taulantia", "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House", Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 1 + Loti 2) dhe "Riforcimi i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501", në vlerën totale të fondit limit prej 524,304,287 lekë, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

36.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

37. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së shërbimit nr. 9853/8 prot., datë 08.10.2021, me objekt "Depozitimi i mbetjeve urbane", Bashkia Durrës, me vlerë të kontratës (pa tvsh) 281,508,800 lekë, realizuar nga OE "I " BV SPV (për 12 muaj), rezultoi se:
- Në kontratë nuk ekzistojnë specifikime teknike të detajuara, nuk ka një peshore dhe persona përgjegjës për peshimin e mbetjeve para transportit për në Landfill-in e Sharrës, veprime që krijojnë hapësira dhe mbartin riskun për shifra fiktive të ardhura nga Furnizuesi dhe për pagesa të pajustifikuara.
- Për realizimin e proçesit të plotë të pastrimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane, në planifikimin e shpenzimeve për vitin 2022, shpenzimet e planifikuara për menaxhimin e mbetjeve urbane janë 683,591,000 lekë, pa depozitimin e mbetjeve në Landfillin e Sharrës ose 1,038,724,000 lekë duke përfshirë edhe depozitimin e cila përbën 14% të buxhetit të Bashkisë Durrës në vlerën 7,038,724,000 lekë *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

37.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa të menjëhershme për:
- Gjetjen e rrugëve ligjore për amendimi e kontratës në lidhje me specifikimet teknike të detajuara, si dhe për gjetjen e zgjidhjes për peshimin e mbetjeve para transportit për Landfillin e Sharrës me qëllim kryerjen e pagesave sipas shërbimit real të këtij procesi jetik për qytetarët.
- Ngritjen e një grupi pune për studimin e fizibilitetit të shërbimit të pastrimit të qytetit dhe depozitimit të mbetjeve urbane, i cili me mbarimin e kontratës aktuale të depozitimit të mbetjeve të shërbejë si bazë për të gjetur rrugët alternative për proçesin e plotë të manaxhimit të mbetjeve (pastrim dhe depozitim), që ky shërbim të jetë cilësor dhe me kosto sa më të ulët me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve të Bashkisë Durrës.

Menjëherë

38. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës për dhënie me qira të sipërfaqeve funksionale të tregut Agrobujqësor, u konstatua se kontrata e qirasë lidhur midis Bashkisë Durrës dhe OE "A " shpk, sipërfaqja e zënë nga ky subjekt e tejkalon sipërfaqen e marrë me qira duke mos respektuar kontratën e lidhur me Bashkinë Durrës sa I përket përcaktimeve në nenin 2 pika 2.1 "*Qëllimi i përdorimit të kontratës".* Veprime në kundërshtim me VKM nr.

54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies të qirave të Enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetrore", i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

38.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës (Sektori I pronave dhe I Kontrollit), të marrë masa për verifikimin e sipërfaqes së zënë më tepër nga subjekti "A " shpk, të përllogarisë diferencën dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për vjeljen e detyrimit të krijuar, si dhe të kërkojë lirimin e sipërfaqes së zënë më tepër.

Menjëherë dhe në vijimësi

39. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i ankesës së shtetasit K.K , në lidhje me ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor të Formës së Prerë protokolluar në KLSH, me nr.587/3 prot., datë 20.09.2023, u konstatua se Bashkia Durrës, përfaqësuar nga titullari institucionit, si personi i ngarkuar nga ligji, nuk ka kryer ekzekutimin e Vendimit të Shërbimit Civil nr. 169 datë 20.12.2010, lënë në fuqi me Vendimin gjyqësor nr. 14, datë 06.04.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës. për të paguar në favor të palës kreditore deri në Gusht 2023 shumën 7,980,855 Lekë.

-Nga auditimi i ankesës së shtetasit G.K në lidhje me ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor të Formës së Prerë, protokolluar në KLSH, me nr.884 prot., datë 09.10.2023, u konstatua se Bashkia Durrës, përfaqësuar nga titullari institucionit, si personi i ngarkuar nga ligji, nuk ka kryer ekzekutimin e Vendimit nr. 3289, datë 26.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë për të paguar në favor të palës kreditore deri në dhjetor 2022 shumën 7,457,014 Lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 142/3, neni 42/2; K.Pr.Civile, neni 451/a, neni 500, neni 609, neni 615; Kodin civil, neni 112; Udhëzimin nr. 1, Datë 04.06.2014 "*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit'* pika 2; Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 "*Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së presë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil*", Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 306-319 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

39.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për shtetasit K.K dhe G.K dhe të shmangin në të ardhmen ndjekjen e procedurave të gabuara për çështjet e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", **nga Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,794,896 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "FV Ndriçimi rruga Neki Libohova dhe "Marta Durda"", Bashkia Durrës, me vlerë 10,306,880 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve OE "A. Co" SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **552,966 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1801/6 prot., datë 09.09.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe OE "A.-2. Co" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **552,966 lekë pa TVSH** nga OE "A.-2. Co" SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1801/6 prot., datë 09.09.2022, me objekt "FV Ndriçimi rruga Neki Libohova dhe "Marta Durda"", Bashkia Durrës", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "*FV Ndriçimi rruga "Shoqëria Bashkimi", "Aleks Komeni", "Krisaq Boshnjaku*", "Paskal Prodani", Bashkia Durrës, me vlerë 8,679,007 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve OE "S.U." SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **358,131 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1797/13 prot., datë 14.06.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe OE "S. U." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **358,131 lekë pa TVSH** nga OE "S. U." SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1797/13 prot., datë 14.06.2022, me objekt "FV Ndriçimi rruga "Shoqëria Bashkimi", "Aleks Komeni", "Krisaq Boshnjaku", "Paskal Prodani", Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "*Riforcim godine banimi 12 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, rruga Neki Libohova***"** nr.70, kod GIS 5061, 5063", Bashkia Durrës, me vlerë 204,334,356 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve BOE "E.-Alb" SHPK & "Ll." ShPK & "E. K." SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **1,118,965 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3638/2 prot., datë 01.06.2021, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe BOE "E.-Alb" SHPK & "Llazo" ShPK & "E. K." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,118,965 lekë pa TVSH** nga BOE "E.-A." SHPK & "Ll." ShPK & "E. K." SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3638/2 prot., datë 01.06.2021, me objekt "Riforcim godine banimi 12 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, rruga Neki Libohova" nr.70, kod GIS 5061, 5063", Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "Përforcimi i terrenit nga rrëshqitja e dherave në zonën e ndodhur në lagjen nr. 10, në kodrën pranë Currilave, nga ana veriore dhe perëndimore të saj", Bashkia Durrës, me vlerë 10,320,229 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve OE "N." SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **298,400 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1574 prot., datë 24.03.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe OE "N." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **298,400 lekë pa TVSH** nga OE "N." SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1574 prot., datë 24.03.2022, me objekt "Përforcimi i terrenit nga rrëshqitja e dherave në zonën e ndodhur në lagjen nr. 10, në kodrën pranë Currilave, nga ana veriore dhe perëndimore të saj", Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "*Rikonstruksioni rruga Ali Pashë Tepelena, At Gjergj Fishta dhe Migjeni*", Bashkia Durrës, me vlerë 9,853,620 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve OE "B." SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **161,138 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 306 prot., datë 13.01.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe OE "B." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **161,138 lekë pa TVSH** nga OE "B." SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 306 prot., datë 13.01.2022, me objekt "Rikonstruksioni rruga Ali Pashë Tepelena, At Gjergj Fishta dhe Migjeni", Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "*Rikonstruksioni rruga "Azem Hajdari - Migjeni*" NjA Rrashbull, Bashkia Durrës, me vlerë 8,719,716 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve BOE "V. E" ShPK & "S.2F" SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **135,096 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7842/6 prot., datë 25.11.2021, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe BOE "V. E" ShPK & "S. 2F" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **135,096 lekë pa TVSH** nga BOE "V.E" ShPK & "S. 2F" SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 7842/6 prot., datë 25.11.2021, me objekt "Rikonstruksioni rruga "Azem Hajdari - Migjeni" NjA Rrashbull, Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "*Rikonstruksion rruga Currila, segmenti hotel Ferrara-Guest House*", Bashkia Durrës, me vlerë 27,887,100 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve OE "B." SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **170,200 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3473/7 prot., datë 29.08.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe OE "B." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **170,200 lekë pa TVSH** nga OE "B." SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar

në kontratën me nr. 3473/7 prot., datë 29.08.2022, me objekt "Rikonstruksion rruga Currila, segmenti hotel Ferrara-Guest House", Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Në 9 raste**,** nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe nga Drejtoria Juridike nuk është Monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë në lidhje me mospagesën e qirasë për sipërfaqen e objekteve pasuri shtetërore ***duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumen totale prej*** **939,832 lekë,** në kundërshtim me kreun VI pika 1 të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6., faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të kërkojnë në rrugë gjyqësore për të gjitha rastet, shlyerjen e detyrimeve të parashikuara në kontratë në shumen totale prej 939,832 lekë, të shoqëruar me penalitet kamatë ditore prej 0.1% të vlerës së qirasë mujore.

Brenda datës 30.06.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga qiradhënësi Bashkia Durrës është zgjidhur kontrata e qirasë me qiramarrësin I. K., pa bërë më parë pagesën e dy muajve në shumen prej 79,380 lekë të shoqëruar me penalitet kamatë ditore prej 0.1% të vlerës së qirasë mujore, ***duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Durrës,*** në kundërshtim me neni 6 "Pagesa e Qirasë" e Kontratës së Qirasë lidhur në datë 17.1.2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6., faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë juridike, të kërkojë në rrugë gjyqësore pagesën e dy muajve nga qiramarrësi I. K. në shumen prej **79,380 lekë**, të shoqëruar me penalitet kamatë ditore prej 0.1% të vlerës së qirasë mujore.

Brenda datës 30.06.2024

3. Gjetje nga auditimi: a. Nga auditimi u konstatua se Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" për taksa dhe tarifa vendore më datën 01.01.2018, ka qenë në vlerën 733,273,353 lekë. Gjatë vitit 2018 për këtë llogari ka pasur pakësime në vlerën 630,083,524 lekë, ndërsa më datë 31.12.2018, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 103,189,829 lekë. Për pakësimin e kryer në vlerën **630,083,524 lekë** e cila i përket detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore, nga Bashkia Durrës nuk administrohet asnjë vendim, shkresë apo dokumentacion për vlerën e pakësuar.

- Nga auditimi i procesit rezulton se nuk rakordon vlera e detyrimit vjetor të subjekteve në sistemin e DTTV me atë të paraqitur në evidencat për raportim në kontabilitet.

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën në mënyrë rastësore 11 subjekte nga sistemi dhe u ndoq procesi i përgatitjes së regjistrit të borxhit prej të cilit përgatiten evidenca të ndryshme nga DTTV. Rezultatet e testimit të këtij procesi për 11 subjektet e përzgjedhura në trajtë narrative shprehen si më poshtë:

Për vitin 2021 Detyrimi i evidentuar në sistem krahasuar me detyrimin paraqitur në evidencën për kontabilitet për vitin 2021 rezulton me diferencë negative.

Në sistem detyrimi është 1,084,371 lekë më pak se detyrimi i paraqitur në evidencën për kontabilitet.
Për vitin 2022 detyrimi i evidentuar në sistem krahasuar me detyrimin paraqitur në evidencën për kontabilitet për vitin 2022 rezulton me diferencë pozitive.
Në sistem detyrimi është 888,520 lekë më shumë se detyrimi paraqitur në evidencën për kontabilitet.
Detyrimi progresiv vetëm në vitet 2021 - 2022 i evidentuar në sistem për këto 11 subjekte rezulton me difrerencë pozitive krahasuar me detyrimin paraqitur në evidencën për kontabilitet për vitin 2021.
Në sistem detyrimi është **7,315,195 lekë** më shumë se detyrimi paraqitur në evidencën për kontabilitet.
DTTV Durrës nuk paraqet në kontabilitet vlerën e saktë të detyrimit vjetor për subjektet.
Sipas rezultateve të përfituara nga testimi konstatohet një diferencë në vlerën 7,315,195 lekë midis Kontabilitetit dhe Sektorit të Menaxhimit të Borxhit. Në sistem detyrimi është 7,315,195 lekë më shumë se në evidencën e paraqitur për kontabilizim (për 11 subjektet e zgjedhura). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296,, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 4 pika 26, neni 6; neni 10 dhe 11, të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me UMF nr. 5 datë 21.02.2022, ...pika 32, ...Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të bëjë saktësimin e vlerës të kërkesave për arkëtim mbi debitorët për të gjitha subjektet tatimpagues, duke përllogaritur detyrimet tatimore bazuar në paketën fiskale të miratuar në vite dhe nëse dalin diferenca të planifikohen për t'u arkëtuar dhe identifikuar debinë aktuale, të paraqesin në dokumentacionin kontabël dhe në pasqyrat financiare vlerën e saktë të tyre.
Bashkia Durrës të ngrejë një grup pune për identifikimin e personave përgjegjës dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse për ndryshimin e detyrimeve në kontabilitet (pasqyrat financiare vjetore) dhe për pasqyrimin jo të saktë të detyrimit vjetor për subjektet, në shumën prej **630,083,524 lekë** vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Durrës.
Bashkia Durrës, të bëjë saktësimin e vlerës prej 7,315,195 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Durrës si dhe rakordimin e të dhënave midis drejtorive me qëllim unifikimin e detyrimeve të taksapaguesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të çregjistrimit dhe ndjekjes së subjekteve debitore nga DTTV u konstatua se evidencat e DTTV dhe raportet e sistemit të DTTV kanë mospërputhje midis tyre dhe detyrimet nuk pasqyrohen korrekt në pasqyrat financiare të bashkisë.
Nga grupi i auditimit u përzgjodhën 40 raste nga lista e bizneseve të cilëve ju është ndryshuar statusi në Sistem (nga Aktiv në mbyllur, pasiv, pezulluar).
Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:
- Për të 40 rastet, të cilat kanë ndryshuar status nga "aktiv" në "mbyllur", në sistemin e DTTV detyrimet nuk janë pasqyruar korrekt në të gjitha raportet e DTTV, ku 17 subjekte rezultojnë Aktiv në Regjistrin Elektronik të QKB dhe 20 subjekte rezultojnë me statusin çregjistruar ose pezulluar.
Vlera e detyrimit për subjektet e analizuara sipas evidencave të përgatitura nga DTTV për kontabilizimin e borxhit për vitin 2022 është 0 lekë, ndërsa vlera e detyrimit për subjektet e analizuara sipas Sistemit të DTTV, është 72,114,783 lekë;

- Procesi i ç'rregjistrimit në Regjistrin Elektronik të QKB bëhet pa u shlyer ose bllokuar vlera debitore e subjektit.
- Mbyllja në sistemin e DTTV për këto subjekte bëhet si rezultat i çregjistrimit në QKB për shkak të vonesave në kthim përgjigjet e DTTV *(Në rast të mungesës së një konfirmimi në kohë nga DTTV, QKB proceson me çregjistrimin automatik*).
- Statusi (mbyllur, pezulluar, pasiv) në sistemin e DTTV bën që ky subjekt mos të ngarkohet me detyrime për taksa dhe tarifa vendore dhe nuk pasqyrohet më në asnjë raport apo evidencë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 5, 6, 10, 11,...; Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë i ndryshuar" neni 1, neni 2 germat a, ç, neni 5 germat a, d, dh, f, g, gj, h, i, neni 6 pikat 1, 2, 3, neni 12 germat a, b, dh..., neni 13 germa b, neni 15, neni 23 pika 1, 4, neni 26, neni 27,neni 28 pika 1, neni 29, neni 31, neni 40, neni 41, neni42, neni 43 pika1, 2, 3, neni 44, neni 45, neni 47 , neni 48 pika 1, neni 57 pikat 4, 5, nenet 60, 61, 62, neni 65 pika 5, nenet 68, 69 , neni 70 pika 2, neni 71/1 pika 5 ; ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, nenet 28 –40, neni 42, neni 43 germa d, neni 59 ; Manualin i Menaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108 datë.17.11.2016; Udhëzimin nr. 26, datë 16.12. 2014; Udhëzimin nr. 655/1 datë 06.02.2007 "Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proçeduriale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore; VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores "*Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*", i ndryshuar; VKB - në nr.160, datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit"; të Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me UMF nr. 5 date 21.02.2022, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik"; Rregulloren e brendshme të Bashkisë Durrës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të bëjë saktësimin e vlerës të kërkesave për arkëtim mbi debitorët për të gjitha subjektet tatimpagues, duke paraqitur në dokumentacionin kontabël dhe në pasqyrat financiare vlerën e saktë të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe arkëtimit të taksës së pasurisë biznes (ndërtesës), u konstatua se ka pasaktësi në identifikimin e pasurive, sipërfaqeve dhe kontratave përkatëse për planifikimin e saktë të taksës mbi pasurinë kategoria biznes.

-Pranë 2 qendrave tregtare të kontrolluara zhvillojnë aktivitet rreth 50 subjekte të cilat taksën e ndërtesës e kanë kaluar te personi që zotëron pronësinë e qendres. Këta persona janë debitorë në këtë zë qysh prej vitit 2010, konkretisht në vlerën 26,000,000 lekë dhe në vlerën 9,961,000 lekë.

Gjithashtu u konstatua se një nga pronarët në objektin F. C. nga vitit 2015 e në vazhdim nuk është ngarkuar me detyrimin sipas paketave fiskale të miratuara, që nga përllogaritja e DTTV, ky detyrim kap vlerën e 1,867,416 lekë.

Nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në këtë qendër tregtare konstatohet një debi e akumuluar në vlerën prej 17,677,555 lekë, ku taksa e ndërtesës kap vlerën 13,836,609 lekë.

-Në lidhje me ngarkesën fiskale 2022 sipas të dhënave të sistemit, është identifikuar se kjo qendër është taksuar për taksë ndërtesë për një sipërfaqe 11,234.36 m^2 dhe pjesa e mbetur prej 2984.66 m^2 nuk është arritur të identifikohet në sistem.

-Nga shqyrtimi i të dhënave që administrohen në sistemin e DTTV Bashkia Durrës dhe dokumentacionit të administruar në praktikën nr. 172175 për Subjektin B. G. u konstatua se

të dhënat që administrohen në ekstraktin historik të QKB, nuk përputhen me të dhënat e paraqitura në akt konstatimin nr. 0015309, mbajtur më datë 12.11.2019, mbi të cilin bëhet regjistrimi në sistemin DTTV.
Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar vullnetarisht nga subjekti pranë QKB u konstatua se sipërfaqja totale është njësi 592 m^2, Apartament 239.5 m^2 dhe jo 100 m^2 sipas akt konstatimit me nr. 0015309 mbajtur më datë 12.11.2019.
Nga DTTV konkretisht sektori i terrenit dhe sektori i manaxhimit të borxhit nuk është marrë asnjë masë për qartësimin e sipërfaqeve në administrim të B. G. apo situatës debitore të tij dhe subjekteve që administrohen prej tij.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 20, neni 22/5..; në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 5, 8, neni 23 pika 4, 60, 61, 62, neni 71/1 pika 5, neni 73, neni 89, pika 2, neni 116; VKM nr. 132, datë 7.3.2018 "*Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës*"; Udhëzimin nr. 17 datë 20.06.2022 "*Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve proçeduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore* "; VKB - në nr.160, datë 23.12.2021 "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit*", pika A.1.1.1 "*Taksa mbi ndërtesat*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të identifikojë çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e bashkisë, si dhe të planifikojë detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve e prapambetura.
5.2 Rekomandimi: DTTV Bashkia Durrës, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët në shumën 55,505,971 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve që lindin për taksa dhe tarifa vendore, respektivisht:
- **vlera 35,961,000 lekë,** për 50 subjekte që ushtrojnë aktivitet në 2 qendra tregtare "F. C." dhe " Tregtare Blu Star".
- **vlera 1,867,416 lekë** për z. R. R. në cilësinë e pronarit në objektin "F. C." nga viti 2015.
- **vlera 17,677,555 lekë** nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në qendrën tragtare "F. C.".

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të tregjeve bashkiake që operojnë në Bashkinë Durrës u konstatua se ka një mosrakordimi të dhënash midis DTTV-së dhe administratës së tregut Agrobujqësor Bashkia Durrës kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës me anë të Vendimit nr. 536, datë 01.05.2008 "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës të Qarkut të Durrësit*". Për këtë pronë Bashkia Durrës nuk disponon çertifikatë pronësie.
-Tregu Agrobujqësor ka funksionuar si treg qysh prej datës 15.03.2022 sipas proces verbalit datë 15.03.2022 dhe pyetësorëve me personelin që e administron. Tregu Agrobujqësor ka një vlerë të pa arkëtuar për 265 tregtarë për zënien e hapësirës në tregje për periudhën (15/03/2022-01/08/2022) në shumën prej 4,650,750 lekë**,** vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Durrës.
-Menaxhimi i tregut dhe zënia e hapësirave tregtuese nga tregtarët nuk llogaritet sipas Paketës Fiskale të miratuar me m^2 por me banak duke sjell mungesë të ardhurash për Bashkinë Durrës në vlerën rreth 10,308,545 lekë.
Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me , ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar; ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në*

Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; VKB nr.160, datë 23.12.2021 "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit*", pika A.2.6.3 "*Tarifa për sipërfaqe të tregut në administrim të Bashkisë Durrës*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për verifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregjet të cilat administrohen nga bashkia duke llogaritur dhe arkëtuar detyrimet për të gjitha subjektet që nga data kur ka filluar shfrytëzimi i tregut Agrobujqësor.

6.1 Rekomandimi: DTTV Bashkia Durrës, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët në shumën 4,650,750 lekë për 265 tregtarët e tregut Agrobujqësor, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve që lindin për taksën dhe tarifa vendore me qëllim shmangien e mundësisë për çregjistrimin e tyre pa shlyer detyrimet tatimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua **1 praktikë** në të cilën mënyra e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratuar për leje ndërtimi, me objekt:1."Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat", miratuar me vendimin Nr.2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B. M., në Lalz, Durrës, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **96,315 lekë.** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me bazën të Ligjit Nr. 107/2014, për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 46 dhe Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Neni 27. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 214-246 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Durrës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **96,315 lekë**, që përbëjnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Brenda datës 30.06.2024

E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 2 raste u konstatua përllogaritje e gabuar e fondit limit në vlerën 534,240 lekë më shumë për vendosje të zërit të punës në mënyrë të paargumentuar në objektin "Sistemim KUB në rrugën "Taulantia" dhe 5,982,745 lekë më shumë për vendosje të çmimit jo sipas manualin në fuqi të çmimeve të punimeve të ndërtimit në objektin "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House", veprime jo në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të nxjerrë përgjegjësitë për rastet e përllogaritjes së fondit limit në mospërputhje me legjislacionin e punimeve të ndërtimit dhe të marrë masat e nevojshme për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen, me qëllim përdorimin me ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Durrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me objekt "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House" Bashkia Durrës, me fond limit 37,248,896 lekë pa TVSh, fituar nga OE "B. ShPK me vlerë 23,239,590 lekë pa

TVSh, u konstatua se është skualifikuar padrejtësisht OE "K." ShPK me ofertë ekonomike 20,871,590 lekë pa TVSh, ose 2,841,192 lekë pa TVSh më pak se OE i shpallur fitues, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e skualifikimit të padrejtë të këtij OE dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Durrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me objekt "Shtimi i funksionaliteteve të kontrollit dhe kalkulimeve të taksave, vjeljes së detyrimeve dhe menaxhimit më eficient të buxhetit fiskal në sistemin ekzistues të Bashkisë Durrës", u konstatua se pas kërkesës së Bashkisë Durrës drejtuar AKSHI-t për miratimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike për përmirësimin e sistemit ekzistues, AKSHI nuk e ka bërë miratimin e specifikimeve teknike, duke njoftuar Bashkinë Durrës që po kryhet një procedurë prokurimi që përfshin procedurën e filluar nga kjo bashki. Edhe pas këtij njoftimi AK Bashkia Durrës, ka kryer prokurimin e këtij shërbimi me fond limit 32,989,483 lekë. Ky investim, me implementimin e projektit për të cilën ka filluar procedura e prokurimit në AKSHI, nuk do të funksionojë më, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve të Bashkisë Durrës në vlerën 32,989,483 lekë. Ky veprim është në kundërshtim me VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës, të nxjerrë përgjegjësitë për kryerjen e këtij investimi, që mund të dublohet me përfundimin e investimit nga ana e AKSHI-t dhe të marrë masat e nevojshme për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve të Bashkisë Durrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

F. MASA DISIPLINORE

Për të gjithë punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Durrës**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", VKM nr. 115, datë 05/03/2014, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil", i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale për **33 punonjës**, si më poshtë:

F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

a. **"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në 2 vjet" deri në "Largim nga shërbimi civil", sipas shkeljeve të konstatuara për punonjësit si më poshtë:**

1. Z. A.I., në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

Për moszbatim të nenit 82, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në procedurat si më poshtë:

- Për procedurën e prokurimit, "Sistemim KUB në rrugën "Taulantia", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House", Bashkia Durrës, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me një OE tjetër;
- Për procedurën e prokurimit, "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 1+Loti 2)", Bashkia Durrës, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, "Riforcimi i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501", Bashkia Durrës, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;

2. Znj. K. B., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
Për moszbatim të nenit 82, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në procedurat si më poshtë:

- Për procedurën e prokurimit, "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House", Bashkia Durrës, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me një OE tjetër;
- Për procedurën e prokurimit, "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 1+Loti 2)", Bashkia Durrës, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, "Riforcimi i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501", Bashkia Durrës, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;

3. Z. L. F., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
***4.* Z. B. M.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
Për moszbatim të nenit 82, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në procedurat si më poshtë:

- Për procedurën e prokurimit, "Sistemim KUB në rrugën "Taulantia", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;

***5.* Z. G. D.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
Për moszbatim të nenit 82, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në procedurat si më poshtë:

- Për procedurën e prokurimit, "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House", Bashkia Durrës, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me një OE tjetër;

6. Znj. I. F., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
Për moszbatim të nenit 82, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në procedurat si më poshtë:

- Për procedurën e prokurimit, "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe

Manëz (Loti 1+Loti 2)", Bashkia Durrës, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;

7. Z. L.B , në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
Për moszbatim të nenit 82, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në procedurat si më poshtë:
- Për procedurën e prokurimit, "Riforcimi i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501", Bashkia Durrës, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Menaxhimit të Borxhit dhe Apelimit, pasi është konstatuar me shkelje në 8 raste, në lidhje me mosmarrjen e masave të shlyerjes së borxhit dhe ndjekjen e proceseve për realizimin e të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
8. z. F. A.
9. z. K. D.
10. z. E. K., me detyrë punonjës pranë Drejtorive të varësisë së Bashkisë Durrës, në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës për mbikëqyrjen e kontratës "Depozitimi i mbetjeve urbane", Bashkia Durrës, pasi nga mosveprimet e tyre, ka patur diferenca në volumet e shërbimit të situacionuara nga ato të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 14,370,743 lekë pa tvsh.
11. Znj. K. A., me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik, nga periudha 07/09/2009, për parregullsitë e konstatuara në **10 raste**, në lejet e ndërtimit dhe në certifikat e përdorimit të miratuara.

b. "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj", deri në "Largim nga shërbimi civil", në proporcion me shkeljen, për tre punonjësit e mëposhtëm:

1- Znj. I. B., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkisë Durrës.
2. **Znj. A. M.**, me detyrë specialist i Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.
3. **Znj. A. M.**, me detyrë specialist i Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në lidhje:
-**Me 9 rastet,** ku nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe nga Drejtoria Juridike nuk është Monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë në lidhje me mos pagesën e qirasë për sipërfaqen e objekteve pasuri shtetërore ***duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumen totale prej*** **939,832 lekë,**
-Me 7 raste ku nga Bashkia Durrës, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve Bashkia Durrës dhe Administrata e Ndërmarrjes BGT, është lejuar të ushtrohet aktivitet nga subjekte private në objekte pasuri shtetërore pa Kontratë-Qiraje.
-Në 7 rastet ku nga Qiradhënësi Bashkia Durrës, (Administrata e Ndërmarrjes BGT) nuk është njoftuar me shkrim Qiramarrësi, për dorëzimin e objektit për "Zgjidhje Kontrate" pasi është mbyllur afatit i kontratës së qirasë për sipërfaqen e objektit të pasurisë shtetërore.

c. "Vërejtje", për 23 punonjësit si më poshtë:

1. Z. E.L , me detyrë Drejtori i Drejtorisë Ekonomike në Bashkinë Durrës, konstatuar me shkelje në 5 raste në lidhje me procesin kontabilizimit të të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

2. Z. L.D me detyrë Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore konstatuar me shkelje në 12 raste në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
3. Zj. H. H. Përgjegjësi i Sektorit të Financës pranë Drejtorisë Ekonomike në Bashkinë Durrës, konstatuar me shkelje në 3 raste në lidhje me procesin kontabilizimit të të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
4. Zj. V.Q me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit në Bashkinë Durrës konstatuar me shkelje në 5 raste në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
5. Zj. A.K me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Regjistrimit të të Ardhurave konstatuar me shkelje në 5 raste në lidhje me realizimin e të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
6. Zj. M.P me detyrë Drejtor i Auditit të Brendshëm konstatuar me shkelje në 3 raste në lidhje me mos evidentimin mbi auditimin e realizimit të të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
7. Z. SH.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit të Taksave dhe Tarifave Vendore konstatuar me shkelje në 6 raste në lidhje me realizimin e të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
8. Z. F. K. me detyrë Administrator i Tregut AgroBujqësor konstatuar me shkelje në lidhje realizimin e të ardhurave nga kjo veprimtari, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
9. R. D.
- Në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të Dokumenteve të Tenderit me objekt "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House", Bashkia Durrës, për përllogaritje të gabuar të fondit limit, me pasojë rritjen fiktive të fondi limit në vlerën 5,982,745 lekë
- Në cilësinë e Drejtorit të DPKZHT Bashkia Durrës, nga periudha 30/03/2022, për parregullsitë e konstatuara në **2 raste**, në lidhje me mosparaqitjen e saktë të planvendosjes së miratuar dhe respektimin e të gjitha distancave, në lejet e ndërtimit të miratuara me objekt:
1."*Godinë shërbimi & banimi 6 kat+1 kat nën tokë & banesë 2 kat +1 kat nën tokë*", miratuar me vendimin Nr. 104, datë 29.04.2022, me zhvillues "A. K. 2019" ShPK, në adresën Lagjja 17, Rruga "Doktor Remzi", Durrës.
2."*Struktura akomoduese turistike 2 dhe 3 kat dhe rrethim i pronës*", miratuar me vendimin Nr. 925-22/6, datë 21/12/2022, me zhvillues "Ch. G." ShPK, në adresën Hamallë, Njësia administrative Manëz, Durrës.

10. J.K.
- Në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të Dokumenteve të Tenderit me objekt "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House", Bashkia Durrës, për përllogaritje të gabuar të fondit limit, me pasojë rritjen fiktive të fondi limit në vlerën 5,982,745 lekë
- Në cilësinë e hartuesit të dokumenteve të tenderit me objekt "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 1+Loti 2)", Bashkia Durrës dhe me objekt "Riforcimi i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501", Bashkia Durrës, në lidhje me kriterin e stafit teknik
11. M. J.
- Në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të Dokumenteve të Tenderit me objekt "Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House", Bashkia Durrës, për përllogaritje të gabuar të fondit limit, me pasojë rritjen fiktive të fondi limit në vlerën 5,982,745 lekë.

- Në cilësinë e hartuesit të dokumenteve të tenderit me objekt “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 1+Loti 2)”, Bashkia Durrës dhe me object “Riforcimi i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501”, Bashkia Durrës, në lidhje me kriterin e stafit teknik.

12. Zj. N.S , me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave konstatuar me shkelje në 3 raste në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

13. Z. A. L.me detyrë Specialist (Inspektor) i Sektorit të Kontrollit**,** konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

14. Z. E. Gj. me detyrë Specialist (Inspektor) i Sektorit të Kontrollit**,** konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

15. Z. J. H. me detyrë Specialist (Inspektor) i Sektorit të Kontrollit**,** konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

16. Z. A. H. me detyrë Specialist (Inspektor) i Sektorit të Kontrollit**,** konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

17. Z. M. P. me detyrë Inspektore e Taksave pranë Tregut Agrobujqësor**,** konstatuar me shkelje në lidhje realizimin e të ardhurave nga kjo veprimtari, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

18. Znj.A. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nga periudha 09/06/2021, për parregullsitë e konstatuara në **5 raste**, në lejet e ndërtimit dhe në certifikat e përdorimit të miratuara.

19. Znj. J. M., me detyrë specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021, për parregullsitë e konstatuara në **1 rast**, në lejen e ndërtimit të miratuar.

F.2. Për punonjësit me kontratë pune.

a- <u>Zgjidhje të kontratës së punës për një punonjës</u>:

1. Z. D. M., me detyrë Kryeinspektor i IMT-së Bashkia Durrës nga periudha 01.01.2022 e në vazhdim, pasi nga auditimi u konstatua se:

-Në 35 raste edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Prishje e Objektit të Kundërligjshëm” dhe vendimin për “Dënim me Gjobë”, çka ka bërë mosrespektim të afateve të parashikuara në ligj dhe mosvijimin e procedurave për nxjerrjen e vendimeve për subjektet që kanë ndërtuar pa leje ndërtimi për qëllim fitimi, në kundërshtim me nenin 5 pika “d“ dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Në 94 raste, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e “Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektit të Kundërligjshëm“, që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishje, vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Durrës, duke u bërë shkaktar i rritjes së numrit të ndërtimeve informale që kalojnë në procesin e legalizimit, ku subjektet kanë përfituar parcela ndërtimore në pronësi publike, në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, në kundërshtim me nenin 5 pika “d“

dhe nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe në kundërshtim me nenin 52 pika 6 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.
-Në 17 raste nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është bërë "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Institucioneve ligjzbatuese, në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, çfarë ka bërë që objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishje**.** vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Durrës,
Theksojmë se për këto shkelje, përgjegjësia ligjore bie mbi shtetasin D. M., me detyrë Kryeinspektor pranë IMTV-së Bashkia Durrës.

b- <u>"Vërejtje" për 4 (katër) punonjës, si më poshtë:</u>

1. Z. S. M., me detyrë inspektor nga periudha 17/06/2019, për parregullsitë e konstatuara në **2 raste** në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara me objekt:
1."*Struktura akomoduese dhe shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore*", miratuar me vendimin Nr.3009, datë 10/03/2022, me zhvillues R.S. dhe V.S., në adresën Lalëz, njësia administrative Ishëm, Durrës.
2."*Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat*", miratuar me vendimin Nr. 2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B. M., në Lalz, Durrës.
2. Z. G. H., me detyrë inspektor i IMT-së, nga periudha 27/12/2017, për parregullsitë e konstatuara në **1 rast** në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara me objekt:
1."*Godinë Banimi dhe Shërbimi 2-4 dhe 6 Kate me 1 Kat Nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 3004, datë 10/03/2022, me zhvillues "K.K. 2003", në adresën lagjja 6, Rruga "Aleksander Goga ", Durrës.
3. Z. A. H., me detyrë inspektor i IMT-së, nga periudha 10/5/2021, për parregullsitë e konstatuara në **1 rast** në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara.
4. Z.K. L., me detyrë inspektor i IMT-së, nga periudha 5/5/2014, për lejimin e zhvillimit të ndërtimeve pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh, në rrugën "Vath Turja", Durrës.

H. <u>PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:</u>
Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore në pikat "E" dhe "F" më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë**:
1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit për punonjësit e listuar në pikën "E", në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.
2. Ti kërkojë Departamentit të Administratës Publike kryerjen e verifikimeve nëse punonjësit e listuar në pikën "F" janë pjesë e shërbimit civil dhe të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e procedurës disiplinore, mbi bazën e fakteve të paraqitura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.
3. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

V. ANEKSET

Aneksi nr. 1 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)", nga faqja 284 deri 306 të të Raportit Përfundimtar.

Subjektet që nga Kryeinspektori i IMT-së nuk janë nxjerrë vendime për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm", janë sipas tabelës:

Nr.	EMËR SUBJEKTI	NR. PROT P-V KONSTATIMI INSP.
1	P.D.'D.' shpk Lgj. 15, Spitalle.	119/1 20/01/22 S- 0000180 G. H. A. Gj.
2	R. Z.'K.' shpk Lgj. 13, Plazh.	278/1 07/02/22 S- 0000189 K. L. A. H.
3	A. P.'Z. & Co'shpk Lgj. 15, Spitalle.	330/1 11/02/22 S- 0000268 G. H. A. Gj.
4	Shoqëria 'P.' Lgj. 1, Rr.'Taulantia, perball hotel 'A.'.	436 22/02/22 S- 0000192 E.L.K.L.
5	A. R. M.. Shkembi I Kavajes, zone Plazh.	518 02/03/22 S- 0000271 K.L. A.Gj.
6	A. B. Lgj. 1, Rr.'Taulantia'. ish kontinentali.	638 28/03/22 S- 0000287 K.L. E.L.
7	M. A. SH. Lgj. 15, Rr.'Frutore'.	651 28/03/22 S- 0000288 G.H. A.H.
8	A. S. Lgj. 1, Rr.'Kalaja'.	704/1 07/04/22 S- 0000293 K.L. G.H.
9	A. SH.Lgj. 3, Rr.'Epidam'.	736 11/04/22 S- 0002701 K.L. A.H.
10	Sh. S. S. Hamallaj. 'Kompleksi V.m.', vila c-54, Nj.Adm.Sukth.	768 14/04/22 S- 0002703 G.H. A.Gj.
11	A. Ë.Lgj. 13, perball xhamise, Plazh.	815 22/04/22 S- 0000299 K.L. A.Gj.
12	P. LL. 'Ll.01' shpk Lgj. 13, Plazh, perbri bar restorant 'Vera', Shkembi I Kavajes.	860 28/04/22 S- 0002706 K.L. G.H.
13	B. SH. Katund I Ri. Nj.Adm.Katund I Ri.	870 29/04/22 S- 0000231 A.Gj. K.L.
14	N. N. P.Lgj. 17, Rr.'Drita diturise'.	1197 06/06/22 S- 0000198 A.H. E.L.
15	G. C., A. M. 'M.' shpk Lgj. 1, Currila.	1307 10/06/22 S- 0002715 G.H. A.Gj.
16	N. Z. A.j Rr. Nj.Adm.Rrashbull.	1387/1 22/06/22 S- 0002743 K.L. A.H.
17	N. SH. Fshati Rinia, Rr.'Uniteti'.Katund I Ri.	1415 27/06/22 S- 0000199 A.H. K.L.
18	L. SH. Lgj. 15. Rr.'Gregori Durrsit'.	1471/2 04/07/22 S- 0000238 K.L. A.H.
19	L. H. N.' shpk Rrashbull.	1481/2 06/07/22 S- 0002718 G.H. A.Gj.
20	J. G.'R.-G' konst. Shkembi I Kavajes. Nj.Adm.Rrashbull.	1621 01/08/22 S- 0002721 G.H. A.Gj.
21	V. H. 'K.C.' shpk Lgj.3 Rr.'Egnatia'.	1650 11/08/22 S- 0002941

		A.Gj. G.H.
22	Th. K. Lgj.16 Rr.'Hysen Kertusha'.	1652 12/08/22 S- 0000201 G.H. A.H.
23	V. e A. B. Lgj.6. Rr.'Maliq Muco'.	1677/1 23/08/22 S- 0002752 K.L. A.H.
24	H. A. MURRANI Lgj.5. Rr.'Andon Naci'.	1799 12/09/22 S- 0000203 K.L. S.M.
25	A. B. Lgj.2 Rr.'Karl Topia'.	1859 14/09/22 S- 0002753 K.L. G.H.
26	O. B. 'G. o. g.' Lgj.15. Porto - Romano.	1983/1 04/10/22 S- 0002912 K.L. A.H.
27	B.A.H. 'Vellezerit H.' Lgj.15. Rr.'A.Goga', varrezat e reja.	2027 10/10/22 S- 0002730 K.L. A.Gj.
28	*E.* K. 'A. G.' shpk Lgj.15. Rr.'A.Goga'.	2098/1 19/10/22 S- 0002917 G.H.A.Gj.
29	A. Rr. 'Art konstr' Lgj.2. Rr.'Sefer Efendi', pll.Karanxha	2252/1 07/11/22 S- 0002757 K.L. A.H.
30	G. D. 'P.and g. o.'shpk Lgj.15 Rr.'K.Franceskan'.	2260/1 08/11/22 S- 0002758 K.L. A.Gj.
31	S.M. B.A. 'B. D' shpk Bisht kamez. Nj.Adm.Katund i ri.	2440/1 06/12/22 S- 0002947 K.L.A.H.
32	A. M.& L. M. "M.' shpk NB Frutore.	2441/1 15/12/22 S- 0000206 K.L. A.H.
33	M. K.Rr.'Hajdar Demiri".	2461 19/12/22 S- 0000208 K.L.A.H.
34	A.G. 'G. k.' shpk M. S. Lgj.17.Rr.'Ksanthipi Syko', pran Sig. Shoq.	2474 15/12/22 S- 0002951 G.H. A.Gj.
35	L.N. '3A Group' shpk Lgj.13. Rr.'QafeBote', Plazh.	2489/1 16/12/22 S- 0000207 K.L. A.H.

Aneksi nr. 2 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)", nga faqja 284 deri 306 të të Raportit Përfundimtar.

Subjektet që nga Kryeinspektori i IMT-së nuk janë nxjerrë vendime "Dënim me Gjobë", janë sipas tabelës:

Nr.	Emër Subjekti	Nr prot. P-V Konstatimi Inspektorët	Vendim - Prishje
1	A. M. K. [rrethim me rrjet/tel e shtylla/b] Manez e vjeter. Nj.Adm.Manez.	95 17/01/22 S- 0000263 G.H.A.Gj.	03 21/01/22 S- 0000121 jo 2
2	A. K. [porte/m, mur/rreth me blloqe/b] (ekzistuese) Lgj. 2, Rr.'Ulliri Celistani'.	228 31/01/22 S- 0000228 E.L.K.Lame	07 04/02/22 S-0000125 Po 04
3	S. K. [porte/m,rrethim me rrjet/tel] (ekzistuese) Lgj. 2, Rr.'Ulliri Celistani'.	229 31/01/22 S- 0000229 E.L. K.L.	08 04/02/22 S- 0000126 Po 05
4	M. A. C. [mur/rreth me blloqe/b] Kulle, Nj.Adm.Sukth.	415 18/02/22 S- 0000190 K.L. E.L.	11 21/02/22 S- 0000129 Po 09
5	D. Z. B. [plate/b, mure ndarese/t, kollona/d e mbules/d] Lgj. 15, Rr.'Shen Pali', portoromano.	430 21/02/22 S- 0000269 G.Hidri A.Gjata	13 24/02/22 S-0000131 Po 11
6	G. M.	585 11/03/22	16 11/03/22

	[obj lokal me konstr/d] (ekzistuese) Lgj. 15, te depozitat e naftes, hidrovor, portoromano.	S- 0000277 A.Gj. A.H.	S-0000134 Po 16
7	F. A. [vendosje tende/perg konstr/m, mbules/mush] Lgj.13, 'Lidi Gostivar', hekurudha plazh.	620 23/03/22 S- 0000285 K.L. A.Gj.	
8	F. G. [vendosje tende/dill me profil/m] Lgj. 6, Rr.'Deshmoret'.	636 25/03/22 S- 0000286 G.H. A.H.	28 30/03/22 S- 0000146 jo 26
9	I. SH. [obj 1kat/ekz i demtuar (amortizuar)] Lgj. 8, Rr.'Abdulla Teku'.	657/ 107/04/22 S- 0000293 K.L. G.H.	34 11/04/22 S- 0000152 Po 31
10	R. K. [ndarje e mureve te brendeshme mur/t, suvatime, zevendesim dritareve] (ne ndertim) Lgj. 13, Rr.'Pavarsia', Plazh.	734 08/04/22 S- 0000194 K.L. A.Gj.	
11	H. S. T. [mure/rreth me blloqe/b, porte/m] (ekzistuese) Vardardhe. Nj.Adm.Sukth.	794 19/04/22 S- 0000297 K.L. A.Gj.	38 26/04/22 S- 0000156 jo 35
12	R. Z. SH. [shkall me konstr/m vendosur ne fasaden e pallatit/ekz] Lgj. 11, Rr.'Petraq Boshnjaku'.	795 9/04/22 S- 0000294 K.L. G.H.	39 26/04/22 S- 0000157 jo 36
13	F. P. B. [obj/ekz (kiosk) me konstr/m, vetrata/xham, mbulese/tjeg] (ekzistuese) Lgj. 11, Rr.'Petraq Boshnjaku'.	796 19/04/22 S- 0000295 G.H.A.Gj.	40 26/04/22 S- 0000158 Po 37
14	J. A. G. [pedane/ekz me konstr/d e vetrata/xham] (ekzistuese) Lgj. 9 Rr.'A.Goga', pizeri 'Emporio'.	814 (A-A) 22/04/22 S- 0000298 K.L. G.H.	
15	M. Q. R. [mur/rreth me blloqe/b, porte/m, mbules/b,kollona/b] (ekzistuese) Lgj. 15, Rr.'Domenikanet', tre cezmat Spitalle.	1056 19/05/22 S- 0002735 K.L. A.H.	53 3/05/22 S- 0000171 jo 50
16	Xh. SH. [zenie e hapsires/publ me mur blloqe/b e porte/m/ekz] (ekzistuese) Lgj. 8, Rr.'Isuf Ferra'.	1200 06/06/22 S- 0002712 G.H. A.Gj.	58 09/06/22 S- 0000176 Po 56
17	V.T. [zenie e hapsires/publ me mur rrethues blloqe/b] (ekzistuese) Lgj. 8, Rr.'Isuf Ferra'.	1201 06/06/22 S- 0002713 G.H. A.Gj.	59 09/06/22 S- 0000177 Po 57
18	A. R. K. [shtese/ans konstr/m veshur/krtxhes ne kati1 te pallatit (Vera Berdaj)] (e perfunduar) Lgj. 2, Rr.'Sefer efendiu'.	1225 06/06/22 S- 0000235 E.L. S.M.	
19	N. H. M. [shtes/ans/ekz banjo me blloqe/b] (ekzistuese) Lgj. 8, Rr.'Isuf Ferra'.	1274 07/06/22 S- 0002714 G.H. A.Gj.	60 09/06/22 S- 0000178 Po 58
20	Qendra 'N.' [mure/rreth me blloqe/b e porte/m] (ekzistuese)	1359 17/06/22 S- 0002739 K.L. A.H.	62 20/06/22 S- 0000180 jo 60

	Fshati Vardardhe. Nj.Adm.Sukth.		
21	M. Sh. B. [vendosje roloti me goma per arsye biznesi prane rruges kryesore] Gjiri I Lalezit Ishem.	1411 24/06/22 S- 0000236 S.M. E.L.	
22	R. B. 'D.' [ngritur ne lartesi me blloqe/b mbi mrin rreth/ekz, armature/d, fitila/h, kollona pa beton] 13. Rr.'Milto Kultja', plazh.	1538 18/07/22 S- 0002719 A.Gj. G.H.	
23	B. Q. B. [shtese/ans mur/te qepen ne pll/ekz 5katsh] (ekzistuese) Lgj.4 Rr.'Petraq Boshnjaku'.	1582 25/07/22 S- 0002720 G.H.B.M.	75 27/07/22 S- 0000193 Po 72
24	E. D. [mure/rreth me blloqe/b] (ekzistuese) Lgj.14. Rr.'Asti Nushi'. Shkozet.	1653 12/08/22 S- 0002726 G.H.A.Gj.	80 17/08/22 S- 0000198 Po 76
25	F. I. V. [porte/m, mure/t, kollona/b] (ekzistuese) Lgj.14 Rr.'Asti Nushi'. Shkozet.	1654 12/08/22 S- 0002725 G.H. A.Gj.	79 17/08/22 S- 0000197 jo 77
26	R. D. M. [2 kontenier/m e kioske konstr/d, tende konstr/m me panel/sand] Gjiri i Lalzit. Bize.	1940 23/09/22 S- 0002754 S.M. E.L.	89 26/09/22 S- 0000207 Po 87
27	S. D. [shtese/kat me konstr/m e kartonxhes] Hotel 'Adis', Shkembi I Kavajes	1973 03/10/22 S- 0002755 K.L. A.H.	
28	F. N. B. [shtese/ans konstr/m, mbuluar me panl/sand, vetrada/xh, hapje dritare, vendosje motorra/kondic + aspirat, ne fasaden e pallatit] Lgj.12. Rr.'Koco Kazanxhi'.	2084 18/10/22 S- 0002913 S.M. E.L.	93 21/10/22 S- 0000242 jo 91
29	F. K. [vendosje porte/m] Lgj.13. Rr.'Japi Gija', plazh.	2100 19/10/22 S- 0002914 S.M. E.L.	
30	V. L. [garazh me tulla e dere/m] (ekzistuese) Lgj.9/1. Rr.'A.Goga'.	2101 19/10/22 S- 0002916 S.M. E.L.	95 21/10/22 S- 0000244 Po 92
31	A. M. [garazh me tulla e dere/m (e rrenuar)] (ekzistuese) Lgj.9/1. Rr.'A.Goga'.	2102 19/10/22 S- 0002915 S.M.A.Gj., E.L.	94 21/10/22 S- 0000243 Po 93
32	I pa identifikuar [vendosje e platforms betonit (ure)] (ekzistuese) Shkafane, Rr. e Lalzit. Nj.Adm.Manez.	2303 11/11/22 S- 0002759 K.L. A.H.	99 14/11/22 S- 0000248 Po 97
33	F. K. [vendosje porte/m ne tok/shtet] (e montuar) Lgj.13. Rr.'Japi Gija', Plazh.	2490 16/12/22 S- 0002920 S.M. E.L.	107 16/12/22 S- 0000256 Po 105
34	S. P. [rrethim i obj me llamarin] Lgj.13. përball 'Adriatikut', Plazh.	2543 29/12/22 S- 0002921 E.L. S.M.	109 30/12/22 S- 0000258 Po 107

Për vitin 2022 ndryshimet në buxhet për shpenzimet në mënyrë të detajuar paraqiten në Aneks:

Nr.	Programi	Llog. ekon.	Totali ndyshimeve (në 000/lekë)	Emërtimi i fondit	VKB/VKM
1	04970	609	-1,953	Fondi prej 10,033 mijë lekë është alokuar per objektin : Rikonstruksion i terrenit sportiv ne shkollën 9 vjecare "Fshat Rinia" NJA Katund i RI si kontribut i perbashket midis Bashkisë Durrës dhe World Vision Albania viti 2022	VKB Nr.32 Dt.28.04.2022
	09120	231	-2,375		
	9120	231	10,033		
	Totali 1		**5,705**		
2	03280	604	-11,700	Fondi prej 18,818 mijë lekë është alokuar për ndihmë financiare për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre	VKB Nr.57 Dt.31.05.2022
	03280	606	18,818		
	03280	609	-7,118		
	Totali 2		**0**		
3	04760	602	300	Fondi prej 300 mijë është per financimin e Festivalit Veror te Librit 2022	VKB Nr.73 Dt.12.07.2022
	04970	609	-300		
	Totali 3		**0**		
4	01110	231	-8,060	Fondi prej 30,601 mijë lekë eshte marrë nga kursimet e prokurimeve dhe është alokuar për financimin e shpenzimeve per karburant per efekt te rritjes se cmimit te karburantit per Ndërmarrjen e shërbimeve Komunale dhe Komunale Plazh	VKB Nr.74 Dt.12.07.2022
